

NJË FLLUSKË

Prej Oqeanit të Kur'anit të Gjithurtë!

خُدَايِ يُزَكِّرْمُ خُوذُ مُلْكِ خُوذُ رَامِي خِرْدُ أَرْتُو بُرَايِ تُو بِنِكْ دَارُ
بِهَسَايِ بِي كِرَانِ دَادَه

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ
وَعَلَى آلِهِ وَصَحْبِهِ أَجْمَعِينَ

Zoti im, Zotëruesi i dorëgjërësisë së pafundme; Ai e blen pasurinë e Tij prej teje dhe e ruan atë për ty dhe të jep në këmbim një çmim të madh.

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Lavdërimet qofshin për Allahun, Zotin e të gjitha botëve, dhe paqja dhe bekimet qofshin mbi prijësin e të dërguarve, shkëlqesinë tonë, Muhammedin a.s.m dhe mbi të gjithë familjen e tij dhe sahabët!

Mësoje, o besimtar që i kryen namazet e detyruar dhe që reciton Emrat e Allahut! Kur ti thua, për shembull, **أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ** Eshhedu en la ilahe il-la-llah, ‘Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut’, ose **مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ** Muhammedun Resulull-llah, ‘Muhammedi është i dërguari i Allahut’, ose **الْحَمْدُ لِلَّهِ** El-Hamdu lil-lah, ‘Falënderimi e lavdërimi i takojnë Allahut’, ti ke bërë një pretendim, ke shpallur një çështje dhe një bindje, dhe ke deklaruar një konkluzion. Në momentin që ti e ke

bërë këtë, qindra e miliona dëshmojnë për vërtetësinë tënde në çështjen tënde dhe ti ndjen sikur miliona e miliona besimtarët të cilët jetuan para teje dhe që shprehën të njëjtat shpallje e fjalë të konfirmojnë e të vërtetojnë ty. Gjithashtu, çfarëdo që dëshmon për të vërtetën e Islamit, çfarëdo që vërteton esencat apo dekretet dhe të gjitha provat, dëshmitë dhe treguesit tek të cilët mbështeten pjesët e kështjellës së Islamit, të gjitha këto të vërtetojnë e të afirmojnë në çështjen tënde dhe forcojnë bindjen dhe konkluzionin tënd. Përsëri, deklaratat e tua marrin bekime dhe dhurata të panumërta; dhe shpërblime të pallogaritshme derdhen (tek ti) në këmbim për to. Ato rrethohen nga një aureolë tërheqëse kuptimi dhe nga një gëzim, duke frymëzuar shpirtin të formuar prej rrezeve të ekstazave shpirtërore të komunitetit të besimtarëve dhe të shkëlqimeve të dritës të lëshuara nga zemrat e atyre që besojnë në Unitetin e Zotit, të cilët përthithin e marrin ujin e jetës prej burimeve të këtyre fjalëve të bekuara.

Mësoje, o shok! Është një rregull i vërtetuar se ai që pohon diçka preferohet mbi atë që e mohon atë. Kjo është kështu për shkak se mohimi është i vetëkufizuar, ndërsa pohimi nuk kufizohet nga një burim i veçantë apo mjet. Në qoftë se mijëra njerëz e mohojnë diçka, ky mohim nuk do të ishte më i fortë se ai i një personi të vetëm. Por, në qoftë se një mijë njerëz pohojnë diçka, pohimi i njërit prej tyre do të jetë aq i fortë sa ai i të gjithë atyre. Supozo që një njeri e sheh hënën nëpërmjet një dritareje, një tjetër e shikon nëpërmjet një tjetre dhe një i tretë e sheh nëpërmjet një të trete, dhe kështu me rradhë. Meqenëse secili e ka shikuar hënën nëpërmjet dritares së tij dhe të gjithë ata e konfirmojnë dhe e vërtetojnë, pohimi nga njëri për ekzistencën e hënës do të ishte aq i fortë sa ai i numrit të të gjithë atyre të cilët kanë deklaruar se e kanë shikuar hënën. Në kontrast, supozo që një njeri nuk e ka parë hënën për shkak se ai nuk ka një dritare që të shikojë përmes saj; një tjetër për shkak të dobësisë së shikimit të tij dhe një i tretë nuk e shikon për shkak se nuk e ka soditur, e kështu me rradhë. Atëherë, fuqia e mohimit të secilit do të kufizohej tek vetvetja. Mohimi nga ana e tyre ekzistencën e shfaqjes së hënës nuk do të thotë absolutisht se hëna nuk ekziston në vetvete. Mohimi i secilit nuk e mbështet atë të tjetrit për shkak të llojshmërisë së arsyeve, pavarësisht shumësisë së atyre që e mohojnë. Kështu, mohimi i secilit kufizohet tek ai që mohon.

Në qoftë se ti e ke kuptuar këtë pikë të hollë, mësoje se sikur e gjithë bota e çudhëzimit dhe e mosbesimit të binin dakord mbi

mohimin e një çështjeje të besimit, mohimi i tyre do të ishte si mohimi i një personi të vetëm. Ai nuk ka asnjë vlerë përveç të qenit një argument i mangët, i kufizuar tek mohuesi. Sa për të udhëzuarit mbi çështjet e besimit, meqenëse ata vërtetojnë e i konfirmojnë të gjithë dhe secilin, secili prej tyre ka aq shumë dëshmitarë sa numri i të gjithëve.

Mësoje, o shok! Pjesët ose gurët e një ndërtese të fortë mbështesin njëri-tjetrin dhe secili merr forcë nga tërësia, dhe dobësia e secilit më vete largohet për shkak se secili mbështet tjetrin. Është sikur e gjithë ndërtesa ndihmon secilën prej pjesëve të saj. E ngjashme me këtë, njohja e veçorive të secilës prej degëve dhe frutave të një peme varet nga njohja e tërësisë së pemës, ndërkohë që secila sjell njohje për tërësinë. Është sikur secili prej tyre të ishte një dritare nëpërmjet të cilës të shikohet për tek gjithësecili, dhe shërben si një standart për ta njohur atë. Është në këtë mënyrë që secili prej rrezatimeve të besimit dhe Islamit dhe të çështjeve të tyre mbështetet nga e tëra dhe mund të jetë më e qartë dhe e vetëkuptueshme paralel me numrin e të tërës. Sa më shumë të degëzohen besimi e Islami, aq më të bindur e më të sigurtë jemi ne për të vërtetën e secilës prej pjesëve të tyre.

Pavarësisht këtij fakti, nefsi dhe shejtani priren drejt rrugës së kundërt; ato marrin dobësinë e një pjese si një pretekst për ta parë të tërën si të dobët.

Mësoje, o shok! Çdo pjesë e universit shërben si një njësi krahasimi për të parë mundësinë e ekzistencës së të gjitha pjesëve të tij. Anasjelltas, pjesët e universit shërbejnë si njësi krahasimi për të shikuar mundësinë e ekzistencës së secilës prej pjesëve të tij.

Mësoje, o shok! Pjesa më e vogël e çdo tërësie të madhe ka nevojë (për qënien e vet) për çfarëdo që i nevojitet tërësisë (për qënien e saj). Çfarëdo që i nevojitet një peme, gjithashtu ajo i nevojitet edhe një fruti.

Kështu, Krijuesi i frutit, madje i më të vogëlës së qelizave të tij individuale, sigurisht është Krijuesi i pemës dhe për të njëjtën arsye gjithashtu është Krijuesi i tërësisë së tokës dhe i tërësisë së pemës së krijimit.

Mësoje, o shok! Kjo është një çështje, dy anët ose dy gjysmat e së cilës janë pafundësisht të largëta nga njëra-tjetra. Secila gjysëm është si një bërthamë, e cila ka lulëzuar dhe është rritur në një pemë të

zhvilluar. Pas dëshmisë së rritjes së saj, askush nuk duhet të ketë asnjë dyshim për veçantinë dhe autenticitetin e asaj çështjeje. Do të ishte e mundur të kishte ndonjë dyshim për natyrën e bërthamave sa kohë që ato të mbeten si bërthama nën tokë; por pasi secila të jetë rritur e të jetë bërë një pemë dhe të ketë prodhuar fruta, në qoftë se ti akoma do të kishe dyshim për llojin e saj, ndërsa frutat e saj dëshmojnë për çfarë lloji është, dhe në qoftë se ti do ta ngatërroje atë me ndonjë farë – bërthamë– tjetër, frutet e saja do të të kundërshtonin e përgënjeshtonin ty.

Për shembull, nuk do të ishte e lehtë për ty ta pandehje një farë, e cila është bërë një pemë molle, si një farë kungullujëse, veçse në qoftë se do ta pandehje atë të jetë ashtu ose t'i pandehje të gjitha frutet e saj të ndryshoheshin e ktheheshin në kungullujëse, gjë e cila është e pamundur.

Profetësia është si një bërthamë prej të cilës pema e Islamit është rritur me të gjitha lulet e frutet e saj. Kurani është një diell i cili ka prodhuar frutet e planetëve të njëmbëdhjetë shtyllave të Islamit.¹ A do të ishte e mundur që akoma të kesh dyshime për autenticitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e asaj bërthame pasi ne i kemi parë të gjitha frutet e saj të vyera?

Mësoje, o shok! Një vezë kloçitet –ngrohet– dhe një zog palloi ose një zog tjetër i bukur shfaqet. Pastaj ky zog ose zogu i porsalindur rritet e bëhet i madh, bëhet një pallua i bukur ose një zog tjetër i bukur duke fluturuar në qiell. Ose një pemë rritet nga një bërthamë dhe i shtrin degët e saj lart në qiell dhe prodhon fruta. Nëse dikush do të kërkonte të gjejë në lëvozhgën e vezës atë çfarë ka dëgjuar rreth bukurive të palloit ose të zogut, ai sigurisht që ka mashtruar vetveten. Ose në qoftë se dëshiron të gjejë në lëvoren e farës së saj nën tokë atë çfarë ai ka dëgjuar rreth madhësisë, luleve dhe fruteve të pemës, ai sigurisht ka bërë një marrëzi nga vetvetja.

Gjithashtu, në qoftë se dikush e shikon profetin tonë a.s.m në mënyrë sipërfaqësore, në dritën e asaj që rrëfejnë librat e historisë që prej fillimit të jetës së tij, njeriu nuk do të ishte në gjendje ta perceptonte e vlerësonte vlerën e tij dhe nuk do ta njihje plotësisht

¹Domethënë, gjashtë shtyllat e Imanit dhe pesë shtyllat e Islamit. (Përkthyesi)

karakterin dhe personalitetin e tij shpirtëror, ndonëse feja Islame dhe civilizimi i botës së Islamit kanë lulëzuar prej tij. Njeriu duhet t'i shikojë tregimet e librave të historisë e të biografisë si një mbulesë e hollë, e cila ashtu si hëna që u çu më dysh nga një shenjë e gishtit të profetit, duhet të grisët për ta shfaqur atë si bërthamën dhe themeluesin e këtij civilizimi, njeriu duhet t'i shikojë ato çfarë sheh prej thjesht dimensionit njerëzor të qënies së tij si një guaskë ose si një farë prej të cilës është zhvilluar pema e bekuar Tuba e Muhammedit a.s.m; ajo është një pemë që është vaditur prej bekimeve Hyjnore dhe është lulëzuar e zhvilluar vazhdimisht përmes kohës nga ndihma e Përkujdesjes Hyjnore. Çfarëdo që dikush dëgjon prej thjesht cilësive dhe gjendjeve njerëzore dhe prej fillimit të jetës së tij, ai nuk duhet të kapet e mbyllet aty, por duhet ta ngrëjë kokën e tij me shpejtësi dhe në çdo herë ta drejtojë lart shikimin tek rangu i lartë i madhështisë që ai arriti dhe ku u ngjiti deri tek pika përfundimtare e madhështisë së tij, që është diçka e pamundur për njeriun ta perceptojë.

Gjithashtu, dikush që gjykon karakterin me një dyshim ose me një kureshtje të mund të bëjë dallim midis të qënurit një subjekt dhe të qënurit objekt, një burim dhe një pasqyrë. Ai nuk mund të bëjë dallim ndërmjet të qënurit si një shkronjë, e cila nuk ka kuptim në vetvete dhe prandaj ajo tërheq vëmendjen drejt diçkaje tjetër dhe jo vetvetes dhe ndërmjet të qënurit një fjalë e cila, duke pasë një kuptim në vetvete, tërheq vëmendjen drejt vetes. Ai nuk mund të bëjë dallim midis asaj që është esenciale ose e brendaqenësishme që i takon Qënies Hyjnore dhe midis asaj që përhapet ose manifestohet prej tij. Profeti a.s.m është thjesht një shërbëtor i Zotit xh.sh. dhe është më i avancuari se çdokush tjetër në adhurim dhe në robëri ndaj Tij. Ne duhet ta shohim atë si një personalitet i cili është objekti i manifestimeve Hyjnore. Çfarëdo që ai ka prej plotësive është vetëm prej Allahut të Gjithëfuqishëm.

Ashtu siç e kemi përmendur në mënyrë të përsëritur, asgjë, qoftë e madhe apo e vogël, nuk mund të jetë nga vetvetja burimi real apo origjina e ndonjë gjëje. Por, grimca më e vockël, ashtu si një pasqyrë duke reflektuar atë çfarë manifestohet në të prej manifestimeve të Zotit xh.sh mund të përfshijë madje edhe yjet e qiejve. Ndërsa një njeri i pavëmendshëm ndaj realitetit të gjërave e shikon çdo gjë përsa ka të bëjë me vetveten, dhe jo në lidhje me origjinën e asaj që manifestohet në të, dhe është kështu i humbur e i çudhëzuar në përfytyrimin e artit Hyjnor si natyrë.

Mësoje, o shok! Sigurisht dua ja ose lutja përmban kuptimet e besimit në Një Zot dhe të adhurimit. Ai që lutet në mënyrë të fshehur ose të heshtur duhet të jetë i bindur se Ai, të Cilit i drejton lutjen, e dëgjon dhe i njeh dëshirat dhe nevojat e tij dhe është i Aftë t'ia plotësojë kërkesat. Kjo kërkon bindjen se Ai të Cilit i drejtohet lutja është i Gjithëditur për të gjitha gjërat dhe i Gjithëfuqishëm për të gjitha gjërat.

Mësoje, o shok! Nëpërmjet manifestimit, dielli –llampa e botës– mund të hyjë në syrin e një mize dhe e ndriçon atë. Por flaka e prodhuar nga ndezja e një shkrepseje nuk mund të hyjë vetë në atë sy. Në qoftë se ajo do të hynte, syri do të verbohej. Në të njëjtën mënyrë, një grimcë e vockël mund të jetë një objekt i manifestimeve të Emrave të 'Diellit' të Parapërrjetshëm, ndërsa do të ishte e pamundur për grimcën të përmbante diçka vërtet efektive dhe operative në krijim, edhe sikur ajo të ishte më e vogël se më e vogëla e grimcave.

Mësoje, o shok! O nefs kryeneç, mburravec e mendjemadh! Shiko se sa i pafuqishëm, i varfër dhe i mjerë je ti! Një mikrob që mund të shihet vetëm nëpërmjet zmadhimit të tij qindra herë mund të të konfrontojë e të të shpartallojë ty plotësisht.

Mësoje, o shok! Do të shfaqej se deri në çfarë shkalle është njeriu i dobët dhe i pafuqishëm kur lihet në tekat e tij dhe para Fuqisë dhe Madhësisë së Krijuesit, është se kur niset të kalojë e shqyrtojë në kujtesën e tij, e cila thuhet se zë një hapësirë me përmasën e një fare sinapi, ai e gjen këtë kokërr të vockël të shtrihet para tij si një shkretëtirë e madhe që është e pamundur të përshkohet.

Ndërsa njeriu nuk mund ta përfundojë udhëtimin përmes kujtesës së tij, me përmasën e një kokrre, si do të mundej ai të udhëtonte përmes tërësisë (së mendjes së tij)? Në qoftë se, lidhur me mendjen, kujtesa bëhet si një shkretëtirë e pakufishme, mendja do të jetë si një oqean i pamatshëm. Lavdi Zotit, i Cili e ka bërë kokrrën (e kujtesës) si një botë për mendjen e njeriut dhe e ka bërë dynjanë për të si një kokërr!

Mësoje, o shok! Njeriu padrejtësisht ia atribuon frutet e veprës së një grupi një personi të vetëm dhe supozon se ai individ i ka prodhuar ato fruta. Nga kjo padrejtësi buron një lloj i vërtetë shirku – përshkrim i partnerëve me Zotin. Sepse supozimi se rezultati i punës së një komuniteti dhe produkti i vullnetit të tyre të lirë të kenë buruar prej një

personi të vetëm do të thotë të pranosh se ai person të kishte një fuqi të jashtëzakonshme, e cila ka arritur shkallën e krijueshmërisë. Perënditë e grekëve të lashtë dhe të popujve të tjerë u sajuan e u lindën prej këtyre supozimeve djallëzore.

Mësoje, o shok! Njeriu është i rrethuar nga rrathë bashkëqëndrorë. Njëri prej atyre rrathëve formohet nga rrobat e tij dhe trupi i tij. Një rreth tjetër është ai i qytetit të tij të lindjes, dhe një tjetër është ai i tokës, dhe një tjetër është bota e dukshme materiale, dhe kështu me rradhë. Por, përveç sferës më të vogël, ai nuk ka pjesë e as influencë në asnjërin prej këtyre rrathëve. Ai nuk është në gjendje të bëjë asgjë thelbësore lidhur me rrathët e tjerë, përkundrazi, ato kanë një efekt mbi të. Ai mundet vetëm të përfitojë prej tyre edhe materialisht edhe shpirtërisht. Në qoftë se do të guxonte të ndërhyjë në to, ai vetëm do të pakësonte dobitë e përfitimit të tij prej tyre për shkak të natyrës së tij të mangët.

Mësoje, o shok! Ai që reciton Emrat e Allahut përfiton prej tyre nëpërmjet shumë prej aftësive të tij. Nëpërmjet disave prej atyre aftësive ai përfiton prej recitimit me vetëdijen e mendjes dhe të zemrës, dhe nëpërmjet të tjerave ai përfiton pa vetëdije. Kështu, për recitimin e bërë pa vetëdije nuk mund të thuhet se nuk sjell dobi.

Mësoje, o shok! Allahu e ka krijuar njeriun prej një përbërje shumë të çuditshme. Ai është një qenie e njëtrajtshme e përbërë prej një shumësie të madhe pjesësh. Ai është edhe i thjeshtë, edhe kompleks në të njëjtën kohë. Ai është një individ i veçantë por i përbërë nga organe, gjymtyrë, shqise, ndjenja dhe aftësi, secila prej tyre ka dhimbjet dhe kënaqësitë e saja, së bashku me të tjerat që lidhen me ardhjen nga tërësia e trupit. Ndodhet një ndihmë e shpejtë e ndërsjellë dhe një mbështetje midis tyre. Në sajë të urtësisë së këtij krijimi të mahnitshëm, njeriu u bë objekt i manifestimeve të të gjitha llojeve të kënaqësive dhe të bekimeve dhe të të gjitha shkallëve të larmisë së plotësive –sidomos në Ahiret– në qoftë se ai do të ndiqte rrugën e adhurimit. Ndërsa, në qoftë se, në kontrast, ai do të ndiqte rrugën e çudhëzimit e të egoizmit, ai do të ishte objektiv i të gjitha llojeve të dhimbjeve dhe vuajtjeve dhe i të gjitha formave të torturave. Dhimbja e dhëmbit është e ndryshme nga dhimbja e veshit. Kënaqësitë e syve janë të ndryshme nga kënaqësitë e gjuhës. Gjithashtu, kënaqësitë dhe dhimbjet që vijnë nga prekja, imagjinata, arsyeja dhe zemra, që të gjitha janë të ndryshme nga njëra–tjetra.

Mësoje, o shok! Dobitë e mospërcaktimit të kohëve të vdekjes janë një provë e qartë e qënies së saj e përcaktuar në njohjen e Krijuesit, Themeluesit. Po të kishte qenë i përcaktuar për njeriun, duke supozuar atë të jetë i varur nga një ‘ligj natyror’, njeriu do të kishte menduar që exheli do të kishte qenë i papërcaktuar brenda njohjes Hyjnore. Meqënëse ai nuk është përcaktuar për njeriun, atëherë njeriut nuk i mbetet asnjë e drejtë të supozojë se ai është gjithashtu i papërcaktuar (në njohjen Hyjnore).

Mësoje, o shok! Recitimi i rregullt i disa Emrave Hyjnorë është midis shenjave ose treguesve të Islamit. Shenjat e Islamit janë gjithashtu të lartësuara për ‘dorën’ e dëshirës për t’u dukur dhe të hipokrizisë për t’i arritur – domethënë ato janë më të larta se t’i arrijnë duart e hipokrizisë.

Mësoje, o shok! Përbërja e formulës duke shpallur Unitetin Hyjnor **لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ** *La i lahe il –lallah*, ‘Nuk ka zot tjetër përveç Allahut’, është për qëllimin e izolimit të zemrës prej llojeve të lidhjeve (të brendshme) me çfarëdo që e ndan njeriun nga Zoti dhe me objektet e rreme të adhurimit. Sepse ai që e reciton këtë formulë ka shumë aftësi e shqisë; secila prej tyre duhet të bindet për Unitetin Hyjnor, duhet të izolohet e pastrohet absolutisht prej qëndrimeve politeiste të veçanta për të.

Mësoje, o shok! Nuk do të bënte ndryshim nëse ti do t’ia dërgoje si dhuratë shpërblimin e recitimit të sures ‘El Fatiha’, kapitullit hapës të Kuranit, një njeriu të vetëm ose njëmijë apo miliona njerëzve, meqë nuk ka ndryshim ndërmjet një njeriu dhe mijëra njerëzve në dëgjimin e një fjale të shprehur. Sepse gjërat jomateriale shumohen ose përhapen shumë shpejt dhe një kopje e saj nuk e pengon një tjetër, si një dritë duke u reflektuar në një ose në miliona pasqyra – në pasqyrën e një individi ose në mijëra pasqyra.

Mësoje, o shok! Salevati dhe selami, bekimet dhe paqja mbi profetin Muhammed a.s.m është si përgjigje ndaj thirrjes –ftesës– së Dhënësit të mirësive, i Cili përhap bekimet e Tij me bollëk dhe ka shtruar tryezën e mirësive të Tij mbi të, të cilin e nderoi me Miraxhin. Kur ai që bën salevate e selam mbi profetin a.s.m, e përmend profetin me një atribut (të mirë), ai duhet të përqëndrohet dhe të reflektojë mbi atë që ai vlerëson me qëllim që ai të mund të përmllohet për t’i çuar salevat e selam gjithnjë e më shumë.

Mësoje, o dijetar fetar! Mos u dëshpëro për indiferencën e njerëzve ndaj njohjes tënde dhe për papërshtatshmërinë e rrogës –shpërblimit– që ata të paguajnë. Sepse paga ose shpërblimi vjen në përpjestim me nevojën dhe jo me shkallën e meritës personale. Shpërblimi i meritës personale do të të jepet në Ahiret. Nuk është e lejueshme për ty ta shesësh atë –meritën tënde personale– për një çmim të vogël, për furnizimet vegullimtare të kësaj bote.

Mësoje, o shkruer dhe o folës publik që u adresohesh njerëzve me gjuhën e medias! Ti duhet të jesh modest para njerëzve dhe të ndjehesh i lirë të shpallësh mangësitë e tua duke u penduar. Ti nuk ke të drejtë të jesh vetëkrenar e të publikosh atë çfarë është kundra treguesve apo shenjave të Islamit. Kush të ka lejuar ty, kush të ka deleguar, dhe nga ku e ke marrë të drejtën për të përhapur dyshime të pabaza rreth fesë Islame, për të përhapur çudhëzim midis kombit dhe komunitetit mysliman? A mos vallë mendon se i gjithë kombi është i çudhëzuar si ti? Askush nuk është i lejuar t'i shohë apo t'i shfaqë të tjerët si të çudhëzuar. Nga ku e ke marrë lejen të lëndosh tërësinë e komunitetit musliman si të devijuar prej simboleve të Islamit? Sigurisht, të publikosh në media atë që shumica e besimtarëve nuk e pranojnë është thirrje për devijim, dhe ai që e publikon një çështje të tillë është thirrës për diviacion – shmangie.

Mësoje, o shok! Meqënëse mosbesimi është e kundërta e besimit, mosbesimtarët janë armiqësorë ndaj besimtarëve. Për këtë arsye, për mosbesimtarët –mohuesit– me të cilët është e pamundur të vendosësh shoqëri, është krejtësisht e pavlerë. Kurani i gjithurtë i ka dënuar mosbesimtarët dhe paraardhësit e tyre mohues me dënim të përjetshëm në Xhehennem. O njerëzit e Kuranit, mos pritni që ata t'ju duan e t'ju ndihmojnë! Thuaj,

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ ﴿١﴾ نِعْمَ الْمَوْلَىٰ وَنِعْمَ النَّصِيرُ

“Dhe Allahu është kurdoherë i Gjithëmjaftueshëm si Rregulluesi i të gjitha punëve”² dhe “Sa Mbrojtës i Shkëlqyer (është Allahu) dhe sa Ndihmues i Shkëlqyer!”³

²Kur'an, 4:172

³Kur'an, 8:40

Mësoje, o shok! Ndryshimi midis civilizimit të mosbesimtarëve dhe atij të besimtarëve (të vërtetë) është ky:

I pari është barbarizëm, i cili e maskon vetveten dhe që paraqitet si civilizim, nga ana e jashtme është i shndritshëm dhe nga ana e brendshme është i shëmtuar. Në dukje është i këndshëm, por në realitet i frikshëm.

Sa për civilizimin e besimtarëve, ana e tij e brendshme është më e lartësuar se sa ana e tij e jashtme. Në kuptim ai është më i plotë se sa në aparençë – paraqitje. Ai përbëhet nga miqësia e ngushtë, dashuria dhe nga ndihma e ndërsjellë. Kjo është kështu për arsye se, për llogari të besimit të tij dhe vërtetimit të Unitetit Hyjnor, një besimtar shikon vëllazërinë midis të gjitha gjërave në univers dhe shoqërinë e dashurinë midis të gjitha pjesëve të tij, veçanërisht midis qënieve njerëzore dhe sidomos midis besimtarëve. Ai gjithashtu e shikon vëllazërinë në origjinë dhe unionin –bashkimin– në fund. Domethënë, të gjitha gjërat vijnë nga një origjinë e vetme, dhe pasi të degëzohen e ndahen si degët e një peme bashkohen në fund.

Sa për mosbesimtarin –mohuesin– për llogari të mosbesimit të tij, ai i shikon të gjitha gjërat si armiqtore dhe të huaja e të veçuara nga njëra-tjetra. Ai e shikon armiqtësinë madje edhe midis vëllezërve, meqë në shikimin e tij, vëllazëria është vetëm një pikë takimi midis dy vijave; njëra vijë është ajo e ndarjes së parapërdjetshme e shtrirë në të shkuarën dhe tjetra është ajo e ndarjes së përjetshme e shtrirë përpara në të ardhmen. Vetëm nëpërmjet zellit kombëtar ose pasionit racial, ndjenja e vëllazërisë midis mosbesimtarëve mund të jetë e fortë për një kohë të shkurtër e të kufizuar, por dashuria që një jobesimtar ndjen të ketë për vëllain e tij është në fakt për vetveten.

Aspektet e pranueshme njerëzore të civilizimit të mosbesimtarëve dhe të virtyteve shpirtërore për t'u parë në të janë ose të huazuara prej civilizimit të Islamit, ose të mbetura prej feve qiellore, ose janë marrë prej udhëzimit të Kuranit.

Në qoftë se dëshiron, imagjinoje veten tënde midis një grupi në praninë e një udhëheqësi shpirtëror musliman në fshatin 'Nurshin', biseda dhe këshilla e të cilit lëshon rreze prej civilizimit Islamik. Në prezencën e tij ti do të gjesh mbretër duke qëndruar ulur me të varfër dhe engjëj të përzier me qenie njerëzore. Pastaj, shko në Paris, tek

kryeqyteti i Europës dhe ndiq një takim të baronëve apo mbretërve. Ti do të gjesh atje ‘akrepa’ të veshur me veshje njerëzore dhe ‘demonë’ në formën e qënieve njerëzore.

Dallimin midis civilizimit të Kuranit dhe civilizimit të sotëm i kam shpjeguar në trajtesën “El-Lemaviu” – “Rrezëllimat” në fund të koleksionit “Sozler” dhe në veprën “Es-Sanihat”.

رَاجِعُهُمَا تَرَى أَمْراً عَظِيماً غَفَلَ عَنْهُ النَّاسُ

Referoju atyre të dyjave që të shohësh në to një çështje të madhe, ndaj të cilës njerëzit kanë qenë të pavëmendshëm.

Mësoje, o shok! Në qoftë se dëshiron Ixhtihad,⁴ dera për Ixhtihad është e hapur. Por nuk është e lejuar të hyni nëpërmjet asaj dera në rrethanat vijuese:

Së pari: Në dimër, kur stuhitë janë të forta, edhe vrimat e vogëla bllokohen; në asnjë mënyrë nuk do të ishte e arsyeshme të hapen dyer të reja; si mund të hapen dyert? Në sulmet e rrepta të përmbytjeve të fuqishme, të bësh hapje në mur me qëllim që ta riparosh atë, të çon në mbytje e shkatërrim.

Së dyti: Mësimet themelore të fesë Islame kërkojnë që Ixhtihadi të mos ndërhyjë në to. Ato janë si ushqimi bazë ose si lëndë ushqyese për muslimanët dhe janë neglizhuar, madje janë tronditur e refuzuar. Për këtë arsye, ne duhet të përpiqemi me të gjithë fuqinë tonë t’i gjallërojmë ato dhe t’i vëmë në zbatim në jetën praktike. Atëherë, në qoftë se do të lindte nevoja, Ixhtihadi do të mund të aplikohet në çështjet teorike dytësore, të cilat në fakt janë bërë nga dijetarët e hershëm mjaft të gjëra për të rrethuar e përfshirë përgjigjet për nevojat e të gjitha kohëve.

Së treti: Çdo shekull apo periudhë kohe ka mallrat e ndryshëm e shumë në kërkim në tregjet e saj. Mallrat në kërkim në tregun e sotëm janë politikat dhe sigurimi i mjeteve të domosdoshme të jetesës së kësaj bote. Por në kohën e shekullit që vijoi atë të profetit a.s.m, ajo që ishte në kërkim ishte të nxirnin si përfundime të deduktueshme prej fjalës së Tij – Kuranit– gjërat që kënaqnin Krijuesin e universit dhe që siguronin

⁴Gjykime të pavarura në Sheriat; interpretim i Sheriatit, ligjit të shenjtë.

lumturinë e përjetshme. Meqenëse mendjet, zemrat dhe shpirtërat, që të gjitha u përqëndruan në atë kohë mbi njohjen e gjërave që janë të kënaqshme për Zotin e qiejve dhe të tokës, kushdo që kishte mundësi ose aftësi, mësoi me vetëdije ose pa vetëdije prej rrethanave dhe ndodhive dhe bisedave që sundonin në atë kohë. Ishte sikur gjithçka shërbeu për të dhënë mësim dhe për t'i përgatitur ata me kapacitet të mjaftueshëm për Ixhtihad, kështu që lënda djegëse në mendjet e tyre ndizej edhe në qoftë se nuk ndizej me 'shkrepësen' e studimit të veçantë. Kur ata i drejtoheshin Ixhtihadit, kjo do të thonte për ta dritë mbi dritë.

Ndërsa sot, mendjet dhe zemrat janë në konfuzion të madh. Njerëzit nuk mund të përqëndrohen mbi një subjekt dhe rrymat moderne të mendimit dhe politikat dominojnë mendjet. Për këtë arsye, një individ me të njëjtën shkallë inteligjence si ajo e Sufjan Ibn Uyajna⁵ për të arritur kompetencën për të bërë Ixhtihad kërkon dhjetëfishin e kohës që pati Sufjani për arritjen e Ixhtihadit. Sepse kur Sufjani në moshën e pubertetit nisi të studionte për Ixhtihad, kapaciteti i tij ishte si një shkrepëse gati për ta nderur. Ndërsa kapaciteti i shokut të tij në këtë kohë është aq larg ixhtihadit sa shkalla e të qënurit të tij i zhytur thellë në shkencat jofetare moderne dhe fortësohet prej tyre sa shkalla e prokopisë me to.

Së katërti: Në qoftë e ai që dëshiron të bëjë ixhtihad, për të zgjeruar sferën e çështjeve dytësore Islamike, synon të arrijë tek një shkallë më e lartë e devotshmërisë dhe të ndjekjes më strikt të mësimëve themelore të Islamit, kjo dëshirë shkakton plotësim. Por në qoftë se ai neglizhon të ndjekë shtyllat e Islamit dhe preferon jetën e kësaj bote mbi Ahiretin –botën tjetër– atëherë dëshira e tij për të bërë Ixhtihad bëhet një prirje për shkatërrim dhe një mjet për të kërkuar rrugë për të qenë i lirë prej përgjegjësive fetare.

Së pesti: Dobia prej një obligimi fetar është shkaku i të preferuarit për ta përmbushur atë; ajo dobi nuk është shkaku i qënies së saj e ligjësuar në vend të parë; me fjalë të tjera, dobia është urtësia e të

⁵Sufyan Ibn Uyajna ishte njëri prej dijetarëve më të mëdhenj të historisë Islame. I lindur më 726, ai vdiq në 874. Ai i njihnte mirë hadithin dhe fik'hun. Ai takoi më shumë se tetëdhjetë dijetarë që i përkisnin gjeneratës që vijoi sahabët. Ai transmeton hadithe prej Zuhri Ibn Munkadir, Ibn Al Zinad, A'mash dhe të tjerët. Imam Shafiu, Shuba, Ibn Is'hak, Ibn Xhurajh dhe Jahja Ibn Kethir dhe disa të tjerë transmetojnë prej tij. Ai ishte një dijetar shumë i devotshëm.

preferuarit dhe jo shkak për ligjësim. Por shikimi i kësaj kohe e bën dobinë shkakun për ligjësim. Shikimi modern gjithashtu orientohet së pari dhe pikërisht tek lumturia e kësaj bote; kurse shikimi i Sheriatit orientohet së pari dhe pikërisht tek lumturia e Ahiretit, dhe e merr në konsideratë jetën e kësaj bote proporcionalisht për qënien e saj një mjet për të fituar lumturinë e përgjeshme.

Për më tepër, shumë nga ‘nevojat’ moderne, me të cilat njerëzit janë mësuar, janë bërë thjesht ‘domosdoshmëri të jetës’ për shkak të abuzimit të njerëzve nga zgjedhja e tyre e keqe dhe prej tendencave të paligjshme. Prandaj ‘domosdoshmëria’ e tyre nuk mund të pranohet e nuk mund të bëhet bosht për dekretet e lejueshmërisë –Ruhsat; nuk mund të bëhet mjet për bërjen e gjërave të palejueshme të lejueshme. Ashtu si dikush që dehet me një pije haram dhe që nuk shfajësohet për sjelljen e tij në kohë dehje –domethënë ai që është dehur me vullnetin e tij të lirë– shfajësimi për dehjen nuk mund të pranohet si justifikim për sjelljen kriminale; po ashtu, çdo ixhtihad me këtë shikim në këtë kohë konsiderohet të jetë ‘tokësorë’ dhe jo ‘qiellorë’. Dhe çdo shtojcë e një ligji apo një amendament në ligjet e Krijuesit të qiejve e të tokës dhe në rregullat e shërbëtorëve të tij pa autoritetin e Tij, është e papranueshme dhe hidhet poshtë. Për shembull, disa njerëz të pakujdesshëm e miratojnë hytben e ditës së Xhuma dhe të disa shenjave të Islamit në gjuhën e atij vendi, me qëllim që njerëzit e zakonshëm nga masat e muslimanëve të kuptojnë ngjarjet politike. Por ky gafil –i pakujdesshëm– nuk e din se politikat e kohës aktuale janë bërë të ngatërruara e të përziera me gënjeshtër, me dredhi e ligësi, sa që janë bërë tamam si pëshpëritjet e djallit. Prandaj, pëshpëritjet e politikës nuk kanë të drejtë të ngjiten mbi atë pozitë të lartë.

Gjithashtu, ky injorant nuk e kupton se shumica e muslimanëve kanë nevojë që t’u përshkruhen mësimet thelbësore të Islamit, çështjet e pakundërshtueshme të Islamit dhe urdhëresat e njohura të domosdoshme dhe t’i zbatojnë shartet -kushtet- e imanit dhe të Islamit dhe shkallët e ihsanit- sinqeritetit dhe mirëbërësisë. Dhe duke i dëgjuar shumë barazohen njerëzit e zakonshëm me të diturit në përkujtim e sjelljen ndërmend nëpërmjet dëgjimit të Kuranit. Muslimani i zakonshëm e kap këtë kuptim të përgjithshëm nga Kurani Kerim.⁶

⁶Ndërsa çështja e gjashtë është lënë e nënkuptuar këtu dhe është sqaruar në ‘Fjalën e Njëzet e Shtatë’ – Trajtesa e Ixhtihadit.

Mësoje, o ti që je i mbështjellur nga pakujdesia dhe nga errësira e natyralizmit, dhe si rrjedhojë je bërë ‘i verbër’ dhe ‘i shurdhër’, një adhurues i shkaqeve materiale në errësirën e të imagjinuarit natyrën si origjinën e ekzistencës! Unë do të të shpjegoj ty njëren prej pesëdhjetë e pesë ‘gjuhëve’ të folura nga secila prej grimcave të vockëla dhe prej pjesëve përbërëse të universit për të dëshmuar ekzistencën e domosdoshme të Zotit të Gjithëfuqishëm dhe Unitetin e Tij, Perëndinë – Hyjninë e Tij. Kjo ka të bëjë me dhimbjet e tronditjet e mendjes dhe të shpirtit që burojnë nga çudhëzimi i atribuimit të gjërave vetvetes së tyre ose shkaqeve materiale. Nga kjo dhimbje, shpirtërat dhe mendjet kërkojnë strehim tek Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm, Një dhe Unik, me fuqinë e të Cilit është e mundur të shpjegohen të gjitha vështirësitë, dhe me Vullnetin e të Cilit të gjitha paqartësitë mund të sqarohen, dhe me përkujtimin e të Cilit të gjitha zemrat gjejnë paqë e qetësi.

Në qoftë se dëshiron që ta kuptosh qartë atë, shikoje këtë: qëniet ose u atribuohen vetë krijesave e shkaqeve ose Autorit të Vetëm, Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm. Për shkak të arsytimit të mangët, mund të supozohet e vështirë t’ia atribuosh të gjitha gjërat Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm. Atëherë, për shkak të paaftësisë e pamjaftueshmërisë absolute të çdo shkakut për t’i dhënë ekzistencë ndonjë krijese, atribuimi i ekzistencës së tyre vetëkrijimit ose shkaqeve materiale nuk është diçka për t’u supozuar, por realisht e sigurisht është e pamundur. Ajo çfarë supozohet në alternativën e parë është e sigurt në të dytën. Për më tepër, ndërsa ndodhet vetëm një vështirësi e supozuar në atribuimin e krijimit një Ekzistuesi të Vetëm të Domosdoshëm, vështirësia e qartë ose pamundësia në atribuimin e tij vetë krijesave ose shkaqeve janë aq të shumta sa numri i pjesëve të universit.

Për shembull, në qoftë se një bletë nuk i atribuohet një Ekzistuesi të Vetëm të Domosdoshëm, për shkak të ndërlikohjes së saj me të gjitha pjesët e botës, të gjithë qiejt dhe toka do të duhej të merrnin pjesë në ardhjen e saj në ekzistencë. Gjithashtu, ardhja e gjërave të shumta prej një burimi të vetëm është shumë më e lehtë se sa krijimi i një gjëje të vetme prej burimeve të shumta që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin dhe janë të shurdhëra e të verbëra dhe ardhja bashkarisht e të cilave u shton atyre veçse shurdhësi e verbëri.

Ashtu siç është përmendur, në qoftë se vështirësia e supozuar në atribuimin e gjërave një Qënie të Vetme është me madhësinë e një grimceje, ajo vështirësi do të bëhej aq e madhe sa malet kur krijesat u atribuohen vetvetes së tyre apo shkaqeve. Sepse me një lëvizje të vetme, një qënie e vetme mund të prodhojë një rezultat e t'i japë një formë ose një rregull gjërave të shumta. Por nuk do të ishte e lehtë për gjëra të shumta të prodhonin të njëjtin rezultat madje edhe me shumë lëvizje; dhe ato do të ishin në gjendje të japin të njëjtën formë ose rregull vetëm pas shumë përpjekjeve të mëdha dhe pas vuajtjes së shumë vështirësive. Për shembull, një komandant i vetëm mund të komandojë ushtarë të shumtë me shumë lehtësi, gjë e cila është pamundësisht e vështirë për vetë ushtarët. Pika të panumërta vijne nga një curril i vetëm uji. Ajo vështirësi e supozuar në rastin e parë bëhet pamundësi të panumërta në të dytin. Disa nga këto pamundësi janë siç vijon:

Meqenëse plotësia e artit dhe skalitjet e përsosuritë në gjëra kërkojnë një njohje gjithëpërfshirëse, një shikim absolut, një fuqi të plotë dhe një vullnet të gjithanshëm, secila nga grimcat që i formojnë ato duhet të kenë Atributet e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm.

Në qoftë se gjërat nuk i atribuohen Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm, atëherë do të ishte e domosdoshme t'i atribuonim Hyjni çdo gjëje dhe si rrjedhojë të shoqëroje ortakë me Hyjninë e Tij dhe me Ekzistuesin e Vetëm të Domosdoshëm, i Cili është absolutisht i Lartësuar e pa ortakë. Në qoftë se ne nuk do t'ia atribuonim një kube ndërtuesit, atëherë ndërtimi i patëmeta i kubesë, e pamundur të ndodhë nga rastësia, do të kërkonte që secili prej gurëve që formojnë atë të ishte aq i ditur e i talentuar si një inxhinier. Ashtu si ato gurë, në qoftë se gjërat nuk i atribuohen një Qënieje të Vetme, grimcat ose atomet që formojnë një gjë duhej edhe të ishin dominues me vetëdije dhe të dominoheshin nga njëra-tjetra dhe nga vetë gjëja.

Meqenëse balanca absolute, solidariteti, ndihma e ndërsjellë dhe bashkëlidhja e vëzhguar në univers kërkojnë vetëdije gjithëpërfshirëse dhe fuqinë absolute të shikimit, secila nga grimcat duke formuar gjërat dhe shkaqet duhet ta kishte këtë shkallë vetëdije, njohje dhe fuqie shikimi. Në qoftë se gjërat u atribuohen veteteve, vetë ato ose madje secila nga grimcat duke i formuar duhej t'i kishte këto attribute, dhe në qoftë se ato u atribuohen shkaqeve, atëherë shkaqet duhet t'i kishin ato.

Shumë pamundësi të tjera e koncepte të gabuara si ato që u përmendën do të shfaqeshin nga mospranimi i Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm si Krijuesin e Themeluesin e të gjitha gjërave. Ndërsa, kur gjërat i atribuohen Zotit të tyre të Vërtetë, i Cili domosdoshmërisht ekziston dhe është Një i Vetëm, grimcat dhe pjesët përbërëse bëhen si pika shiu duke mbajtur imazhet e diellit nëpërmjet reflektimit. Ato janë objekte që vijnë në ekzistencë nëpërmjet rrezeve të manifestimeve të Fuqisë Hyjnore Absolute, të ndritshme, gjithëpërfshirëse, të përjetshme, të pafundme dhe të bazuara, madje që përfshijnë njohjen dhe dëshirën e parapërvjetshme dhe të pafundme. Ajo është Fuqia për të Cilën mrekullitë e krijesave dëshmojnë dhe një rreze e së cilës është më rrezatuese dhe më depërtuese se dielli, meqë dritat e diellit mund të pengohen, përthyhen, ndahen e shpërndahen në botën e shumësisë ashtu si dielli duke u ‘përfshirë’ madje edhe në copën më të vockël të qelqit.

Ndryshimi midis atribuimit të gjërave vetvetes ose shkaqeve dhe Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm është si ndryshimi midis imazhit të diellit të reflektuar në një pikë uji dhe midis pretendimit se ai imazh të ishte vetë dielli. Sa pretendim i pakonceptueshëm është ky! Në kontrast, nuk ndodhet vështirësi në Fuqinë e Parapërvjetshme Hyjnore për të depërtuar madje edhe në gjënë më të vogël. Në lidhje me Të, grimcat dhe yjet, pjesët dhe të tërat, individët dhe speciet, e pakta dhe e shumta, e vogëla dhe e madhja, ti dhe universi, bërthama dhe pema, secila prej tyre janë të njëjta. Sepse ajo Fuqi është esenciale, thelbësore dhe e domosdoshme për vetë Esencën e Parapërvjetshme Hyjnore dhe si rrjedhojë është e pakonceptueshme për atë Fuqi të ketë të kundërt. Gjithashtu, ajo nuk ka shkallë: më e vogëla dhe më e madhja janë të njëjta në lidhje me Të.

Me qëllim që ta kuptosh këtë pikë më qartë nëpërmjet krahasimeve prej sferës së mundësive dhe shumësisë, vëri veshin kësaj që vijon

وَلِلَّهِ الْمَثَلُ الْأَعْلَىٰ “Dhe Allahut i takon krahasimi më i lartë”.

Për shkak të ‘tejudkshmërisë’, në marrjen e manifestimeve të diellit në formën e imazheve, copat e qelqit, oqeanet dhe planetet janë të njëjtat. Për shkak të qënies ‘përballë njëra-tjetrës’, në reflektimin e dritës së një lllambe që qëndron tek një pikë qëndrore, më e vogëla e

pasqyrave që qëndron në rrethin më të vogël (rreth asaj qendre) dhe të gjitha pasqyrat në rrethin më të madh janë të njëjta.

Për shkak të qënies ‘jomateriale’, në përfitimin prej saj –si prej një burimi drite– për shembull, numra të mëdhenj gjërash nuk janë pengesa për njëra–tjetrën. Për shembull, në dëgjimin e një fjale të shprehur, një ose mijëra dëgjime janë të njëjtë, ajo mund të dëgjohet nga mijëra njerëz në të njëjtën kohë duke mos e penguar njëra–tjetrën.

Ndodhet një balancë e saktë ose masë shumë e saktë në univers; shikoje balancën kaq të madhe e kaq të ndjeshme që gjërat aq të vogëla sa arrat ose aq të mëdhaja sa malet mund të peshohen me të njëjtën saktësi. Supozo që ne të peshonim dy palë gjërash, le të jenë aq të mëdhaja e të rënda sa dy diej ose aq të vogëla e të lehta sa dy arra, në qoftë se do të vendosej një arrë në njërën prej tyre, pjatat do të ishin dy botëra më vete, njëra lartë në plejada dhe tjetra poshtë në tokë, pra shumë larg njëra–tjetrës për shkak të ndjeshmërisë së peshores.

Për shkak të rregullit të përpiktë dhe ndërlidhjes midis gjërave, nuk do të ishte më e vështirë për një fëmijë të manovronte apo të drejtonte një anije të madhe se sa anijen e tij lodër. Për shkak të nënshtrimit, bindjes, me komandën “para marsh”, një komandant mund të lëvizë një ushtri të madhe me aq lehtësi sa lëvizja e një individi.

Meqenëse realiteti i ekzistencës është i palëndët dhe ajo çfarë i jep një specieje natyrën e saj nuk është përbërja e saj fizike, anëtari më i vogël i një specieje është i të njëjtës natyrë si anëtari më i madh i saj, si dhe si të gjithë anëtarët e saj.

Kështu, për shkak të veçorive të tilla esenciale të gjërave ose karakteristikave bazë të ekzistencës, në lidhje me Fuqinë Hyjnore, e pakta dhe e shumta, dhe e madhja dhe e vogëla janë të njëjta.

Dimensioni i brendshëm i ekzistencës (i cili është dimension i saj esencial, ndërkohë që format e saj materiale, të dukshme e të jashtme janë kalimtare dhe aksidentale) është i tejdukshëm. Fytyra e të gjitha gjërave në ekzistencë kthehet drejt Fuqisë Hyjnore, e cila është e palëndët dhe prej thjesht dritës.

Ndodhet një balancë pafundësisht e saktë në ekzistencë dhe të gjitha gjërat janë pafundësisht të mirërregulluara e të ndërlidhura me

njëra-tjetrën. Të gjitha grimcat që formojnë gjërat janë të bindura ‘me entuziazëm’ ndaj ligjeve Hyjnore dhe rregullave të krijimit, saqë mund të përmbliidhen me Fjalën – urdhërin “*Kun – Bëhu, ji*”. Dhe Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm është absolutisht i Lirë, i Pastër prej trupësisë dhe i shkëputur e i larguar prej gjërave trupore. Për shkak të këtyre veçorive që u përkasin gjërave dhe Fuqisë Hyjnore, është njëlloj e lehtë për Fuqinë Hyjnore që të risjellë në jetë një mushkonjë, të ringjallë tokën, të krijojë një bletë, të krijojë qiejt dhe tokën, të sjellë në ekzistencë grimcën dhe diellin. Aktualisht, kjo lehtësi është e dukshme dhe konkrete që s’ka nevojë për provë. Fuqia Hyjnore, natyra e së Cilës është e panjohur për ne, por aktet e mrekullueshme nuk janë të panjohura për ne, është e tillë saqë në qoftë se aktet e Saj u atribuohen shkaqeve ose vetvetes së tyre, vështirësi të panumërta me siguri do të shfaqeshin. Kurse Fuqia Hyjnore depërton në dimensionet e tejdukshme e të brendshme të gjërave ose në arkitipet e tyre, të cilat përbëjnë esencën e ekzistencës së tyre në njohjen Hyjnore, edhe përmes hapjeve të tilla të vogëla sa vrima e një gjilpëre, dhe manifestohet mbi to nëpërmjet krijueshmërisë së saj.

Shkurtazi: Ajo çfarë ne shohim lidhur me krijimin e gjërave prej Fuqisë demonstroi:

Një: Se mjetet dhe shkaqet e jashtme duhet të shërbejnë si perde për të ruajtur Dinjitetin e Fuqisë (në sytë e njerëzve) në trajtimet e Saj me aspektet materiale të gjërave; sepse njerëzit, për shkak të paaftësisë së tyre për të parë Urtësinë e Vërtetë të Fuqisë në krijimin e gjërave dhe ngjarjeve të interpretuara si fatkeqësi, mund të fajësojnë Qënien Hyjnore. Kështu, me qëllim që t’i shpëtojnë ata prej një paturpësie të tillë të rrezikshme, Allahu vepron prapa shkaqeve në botën e dukshme materiale.

Dy: Se në trajtimin me gjërat si jeta, ekzistenca dhe drita, të cilat janë të tejdukshme si në aspektet e tyre të jashtme, po ashtu edhe në aspektet e tyre të brendshme, nuk janë vendosur perde -mjete- midis tyre dhe Fuqisë Hyjnore.

Tre: Se Fuqia Hyjnore nuk ka as vështirësinë më të vogël në trajtimin e gjërave. Asgjë nuk është e vështirë për Atë Fuqi, e Cila e bën një pemë fiku prej farës së saj më të vogël sa një grimcë dheu dhe var një vilë rrushu prej një kërcelli të hollë si pe. Në të vërtetë, ekzistenca e Pronarit të asaj Fuqie të Parapërdjetshme është më e

dukshme se ekzistenca e universit. Çdo krijesë dëshmon për ekzistencën e vet në disa mënyra të pakta, ndërkohë që ajo dëshmon për Krijuesin e saj në shumë mënyra e rrugë të dukshme, të kuptueshme e racionale. Çfarëdo krijesë që të jetë ajo, në qoftë se të gjitha shkaqet qiellore e tokësore do të grumbulloheshin bashkë ta mbështesnin njëri-tjetrin, ato nuk do të ishin në gjendje të prodhonin një të përngjashëm të saj. Në artin që ato përmbajnë dhe në mjeshtërinë që ato kërkojnë për t'u bërë, as fara e pemës së fikut nuk është më e vogël se vetë pema, as njeriu nuk është më i vogël se e gjithë toka. Kështu, Fuqia që krijon bërthamën dhe njeriun nuk ka aspak vështirësi në krijimin e pemës dhe tokës.

O ti që çudhëzohesh e humbet rrugën duke e supozuar të pamundur atribuimin e gjërave një Krijuesi të Vetëm të Domosdoshëm! Ti e ke parë se vështirësia dhe pamundësia qëndrojnë në atribuimin e ekzistencës vetvetes së saj ose shkaqeve. Dhimbjet e torturat e mendjes dhe të shpirtit që burojnë nga çudhëzimi pushojnë vetëm duke ikur e duke iu nënshtruar Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm, nëpërmjet Fuqisë së të Cilit ekzistenca e të gjitha gjërave mund të shpjegohet. Duke ia referuar Vullnetit të Tij, të gjitha paqartësitë qartësohen nëpërmjet përmendjes së Tij dhe varësisë tek Emrat e Tij, zemrat dhe mendjet mund të gjejnë paqë e qetësi.

Mësoje, o shok! Fusha ku mendja e njeriut dhe zemra lëvizin është shumë e gjerë për t'u rrethuar e përfshirë. Megjithëse ai ndonjëherë udhëton brenda një grimce të vogël, noton në një pikë, dhe e burgos vetveten në një pikë, ai në të vërtetë vendos tërësinë e botës para syve të tij dhe përfshin në mendjen e tij tërësinë e krijimit, duke aspiruar të shohë Ekzistuesin e Vetëm të Domosdoshëm. Ndonjëherë ai bëhet më i vogël se një grimcë e vockël, por ndonjëherë ai bëhet më i madh se qiejt. Ndërsa në ndonjë kohë ai futet në një pikë, në kohë të tjera ai përfshin tërësinë e ekzistencës me të gjitha speciet e pjesët e saj.

Mësoje, o shok! Për dhuratat që Allahu ia ka caktuar një njeriu për t'i arritur ose për t'i përdorur e për të përfituar prej tyre, ndodhen kushte dhe kode; disa prej tyre janë vendosur nga Krijuesi dhe disa i përkasin njeriut. Për shembull, drita, ajri, ushqimi dhe të folurit – jehona– janë dhuratat e Allahut, përfitimi prej të cilave varet nga pasja e syve të shëndoshë e të shëndetshëm, nga pasja e hundës, e gojës, e veshëve etj. Të gjitha ato shqise e organe janë krijuar nga Allahu i

Gjithëfuqishëm; pjesa jonë në pasjen e tyre është të vepruarit atë çfarë ne duhet të bëjmë për t'i mbajtur ato të shëndosha e të shëndetshme. Ti kurrë nuk duhet të supozosh se ato janë gjëra të gjetura në rrugë rastësisht dhe kështu që ti të mund t'i pronizojë e t'i përdorje si të duash. Ato të erdhën nga Vullneti i Atij të Vetmi që t'i ka dhuruar, dhe ti duhet t'i mbash ato në punë me dëshirën tënde dhe t'i përdorësh në përputhje me Vullnetin, dëshirën e Atij të Vetmi që t'i dhuroi.

Mësoje, o shok! Fundet e gjërave dhe përfundimet e tyre nuk janë më pak të rregullta, të sistemuara e më pak të përkryera se sa fillimet e tyre; domethënë, gjërat nuk janë më të rregullta e të sakta në fillimin e tyre se sa në fundin e tyre. As paraqitja e tyre e jashtme dhe as format e tyre nuk janë më të bukura në art dhe më të lartësuara në urtësi se sa anët e brendshme të tyre. Kurrë mos supozo se fundet e gjërave dhe aspektet e brendshme të tyre janë lënë kot që të luajë me to dora e rastësisë. A nuk e shikon ti se lulja dhe fruti duke u rritur prej saj shfaqin më shumë urtësi se sa bërthama dhe filiza që u rrit prej bërthamës? Atëherë, Autori Krijues xh.sh, qoftë e lartësuar Madhështia e Tij, është i Pari, i Fundit, i Dukshmi dhe i Padukshmi,

وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ “dhe Ai është i Gjithëditur për të gjitha gjërat”.

Mësoje, o shok! Mrekullia e Kuranit e ruan Kuranin nga deformimi, ndryshimi. Është pamundësisht e vështirë për fjalët e dikujt, qoftë ai një interpretues i Kuranit ose një shkrimtar apo përkthyes, ose një korruptues apo ndonjë tjetër, të ngatërrohen me vërsetet e Kuranit. Nuk është e mundur për një të tillë të veshë ‘veshjen’ e Kuranit, siç ndodhi me librat e tjerë të shpallur të cilët u ngatërruan e u përzierën me fjalët e të tjerëve dhe përfundimisht u ndryshuan.

Mësoje, o shok! Ndodhet një përsëritje e vërsetit,

فَبِأَيِّ آلَاءِ رَبِّكُمُ تُكَذِّبَانِ

“Atëherë pra, cilën nga mirësitë e Zotit tuaj ju (njerëz dhe xhinde) e mohoni?” në suren ‘Er-Rahman’ në fund të vërseteve të shpallura që tregojnë fenomenet e ndryshme “natyrore”, secila duke qenë një shenjë e Ekzistencës dhe e Njësisë Hyjnore. Ai tregon se mosbindja e njerëzve dhe e xhindëve (ndaj urdhrave të Allahut) dhe rebelimi i tyre dhe mosmirënjohja burojnë kryesisht prej verbërisë së tyre ndaj Aktit

Hyjnor i të dhuruarit të mirësive dhe nga pavëmendshmëria e pakujdesia ndaj Atij që i dhuron ato mirësi, dhe si rrjedhojë ata ua atribuojnë mirësitë shkaqeve dhe rastësisë. Si pasojë, ata bëhen mohuesit e bekimeve të Allahut. Prandaj, është e rëndësishme për një besimtar të recitojë në fillim të përdorimit ose të konsumimit të çdo mirësie, “*Bismilahir–Rahmanir–Rahim*”, “*Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit*”. Kjo do të thotë se ajo është nga Allahu dhe ai e merr atë në Emrin e Tij xh.sh, dhe për hir të Tij, dhe jo për hir të mjeteve dhe shkaqeve, dhe kështu Atij i takon i gjithë falënderimi dhe mirënjohja.

Mësoje, o shok që je i zbuluar para pëshpëritjeve të shejtanit dhe para mendimeve të pavullnetshme dhe sugjestionëve e nxitjeve që burojnë nga zemra dhe nefsi dhe që para teje shfaqen disa skena të ndyra dhe imagjinata kur ti nis të shqyrtosh rreth të vërtetave Hyjnore! Retë e zeza e të neveritshme të fëlliqësisë e të ligësisë kalojnë para syve të tu me imagjinatën e të cilave ti dridhesh kur shikon ‘Diellin’ e të vërtetave. Është sikur duart e tua bëhen të ndotura me ndyrësinë e imagjinatës tënde kur ti i shtrin për shenjtërimin e lartësimin e Zotit, dhe sikur sytë e tu ndyhen me jashtëqitjen e nefsit tënd kur ti i fikson tek tesbihatet – tek lavdërimi dhe lartësimi i Allahut. Pastaj, kjo ndyrësi e jashtëqitje reflektohen mbi gjërat e shenjta në shikimin tënd, duke të të bërë të vuash për shkak të tyre dhe që tërheqin më shumë vëmendjen tënde ndaj tyre. Mos vuaj prej tyre dhe mos e lësho veten tënde tek shqyrtimi i tyre me qëllim që të shpëtosh prej kësaj gjendje. Ato nuk të japin dëm veçse nëse ti i supozon ato si të dëmshme dhe përqëndrohesh mbi to.

Hidhe vështrimin tek dielli dhe drita e tij, tek qielli dhe yjet e tij, dhe tek kopështi dhe yjet e tij, nëpërmjet vrimave të një manteli të njollosur me copa të ndryshme papastërtie. A nuk e shikon se është e pamundur që ajo çfarë ti sheh të mund të bëhet e lyer me ato copa papastërtie. Pëshpëritjet dhe mendimet që të ndodhin ty pa qëllim, në mënyrë të pavullnetshme, janë si disa insekte dhe grerëza. Në qoftë se ti përpiqesh të luftosh me to për t’u mbrojtur kundra tyre, ato do të grumbulloheshin dhe do të të kërdiseshin e mundonin më shumë. Në qoftë se ti e ndërpret luftën me to, ato do të të lënë.

Mësoje, o shok, që preokupohesh me filozofinë dhe që preferon arsyen mbi shpalljen, mbi komentet rreth shpalljes; dhe si rrjedhim e

korrupton atë meqë nuk mund ta ndërthesh e përfshish me arsyen tënde të mangët dhe për shkak të mburrësisë dhe zhytjes tënde në filozofi! Njëherë, unë mendova ashtu si ti tani. Por më vonë unë pashë një kështjellë të lartë e brilante, dyshemetë e së cilës janë lidhur me tavanin e qiejve, nga dritaret e së cilës janë varur litarë të ndryshëm. Disa prej këtyre litarëve janë të afërt me tokën. Kushdo që është i aftë për të mposhtur e kontrolluar nefsin e tij dhe kapet pas njërit prej atyre litarëve mund të ngjitet tek stacionet më të larta. Pastaj, unë kam parë disa njerëz të cilët, të humbur në mburrësinë e kotësinë e tyre dhe të pakujdesur ndaj atyre litarëve, përpiqen të ngrihen mbi gjërat, si gurët të cilët ata i kanë grumbulluar e i kanë bërë pìrg nën këmbët e tyre. Pasi ngjiten pak, ata bien. E si mund të ngjiten ata?! Unë kam parë të tjerë, të cilët duke u mbështetur në egot e tyre të pabindura e arrogante, ngulin gozha në muret e kështjellës dhe përpiqen të kacavaren nëpërmjet tyre. Por përsëri ata rrëzohen e thyejnë qafat e tyre. Dhe kështu unë kam vëzhguar se çfarëdo kapacitetesh që ka një njeri dhe çfarëdo aftësish intelektuale, ato i janë dhënë atij për t'i përdorur në përputhje me kapacitetin e tij dhe që t'i përdorë me qëllim që të ngjitet tek litarët dhe jo tek stacionet. Arsyeja jote është një litar me të cilin ti je i lidhur, ndërsa ti mund të ngrihesh nëpërmjet shpalljes. Kushdo që mbështetet tek Allahu, sigurisht që Allahu i mjafton atij.

Mësoje, o shok që habitesh për triumfin e tiranëve mëkatarë ndaj të devotshmive dhe për epërsinë e të ligjve ndaj të drejtëve në jetën e kësaj bote! Në një vizion unë pashë një kështjellë. Ndodheshin pavione në të, njëri brenda tjetrit. Banorët e saj ndryshonin në bukuri, lartësi, lavdi e shkëlqim. Ai që qëndronte në qendër i ngjasonte mbretit. Poshtë tij për tek hyrja ndodheshin dhoma, banorët e të cilave ndryshonin në rangje e dallueshmëri. Ai që rrinte në këmbë pranë portës ishte një shërbëtor dhe përpara portës ndodhej një qen i laznitur. Pastaj, unë pashë një kështjellë tjetër me një shesh –ballë– të shndritshëm. Në habi, unë e sodita dhe pashë se mbreti atje po luante me qenin përpara hyrjes. Gratë e veshura në mënyrë të pahijshme po bënë shaka me fëmijët dhe ndërkohë detyrat e rëndësishme mbetën të papërfunduara. Detyrat ose funksionet e qenit, të fëmijëve dhe të shërbëtorëve të nivelit –gradës– më të ulët u dukën të kishin fituar rëndësi. Banorët merreshin me gjëra të turpshme. Sado vezulluese, e fortë dhe madhështore ishte kështjella në dukje, në realitet ajo ishte e errët dhe në një gjendje të mjeruar.

Ti mund t'i marrësh kështjellat si shembull duke përfaqësuar njerëzit. Sepse unë e pashë një individ njerëzor si një kështjellë. Madje unë pashë nefsin tim si një kështjellë. Banorët e kështjellave janë të shkallëve ose rangjeve pafundësisht të ndryshme në njohje ose në moral, apo në pasjen e vlerave njerëzore. Unë kam vëzhguar se ajo çfarë njerëzit e civilizuar modern e quajnë progres është rënie e degjenerim. Ajo çfarë ata e quajnë fitim dhe mbajtje fuqie është vulgarizim dhe humbje vlere. Çfarë ata e quajnë të qënurit i zgjuar, ripërtëritje dhe ndriçim është thellësi në gjumin e pakujdesisë. Dhe ajo çfarë ata e quajnë mirësjellje është një shfaqje dhe hipokrizi; zgjuarsia, intrigë djallëzore dhe humanizmi është veçse një shndërrim në bisha të egra. Por, si rezultat i aftësive rrezatuese të dhëna nga Zoti xh.sh duke qenë së bashku me nefsin e tij të errët, disa skena tërheqëse e të hijshme mund të shfaqen në këtë njeri të rrëzuar e rebel. Kurse, sa për besimtarin e devotshëm që i bindet Allahut të Gjithëfuqishëm, nefsi i tij përfaqëson qenin me pamje të degjeneruar përpara derës. Ai i përdor aftësitë që iu dhanë nga Zoti jo për të kënaqur dëshirat dhe tekat e tij të ulëta, por për të udhëzuar të çudhëzuarit dhe për t'i kthyer ata tek ajo për të cilën ato u krijuan. Në qoftë se Allahu xh.sh e do një shërbëtorin e Tij, Ai nuk e bën atë të dojë bukuritë e dynjasë, por e bën atë nëpërmjet disa fatkeqësive, t'i përbuzë e t'i urrejë ato bukuritë.

Ah, medet! Sa keq që ky civilizim i prishur i ka zhvilluar disa çudira tërheqëse dhe disa lodra zbavitëse pas të cilave banorët e kështjellës së njeriut magjepsen, si fluturat e tërhequra pas dritës, e cila kthehet në zjarr përvëlues për to.

Mësoje, o Said i mjerë! Përse është kjo mendjemadhësi, pakujdesi dhe indifferencë ndaj bekimeve të Zotit xh.sh? A nuk e shikon se ti ke një vullnet të lirë jo më të fortë se një qime dhe një fuqi jo më të madhe se sa një grimcë e vockël? A nuk e shikon se ti ke një jetë jo më të gjatë se një shkrepëtimë drite, një vetëdije jo më të ndritshme se një dritë e dobët që shuhet, ke një kohë jo më të gjatë se një çast kalimtar, dhe një hapësirë me përmasën e një varri? Megjithatë, pafuqia jote është e pafundme, nevojat e tua janë të pakufishme, varfëria jote është e palimit. Ambiciet e tua janë të pakufishme. Atëherë dikush kaq i nevojshëm e i pafuqishëm si do të mbështetej në atë që është në dorën e tij dhe të varet tek vetja e tij apo duhet të mbështetet tek Allahu i Gjithëmëshirshëm e Mëshirëplotë? Midis ambalazhimeve të mëshirës së Tij dhe sënduqeve të mirësive të Tij janë këto diej të mbushura me

dritë dhe këto pemë frutdhënëse; dhe midis rrjedhave që shfaqen prej burimit të bekimeve të Tij dhe rrymave të mëshirës së Tij janë uji dhe drita.

Mësoje, o shok, që e vlerëson shumë të madh rezultatit dhe shikon të dobët dëshminë që të çon tek ai! Nuk ka tregues që dëshmon për një të vërtetë prej të vërtetave të besimit veçse ai tregues pastrohet, përforcohet dhe mbështetet nga çdo element individual dhe nga çdo pjesë e Islamit. Është sikur dëshmi të panumërta, dëshmitarë dhe shenjat e të vërtetës së Islamit dhe të të vërtetave të besimit mbështesin të vërtetën e secilës dhe vendosin vulën e aprovimit e të miratimit mbi të. Sepse, siç u përmend në fillim të kësaj trajtесе, ndërsa (për shkak të papajtueshmërisë së arsyeve) mohimi ose refuzimi i një mijë njerëzve nuk është më i fortë se mohimi i një njeriu të vetëm; ndërsa sa më shumë të jenë ata që e konfirmojnë, e vërtetojnë, aq më i fortë është argumenti i tyre.

Mësoje, o shok! Dashuria e fortë për diçka mund të bëhet shkak për mohimin e asaj gjëje. Kjo gjithashtu është e vërtetë për intensitetin e frikës – për frikën e fortë; gjithashtu edhe tepria në madhësi; madhështia e tepruar e dikujt i shkakton atij të mohohet dhe në përfshirjen dhe kapjen e mendjes.

Intensiteti i dashurisë për atë që mund të mos arrihet mund ta çojë gjënë e dashuruar të mohohet. Gjithashtu, intensiteti i frikës mund ta bëjë dikë të mohojë atë që ai e ka frikë. Gjithashtu, madhështia që është përtej kapjes së arsyes mund të mohohet nga ajo arsye, meqë është përtej ngërthimit të saj.

Mësoje, o shok! Unë jam aq shumë i bindur sikur ta kisha vështuar drejtëpërdrejtë se fara e mosbesimit potencialisht mban Ferrin, ashtu si një bimë sinapi që përmblihet në farën e saj. Gjithashtu, besimi potencialisht mban farën e Parajsës, ashtu si palma që përmblihet në bërthamën e frutit të saj. Ashtu siç nuk është e huaj, e çuditshme që një farë apo një bërthamë të rritet, kthehet në bimë filizë apo në pemë, në bimë sinapi e në palmë, në shembullin tonë, po ashtu nuk do të konsiderohej e pamundur apo e çuditshme që esenca e çudhëzimit të mishërohet –trupëzohet– si një ferr torturues dhe dritat e udhëzimit të mishërohen si një parajsë e ëmbël. Ndodhen detaje për këto vëzhgime tek trajtesa “*El-Levamiu*”, pas ‘*Fjalës së Tridhjetë e Tre*’ tek koleksioni i Fjalëve “*Sozler*”.

Mësoje, o shok! Ashtu si një farë ose bërthamë nëse shpohet në zemër, ajo nuk mund të rritet e të krenohet nga vetvetja, po ashtu kur kokrra e egos njerëzore shpohet me rrezet dhe ‘flakët’ përvëluese të recitimit të rregullt të Emrit Hyjnor: Allah...Allah, ajo –egoja– nuk mund të rritet e forcohet, për të qenë krenare nga vetvetja në pakujdesi si Faraoni duke u mbështetur tek arritjet e llojit të vet –njerëzimit– dhe duke kundërshtuar me rebelim ndaj Krijuesit Mposhtës e Detyrues të qiejve dhe të tokës. Evlijatë –shenjtorët– e tarikatit Nakshibendi kanë qenë në gjendje ta hapin kokrrën e zemrës dhe të zbulojnë një rrugë të shkurtër për të shpuar malin shkëmbor të egos dhe për të thyer kokën e nefsit kryeneç me ‘turjelën’ e dhikrit të fshehtë – me recitimin në heshtje të Emrave të Allahut, ashtu siç shkatërrohet ose thërmmohet idhulli i natyralizmit (filozofik) nëpërmjet recitimit me një zë të lartë të atyre Emrave Hyjnorë.

Mësoje, o shok! Ashtu si në sferat e tjera të shumësisë –sferat trupore ku gjërat ekzistojnë të ndara dhe në shumësi– në më të largëtat, më të shtrirat dhe më delikatet e tyre, skalitjet e urtësisë, të përkujdesjes dhe të bërjes të qëndrueshme e të përkryer janë të dukshme qartë. Nëse dëshiron një shembull, shiko tek përfundimet më të largëta të lëkurës që mbulon trupin njerëzor. Shiko se si faqja e ballit të saj dhe në fytyrën e saj dhe në pëllëmbat e saj pena e Fuqisë Hyjnore ka skalitur vija e skica të cilat tregojnë kuptime në shpirtin e njeriut. Kjo kopje e padukshme e jomateriale e historisë së të gjithë jetës së tij është varur rreth qafës së tij, e cila tregon kaderin e tij të përfshirë në krijimin e tij. Kjo skalitje, (e cila tregon kaderin e njeriut) nuk lë hapje nëpërmjet të cilës rastësia e verbër apo vepruesit e tjerë të verbër ose çakërrat –vëngëroshët– të tillë si shkakësia të mund të depërtojnë.

Mësoje, o shok, që je i dhënë pas jetës së kësaj bote! Ti mendon se qëllimi i jetës dhe i çfarëdoje që Fuqia e Parapërrjetshme ia ka besuar si amanet esencës së njeriut dhe qënieve të gjalla –të tilla si sistemet e mahnitshme dhe aftësitë e jashtëzakonshme– është vetëm për të ruajtur këtë jetë kalimtare, për të siguruar vazhdimësinë e saj! Jo, kjo nuk mund të jetë! Në qoftë se qëllimi i jetës qëndron në vazhdimësinë e saj, atëherë provat më të dukshme, më të qarta dhe më të ndritshme të urtësisë, të përkujdesjes, të rregullsisë dhe të mungesës së kotësisë, të cilat vëzhgohen gjithandej universit dhe dëshmohen nga rregulli i përgjithshëm i universit, do të bëheshin, (meqënëse çdo gjë zhduket), shembujt më të çuditshëm të kotësisë, të harxhimit pa masë, të

paqëllimshmërisë dhe të rrëmujës. Ajo çfarë bie tek pjesa e dikujt prej frutave dhe qëllimeve të jetës është në përpjestim me shkallën e pjesës së tij në pronësinë e jetës së tij dhe në autoritetin mbi të. Qëllimet dhe frutat e tjerë i përkasin Dhënësit të jetës xh.sh, qoftë e lartësuar madhështia e Tij! Njeriu është veçse objekt i manifestimeve të Emrave të Krijuesit xh.sh.. Allahu do t'i shfaqë ngjyrat dhe rrezatimet e mëshirës së Tij në Xhennet –Parajsë– në jetën e përtejme, e cila do të përbëhet prej frutave që rriten prej farërave të jetës së kësaj bote.

Lidhja e njeriut me jetën e tij është si lidhja midis një timonieri –piloti– dhe një anijeje Hyjnore të cilën ai e drejton. Ajo çfarë bën timonieri është vendosja e gishtave të tij mbi instrumentet e domosdoshëm për ta lëvizur e manovruar anijen. Ajo çfarë bie tek pjesa e tij prej dobive dhe të ardhurave është në përpjestim me lidhjen e tij me anijen dhe me shërbimin që ai bën. Ajo nuk është më shumë se një në njëmijë. Kjo është e njëjta lidhje me çdo qenie të gjallë dhe me anijen e ekzistencës dhe jetës së tij. Ajo çfarë bie tek pjesa e një qenieje të gjallë prej dobive dhe qëllimeve të jetës së saj është vetëm një në njëmijë. Për më tepër, kjo dobi e vetme nuk është pjesa që ajo ka merituar vetë.

Mësoje, o zemra ime! Kënaqësitë e dynjasë dhe bukuritë e saj pa njohjen e Krijuesit tonë, Pronarit tonë dhe Zotit tonë, edhe në qoftë se do të ishin me shkallën e atyre të Xhennetit, nuk janë më shumë se një Ferr -Xhehennem. Kjo është eksperiencia dhe vëzhgimi im. Me njohjen e Tij xh.sh, një bekim si dhembshuria bëhet aq e këndshme dhe e ëmbël saqë do të mund ta bënte njeriun të jetë indiferent ndaj çfarëdo gjëje në dynja, madje edhe ndaj parajsës.

Mësoje, o zemra ime! Çfarëdo që ndodh në këtë botë ka dy aspekte: njëri aspekt i përket dynjasë, nefsit dhe dëshirave e tekave të njeriut, aspekti tjetër i përket Ahiretit, botës së përtejme. Për sa ka të bëjë me aspektin e kësaj bote, më e madhja, më e rëndësishmja dhe më e vërtetuara e çështjeve është në të njëjtën çështje prej shkallës më të vogël, më të parëndësishmes dhe më të përkohshmes në vetvete. Kështu, nuk do të ishte e denjë të brengosesh e të dëshpërohesh dhe t'i japësh rëndësi asaj.

Mësoje, o zemra ime! A ke parë ndonjë më të marrë e më injorant se ai që e sheh imazhin e diellit në një objekt të vockël të tejdukshëm ose manifestimin e tij mbi një lule si ngjyrë, dhe pastaj kërkon që ai

imazh apo ajo ngjyrë duhet të jetë e gjitha që mund të kërkohet prej dritës dhe llampës që shpërndan nxehtësi e dritë në tavanin e botës, e cila gëzon pozitën qendrore në sistemin diellor dhe i bën planetët të rrotullohen përreth saj? Për më tepër, kur ajo çfarë ai shikon në objektin më të vogël ose në lulen zhduket, për shkak të shikimit të tij të kufizuar e të mangët, ai mohon ekzistencën e diellit në mesditë, madje edhe pse të gjitha gjërat, pikat e vesës, pikat e shiut, të gjitha pikat dhe flluskat e ujit kudo, dëshmojnë për të në dritën e gjërë të ditës.

Pastaj, ai injorant ngatërron ekzistencën e një hijeje të formuar nëpërmjet manifestimit apo reflektimit sipas kapacitetit të gjësë së përcaktuar nga Kaderi Hyjnor, me ekzistencën kryesore substanciale. Për shembull, ai shikon imazhin e diellit në një objekt transparent dhe thotë: ‘A është dielli kaq i vogël? Ku është nxehtësia e tij e jashtëzakonshme dhe ku janë veçoritë e tij të tjera?’ Dhe kështu me rradhë.

Brenda objekteve të tilla, ndodhet një dëshirë e gabuar për të marrë një urë zjarri prej zjarrit të diellit, ose ta prekë atë me duar, ose të ushtrojë ndonjë lloj influence mbi diellin. Ai që kundërshton nuk e kupton se qënia e tij ‘afër’ diellit nuk do të thotë dhe as nuk e bën të domosdoshëm që dielli duhet të influencohet prej akteve të tij. Për më tepër, ai shikon se më të vogëlat e gjërave bëhen çuditërisht të qëndrueshme, me përkujdesje të mahnitshme, me art shumë të këndshëm dhe për qëllime domethënëse; atëherë, duke bërë analogji të rreme, të gabuar e çudhëzuese, ai supozon se Autori i tyre duhet të ketë ushtuar përpjekje të tepërta për t’i bërë ato. Ai thotë, çfarë vlere ka, për shembull, kjo mushkonjë që Krijuesi i Gjithurtë ka harxhuar përpjekje të madhe duke punuar mbi të?

O ti që mendon si një sofist! Për Allahun është më i Larti shembull:

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ

“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Vekil (Kujdestar, Ruajtës, Rregullues) mbi gjithçka”.⁷

Ti duhet të kesh në mendje katër pikat vijuese me qëllim që çështja të mund të mbetet e qartë në mendimin tënd:

⁷Kur’an, Zumer 62

Pika e Parë: Çdo gjë prej grimcave tek diejt e përshkruan Allahun xh.sh me çfarëdo që ajo mban (prej Atributeve të Tij) duke e përshkruar Atë në plotësinë e Hyjnisë së Tij. Çfarëdo që ajo gjë ka (prej të mirës) është prej Atij; ajo (domethënë e mira) nuk i atribuohet asaj si e veta, si e mira e saj.

Pika e Dytë: Në çdo gjë ndodhen dyer të hapura nga Drita e të Gjithëfuqishmit. Në qoftë se ndonjë person dritëshkurtër e mendjengushtë e shikon njëren prej atyre dyerve si të mbyllur, kjo nuk vijon që të gjitha dyert e tjera të supozohen të jenë gjithashtu të mbyllura. Përkundrazi, një derë e hapur duhet të merret si një tregues me kuptimin se të gjitha prej dyerve janë në fakt të hapura.

Pika e Tretë: Kaderi, i cili është një reflektim prej njohjes gjithëpërfshirëse të Allahut xh.sh, ka përcaktuar për çdo gjë një karakter të veçantë e të përshtatshëm prej rrezeve prej Emrave Hyjnorë Absolutë të ndritshëm.

Pika e Katërt: Sigurisht që urdhëri i Tij, kur Ai e do një gjë, është vetëm se Ai i thotë asaj: كُنْ فَيَكُونُ “Bëhu” –dhe ajo është bërë në çast!⁸

مَا خَلَقْتُكُمْ وَلَا بَعَثْتُكُمْ إِلَّا كَنَفْسٍ وَاحِدَةٍ

“Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm!”⁹

Në qoftë se gjërat u atribuohen vetvetes së tyre ose shkaqeve të mundshme, atëherë ajo do të kërkonte që të gjithë njerëzit me arsytim të shëndoshë do të duhej t’i pranonin të gjitha llojet e pamundësive, paperceptueshmërive, që burojnë prej këtij gjykimi të pamenduar e prej budallai [si realisht të mundshme].

Mësoje, o shok! Kurani i shpjegimit të mrekullueshëm shpjegon shumë të vërteta nëpërmjet shëmbëllesave dhe krahasimeve, meqë të vërtetat Hyjnore abstrakte merren ose paraqiten në forma konkrete e të kufizuara në këtë sferë -materiale- të mundësive. Një qenie e mundshme i shikon format konkrete në sferën e mundësive dhe shqyrton në dritën e

⁸Kur’an, Jasin, 82

⁹Kur’an, Lukman, 31:28

tyre aktet që dalin prej sferës së domosdoshmërisë absolute, domethënë, sferës së Hyjnisë. Dhe Allahut i takon krahasimi më i lartë.

Mësoje, o shok! Zemra ka të njëjtin kuptim për ty siç ka Froni Hyjnor për universin. Zemra jote në ty është ‘dimensioni i jashtëm’ i qënies tënde. Ti je ‘dimensioni i brendshëm’ i qënies tënde në zemrën tënde. Në sferën e Emrit Hyjnor ‘*Edh-Dhahiru*’, ‘*i Jashtmi*, *i Dukshmi*’, Froni Hyjnor i rrethon të gjitha gjërat. Në sferën e Emrit Hyjnor ‘*El-Batinu*’, ‘*i Padukshmi*, *i Brendshmi*’, Ai -Froni- është si zemra e krijimit. Në sferën e Emrit Hyjnor ‘*El-Evvelu*’, ‘*i Pari*’ tregohet për të me:

وَكَانَ عَرْشُهُ عَلَى الْمَاءِ “Dhe Arshu (Froni i Tij) ishte mbi ujë”¹⁰

Në Emrin Hyjnor ‘*El-A’hir*’, ‘*i Fundit*’, ai simbolizohet nga

سَقْفُ الْجَنَّةِ عَرْشُ الرَّحْمَنِ

“Tavani i Parajsës është Froni i të Gjithëmëshirshmit”¹¹

Froni Hyjnor ka cilësitë e të qëniet i Pari, i Fundit, i Jashtmi, i Brendshmi duke buruar nga vërseti: هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ “Ai është i Pari, i Fundit, i Jashtmi, i Brendshmi”¹²

Mësoje, o shok! Pafuqia i jep shkas thirrjes, përgjërimit, ndërsa nevoja shkakton bërjen e duasë.

O Zoti im, o Krijuesi im, o Pronari im! Unë të përgjerohem Ty, unë të lutem Ty sepse unë jam i nevojshëm! Unë kërkoj strehë tek Ty nëpërmjet lutjes sime, sepse unë jam në mjerim. Pafuqia ime është mjete im për përgjërimit ndaj Teje dhe për të të kërkuar ndihmë. Dobësia ime është thesari im. Kapitali im janë ambiciet dhe dhimbjet e mia. Ndërmjetësit e mi janë i dashuri Yt –profeti Muhammed a.s.m dhe mëshira Jote. Më fal mua, fali gjynahet e mia dhe ki mëshirë mbi mua, o Allah! O i Gjithëmëshirshëm! O Mëshirëplotë!

¹⁰Kur’an, 11:7

¹¹Transmeton Ibnu Maxheh.

¹²Kur’an, 57:3

هَذِهِ الْمُنَاجَاتُ تَحْظَرُ فِي الْقَلْبِ هَكَذَا بِلَايَانِ الْفَارِسِيِّ

یا رب بَشَشْ جَهتِ نَظَرِ مِی کَر دَمِ دَرِ خُو دَرَا دَرِ زَمَانِ نَمِی دِیدَمِ
 دَر رَا نَسْتِ مِی دِیدَمِ کِه دِی رُوزِ مَن رَا پَدِ رِ مَنَسْتِ
 وَ دَرِ چِپِ دِیدَمِ کِه فَ رِ دَا قِ مَنَسْتِ
 وَ اَیْمُرُ وِزْتَا بُو تِ جِئِمِ پُرَا ضِطْرَابِ مَنَسْتِ
 بَرَسِ عَمْرُ جَبَنَ اَرَهْ مَن اَی تَا دَهْ اَسْتِ
 دَرِ قَدَمِ اَبِ حَاکِ خَلَقْتِ مَن وَ حَاکِ تَرِ عِظَامِ مَنَسْتِ
 چُونِ دَرِ پَسِ مِی نِ کَرَمِ بَی نَمِ اَیْنِ دُنْیَا، بِنِ بُنْیَا دِهیچِ دِهیچِ نَسْتِ
 وَ دَرِ پِشِ اَنْدَا زَهْ نَظَرِ مِی کُنَمِ دَرِ قَبْرِ کُشَا دَهْ اَسْتِ
 وَ رَاهِ اَبَدِ بَدُو رِ دَرَا زِ بَدِیدِ اَرَسْتِ

مَرَا جُزْ جُزْ اِخْتِیَا رِی چِی زِی نِی سْتِ دَرِ دَسْتِ
 کِه اُو جُزْ هَمِ عَا جِرْ هَمِ کُو تَا هْ وَ هَمِ کَمِ عِبَا رَسْتِ
 نَهْ دَرِ مَاضِی مَحْبَالِ حُلُو لِ نَهْ دَرِ مَسْتَقْبَلِ مَدَارِ نَفُو دَسْتِ
 مِی دَانِ اُو اَیْنِ زَمَانِ حَالِ وَ یَا کِ اَن سِیَا لَسْتِ
 بَا اَیْنِ هَمِ فَ قَرَحَا وَ ضَعْفَمَا قَلِمِ قَدَرْتِ تُو اَشِ کَا رَهْ
 نُو شْتِهْ اَسْتِ، دَرِ فِطْرَتِ مَامِی لِ اَبَدِ وَ اَمَلِ سَرْمَدِ
 بَلْکِه هَر چِه هَسْتِ، هَسْتِ

دَا رُزُ اِخْتِیَا جِ مَانِنْدِ دَا اَبْرُهْ مَدِ نَظَرِ بُرُزْ کِه دَا رَسْتِ
 خِیَالِ کِه اَمِ رَسْدِ اِخْتِیَا جِ نِی زِ رَسْدِ دَرِ دَسْتِ
 هَر چِه نِی سْتِ دَرَا اِخْتِیَا جِ هَسْتِ

دَاۤرُہٗ اِقْتِ رَاہِیچُو دَاۤرُہٗ دَسْتِ کُو تَاہَسْت
 پَس فَرُو حَاجَاتِ مَابَقَد رَجِحَا نَسْت
 وَ سَر مَائِدَہٗ مَہَم جُو جَزُو لَا یَجَزِی اَنَسْت
 اِیْن جَزُو کَدَام وَاِیْن کَاثِنَاتِ حَاجَاتِ کَدَامَسْت
 پَس دَر رَاہِ تُو اَز اِیْن جَزُو نِیْرَا زَمِی کَدَشْتَن چَا رَہِ مَنَسْت
 تَا عِنَا یَتِ تُو دَسْت کِیْر مَن شُو دَر حَمَتِ بِي نِهَا یَتِ تُو پِنَاہِ مَنَسْت
 اَن کَس کَبِ بَحْرِی نِهَا یَتِ رَحْمَتِ یَا فُت اَسْت تَجِکِہ
 نَه کُنَد بَر اِیْن جَزُو اِخْتِیَارِی کَبِ یَکْ قَطْرَہٗ سَر اَسْت
 اَیْوَاہِ اِیْن زِنْدِ کَا یِنِ ہَم چُو خَا بَسْت
 وِیْن عُمْرِ بِي بُنِیَا دَہَم چُو بَا دَسْت
 اِنَّا نَ بَزَوَالٍ دُنِیَا بِنَا اَسْت اَمَّا لِي بَقَا اَلَا مَبَقَا اَسْت
 بِيَا اَنَّمِی نَفْسِ نَا فَرَجَامُ وُجُو دِ فَا نِی خُو دَرَا فَا کُنْ
 خَالِقِ خُو دَرَا کَبِ اِیْن ہِیْتِی وَ دِیْعَہٗ ہَسْت
 وَ مُمْلِکِ اُو وَ اُو دَا دَہٗ فَنَا کُنْ تَابَقَتَا یَا بَدَا اَن
 سِرِّی کَبِ : نَفْسِ نَفْسِ اِثْبَاتِ اَسْت
 خُدَا یِ پُر کَرَمِ خُو دَرَا مُمْلِکِ خُو دَرَا مَعِ خِہ دَا ز تُو
 بَسَا مِی نِی کَرَا نَ دَا دَہٗ بَرَا مِی تُو نِکَا ہِ دَا رَسْت

O Zot! Unë sodita në të gjitha gjashtë drejtimet duke kërkuar një ilaç për dhimbjet e mia. Por, ah medet, unë nuk munda të gjej ilaç për to.

Unë shikova qohën e shkuar në të djathtën time për të gjetur një ngushëllim, por e djeshmja m'u shfaq në formën e varrit të babait tim.

Atëherë, unë shikova të ardhmen në të majtën. Unë nuk munda të gjej ilaç. Por e nesërmja m'u shfaq në formën e varrit tim.

Unë hodha vështrimin tek dita e tanishme, dhe e pashë se ajo i ngjasonte një arkivoli që po mbante xhenazen e trupit tim të sfilatur e të plagosur rëndë. Atëherë, unë ngrita kokën time dhe pashë se kufoma ime po më shikonte mua poshtë nga maja.

Unë e ula kokën time dhe pashë se pluhuri i qockave të mia nën këmbë ishte përzier me dheun e krijimit tim të parë.

Duke u kthyer edhe prej atij drejtimi, gjithashtu, unë sodita prapa dhe pashë një dynja të përkoishme, të pathemeltë duke u rrokullisur në luginat e asgjësë dhe në errësirat e mosekzistencës.

Meqenëse, unë nuk munda të gjej asnjë të mirë edhe nga ai drejtim, unë ktheva shikimin tim përpara meje, nga ana ballore. Unë pashë se dera e varrit tim qëndronte e hapur në fund të rrugës sime dhe matanë asaj, nga larg u shfaq rruga që të çonte në përjetësi.

Ajo që unë kam ëshhtë veçse një vullnet i pjesshëm i lirë; ajo fuqi e zgjedhjes ëshhtë e pafuqishme, e shkurtër dhe e mangët. Ai vullnet i lirë nuk ka fuqi të depërtojë tek e shkuara dhe as të penetrojë tek e ardhmja. Arena ku fuqia e zgjedhjes ëshhtë aktive ëshhtë qoha e shkurtër e tanishme dhe çasti i tanishëm kalimtar.

Pavarësisht të gjithë varfërisë sime dhe dobësisë, 'Pena' e Fuqisë Tënde ka shkuar në natyrën time dëshira të pafundme dhe ambicie që shtrihen për përjetësi.

Sfera e nevojës ëshhtë aq e madhe dhe e shtrirë, aq sa shtrihet shikimi. Në fakt, kudo që shtrihet imagjinata, gjer atje shtrihet edhe sfera e nevojës.

Ndërsa, sfera e fuqisë sime ëshhtë aq e ngushtë dhe e shkurtër, aq sa arrin krahu im.

Atëherë, varfëria ime dhe nevoja ime janë aq të shtrira sa e gjithë bota.

Ndërsa kapitali im është diçka e vogël si një grimcë e parëndësishme.

Atëherë, çfarë do të tregonte aftësia e vullnetit të lirë përballë këtyre nevojave aq të shtrira sa të rrethojnë universin?

Por, o Krijuesi im, unë heq dorë nga ajo fuqi e zgjedhjes dhe po e braktis egoizmin në rrugën Tënde, me qëllim që mëshira Jote absolute të mund të më ndihmojë e të më mbështesë.

Kushdo që gjen detin e pafundmë të mëshirës, sigurisht nuk mbështetet në vullnetin e tij, e në zgjedhjen, e cila është si një mirazh shumë i vogël, është si një pikë nga 'mirazhi'.

O Zot! Kjo dynja –kjo jetë kalimtare– është veçse një gjumë; kjo jetë gjithashtu fluturon si era.

O nefsi im i mjerë, i dhënë pas jetës dhe i dëshiruar për një jetë të gjatë, zgjohu dhe eja në vetë!

Krijuesi yt është Ai në Dorën e të Cilët është e gjithë jeta dhe ekzistenca. Ë Tij është tërësia e ekzistencës dhe është pikërisht Ai, i Cili jep jetë e ekzistencë.

Kështu, sakrifikojë veten tënde në rrugën e Tij, me qëllim që ajo të bëhet e përjetshme, që ajo të fitojë qëndrueshmëri.

Sepse mohimi i mohimit është pohim.

Kështu, në qoftë se mosqënia jonë mohohet (në favor të qënies), qënia jonë gjen ekzistencë të vërtetë.

O Zoti im! O Zotërues i bujarisë dhe i dorëgjërësisë! Më dhuro mua një jetë e një vend prej prezencës Tënde.

Dhe më jep mua vlerë të pakufishme në shikimin Tënd, sepse sigurisht, Ti je Gjithëruajtës dhe Gjithëmbrojtës!

Një adresim për parlamentin¹³

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَّوْقُوتًا

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“Vërtet namazi (falja) u është bërë detyrim besimtarëve në kohë të përcaktuara”¹⁴

O anëtarët e parlamentit! Ju do të ringjalleni për një Ditë të Madhe!

O ushtarët e Islamit! O Këshilli i lartë konsultativ i Kombit! Ju kërkoj t’u vini veshin ca fjalëve këshilluese prej këtij të përvuajturi modest mbi një çështje (të rëndësisë më të madhe).

Këshilla jepet në dhjetë pjesë:

Së Pari: Mirësia më e madhe Hyjnore në këtë fitore kërkon dhënie falënderimi me qëllim që ajo të mund të vazhdojë. Në qoftë se një mirësi –bekim– nuk kthehet me falënderim, ajo zhduket e ndërpritet. Tani që ju e keni shpëtuar Kuranin prej sulmeve të armikut me ndihmën e Allahut (atëherë, me qëllim që bekimet e Tij të mund t’ju vijjnë juve vazhdimisht), ju duhet t’iu bindeni urdhëresave të Tij më të qarta e vendimtare të tilla si namazet –faljet– e detyruara.

Së Dytë: Ju me këtë fitore i keni dhënë gëzim botës Islame dhe keni fituar dashurinë dhe përkuljen e tyre prej respekti. Por kjo dashuri dhe ky orientim i tyre ndaj jush do të mund të vazhdonte vetëm nëpërmjet përmbushjes suaj të urdhëresave të Islamit, të cilat demonstrojnë se ky vend është musliman. Sepse muslimanët ju duan juve për shkak të qënies suaj muslimanë.

¹³Ky adresim iu bë parlamentit turk më 19 janar të 1923.

¹⁴Kur’an, 4:103

Së Treti: Ju keni udhëhequr ushtarët e Islamit të cilët ose janë martirizuar ose kanë mbijetuar, dhe të cilët mund të vlerësohen që të kenë arritur rangun e shenjtërisë. Kështu, nga ju pritet të zbatoni urdhëresat e Kuranit me qëllim që ju të mund të jeni në shoqërinë e atyre personave të ndritur në botën tjetër. Përndryshe, megjithëse ju keni një pozitë autoriteti në këtë botë, ju do t’ju duhet t’i kërkonit dritë një ushtari të thjeshtë në botën tjetër. Sepse kjo dynja me gjithçka që ajo përmban prej famës dhe nderit nuk është diçka që ia vlen sa t’ju mjaftonte juve dhe të ishte një qëllim për ju.

Së Katërti: Popujt muslimanë, edhe në qoftë se vetë nuk i kryejnë namazet e detyruar dhe edhe sikur të bëjnë disa gjynahe të mëdhaja, përsëri ata dëshirojnë që ata të cilët i udhëheqin duhet të jenë të devotshëm e të drejtë. Atë çfarë kërkojnë para së gjithash njerëzit e Turqisë juglindore –Kurdistani, provincat lindore– prej zyrtarëve dhe autoritarëve të tyre është kryerja e namazit. Në qoftë se zyrtarët do ta kryenin namazin, njerëzit do të kishin besim tek ata. Përndryshe, ata do të ishin dyshues ndaj tyre, edhe sikur ata të ishin zyrtarë të shquar. Njëherë, fiset e Bayt Al–Shabab u revoltuan kundra qeverisë së tyre. Kur unë i pyeta ata për arsyen e rebelimit të tyre, ata u përgjigjën:

“Guvernatori ynë nuk i kryen namazet e detyruara dhe ai pi alkool, si do t’i bindemi ne një njeriu të pa fe si ai?”

Ata që e dhanë këtë përgjigje nuk i kryenin vetë namazet e detyruara. Për më tepër, ata ishin kusarë.

Së Pesti: Shumica e profetëve u shfaqën në lindje, ndërsa shumica e filozofëve u shfaqën në perëndim. Kjo është një shenjë e Kaderit Hyjnor se shtytësi –nxitësi– kryesor për progresin e lindjes është shpallja dhe ‘zemra’, jo arsyeja dhe filozofia. Ju e keni zgjuar lindjen, tani drejtojeni atë në një rrugë të përshtatshme e në harmoni me natyrën e temperamentin e saj. Përndryshe, përpjekjet tuaja ose do të shkonin për kot, ose do të kishin një dobi të përkohshme sipërfaqësore.

Së Gjashti: Armiqtë tuaj dhe armiqtë e Islamit –francezët dhe veçanërisht anglezët– e kanë shfrytëzuar dhe vazhdojnë akoma ta shfrytëzojnë neglizhencën e tyre ndaj fesë dhe indiferentizmin ndaj saj. Madje, unë mund të them se disa të tjerë të cilët shfrytëzojnë neglizhencën tuaj në fe, ju bëjnë juve dhe Islamit aq shumë dëm, aq sa armiqtë tuaj. Për hir të mirëqënies së Islamit, dhe sigurisë e

prosperitetit të kombit, ju duhet të braktisni këtë neglizhencë dhe të nisni përsëri detyrat tuaja fetare. A nuk e shikoni se pavarësisht vendosmërisë së tyre të jashtëzakonshme, qëndrueshmërisë dhe shkaktimit në një farë mase të zgjimit midis muslimanëve, ndjekësit e partisë së Unionit e të Progresit u përbuzën dhe u urryen nga njerëzit për shkak se ata shfaqën deri diku indiferentizëm dhe pakujdesi në praktikimin e fesë? Në qoftë se muslimanët që jetojnë në vende të tjera shfaqën respekt për ta, ata e bënë këtë për shkak se nuk e shikuan neglizhencën e tyre në praktikimin e fesë.

Së Shtati: Bota e mosbesimit -e kufrit- në mënyrë të vazhdueshme, me të gjithë fuqinë e saj e ka sulmuar ashpër botën Islame qysh prej një kohe të gjatë. Me të gjitha lehtësitë teknologjike të saj, me civilizimin, filozofinë, shkencën dhe me organizatat misionare të saj, ajo ka vendosur superioritet mbi botën muslimane në fushat materiale e ushtarake. Megjithatë, ajo -bota e mosbesimit- nuk ka qenë në gjendje të triumfojë ndaj saj në fe, nuk e ka mposhtur fetarisht. Dhe të gjitha grupet e devijuara fetare brenda shtetit kanë mbetur gjithmonë pakica të sunduara. Prandaj, në kohën që Islami ka ruajtur forcën dhe qëndrueshmërinë e tij nëpërmjet Ehliis Sunneti vel Xhemaah, rrugës së profetit a.s.m, një lëvizje ateiste që vjen nga elementët e korruptuar të civilizimit europian nuk mund të gjejë rrugë për të hyrë në botën Islamike. Arritjet e rëndësishme revolucionare në botën Islamike janë të mundura veçse duke iu bindur shtyllave të Islamit, përndryshe jo. Duke ditur se në të shkuarën nuk ka pasë si kjo lëvizje, por edhe në qoftë se ka pasur, dhe disa arritje janë parë, ato nuk kanë qenë të vazhdueshme.

Së Teti: Në një kohë kur civilizimi i korruptuar europian, i cili ka shkaktuar indiferencë -mospërfillje- ndaj fesë është në prag të rënies, ndërkohë një civilizim i ri kuranor është gati duke u shfaqur, nuk do të ishte e mundur të arrihet ajo që është e mirë me mospërfillje ndaj Islamit. Ndërsa, sa për shfaqjen e rrymave dhe tendencave negative e rrënuese, bota Islamike, pasi ka pësuar kaq shumë dëm, nuk ka nevojë për ato.

Së Nënti: Ata që i vlerësojnë shërbimet që ju keni bërë dhe fitoren që e fituat në këtë luftë të pavarësisë dhe që ju duan juve nga thellësitë e zemrave të tyre janë shumica besimtare e këtij vendi, sidomos njerëzit e thjeshtë të cilët janë muslimanët e vërtetë. Ata ju duan ju me

sinqeritet, ju mbështesin dhe vlerësojnë sakrificat tuaja dhe ndjehen borxhli ndaj jush. Ata ju japin ju një fuqi vërtetë të madhe e të gjërë, e cila është zgjuar. Prandaj, për dobinë e Islamit, është e domosdoshme për ju të ndërtoni një lidhje me ata dhe të mbështeteni tek ata duke ndjekur udhëresat e Kuranit fisnik. Përndryshe, të preferosh pakicën devijuese e cila imiton përzemërsisht perëndimin dhe që i kanë këputur lidhjet me kombin, t'i preferosh këta mbi masat e muslimanëve është krejtësisht në kundërshtim me interesin dhe me mirëqënien e Islamit e të muslimanëve. Bota Islame do të largohej prej jush dhe do të kërkonte ndihmë prej të tjerëve.

Së Dhjeti: Në qoftë se në një rrugë ndodhen nëntë mundësi për shkatërrim, dhe vetëm një mundësi e vetme për shpëtim, atë rrugë nuk do ta ndiqte veçse një i marrë, i pamend që s'i hyn në sy jeta. Kurse në kryerjen e farzeve fetare ka shpëtim për nëntëdhjetë e nëntë përqind, duke ditur se kryerja e tyre nuk merr veçse një orë të vetme në ditë. Ndërkohë që ndodhet nëntëdhjetë e nëntë përqind dëm në moszbatimin e urdhëresave të Islamit.

Kështu, jam kureshtar të di se çfarë justifikimi mund të shfaqet për neglizhencën apo për moskryerjen e obligimeve Islamike, gjë e cila është e sigurtë që do t'i sjellë njeriut dëm edhe në këtë botë, edhe në tjetrën. Si do ta lejonte këtë neglizhencë zelli fetar e kombëtar?

Njerëzit imitojnë këtë grup të ushtarëve muslimanë, anëtarët e parlamentit në aktet e tyre. Sa për mangësitë e gabimet e tyre – anëtarëve të parlamentit– njerëzit ose i imitojnë edhe këto gjithashtu, ose i kritikojnë për shkak të tyre, dhe që të dyja këto shkaktojnë dëm e rrezik. Kjo do të thotë se kapja e tyre pas të drejtave të Allahut dhe orientimi i tyre për të kryer farzet, përmban edhe të drejtat e njerëzve gjithashtu. Ndodhen ata që ndjekin nxitjet dhe sugjestionet e nefseve dhe të kapriçove të tyre të pëshpëritura prej shejtanit. Ata nuk e dëgjojnë mesazhin e qartë mbi të cilin kanë rënë dakord me unanimitet i gjithë komuniteti musliman për shekuj. Ata nuk u kushtojnë vëmendje provave të panumërta për të vërtetat e tij dhe për qënien e tij i dobishëm dhe nuk u kushtojnë vëmendje as paralajmërimeve të bëra kundra neglizhencës ndaj tij. Për këta njerëz nuk mund të ketë pritshmëri që të realizojnë të mirën dhe arritjet e rëndësishme.

Ky revolucion i madh duhet të bazohet mbi themele të shëndosha. Në sajë të fuqisë që gëzon, personaliteti kolektiv i këtij parlamenti të

nderuar ka marrë kuptimin dhe funksionin e Sulltanatit. Ai nuk duhet të dështojë të marrë funksionin e kalifatit duke përmbushur dhe duke i bërë njerëzit t'i përmbushin ato parime të Islamit, të cilat shfaqin nëse një vend është musliman apo jo. Ky parlament nuk duhet të dështojë të përmbushë nevojën fetare të njerëzve, të cilët ndërsa u nevojiten gjërat për jetën, ndjejnë nevojën e fesë të paktën pesë herë në ditë. Ata nuk janë degjeneruar nga kënaqësitë mashtruese të civilizimit modern, dhe nuk i kanë harruar nevojat e tyre shpirtërore. Ata do të pranojnë si kalif atë që ju do ta emëroni si kalif dhe që do t'i jepni atij mbështetje të sigurtë për të vepruar si kalif. Çdo fuqi apo mbështetje që nuk vjen nga parlamenti dhe nuk varet prej tij, do të shkaktonte përçarje e plasaritje, gjë e cila është në kundërshtim me urdhërin kuranor,

وَأَعِظُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا

“Dhe mbahuni fort, të gjithë ju së bashku pas litarit të Allahut (Kuranit) dhe mos u ndani mes jush”.¹⁵

Kjo është koha për të qenë një komunitet i bashkuar –është koha e xhematit– dhe për të vendosur vetëdijen kolektive. Personaliteti kolektiv, i cili është shpirti i xhematit, është më i qëndrueshëm e më i fortë se sa personaliteti i individit; dhe është më i aftë për të zbatuar urdhëresat e Sheriatit. Një person i vetëm, i cili merr përsipër peshat e kalifatit mund t'i përmbushë kërkesat e kalifatit vetëm duke u mbështetur tek personaliteti kolektiv (i përfaqësuar në parlament për njerëzit). Në qoftë se ky personalitet është i drejtë, shërbimet që ai është në gjendje t'i sjellë do të jenë më të mira dhe më të shtrira se ato të një individi të vetëm. Por në qoftë se ai personalitet kolektiv është i korruptuar, atëherë, korrupsioni që ai do të shkaktojë do të jetë gjithashtu më i madh dhe më i shtrirë.

Çfarëdo që bën një individ i veçantë, qoftë e mirë apo e keqe, përgjithësisht është e kufizuar në efektet e saj. Ndërsa e mira dhe e keqja që bën një komunitet është e pakufishme. Duke shkaktuar të këqijat ose korrupsionin brenda vendit, mos i shkatërroni dhe mos i bëni të pafrutshme të mirat dhe meritat që i keni fituar nëpërmjet luftës kundra armikut të jashtëm. Ju e dini mirë se armiqtë tuaj të jashtëm dhe kundërshtarët dëshirojnë të rrënojnë shtyllat kryesore të Islamit.

¹⁵Kur'an, 3:103

Prandaj, ju jeni të obliguar t'i gjallëroni e t'i ruani këto shtylla. Përndryshe, ju në mënyrë të pavetëdijshme do të ndihmoni armikun tuaj të gatshëm t'ju sulmojë befas.

Neglizhenca dhe apatia në praktikimin e urdhëresave kryesore të Islamit demonstroi dobësinë e kombit, dhe se dobësia nuk i ndalon armiqtë e kombit prej sulmit; përkundrazi, dobësia i inkurajon ata.

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ ❁ نِعْمَ الْمَوْلَى وَنِعْمَ النَّصِيرُ

“Allahu është i Mjaftueshëm për ne dhe sa Mbrojtës i Mirë është Ai! Sa Zot i Mirë dhe sa Ndihmues i Mirë!”

SHTOJCË

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmti, Mëshirëplotit.

Lavdërimi qoftë për Allahun, i Cili është pafundësisht i Lartë dhe absolutisht i Pastër e larg pasjes së përngjasuesve as në Esencën e Tij dhe as në Atributet e Tij. Ai është Krijuesi, i Tillë që ajo botë e madhe është krijimi i Tij, dhe kjo botë e vogël, domethënë njeriu, është shpikja e Tij. Ajo është konstrukti i Tij dhe kjo është ndërtesa e Tij. Ajo është vepra e Tij e artit dhe kjo është ngjyrimi i Tij. Ajo është skicimi i Tij dhe kjo është stolisja e Tij. Ajo është mëshira e Tij dhe kjo është mirësia e Tij. Ajo është fuqia e Tij dhe kjo është urtësia e Tij. Ajo është madhështia e Tij dhe kjo është Hyjnia e Tij. Ajo është krijesa e Tij dhe kjo është modelimi i Tij. Ajo është mbretëria e Tij dhe kjo është robëria e Tij. Ajo është vendi i Tij i adhurimit dhe ky është shërbëtori i Tij adhurues. Në të dyja anët, madje, në çdo pjesë të të dyve ndodhet një stampë që tregon se çdo gjë që gjendet është prona e Tij.

اللَّهُمَّ يَا قَوْمَ الْأَرْضِ وَالسَّمَاءِ إِنَّا نَشْهَدُكَ وَجَمِيعَ مَصْنُوعَاتِكَ وَجَمِيعَ خَلْقِكَ بِأَنَّكَ أَنْتَ اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ وَحَدَكَ لَا شَرِيكَ لَكَ وَنَسْتَغْفِرُكَ وَنَتُوبُ إِلَيْكَ وَنَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُكَ وَرَسُولُكَ أَرْسَلْتَهُ رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَيْهِ كَمَا يَنْبَغُ حُرْمَتَهُ وَكَمَا يَلِيقُ بِرَحْمَتِكَ وَعَلَى آلِهِ وَصَحْبِهِ أَجْمَعِينَ

O Zot! O Mbajtësi i tokës dhe i qiellit! Ji Dëshmitar dhe le të dëshmojnë ata që mbajnë Fronin Tënd dhe melekët e Tu së bashku me dëshminë e të gjithë profetëve të Tu, evlijatë e Tu, shenjat e Tua, vërsetet e Tua (në librat që Ti ke dërguar) dhe i gjithë krijimi Yt se Ti je Allahu, nuk ka zot tjetër përveç Teje, je Një dhe nuk ke shokë. Na fal neve, ne kthehemi tek Ty me pendim dhe ne dëshmojmë se sigurisht Muhammedi a.s.m është shërbëtori Yt dhe profeti, të cilin Ti e dërgove si një mëshirë për të gjitha botët.

O Zot! Jepi bekimet e Tua atij siç i përshtatet nderimit që ai e meriton dhe jepi mëshirën Tënde për të cilën ai është i denjë; dhe mbi të gjithë familjen e tij dhe sahabët –shokët– e tij!

Mësoje, o shok! Trupi yt dhe gjërat e domosdoshme për mbajtjen e tij që Allahu t'i ka dhuruar, nuk të janë dhënë për t'i bërë si pronën tënde që ti t'i përdorësh ato si të duash. Por ti ke të drejtë t'i përdorësh vetëm në përputhje me kënaqësitë e Atij, i Cili t'i ka dhënë ty dhe jo siç të pëlqen ty, ashtu si një mysafir që nuk mund të harxhojë e as të përdorë asgjë që i përket mikpritësit të tij, veçse me lejen dhe aprovimin e këtij të fundit.

Mësoje, o shok që vlerëson ringjalljen si të pamundur e të pagjasë! A nuk i sheh shembujt e panumërt të ringjalljes, të tubimit dhe të shkatërrimit –kijameteve të pjesshëm– që ndodhin në shkallë të vogëla përpara syve të tu? Ndërsa duke vëzhguar shembuj të shumtë të vdekjes dhe të ringjalljes çdo vit të shfaqura madje prej çdo peme me fruta ose me lule, atëherë si mund ta vlerësosh si të pamundur shkatërrimin e madh përfundimtar të botës dhe rindërtimin e saj? Në qoftë se ti dëshiron një bindje që vjen prej vëzhgimit të drejtëpërdrejtë, shko me mendjen tënde në fund të pranverës dhe të verës nën një pemë mani ose kajsie. Shiko se si frutat e tyre të ëmbël e të gjallë rikrijohen e riparaqiten. Ato fruta të freskët, të këndshëm e të kënaqshëm duke të të buzëqeshur në fytyrë janë pothuajse të njëjtë me ato që vdiqën vitin e kaluar. Në qoftë se, ashtu si qëniet njerëzore, ato do të kishin shpirtëra, ato do të ishin ekzaktësisht të njëjtat fruta që vdiqën vitin e kaluar. Pastaj, reflekto mbi faktin se pavarësisht qënies së vet dru i thatë dhe ndërlikimit dhe ngushtësisë së gypeve kapilare nëpërmjet të cilave ushqimi u arrin luleve dhe frutave, koka e pemës befasi bëhet një botë e shkëlqyer. Ajo përshkruan për vëzhguesin e vëmendshëm kuptimin e:

وَإِذَا الْقُبُورُ بُعِثَتْ

“Dhe kur varret të kthehen përmbys (dhe të nxjerrin ç’kanë brenda)”¹⁶

Është e vërtetë se asgjë nuk është e vështirë për Fuqinë që prodhon prej pemës së thatë ato gjëra të ëmbëla e të këndshme – lulet, gjethet dhe frutat. Kjo është e vërtetë dhe ne besojmë!

¹⁶Kur’an, 82:4

Mësoje, o shok! Çdo sure e Kuranit përmban në përmbledhje tërësinë e përmbajtjeve të Kuranit dhe të qëllimeve që ndjekin suret e tjera si dhe historinë, tregimet e rëndësishme që ato përmbajnë. Kjo është kështu me qëllim që të mos privohet ai që është në gjendje të lexojë vetëm një sure të shkurtër të Kuranit, dhe jo të gjithë atë; për shkak të qënies së tij ose analfabet, ose ka ndonjë lloj paaftësie ose mangësie, që të mos privohet prej shpërblimit që vjen nga leximi i të gjithë Kuranit. Në sajë të kësaj shkreptime të mrekullisë, për atë që e lexon atë, një sure e vetme e zëvendëson të gjithë Kuranin.

Mësoje, o shok! Nuk është e domosdoshme për një të vetëm që vepron me autoritet mbi gjëra të shumta të jetë personalisht midis tyre dhe në kontakt fizik të drejtëpërdrejtë me to. Kjo është kështu veçanërisht në qoftë se ai i vetëm nuk është i të njëjtës natyrë si gjërat që mbi të cilat ai ushtron influencë dhe përsëri sidomos në qoftë se ai i vetëm është, në kundërshtim me gjërat, jo i mundshëm dhe jolëndor. Me qëllim që të imponojë urdhërin e tij mbi trupat e tij, një komandant jo gjithmonë duhet të jetë personalisht midis tyre, por komanda e tij përgjithësisht vihet në zbatim nëpërmjet urdhërave dhe dekreteve. Në qoftë se detyra e komandimit do t'u lihej vetë trupave, secili prej tyre do të duhej të vepronte edhe rolin e komandantit edhe atë të komandimit dhe si rrjedhojë duhej të kishte edhe aftësinë, kapacitetin për të komanduar.

I Gjithëlavdishmi i Vetëm pavarësisht madhësisë së Tij të pafundme dhe qënies së Tij pafundësisht i Lartësuar e larg të qënit midis nesh në kontakt fizik me ne, vepron mbi ne si të dëshirojë. Ashtu si dielli, i Gjithëlavdishmi i Vetëm është më i afërt me ne se sa ne me vetet tona dhe ne jemi larg prej Tij, madhështia e Tij qoftë e lartësuar.

Mësoje, o shok! Ashtu si një pemë që përfundon në frutin e saj, në sajë të një pjese duke përfshirë veçoritë e të tërës, gjërat e shumta rezultojnë në unitet. Një gjë e vetme e tërë bëhet si tërësia e specieve të saj dhe një pjesë bëhet tërësi e gjësë prej të cilës ajo është një pjesë. Për shembull, meqënëse çdo grimcë prej dritës së diellit e shpërndarë gjithandej hapësirës përmban një imazh të diellit, grimcat duke u dridhur prej dritës bëhen sikur secila një diell i vockël për shkak të lidhjes së saj të pandërprerë me diellin. Për Allahun është krahasimi më i lartë. Emrat e Dritës së dritave të parapërdjetshme manifestohen në një

mënyrë të ngjashme: çdo manifestim shihet edhe mbi çdo individuale edhe mbi tërësinë e species së saj.

Mësoje, o ti që je i kënaqur me dynjanë dhe je i qetë me të! Shembulli yt është si shembulli i atij që rrokulliset poshtë duke rënë nga maja e një kështjelle shumë të lartë; dhe ajo kështjellë rrokulliset në një rrjedhë e cila bie prej një mali shumë të thepisur. Dhe ai mal rrokulliset duke rënë nëpërmjet tërmeteve në thellësitat e tokës.

Kështjella e jetës rrënohet dhe ‘aeroplani’ i shkurtësisë së jetës fluturon me shpejtësinë e dritës. Ti shumë shpejt do të varrosesh në gropën e varrit i mbështjellë me qefinin tënd të bardhë. Rrjedha e kohës i rrotullon rrotat e saj me një shpejtësi marramendëse, dhe anija e tokës lundron e kalon siç kalojnë retë. Në qoftë se dikush udhëton në një tren që ecën me shpejtësi të lartë e zgjat dorën e tij për tek lulet me gjemba përgjatë hekurudhës, dhe gjembat ia çjerrin duart e tij, atëherë ai nuk do të fajësonte askënd tjetër përveç vetvetes. Meqënëse është kështu, mos i lakmo kënaqësitë e botës, as mos i shtrij duart e tua tek ato, sepse në qoftë se dhimbjet që vijnë prej ndjenjës së ndarjes në kohën kur ti i ke arritur ato ta çjerrin zemrën, ti mund të imagjinosh se çfarë do të ndodhte në kohën e ndarjes përfundimtare!

O nefs urdhërues për të liga! Ti mund të adhurosh cilindo që të duash dhe të pretendosh çfarëdo që dëshiron. Sa për mua, unë nuk adhuroj askënd tjetër përveç Atij, i Cili më ka krijuar dhe që ka nënshtruar për mua diellin, hënën dhe tokën, pemët dhe çfarë ka mbi të. Unë nuk i kërkoj ndihmë askujt tjetër përveç Atij që më mban e më transporton mua në ‘aeroplanin e jetës’ duke lëvizur përmes ‘hapësirës’ së Kaderit dhe i Cili ka nënshtruar për mua ‘anijen kozmike’ –tokën–midis planetëve.

Unë nuk i kërkoj ndihmë askujt tjetër përveç Atij i Cili më bëri të hip në ‘trenin’ e kohës duke udhëtuar me shpejtësinë e vetëtimës përmes tunelit të kohës në malin e jetës drejt portës së varrit përgjatë rrugës për në përjetësi. Duke qëndruar ulur me lejen dhe biletën e Tij në ‘vagonin’ e kësaj dite, e cila lidhet edhe me të djeshmen edhe me të nesërmen, unë i thërras e i kërkoj ndihmë vetëm Atij, i Cili është i aftë të ndalojë rrotën e Kaderit, e cila në dukje lëviz anijen e tokës dhe e bën lëvizjen e kohës të pushojë nëpërmjet ribashkimit të diellit dhe të hënës. Unë i kërkoj ndihmë vetëm Atij, i Cili është në gjendje, nëpërmjet transformimit të tokës në një tokë tjetër, të mbajë dhe të

stabilizojë këtë botë të ndryshueshme që rrokulliset prej majave të ekzistencës për në thellësitrat e luginave të zhdukjes dhe të mosekzistencës. Sepse unë kam ambicie, shpresa dhe qëllime që lidhen me të gjitha gjërat. Ambiciet e mia janë të lidhura tek kalimi i kohës dhe tek lëvizja e tokës.

Unë gjithashtu ndjej një lidhje të thellë me gëzimet dhe hidhërimet e të gjitha gjërave veçanërisht me ato të njerëzimit, dhe sidomos me të drejtët midis banorëve të qiejve dhe të tokës. Kështu, unë nuk adhuroj askënd tjetër përveç Atij i Cili njih madje edhe më të fshehtat e mendimeve që i ndodhin zemrës sime dhe që kënaq edhe më të vogëlën e më të hollën e ambicieve dhe prirjeve të zemrës sime.

Ai gjithashtu është në gjendje, nëpërmjet shkatërrimit të dynjasë dhe duke e ndryshuar atë në Ahiret, të realizojë dëshirën e mendjes dhe të imagjinatës sime, kryesisht, të realizojë lumturinë e përjetshme për njerëzimin. Dora e Tij i arrin të dyja, edhe grimcën e vockël edhe diellin në të njëjtin çast, dhe asgjë, sado e vogël që të jetë nuk mund të jetë shumë e vogël për t'u fshehur prej Tij, dhe sado e madhe që mund të jetë nuk mund të jetë shumë e madhe për fuqinë e Tij për ta rrethuar. Ai është i Tillë që në qoftë se do ta njihje Atë, dhimbjet e tua ndryshohen në kënaqësi, dhe pa Atë, shkencat do të rezultonin në thjesht fantazi e hamendësime, dhe filozofitë në sofizma.

Pa dritën e Tij, shembujt e ekzistencës ndryshohen në shembuj mosekzistence, dritat në shtresa errësire, krijesat e gjalla në gjëra të vdekura, kënaqësitë në dhimbje e gjynahe, të dashurit dhe në të vërtetë të gjitha gjërat, në armiq. Pa Atë, qëndrueshmëria bëhet fatkeqësi, plotësia shkon për kot, jeta harxhohet e bëhet torturë, mendja bëhet mjet vuajtjeje e mundimi, dhe ambiciet e shpresat bëhen dhimbje.

Kushdo që ia nënshton vetveten Vullnetit të Zotit dhe ndjek kënaqësitë e Tij xh.sh, atëherë çdo gjë i shërben atij, dhe kushdo që, në të kundërt nuk i bindet Allahut, atëherë çdo gjë do të kthehet kundra tij. Në qoftë se dikush do të pohonte se çdo gjë që ekziston i përket ekskluzivisht Atij, duke qenë një pronë e Tij, gjithçka i shërben atij. Ai të ka krijuar ty të rrethuar prej rrathësh nevojash njëri përreth tjetrit dhe të ka pajisur ty me atë projekt me të cilin ti mund të kënaqesh vetëm në rrethin më të vogël në qoftë se ti do të mbështeteshe në dëshirën dhe në fuqinë tënde. Disa prej nevojave të tjera të tua lidhen me një rreth aq të madh sa që ai shtrihet prej parapërrjetësisë në paspërrjetësi dhe midis

qendrës së tokës dhe Fronit Hyjnor. Me qëllim që të përmbushësh këto nevoja, Ai të ka pajisur ty me duanë ose lutjen. Në shpallje është dekretuar,

قُلْ مَا يَعْبُؤُا بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ

*"Thuaj: Zoti im kujdeset për ju vetëm nga dua ja juaj drejtuar Atij"*¹⁷.

Fëmija u thërret prindërve të tij për të arritur atë çfarë duart e tij nuk mund ta arrijnë, dhe një shërbëtor i lutet Zotit të tij për atë çfarë është e pamundur ta arrijë.

Mësoje, o shok! Plotësia e artit në çdo gjë dhe struktura e saj e fortë vjen nga uniteti i origjinës. Po të mos ishte uniteti i origjinës, që nuk pranon ndarje dhe shpërbërje dhe që nuk mund të pengohet nga manifestimi, atëherë do të kishte prishje të harmonisë dhe çrregullim në ekzistencë.

Për shembull, dielli një dhe i vetëm, ekziston në çfarëdo që ai prek me dritën e tij prej një grimce të vockël të tejdukshme deri tek faqja e një oqeani, dhe reflektimi i tij ose manifestimi në një gjë nuk e pengon atë prej qënies i manifestuar në një tjetër. Kjo është kështu për diellin, një objekt fizik i mundshëm, i përfshirë dhe i pajetë, dhe i cili është një 'pikë' që ndriçon prej manifestimit të një rrezeje të Emrit Hyjnor *En-Nur, Drita*. Ti mund ta marrësh me mend si mund të ishte për Diellin e Parapërrjetshëm dhe për Sulltanin e Paspërrjetshëm, Ekzistuesin e Përherëshëm të Domosdoshëm, të Vetmin Unik, të Gjallin e Përjetshëm, të Gjithëfuqishmin dhe të Kërkuarin përjetësisht, madhështia e Tij qoftë e lartësuar! Dhe Allahut i takon krahasimi më i lartë; Uniteti i Dritës rrethuese tregon njësinë, dhe ekzistenca e diellit me të gjitha veçoritë e tij në çdo pjesë e grimcë nëpërmjet manifestimit të dritës së tij nënkupton unitetin. Shqyrtoje këtë!

Mësoje, o shok! Midis dëshmitarëve më të vërtetë të Njësisë Hyjnore janë: Uniteti ose organizimi harmonik në mënyrë të mrekullueshme në çdo gjë, e cila shtrihet nga grimcat e qelizave të syve të tu për tek tërësia e universit; struktura e qëndrueshme në mënyrë perfekte që çdo gjë ka në përputhje me kapacitetin e saj të përcaktuar

¹⁷Kur'an, 25:77

nga Dekreti dhe Kaderi Hyjnor dhe lehtësia absolute në shpikjen dhe ndërtimin e të gjitha gjërave.

Kjo lehtësi absolute gjithashtu tregon për faktin se ekzistenca e Krijuesit nuk është e të njëjtit lloj si ekzistenca e gjësë së krijuar. Ekzistenca e Krijuesit është pafundësisht më e rrënjosur thellë dhe më e vërtetuar se ajo e gjësë së krijuar.

Mësoje, o shok! Toka të jep ty, t'i shet produktet e saj dhe mallrat në dorën e saj tepër lirë. Në qoftë se e gjitha që ajo të jep do të ishte prona e vet ose produkt i shkaqeve materiale, ti nuk do të ishe në gjendje të bleje një shegë të vetme me të gjitha ato që shpenzon për të futur në dorë gjithçka që ti merr prej tokës nëpërmjet duarve të pemëve dhe të fushave të saj. Sepse ti e shikon se Autori Krijues ka shfaqur kujdesin më të skajmë në (krijimin) e gjithçkaje deri tek kokrrat duke e bërë secilën pafundësisht të përkryer dhe duke e pajisur atë në mënyrë të hollësishme.

Ai gjithashtu ka përfshirë në atë çfarë Ai përfshin me vetëdijen më të plotë dhe mjeshtërinë më të zgjuar duke e pajisur atë me hollësitë e ngjyrës, shijes dhe aromës për të tërhequr vëmendjen e klientëve, blerësve. Ai nuk ka aspak vështirësi në krijimin e saj dhe nuk ka aspak nevojë për kontakt fizik me të. Në qoftë se ajo nuk do të kishte qenë krijesa e Tij për të Cilin një kokërr, një kopësht, një individ dhe e gjithë specia, një grimcë dhe dielli janë në mënyrë të dukshme dhe padyshim të njëjta në lidhje me fuqinë e Tij, ajo nuk do të ishte prej cilësisë së saj të përkryer të tanishme. Meqënëse ajo është krijuar në mënyrë kaq perfekte e artistikisht dhe me një bollëk të tillë, atëherë ato kokrra rrushi apo kokrra shege, për shembull nuk mund të ishin krijuar vetëm për të përmbushur kënaqësitë e përkohshme dhe dëshirat e veçanta të disa qënieve të gjalla. Po të ishte kjo e vërtetë, ajo do të kërkonte që krijuesi i tyre të ishte, ruajna Zot nga një mendim i tillë, pa vetëdije, pa dëshirë, pa njohje, pa zgjedhje dhe pa plotësi. Por arti i plotë i pavetëdijshëm, i urtë dhe i qëllimshëm në çdo gjë i kundërshton plotësisht hipoteza të tilla.

Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm, i Gjithëfuqishmi, Dëshiruesi, i Gjithëdituri, i Gjithurti, në Dorën e të Cilit është mbisundimi mbi gjithçka.

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ
مَا خَلَقَكُمْ وَلَا يَعْثُبُكُمْ إِلَّا كَفْسٍ وَاحِدَةً

“Sigurisht që urdhëri i Tij, kur Ai do një gjë, është vetëm se Ai t’i thotë asaj: ‘Bëhu’ –dhe ajo është bërë (në çast).”¹⁸

“Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve është si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm.”¹⁹

Dhe në çdo krijesë, Ai ka shembuj urtësie dhe qëllime që lidhen me manifestimet e Emrave të Tij dhe me kuptimin e akteve të Tij si Zoti i Gjithëfuqishëm, dhe jo të lidhur vetëm me dobitë që ajo u jep konsumatorëve të saj. Do të ishte e pamundur që kjo gosti universale të jetë e përgatitur prej një fuqie të verbër dhe se të gjitha ato fruta, ato produkte duke ardhur si rrymë a rrjedha të jenë një lodër e rastësisë apo e koinçidencës. Forma e veçantë, ngjyra, aroma dhe shija e përcaktuar për secilën për disa qëllime e shërbime, secila e bërë me vetëdije, kjo e refuzon në mënyrë vendimtare e të sigurtë dorën e rastësisë së verbër dhe të koinçidencës. Përkundrazi, ndodhet bollëk dhe lirësi në çmim, dhe lehtësi në ardhjen e tyre në ekzistencë qoftë individualisht apo si specie dhe struktura e tyre e përkryer, dhe pavarësisht shumëllojshmërisë së pafundme, formimi i tyre prej vetëm pak substancave, të gjitha këto dëshmojnë për një bujari absolute të të Gjithëbujarit Absolut, të Gjithurit Absolut dhe të Gjithëfuqishmit Absolut. Madhështia e Tij qoftë e lartësuar! Dhuratat e Tij rrethojnë e gjithëpërfshijnë dhe mirëbërësia e Tij i përfshin të gjithë.

Lavdi Zotit, i Cili ka bashkuar bujarinë e pafundme absolute me urtësinë e pafundme dhe me kursimin. Lavdi Allahut, i Cili ka vendosur dhënien me bollëk të madh absolut të pakufizuar brenda limiteve të një rregulli të përkryer, në një balancë ose masë të ndjeshme dhe një drejtësie absolute. Ky rregull, kjo balancë dhe kjo drejtësi janë të një shtrirje të tillë sa që një elefant detyrohet të mbrojë veten kundra një mize që e pickon atë në një pikë të trupit të tij të stërmadh, dhe se

¹⁸Kur’an, 36:82

¹⁹Kur’an, 31:28

njeriu mendjemadh e kryelartë detyrohet të luftojë kundra ‘shtizës’ së vogël të një mushkonje.

يَا أَيُّهَا النَّاسُ ضُرِبَ مَثَلٌ فَاستَمِعُوا لَهُ إِنَّ الَّذِينَ تَدْعُونَ
مِنْ دُونِ اللَّهِ لَنْ يَخْلُقُوا ذُبَابًا وَلَوْ اجْتَمَعُوا لَهُ وَإِنْ يَسْلُبْهُمُ
الذُّبَابُ شَيْئًا لَا يَسْتَنْقِذُوهُ مِنْهُ ضَعُفَ الطَّالِبُ وَالْمَطْلُوبُ ۗ

“O njerëz! Është thurur një përngjasim për ju, kështu që dëgjoni mirë. Me të vërtetë që ata të cilëve ju u drejtoheni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe sikur të mbledheshin të gjithë së bashku për t’ia arritur qëllimit. Dhe nëse miza merr diçka prej tyre, ata nuk do të kenë aspak fuqi për ta çliruar atë prej mizës. Kështu që dobët janë (që të dy) edhe lutësi, edhe i luturi.”²⁰

Dhe zemërimi i një deti dhe furia e stuhive bien e fashiten dhe ashpërsia e të ftohtit zvogëlohet nëpërmjet një duaje të bërë në heshtje prej një fëmije zemërthyer i cili shpëtoi dhe u transportua i sigurtë.

أَمَّنْ يُجِيبُ الْمُضْطَّرَّ إِذَا دَعَاهُ وَيَكْشِفُ السُّوءَ ...

“A nuk është Ai (më i Miri) i Cili i përgjigjet të pikëlluarit, kur ai i drejtohet Tij (me lutje) dhe i Cili e largon të keqen (e tij)...”²¹

Ai që dëgjon të rrahurat e zemrës dhe që është në dijeni të çfarëdoje që i ndodh asaj i përgjigjet asaj, dhe drejton lëvizjet e diellit dhe hënës, Sovraniteti i Tij qoftë i lartësuar!

Mësoje, o shok që ia përshkruan çdo gjë ligjit të shkakësisë! Krijimi i një shkakut dhe duke e bërë atë shkakun e një efekti, pajisja e tij me pajimet e domosdoshme për ta sjellë efektin në ekzistencë, nuk është një akt më i lehtë, më i përkryer dhe më i mahnitshëm se sa krijimi i efektit me urdhërin: “*Bëhu!*” që lëshohet prej Tij, në lidhje me të Cilin grimcat dhe diejt janë të njëjtë, të barabartë.

Mësoje, o zemra ime! Vuajtjet, zhdukja dhe vdekja që ti i sheh të mbushin botën janë vetëm ripërtëritje të shembujve. Në çdo ndarje dhe zhdukje, në vend të dhimbjes së zhdukjes, një besimtar gjen kënaqësinë

²⁰Kur’an, 22:73

²¹Kur’an, 27:62

e ripërtëritjes. Beso dhe gjej siguri e kënaqësi; nënshtroje veten tënde ndaj Tij dhe gjej paqë e lumturi!

Mësoje, o shok! Racizmi është një kombinim i pakujdesisë, i injorancës, i çudhëzimit, i mburrjes, i shtirjes dhe i padrejtësisë, të cilat e mbështesin dhe i japin forcë njëra-tjetrës. Racisti bën një idhull prej racës së tij, e bën racën e tij si të adhuruarin e tij, ruajna Zot prej devijimeve të tilla! Sa për zellin ndaj Islamit, ai është një dritë e ndritshme që vjen nga besimi.

Mësoje, o shok i preokupuar me debate me heretikët –ateistët– agnostikët dhe me imituesit e ateistëve europianë! Ti je në rrezik të madh në qoftë se nefsi yt nuk është i pastruar plotësisht –nuk je i bindur plotësisht për të vërtetat e besimit e të Islamit– ti gradualisht mund të tërhiqesh në mënyrë të pavetëdijshme tek ana e armiqve të tu. Ti nuk mund të besosh në nefsin tënd urdhëruar për të liga në një debat sot të quajtur arsyetim objektiv. Sepse në mendjen e një diskutuesi i cili shqyrton idetë e kundërshtarit të tij dhe përkohësisht i supozon ato si të vërteta për të gjetur përgjigje për ato, një farë kritikimi dhe gjetje gabimi del e mugullon dhe vetë diskutuesi fillon të sillet një përfaqësues për kundërshtarin e tij. Duke e shfrytëzuar këtë, shejtani e ul veten në mendjen e tij dhe përpiket ta rrisë atë farë.

Por, në qoftë se ti ke nijet –qëllim– të pastër (në debat) kur ti ndjen se ke filluar të sillesh si një përfaqësues për kundërshtarin tënd, ti menjëherë kthehesh të luftosh kundra armikut tënd më të madh brenda teje dhe me ngulm kërkon falje prej Allahut me përgjërime e përlulësi të plotë.

Mësoje, o shok! Supozo se një pallat i mahnitshëm po ndërtohet dhe zbukurohet për një mbret të madh. Kushdo që e dëshmon dhe i sheh instrumentet e përdorura dhe punëtorët e punësuar pa ditur se për çfarë qëllimesh po ndërtohet pallati, sigurisht do të dalë me përfundimin –konkluzionin– se punëtorët nuk po punojnë për llogari të vetes së tyre, por për llogari të atij që i punëson ata për disa qëllime të larta. Në të njëjtën mënyrë, shikoji qëniet frymorë dhe jofrymorë të punësuar në univers për qëllime e synime të shumta fisnike e të holla, madje shumicën e të cilave edhe të zgjedhurit prej shkollarëve dhe dijetarëve nuk janë në gjendje t'i perceptojnë. Shqyrtoje shijen e hollë që shfaqin lulet me qëllim që ta bëjnë vetveten të dashura prej atyre që i shikojnë. Ti sigurisht do të bindeshe se ashtu si qëniet e tjera, kafshët

për shembull, lulet janë ngarkuar nga ana e të Gjithurtit Gjithëbujar me shërbimin ndaj mysafirëve të Tij në tokë dhe për ta bërë Atë të dashur nëpërmjet tyre.

A kanë lulet ndjenja dhe a kanë kafshët vetëdije që ato të mund t'i kapnin qëllimet për skicat dhe zbukurimet dhe hollësitë e hijeshive të bujarisë që ato bëhen të shfaqin? Kështu, ato –këto situata– janë për ta bërë Një Zot Gjithëbujar të njohur e të dashur prej shërbëtorëve të Tij të vetëdijshëm, mysafirëve të Tij. Madhështia e Tij qoftë e lartësuar dhe dhuratat e Tij rrethojnë dhe përkujdesja e Tij i përfshin të gjithë.

Mësoje, o nefs urdhërues për të liga e qëllimkeq! Ti kërkon të shohësh çfarë është e domosdoshme për të gjithë gradat e ekzistencës në një gradë të vetme, dhe me çfarë është e nevojshme nga të gjitha shqisat në një shqisë të vetme. Ti gjithashtu kërkon t'i përjetosh të gjitha kënaqësitë që i përjeton me të gjitha ndjenjat e tua, me aftësitë dhe me shqisat, t'i përjetosh me secilën prej tyre më vete. Ti kërkon të shohësh rrezet e të gjithë Emrave të bukur Hyjnor në çdo Emër, dhe madhështinë e Krijuesit në çdo krijesë, dhe të zbulosh kuptimin e çdo gjëje reale të manifestuar në reflektimin e saj në mendje. Ndërkohë që me qëllim që të mos zbulohesh para sugjerimeve dhe mendimeve të këqija rreth Krijuesit, ti duhet të kërkosh të gjesh në çdo gjë atë çfarë ajo meriton dhe mund ta përfshijë.

Mësoje, o shok! Kur ti ke një mendim të lartë për veten tënde, shiko ata që janë më të mëdhenj se ti. Kur ti i sheh ato, si insektet, që janë më të vogëla se ti, atëherë shikoj qelizat e trupit tënd dhe përqëndrohu tek vetëm njëra midis tyre derisa t'i shohësh mushkonjën dhe ato më të mëdhaja se ajo, më të mëdhaja se sa ti. Por kjo nuk duhet që të të shkaktojë ty të shpërfillësh urtësinë, mëshirën, favorin dhe përsosurinë e artit në ty. Kur ti i sheh mirësitë e panumërta të të njëjtit lloj që të janë dhënë ty, shiko nevojën tënde, dobësinë e vetes tënde dhe qëllimet për ato mirësi, me qëllim që ti të mos i përbuzësh e mos t'i shpërfillësh ato.

A e pakëson nevojën tënde për syrin ajo që të gjitha kafshët kanë sy? Ose, a mos vallë e pakëson përfshirja e një mirësie të veçantë apo e qëllimit për të? Jo, përkundrazi, ajo e intensifikon nevojën për të dhe e shton përfshirjen e saj.

Mësoje, o shok! Ndodhen qëllime të panumërta për jetën e çdo gjallese. Vetëm njëra midis tyre ka të bëjë me vetë gjallesën, ndërsa qëllimet e tjera që kanë të bëjnë me të Gjallin e Përjetshëm, të Vetmin dhe Jetëdhënësin, janë në përpjestim me shtrirjen e sundimit dhe pronësisë së Tij të pakufishme. Nuk ka të drejtë i madhi në krijim, sado i madh që të jetë t'i mburret të vogëlit; në realitet nuk ndodhet as paqëllimshmëria e as kotësia më e vogël në krijim. Por duke e shikuar çdo gjë lidhur me interesat e dëshirat e tyre, njerëzit egoistë e arrogantë mund t'i vlerësojnë ato gjëra që i shohin si pa lidhje, për dobitë e tyre, si të kota e të paqëllimta. Tryeza universale e shpërndarë mbi tokë është dhuratë për njerëzimin për shkak të kalifatit dhe me kusht që ai ta përmbushë këtë përgjegjësi e ta përdori në Emrin e Allahut me nder, dhe jo vetëm për të përfituar prej saj.

Mësoje, o shok! Në qoftë se dikush të pëshpërit ty:

“Ti je veçse një kafshë midis kafshëve të tjera të panumërta; miza është vëllai yt dhe bleta motra jote. Si mundesh ti të kesh një lidhje me të Vetmin, i Cili thotë:

يَوْمَ نَطْوِي السَّمَاءَ كَطَيِّ السِّجِلِّ لِلْكُتُبِ
وَالْأَرْضُ جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَالسَّمَاوَاتُ مَطْوِيَّاتٌ بِيَمِينِهِ

“Ne do t’i mbështjellim qiejt si letër e shkryar...”²²dhe “Dhe në Ditën e Kijmetit e gjithë toka dhe qiejt do të jetë e mbështjellë në Dorën e Tij të Djathtë”²³.

I thuaj atij: *“Pranimi im për pafuqinë time, varfërinë dhe parëndësinë para Tij, së bashku me njohjen time dhe bindjen time ndaj Tij, bëhet një pasqyrë për të më treguar mua fuqinë e Tij, pasurinë dhe dinjitetin e Tij. Është për shkak të saj që unë kam përparuar prej rangut të qënies një kafshë për tek rangu i humanizmit. Plotësia e madhështisë dhe e gjithëpërfshirjes së fuqisë së Tij kërkon që Ai duhet ta dëgjojë thirrjen time dhe të shohë nevojat e mia, dhe se mbajtja e Tij tokën e qiejt nuk e pengon Atë nga dhënia e Tij mbështetje për mua dhe për të m’i rregulluar punët e mia”.*

²²Kur’an, 21:104

²³Kur’an, 39:67

Lidhja e Allahut me gjërat dhe ngjarjet e vogëla e të parëndësishme në dukje nuk e kundërshton madhësitinë e Tij. Përkundrazi, në qoftë se Ai nuk e lidh Vetën me to, kjo do të ishte një mungesë nga ana e madhësisë së Hyjnisë së Tij. A nuk e sheh ti se çdo flluskë, çdo pikë uji dhe çdo copë qelqi, sado e vogël që është përmban imazhin e diellit? Në qoftë se ato do të mund të flisnin, secila prej tyre do të thonte: “Dielli më përket mua, ai është në mua, ose ai më shoqëron mua”. Dhe as ato pika, as copat e xhamit, as planetet dhe as faqet e deteve nuk e pengojnë njëri-tjetrin prej pasjes së një lidhje me diellin, dhe as madhështia e diellit nuk i pengon ato lidhje. Përkundrazi, si në këtë shembull, sa më shumë ta njohim të Gjithëfuqishmin e Vetëm dhe sa më shumë të jemi të vetëdijshëm për varfërinë tonë dhe ultësinë tonë para Tij, aq më të afërt jemi ne për Të. Sa e mirë është pozita e dikujt që nuk e harron varfërinë dhe pafuqinë e vet para Tij për pasurinë e të Cilit, fuqinë, dinjitetin dhe madhësitinë nuk ka limite.

Lavdi Atij i Cili ka përfshirë mirësi të pakufishme, dhembshuri të pafund në madhëri të pafund, i Cili ka kombinuar afërsinë e pafundme me largësinë e pafundme, i Cili ka vendosur vëllazëri ndërmjet grimcave të vockëla dhe diejve, dhe i Cili e manifeston fuqinë e Tij nëpërmjet kombinimit të të kundërtave.

Shiko se si kjo mbështetje –mbajtje– madhështore dhe ky drejtim i tokës dhe i qiejve nuk e pengon Atë nga mbështetja me dhembshuri ndaj insekteve. Shiko se si mbështetja dhe administrimi i Tij nuk e pengon Atë nga krijimi i më të vogëlës së bletëve dhe të zogjve, dhe nga dhënia e jetës për më të vegjëlit e peshqive në thellësitë e deteve. Shiko se si forca e stuhive të tokës dhe tërbimi i deteve nuk e largon prej mirëbërësisë së plotë dhe dhembshurisë ndaj krijesës së gjallë më të fshehur, më të dobët, më të pafuqishme në vendin më të fshehur në thellësitë e detit në natën më të errët.

Mëshira shfaqet duke buzëqeshur midis zemërimit të detit dhe fytyrës së tij të egër e të vrenjtur. Sepse ndërsa ky det thërret me tonin e tij ulëritës *“يَا عَظِيمُ يَا جَلِيلُ يَا كَبِيرُ يَا اللَّهُ سُبْحَانَكَمَّا عَظَمَ كِبْرِيَاءَكَ”* o i Gjithëfuqishëm, o i Madhërihëm! O i Madh! Lavdia të takon Ty, sa i Madh je Ti!”, ajo krijesë e vogël i përgjigjet ulërimës së tij me thirrjet në mënyrë të heshtur

يَا لَطِيفُ يَا كَرِيمُ يَا رَزَّاقُ يَا رَحِيمُ يَا اللَّهُ سُبْحَانَكَ مَا أَلْطَفَ إِحْسَانَكَ

“O Hirplotë, o Gjithëbujar, o Furnizues, o Mëshirëplotë, o Allah! Sa e hollë dhe e bukur është mirëbërësia Jote!”

Në këto dy tipe –lloje– të thirrjes së Allahut nëpërmjet Emrave të Tij dhe lavdërimeve ndaj Tij, janë një madhështi e bukur dhe e këndshme, një mirësi e shkëlqyer dhe një butësi, si edhe një tip i lartë adhurimi ndaj të Vetmit Unik, të Kërkuarit Përjetësisht, madhështia e Tij qoftë e lartësuar dhe favori i Tij i rrethon të gjithë.

Mësoje, o shok! Pas kërkimit të njohjes së domosdoshme rreth besimit, është detyrë për ty të bësh vepra të mira e të drejta. Sepse Kurani i gjithurtë deklaroi vazhdimisht: *“الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ”* *“Ata që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi”*.

Po, kjo hapësirë e shkurtër jete mjafton vetëm për bërjen e asaj që është më e rëndësishme dhe më e domosdoshme. Sa për shkencat dhe teknologjinë, ato janë të domosdoshme sa kohë që ato ndihmojnë në përmbushjen e nevojave esenciale dhe progresit të njerëzimit mendërisht e shpirtërisht dhe të prosperitetit të tyre në të dyja botet. Në qoftë se ato shkaktojnë shturje dhe rebelim, ato janë të dëmshme.

اللَّهُمَّ يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِينَ وَأَرْحَمَ أُمَّةٍ مُحَمَّدٍ عَلَيْهِ الصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ
وَنُورَ قُلُوبِ أُمَّةٍ مُحَمَّدٍ عَلَيْهِ الصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ بِنُورِ الْإِيمَانِ وَالْقُرْآنِ
وَنُورِ بُرْهَانَ الْقُرْآنِ وَعَظْمِ شَرِيْعَةِ الْإِسْلَامِ آمِينَ

O Allah! O më i Mëshirshmi i mëshiruesve! Mëshiroje ummetin e Muhammedit a.s.m, dhe ndriçoji zemrat e tyre me dritën e besimit dhe të Kuranit! Dhe ndriçoje provën e Kuranit dhe lartësoje Sheriatin Islam! Amin!

NJË FARË

Nga një Frut i Kopshteve të kur'anit

حَبِّهِ مِي كُوَيْدِ
مَنْ شَاخِ وَرَحْمَتِمْ پَرَا زَمِيوَهُ تَوْجِيْدِيكَ شَبْنَمِ اَرِيْمِمْ پَرَا زَلُو لُو تَوْجِيْدِي
بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِيْمِ
الْحَمْدُ لِلّٰهِ عَلَى دِيْنِ الْاِسْلَامِ وَكَالِ الْاِيْمَانِ وَالصَّلَاةِ وَالسَّلَامِ
عَلَى مُحَمَّدٍ الَّذِي هُوَ مَرْكَزُ دَاوِرَةِ الْاِسْلَامِ وَمَنْبَعُ اَنْوَارِ الْاِيْمَانِ وَعَلَى
اٰلِهِ وَصَحْبِهِ اَجْمَعِيْنَ مَا دَامَ الْمَلَكُوَانِ وَمَا دَامَ الْقَمَرَاتِ

Fara thotë

*Unë jam një degë e një peme frutore me fruta të shumtë të Njësimit
Ose një fluskë prej detit që në të fshihen shumë inxhi Hyjnorë.*

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi Zotit për fenë e Islamit dhe plotësinë e imanit (besimit).

*Bekimet e Allahut dhe paqja qofshin mbi profetin Muhammed a.s.m,
i cili është qendra e rrethit të Islamit dhe burimi i dritave të imanit, dhe
mbi të gjithë familjen e tij dhe sahabët sa të vazhdojnë dita dhe nata,
dhe sa të lëvizin –rrotullohen– dielli dhe hëna në udhët e tyre.*

Mësoje, o shok! Në qoftë se ti e shikon universin si një libër të madh, ti do të shikoje dritën e Muhammedit a.s.m. si bojën e penës me të cilën është shkruar ai libër. Në qoftë se ti e shikon universin në formën e një peme, ti do ta shihje dritën e tij (a.s.m) si farën e saj origjinale dhe rrjedhimisht si frutin e saj. Në qoftë se ti e shikon universin si në formën e një qënieje të gjallë, ti do ta shohësh dritën e

tij si shpirtin e saj. Në qoftë se ti e shikon universin në formën e një njeriu të madh, ti do ta shohësh dritën e tij si mendjen e tij. Në qoftë se ti e shikon universin si një kopësht të lulëzuar, do ta shohësh dritën e tij a.s.m. si bilbilin e atij kopështi. Në qoftë se ti e shikon universin si një kështjellë të lartë e të stolisur me shumë dhoma e apartamente, të cilat shfaqin shkëlqimin e Sovranitetit të Parapërdjetshëm dhe mrekullitë e lavdisë së Tij, si dhe bukuritë e manifestimeve të Hijeshisë së Tij të mahnitshme të Artit të Tij, atëherë ti do ta shohësh dritën e profetit Muhammed a.s.m. si një spektatore. Ai së pari i shikon ato për vete dhe pastaj thërret e shpall: “O njerëz! Ejani e i shikoni këto pamje të këndshme! Nxitoni për të marrë pjesën tuaj në to, dashurinë, habinë, freskinë, vlerësimin, ndriçimin, reflektimin dhe shumë gjëra të tjera të larta”. Ai ua tregon atyre të gjitha këto; ai i vëzhgon ato dhe i bën të vëzhgohen nga njerëzit. Meqenëse ai habitet nga ato, ai gjithashtu i bën njerëzit të habiten prej tyre. Ai e do Pronarin e tyre dhe e bën Atë të dashur prej njerëzve. Meqenëse ai vetë është i ndriçuar nëpërmjet tyre, ai gjithashtu i bën të tjerët të ndriçuar. Ai përfiton prej tyre, dhe i bën edhe të tjerët gjithashtu të përfitojnë.

Mësoje, o shok! Njeriu është fruti i pemës së krijimit. Fruti është më i ploti i pjesëve të një peme dhe më i largëti prej rrënjëve. Ai gjithashtu është më gjithëpërfshirësi i tyre, i cili ka veçoritë e tërësisë së pemës.

Midis qënieve njerëzore ndodhet njëri prej të cilit i Gjithëfuqishmi xhel–le sheënuhu rriti këtë pemë të krijimit. Atëherë, Krijuesi xhel–le xhelaluhu e bëri atë njeri frutin e asaj peme. Pastaj, i Gjithëmëshirshmi e bëri atë frut të ndritshëm bërthamën e pemës së Islamit, dhe llampën ndriçuese të botës së saj dhe diellin e sistemimit të saj.

Pa dyshim, çfarë është e domosdoshme për një pemë është gjithashtu e domosdoshme për bërthamën e saj. E krahasuar me masën e madhe të pemës, masa e vogël e bërthamës, si fara e një fiku, nuk e përjashton atë nga ky rregull. Ndodhet një kokërr gjithashtu brenda njeriut. Në qoftë se njeriu do të kishte qenë një frut, kjo kokërr do të kishte qenë bërthama e tij. Kujdes, kjo kokërr është zemra.

Unë kam parë se për shkak të shumëllojshmërisë së nevojave të tij, njeriu ka lidhje me të gjitha speciet e krijimit, madje me të gjitha pjesët individuale të tij, dhe për shkak të intensitetit të nevojës dhe varfërisë së tij, ai ka lidhje me të gjitha dritat e Emrave të bukur Hyjnorë. Është

sikur njeriu të kishte aq shumë nevoja, aq sa pjesët e krijimit; ai ka armiq e hasëm aq sa për të mbushur dynjanë. Ai nuk do të kënaqej me askënd përveç Atij që është i Aftë ta bënte atë të pavarur dhe që do ta mbronte atë kundër çdo gjëje.

Unë gjithashtu kam parë se si një hartë ose si një indeks, ose si një shembull apo model, njeriu ka një kapacitet për të përfshirë ose për të përfaqësuar tërësinë e krijimit. Ai ka një qendër –një bërthamë– që nuk pranon veçse Një. Ajo nuk lidhet me asgjë tjetër përveç asaj që është e përjetshme dhe e amshuar. Kjo bërthamë është kokrra e zemrës, e cila duhet të vaditet nga Islami dhe të marrë dritë nga imani, besimi, uji i saj është Islami dhe drita e saj është imani. Në qoftë se në dheun e adhurimit dhe të pastërtisë së qëllimit ajo do të ujitej nga Islami dhe do të zgjohej në jetë nga imani, ajo do të rritej një pemë e tillë e ndritshme shpirtërore prej botës ose urdhërit që do të ishte shpirti i trupit të saj fizik. Në qoftë se ajo nuk do të ujitej, ajo do të mbetej një bërthamë e thatë që do të digjej në zjarr deri sa të pranojë cilësinë e dritës derisa të kthehet në dritë.

Në bërthamë ndodhen gjëra shumë të holla e delikate si nervat; secila prej tyre, po ndodhi që fara mbin siç duhet, përmbush një detyrë tepër të rëndësishme. Gjithashtu kokrra e zemrës ka shërbëtorë mosveprues –të paaktivizuar– të cilët, kur aktivizohen e zhvillohen me jetën e zemrës, udhëtojnë nëpër kopshtet e universit si zogj. Si rrjedhojë, kokrra e zemrës zgjerohet e shtrihet deri në atë shkallë sa që njeriu thotë: lavdi Zotit për të gjitha krijesat e Tij, sepse të gjitha ato janë mirësi që më janë dhënë mua. Për shembull, imagjinata që është më e dobëta dhe më e mekura e shërbëtorëve të zemrës, është e ngarkuar me një detyrë të çuditshme. Nëpërmjet saj, njeriu, i mbyllur në një vend të ngushtë, futet në një kopësht gjallërues, gazmor dhe, ndërsa kryen namazin e detyruar në qoshen më të largët të lindjes apo të perëndimit, e vë kokën e tij nën “Gurin e Zi” në Qabe dhe i lë në besim –në amanet– Gurit të Zi dëshminë e tij për Qënien e Allahut Zoti i tij.

Siç dihet, “lëmi” mbështillet e vërtitet rreth kokave të frutave dhe fruti është ai që nxirret dhe ruhet. E ngjashme me këtë, fusha e ringjalljes është lëmi që e pret njeriun, frutin e krijimit për të ndarë kokrrën nga byku (kashta).

Mësoje, o shok! Brenda kësaj bote, gjithësecili ka një botë të veçantë krejtësisht të njëjtë me botën e jashtme, veçse në qendrën e kësaj bote të veçantë qëndron vetë njeriu që është në të, dhe jo dielli. Çelësat për këtë botë janë në duart e njeriut dhe lidhen me shqisat e aftësitë e tij.

Kjo botë e merr ngjyrën e vet pas qendrës së saj –njeriut të cilit ajo i përket– dhe përsëri ajo varet tek vetë njeriu nëse bota e tij është e begatë, e lulëzuar, e bukur apo e shëmtuar, ose e ndritur apo e errët. Ashtu si pamjet që do të kenë një kopësht që reflektohet në një pasqyrë dhe ndryshimet që ai do të shfaqë varen nga pasqyra, po kështu bota e veçantë e gjithësecilit varet tek ai që e ka atë në të gjitha pamjet dhe karakteristikat.

Prandaj, mos mendo se masa e vogël e trupit tënd mund të jetë një justifikim për papërfillshmërinë –vogëlsinë– e mëkateve të tua. Një errësirë apo një ashpërsi e vogël e papërfillshme në zemrën tënde mund t’u shkaktojë të gjitha yjeve të botës tënde të veçantë të shuhen.

Mësoje o shok! Përgjatë tridhjetë viteve unë kam luftuar kundër “rebelëve”, njëri është ‘egoja’ brenda njeriut, dhe tjetri është natyra në botën e jashtme. Unë e kam parë të parin si një pasqyrë e hijesuar –me hije, e mjegullt– e cila reflekton dikë tjetër ndryshe nga vetja. Por njeriu e shikon atë si të kishte një ekzistencë të pavarur, duke shfaqur vetveten, dhe si rrjedhojë duke u bërë një tiran i paepur në rebelim kundra Krijuesit të vet.

Sa për tjetrën, natyrën, unë e kam parë atë si një vepër e Artit Hyjnor, si një ngjyrim –pikturë e zbukurim– i të Gjithëmëshirshmit. Por, si rezultat i shikimit të saj në mënyrë të pakujdesshme nga njerëzit, ajo është shikuar nga materialistët si të ishte perëndi, e vetëkrijuar dhe se ekziston nga vetvetja, dhe është bërë një pretekst për mosmirënjohje, e cila ka rezultuar në mosbesim, mohim.

Falënderimet e lavdërimet qofshin për Allahun, me ndihmën e të Vetmit, të Kërkuarit përjetësisht, dhe me ndriçimin e Kuranit të lavdishëm, lufta ime ka përfunduar me vdekjen e këtyre dy rebelëve, me copëtimin e këtyre dy idhujve. Ashtu siç u diskutua në trajtesat: “*Pika, pikëla, grimca, fryma, kokërra dhe flluska*”, prapa perdes së natyrës është shfaqur një vepër e Artit Hyjnor, një koleksion i ligjeve të krijimit dhe që veprojnë në univers. Dhe egoja është copëtuar dhe pas

saj është shfaqur i Vetmi, ngjashmëria e të Cilit nuk ekziston, xhel–le xhelaluhu.

Mësoje, o ego! Ndodhen nëntë gjëra në botën tënde për natyrën dhe pasojat e të cilave ti je e pavetëdijshme:

Njëra prej tyre është trupi yt. Ai është si një frut i freskët, i këndshëm dhe i kënaqshëm në verë, por i thatë dhe i kalbur në dimër.

Tjetra është cilësia jote shtazore, jeta jote fizike. Hidhe vështrimin tek kafshët dhe shiko se sa shpejt u vjen atyre vdekja dhe zhdukja.

E treta, është cilësia jote njerëzore. Ajo ngurron –është ndërdushas– midis shuarjes dhe pastrimit dhe midis zhdukjes dhe qëndrueshmërisë. Ruaje atë pjesë të saj e cila është e prirur të mbetet përgjithmonë nëpërmjet përmendjes së vazhdueshme të të Qëndrueshmit të Vetëm përjetësisht.

E katërta, është jetëgjatësia e caktuar për ty. Ajo është e shkurtër dhe e kufizuar dhe zgjat deri në kohën e exhelit të caktuar për të, e cila as nuk mund të përshpejtohet dhe as nuk mund të shtyhet. Prandaj, mos u pikëllo për të, as mos u mërzit, as mos u frikëso për të dhe as mos e ngarko atë me ambiciet e kësaj bote të pamundura për t’u arritur brenda saj.

E pesta, është ekzistenca jote fizike. Ajo është në Dorën e Pronarit të Vërtetë të të gjitha gjërave. Ai kujdeset për të më shumë se sa ti. Në qoftë se ti ndërhysh tek ajo në mënyrë të panevojshme pa lejen e Tij, ti do t’i shkaktoje dëm asaj. A nuk e sheh ti se lakmia sjell dëshpërim e zhgënjim dhe këmbëngulja për të fjetur gjumë i shkakton njeriut të humbasë gjumin e tij e të bëhët i pagjumë?

E gjashta, janë fatkeqësitë që të bien ty. Ato nuk janë realisht të hidhura, sepse ato kalojnë shpejt. Ato japin kënaqësi nëpërmjet zhdukjes dhe qënies së tyre të ndjekura nga mbarësitë. Përveç kësaj, ato të bëjnë ty të kthehesh nga ajo që është kalimtare për tek ajo që është e qëndrueshme nëpërmjet të të Qëndrueshmit të Vetëm të Përjetshëm.

E shtata, është se ti je një mysafir këtu, kudo që ti je në botë. Një mysafir nuk e lidh zemrën e tij me atë që nuk i përket dhe që nuk e ndjek atë gjatë gjithë udhëtimit të tij. Ashtu siç do të largohesh shpejt prej këtu, po kështu ti do të largohesh shpejt prej këtij qyteti: ti ose do

të varrosesh në të ose do të dalësh jashtë tij. Ashtu siç do të largohesh medoemos prej tij, po ashtu ti do ta lësh këtë botë kalimtare ose do të dëbohesh prej saj. Prandaj hiq dorë prej saj dhe braktise me nder e dinjitet, përpara se të dëbohesh i poshtëruar.

E teta, është që ti duhet ta sakrifikosh ekzistencën tënde fizike për të Vetmin Unik i Cili ta ka dhënë atë ty. Sepse Ai e blen atë për një çmim shumë të lartë. Nxito ta shesësh atë, ose më mirë ta sakrifikosh atë. Sepse:

Së Pari: Ajo do të ikte për asgjë.

Së Dyti: Ajo i përket Atij dhe do të rikthehet tek Ai.

Së Treti: Në qoftë se ti mbështetesh tek ajo (jeta), ti do të biesh në mosekzitencë. Sepse ekzistenca jote në fakt është një derë e hapur për tek Ai. Në qoftë se ti do ta hapje atë derë nëpërmjet braktisjes së saj, ti do të gjeje ekzistencën e përjetshme.

Së Katërti: Në qoftë se ti do të kapeshe pas ekzistencës tënde, vetëm një pjesë me përmasën e një pike do të mbetej prej saj në dorën tënde, dhe ti do të mbështillesh e mbulohest nga një errësirë e dendur mosekzistence. Por, në qoftë se ti e heq dorën tënde prej asaj pjese, atëherë dritat e ekzistencës do të të rrethojnë ty prej të gjitha anëve.

E nënta, ka të bëjë me gëzimet ose me kënaqësitë e kësaj bote. Çfarëdo që Kaderi Hyjnor ka përcaktuar për ty, ajo do të vijë tek ty. Prandaj mos u shqetëso rreth saj. Një njeri me mend nuk do ta lidhte zemrën e tij me gjëra kalimtare. Sido që të përfundojë bota jote e veçantë, atëherë do të ishte më mirë që t'i braktisje kënaqësitë e saj. Në qoftë se ajo do të përfundonte në lumturi, njeriu do ta arrinte lumturinë duke braktisur kënaqësitë e saja; në qoftë se ajo do të përfundonte në vuajtje e mjerim, si do të mund të gjente kënaqësi prej trekëmbëshit ai që pret të ekzekutohet me varje? Madje, edhe ai që, për shkak të mosbesimit, e supozon vetveten të shkaktojë mosekzistencë absolute – ruajna Zot prej një supozimi të tillë– do të ishte më mirë për të t'i braktiste kënaqësitë e kësaj bote. Sepse zhdukja e herë pas hershme e këtyre kënaqësive e bën një jobesimtar që të ndjejë vazdimisht dhimbjet e mosekzistencës absolute që ai e supozon se do të vijojë vdekjen, dhe ato dhimbje janë më akute, më të rënda se kënaqësitë që ai do t'i gjente në gëzimet e jetës.

Mësoje, o shok! Shëmbëllimi yt kur goditesh me fatkeqësi të lëshuara prej Kaderit Hyjnor është ai i deleve tek të cilat bariu hedh gurë për t'i bërë ato të kthehen prapa kur ato futen në kullotën publike. Delet e goditura prej gurëve të bariut kthehen prapa sikur ato të thonin me gjuhën e gjendjes: “Ne jemi nën urdhërin e bariut. Ai na njeh ne më mirë se sa ne veten tonë, prandaj ne duhet të kthehemi”.

O nefsi im! Mos ji më i çudhëzuar se delet! Kur të goditesh me fatkeqësi thuaj:

إِنَّا لِلَّهِ وَإِنَّا إِلَيْهِ رَاجِعُونَ

“Vërtet të Allahut jemi dhe padysim tek Ai do të kthehemi”²⁴.

Mësoje, o shok! Prej dëshmimeve të panumërta se zemra nuk është krijuar për t'u preokupuar kryesisht me çështjet e kësaj bote, kushtoji vëmendje kësaj që vijon:

Kur zemra lidhet me diçka, ajo lidhet me të shumë fort. Ajo vendoset tek ajo me shumë zell dhe duke kërkuar në të qëndrueshmëri e përjetësi, humbet në të plotësisht. Kur ajo shtrin, zgjat dorën e saj për të kapur diçka prej saj, ajo e zgjat atë për të marrë një pjesë aq të madhe sa një shkëmb i madh, por pjesa që ajo mund të ngërthejë prej botës nuk është më e madhe se sa një fije floku ose mbetet dorëbosh.

Zemra është një pasqyrë për të reflektuar të Kërkuarin e Vetëm përjetësisht. Ajo nuk e pranon një idhull të skalitur prej guri. Ai gurë e thyen atë. Një dashurues metaforik vuan më shumë nga dora e të dashurit të tij. Kjo ndodh për shkak se i dashuri në mënyrë të pavetëdijshme refuzon atë që në fakt nuk i përket atij apo asaj, meqë dashuruesi nuk është i denjë të qëndrojë në zemrën e të dashurit.

Mësoje, o shok! Kurani u shpall dhe me të zbriti një tryezë qiellore në të cilën ndodhen të gjitha llojet për të cilat kanë nevojë nivelet e llojit njerëzor të ndryshëm në orekset e tyre intelektuale. Ushqimet gjenden në këtë tryezë Hyjnore me një lloj rendi ose rregulli. Së pari vjen ushqimi për t'u ofruar njerëzve të thjeshtë të cilët formojnë shumicën e njerëzimit. Për shembull, pjesa e njerëzve të zakonshëm në

²⁴Kur'an, 2:156

أَزَّ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ كَانَتْ أَرْثًا فَفَقَّتْنَا هُمَا

“...se qiejt dhe toka ishin të bashkuar së bashku si një njësi e vetme krijimi, pastaj Ne i ndamë ato!”²⁵ është:

Nuk kishte lidhje ndërmjet qiejve dhe tokës. Qiejt ishin të pastërta dhe pa re, të paaftha për të dërguar shi, ndërsa toka ishte e thatë dhe djerrinë. Pastaj, me vullnetin dhe lejen e Allahut të Gjithëfuqishëm, një lidhje, një kontakt u vendos midis tyre dhe si rrjedhim, qiejt lindën shi dhe toka filloi të lindë produktet, frutet e saj. Pjesa e vërsetit duke ndjekur pikërisht fjalitë lart,

وَجَعَلْنَا مِنَ الْمَاءِ كُلَّ شَيْءٍ حَيٍّ

“...Dhe Ne kemi bërë çdo gjë të gjallë prej ujit...”

aludon për atë kuptim. Konceptimi i atyre me nivel më të lartë të të kuptuarit që do të deduktohej prej shprehjeve kuranore të përmendura lart është: Dielli dhe planetet u ndanë prej brumit të lëndës së krijuar prej dritës së prijësit të të gjithë krijimit a.s.m. Kjo tregohet prej hadithit, **أَوَّلُ مَا خَلَقَ اللَّهُ نُورِي** “Ajo që Allahu krijoi së pari ishte drita ime”²⁶. Një shembull tjetër :

أَفَعَيْنَا يَا خَلْقَ الْأَوَّلِ بَلْ هُمْ فِي لَبْسٍ مِنْ خَلْقٍ جَدِيدٍ

“A qemë atëherë të lodhur me krijimin e parë? Jo, por ata janë në dyshim të thellë për një krijim të ri (për Ringjalljen)”²⁷.

Njerëzit e thjeshtë kuptojnë prej këtij vërseti se ata të cilët nuk mund ta pranojnë ringjalljen e pohojnë krijimin e tyre të parë, të cilët ata duhet ta pranojnë si shumë më të çuditshëm. Ata e gijkojnë ringjalljen si të pagjasë, ndonëse ajo do të jetë më e lehtë. Përtej ose mbi këtë nivel të të kuptuari, ndodhet një provë e ndritshme për një lehtësi të plotë të ringjalljes.

²⁵Kur’an, 21:30

²⁶Transmetojnë Ahmedin dhe të tjerët. Shiko ‘Kashf al Khaafa’ 1-205.

²⁷Kur’an, 50:15

O mohues të ringjalljes! Ju ringjalleni, vini përsëri shumë herë në jetën tuaj, madje në çdo vit të jetës suaj, madje në çdo ditë. Ashtu si ndryshimi i rrobave në mëngjes e mbrëmje, ju i veshni trupat tuaj dhe pastaj i hiqni ato çdo ditë²⁸.

Mësoje, o shok! Sa e marrë është egoja njerëzore, ose nefsi! Ajo shikon në vetvete skalitjet, gjurmët dhe shenjat prej Një Zoti me zgjedhje Absolute dhe të Gjithurtë duke dhënë mbështetje, zhvillim e administrim, dhe dallon se kjo është e vërtetë tek të gjitha qëniet individuale dhe tek speciet dhe llojet si një rregull universal dhe gjithëpërfshirës. Si rrjedhojë, ajo duhet të bindet për këtë si një realitet i pamohueshëm i vërtetuar nga tërësia e krijimit. Megjithatë, egoja idiote fatkeqësisht e mashtron vetveten duke e supozuar atë manifestim të përgjithshëm të Emrave të bukur Hyjnorë, të cilët manifestohen edhe tek ajo, gjithandej universit si një shenjë e neglizhencës Hyjnore ndaj saj dhe si një perde poshtë të cilës ajo mund të fshihet nga shikimi dhe kontrolli i Krijuesit. Përbotshmëria dhe intensiteti i këtyre manifestimeve e çon egon e mjerë të supozojë se nuk gjendet asnjë që e vështron. Madje edhe shejtani do të turpërohej prej një sofistike të tillë si kjo.

Mësoje, o nefsi i dëshpëruar dhe i shqetësuar! Ashtu si lindja e diellit në mëngjes dhe si perëndimi i tij në mbrëmje, çfarëdo që të bie ty gjatë jetesës tënde, në çfarëdo rrethanash që do të jesh, ka qenë paracaktuar nga Pena e Kaderit Hyjnor dhe është skalitur në ballin tënd. Në qoftë se dëshiron të godasësh ‘kudhrën’ e Kaderit me kokën tënde të dobët, ti do të shikoje se vetëm shqetësimi dhe copëtimi do të shtohet. Ji i bindur se ai që nuk është në gjendje të futet në rajonet, thellësitat e qiejve dhe tokës, duhet të pranojë me kënaqësi Hyjninë e të Vetmit Unik, i Cili ka krijuar çdo gjë dhe ka dekretuar paracaktimin e saj.

وَأَخْلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَقَدَرَهُ تَقْدِيرًا

“...i Cili krijoi çdo gjë duke e matur saktësisht sipas përmasave të përpikta të duhura.”²⁹

²⁸Detajet e kësaj prove ndodhen tek komenti Isharatul Ixhaz tek komentimi i vërsetit: “Si edhe ata që besojnë me bindje në Botën e Përtejme”. Autori.

²⁹Kur’an, 25:2

Mësoje, o shok! Në qoftë se autori i një gjëje do të ishte brenda saj, ai do të ishte i të njëjtës natyre si ajo gjë, dhe do të duhej të kishte aq shumë autorë aq sa gjërat e bëra, ndryshe jo. Për shembull, shikojë këtë libër! Ai është shkruar me një penë të vetme por i shtypur nga përdorimi i shumë shkronjave të ndryshme aq sa shkronjat e alfabetit, ose një njeri i vetëm e shtyp atë nëpërmjet shtypjes së tasteve në makinën e shkrimit. Skicimet ose qëndisjet në një vepër arti nuk janë bërë nga vetë vepra, as frutat e një peme nuk janë të bëra nga vetë pema, as shkronjat e një pjese shkrimi nuk janë prodhuar nga vetë ajo pjesë. Përndryshe, rregulli do të prishej dhe çdo gjë do të shkonte në kaos. Por, ne shohim se ndodhet një rregull i përkryer dhe stabilitet në krijim. Kjo është kështu për shkak se çdo gjë është skalitur nga Pena e Fuqisë Hyjnore në skicat e Kaderit.

Mësoje, o shok! Sa e çuditshme është që mendja, e cila përfshin universin dhe shkon aq larg matanë tij prej sferës së të krijuarës, ndonjëherë ajo mbytet në një pikë. Ajo zhuket në një atom, humbet në një fije floku, dhe e kufizon ekzistencën në të cilën humbet, duke dashur të fusë gjithçka që ajo përfshin në pikën që e ka gëlltitur.³⁰

Mësoje, o shok! Në qoftë se e drejta e pronësisë dhe e autoritetit të këtij mbisundimi material të përket ty, frikësimet dhe shqetësimet e kujdesjes dhe mbajtjes së tij do ta bënin tepër hidhëruese për ty që të përfitosh prej atij mbisundimi. Ndërsa Mirëbërësi Gjithëbujar ka marrë përsipër të të furnizojë për çfarëdo gjëje që ti ke nevojë. Ajo çfarë bie tek ti është vetëm se të hash prej tryezës së favoreve dhe mirësive të Tij dhe ta falënderosh Atë. Shprehja e falënderimeve ndaj Tij është një shkak për shtimin e mirësive të Tij ndaj teje, sepse kjo do të thotë ta shohësh aktin e favorizimit ose dhënies së mirësisë në vetë mirësinë dhe shikimi i mirëbërësisë e largon dhimbjen e ikjes së mirësisë. Sepse zhdukja e një mirësie nuk është zhdukja e saj e përjetshme saqë të japë brengë. Por, ashtu si frutat e një peme që u konsumuan këtë vit e cila ndiqet nga fruta të reja në vitin e ardhshëm, që do të thotë largim me një qëllim që t'i bëjë vend ardhjes së një tjetre, dhe kështu ajo të jep gëzimin e kënaqësive të ripërtërita.

³⁰Po, filozofët me mendjet më të mëdha të tokës mbyten në një pikë dhimbjeje, asgjësohen në një grimcë prej dashurisë, humbasin në një fije gëzimi, e kufizojnë ekzistencën tek ai në çastin e asgjësimimit me interesat e tyre, dhe përpiqen të tërheqin me vete të gjitha njohjet e ekzistencës tek thellësia e pikës e cila i ka gëlltitur.

وَآخِرُ دَعْوَاهُمْ أَنِ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

“Duaja e fudit e tyre do të jetë: Gjithë lavdërimet e falënderimet janë për Zotin e të gjitha botëve”³¹ tregon se ‘Hamdi’, ‘Lavdërimi’ është në vetvete pikërisht kënaqësia. Ajo është e vërtetë. Lavdërimi është të shohësh pemën e mirëbërësisë në frutin e mirësisë. Kjo largon dhimbjet që burojnë nga mendimi i zhdukjes së tyre dhe bëhet vetë kënaqësia.

Mësoje, o shok! Njohuritë e dhëna nga shkencat dhe nga filozofia materialiste rreth botës së jashtme nuk mund të jenë pa dyshime dhe gabime. Ndërsa informacioni i bazuar mbi ndërgjegjjen e shëndoshë është kryesisht i pastër dhe larg dhënies së dyshimeve dhe shqetësimeve. Prandaj, shiko prej botës tënde të brendshme, prej ndërgjegjjes tënde drejt botës së jashtme. Mos vepro ndryshe, dhe kështu shmang gabimin.

Mësoje, o shok! Meqenëse ky civilizim i korruptuar e ka bërë botën kaq të vogël sa një qytet, popujt, njerëzit, mësojnë e dëgjojnë prej njëri-tjetrit nëpërmjet medias dhe e ndihmojnë njëri-tjetrin në aktet e mëkatshme e në atë që nuk kanë dobi dhe nuk kanë asnjë përfitim për ta. Kjo i çon ata në gabim dhe trashet për ta perdja e pakujdesisë mbi fenë dhe mbi jetën fetare. Kjo perde mund të griset veçse nëpërmjet një përpjekje e lufte të madhe. Ky civilizim gjithashtu ka bërë në shpirtin e njeriut hapje të panumërta nga dynjaja të cilat nuk mund t’i mbyll askush përveç atij të cilit Allahu i ka dhënë mëshirë të veçantë.

Mësoje, o shok! Një grimcë e vogël e tejdukshme përfshin imazhin e diellit ndonëse ajo nuk mund të mbajë dy grimca prej masës dhe natyrës së vetvetes. Pikat e shiut dhe flluskat mbi faqen e një oqeani shndrisin me imazhet e diellit të mbajtur prej tyre.

Gjithashtu, të gjitha grimcat përbërëse dhe pjesët përbërëse të universit kanë kapacitetin e marrjes së manifestimeve të Fuqisë Hyjnore të ndritshme, të parapërrjetshme, absolute, gjithëpërfshirëse, e shoqëruar nga njohja dhe dëshira Hyjnore të parapërrjetshme dhe të pafundme. Do të ishte e pamundur për një grimcë të një qelize në syrin tënd të ishte origjina e fuqisë, vetëdijes dhe e dëshirës që kërkon

³¹Kur’an, 10:10

përmbushjen e dhjetë funksioneve të saj në të gjitha venat e tua, në arteriet dhe në sistemin nervor dhe në fuqitë e shikimit, të dëgjimit, të menduarit dhe të përshkruarit e tij.

Ky art i përkryer e i mahnitshëm, kjo skalitje e zbukuruar dhe e mirërregulluar, dhe kjo urtësi e thellë dhe e hollë mund të shpjegohen në dy mënyra:

Ose secila prej grimcave përbërëse dhe pjesëve përbërëse të universit të ishte origjina etributeve gjithëpërfshirëse absolute e të plota, të tilla si fuqia, dëshira, njohja, vetëdija etj, ose secila prej tyre të ishte një objekt duke marrë dhe duke reflektuar rrezatimet e “Diellit” të Parapërdjetshëm, të Cilit i përkasin të gjitha këto Attribute.

Në alternativën e parë, ndodhen aq shumë pamundësi, aq sa numri i grimcave dhe i pjesëve përbërëse të universit. Pranimi i kësaj alternative do të thotë se një bletë na qenka aq e fuqishme sa të mbante malet Ararat dhe Subhan³² në fletët e saj dhe se lumenjtë si Nili dhe Eufirati të mund të buronin e vërshonin prej syve të një mushkonje. Ndërsa, duke qenë e pamundur që të mbajë çfarëdo gjëje prej fuqisë së saj, çdo grimcë dëshmon se nuk ka krijues, as mbështetës, as zot, as zhvillues, as administrator, as pronar as vetekzistues dhe as perëndi përveç Allahut. Dhe të gjitha grimcat dhe pjesët përbërëse të universit shpallin në gjuhë të ndryshme dhe dëshmojnë në mënyra të ndryshme dhe thonë:

عِبَارَاتُنَا شَتَّى وَحُسْنُكَ وَاحِدٌ * وَكُلُّ إِلَى ذَاكَ الْجَمَالِ يُشِيرُ

Shprehjet tona janë të ndryshme por bukuria Jote është e vetme, kështu, gjithçka që ekziston tregon Atë bukuri.

Çdo shkronjë e librit të universit e tregon ekzistencën e vet vetëm në një mënyrë dhe me masën e qënies një shkronjë, ndërkohë që ajo e tregon Shkruesin dhe Artistin e saj në mënyra të ndryshme. Ajo tregon një këngë të gjatë lavdërimi me gjuhën e Emrave të manifestuar mbi të.

تَأْمَلْ سَطُورَ الْكَائِنَاتِ فَاتَّهَا * مِنْ الْمَلَأِ الْأَعْلَى إِلَيْكَ رَسَائِلُ

³²Ararat dhe Subhan janë dy male në Turqinë lindore. (Përkthyesi).

Reflekton mbi rreshtat e librit të universit,

Sepse ato janë mesazhe për ty prej botës më të lartë.

Mësoje, o shok! “Pasqyrat” në të cilat manifestimet Hyjnore shfaqen janë të një shumëllojshmërie të ndryshme; prej tyre janë copat e qelqit, uji, ajri, bota e simboleve ose e formave jomateriale, shpirti, mendja, imagjinata, koha dhe shumë gjëra të tjera, të cilat ne nuk i njohim. Reflektimet e gjërave të ngurta e materiale në pasqyra janë të vdekura dhe gjykohen si të ndara ose të palidhura prej vetes së tyre. Ato nuk i kanë veçoritë esenciale të origjinave të tyre dhe prandaj nuk janë të njëjta me to. Kjo tregohet nga fakti se kur merren fotot e tyre, ato shihen vetëm me format e tyre të jashtme fizike. Por, reflektimet e gjërave të ndritshme nuk janë të ndara prej origjinaleve të tyre. Ato janë të lidhura me to dhe mbajnë veçoritë e tyre dhe atributet. Megjithëse jo krejtësisht të njëjta me origjinalet e tyre, ato nuk janë gjëra të tjera veçse ato.

Në qoftë se Krijuesi xh.sh, madhështia e Tij qoftë e lartësuar, do ta kishte bërë nxehtësinë e diellit shpirtin e tij, dritën e tij ta kishte bërë vetëdijen e tij dhe ngjyrat në dritën e tij t’i kishte bërë shqisat e tij, atëherë dielli do të të kishte folur ty nëpërmjet ‘zembrës’ së pasqyrës në dorën tënde. Do të ishte sikur ai të të fliste ty nëpërmjet telefonit tënd ose ‘pasqyrës’ së zembrës tënde. Sepse, sipas kapacitetit të saj, imazhi i diellit në pasqyrë në dorën tënde do të kishte pasur nxehtësinë e jetës dhe të dritës së vetëdijes dhe ngjyrat e shqisave. Për shkak të këtij fakti, profeti a.s.m. i ndrituri në identitet, bëhet i njoftuar për të gjitha salevatet që bëhen për të në të njëjtin moment. Ky është çelësi për shumë të vërteta misterioze.

Mësoje, o shok se *Subhanallah* dhe *Velhamdulil-lah* e përshkruajnë Allahun e Gjithëfuqishëm me atributet e madhështisë dhe të bukurisë.

‘*Subhanallah*’ nënkupton natyrën e mundshme të shërbëtorit dhe largësinë e tij prej Allahut, Ekzistuesit të Vetëm të domosdoshëm, të Lartësuarit dhe Madhështorit.

Dhe ‘*El-Hamdu lil-lah*’, nënkupton afërsinë e Allahut me mëshirë e mirësi ndaj shërbëtorëve dhe krijesave të Tij.

Shqyrtoje këtë: Dielli është afër teje; ai e bën nxehtësinë dhe dritën e tij të të arrijë ty dhe vepron në ty me lejen e Krijuesit të tij. Kështu, ai funksionon si një pasqyrë për manifestimin e Emrit Hyjnor “*En-Nur*”, “*Drita*” dhe si një marrëse –enë– për mirësitë e Tij të cilat janë nxehtësia dhe drita megjithëse ti je shumë larg prej tij dhe nuk mund ta arrijë dora jote atë. Ndërsa ai ka ndikim mbi ty, ti nuk mund të ushtrosh asnjë ndikim mbi të. E ngjashme me këtë –për Allahun është krahasimi më i lartë– Allahu xhel–le xhelaluhu është afër nesh, kështu ne e lavdërojmë Atë, dhe ne jemi larg Tij dhe kështu ne e shenjtërojmë Atë – bëjmë tesbihate për Të. Lavdëroje Atë sepse ti e sheh se Ai është i Afërt me mëshirën e Tij. Dhe shenjtëroje Atë sepse ti e sheh që ti je larg prej Tij. Mos e ngatërro afërsinë e Tij ndaj teje me largësinë tënde prej Tij që të mos ngatërrohet tek ti e vërteta dhe rruga e drejtë. Me kusht që ti të mos bësh asnjë ngatërresë, ti mund ta shikosh afërsinë e Tij prej këndvështrimit të largësisë tënde dhe largësinë tënde prej këndvështrimit të afërsisë së Tij, dhe ti mund t’i kombinosh këto dy shikime dhe thuaj: *Subhanallah ve Bihamdihi!*

Mësoje, o shok që lufton për dynjanë! Ti duhet ta braktisësh dynjanë për katër arsye e mëposhtme:

E Para: Meqë ajo ikën shpejt dhe zhduket, dhimbjet që burojnë nga zhdukja dhe ndarja e largojnë kënaqësinë e arritjes ose të bashkimit me diçka që pëson zhdukje.

E Dyta: Meqë ajo që mbetet nga kënaqësitë e saj janë vetëm dhimbje e dëshpërime.

E Treta: Meqë ajo që të pret ty dhe ajo për tek e cila ti po udhëton drejtëpërdrejtë dhe me nxitim dhe pa u shmangur prej varrit, i cili është dera për tek bota tjetër, nuk pranon prej teje stolitë e botës si një dhuratë, sepse ato do të transformohen në gabime e mëkate atje.

E Katërta: Me qëllim që të kuptojmë ndryshimin ndërmjet kësaj bote dhe tjetrës, reflekto mbi ndryshimin midis qëndrimit midis armiqve, parazitëve dhe insekteve të dëmshme për një orë dhe midis qëndrimit në një vend për vite të shumta ku janë grumbulluar të gjithë miqtë e tu më të dashur dhe më të mëdhenjtë. Pronari Absolut i të gjithë dominimit gjithashtu të bën thirrje për ta braktisur atë orë kënaqësie me qëllim që të kesh ngushëllim e kënaqësi të plotë në

shoqërinë e të dashurve të tu në ato vite. Prandaj, përgjigjjiu thirrjes së Zotit përpara se të shkosh tek Ai i lidhur me pranga.

Lavdia i qoftë Allahut! Sa e madhe është mëshira dhe favori i Tij ndaj njeriut, që Ai xh.sh blen prej njeriut me një çmim shumë të lartë pasurinë të cilën ia pati lënë në besim atij dhe e ruan atë përjetësisht për të. Në qoftë se njeriu pretendon pronësi mbi të dhe nuk ia shet Zotit, ai do të zbulohet para fatkeqësive të mëdhaja, meqë ai merr përsipër ta ruajë e ta mbajë me një fuqi shumë të pakët e të pamjaftueshme. Në qoftë se përpiket ta mbajë atë në shpinën e tij, ajo do të rëndonte shpinën e tij për ta mbajtur. Ajo do të zhdukej prej tij shpejt dhe do të ikte për kot, duke i lënë atij vetëm mëkatet që i ka shkaktuar.

Mësoje, o shok! Është sikur dy rreshtat vijues u thanë për mua:

وَعَيْنِي قَدْ نَامَتْ بِلَيْلٍ شَيْبِي * وَلَمْ تَنْتَبِهْ إِلَّا بِصُبحٍ مَشِيْبٍ

*“Sytë e mi ishin në gjumë gjatë natës së rinisë sime;
Ato u zgjuan veçse kur ishte mëngjesi i pleqërisë!”*

Unë vështrova se çfarë unë shikova si zgjimin më të madh në rininë time, ishte në fakt më i thelli i përgjumësisë. Kështu, ajo që modernistët e përshkruajnë si ndriçim dhe zgjuarsi i ngjason atij zgjimit tim në rininë time. Ata janë si ai i cili pa në ëndrrën e tij në të cilën ai po zgjohet prej një gjumi dhe ua tregon ëndrrën e tij të tjerëve. Por ai ka kaluar nga një gjumë më pak i rëndë për tek një gjumë më i rëndë. Si do të mundej ai që është në gjumë, i cili i ngjason të vdekurit ta zgjonte të zgjuarin e përgjumur? Si do të mundej një i përgjumur ta bënte vetveten të dëgjohet nga prapa perdeve të dendura të gjumit?

O ju të zgjuar të përgjumur, që e quani veten si të zgjuar! Mos iu afroni të civilizuarve duke bërë lëshime ndaj tyre, dhe duke u përpjekur t’u përngjasoni atyre në fe. Mos mendoni se duke bërë kështu ju mund të ndërtoni një urë apo të mbushni luginën midis atyre dhe nesh. Jo, distanca ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve është e pakufishme. Luginë mes nesh është shumë e thellë për ta mbushur. Do të ishte e mundur që ju ose do t’u bashkoheni atyre, ose do të shmangeshit shumë prej rrugës së drejtë.

Mësoje, o shok! Sigurisht, ndodhet në mëkat fara e mosbesimit në esencën e mëkatit, sidomos në qoftë se mëkatet kryhen në mënyrë të vazhdueshme, ato shumohen. Sepse në qoftë se një mëkat kryhet shpesh, kjo e bën mëkatarin indiferent, moskokëçarës ndaj mëkatit dhe lëshohet pas tij, dhe bëhet një huq, një sëmundje që ilaçi i vetëm për të qëndron në braktisjen e atij mëkati. Atëherë mëkatarin do të dëshironte të mos kishte ndëshkim për atë mëkat dhe në mënyrë të pavetëdijshme përpiqet të gjejë një justifikim për të besuar në mosekzistencën e dënimit të përjetshëm. Kjo gjendje e mëkatarit vazhdon derisa ai të mohojë ndëshkimin e përhershëm dhe banesën e dënimit. Gjithashtu, turpi që buron nga kryerja e një mëkati që nuk ndiqet nga pendesa dhe brejtja e ndërjegjjes dhe nga kërkimi i faljes prej Allahut do ta çonte mëkatarin në mohimin e qënies së mëkatit; dhe do ta çonte atë në mohimin e ekzistencës së atyre –si melekët ruajtës– të cilët e shohin atë dhe janë në dijeni të mëkatit të tij. Për shkak të intensitetit të turpit që ndjen, mëkatarin dëshiron të mos ketë dhënie llogarie në botën tjetër. Kur ai rastis edhe ndonjë argument të rremë për mosekzistencën e mosdhënies llogari, ai e merr atë si një provë të fortë dhe mohon dhënien e llogarisë në Ahiret. Si pasojë kjo përfundon në errësimin, nxirrjen e zemrës. Na ruajtë Allahu nga një pasojë e tillë! Amin.

Mësoje, o shok! Shkreptimat e mrekullisë së Kuranit numërohen rreth dyzet lloje. Këtu sa vijon janë vetëm disa prej aspekteve të tij të shumta të elokuencës.

Ai ka një rrjedhshmëri të pastër, të mirëfilltë dhe është absolutisht i lirë e i pastër prej të gjitha mangësive në stil e kuptim. Ndodhet një solidaritet i fortë dhe harmoni midis vërseteve dhe paragrafëve të tij, të cilat mbështesin njëra-tjetrën. Megjithëse i shpallur pjesë-pjesë për njëzet e ca vite në raste të ndryshme, siç dëshmojnë shkencat e stilit retorik dhe semantik, ndodhet një kohezion i qëndrueshëm dhe harmoni midis vërseteve dhe qëllimeve të tij, saqë është sikur ai të ishte shpallur përnjëherë dhe në një rast të vetëm. Megjithëse shumë pjesë të tij erdhën si përgjigje për pyetje të ndryshme, ai nuk përmban asnjë kontradiktë në kuptim dhe ndodhet një pajtueshmëri e harmoni e tillë midis pjesëve të tij, saqë është sikur ai të kishte ardhur për t’iu përgjigjur vetëm një pyetje.

Ai gjithashtu erdhi për të shpjeguar e gjykuar ndodhi të ndryshme në karakter, por ai ka një rregull të tillë saqë është sikur ai të kishte

ardhur për të gjykuar vetëm një ndodhi të vetme. Është Allahu Ai që flet në të në stile të përshtatura për të gjitha nivelet e të kuptuarit. Ai i zbriti –iu shpall– para së gjithash, profetit a.s.m në gjendjet e tij të ndryshme, por ai ka një rrjedhshmëri të tillë stili dhe bashkëpërgjigje midis pjesëve të tij saqë është sikur ai t’i ishte shpallur atij ndërsa ai të ishte vetëm në të njëjtën gjendje. Megjithëse ai u adresohet të gjithë njerëzve në të gjitha kohët, ai flet aq rrjedhshëm e ëmbël, me rregull e me qartësi, saqë është sikur ai t’i adresojë vetëm një nivel të të kuptuarit. Ai flet në një mënyrë të tillë sikur çdo klasë e të adresuarve mendon se ai u adresohet drejtëpërdrejtë e kryesisht atyre. Ai u shpall për të udhëzuar gjithkënd dhe për t’iu mundësuar atyre të arrijnë shkallët e tyre të ndryshme të udhëzimit, por ai është aq i mirëbalancuar, i rregullt e i drejtëpërdrejtë saqë sikur ai të ndiqte një qëllim të vetëm. Qëllimet dhe synimet që ai ndjek mund të përmbliken në këto katër, ose ato qëllime vërtiten mbi katër boshte: ato janë Njësia Hyjnore, profetësia, Ringjallja, dhe drejtësia (adhurimi ose devocioni ndaj Allahut në besim dhe në jetën praktike). Meqënëse ai para së gjithash përqëndrohet mbi Unitetin e Zotit, ai është plotësisht koherent, harmonik, i njëtrajtshëm dhe i rregullt.

Kushdo që ka sy do të shohë se Kurani ka një sy, i cili e sheh të gjithë krijimin, si një faqe e qartë. Ai i bën përsëritjet për të vërtetuar e vendosur qëllimet e tij në mendjet dhe zemrat, dhe në mënyrë të përsëritur rrëfen tregimet e disa profetëve për të përforcuar paralajmërimet dhe mësimet që ai synon t’i japë. Megjithatë, përsëritjet e tij nuk të lodhin dhe nuk të mërzhisin aspak; dhe as nuk e prishin shijen për të. Ndërsa ai bën përsëritje, i ngulit qëllimet e tij thellë në mendje e zemra. Ashtu si myshku që aromatizon më shumë –jep më shumë erë, përhapet më shumë– nëse e përdor më shpesh, po ashtu Kurani sa më shumë që ta përsërisë një temë, aq më shumë parfumon dhe aq më shumë përhapen prej tij “Frymat e të Gjithëmëshirshmit”. Sa më shumë ta lexosh atë, në qoftë se do të ishte një njeri me shije të mirë dhe me zemër të shëndoshë, aq më shumë kënaqësi do të marrësh prej tij. Kjo është për shkak se ai e ushqen zemrën dhe i jep shërim e forcë shpirtit. Ushqimi esencial –i domosdoshëm– për trupin si ajri, uji dhe buka nuk jep mërzhitje kur merret në mënyrë të përsëritur, përkundrazi trupi i do dhe i kërkon ato gjithë kohën.

Njeriut i nevojitet ajri në çdo çast, uji disa herë në ditë, dhe ushqimi të paktën një herë në ditë. Atij gjithashtu i nevojiten këto substanca të

domosdoshme ushqimi të gjithë kohën, ato nuk e mërzisnin atë, por duke i marrë ato në mënyrë të përsëritur i japin atij kënaqësi gjithnjë të ripërtërirë. E ngjashme me këtë, lidhur me jetën e tij intelektuale dhe shpirtërore, njeriut i nevojitet çfarëdo që është në Kuran. Atij i nevojiten disa prej elementeve të tij si “*Huve*”, *Ai, Allahu* në çdo çast, dhe shpirti e rifreskon veten nëpërmjet tyre; dhe disa si “*Bismil-lah*” i nevojiten në çdo orë, dhe disa të tjera në çdo ditë, secila sipas shkallës së nevojës për të. Kështu, Kurani i bën përsëritjet në përputhje me shkallën e nevojës që ndjen jeta e zemrës.

Për shembull, meqenëse *Huve –Ai, Allahu–* ose *Bismil-lah* janë si një ajër i freskët për të rifreskuar trupin dhe për të oksigjenuar gjakun, ato duhet të përsëriten të gjithë kohën. Përsëri, Kurani në mënyrë të përsëritur e përmend një ngjarje të veçantë çdo herë nga një këndvështrim i ndryshëm dhe kështu tregon disa parime universale. Për shembull, frazat dhe fjalitë e përdorura lidhur me tregimin e profetit Musa a.s janë më të dobishme për njerëzimin se sa Shkopi i Musait dhe dobitë e tyre nuk përkufizohen për një kohë a popull të caktuar.

Përmbledhja: Kurani i gjithurtë është një libër recitimi e përmendjeje të Emrave Hyjnorë, është libër reflektimi, libër legjislacioni, libër njohjeje, libër i të vërtetave dhe libër ligji. Ai është një shërim për atë çfarë është në kraharoret e njerëzve, dhe është udhëzim i pastër dhe mëshirë për besimtarët.

Mësoje, o shok! Njeriu është prej një natyre të tillë të çuditshme saqë në kohë të pavëmendshmërisë ai ngatërron funksionet e shqisave dhe organeve të tij fizike dhe aftësitë e tij mendore e shpirtërore. Ai është si një i çmendur, i cili për shkak të afërsisë midis syve të tij dhe duarve e zgjat dorën për të kapur çfarëdo që ai e sheh me sytë e tij. Njeriu gafil –i pavëmendshëm– për ndryshimin midis asaj që është Hyjnore dhe asaj që është njerëzore, i cili është i paaftë të përmbushë edhe çështjen më të vogël lidhur me vetveten, përpigjet në kotësinë e tij të ndërhyjë tek Aktet e Allahut dhe tek sundimi i Tij në univers. Ndodhet një ndryshim i vogël midis qënieve njerëzore në formën dhe strukturën fizike. Por përsëri, është e veçantë për natyrën e njeriut, që në kundërshtim me kafshët, të ketë aq shumë ndryshueshmëri të madhe dhe diferencë ndërmjet tyre në karakter, në natyrë e në shpirt sa ai ndërmjet një atomi dhe diellit të diejve.

Madje në qoftë se ndodhet një ndryshim i madh midis, për shembull, një peshku e një zogu në formën trupore dhe në strukturë, nuk ka ndryshim midis tyre në qënien e tyre kafshë. Ndërsa është sikur të qëndronte në majë të pikës qëndrore të “Konit të ekzistencës” dhe të çdo gjëje, le të jetë ajo një atom apo dielli ose dielli i diejve, është në të njëjtën largësi prej tij. Kjo është kështu për shkak se aftësitë dhe fuqitë e tij –dëshirat e tij, zemërimi e intelekti i tij– nuk janë të kufizuara. Ai zvogëlohet dhe zbret nëpërmjet egoizmit dhe kotësisë tek më e ulëta e ultësirave. Në kontrast, duke braktisur egoizmin dhe kotësinë dhe nëpërmjet adhurimit dhe robërisë ndaj Allahut dhe me mëshirën e Tij, ai mund të lartësohet e ngjitet tek më e larta e lartësisë, tek shkalla e të qënurit “Dielli i diejve” si Profeti Muhammed a.s..m..

Mësoje, o shok! Ajo që është esenciale për gjërat është se i Vetmi i Përjetshëm nuk i lejon ato të shkojnë në mosekzistencë absolute. Madje edhe gjërat që kalben apo zhduken shpejt si fjalët e shprehura dhe konceptet e formuara nga çasti në çast në mendje ruhen në vende të sigurta. Por, ato mund të marrin forma të ndryshme sipas vendeve ku ato ruhen. Është sikur gjërat të ngarkoheshin me ruajtjen e një gjëje, qoftë në formën dhe natyrën e saj ekzakte ose vetëm në një aspekt. Megjithëse shkenca e ka zbuluar këtë realitet, ajo nuk ka qenë akoma në gjendje ta ngërthejë atë plotësisht. Ajo gabon duke ia atribuar proceset kimike të tilla si kombinimi, përbërja dhe shpërbërja e vetë gjërave dhe kështu duke i përshkruar përjetësi materies, lëndës. Por lënda nuk mund të jetë e përjetshme dhe Allahu xh.sh i shkrin, i përzien e i formon gjërat dhe Ai i krijon dhe i bën ato të vdesin. Ai vepron ashtu siç dëshiron dhe urdhëron e gjykon ashtu siç don.

Mësoje, o Said i mjerë! Varri është një derë, brenda tij është mëshirë e lumturi, kurse jashtë tij gjendet vuajtja dhe mjerimi. Pothuajse të gjithë të dashurit e tu, miqtë e tu, banojnë në anën tjetër të kësaj dere. A ende nuk është koha për ty të ndjesh dëshirë për t’iu bashkuar atyre dhe botës së tyre? Ti duhet të pastrohesh prej mëkateve të tua, përndryshe ata do të zemërohen me ty.

Në qoftë se, për shembull, do të të thuhej ty se Imam Rabbani Ahmet El Faruki, iu shenjtëroftë sekreti i tij banon tani në Indi, sigurisht ti do ta lije atdheun tënd dhe do të përballëshe me rreziqet e udhëtimit për ta vizituar atë. Ndërsa ndodhen me mijëra yje të quajtur Ahmed përreth ‘diellit’ të përmendur si Ahmed në Ungjill, si Ahiad në

Teurat dhe Muhammed në Kuran dhe ndodhen me miliona të quajtur Muhammed. Të gjithë ata janë tani brenda derës së varrit, të mbuluar nga mëshira e Allahut. Prandaj, ju duhet që gjithmonë të mbani në mendje parimet vijuese:

Në qoftë se ti je një shërbëtor i mirë i nënshtruar plotësisht ndaj Allahut, atëherë çdo gjë të nënshtrohet ty.

Në qoftë se në të kundërtën, ti nuk do t'i nënshtroheshe Allahut, çdo gjë është armiqësore ndaj teje.

Çdo gjë është e paracaktuar. Kështu, ji i kënaqur me atë çfarë vjen tek ti me qëllim që ti të jesh në gjendje qetësie.

Përndryshe, ti do të zbuloheshe para torturave të njëpasnjëshme.

Jeta dhe trupi yt i përkasin Zotit, por të janë lënë ty në amanet. Megjithatë, Ai dëshiron t'i blejë ato prej teje për t'i ruajtur për ty përjetësisht. Në qoftë se ato lihen me ty, ato do të zhdukeshin për asgjë.

Ti ke nevojë për Të në çdo aspekt dhe nën çdo rrethanë.

Ti je i rrethuar nga të gjitha katër anët dhe po shtyhesh për tek varri i cili po të pret.

Zemra nuk merr kënaqësi të vërtetë nga ajo që nuk vazhdon. Ti je duke u zhdukur, po kështu edhe bota jote dhe bota e të gjithë njerëzve të tjerë.

Universi do të zhvishet prej veshjes së tij të tanishme dhe do të vishet me një mantel tjetër. Është sikur universi të ishte një orë e madhe, sekondat, minutat dhe orët e të cilës ndjekin njëra-tjetrën me qëllim që ai të vinte tek exheli i vet. Prandaj, mos u jep rëndësi veprave e gjurmëve të lëna nga ti në këtë botë kalimtare dhe të cilat nuk do të të sjellin asnjë dobi në Ahiret, në botën tjetër.

Mos e shiko dispozitën e Tij të krijimit me mëshirë e favorizim nga këndvështrimi i vogëlsisë tënde dhe të qënies tënde larg prej Tij dhe prej madhësisë dhe lartësisë së Tij. Domethënë, të shikuarit e krijimit si shumë larg prej Tij dhe si shumë të parëndësishëm për Të për ta trajtuar atë –krijimin– me favor e mëshirë, mos mendo pse Ai do ta ulte Vetveten për të të favorizuar ty dhe për të të mbështetur. Por, një lidhje e mirë e Tij me krijimin kërkon prej teje që të bësh tesbihatet – ta lavdërosh Atë, ashtu siç Ai e meriton.

As mos i shiko Atributet e Tij të madhështisë nga këndvështrimi i afërsisë së Tij me krijimin dhe duke e mbuluar atë -krijimin- me njohjen dhe me mëshirën e Tij dhe nga këndvështrimi i qënies tënde i përfshirë në favorizimin dhe mirëbërësinë e Tij. Sepse, atëherë, dyshimet dhe keqkuptimet (rreth madhështisë dhe lartësisë së Tij) do të të sulmonin.

Lavdi Atij, i Cili është absolutisht i lirë dhe i përjashtuar prej qënies i kapur nga mendjet dhe mendimet, i lavdëruar qoftë Ai, mëshira e të Cilit i rrethon të gjitha gjërat.

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ يُحْيِي وَيُمِيتُ وَهُوَ حَيٌّ لَا يَمُوتُ بِيَدِهِ الْخَيْرُ وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Ai është Një. Ai nuk ka shokë. I Tij është sundimi i të gjitha gjërave dhe Atij i takon i gjithë lavdërimi; Ai jep jetë dhe shkakton vdekjen. Në Dorën e Tij është e gjithë e mira, dhe Ai është i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat.

Mësoje, o shok! Një njeri që ka një ‘zemër të gjallë’, kur drejton vështrimin drejt qënieve, ai sheh çështje e gjëra madhështore e gjithëpërfshirëse që kalojnë matanë perceptimit të tij dhe për të cilat ai çuditet. Për të gjetur një ilaç për dhimbjet e tij të çudisë e habitës, ashtu si një i etur që nxiton për tek uji i ëmbël, ai nuk mund t’i shmanget veçse të shprehë me mallëngjim **سُبْحَانَ اللَّهِ** ‘Subhanallah’!

Ai sheh hollësitë e favorizimit Hyjnor dhe përjeton kënaqësitë që e detyrojnë atë të shprehë gëzimin e tij. Ai dëshiron shtimin e kënaqësive duke dalluar aktin e favorizimit në mirësitë që ai i konsumon dhe Dhënësin e mirësive në aktin e favorizimit. Pastaj, si dikush që ka gjetur një thesar të fshehtë, ai lehtësohet duke shprehur **الْحَمْدُ لِلَّهِ** ‘El Hamdu lil-lah’.

Kur ai shikon krijesa shumë të çuditshme e të jashtëzakonshme për të cilat nuk është në gjendje që t’i përshkruajë, dëshira që ai ndjen për të zbuluar të vërtetën rreth tyre e preokupon mendjen e tij dhe ai gjen qetësi vetëm duke thënë **اللَّهُ أَكْبَرُ** ‘Allahu Ekber’. Domethënë, Krijuesi i tyre është pakrahasimisht i pa masë i Madhërishëm dhe kjo

nuk i jep Atij as vështirësinë më të vogël për t'i krijuar e drejtuar. Ai është si ai që, duke parë hënën duke u rrotulluar rreth vetes, çuditet shumë, ose si dikush, që duke parë një mal që shfaqet nga toka gjatë një tërmeti, frikësohet shumë. Ai shpëton prej 'peshave' të çudisë dhe të frikës duke i vënë ato në 'anijen' e të Gjithëfuqishmit, të Gjithë të Fortit e të Plotëpushtetshmit xhel–le xhelaluhu.

Mësoje, o shok! Me mëkatet e të këqijat e tua ti nuk mund t'i bësh dëm Allahut, por i bën dëm veçse vetes tënde. Për shembull, në realitet, Zoti nuk ka absolutisht asnjë ortakë. Duke përfytyruar për Të ndonjë ortak, ti nuk mund të kesh asnjë ndikim në sovranitetin e sundimin e Tij të plotë e absolut mbi universin. Shoqërimi yt ortakë me Të e dëmton botën tënde dhe i shkakton shtëpisë tënde të shkatërrohet mbi kokën tënde.

Mësoje, o shok! Kushdo që mbështetet në Zotin, Zoti është i mjaftueshëm për të. Prandaj, thuaj: **حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ**
Allahu më mjafton, dhe sa Ruajtës i Mirë është!

Para së gjithash: Ai është absolutisht i Plotë: plotësia absolute është e dashur edhe për veten, edhe shpirtërat sakrifikohen për të.

Së dyti: Meqenëse ajo është e dashur për Vetveten, Ai është i Dashuri i Vërtetë, dhe dashuria kërkon sakrificë.

Së treti: Ai është Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm. Në afërsinë e Tij burojnë dritat e ekzistencës, ndërsa duke qenë larg prej Tij shkaktohet errësira e mosekzistencës ose dhe i jep shpirtit të njeriut dhimbje të pashërueshme për shkak të shuarjes së aspiratave e shpresave të tij.

Së katërti: Ai është Streha e shpirtit njerëzor i mbytur brenda kufijve të ngushtë të ekzistencës materiale, duke vuajtur prej papastërtisë, zburimeve mashtruese të dynjasë dhe shtypet nën peshën e dhimbjeve që burojnë nga dashuria e shpirtit ndaj krijimit.

Së pesti: Ai është i Qëndrueshmi i Përjetshëm, nëpërmjet Tij është qëndrueshmëria dhe pa Të është zhdukja, gjë e cila shkakton vetëm dhimbje e dëshpërim. Pa Të grumbullohen sa numri i krijesave

dhimbjet mbi shpirtin e njeriut, ndërsa kush e gjen Atë dhe mbështetet tek Ai, do të shfaqeshin mbi të dritat prej kudo.

Së gjashti: Ai është Pronari i Vetëm i të gjithë ekzistencës. Ai i mban për ty peshat e jetës dhe ekzistencën trupore që ai ta ka lënë ty në besim, në amanet, meqë ti nuk je në gjendje t'i mbash, dhe duke pandehur e supozuar se i ke në pronësi kjo të bën të biesh në vuajtje e tortura të dhimbshme. Në qoftë se ti dëshiron qëndrueshmërinë e tyre dhe vazhdimësinë e mirëbërësisë së Tij, mos u dëshpëro që Ai po i merr prej teje. Flluskat e ujit që përmbajnë imazhet e diellit nuk pikëllohen që po largohen e zhduken. Për ripërtëritjen e reflektimeve të diellit, ato i sakrifikojnë me gëzim format e tyre të dukshme. Gjithashtu, as frutat nuk pikëllohen nga ndarja e tyre prej pemës, as farërat nuk hidhërohen prej shpërbërjes së frutit në tokë. Ti e di se shpërbërja e tij do të thotë rritja e një peme të re, e cila do të japë fruta të shumtë.

Edhe ti je gjithashtu një frut, një mishërim i mirëbërësisë së Tij.

Së shtati: Ai është i Pasuri Absolut dhe Dhënësi i pasurisë. Në Dorën e Tij janë çelësat për të gjitha gjërat. Në qoftë se ti do të bëheshe një shërbëtor i sinqertë ndaj Tij, dhe pastaj e sodit universin, ti do të shohësh sovranitetin dhe madhësitinë e Pronarit tënd dhe do të gjesh lehtësi e qetësi. Atëherë, ti do ta shihje universin sikur të ishte prona jote që ti e ke në pronësi pa asnjë shqetësim dhe për zhdukjen e të cilës ti nuk do të ndjesh asnjë brengë. Një shërbëtor i sinqertë i mbretit, i cili asgjësohet në dashurinë e Tij, bëhet krenar për çfarëdo që i përket Atij.

Së teti: Ai është Zoti i të gjithë profetëve dhe mesazhierëve, i evlijave dhe i të devotshmive, që të gjithë ata janë të lumtur me mëshirën e Tij. Në qoftë se ti ke një zemër të shëndoshë e të paprishur, njohja jote për lumturinë e tyre do të të jepte në mjerimin tënd lumturi e kënaqësi.

Mësoje, o shok! Në qoftë se do të kishe logjikë të shëndoshë, nuk do të ishte e përshtatshme për ty as të gëzohesh, as të dëshpërohesh, as të zemërohesh dhe as të ankohesh për atë që ti e fiton apo e humbet prej gjërave të kësaj bote. Sepse dynjaja është kalimtare dhe zhduket, po kështu edhe bota jote, dhe sidomos ti. Ti nuk je krijuar për të qëndruar këtu përgjithmonë, as nuk je bërë prej hekuri e as prej druri që ti të mund të qëndroje më gjatë. Ti je prej mishi e gjaku të ripërtërirë

gjithmonë dhe prej gjymtyrësh delikate, të holla dhe ti mund të lëndohesh e cënohesh edhe prej më të vogëlës së gjërave. Njëra pjesë ose njëra përbërje e jotja thyhet, tjetra ngrin, dhe akoma një tjetër shkrihet nëpërmjet zbërthimit të atomeve të saj. Shiko, mëngjesi i pleqërisë e ka thyer kokën tënde dhe e ka mbuluar gjysmën e saj si një qefin i bardhë. Sidomos sëmundjet që të bien me synim që të banojnë tek ty, janë paraprijësit e vdekjes. Ato shkatërrojnë kënaqësitë e jetës. Megjithatë, ndodhet një jetë e përhershme para teje. Rehatia dhe lumturia jote në atë jetë varen nga përpjekjet që ti bën këtu, ndonëse lakmia jote është e një shkalle sikur ti do të qëndroje përgjithmonë në dynja. Zgijohu para se të të zgjojnë agonitë e vdekjes.

Mësoje, o shok! Kur ti kthehesh drejt të Gjithëfuqishmit xh.sh. duke supozuar se Ai është i Njohuri dhe i Dituri, Ai do të bëhej për ty i panjohur dhe i paditur. Sepse supozimi yt për qënien e Tij i njohur dhe i ditur bazohet mbi një njohje imituese dhe të zakonshme rreth Tij. Një njohje e tillë, në të shumtën e rasteve, nuk ka të bëjë aspak me të vërtetën. Kuptimi që ajo i përcjell mendjes tënde është shumë larg shpjegimit të Atributeve Absolute Hyjnore.

Por, në qoftë se ti kthehesh drejt të Gjithëfuqishmit duke e pranuar Atë si Një Ekzistues por i panjohur, atëherë, rrezet e njohjes së vërtetë rreth Tij do të zbulohen për ty dhe Atributet Hyjnore gjithëpërfshirëse dhe absolute të manifestuar në univers do të të shfaqen në dritën e kësaj njohje.

Mësoje, o shok! Të mjafton si një burim i pafundmë krenarie që ti ke një Pronar të Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat. Ai është Një i Plotëpushtetshëm i Tillë saqë në Ditën e Fundit –të Kijametit– qiejt do të jenë të mbështjellë në Dorën e Tij të djathtë dhe toka do të jetë në Dorën e Tij. Ai të zhvillon, të rrit e të mbështet me dhembshuri e me mëshirë më të plotë se ajo e dy prindërve të tu. Kurse, ti je një pikë në det, dhe deti është si një pikë në pjesën e njohur të universit, dhe kjo pjesë është si një grimcë e vockël midis krijesave të mëdhaja të Tij. Ai është Drita e dritave dhe Njohësi i të gjitha sekreteve. Në qoftë se një mbret tokësor njerëzor nuk preokupohet me detajet e çështjeve të mbretërisë, kjo nuk është për shkak se ai është i madh, por për shkak se ai nuk është i aftë mjaftueshëm për të qenë ashtu. Në kontrast, për shkak të madhësisë së Sovranit të Parapërdjetshëm, Ai i skalit shenjat e Hyjnisë së Tij në faqen e qiejve me penën e shpikjes së Tij me bojën

e yjeve si perla. Në të njëjtën kohë, Ai i skalit shenjat e Veta si Perëndi në faqen e bebes së syrit me të njëjtën penë me bojën e atomeve.

Lavdia i takon Atij, që për Hyjninë dhe madhështinë e të Cilit të gjithë ato objekte qiellore, ato planete si perla, janë prova të ndritshme dhe për Qënien e Tij si Perëndi, të gjithë ato yje buzëqeshës e të ndritshëm janë rrezet e dëshmuesve.

Mësoje, o shok! Ashtu si drita që përmban shtatë ngjyrat, Emrat e bukur Hyjnorë përmbajnë e nënkuptojnë njëri-tjetrin. Ato gjithashtu dëshmojnë për njëri-tjetrin dhe japin efekt tek njëri-tjetri. Ato reflektohen në njëri-tjetrin. Ato mund të recitohen sikur të ishin edhe si analogji, edhe si konkluzione të arritura nëpërmjet tyre në të njëjtën kohë, ose edhe si argumente, edhe si përfundime të arritura nëpërmjet tyre. Secili prej Emrave më të mëdhenj i përmban të gjithë Emrat e tjerë në shkallën më të madhe. Është e mundshme për disa që ta arrijnë dritën e Emrit më të madh nëpërmjet disa Emrave të tjerë. Dhe Cili është Emri më i Madh, kjo ndryshon sipas atyre që përpiqen ta zbulojnë e të arrijnë tek Ai Emër. Allahu e di më së miri të vërtetën.

Një lutje

تَضَرَّعُ وَنِيَّانُ

الهِ لِأَزْمَعَلَى أَنْ لَا أَبَالِي وَلَوْ فَاتَتْ مِنِّي حَيَاتُ الدَّارَيْنِ وَعَادَتْنِي الكَائِمَاتُ
بِتَمَامِهَا إِذْ أَنْتَ رَبِّي وَخَالِقِي وَالْهَيَّ إِذْ أَنَا مَخْلُوقُكَ وَمَصْنُوعُكَ لِي جِهَةٌ
تَعَلَّقِي وَانْتِسَابِي مَعَ قَطْعِ نَهَائِي عِصْيَانِي وَغَايَةِ بُعْدِي لِسَائِرِ
رَوَابِطِ الكَرَامَةِ فَاتَضَرَّعُ بِلِسَانِ مَخْلُوقِيَّتِي يَا خَالِقِي ❁ يَا رَبِّي يَا رَازِقِي
يَا مَالِكِي يَا مَصْوُورِي ❁ يَا إِلَهِي أَسْأَلُكَ بِاسْمَائِكَ الْحُسْنَى وَبِاسْمِكَ الْأَعْظَمِ
وَبِغُفْرَانِكَ الْحَكِيمِ وَبِحَبِيبِكَ الْأَكْرَمِ وَبِكَلَامِكَ الْقَدِيمِ وَبِعَبْرَتِكَ
الْأَعْظَمِ وَبِالْفِ الْفِ قُلْ هُوَ اللهُ أَحَدٌ اِرْحَمْنِي يَا اللهُ يَا رَحْمَنُ يَا حَنَّانُ
يَا مَنَّانُ يَا دِيَانَ اغْفِرْ لِي يَا غَفَّارُ يَا سَتَّارُ يَا تَوَّابُ يَا وَهَّابُ اغْفِرْ عَنِّي
يَا وَدُودُ يَا رُؤُوفُ يَا عَفُوفُ يَا غَفُورُ ❁ الطُّفُّ بِي يَا لَطِيفُ يَا خَيْرُ يَا سَمِيعُ
يَا بَصِيرُ وَتَجَاوَزْ عَنِّي يَا حَلِيمُ يَا عَلِيمُ يَا كَرِيمُ يَا رَحِيمُ اهْدِنَا الصِّرَاطَ
الْمُسْتَقِيمَ يَا رَبِّ يَا صَمَدُ يَا هَادِي جُدْ عَلَيَّ بِفَضْلِكَ يَا بَدِيعُ يَا بَاقِي يَا عَدْلُ
يَا هُوَ أَخِي قَلْبِي وَقَهْرِي بِنُورِ الْإِيمَانِ وَالْقُرْآنِ يَا نُورُ يَا حَقُّ يَا حَيُّ يَا قَيُّومُ
يَا مَالِكُ الْمَلِكِ يَا ذَا الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ يَا أَوَّلُ يَا آخِرُ يَا ظَاهِرُ يَا بَاطِنُ يَا قَوِيُّ

يَا قَادِرُ يَا مَوْلَايَ يَا غَافِرُ يَا رَحِمَ الرَّاحِمِينَ أَسْأَلُكَ بِاسْمِكَ الْأَعْظَمِ
فِي الْقُرْآنِ وَمُحَمَّدٍ عَلَيْهِ الصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ الَّذِي هُوَ سِرُّكَ الْأَعْظَمُ
فِي كِتَابِ الْعَالَمِ أَنْ تَفْتَحَ مِن هَذِهِ الْأَسْمَاءِ الْحُسْنَى كَوَاةً مُفِيضَةً أَنْوَارَ
الْإِسْمِ الْأَعْظَمِ إِلَى قَلْبِي فِي قَالِي وَإِلَى رُوحِي فِي قَبْرِي فَصَيِّرْ هَذِهِ
الصَّحِيفَةَ كَسَفِّ قَبْرِي وَهَذِهِ الْأَسْمَاءُ كَكَوَاتٍ تُفِيضُ اشِعَّةَ
شَمْسِ الْحَقِيقَةِ إِلَى رُوحِي الْهَيِّ ائْتِنِّي أَنْ يَكُونَ لِي لِسَانٌ أَبَدِيٌّ يُنَادِي
بِهَذِهِ الْأَسْمَاءِ إِلَى قِيَامِ السَّاعَةِ فَاقْبَلْ هَذِهِ النُّفُوسَ الْبَاقِيَةَ بَعْدِي
نَائِبًا عَنِ لِسَانِي الرَّزَائِلِ ۞ اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ صَلَاةً مُبْجِنًا
بِهِا مِنْ جَمِيعِ الْأَهْوَالِ وَالْأَفَاتِ وَتَقْضِ لَنَا بِهَا جَمِيعَ الْحَاجَاتِ وَتَطَهِّرْنَا
بِهِا مِنْ جَمِيعِ السَّيِّئَاتِ وَتَغْفِرْ لَنَا بِهَا جَمِيعَ الذُّنُوبِ وَالْخَطِيئَاتِ يَا اللَّهُ
يَا مُجِيبَ الدَّعَوَاتِ اجْعَلْ لِي فِي مُدَّةِ حَيَاتِي وَبَعْدَ مَمَاتِي فِي كُلِّ
أَنْ أَضْعَافَ أَضْعَافِ ذَلِكَ أَلْفَ صَلَاةٍ وَسَلَامٍ مَضْرُوبِينَ فِي
مِثْلِ ذَلِكَ وَأَمْثَالِ أَمْثَالِ ذَلِكَ عَلَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِهِ وَأَصْحَابِهِ وَ
أَنْصَارِهِ وَاتَّبَاعِهِ وَاجْعَلْ كُلَّ صَلَاةٍ مِنْ كُلِّ ذَلِكَ تَزِيدُ عَلَيَّ أَنْفَاسِي الْعَاصِيَةِ
فِي مُدَّةِ عُمرِي وَاغْفِرْ لِي وَارْحَمْنِي بِكُلِّ صَلَاةٍ مِنْهَا بِرَحْمَتِكَ
يَا رَحِمَ الرَّاحِمِينَ

O Zot! Më duhet që të mos shqetësohem edhe në qoftë se do t'i humbsja të dyja jetët –këtë jetë dhe tjetrën– ose edhe në qoftë se i gjithë universi të bëhej i imi, meqenëse Ti je Zoti im, Kriuesi im dhe Perëndia ime! Unë jam njëri i krijuar dhe i bërë prej Teje. Pavarësisht rebelimit tim të skajshëm dhe pavarësisht largësisë së pakufishme prej lidhjeve të tjera të mirësisë, unë kam një lidhje me Ty, e cila është qënia ime krijesa Jote. Unë të lutem e të përgjërohem me gjuhën e kësaj lidhje;

O Krijuesi im! O Zoti im! O Furnizuesi im! O Pronari im! O Formëdhënësi im! O Perëndia ime!

Për hir të Emrave të Tu të bukur dhe të Emrit Tënd më të Madh, dhe për hir të kriterit Tënd të gjithurtë –Kuranit– dhe të dashurit Tënd më të nderuar, profetit Muhammed a.s.m dhe për hir të Fjalës Tënde të parapërrjetshme dhe të Fronit Tënd më të Madh, dhe për hir të mijëra e mijëra “Kul Huvall–llahu Ehad” “Thuaj, Ai është Allahu, Një, i Vetmi”, ki mëshirë mbi mua. O Allah, o i Gjithëmëshirshëm, o i Dhembshur, o Mirëbërës, o Sunduesi më i Lartë! Më fal mua o Fajfalës, o Mbulues (i mëkateve), o Pranuesi i pendesës, o Dhurues i Madh! Më fal mua, o i Dashur, o Zemërbutë, o Falës! O Fajfalës i Madh! Më favorizo me dhembshurinë dhe butësinë Tënde, o Zemërbutë, o i Mirinformuar, o Gjithëdëgjues, o Gjithëshikues! Mos i vër re gjynahet e mia, o i Durueshëm, o i Gjithëditur, o Gjithëbujar, o Mëshirëplotë.

“Na udhëzo në rrugën e drejtë...” O Zot! O i Kërkuari përjetësisht! O Udhëzues! Më favorizo gjithnjë me mirësinë e bujarinë Tënde, o Krijues, o i Qëndrueshmi përjetësisht, o i Gjithëdrejtë! O Huve (o Ai)!

Gjallëroje zemrën time dhe (ndriçoje) varrin tim me dritën e besimit dhe të Kuranit, o Dritë, o i Vërtetë, o i Gjallë i Përjetshëm, o Vetekzistues i Përhershëm, o Pronar i të gjitha dominimeve! O Zotëruesi i madhësisë dhe i mirëbërësisë, o i Pari (që s'ke fillim), o i Fundit (që s'ke mbarim), o i Dukshmi, o i Padukshmi, o i Gjithëfuqishëm. O i Plotëfuqishëm, o Pronari im, o Zoti im, o Falës, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve.

Për hir të Emrit Tënd më të madh në Kuran dhe për hir të profetit Muhammed a.s.m, i cili është mishërimi më i madh i kuptimit që Ti i ke dhënë krijimit, të lutem të hapësh nëpërmjet këtyre Emrave të bukur dritare përmes të cilave Dritat e Emrit Tënd më të Madh të mund të

hyjnë në zemrën time ndërsa jam në këtë botë, dhe të hyjnë në shpirtin tim në varrin tim. Le të jetë kjo faqe tavani i varrit tim dhe këto Emra dritare nëpërmjet të cilave rrezet e Diellit të së Vërtetës të derdhen në shpirtin tim.

O Zot! Unë dëshiroj që të kem një gjuhë të përjetshme me të cilën unë gjithmonë të të thërras Ty me këto Emra gjer Ditën e Kijametit. Pranoji këto rreshta si një zëvendësuese të përjetshme për gjuhën time të përkohshme.

O Zot! Jepi paqë e bekime shkëlqesisë sonë, Muhammedit a.s.m, në një mënyrë që Ti të na shpëtosh neve prej të gjitha fatkeqësive dhe katastrofave dhe të na përmbushësh të gjitha nevojat tona dhe të na pastrosh neve prej të gjitha të këqijave dhe të na i falësh të gjitha gjynahet dhe mëkatet tona.

O Zot! O Përgjigjësi i lutjeve! Prano prej meje në çdo moment gjatë jetës sime dhe pas jetës mijërat e mijërave të shumëfishuara prej salevateve mbi shkëlqesinë tonë, Muhammedin a.s.m dhe mbi Ehlibejtin –familjen e tij, mbi sahabët, mbi Ensarët dhe ndjekësit e tij. Shtoji këto salevate e selame sa numri i frymëmarrjeve dhe frymënxjerrjeve të mia gjatë jetës sime, dhe më fal mua dhe ki mëshirë mbi mua për hir të çdo salevati prej tyre, për hir të mëshirës Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve! Amin.

Shtojcë

O shok! Unë e besoj veten time të jetë si e detyruar të përpiqet e të zbulojë diçka tepër të rëndësishme nëpërmjet veprave të mia të ngatërruara. Ah, sikur ta dija nëse pata qenë në gjendje ta zbuloja ose nëse akoma duhet të shfaqet, ose në qoftë se unë jam një mjet për ta bërë atë të lehtë për një zbulim që do të vijë për ta arritur.

لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ
حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ ❀ نِعْمَ الْمَوْلَى وَنِعْمَ الْمَصِيرُ

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْحَمْدُ لِلَّهِ عَلَى نِعْمَةِ الْإِيمَانِ وَالْإِسْلَامِ بَعْدَ دَقَطَرَاتِ الْأَمْطَارِ وَأَمْوَاجِ
الْبِحَارِ وَشَمَرَاتِ الْأَشْجَارِ وَنُقُوشِ الْأَزْهَارِ وَنِعْمَاتِ الْأَطْيَارِ وَلِعَمَاتِ
الْأَنْوَارِ وَالشُّكْرُ لَهُ عَلَى كُلِّ مِنْ نِعْمَةٍ فِي الْأَطْوَارِ بَعْدَ كُلِّ نِعْمَةٍ فِي
الْأَدْوَارِ وَالصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ عَلَى سَيِّدِ الْأَنْبِيَاءِ وَالْأَخْيَارِ مُحَمَّدٍ الْمُخْتَارِ
وَعَلَى آلِهِ الْأَطْيَارِ وَأَصْحَابِهِ نُجُومِ الْهَدَايَةِ ذَوِي الْأَنْوَارِ مَا دَامَ اللَّيْلُ وَالنَّهَارُ

Nuk ka fuqi e forcë përveç se me Zotin. Allahu është i mjaftueshëm për ne, sa Ruajtës i Mirë është Ai! O Zot! Mos na nxjerr prej dynjaje veçse si martirë e besimtarë!

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Të gjitha lavdërimet qofshin për Allahun, për mirësinë e besimit dhe të Islamit sa numri i pikave të shiut, dhe i valëve të detit dhe i frutave të pemëve, dhe i qëndisjeve të luleve, dhe i këngëve të zogjve dhe i rrezeve të dritave, dhe falënderimet qofshin për Të për secilën nga mirësitë e Tij në të gjitha rrethanat, sa numri i të gjitha mirësive të Tij në të gjitha kohët. Paqja dhe bekimet qofshin mbi prijësin e shenjtorëve të pastër dhe të mirëve të qënieve njerëzore, mbi profetin e zgjedhur, Muhammedin, edhe mbi familjen e tij të pastër dhe sahabët e tij, yjet e udhëzimit dhe të ndritshëm sa të vazhdojnë netët dhe ditët.

Mësoje, o shok! Ndodhen kushte të veçanta për secilin nga stacionet e një udhëtari gjatë udhëtimit të tij. Ai që udhëton në rrugën për tek Allahu gjithashtu duhet të marrë një qëndrim të veçantë për secilin nga stacionet, rangjet dhe perdet që vijnë në rrugën dhe nëpërmjet ose përmes të cilave ai duhet të kalojë, dhe secila nga gjendjet që ai do t'i përjetojë gjatë udhëtimit të tij. Ai që i ngatërron këto (me njëra-tjetrën) bën gabime. Ai do të ishte si dikush që dëgjon hingëllimën e një kali që vjen nga një stallë tek fshati të cilin ai ndodh të jetë duke e vizituar; pastaj ai shkon në një qytet dhe, duke dëgjuar këngën e një bilbili në shtëpinë tek e cila ai është duke qëndruar si një mysafir, ai ngatërron hingëllimën e kalit me këngën e bilbilit ose pret që bilbili të hingëllojë si një kalë.

Mësoje, o shok! Njëra nga arsytet pse ti e shikon jetën e kësaj bote si të bukur është shkëlqimi i personave të mëdhenj e të shquar që erdhën më herët duke shndërritur si yjet e udhëzimit në 'pasqyrën' e botës. Kjo është kështu për shkak se e ardhmja është pasqyra e së shkuarës dhe e shkuara tashmë është përzier e kombinuar me botën e ndërmjetme midis kësaj bote dhe tjetrës, duke lënë formën e saj në pasqyrën e së ardhmes dhe në histori dhe në kujtesat e njerëzve. Shembulli yt në dashurinë e dynjasë me dashurinë e tyre është si shembulli, ose i ngjason një personi i cili has në rrugë një pasqyrë të madhe në të cilën ai shikon imazhet e shokëve dhe miqve të tij të cilët tashmë kanë emigruar në 'Lindje', të cilët shfaqen në pasqyrë të kenë shkuar në 'Perëndim'. I tmerruar nga 'Lindja', ai kthehet dhe nxiton drejt 'Perëndimit'. Në qoftë se perdja e pavetëdijes dhe pavëmëndshmërisë do të ngrihej e hiqej prej fytyrës tënde, ti do ta shikoje veten tënde duke nxituar në një shkretëtirë të madhe drejt një mirazhi dhe torturimi dhe jo drejt një burimi uji të ëmbël...

Mësoje, o shok! Njëri nga aspektet e madhështisë së Kuranit dhe nga treguesit më të vërtetë të të vërtetave të tij është sa vijon:

1. Ai përmban çfarëdo që është e domosdoshme për të gjitha shkallët e vërtetimit të Unitetit Hyjnor dhe të varieteteve të tij –unitetin në Esencë, unitetin në Atribute, unitetin në Emrat dhe unitetin në Akte– dhe ruan e mban balancën midis të gjitha të vërtetave të lartësuaru Hyjnore.

2. Përsëri, ai përfshin e përmban çfarëdo që kërkohet nga Emrat e bukur Hyjnorë dhe ruan përpjestimin e harmoninë midis tyre,

3. Dhe gjithashtu ai gjithërrethon e grumbullon cilësitë esenciale të Perëndisë dhe të Hyjnisë me balancë të përkryer e të plotë.

Kjo cilësi e Kuranit nuk gjendet në produktet e asnjë mendje njerëzore qoftë midis evlijave që depërtojnë në dimensionin e brendshëm të ekzistencës, as midis filozofëve iluministë (ishrakijjunë) që kanë depërtuar në aspektin e brendshëm të gjërave dhe ngjarjeve dhe as midis dijetarëve të pastër e të plotësuar të cilët shikojnë tek bota e padukshme. Ata nuk mund ta ngërthejnë të vërtetën absolute me shikimet e tyre të kufizuara. Ata vëzhgojnë vetëm një aspekt të tij, dhe në përpjekjet e tyre për ta kapur, ata e trajtojnë atë në disa rrugë të padrejta ekstreme, dhe kjo shkatërron balancën dhe prish përpjestimin e harmoninë.

Shembulli i tyre është si shembulli i palombarëve të cilët kërkojnë në fund të detit një thesar të të gjitha llojeve të gurëve të çmuar. Ndonjëri prej tyre rastisi të gjejë një diamant të gjatë dhe konkludoi se thesari përbëhet vetëm nga ai lloj diamanti. Kur ai dëgjon se disa prej shokëve të tij kishin gjetur gurë të tjerë të çmuar, i mendon se ato gurë janë gurë të çmuar për t'u vendosur në atë diamant. Në dorën e një tjetri kalon një rubin sferik, ndërsa një tjetër gjen një copë katrore prej qelibari e kështu me rradhë. Secili nga ata beson se xhevahiri që ai shikon në dorën e tij -jo me sy- është origjinal dhe esencjal në atë thesar si dhe pjesa më e madhe e tij. Dhe supozon se gjërat për të cilat ai dëgjon janë pjesë shtesë e detaje të tij. Kështu, balanca e të vërtetave priset dhe raporti i ndërsjellë dhe harmonia gjithashtu prishen. Ngjyra e shumë të vërtetave ndryshon, dhe me qëllim që të shikojnë ngjyrën e vërtetë të realitetit, ata detyrohen të përdorin interpretime të detyrueshme dhe shpjegime të ndërlikuara. Disa herë ata shikojnë aq larg deri në mohim e mos pranim. Kushdo që lexon librat e filozofisë 'Ishrakijjune' dhe veprat e sufive të cilat mbështeten në ndriçimet dhe vizionet pa i peshuar ato me peshat e sunnetit të pastër, padyshim do ta konfirmojë këtë pohimin tonë.

Pastaj, shiko Kuranin e gjithurtë. Ti e shikon se ai gjithashtu është një palombar. Por ai ka një sy të hapur i cili e shikon të gjithë thesarin me çfarëdo që ai përfshin, dhe e përshkruan atë pikërisht ashtu siç është, pa kaluar në ekstreme dhe pa neglizhuar asgjë, duke mos shkatërruar balancën dhe harmoninë midis pjesëve të thesarit. Për

shembull, ai përfshin çfarëdo që është e domosdoshme për të përkruar madhësitinë e Zotit të Plotëfuqishëm, të tilla si:

وَالْأَرْضُ جَمِيعًا قَبْضَتُهُ يَوْمَ الْقِيَامَةِ وَالسَّمَاوَاتُ مَطْوِيَّاتٍ بِيَمِينِهِ ﴿٣٣﴾
يَوْمَ نَطْوِي السَّمَاءَ كَطَيِّ السِّجِلِّ لِلْكُتُبِ

“Dhe e gjithë toka do të jetë e mbërthyer nga Dora e Tij dhe qiejt do të mbështillen në Dorën e Tij të djathtë”³³.“

Edhe Ditën kur Ne do t'i mbështjellim qiejt si letër e shkruar (e mbështjellë tub për shkrime)³⁴.

هُوَ الَّذِي يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ “Ai është i Cili ju formëson në mitra ashtu siç Ai dëshiron”³⁵.

مَا مِنْ دَابَّةٍ إِلَّا هُوَ آخِذٌ بِنَاصِيَتِهَا “Nuk ka asnjë krijesë të gjallë që Ai të mos e ketë kapur pas baluqeve të ballit (ta ketë nën sundimin e Tij të plotë)”³⁶.

خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ “I Cili krijoi qiejt dhe tokën”³⁷.

خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ “Allahu ju ka krijuar ju dhe çfarë ju veproni”³⁸.

يُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا “Si Ai e ringjall tokën pas vdekjes së saj”³⁹.

وَأَوْحَىٰ رَبُّكَ إِلَى النَّحْلِ “Dhe Zoti yt frymëzoi dhe bletën”⁴⁰.

وَالشَّمْسِ وَالْقَمَرِ وَالنُّجُومِ مُسَخَّرَاتٍ بِأَمْرِهِ “Dielli, hëna dhe yjet i janë nënshtruar urdhërit të Tij”⁴¹.

³³Kur'an, 39:67

³⁴Kur'an, 21:104

³⁵Kur'an, 3:6

³⁶Kur'an, 11:56

³⁷Kur'an, 6:1

³⁸Kur'an, 37:96

³⁹Kur'an, 30:19

⁴⁰Kur'an, 16:68

⁴¹Kur'an, 7:54

أَوَلَمْ يَرَوْا إِلَى الطَّيْرِ فَوْقَهُمْ صَاقَاتٍ وَيَقْبِضْنَ مَا يُمَسِّكُهُنَّ إِلَّا الرَّحْمَنُ
إِنَّ بِكُلِّ شَيْءٍ بِصِيرٌ

“A nuk i shohin ata zogjtë sipër tyre duke hapur krahët e tyre e duke i palosur ato? Askush nuk i mban ato përveç të Gjithëmëshirshmit (Allahut). Vërtetë Ai është Gjithëshikues i çdo gjëje”⁴².

وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا

“Froni i Tij shtrihet mbi qiej dhe tokë dhe Ai nuk ndjen aspak lodhje në ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre”⁴³.

هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

“Ai është i Pari dhe i Fundit, i Jashtmi dhe i Brendshmi dhe Ai është i Gjithëditur për çdo gjë”⁴⁴.

وَهُوَ مَعَكُمْ أَيْنَ مَا كُنْتُمْ “Dhe Ai është me ju kudo që të jeni”⁴⁵.

Ajo çfarë vëzhgohet në sektet e ndryshme devijuese është se ata të gjithë janë shmangur për shkak se udhëheqësit e tyre, të cilët kanë kaluar në dimensionin e brendshëm të ekzistencës, janë kthyer duke pas bërë gjysmën e rrugës në zbulimet e tyre. Ata kanë fituar diçka dhe kanë humbur shumë gjëra.

Mësoje, o shok! Duke e përshkruar qiellin me fjalën: “Dhe Ne e kemi zbukuruar qiellin e dynjasë”⁴⁶ dhe duke e përmendur dynjanë si të kundërtën e Ahiretit, botës tjetër, tregon për faktin se gjashtë qiejt e tjerë lidhen me botërat e tjera, prej Berzahut –botës së ndërmjetme– për tek Xhenneti. Qielli që ne shohim me yjet e tij është qielli i dynjasë. Megjithatë, Allahu e di më së miri.

⁴²Kur’an, 67:19

⁴³Kur’an, 2:255

⁴⁴Kur’an, 57:3

⁴⁵Kur’an, 57:4

⁴⁶Kur’an, 41:12

Mësoje, o shok! Ti erdhe në ekzistencë prej mosekzistencës. Pastaj, Krijuesi yt të favorizoi duke të të ngritur prej nivelit më të ulët të ekzistencës tek niveli i të qënit në formën e njeriut musliman. Çfarëdo që ti ke marrë dhe çfarëdo që ka ndodhur ndërmjet lëvizjes tënde të parë në fillimin e ekzistencës tënde dhe gjendjes tënde të tanishme është një favor i Zotit xh.sh mbi ty. Nga secila prej këtyre favoreve ndodhet një frut i bashkëngjitur tek ti dhe një ngjyrim i vendosur mbi ty. Ti je si një varëse (gushe) e mirësishtuar, ose si një bistak, ose si një kalli, në të cilat ‘rruazat’ ose ‘kokrrat’ e favoreve dhe të mirësive janë varur. Ti je si një indeks i favoreve të të Gjithëfuqishmit xh.sh.. Ekzistenca kërkon një shkak, ndërsa mosekzistenca nuk e kërkon. Ti do të pyetesh se si ke arritur tek kaq shumë favore gjatë rrugës së fitimit të një ekzistence të plotë e të përsosur prej nivelit të qënies një grimcë gjer në vdekje; si i meritove ato edhe në qoftë se ti e ke falënderuar Zotin për to. Asnjë njeri me sado pak inteligjencë të ketë nuk do të pyeste për gurin se përse nuk është bërë një pemë, as nuk do të pyeste një pemë se përse nuk është bërë një qenie njerëzore...

O Said i mjerë, o krijesë arrogante! Ti je një pikë ne mes të një vargu krijesash. Ti je dalluar me favore e mirësi sa numri i krijesave poshtë teje gjer tek mosekzistenca. Ti je përgjegjës për dhënie falënderimesh për secilën prej tyre. Sa për favorët që u janë dhënë atyre sipër teje, ato nuk janë për ty. Ti nuk do të pyetesh për asnjërën prej favoreve për të cilat ti je i pamundur që t’i arrish, ashtu si një grimcë që nuk ka të drejtë të ofshajë, duke thënë: “Ah medet! Përse nuk u bëra një diell?”, as një bletë nuk ka të drejtë t’i ankohet Krijuesit të saj, duke i thënë: “Do të kisha dashur të më kishe bërë një pemë –hurme–frutdhënëse”.

Mësoje, o ego! Është një shkak për shkatërrimin tënd dhe që të çon ty në humbje e shmangie, dhe që të poshtëron ty, se ti nuk ia jep çdo gjëje hakun që i takon dhe nuk i vë çdo gjëje peshën që ajo ka mundësi ta mbajë. Ti kalon në ekstreme dhe i ngarkon një ushtari të vetëm të gjitha pajimet e një ushtrie. Ti dëshiron ta shohësh vetë diellin me të gjithë madhështinë e tij dhe me planetët në imazhin e tij në syrin e një pike ose në faqen e një luleje. Në të vërtetë, një pikë ose një lule e përshkruan diellin për ty (secila sipas kapacitetit të saj për të pasqyruar diellin), por ato nuk i kanë cilësitë e diellit.

Mësoje, o shok! Pronësia dhe dominimi i të gjitha gjërave i përket vetëm Atij. Ai gjithashtu e ka në pronësi trupin tënd, të cilin Ai ta ka besuar ty si amanet. Nuk ka asnjë dobi të shqetësohesh e mërzitësh rreth tij dhe asnjë e mirë nuk ndodhet në atë që nuk është e përjetshme. Shmange shkeljen e premtimeve dhe detyrave të tua. Ti je i destinuar të vdesësh, dhe vdekja që rezulton në jetë është më e mirë se kjo jetë që rezulton në vdekje.

Mësoje, o shok! Ndërsa imazhi i diçkaje të reflektuar në një pasqyrë nuk është i njëjtë me vetë gjënë dhe as tjetër, në mënyrë paradoksale, imazhi është edhe identik –i njëjti– me gjënë, edhe tjetër nga ajo në të njëjtën kohë. Për shkak të imazhit, duke qenë forma e ‘kuptimit’ të reflektuar në pasqyrë, ai –imazhi– është i njëjtë me gjënë dhe çfarë është e vërtetë prej gjësë është gjithashtu e vërtetë prej imazhit. Ndërsa për shkak të imazhit që konsiston vetëm në formën e gjësë së reflektuar në paqsyre, ai është diçka tjetër nga gjëja. E ngjashme me këtë, ajo çfarë reflektohet –pasqyrohet– në pasqyrën e mendjes meqë ajo është forma e kuptimit, është diçka e njohur, ndërsa, meqenëse ajo është përshkrimi i gjësë së pasqyruar, është njohje.

Mësoje, o shok! Shumë botëra janë vendosur në ekzistencë duke mos penguar njëra–tjetrën. Në qoftë se dëshiron, hyr në një natë të errët në një shtëpi të ndriçuar me një llampë elektrike dhe katër muret e së cilës janë prej xhami që është si një fener –llampë– e botës së shëmbëllesës.

Së pari, ti do të shohësh në mure vende të shumta të ndriçuara dhe vetë qytetin të pasqyruar e të ndriçuar;

Së dyti, ti mund të bësh çdo lloj ndryshimi dhe modifikimi në ato vende të reflektuara;

Së treti, ti do ta shohësh se llampa e vërtetë është më e afërta për më të largëtën e llampave të reflektuara, meqë ajo është origjinalja e të gjitha llampave të reflektuara;

Së katërti, një pjesë e kësaj ekzistence sa masa e një kokrrë mund të përmbajë e përfshijë një botë të tërë prej ekzistencës së reflektuar.

Të gjitha këto katër cilësi janë gjithashtu të vërteta për shumë gjëra të tjera, madje edhe për Ekzistencën e Domosdoshme dhe për botën e mundësive, të cilat janë hijet e dritave të Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm, ekzistenca e të Cilit është absolutisht e domosdoshme.

Megjithëse ekzistenca e botës së mundësive është iluzive -e rreme- në vetvete, ajo ka një stabilitet nëpërmjet urdhërit të të Gjithëfuqishmit dhe është e dukshme, e ndjeshme nëpërmjet krijimit nga ana e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm.

Mësoje, o shok! Do të ishte e pakonceptueshme që kjo pronë - sferë- ekzistence të mos kishte Një të Vetëm që ta kishte sjellë në ekzistencë dhe ta kishte në pronësi. Gjithashtu, do të ishte e pakonceptueshme që Ai Pronar të mos e bënte Vetën të njohur për njeriun, i cili është i aftë të kapë bukuritë e kësaj sfere pronësie duke dëshmuar për plotësinë e Pronarit. Njeriu, i cili është bërë si kalif - sundues- në këtë djep të tij -tokë- të përgatitur për banimin e tij, vepron me autoritet si në djepin e tij, po ashtu, edhe në tavanin e ruajtur qiellor me mendjen e tij. Për më tepër, pavarësisht dobësisë dhe vogëlsisë së tij, siç dëshmohet nga veprimet e tij të çuditshme e të jashtëzakonshme, njeriu është më i nderuari i krijesave. Gjithashtu, midis shkaqeve, njeriu është më gjithëpërfshirësi dhe më ndikuesi në zgjedhje dhe me vullnetin e lirë. Kështu, Pronari e dërgon atë i cili do ta bëjë Pronarin të njohur për banorët e sferës së pronësisë së Tij, të cilët janë të pavëmëndshëm për Të dhe i njofton ata për atë çfarë është e kënaqshme për Të dhe i informon për atë çfarë kërkon Ai Pronar xh.sh prej tyre.

Mësoje, o shok! Të gjitha ndjenjat dhe aftësitë e njeriut duke përfshirë madje edhe ato të supozimit dhe të imagjinatës detyrohen përfundimisht të pajtohen e të bien dakord me të vërtetën dhe të kërkojnë strehim tek ajo. Është e pamundur për gënjeshtërën të ketë vend në to. Ato pohojnë se është e pamundur për universin të jetë i ndryshëm nga mënyra se si e përshkruan Kurani.

Mësoje, o shok! Nuk ka përplasje, as shtytje midis botërave të dritës, botës së nxehtësisë, të ajrit, të elektricitetit dhe gravitetit dhe, gjithashtu midis atyre të eterit dhe të ideve, apo të formave jomateriale dhe botës së ndërmjetme të varrit. Ato ekzistojnë bashkë me ty kur ti je pa askënd duke të të penguar dhe duke mos u përzier me ty në vendin ku je. Gjithashtu, ndonëse shumë më e shtrirë apo më e madhe se kjo botë e ngushtë, shumë prej botëve të së padukshmes mund të ekzistojnë së bashku. Gjithashtu, ajri nuk na pengon neve prej udhëtimit, as uji nuk na pengon për të ecur (mbi ose përmes tij), as qelqi nuk e ndalon dritën nga kalimi përmes tij, dhe një objekt i fortë nuk e pengon depërtimin e rrezes X, as dritën e mendjes dhe shpirtin e një meleku

(engjëlli). Hekuri nuk mund të formojë një pengesë përpara kalimit të nxehtësisë dhe përcjelljes së elektricitetit. Asgjë nuk mund ta ndalojë depërtimin e forcës së gravitetit, të lëvizjes së shpirtit dhe dritën e mendjes. Gjithashtu, kjo botë e ngurtë materiale nuk i ndalon e as nuk i pengon qëniet shpirtërore prej qarkullimit, xhindët prej lëvizjes përreth, shejtanët prej infiltrimit e hyrjes dhe melekët prej udhëtimit.

Mësoje, o shok! Drita dhe çfarë është prej drite janë si syri, si lampa dhe si dielli. Është e barabartë -e njëllotë- për to t'i rrethojnë e t'i përfshijnë me manifestimet e tyre qoftë diçka individuale, ose një specie në tërësi, ose një gjë të pjesshme, ose një të tërë, ose një gjë të veçantë, ose mijëra. Vështroje diellin dhe shiko se si në të njëjtën kohë dhe me të njëjtën lehtësi planetët ose oqeanet, ose flluskat, ose pikat e vesës, ose pikat e shiut, ose grimcat më të vockëla të qelqit përmbajnë dhe reflektojnë imazhet e tij (diellit).

Po kështu, -dhe për Allahun është krahasimi më i lartë- janë aktet autoritative të Diellit të Parapërdjetshëm, Dritës së dritave në librin e universit. Ai i shkruan të gjithë kapitujt e tij, pjesët, paragrafët, rreshtat, fjalitë, fjalët dhe shkronjat në të njëjtën kohë me të njëjtën lehtësi absolute, pa asnjë vështirësi. Ai deklaron:

مَا خَلَقَكُمْ وَلَا يَعْشُقْكُمْ إِلَّا كَفَنَفْسٍ وَاحِدَةٍ

“Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm”⁴⁷.

Ne e besojmë dhe e konfirmojmë.

Mësoje, o shok! Ai që reflekton mbi grimcat më të vockëla përbërëse të gjërave dhe mbi ecjen e tyre aq larg deri tek pika më e largët që ato shkojnë dhe vendosen për qëllime dhe rezultate të shumta, do të bindej se ndodhet Një i Vetëm, i Cili i urdhëron ato: “Ndaloni dhe vendosuni”. Është ashtu siç urdhëron kallëpi floririn e shkrirë me gjuhën e hekurit dhe përfundon me: “Mos u derdh! Ji i fiksuar dhe i stabilizuar brenda kufijve të kallëpit të bërë për ndonjë qëllim të veçantë!”

⁴⁷Kur'an, 31:28

Ajo që i urdhëron grimcat më të vockëla përbërëse të gjërave është njohja gjithëpërfshirëse që e manifeston vetveten si Kaderi, fuqia që paracakton. Kaderi bëhet një masë e fiksuar ose një sasi dhe masa bëhet një kallëp.

Mësoje, o shok! Ashtu si vërsetet e Kuranit që interpretojnë njëri-tjetrin, po kështu, pjesët e librit të universit gjithashtu e interpretojnë njëri-tjetrin. Gjithashtu, ashtu si bota fizike, trupore, që me të vërtetë ka nevojë për diellin, prej të cilit të përhapen dritat e mirëbërësisë së të Gjithëfuqishmit mbi të, po ashtu bota shpirtërore ka nevojë për diellin e profetësisë për përhapjen e dritave të mëshirës së të Gjithëfuqishmit mbi të. Profetësia e Ahmedit –Muhammedit– a.s.m është aq e dukshme, e qartë dhe e sigurtë si dielli në mesditë. A ka nevojë dita për ndonjë dëshmi?

Mësoje, o shok! Qëllimet për ekzistencën e një qenie të gjallë nuk lidhen vetëm me jetën, dobinë dhe plotësinë e vetë asaj gjallese. Ndërsa lidhen me vetë qënien vetëm në një drejtim, ato lidhen me Dhënësin e jetës në aspekte të panumërt. Realizimi i qëllimit për vetë gjallesën kërkon një kohë të gjatë, por qëllimet që lidhen me Dhënësin e jetës realizohen në një çast. Duke qenë një pasqyrë duke reflektuar manifestimet e Emrave të Tij më të bukur, një qenie e gjallë e përmbush për një çast nëpërmjet gjuhës së gjendjes funksionin e saj të lavdërimit ndaj Krijuesit të saj me të gjithë Atributet e Tij të plotësisë, bukurisë dhe madhësisë.

Mësoje, o shok! Çdo qenie njerëzore individuale është si një specie e qënieve të tjera, për arsye se:

Një qenie njerëzore ka një të shkuar dhe një të ardhme (meqenëse të gjitha qelizat e tij ripërtërihen çdo gjashtë muaj); dy format e tij individuale largohen prej tij çdo vit, por vetëm pasi të depozitohen e të lënë tek ai dhimbjet e tyre, mëkatet, ambiciet etj. Është sikur ai të ishte një individ gjithëpërfshirës. Gjithashtu, kapaciteti i tij intelektual dhe mendimet gjithëpërfshirëse, ndjenjat dhe emocionet e bëjnë atë si një specie. Përsëri, ai është individualisht ashtu si një specie, përgjegjës për përmirësimin e botës në përputhje me urdhërat e Zotit xh.sh (të cilën ne e quajmë kalifat) dhe që të jetë boshti rreth të cilit bota e tij e veçantë si edhe tërësia e botës rrotullohet. Ndërgjegjja e tij me të gjitha pjesët e krijimit dhe aktet e tij autoritare mbi shumë lloje të bimëve, kafshëve dhe elementëve, e gjitha kjo e bën atë gjithashtu si një specie. Është

sikur çdo qenie njerëzore individuale të ishte një specie në vetvete. Për më tepër, banorët e qiejve e të tokës tregojnë për faktin se çdo qenie njerëzore individuale bëhet si një botë ose qendra e saj nëpërmjet besimit.

Shqyrto se çfarë ndodh në një specie të kafshëve dhe të bimëve çdo vit në emrin e vdekjes, të rigjallërimit dhe të ripërtëritjes. Shikoj shenjat dhe pasojat e mëshirës së Allahut të manifestuar çdo vit në frutat e ripërtëritë ose të rimëkëmbur me pothuajse me identitetet e tyre, dhe ringjalljen e shumë specieve të insekteve dhe parazitëve me lehtësi të plotë. E njëjta gjë ndodh me çdo qenie njerëzore individuale. Nëpërmjet të gjithë këtyre ‘vërseteve’ të krijimit, libri i universit tregon shkatërrimin e përgjithshëm të botës mbi bijtë e njerëzimit dhe ringjalljen e tyre, një fakt të cilin Kurani e tregon me vërsetet e tij të shpalljes. Unë i kam përmendur argumentet e arsyeshme për Ringjalljen në *“Fjalën e Dhjetë”* dhe në *“Fjalën e Njëzet e Nëntë”* të koleksionit të *“Fjalëve”*, dhe tek *“Isharatul Ixhaz”* *“Shenjat e Mrekullisë”*. Referoju këtyre veprave meqë këto largojnë çdo dyshim e skepticizëm.

Mësoje, o shok! Ndërsa duke dëgjuar Kuranin, për secilën nga meloditë e tij ti mund të marrësh një qëndrim të ri dhe një mënyrë sipas shkallëve të udhëzimit duke marrë parasysh nivelet e të adresuarve të tij, dhe përpiqu të marrësh mënyrën e ndërmjetësve duke i vënë në rradhë, prej Xhebrailit, i cili ia solli profetit deri tek ai prej të cilit e dëgjon atë drejtëpërdrejtë. Ndërsa duke e dëgjuar prej atij që është duke e recituar aty ku je, ti duhet të përpiqesh ta dëgjosh sikur ta dëgjoje prej vetë profetit a.s.m, duke e recituar atë në kulmin e profetësisë për të gjithë bijtë e njerëzimit dhe për qëniet e tjera gjithandej tokës. Pastaj, ti duhet të marrësh mënyrën e Xhebrailit ndërsa ia reciton atë profetit a.s.m në horizontin më të lartë. Së fundi, në qoftë se ti mundesh, duhet të përpiqesh ta dëgjosh atë sikur ta dëgjoje prej prapa shtatëdhjetë mijë perdeve prej Folësit të Vetëm të Parapërdjetshëm, i Cili flet me profetin *“në distancën e largësisë së dy harqeve”*.

Mësoje, o shok! Çfarë bie tek pjesa jote prej vetëdijes dhe njohjes është në përpjestim me pjesën tënde në ekzistencën tënde. Kjo është për shkak se nuk ka harxhim të tepruar në ekzistencë dhe shkak është në përpjestim me pasojën e tij, dhe fuqia me realitetin. Kur krahasohet me pjesën në ekzistencën tënde, e cila i përket Atij që e ka krijuar, pjesa

jote është vetëm aq sa një qime e krahasuar me litarin e trashë, ose si fill –penjzë– e krahasuar me rrobat. Sa për vetëdijen dhe njohjen tënde të krahasuara me njohjen dhe shikimin e Krijuesit tënd lidhur me ty, ato janë si drita e një xixëllonje në diellin vezullues duke shndërritur në mesditë. Ti je në errësirën e pavëmendshmërisë dhe nata e natyrës ose e natyralizmit ta shfaq dritën tënde sikur ajo të ishte një yll shpues.

Mësoje, o shok! Ndërmjet akteve të Krijuesit ndodhet një harmoni dhe midis veprave të Tij ndodhet një ngjashmëri. Emrat e Tij reflektohen mbi njëri–tjetrin, Atributet e Tij janë përzier dhe cilësitë e Tij esenciale janë të përziera me njëra–tjetrën. Sidoqoftë, secili prej këtyre ka një qëndrim të veçantë, një mënyrë manifestimi dhe një operim me të tjerët të varur e të ndërvarur prej tij. Në sferën e manifestimit dhe operimit të njërit, rregulli e pasoja nuk duhet t’u atribuohen të tjerëve, as skalitjet dhe veprat e të tjerëve nuk duhet të kërkohen nga ai njeri.

Prandaj, prej veprave të Tij, kur ti shikon objektet e pajeta, shiko para së gjithash fuqinë e madhështinë e Tij. Pastaj, manifestimet e Emrave të tjerë do të të shfaqen ty si të varur prej tyre.

Kur ti vështron kafshët, shiko para së gjithash Emrat e manifestuar mbi to më shumë. Për çdo gjë ndodhet një masë me Të. Të gjitha gjërat Ai i ka krijuar dhe ka vendosur për secilën një masë.

وَكُلُّ شَيْءٍ عِنْدَهُ بِمِقْدَارٍ ۝ وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَقَدَرَهُ تَقْدِيرًا

“Çdo gjë është para Tij në raport (të përcaktuar drejt)”⁴⁸. “...dhe i Cili krijoi çdo gjë duke e matur saktësisht sipas përmasave të përpikta të duhura”⁴⁹.

Mësoje, o shok! لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ “Nuk ka forcë e fuqi veçse nëpërmjet Allahut”, kjo ka një lidhje ose lidhet me secilën prej fazave që një njeri ndërmerr gjatë rrugës së ardhjes së tij në ekzistencë, nga faza e qënies një komponent i elementëve në natyrë për tek ai i të qënurit një qenie e gjallë njerëzore. Në lidhje me secilën nga këto faza

⁴⁸Kur’an, 13:8

⁴⁹Kur’an, 25:2

dhe për secilën nga shqisët dhe aftësitë e tij, njeriu ka nevoja të ndryshme dhe shpresa e pritshmëri, si dhe vuan dhimbje të ndryshme.

لَا حَوْلَ عَنِ الْعَدَمِ وَلَا قُوَّةَ عَلَى الْوُجُودِ إِلَّا بِاللَّهِ *Nuk ka forcë të sjellë nga mosekzistenca dhe nuk ka fuqi për të dhënë ekzistencë, përveç Zotit.*

لَا حَوْلَ عَنِ الزَّوَالِ وَلَا قُوَّةَ عَلَى الْبَقَاءِ إِلَّا بِاللَّهِ *Nuk ka forcë që të shpëtojë nga zhdukja dhe as fuqi që të japë përhershëmëri, përveç Zotit.*

لَا حَوْلَ عَنِ الْمَضَرَّةِ وَلَا قُوَّةَ عَلَى النَّصْعِ إِلَّا بِاللَّهِ *Nuk ka forcë të shkaktojë dëm dhe as fuqi që të sjellë dobi, përveç Zotit.*

لَا حَوْلَ عَنِ الْمَصَائِبِ وَلَا قُوَّةَ عَلَى الْمَطَائِبِ إِلَّا بِاللَّهِ *Nuk ka forcë që të të shpëtojë prej fatkeqësive dhe as fuqi që të të plotësojë nevojat, përveç Zotit.*

لَا حَوْلَ عَنِ الْمَعَاصِي وَلَا قُوَّةَ عَلَى الْعِبَادَةِ إِلَّا بِاللَّهِ *Nuk ka forcë që t'i mundësojë dikujt të rezistojë kundra mëkateve dhe as fuqi që t'i mundësojë dikujt të jetë i vazhdueshëm në adhurim dhe në bindje ndaj Allahut, përveç Zotit.*

لَا حَوْلَ عَنِ النَّفَمِ وَلَا قُوَّةَ عَلَى النَّعْمَةِ إِلَّا بِاللَّهِ *Nuk ka forcë që të shpëton prej dhimbjeve dhe torturave dhe as fuqi që të të dhurojë mirësi, përveç Zotit.*

لَا حَوْلَ عَنِ الظُّلْمَةِ وَلَا قُوَّةَ عَلَى النُّورِ إِلَّا بِاللَّهِ *Nuk ka forcë që të të shpëtojë prej të këqijave dhe as fuqi që të të bëjë të fitosh mirësi, përveç Allahut.*

Nuk ka forcë që të na mundësojë të durojmë dhimbjet dhe as fuqi që të na mundësojë për të realizuar shpresat, përveç Zotit.

Nuk ka forcë që të largojë perden e errësirës dhe as fuqi për të dërguar drita ndriçuese, përveç Zotit, të Lartësuarit, Madhështorit.

Mësoje, o shok! Kushdo që beson në Zotin dhe mbështetet tek Ai, Allahu i mjafton atij. *Hasbunall-llahu ve ni'mel vekil*, Allahu vetëm na mjafton dhe për ne është Rregulluesi më i Mirë i punëve. Sepse Ai është Pronari ynë dhe Pronari i të gjitha gjërave. Kështu, në qoftë se ne e mbështesim veten tonë tek Ai, do të jetë sikur gjithçka të ishte në pronësinë tonë.

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *'Hasbunall-llahu ve ni'mel vekil'*, sepse Ai është i Ploti Absolut dhe plotësia është e dashur prej Tij dhe është e denjë të sakrifikohet për hir të asaj plotësie.

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *'Hasbunall-llahu ve ni'mel vekil'*, sepse Ai është Madhështori, Hirploti, Zotëruesi i plotësisë, i madhështisë dhe i bukurisë. Bukuria është e dashur prej Tij, dhe për hir të zellit dhe dalldisë të prodhuara nga ripërtëritjet që manifestimet e bukurisë së Tij shkaktojnë, ne vdesim duke qeshur dhe jetojmë të gëzuar.

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *'Hasbunall-llahu ve ni'mel vekil'*, sepse Ai është Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm, i Cili u jep ekzistencë të gjitha gjërave. Njohja jonë për domosdoshmërinë absolute të ekzistencës së Tij, e bën tërësinë e ekzistencës të volitshme për ne dhe na dhuron ne ekzistencë të përjetshme. Injoranca jonë ose mohimi i ekzistencës së Tij të domosdoshme na lë neve të mbuluar nga errësira e madhe e mosekzistencës.

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *'Hasbunall-llahu ve ni'mel vekil'*, sepse Ai është i Parapërjetshmi i Përhershëm dhe i Amshuari i Vazhdueshëm, i papërfshirë nga koha e hapësira,

كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ "Çdo gjë do të shuhet e do të shkatërrohet përveç Fytyrës së Tij xh.sh".⁵⁰

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *'Hasbunall-llahu ve ni'mel vekil'*, sepse dynjaja është e përkohshme dhe jeta është kalimtare.

⁵⁰Kur'an, 28:88

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *‘Hasbunall-llahu ve ni’mel vekil’*, sepse për Të, te gjëna kenaqësiu e dynjasë ndryshohen e bëhen dhimbje, ndërsa duke u orientuar drejt Tij dhe duke u lidhur me mëshirën e Tij, njeriu shpëton prej dhimbjeve të të qënurit kalimtar dhe kënaqësitë e përkohshme fitojnë përhershmeri.

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *‘Hasbunall-llahu ve ni’mel vekil’*, sepse nëpërmjet Tij njeriu merr dritat e ekzistencës, ndërsa pa Të ai bie në errësirën e mosekzistencës.

حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ *‘Hasbunall-llahu ve ni’mel vekil’*, sepse në qoftë se ne e njohim Atë dhe ia paraqesim Atij nevojat e ankesat tona, Ai do të na mjaftojë për të gjitha nevojat tona. Në qoftë se në të kundërt, u drejtohem shkaqeve dhe ua referojmë atyre nevojat e ankesat tona, ndonëse shkaqet janë të verbëra e të shurdhëta, dhe të paafta për të na parë e dëgjuar, ne ngatërrohem e humbasim në rrugët tona. Ne jemi si ai që, megjithëse ka nevojë dhe duhet t’ia paraqesë ankesat drejtëpërdrejt mbretit, i cili është i aftë t’u përgjigjet atyre në çast, i drejtohet të gjithë popullatës së vendit njëri pas tjetrit për t’u kërkuar ndihmë.

Mësoje, o shok! Midis hollësive të mrekullisë së Kuranit dhe dëshmimeve se ai është mëshirë e gjithanshme për tërësinë e krijimit, janë si më poshtë:

Ashtu si prej kësaj bote çdo person ka një botë të veçantë në vetvete, po ashtu prej Kuranit çdo person ka një Kuran duke iu adresuar temperamentit të tij dhe duke e edukuar atë dhe duke ia shëruar sëmundjet e tij shpirtërore dhe duke iu përgjigjur kërkesave të tij mendore.

Midis meritave të Kuranit lidhur me udhëzimin janë sa vijon:

Ndodhet një koherencë, thukëti dhe lidhje midis vërseteve të tij, të cilat i mundësojnë çdo njeriu t’i marrë vërsetet prej kapitujve të ndryshëm për udhëzimin e tij dhe për shërimin e sëmundjeve të tij shpirtërore. Kjo është ajo çfarë bëjnë dijetarët dhe udhëzuesit shpirtërorë që u përkasin metodave dhe shkollave të ndryshme.

Megjithëse Kurani u shpall në pjesë në raste të ndryshme, ti i sheh vërsetet e tij të renditura si ruazat e një varëse-gushe- në harmoni të plotë e në koherencë me njëra-tjetrën. As ndarja e tij në vërsete e kapituj nuk shkakton mospërputhje, mospajtim e çrregullim prej qëllimeve të tij kryesore, as kalimi tek vërsetet e tjerë apo tek grupet e vërseteve nuk shkakton asnjë përçarje, shkatërrim. Shumica e vërseteve të tij janë ndërlidhur në mënyrë të hollësishme me njëri-tjetrin, me qëllim që të mund të përmenden së bashku ose të grumbullohen për të formur, për shembull, një përmbledhje lutjesh.

Vërsetet e sures Ihlas mbështesin njëri-tjetrin. Ata janë edhe argumente për njëri-tjetrin, edhe përfundime logjike për t'u arritur prej atyre argumenteve, siç është përmendur tek trajtesa “Rezëllimat”, e cila është vendosur në fund të koleksionit të Fjalëve. Gjithashtu, për shkak të ndërlidhjes midis vërseteve të tij dhe gjithëpërfshirjes së kuptimeve të tyre, ndodhen mijëra e mijëra Kurane brenda Kuranit të vetëm, dhe një libër formohet rreth secilës prej të vërtetave të tij.

اللَّهُمَّ يَا مُنْزِلَ الْقُرْآنِ بِحَقِّ الْقُرْآنِ اجْعَلِ الْقُرْآنَ مُوَسِّئًا
لِي فِي حَيَاتِي وَبَعْدَ مَمَاتِي وَنُورًا فِي قَلْبِي وَقَبْرِي

O Allah, o Shpallësi i Kuranit, për hir të Kuranit, bëje Kuranin një mik të ngushtë për mua në jetën time dhe pas vdekjes sime, dhe dritë në zemrën time dhe në varrin tim.

أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا رَسُولُ اللَّهِ

*Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhammedi është profeti i Allahut. Lamtumirë!*⁵¹

⁵¹Kujtova se u afrua exheli im për shkak të sëmundjes sime të rëndë dhe thashë: Lamtumirë! Unë po udhëtoj prej derës së varrit për tek vendtakimi i të dashurve të mi, profesorëve dhe shokëve të mi prej studiuesve të shkollave dhe të Risale-i Nurit. Autori.

Shtojca e Dytë

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi Allahut, të Gjithëmëshirshmit, midis frutave më të mëdhaja të Tubasë -pemës së shenjtë- të mëshirës së të Cilit janë prijësi ynë Muhammedi a.sm dhe parajsa, të dyja duke u varur poshtë mbi të dyja botët. Ai është i Gjithëfuqishmi i Vetëm. Të gjitha këto krijesa spektatore të ripërtërira dhe këto objekte qiellore janë dëshmitarë të Qënies së Tij Perëndi. Këto bimë shumëngjyrëshe dhe këto lloje të ndryshme kafshësh në kopështin e Tokës janë mrekullitë e artit të Tij dhe dëshmitë e Hyjnisë së Tij. Këto lule të ndritshme dhe me të gjitha gjetet, lulet dhe frutat e tyre, dhe këto pemë frutdhënëse janë mrekullitë e fuqisë së Tij dhe provat e mëshirës së Tij. Të gjitha dëshmojnë se Ai është i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat.

Ngjarjet e së shkuarës janë mrekullitë e fuqisë së Tij duke treguar për faktin se Ai është i aftë të bëjë përngjasimet e tyre në të ardhmen. Nuk ka asgjë që ose ndodhi në të shkuarën, ose që mund të ndodhë në të ardhmen, që mund të dalë përtej dekreteve të fuqisë së Tij. Në lidhje me Të, grimcat më të vockëla dhe diejt më të largët janë të njëjtë. Ai është e Vërteta e Qartë, Një, i Vetmi. Në gjuhët e tyre të ndryshme, grimcat dhe pjesët përbërëse të universit tregojnë për Bukurinë e Tij Absolute, duke thënë:

عِبَارَاتُنَا شَتَّى وَحُسْنُكَ وَاحِدٌ * وَكُلُّ إِلَى ذَاكَ الْجَمَالِ يُشِيرُ

Megjithëse ne jemi të ndryshëm në shprehje, ti ke të njëjtën Bukuri; Çfarëdo që ekziston (në univers) tregon atë Bukuri.

Me të gjithë kapitujt e tij, pjesët, paragrafet, fjalitë, fjalët dhe shkronjat, libri i universit lexon shenjat e ekzistencës së Tij të domosdoshme Absolute dhe Unitetin e Tij, dhe rreshtat e Tij shpallin për mendjet:

تَأْمَلُ سَطُورَ الْكَاتِبَاتِ فَإِنَّهَا ﴿﴾ مِنْ مَلَأَ الْأَعْلَى إِلَيْكَ رَسَائِلُ

Shqyrtoji rreshtat e universit sepse ato janë mesazhe për ty nga vendqëndrimi më i lartë.

Paqja dhe bekimet qofshin mbi prijësin tonë Muhammedin a.s.m dhe mbi të gjithë familjen dhe sahabët e tij.

Mësoje, o Said kryengritës! Mos i fikso sytë e tu mbi atë që nuk është për ty; por shiko veten tënde. Çfarë lloji je ti? Çfarë vlere ke? Mbi çfarë mbështetesh? Ti je një mishërim i pafuqisë dhe i nevojës; çfarëdo gjëje që ke ti, të është dhënë nga Allahu. Dhe ti je në një gjumë, të cilin ti e sheh si një zgjim.

Pafuqia është trupi yt, në të cilin nevoja është shpirti i tij që të nxit ty të lëvizësh. Me gjithçka që ke, ti je një mishërim i favorizimit të Allahut. Jeta jote është një gjumë që banon me të. Ah, medet! Unë jam mbytur në një pikë që është bërë një oqean që po më përpin. Unë jam humbur në një moment që është bërë si përjetësi për mua. Unë e supozoj këtë shkretimë të jetës si një diell të shndritshëm që nuk do të perëndojë kurrë.

O Said i mjerë! Ti ke një kapital rreth gjashtëdhjetë dinar – dollar. Ti tashmë i ke shpenzuar dyzet e pesë dinar prej asaj shume për të përmbushur nevojat e tua në hanin e botës. Ti e ke harruar e neglizhuar shtëpinë tënde dhe pasuria jote është bërë një borxh për ty për ta paguar dhe një zjarr. Sa për pesëmbëdhjetë dinarët, është e dyshimtë nëse do të jesh në gjendje t'i shpenzosh që të gjitha apo vetëm pak prej asaj shume, apo nëse ti do të jesh në gjendje të shpenzosh ndonjë prej saj. Çfarëdo sasi që ti do të ishe në gjendje ta shpenzoje, harxhoje mbi banesën tënde të përjetshme. Të paktën një e treta e saj, le të jetë një dritë për ty. Sa injorant je! Sa në humbje të madhe je ti! Ti e ke shpenzuar mbi këtë jetë kalimtare të gjithë shumën që të është dhënë prej kapitalit tënd dhe shuma e mbetur në dorën tënde për banesën tënde të përjetshme është më e pakta e të paktës. Ti je një udhëtar i pavëmendshëm; ke pasur tre shkalla, grada. I kalove dy shkallë me daljen tënde prej shtëpisë dhe vendit, dhe e ngrite këmbën tënde që të kalosh tek shkalla e tretë duke dalë prej dynjasë kalimtare.

Mësoje, o shok! E tmerrshme është fjala që del prej gojëve të disave kur thonë: “Gjërat formohen nga vetvetja”, ose “shkaqet e kanë sjellë atë në ekzistencë”, ose “natyra e kërkon atë (të jetë kështu)”. Të gjitha këto tre fjali janë të rreme dhe përmbajnë shumë pamundësi. Ti ekziston: sipas fjalisë së parë ti je krijesa e vetes tënde. Sipas të dytës, shkaqet –materiale– të kanë sjellë ty në ekzistencë. Ose sipas fjalisë së fundit, disa ligje të pavetëdijshme, të shurdhëta e të verbëra, ose forca

të cilat ata ia atribuojnë natyrës, ose gjërat e pajeta, duke formuar atë çfarë ata e quajnë natyrë, e kanë kërkuar ardhjen tënde në ekzistencë. Ndërsa e vërteta kërkon që ti je një krijesë e Zotit të Gjithëfuqishëm.

Sa për fjalinë e parë, **تَشَكَّلَ لِنَفْسِهِ** gjërat nuk mund të formohen nga vetvetja sepse:

Secila prej grimcave ose atomeve që formojnë trupin tënd duhej të kishte sy për të shikuar të gjithë krijimin, gjithashtu duhej të kishte vetëdije për të qenë në dijeni për të gjitha kërkesat e jetës dhe ekzistencës. Kjo është çfarë e kërkojnë përbërja jote e përkryer dhe plotësia e artit në ty, dhe sepse të gjitha grimcat e ekzistencës janë në lidhje të gjalla dhe substanciale me njëra-tjetrën dhe me tërësinë e krijimit.

Gjithashtu, madje edhe një libër i thjeshtë për t'u shtypur në një shtëpi botuese duhet të ketë aq shumë shkronja metalike ose taste aq sa numri i shkronjave dhe i simboleve të përdorura në shkrimin e tij. Kështu, për t'u bërë nga vetja jote, duhet të ishin në ty aq shumë kallëpe sa atomet e tu në lidhje të vetëdijshme dhe në komunikim me njëra-tjetrën.

Përsëri, ti ke një përbërje të njëtrajtshme, të gjitha pjesët e të cilës janë në ndërlidhje me njëra-tjetrën. Atëherë, ashtu si gurët që formojnë një hark ose një kube, të gjithë atomet e tua ose bllloqet e ndërtimit të trupit tënd do të duhej të ishin edhe dominant, edhe të dominuar nga njëri-tjetri. Ata gjithashtu duhej të ishin si manifestimet e Emrave dhe Atributeve të të Vetmit Një, i Cili i mbështjell qiejt si letër e shkruar (e mbështjellë tub për shkrime), duhej të ishin edhe të kundërt, edhe plotësues për njëri-tjetrin.

أَوْ جَدَّتْهَا لِأَسْبَابٍ Shkaqet nuk mund të krijojnë asgjë nga vetvetja sepse:

Shqyrto që shishet në një farmaci që përmbajnë përbërës të ndonjë ilaçi rrezohen dhe sasi të përcaktuara substancash në to derdhen dhe përzihen në tokë në masat ekzakte për të formuar ilaçin e dëshiruar. Në qoftë se ajo do të ishte e mundur, atëherë formim yt rastësisht, nga shkaqet e rastësishme, gjithashtu mund të ishte i mundur.

Gjithashtu, në qoftë se shkaqe të panumërta, të verbëra e shurdhe do të grumbulloheshin së bashku, ato vetëm se do të shtonin shurdhëri e verbëri. Është e pakonceptueshme që një gjë me rregull të përkryer të dalë prej tyre. Ndërsa njeriu është vepra më e përkryer e artit, inteligjent, i vetëdijshëm dhe i pajisur me ndjenja të pafundme dhe tejet të ndërlikuara, me shqisë e aftësi dhe me nevoja të ndjeshme të pafundme. Kështu, krijimi yt prej shkaqeve të shurdhëta, të verbëra e të pavetëdijshme është pafundësisht e pamundur.

Pastaj, grumbullimi i atyre shkaqeve të panumërta në mënyrën më të rregullt dhe në masat më të sakta në një qelizë të vetme prej qelizave të syrit tënd nuk është më e lehtë se grumbullimi i objekteve të mëdhenj qiellorë në pëllëmbën tënde, madje në thoin tënd apo në një qelizë të tij; sepse në qoftë se dikush punon në një shtëpi, kjo do të thotë se shtëpia e përfshin atë. Të gjitha pjesët e universit të tilla si ajri, uji, toka, dielli, bimët dhe kafshët etj, lidhen me njeriun. Atëherë, në qoftë se do të ishin shkaqet ato që e bëjnë njeriun, universi me të gjitha pjesët e tij, duhej të ishin në gjendje të operonin brenda çdo pjese të trupit tënd dhe të përfshiheshin nga çdo qelizë e jotja. Kjo do të ishte sofistika më e paimagjinueshme.

اِقْتَضَتْهَا الطَّبِيعَةُ *Natyrë nuk mund të jetë një krijuese sepse:*

Natyrë është diçka e supozuar të ekzistojë, është një emër që i është dhënë nga të pakujdesshmit dhe të çudhëzuarit. Por, në kuptimin e saj të vërtetë, ajo është një art Hyjnor, një ngjyrim prej të Gjithëmëshirshmit.

Sa për atë që ata e quajnë “Forcat Natyrore”, ato janë manifestimet e fuqisë së të Gjithurtit, të Mirinformuarit, dhe të të Gjithëvullnetshmit. Ajo çfarë ata e quajnë “rastësi”, është veçse një supozim që buron nga çudhëzimi i paraqitur prej atyre të pavetëdijshëm ose që mohojnë Autorin e Vetëm Krijues. Në shumë prej trajtesave të mia të tilla si “Nuktah - Pika” dhe shtojca e saj në “Nuktah”, “Grimca” dhe në “Kokrrën” dhe në shtojcën e saj, unë kam argumentuar se ky art i mrekullueshëm, i cili përbën esencën e asaj që ata shohin në natyrë, nuk mund të jetë tjetër përveç veprës së fuqisë së të Mirinformuarit Gjithëshikues, duke patur të gjitha Atributet e plotësisë së Tij.


Si do të mund të ishte që diçka e kufizuar, e ngurtë, e pajetë dhe për të cilën ishte njësoj e mundshme që ajo duhej të ekzistonte ose të mos

ekzistonte, dhe kështu duhet medoemos një i cili preferon ekzistencën e saj dhe ta sjellë atë në ekzistencë, si do të mund ta kishte thurur mantelin e universit? Si do të ishte e mundur që një harrje -mizë- të ketë patur pjesë në thurjen e këtyre manteleve të mirëvizatuar e të zbukuar, me të cilat vishen të gjithë ato botëra? Kështu, shpjegimi i vetëm për ekzistencën tënde si edhe për ekzistencën e të gjithë krijimit është se ti dhe të gjitha gjërat e tjera janë krijesat e Autorit të Parapërtshëm. Dëshmitarët për Qënien e Tij Krijuesi janë aq të shumta sa numri i krijesave. Midis këtyre dëshmuesve, me të gjitha grimcat dhe pjesët e tij përbërëse, universi dëshmon për Të me pesëdhjetë e pesë gjuhë, të cilat u shpjeguan në trajtesën “Katreh” “Pika”.

Midis atyre dëshmive janë Kurani me të gjithë librat e tjerë të shpallur për profetë të ndryshëm dhe të shkruar nga evlijatë dhe nga ata të cilët besojnë në ekzistencën e Zotit, bashkë me çfarëdo që është e ndodh në univers.

Midis tyre janë prijësi i krijimit dhe i të gjithë profetëve të tjerë, i shenjtoreve dhe i melekëve, profeti Muhammed a.s.m..

Midis tyre janë njerëzimi dhe xhindët me të gjitha nevojat e tyre natyrore.

Midis tyre është: 

“Allahu dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Atij”⁵²

Gjithashtu, dëgjo sa vijon:

Mësoje, o shok! Gënjeshtria e atribuimit të krijimit vetë gjërave ose natyrës apo shkaqeve mund të shpjegohet nëpërmjet shembullit të një peme frutdhënëse. Në qoftë se ia atribuon një peme frutdhënëse Zotit xh.sh, Një të Vetmit, ti ia ke atribuuar atë bërthamës së saj, ligjeve të mbirjes, krijimit dhe rritjes, të cilat dalin prej urdhërave të Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm, Një të Vetmit dhe mbi të cilat varet ajo bërthamë. Ajo varet nga ligjet që dalin prej Krijuesit të Vetëm. Për shkak të lehtësisë që vjen prej Njësisë së Tij, i Cili drejton mbirjen e saj, rritjen dhe jetën, është njësoj e lehtë për Atë Krijues të Vetëm ta

⁵²Kur’an, 3:18

rrisë atë bërthamë në një pemë, qoftë ajo një arë kokosi e madhe apo hurmë e madhe që mban fruta të panumërta, ose në një të vogël me vetëm pak fruta.

Ndërsa, në qoftë se ia atribuon një pemë vetes së saj ose shkaqeve apo natyrës, atëherë secila prej frutave të saj, luleve, gjetheve, degëve dhe degëzave do të kërkonte gjithçka që tërësia e asaj peme kërkon. Sepse secila nga pjesët e saj është një përmbledhje e një tërësie, dhe çfarëdo që tërësia ka nevojë, secila nga pjesët e asaj gjithashtu ka nevojë. Tani ti mund t'i shqyrtosh këto dy alternativa në shpjegimin e origjinës dhe ekzistencës së gjërave: ndryshimi ndërmjet tyre është ndryshimi midis asaj që është absolutisht e domosdoshme dhe midis asaj që është e paimagjinueshme. Lehtësia që vjen prej të parës është deri në atë shkallë që e bën ekzistencën e gjërave të domosdoshme, ndërsa vështirësia që del prej të fundit e bën ekzistencën e gjërave të pakonceptueshme e të paimagjinueshme.

Shkurtazi: Në qoftë se ti do t'ia atribuojë ekzistencën e gjërave çfarëdo gjëje tjetër përveç Zotit të Gjithëfuqishëm, në qoftë se ti ia atribuon ekzistencën e tyre vetë gjërave, atëherë ti do të duhej të pranoje se çdo qelizë e trupit tënd të ishte prej cilësisë për të rrethuar e përfshirë të gjithë universin. Në qoftë se ti ia atribuon atë shkaqeve materiale, ndërtuesve të tjerë përveç Zotit, atëherë ti do të duhej të afirmoje e pohojë që çdo qelizë të ishte si një dhomë ku përfshihen të gjitha shkaqet operuese në univers. Sepse të gjitha qelizat janë të njëjta me njëra-tjetrën dhe shfaqin të njëjtën strukturë. Kjo njëtrajtësi - rregullsi- e qelizave të çon ty tek uniteti në larmi, tek ndërlidhja në tërësinë e universit dhe si rrjedhojë tek Uniteti i Krijuesit. Diçka e njësuar, duke shfaqur njëtrajtësi, diçka e përbërë, ku të gjitha pjesët e së cilës janë në lidhje bazë me njëra-tjetrën, nuk mund të jenë krijuar nga më shumë se Një Krijues. Si mundet një qelizë, në të cilën madje as dy krahët e një mize nuk mund të përfshihen, të përmbante shumë shkaqe materiale trupore të nevojshme për të funksionuar?

Diçka me ekzistencë të jashtme materiale është më e vërtetuar, më e qëndrueshme, më e stabilizuar dhe më e fiksuar se sa diçka vetëm me ekzistencë jomateriale, ideale. Një grimcë e vockël e të parës mund të përfshijë një mal që i përket të dytës. Për shembull, forma e reflektuar e një mali mund të përfshihet në një pasqyrë të vogël. Ndërsa, çfarëdo që ekziston në univers është e mundshme, ishte njëlloj e mundshme për të

ardhur në ekzistencë apo jo, dhe ardhja e saj në ekzistencë ishte rezultat i preferencës së Një të Vetmi, i Cili ka autoritetin absolut të preferencës. Ai i Vetëm ka një ekzistencë absolute të domosdoshme, pa të cilën do të kishte qenë e pamundur ndonjë gjë të ekzistonte. Prandaj, ajo ekzistencë e domosdoshme është më e vërtetuar, më e qëndrueshme, më stabil dhe më e fiksuar se e gjithë ekzistenca materiale. Ajo është ekzistenca reale. Ajo nuk mund të përfshihet nga ekzistenca e mundshme. Gjërat e mundshme -çfarëdo që ekziston përveç Ekzistuesit të Domosdoshëm-reflektohen në pasqyrën e Njohjes së Parapërdetshme Gjithërrethuese, ekzistenca e tyre reale konsiston në ekzistencën e tyre në atë njohje, si kuptim. Ato vijnë në ekzistencën materiale nëpërmjet manifestimit të dritave të Ekzistencës së Domosdoshme. Ekzistenca e tyre materiale në botën fizike trupore, e cila është rezultati i transferimit të tyre prej sferës së njohjes gjithëpërfshirëse, nuk mund të jenë kurrë prej të njëjtës esencë e cilësi dhe prej të njëjtës shkallë ekzistenciale si Ekzistenca Reale.

Mësoje, o shok! Ai që e shqyrton krijimin do të shohë se gjërat e forta trupore e materiale ndikohen dhe influencohen prej gjërave jomateriale ose prej gjërave të dritës. Për shembull, shikoji dritën e diellit dhe atë mal. I pari vjen prej qiellit dhe vepron në tokë lirshëm, pavarësisht masës së tij të madhe; nuk mund të bëjë asgjë, as nuk mund të ketë asnjë ndikim mbi mjedisin e tij. Sa më e hollë dhe prej më shumë drite të jetë diçka, aq më efektive dhe më aktive është, ndërsa sa më materiale dhe e ngurtë të jetë, aq më e prekshme do të ishte dhe e ndjeshme për t'u ndikuar e influencuar. Ne mund të konkludojmë prej kësaj se Krijuesi i shkaqeve dhe i pasojave është Ai i Cili është Drita e dritave.

لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ
لَا تُدْرِكُهُ الْأَبْصَارُ وَهُوَ يُدْرِكُ الْأَبْصَارَ وَهُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ

"Asgjë nuk i përngjet Atij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi".⁵³

"Asnjë shikim nuk mund ta kapë Atë (si është etj..) por, Ai i kap të gjitha shikimet, Ai është mbi çdo shikim. Dhe Ai është më i Mprehti, më i Buti, dhe në dijeni të plotë për çdo gjë".⁵⁴

⁵³Kur'an, 42:11

⁵⁴Kur'an, 6:103

Mësoje, o shok! Reflektimi mbi krijimin, mbi shenjat e Zotit në univers është si dritë; ajo e largon ose e shkrin pakujdesinë e ngrirë dhe mungesën e vetëdijes (për Zotin). Të qëniet i kujdesshëm dhe i vëmendshëm është si zjarri. Ajo i djeg dokrrat dhe kotësitat e thata të dyshimeve dhe skepticizmit ndaj Tij. Por, kur ti reflekton mbi veten tënde, mbi botën tënde të brendshme, mbi botën e ndjenjave të tua, emocioneve, aftësive dhe mbi ndërgjegjjen tënde, reflekto aq thellë dhe në aq shumë detaje aq sa të mundesh, ashtu siç e kërkon Emri Hyjnor ‘*El-Batīnu*’, ‘*I Brendshmi, I Padukshmi*’. Sepse plotësia e një arti e shfaq vetveten në detaje dhe degëzime.

Kur ti reflekton mbi botën e jashtme, reflekto mbi të shkurtazi dhe përciptas pa hyrë në detaje. Është e mjaftueshme për ty të kuptosh themelet mbi të cilat bazohet ajo botë. Kjo është ajo që kërkon Emri Hyjnor *Edh-Dhahir*, ‘*I Jashtmi, I Dukshmi*’. Sepse shkëlqimi i një arti bëhet më i dukshëm, më i bukur e më i shkëlqyer kur shikohet e shqyrtohet si një tërësi, dhe bota e jashtme është tepër e shtrirë. Në qoftë se zhytesh në të, meqenëse ajo nuk ka brigje, ti mund të mbytesh.

Në qoftë se futesh thellë në botën tënde të brendshme, por bën një udhëtim të shkurtër e të shpejtë në botën e jashtme, ti mund t’i afrosh Unitetit. Pjesët individuale kërkojnë tërësinë, komplekset kërkojnë përbërës dhe përbërësit bëhen të njësuar, të bashkuar; dhe prej kësaj del drita e bindjes së Unitetit.

Kur ti vepron ndryshe, domethënë, kur ti bën një shqyrtim të shkurtër e sipërfaqësor të botës tënde të brendshme ndërsa hyn në detaje në udhëtimin tënd në botën e jashtme, atëherë diversiteti – larmia- e gjërave të hedh në konfuzion dhe shkakton dyshime tek ti. Egoizmi yt forcohet dhe pakujdesia bëhet e ngulitur në ty. Atëherë, ti je i prirur drejt natyralizmit. Kjo është rruga që të çon prej larmisë së gjërave për në çudhëzim.

اللَّهُمَّ لَا تَجْعَلْنَا مِنَ الضَّالِّينَ آمِينَ

O Zot! Mos na përfshij neve midis të ç’udhëzuarve! Amin.

Mësoje, o shok! Rrëfëhet se kur një njeri lëviz me lakmi, rëzku – furnizimi– i tij ndalon. Kur ai ndalon duke shfaqur lakmi, rëzku i tij lëviz. Kjo është për të shpjeguar një të vërtetë shumë të thellë. Shikoji pemët: ato qëndrojnë të palëvizshme në vendet e tyre dhe rëzku –

furnizimi– u vjen atyre. Ndërsa, meqenëse kafshët lëvizin me lakmi, rëzku i tyre qëndron i palëvizshëm në kërcellet e bimëve. Me të gjitha ngjyrat dhe erërat e saj të ndryshme, një bimë i fton kafshët e uritura dhe i nxit ato të lëvizin prej saj.

Mësoje, o shok! Sa injorant është njeriu i pakujdesshëm, sa i çudhëzuar është ai dhe sa i dëmshëm është ai për vetveten! Ai braktis një mirësi të madhe prej frikës së ekzistencës së një dëmi që ai mund të vuajë me një mundësi një në dhjetë. Nga ana tjetër, ndërsa ndodhen mijëra prova për të vërtetën e saj, ai braktis udhëzimin e vërtetë për një dyshim të vogël dhe si rrjedhojë bie në çudhëzim. Njeriu është një qenie aq e kujdesshme sa që do ta braktiste një gjë, mundësia e së cilës për t'i bërë dëm është një në dhjetë. Atëherë, si është që ai nuk heq dorë prej një gjëje që është nëntëdhjetë e nëntë përqind e sigurt që do t'i japë atij dëmin më të madh në Ahiret?

Mësoje, o shok! Shpirti i njeriut ka nevoja të pafundme dhe vuan prej dhimbjeve të pafundme, dhe ai ka një oreks –dëshirë– për kënaqësi të pafundme dhe ushqen ambicie të pafundme. Madje, edhe dhembshuria me çudhëzimin e zemrës përmban dhimbje të pafundme (për shkak të mosbesimit të saj në Zotin dhe për mosbesimin e saj në Kaderin dhe Mëshirën e Tij). Prandaj, ti nuk mund të thuash: “çila është vlere ime dhe çfarë vlere kam unë që Zoti do ta shkatërrojë këtë botë për ta rindërtuar atë dhe për të më gjykuar mua atje?”

O njeri i çudhëzuar e dyshues! Mos u mashtro në këtë botë! Kënaqësia që ti merr në të varet nga një argument çudhëzues. Një njeri i çudhëzuar, i cili është dyshues rreth ekzistencës së jetës tjetër dhe tmerrohet për qënien i vdekshëm, i përkohshëm dhe që frikësohet nga mendimi i zhdukjes së përhershme, mund të kërkojë qetësi në mundësinë se ndodhet lumturi e përvetshme në botën tjetër. Por, kur ai ndjehet i obliguar për të kryer detyrat fetare, atëherë ai kërkon qetësim në mundësinë se nuk ndodhet botë tjetër ku njerëzit do të thirren për të dhënë llogari për atë çfarë ata bëjnë në këtë botë. Kështu, ai kërkon t'u ikë të dyja llojeve të dhimbjeve. Por, në një kohë të afërt, problemi do të zgjidhet dhe e vërteta do të shfaqet. Ndërsa alternativa e parë e hedh atë përnjëherësh në dhimbjet e grumbulluara, dhe jo t'ia pakësojë ato, po ashtu edhe alternativa e dytë i shkakton atij përballjet me torturat e Ferrit.

Ai gjithashtu e ngushëllon vetveten për një kohë të kufizuar me mendimin: fatkeqësia e ardhshme (vdekja dhe dënimi që vijon) do t'i përfshijë të gjithë njerëzit. Kështu, meqenëse unë do të jem si çdokush tjetër, unë nuk shqetësohem. Por, kur koha e saj -e vdekjes- vjen së shpejti, dhimbjet e tij shtohen përpjestimisht me numrin e të sprovuarve, të goditurve. Përveç vetes së tij, ai ndjen gjithashtu dhimbjet për të afërmit e tij dhe për miqtë e shokët. Meqenëse njeriu ndjen lidhje të bashkëlindura me njerëzit e tjerë, përgjithësimi i fatkeqësisë u shkakton dhimbjeve të tij veçse të shtohen.

O njeri i pakujdesshëm e dyshues! Mos e mendo atë që ti e shijon në pakujdesi e dyshime si një kënaqësi reale, përkundrazi, ndodhen dhimbje të rënda të grumbulluara në të. Ata do të të sulmojnë ty përnjëherësh dhe do të shfaqen si torturat e Ferrit. Në qoftë se ti dëshiron që këto dhimbje të bëhen kënaqësi të ripërtërira për ty dhe që zjarri të ndryshohet në dritë, braktise mburrjen dhe përkulu dhe bëj sexhde para Zotit me nënshttrim pesë herë në ditë. Ji kështu i përlur para Zotit që 'tryeza' e kriterit Hyjnor -Kur'anit- të zbresë me dritë dhe dhurata të besimit. Gjithashtu, vazhdo e ngulmo në reflektim mbi vërsetet e Kuranit dhe mbi fenomenin 'natyral' dhe në praktikimin e detyrave të tua të adhurimit në mënyrë të rregullt. Kështu, perdja e dyshimit dhe e pakujdesisë të mund të digjet dhe shija e ëmbël e qënies i shpëtuar prej hidhësisë së çudhëzimit të mund të shfaqet dhe kënaqësia e lutjes ndaj Zotit të Gjithëfuqishëm të duket.

Mësoje, o shok! Robëria ndaj Zotit të Gjithëfuqishëm kërkon nënshttrim. Një njeri nuk mund ta testojë Zotin (nëse Ai do ta përmbushë testimin e Tij). Zoti ka të drejtë ta testojë robin e Tij, dhe jo robi Zotin e tij.

Mësoje, o shok! Sferat e Emrave Hyjnorë *El-Batinu* dhe *Edh-Dhahiru*, 'i Padukshmi', 'i Dukshmi', janë edhe brenda, edhe përballë njëri-tjetrit. Ata që e kufizojnë vetveten tek i dyti, duke e kërkuar Atë vetëm në natyrë, nuk mund t'i ikin shoqërimit të ortakëve me Zotin duke ia atribuuar shkaqeve dhe natyrës kijueshmërinë dhe efektin krijues. Kurse ata që kërkojnë ta arrijnë Atë vetëm në dritën e të parit, nuk mund t'u ikin besimeve të rreme të atribuimit për Zotin ndarje e bashkim (me disa qënie njerëzore). Sepse imazhet e diellit në gjërat e tejdukshme mbajnë atributet e diellit dhe si rrjedhojë mund ta çojnë dikë të paaftë për të dalluar midis diellit dhe imazheve të tij ta

supozonte secilin prej imazheve të tij si vetë diellin. Gjithashtu, e ngjashme me këtë, ai që kërkon të arrijë tek Zoti vetëm në dritën e Emrit Hyjnor ‘*El-Batinu*’, ‘*i Padukshmi*’, mund të ngatërrojë manifestimet e Zotit në veten e tij, në zemrën e tij dhe në shqisët dhe në aftësitë e tjera të brendshme me vetë Zotin. Kjo mund ta çojë atë ta shohë veten si mishërimi –trupëzimi– i Zotit. Shëmbëllimet e atyre që e kufizojnë vetveten tek Emri Hyjnor ‘*Edh-Dhahir*’, ‘*i Dukshmi*’ dhe e atyre që kufizohen tek Emri Hyjnor ‘*El-Batinu*’, ‘*i Padukshmi*’ janë si ata të cilët përkatësisht ndjekin vetëm interpretimin sipërfaqësor të Kuranit dhe refuzojnë sunnetin, dhe si ata që ndjekin vetëm interpretimin ezoterik –të fshehtë– të Islamit.

Ndërsa, Islami është rruga e drejtë, rruga e mesme.

فَيَا مُنْزَلَ الْقُرْآنِ بِحَقِّ الْقُرْآنِ إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ
 آمِينَ

O Shpallësi i Kuranit! Për hir të Kuranit, na udhëzo neve në Rrugën e Drejtë. Amin. Amin. Amin.

زَهْرَةٌ مِنْ رِيَاضِ الْقُرْآنِ الْحَكِيمِ

Një lule

Prej Kopshtit të Kur'anit të Gjithurtë.

Çdo krijesë e gjallë në botë është si një ushtar i rregullt që punon për llogari të mbretit dhe në emrin e tij. Kushdo që e supozon vetveten si zotin e tij zbulohet para zhdukjes.

Rregulli absolut dhe balanca e vëzhguar në univers janë dy titujt e dy parimeve të të Gjithëmëshirshmit dhe dy kapituj prej librit të qartë dhe prej librit të universit.

Kurani është shpjguesi dhe interpretuesi i këtyre dy librave, indeksi i dy kapitujve dhe përmbledhja e thukët e dy parimeve.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
الْحَمْدُ لِلَّهِ الْحَاكِمِ الْحَكِيمِ الْأَزَلِيِّ الَّذِي نَظَّمَ هَذِهِ
الْكَائِنَاتِ تَقْوَانِ بَعَادَتِهِ وَسُنَّتِهِ وَعَيْنَهَا بَدَسَاتِيرُ قَضَائِهِ وَقَدَرُ هُوَ أَسَسُ بُنْيَانِهِ
أَبْأَصُولٍ مَشِيئَتِهِ وَحِكْمَتِهِ وَرِيَّتُهَا بِنَوَامِيسِ عِنَايَتِهِ وَرَحْمَتِهِ
وَنُورِهَا بِجَلْوَاتِ أَسْمَائِهِ وَبِتَجَلِّيَاتِ صِفَاتِهِ وَهُوَ الْقَادِرُ الْقَيُّومُ
السَّرْمَدِيُّ الَّذِي مَا هَذِهِ
الْكَائِنَاتُ بِمَا هِيَ أَيْهَا وَهُوَ يَأْتِيهَا وَتَمَائِرُ أَيْهَا وَتَرْتِيبَاتُهَا وَمَوَازِينُهَا وَمَحَاسِنُهَا
إِلَّا الْخُطُوطُ قَلَمُ قَضَائِهِ هُوَ نُقُوشُ بَرَكَارِ عِلْمِهِ وَحِكْمَتِهِ
وَتَرْتِيبَاتُ يَدَيْ بَيْضَاءِ صُنْعِهِ عِنَايَتِهِ وَأَزَاهِيرُ رِيَاضِ لُطْفِهِ وَكَرَمِهِ

وَتَمَرَاتٌ فَيَاضَ رَحْمَتِهِ وَ نِعْمَتِهِ وَلَمَعَاتُ تَجَلِّيَاتِ جَمَالِهِ وَ كَمَالِهِ
 جَلَّ جَلَالُهُ حَمْدًا يَزِيدُ عَلَاضِرَ بِجَمِيعِ الدَّرَاتِ فَبِالدَّرَاتِ ۞ فَيَا مَنْ
 بِنَلْنُلُو لَمَعَاتِ بُرُوقِ شُرُوقِ أَسْمَائِهِ ظَهَرَ جَانِبَ الْمَخْلُوقَاتِ وَيَا
 مَنْ تَسَاوَى بِالنِّسْبَةِ إِلَى قُدْرَتِهِ الدَّرَاتُ وَالسِّيَّارَاتُ وَيَا مَنْ كَتَبَ
 عَلَى مِسْطَرِ الْكِتَابِ الْمُبِينِ الْمَصْدَرَ لِنِظَامِ وَالْمِيزَانَ هَذِهِ
 الْكَائِنَاتِ الْمُتَرَيِّنَاتِ إِنَّا نَقَدِّمُ إِلَيْكَ بَيْنَ يَدَيْ كُلِّ سُكُونٍ وَحَرَكَةٍ
 تَتَحَرَّكُ بِهَا ذَرَّاتُ الْعَالَمِ وَمُرَكَّبَاتُهَا شَهَادَةٌ نَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ
 وَحَدِّكَ لَا شَرِيكَ لَكَ وَنَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُكَ وَرَسُولُكَ أَرْسَلْتَهُ
 رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ ۞

اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَيْهِ وَعَلَىٰ هَوَ صَحْبِهِ بَعْدَ جَمِيعِ الْخُرُوفَاتِ الْمَتَشَكِّلَةِ
 فَبِالْكَلِمَاتِ الْمُتَمَثِّلَةِ بِإِذْنِكُمْ مَرَايَا تَمْوجَاتِ الْهَوَاءِ عِنْدَ قِرَاءَةِ كُلِّ
 كَلِمَةٍ مِّنَ الْقُرْآنِ مِنْكُنَّا نُرْوِي لِيَوْمِ النُّشُورِ ۞

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi Zotit, Sunduesit të Gjithhurtë të Parapërdjetshëm, i Cili e ka rregulluar dhe organizuar këtë univers me ligjet e mënyrës së Tij të të vepruarit, duke i dhënë një trajtë e një formë të caktuar me parimet e vendimit dhe kaderit të Tij. Ai e ka ndërtuar atë me rregullat e vullnetit dhe urtësisë së Tij; e ka zbukuruar atë me standartet e përkujdesjes dhe mëshirës së Tij, dhe e ka ndriçuar atë me manifestimet e Emrave dhe Atributeve të Tij. Ai është i Plotëfuqishmi, Vetekzistuesi i Përhershëm, i Amshuari, saqë ky univers me të gjitha veçoritë dhe tiparet e tij të jashtme e të brendshme dhe me të gjitha përmbajtjet, zbukurimet dhe bukuritë janë veçse rreshtat e penës së vendimit dhe kaderit të Tij. Janë skalitjet dhe vizatimet e kompasit të njohjes dhe urtësisë së Tij dhe zbukurimet e “Dorës së Ndritur” të artit të Tij. Universi përbëhet nga lulet e kopshteve të mirësisë dhe dorëgjërësisë së Tij, nga frutet e mëshirës dhe mirëbërësisë së Tij vërshuese, dhe nga shkrepitmat e manifestimeve të bukurisë dhe plotësisë së Tij absolute; lavdia e Tij qoftë e lartësuar. Lavdia qoftë për Të sa numri i të gjitha grimcave në tërësinë e universit të shumëzuara me vetë grimcat.

O Ti që i ke shfaqur të gjitha ato krijesa të mrekullueshme nëpërmjet manifestimit si shkrepitima të Emrave të Tu!

O Ti që në lidhje me fuqinë Tënde grimcat e vockëla dhe planetet janë të njëjta (në krijim e në drejtim)!

O Ti që i ke skalitur të gjitha ato botëra të stolisura në përputhje me masat e Librit të Quartë – burimi i rregullit dhe i balancës!

Para çdo ndalese e fillimi, me të cilat të gjitha grimcat dhe përbërjet e universit nisin të lëvizin, ne japim për Ty dëshminë e besimit: ne dëshmojnë se nuk ka zot tjetër, Ti je Një i Vetëm pa asnjë lloj partneri; ne gjithashtu dëshmojmë se Muhammedi a.s.m është shërbëtori dhe profeti Yt, të cilin Ti e dërgove si një mëshirë për të gjitha botët.

O Zot! Jepi paqë e bekime atij, familjes së tij dhe sahabëve të tij sa numri i shkronjave të fjalëve të Kuranit të përfaqësuara me lejen Tënde në pasqyrat e molekulave të ajrit gjatë recitimit të tyre nga çdo recitues, prej ditës së parë të shpalljes së tij gjer në Ditën e Ringjalljes!

Mësoje, o Said i mjerë! Çfarëdo që arrin tek ti me emrin e mbijetesës, arrin tek ti ose si rezultat i zgjedhjes së ndonjë tjetri, ose pa ndërhyrjen e asnjë zgjedhjeje të lirë. Çfarë vjen tek ti pa ndërhyrjen e ndonjë zgjedhjeje e vullneti, vjen në Emrin e Zotit dhe për hir të Tij. Merre ti atë dhe ‘haje’ duke thënë *Bismil-lah, me Emrin e Allahut* duke ia ofruar falënderimet e tua ekskluzivisht Atij xh.sh.. Sa për atë që vjen tek ti si rezultat i ndonjë zgjedhjeje, mos e merr dhe mos e ‘ha’ atë mbi të cilën nuk është përmendur Emri i Allahut. Mos e ha atë e cila të jepet ty pa e përmendur ose pa marrë parasysht Pronarin e saj real dhe pa drejtuar mendjen tënde drejt Tij, ashtu siç aludohet në vërsetin:

وَلَا تَأْكُلُوا مِمَّا لَمْ يُذْكَرِ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ

*“Mos hani nga ai (mishi) mbi të cilin nuk është përmendur Emri i Allahut”.*⁵⁵

⁵⁵Kur’an, 6:121

Megjithatë, në qoftë se ai nuk e ka përmendur Emrin e Zotit, atëherë përmende ti dhe shiko të Vetmin, i Cili ia ka dhuruar atë atij (i cili ta jep atë ty) dhe ty. Shiko aktin e dhurimit në atë çfarë dhurohet dhe Dhuruesin e vërtetë në aktin e dhurimit. Një shikim i tillë do të thotë dhënie falënderimi. Pastaj, në qoftë se ti do të doje, ti mund ta falënderosh atë i cili ka qenë një mjet për atë gjë që të arrijë tek ti, meqë ajo të erdhi nëpërmjet tij. Por kujdes, o zemra ime! Kujdes se para së gjithash ti duhet të shikosh Dhuruesin e vërtetë.

Shkurtazi: Ti duhet ta përmendësh *Bismil-lah* dy herë mbi atë që të vjen nëpërmjet dikujt tjetër dhe një herë mbi tjetrën – mbi atë që të vjen nëpërmjet askujt.

Ruhu, o nefsi im! Kujdes që të mos e marrësh mjetin për një shkak real. Duke parë se ndonjë mirësi të vjen ty si rezultat i aktit të dikujt, shikimi yt i mangët e supozon atë akt të jetë shkak real për ardhjen e asaj mirësie tek ti. Jo, ruhu, kujdes nga bërja e mungesës së një mirësie tek mungesa e gjësë një tregues se ekzistenca e asaj gjëje është shkak i ekzistencës së asaj mirësie. Ndërsa sipas mënyrës së veprimit të Allahut, ose praktikës së Tij, mungesa e madje edhe njërit prej kushteve ose pjesëve, ose shkaqeve të domosdoshme për ekzistencën e diçkaje rezulton në mungesën e asaj gjëje, ekzistenca e saj varet nga ekzistenca e të gjitha atyre kushteve, ose pjesëve, ose shkaqeve.

Kështu, a do të ishte e drejtë që në qoftë se dikush, detyra e të cilit është të hapë e të mbyllë rubinetin kryesor të kanalit ujitës të një kopështi ku prodhohen shumë bimë, të pretendojë që ai është autori i vërtetë dhe pronari i të gjitha atyre bimëve? Ky është një kriter për të kuptuar shkallët e gafletit (pavëmëndshmërisë dhe harresës ndaj Autorit e Pronarit real) dhe shirkut të fshehur (të përshkruarit ortakë me Të) pa dashje.

Kujdes, o zemra ime! Kujdes që të mos ia atribuosh ndonjë vepër apo produkt që rezulton prej përpjekjes kolektive të një komuniteti të tërë vetes tënde apo ndonjë tjetri, i cili përfaqëson atë komunitet, apo liderit të saj ose udhëzuesit. Një atribuim i tillë është një gabim i madh që do ta çonte atë të cilit i atribuohet vepra në mburrje të madhe dhe në një arrogancë e egoizëm të tmerrshëm. Kjo do të hapte derën për një lloj të shirkut të fshehtë të përshkrimit ortakë me Zotin pa dashje. Mjeti merret për bërësin dhe si rrjedhojë bëhet ai që kërkohet dhe synohet dhe ‘derëtari’ shfaqet në formën e mbretit.

Kujdes, përsëri kujdes kur ti sheh se ndonjë vështrim prej rrezatimit shpirtëror të arrin ty nëpërmjet dikujt, ti nuk duhet ta supozosh atë si burimin apo baza e atij rrezatimi. Ajo që ai bën është vetëm një reflektim (si një pasqyrë) i asaj që shfaqet në të. Por devocioni yt ndaj tij të bën ty të imagjinosh se ajo që vërshon tek zemra jote prej Drejtuesit të zemrave merret së pari nga lideri yt shpirtëror dhe pastaj reflektohet tek ti. Ti i ngjason dikujt, i cili e fikson shikimin e vetëm mbi një copë xhami dhe pas një kohe përqëndrimi, fillon të udhëtojë në botën e simboleve, të shëmbëllesës ose formave jolëndore, dhe shikon ca çudira dhe mendon se ato realisht shfaqen ose manifestohen në xham – pasqyrë. Jo!

Mësoje, o ti që kërkon ndihmë prej shkaqeve (materiale ose natyrore)! Ti po përdor një rrugë të gabuar dhe ti po bën një kërkesë të gabuar, si dikush i cili supozon peshën e fituar – e shtuar – për shkak të një sëmundje, të jetë një shenjë e shëndetit të mirë.

Imagjino që ti shikon një ndërtesë të çuditshme, një pallat të bërë prej xhevahirësh të ndryshëm të mrekullueshëm, disa prej të cilëve, në kohën e ndërtimit, mund të gjenden vetëm në Kinë, disa të tjerë vetëm në Marok dhe disa të tjerë në Jemen, dhe akoma disa të tjerë në Siberi, dhe kështu me rradhë. A nuk do të dëshmoje ti se vetëm Ai që e dominon të gjithë botën dhe çdo gjë që Ai dëshiron të ketë sjellur nga çdo anë e botës pikërisht në kohë nevoje –se vetëm Ai– mund ta ndërtojë atë pallat?

Pikërisht, në këtë mënyrë, çdo qenie e gjallë është si një ndërtesë dhe çdo kafshë është si një pallat Hyjnor. Veçanërisht njeriu është më i bukuri dhe më i mrekullueshmi i atyre pallateve –xhevahirët, grimcat ose atomet– e të cilit janë grumbulluar së bashku prej shumë botërave, botës së shpirttrave, botës së simboleve, prej *Leuhi Mahfudhit* (Pllakës së Ruajtur) dhe prej botërave të ajrit, ujit, tokës, dritës dhe zjarrit. Sfera e nevojave të njeriut shtrihet deri në përjetësi, dhe dëshirat e tij rrethojnë qiejt e tokën. Ai ka lidhje me çfarëdo që përfshihet në sferat e dynjasë dhe të Ahiretit. Prandaj, o njeri! Nuk të përshtatet, as nuk ke të drejtë që ti që e gjykon veten si njeri, t'i lutesh dhe të adhurosh tjetër kënd përveç Atij, i Cili dominon tokën dhe i Cili mban frerët e dynjasë dhe të Ahiretit!

Mësoje, o zemra ime! Njeriu më idiot është ai që nuk e sheh diellin ndërsa sheh imazhet e tij në një pasqyrë, dhe do vetëm pasqyrën dhe

përpiqet ta ruajë atë me pasion me synimin për t'u mbajtur e kapur me diellin përjetësisht. Por, në qoftë se ai do ta kuptonte se dielli nuk zhduket me zhdukjen e pasqyrës, dhe as nuk asgjësohet me thyerjen e saj, ai do ta drejtonte të gjithë dashurinë e tij tek vetë dielli. Sepse, ajo çfarë ai shikon në pasqyrë nuk varet nga pasqyra për vazhdimësinë e saj, por vazhdimësia – qëndrueshmëria – e pasqyrës varet tek vetë ajo, ndërsa ajo ekziston nga vetvetja. Qëndrueshmëria e 'gjallërisë' së pasqyrës dhe shndritja e saj (me diellin në të) janë të mundshme nëpërmjet qëndrueshmërisë së manifestimeve të diellit dhe qënies së pasqyrës përballë diellit.

Kështu, zemra jote është si ajo pasqyrë, dhe dashuria për qëndrueshmëri e ngulitur në natyrën tënde duhet të drejtohet jo tek vetë ajo, por tek ajo që shfaqet në të. Prandaj, thuaj: يَا بَاقِي أَنْتَ الْبَاقِي “O i Qëndrueshmi i Vetëm, Ti je i Qëndrueshmi i Vetëm” dhe kthehu drejt Tij me qëllim që të bëhesh i qëndrueshëm. Atëherë, vdekshmëria le të bëjë çfarë të dojë me ne, ne nuk shqetësohemi për çfarëdo që na bie.

Mësoje, o njeri! Njëra prej veçorive më të çuditshme që Krijuesi i Gjithurtë ka ngulitur në natyrën tënde është se dynjaja nuk të nxë, saqë ti thua “uff” si i burgosuri të cilit i zihet fryma, ndonëse ty të përthith e të zë një gjë aq e vogël sa një farë sinapi, ose një qelizë, ose një kujtesë, ose një minut saqë ti asgjësohesh në to dhe me pasion i përdor ndjenjat e tua për to. Krijuesi të ka dhënë ty aftësi të tilla saqë disa prej tyre nuk do të ngopeshin madje edhe sikur ato të gëlltisnin të gjithë botën. Disa të tjera mërzhiten madje edhe me gjënë më të vogël si grimca më e vockël dhe nuk mund të mbajnë edhe një qime, ashtu si syri që nuk mund të mbajë e të durojë as edhe një qime.

Prandaj, ruhu dhe ji i kujdesshëm në veprat e tua. Frikësohu se mos shkatërrohesh e mbytesh dhe të shkatërroje dhe aftësitë e tua më të holla për shkak të një kafshate ose të një fjale, ose në një shikim, ose në një shenjë apo në një puthje. Sepse çdo gjë ka një aspekt (të lidhur me mosekzistencën) të tillë që mund të të shkatërrojë e të të gëlltisë ty. Shiko pasqyrën në dorën tënde dhe shiko se si qielli përfshihet në të me të gjithë yjet e tij. Shiko se si ‘i Vërteti’ shkruan në kujtesën tënde, e cila nuk është më e madhe se masa e një fare sinapi, shumicën e vepreve dhe akteve të tua dhe madje shumicën e jetës tënde.

Lavdi Atij, të Plotëfuqishmit, Vetekzistuesit të Përhershëm!

Mësoje o shok! Bota jote private është si një shtëpi e ngushtë si varri. Por, meqenëse muret e saj janë bërë prej ‘xhami’, ti e sheh atë aq të shrirë sa shtrirja e shikimit tënd. Lidhur me dimensionin material të jetës së kësaj bote, e shkuara ka ikur, ndërsa e ardhmja nuk ekziston. Por, duke qenë muret e botës tënde si dy pasqyra përballë njëra–tjetrës, ato vijjnë bashkarisht në çastin e kohës tënde të tashme, dhe e bëjnë të vështirë atë për ty për të dalluar midis reales dhe të reflektuarës në to. ‘Linja’ e të tashmes tënde shtrihet në të shkuarën dhe në të ardhmen tënde dhe bëhet një sipërfaqe, një hapësirë. Kur ti bëhesh të lëvizësh prej fatkeqësive, ti e përplas kokën tënde tek muret, duke vuajtur zhgënjimet në imagjinatën tënde dhe duke humbur gjumin. Ti e sheh botën tënde më të ngushtë se sa një varr dhe një urë, dhe jeta jote lëviz më shpejt se një lum dhe madje më shpejt se sa vetëtimat.

Mësoje, o ti që dëshiron t’i shohësh dëshmitë e manifestimeve të Emrit Hyjnor *El –Hafidhu, Gjithëruajtësi*, për të cilin aludohet në vërsetet:

فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ ❁ وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ
وَمَا يَعْزُبُ عَنْ رَبِّكَ مِنْ مِثْقَالِ ذَرَّةٍ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاءِ
وَلَا أَصْغَرَ مِنْ ذَلِكَ وَلَا أَكْبَرَ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ

“Kësisoj, kushdo që bën mirësi sa një thërrmijë qoftë, do ta shohë atë. Dhe kushdo që bën keq sa një thërrmijë qoftë, do ta shohë atë”⁵⁶

“Dhe asgjë nuk i fshihet Zotit tënd qoftë sa një atom në tokë a në qiell qoftë, dhe as çfarë është më i vogël se ai dhe as çfarë është më i madh, veçse shkruhet në Librin e Qartë”⁵⁷

O ti që dëshiron t’i shohësh ato dëshmi në fletët e librit të universit, i cili është i shkruar sipas standarteve të Librit të Qartë!⁵⁸ Merr një grusht farërash prej lulesh e pemësh të ndryshme. Megjithëse ato u përkasin specieve të ndryshme dhe janë prej veçorive të ndryshme, ato janë aq në formë e trajtë saqë ti pothuajse je i pamundur për ta dalluar

⁵⁶Kur’an, 99:7-8

⁵⁷Kur’an, 10:61

⁵⁸Për Regjistrin e Qartë dhe Librin e Qartë shiko tek Sözler, faqja 816.

njërën prej tjetrës. Pastaj, groposi ato së bashku në errësirë –në errësirën e dheut– të thjeshtë e të kufizuar. Pastaj, vaditi me ujë, ujë që nuk ka as masë dhe as standarte për t’i njohur e për t’i dalluar, dhe në çfarëdo drejtimi ta shpërndash, shkon. Pastaj, shikoji ato në kohën e ringjalljes vjetore kur e gjithë natyra vjen përsëri në jetë nëpërmjet fryrjes së ‘Surit’ të rrufesë në pranverë. Shiko se si ato farëra të përziera duke i ngjasuar njëra–tjetrës u janë bindur urdhërave të krijimit të dhëna prej Krijuesit të tyre të Gjithurtë dhe të rritura secila në një lule a pemë të ndryshme në një mënyrë për të manifestuar plotësinë e urtësisë së Tij, njohjes, dëshirës, qëllimit, dallueshmërisë dhe të vetëdijes.

A nuk e shikoni ju se si të gjitha ato gjëra të ngjashme u dalluan saqë kjo pemë fiku shtrihet mbi kokat tuaja? Sa i shkëlqyer është Zoti i saj! A nuk i shikon se ato lule janë zbukuruar për ju dhe ju buzëqeshin duke u bërë të dashura për ju? A nuk i shikon se ato fruta duke mprehur oreksin tuaj ju bëjnë ftesë për tek vetvetja e tyre dhe i sakrifikojnë vetvetet për ju? Kjo dorë – farërash – është ndryshuar me lejen e Krijuesit të saj në një kopësht plot lule e pemë të ndryshme. Vështro nëse ti mund të shohësh ndonjë gabim apo defekt!

فَأَرْجِعِ الْبَصَرَ هَلْ تَرَى مِنْ فُطُورٍ

“Ktheje pra shikimin tënd përsëri. A mund të shohësh ndonjë të çarë?”⁵⁹

Përkundrazi, Gjithëruajtësi, *El-Hafidhu* i ka dhënë çdonjërës prej tyre ekzaktësisht dhe plotësisht atë çfarë i kaloi mbi të prej pasurisë së prindërve të saj. I Vetmi që e bën këtë është Ai i Cili është në gjendje ta shkatërrojë universin dhe ta rindërtojë atë në Ditën e Fundit. Ai i Cili e bën këtë, gjithashtu e bën edhe atë. Akti i regjistrimit të plotë dhe i ruajtjes të vëzhguara këtu, madje në gjëra të papërfillshme e kalimtare është një dëshmi e pamohueshme për regjistrimin dhe ruajtjen e gjërave të rëndësishme, efektet e të cilave shtrihen në përjetësi. Të regjistruara janë aktet dhe veprat e kalifëve –atyre të nderuar me sundimin e tokës sipas ligjeve Hyjnore– dhe aktet, dhe ligjëratat e atyre që kanë marrë amanetin më të madh, dhe veprat e mira dhe të këqijat e shërbëtorëve të Vetmit Unik.

⁵⁹Kur’an, 67:3

أَيْحَسَبُ الْإِنْسَانَ أَنْ يُتْرَكَ سُدىً

“A mendon njeriu se do të lihet i harruar (pa u ndëshkuar ose pa u shpërblyer për detyrimet e përcaktuara për të nga Zoti i tij)?”⁶⁰

Përkundrazi, ai është i detyruar të udhëtojë për në përjetësi dhe do të thirret për të dhënë llogari për çfarëdo që ai bën e thotë këtu në dynja.

Ndodhen aq shumë shembuj e analogji për aktin Hyjnor të ruajtjes dhe regjistrimit saqë ky shembull që ti e ke thurur nuk është një grusht grurë prej një grumbulli, as një grusht uji prej një oqeani, por është një kokrrizë e vetme rëre prej një shkretëtire të madhe ose një pikë uji prej shiut të qiejve. Lavdi Zotit, Gjithëruajtësit, Gjithëkontrolluesit, Gjithëdëshmuesit dhe Gjithëllogaritësit, *El-Hafidhu*, *Er-Rekibu*, *Esh-Shehidu*, *El-Hasibu*.

Mësoje, o Said i pavëmendshëm! Nuk është e denjë për ty ta lidhësh zemrën tënde mbi atë që do të të lërë ty pas fundit të shekullit tënd! Përse e lidh zemrën tënde mbi atë që nuk do të të shoqërojë gjatë udhëtimit tënd për në botën e ndërmjetme të varrit? Madje, si mund të llogarisësh atë që do të të braktisë ty përjetësisht për një ose dy vite, duke e debituar llogarinë tënde me mëkatet e saj, dhe mbi atë që të lë ty kundra dëshirës tënde pikërisht në momentin e gëzimit tënd që e arrite?

Në qoftë se ti je i ndjeshëm, mos u mërzit e mos u shqetëso për atë që nuk të shoqëron në udhëtimin tënd për në përjetësi, që zhduket në trazirat dhe tronditjet e dynjasë, në rrethanat që ndryshojnë vazhdimisht të botës së varrit dhe në revolucionet e Ahiretit. A nuk e sheh se ndodhet diçka brenda teje, e cila nuk kënaqet me asgjë përveç përjetësisë dhe të Përjetshmit dhe e cila nuk kthehet tek asgjë tjetër përveç Atij? Ajo nuk e ul veten para asgjëje përveç Atij. Ajo gjë është mbreti i aftësive të tua. Bindju atij mbretit tënd, që është i bindur ndaj urdhërit të Krijuesit të tij të Gjithurtë Xhel-le Xhelaluhu!

Mësoje! Unë e pashë veten time në një ëndërr duke u thënë njerëzve: “O njerëz! Njëri prej parimeve të Kuranit është që ti të mos konsiderosh asgjë, përveç Atij Subhanehu, më të madh se ti në një mënyrë që ti të marrësh një qëndrim adhurimi para asaj gjëje. As mos e

⁶⁰Kur’an, 75:36

konsidero veten tënde më të madhe se ndonjë gjë, në një mënyrë që ti të pretendosh dominim absolut mbi të. Cilado gjë, përveç Atij xh.sh është e barabartë me çdo gjë tjetër në largësinë e saj prej të qënurit objekt adhurimi dhe për sa kohë ka të bëjë me qënien e saj një gjë e krijuar.

Mësoje, o Said i pakujdesshëm! Ti e hedh vështrimin përreth teje dhe meqenëse ti e sheh botën përreth teje si të qëndrueshme dhe të përjetshme, ti ke iluzionin se edhe ti gjithashtu je i qëndrueshëm dhe i përherëshëm, dhe si rrjedhojë frikësohesh vetëm prej shkatërrimit përfundimtar të botës sikur ti do të jetoje deri në kohën e atij shkatërrimi. Kjo nuk është e vërtetë. Kjo dhe bota jote ekspozohet para zhdukjes dhe asgjësimit në çdo moment. Me këtë iluzion, ti je si ai në dorën e të cilit ndodhet një pasqyrë në të cilën një banesë ose një qytet ose një kopësht reflektohen. Lëvizja më e vogël e pasqyrës dhe bërja e një ndryshimi më të vogël në të shkakton një trazirë e tronditje në atë banesë apo qytet ose në atë kopësht me të cilat ai është shumë i kënaqur. Qëndrueshmëria e tyre aktuale, në dukje nuk të jep ty asnjë dobi. Sepse çfarë bie tek pjesa jote prej tyre është ajo çfarë reflekton pasqyra sipas kapacitetit të saj. Merre në konsideratë pasqyrën tënde dhe si është e mundur për të dhe për çfarë reflektohet në të, se mund të zhduken në çdo moment. Prandaj, mos e rëndo atë me çfarë nuk ka mundësi të mbajë.

Mësoje se është një praktikë e zakonshme e Kijuesit të Gjithurtë të rikthejë (në jetë përsëri) atë çfarë është e një vlere të madhe mbi epoka, mbi stinë duke u përsëritur periodikisht bashkë me ripërtëritjet në shumicën e gjërave. Kur ti i vështron llojet e ringjalljes duke ndodhur në çdo ditë, në çdo vit dhe në çdo shekull, ti e sheh këtë ligj të rregullt të vendosur. Shkencat bien dakord se njeriu është fruti i rëndësisë dhe i vlerës më të madhe. Çdo qenie individuale njerëzore është si një specie e gjallesave të tjera. Prandaj, çdo qenie njerëzore do të ringjallet në Ditën e Gjyqit me identitetin e saj të qartë, trupin, emrin dhe formën.

Mësoje, o nefsi im injorant! Çdo stacion ose pozitë ka një hije, madje ka shumë hije të ndryshme. Si mundet një hije të jetë njëlloj me origjinalin? A i përshtatet atij që sheh fronin e mbretit në ujë ose në ëndrrën e tij ose ulet mbi të, që ta supozojë veten si vetë mbretin ose si të barabartë me mbretin. Ose ai i sheh yjet në pellgun e tij dhe e supozon vetveten të jetë në qiell si dikush që është duke udhëtuar

përmes yjeve ose sipër tyre. Ai që mbështetet mbi mendjen dhe njohjen e tij në udhëtimin e tij në dimensionin e brendshëm të ekzistencës është në arrogancë të rrezikshme. Kjo është kështu sepse, megjithëse hija e tij është vetëm, njëra prej hijeve të stacionit origjinal, ai është krenar për njohjen e tij që ai ia atribuon vetëm vetvetes, ai e sheh vetveten si të krahasueshëm me pronarin real të atij stacioni. Kështu, ai bën një gabim shumë të madh për shkak të mendjemadhësisë dhe fillon të thotë me mosmirënjohje: *إِنَّمَا أُوْتِيْتُهُ عَلٰٓمِ بَلٰٓهٰی فِتْنَةً* “Ajo çfarë unë kam më është dhënë për shkak të njohurisë sime”. Përkundrazi, ajo është veçse një mjet testimi për të.

Mësoje, o shok! Frazat ose fjalitë të cilat zakonisht vijnë në fundin e vërseteve kuranore kanë lidhje, jo vetëm me ato vërsete, por gjithashtu me tërësinë e subjektit dhe çështjes së diskutuar, me tërësinë e sures dhe madje me të gjithë Kuranin. Ato i lidhin vërsetet me njëri – tjetrin, duke i shkaktuar njërit t’i kujtojë e t’i konsiderojë ato. Mos e gjyko atë çfarë pohohet prej atyre frazave nga kuptimet e vërseteve ku ato janë, as mos e kërko madhësinë e tyre vetëm aty ku ato përmenden. Për shembull,

وَكَذٰلِكَ نُوَفِّصُ الْاٰیٰتِ ۗ وَلَقَدْ صَرَّفْنَا فِيْ هٰذَا الْقُرْاٰنِ
 وَلَقَدْ صَرَّبْنَا فِيْ هٰذَا الْقُرْاٰنِ مِنْ كُلِّ مَثَلٍ ۗ
 وَاِنَّ اللّٰهَ عَزِيزٌ حَكِيْمٌ ۗ وَاِنَّ اللّٰهَ عَلِيْمٌ قَدِيْرٌ ۗ

“Në këtë mënyrë Ne i shtjellojmë ajetet në imtësi...”⁶¹

“Dhe nuk ka dyshim se Ne kemi shtjelluar –shpjeguar– në këtë Kuran...”⁶²

“Dhe sigurisht që Ne kemi paraqitur në këtë Kuran çdo lloj përngjasimi...”⁶³

⁶¹Kur’an, 7:174

⁶²Kur’an, 17:41

⁶³Kur’an, 30:58

“Vërtet Allahu është i Plotëpushtetshëm, i Gjithhurtë.”⁶⁴

“Me të vërtetë që Allahu është i Gjithëditur e i Gjithëfuqishëm.”⁶⁵

لَعَلَّكُمْ تَذَكَّرُونَ

“...Që ju të mund të përkujtoni.”⁶⁶

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“...Që ju të mund të bëheni të devotshëm.”⁶⁷

Dhe vërsete të ngjashëm me këto kanë sy që shohin shumicën e vërseteve kuranore, shumicën e shenjave të Allahut në krijim dhe kushtet e përgjithshme dhe çështjet e jetës njerëzore dhe veçoritë e humanizmit.

Ato fraza ose fjali mbyllëse –konkluduese– me të cilat përfundojnë, vulosen ajetet dhe konfirmohen, përveç mistereve të tjera të elokuencës që ato kanë, tërheqin vëmendjen e të adresuarit prej çështjeve të veçanta, të përziera, të ngatërruara e të detajuara për tek ligjet dhe të vërtetat universale dhe gjithëpërfshirëse. Dhe ato e drejtojnë vëmendjen e tij drejt synimeve dhe qëllimeve më të larta.

Mësoje, o zemra ime! Shejtani të mashtron ty duke i dhënë vëmendjes tënde atë çfarë është një shumësi e pafundme dhe kështu duke zvogëluar vlerën e mirësive që të është dhënë ty. Me qëllim që ta shpëtosh veten tënde prej këtij mashtrimi, shiko se sa i nevojshëm, dhe për sa ka të bëjë me përmbushjen e nevojave të tua, sa i pafuqishëm je ti, dhe reflekto mbi urtësinë e qëllimshme në mirësitë që të janë dhënë dhe mbi aktin e qëllimshëm të të dhënit të mirësive. Gjithashtu, ti duhet të meditosh mbi manifestimet e pakufishme të fuqisë Hyjnore, njohjes

⁶⁴Kur'an, 9:71

⁶⁵Kur'an, 16:70

⁶⁶Kur'an, 51:49

⁶⁷Kur'an, 2:185

dhe dëshirës Hyjnore, dhe mbi qëllimet për ekzistencën tënde dhe rezultatet e saj lidhur me të Vetmin Unik, i Cili të ka dhënë ty ekzistencë dhe i Cili ka në pronësi të gjithë Emrat më të bukur Hyjnorë!

Pëshpëritësi (i të këqijave) –shejtani– gjithashtu të mashtron ty duke përdorur egoizmin tënd dhe mburrjen e tmerrshme. Ai sjell tek vëmendja jote krijesat e vogëla dhe krimbat. Ai thotë: “Cila është dobia e krijimit të gjërave të këtilla që zhduken shpejt?” duke nënkuptuar se qëllimi i jetës është në vetë jetën dhe se ajo e nxjerr vlerën e saj prej qëndrueshmërisë. Ky argument të sugjeron se krijimi i atyre krijesave jetëshkurtëra është i kotë. Si rrjedhojë, ai e zvogëlon në shikimin tënd vlerën e mëshirës, të favorizimit, të përkujdesjes dhe të mjeshtërisë së përkryer artistike në atë që ti vëzhgon, duke të të bërë ty të harrosh, madje të mohosh Autorin Krijues. Përgjigju këtij mashtrimi të shejtanit duke i treguar atij qiejt me yjet dhe tokën me të gjitha gjallesat e kafshët e saj. Të krahasuara me ty, vëllimi i tyre shumë i madh do të të zgjojë ty. Kur ti shikon tek ajo që është më e vogël se ti, shiko, o qeliza më e madhe, tek qelizat e trupit tënd. Shiko se sa të mrekullueshme janë ato dhe sa në mënyrë të mahnitshme i përmbushin detyrat e tyre, dhe përsëri shiko se çfarë detyrash jetike kryejnë rruazat e bardha e të kuqe të gjakut në gjakun tënd qarkullues për sa kohë që ti qëndron në këtë vendbanim. Gjithashtu, ti mund të shikosh aftësitë e holla që burojnë nga zemra jote.

Dije, o Europë!⁶⁸ Ti ke marrë në dorën tënde të djathtë filozofinë e errët e devijuese dhe në dorën tënde të majtë civilizimin e dëmshëm e të prishur, dhe pretendon se lumturia e njerëzimit qëndron në to. U thefshin këto dy duart e tua dhe qofshin ato dhuratat e tua shkaku i vdekjes tënde!

O ti që përhap mosbesim e mosmirënjohje! A do të ishte e mundur për dikë me ndërgegjeje të prishur që vuan nga sëmundje mendore dhe

⁶⁸Kjo çështje erdhi e përmbledhur tek shtojca. Ndodhen dy ‘Europa’: Njëra është ajo, e cila duke pasë përfituar prej fesë së Isait –Jezusit a.s dhe prej civilizimit Islamik, ka shpikur e ka bërë gjëra të cilat do ta bënin njeriun të rehatuar në këtë jetë.

Tjetra është ajo që, duke u bazuar mbi filozofinë natyraliste dhe materialiste del kundra feve qiellore, dhe të këqijat e së cilës i kalojnë të mirat e të parës, dhe e cila është bërë shkaku i mjerimit dhe i vuajtjes për shumicën e njerëzimit. Këtu, unë i adresohem ‘Europës’ së dytë. Autori.

shpirtërore të ishte i lumtur vetëm pse është në kulmin e prosperitetit, me plaçka të pasura e me stoli e me rroba të shtrenjta në trupin e tij? A nuk e sheh se si, për një njeri të zhgënjyer ose që i janë këputur shpresat, duke parë madje vetëm njërën prej pritshmërive të tij të porealizuar, e ëmbëla kthehet në të thartë, kënaqësia ndryshohet në dhimbje dhe dynjaja bëhet e ngushtë? Si mundet dikush i ekspozuar para të këqijave të tua dhe i goditur në thellësitat e zemrës dhe të shpirtit të tij me çudhëzimin që ti shkakton, dhe si rrjedhojë është i zhgënjyer në të gjitha aspiratat e tij dhe është i dëshpëruar të gjejë lumturi me atë çfarë ti i ofron atij? A do të ishte e mundur të thuhet për dikë që shpirti dhe zemra e të cilit janë në xhehennem –ferr– dhe trupi i tij është në një parajsë të rreme, mashtruese e kalimtare, se ai na qenka i lumtur?

Dëgjoje, o shpirti i korruptuar dhe intrigues, atë çfarë të thuhet më poshtë! Unë do të të tregoj ty vetëm njërën prej mijëra rreziqeve dhe të telasheve që ti i ke sjellë njerëzimit. Me qëllim që ajo të bëhet e kuptueshme, unë do të të sjell një shëmbëllim.

Ndodhen dy rrugë para nesh. Së pari ne morëm dhe vështruam se në çdo hap njeriu i dobët sulmohet nga një bandë kriminelësh, të cilët e grabisin atë dhe gjërat dhe plaçkat e tij, dhe ia shkatërrojnë kasollen e tij. Ata, gjithashtu i jepnin atij goditje të tilla saqë madje edhe qiejt vajtojnë për të. Kudo që vështruam, ne pamë të njëjtën skenë ku britmat e shtypësve dhe vajtimet dhe ankesat e të shtypurve dëgjoheshin. Meqenëse njeriu ndjen dhimbje për shkak të dhimbjes së të tjerëve, ndërgegjgja e njeriut nuk mund të durojë kaq shumë padrejtësi dhe dhimbje, prandaj, ai që i dëshmon ato, për shkak të dëshpërimit dhe paaftësisë për të bërë diçka që t'i ndalojë ato, i braktis të gjitha ndjenjat njerëzore, dhe me një zemër jo më të shqetësuar për shkatërrimin e të gjithë njerëzve të tjerë për derisa ai vetë është mirë, i nënshtrohet shkallës më të skajme të mizorisë.

O Europë! Njëpërmjet gjenialitetit tënd vengërosh, me një sy, ti ia ke sjellë njerëzimit këtë gjendje të skëterrshme si një dhuratë dhe pastaj duke parë se ajo është një sëmundje e pashërueshme, ti u ke dhënë njerëzve dëfrimet, zbavitjet tërheqëse dhe fantazitë si një ilaç për t'u bërë anestezi atyre. Por, ai ilaçi yt do të jetë shkaku i vdekjes tënde.

Pastaj, ne ndoqëm rrugën tjetër dhe pamë se në çdo stacion, në çdo vend dhe në çdo qytet, ushtarët ishin duke kryer disa detyra, dhe ishin

shpërndarë në të gjitha anët e rrugët; disa oficerë vinin e i lironin prej detyrave të tyre, duke ua marrë armët dhe pajimet e tjera që ua kishte dhënë qeveria dhe duke iu dhënë ushtarëve dokumentet e lirimit. Ushtarët ishin të kënaqur me lirim e tyre dhe që po riktheheshin përsëri tek mbreti i cili i dërgoi, ndonëse nga ana e jashtme ata dukeshin të dëshpëruar për shkak se po liroheshin. Në qoftë se oficerët e mbretit hasnin një ushtar të ri, një rekrut, i cili nuk i njihte, ai rekrut u thoshte atyre: “Unë jam një ushtar i mbretit dhe në shërbim të tij. Destinacioni im përfundimtar është me të. Në qoftë se ju erdhët këtu me lejen dhe kënaqësinë e tij, jeni të mirëpritur. Përndryshe, largohuni tutje prej meje, sepse madje edhe sikur të ishit me mijëra njerëz, unë do të luftoja kundra jush, jo për veten time, por për ruajtjen e amanetit të mbretit tim dhe për mbrojtjen e nderit dhe të dinjitetit të tij mbretëror”.

Kështu, përmes rrugës sonë dhe gjatë udhëtimit tonë, ne pamë e dëshmuam trupa gjithnjë të reja të përqëndruar e të mobilizuar me gëzim e me lëvdata për mbretin –të quajtur lindje– ndërsa shumë të tjerë shkarkoheshin e liroheshin me kënaqësi e duke lavdëruar mbretin – të quajtura vdekje. Kurani i gjithurtë i ka dhënë njerëzimit një dhuratë. Në qoftë se ata do të jenë të respektuar ndaj saj dhe do ta bëjnë atë një udhëzim në udhëtimin e tyre, ata ndjekin dhe futen në këtë rrugë e dytë. Atëherë,

لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

*“As frikë nuk do të ketë mbi ta, as nuk do të pikëllohen”.*⁶⁹

O Europë! Ti pandeh se të gjitha krijesat e gjalla prej më të vogël të peshqëve për tek më i madhi i engjëjve janë zotëra mbi vetveten dhe punojnë vetëm në emrin e vetes së tyre dhe për vetë kënaqësinë e tyre. Se qëllimi i tyre i vetëm në jetë është të përpiqen për të mbijetuar. A nuk e shikon se ndodhet një ndihmë e ndërsjellë universale midis tyre, siç është vendosur e urdhëruar nga Krijuesi i tyre? Bimët u vijnë në ndihmë kafshëve, dhe kafshët u vijnë në ndihmë qenieve njerëzore. Por, ti e sheh këtë si një konflikt e si rivalitet dhe ke dalë në përfundimin se jeta konsiston në konflikt. Subhanallah! Sa e çuditshme! Si mund të jetë një konflikt e rivalitet që grimcat dhe

⁶⁹Kur'an, 10:62

atomet e të gjitha llojeve të ushqimit bëhen të nxitojnë për të ndihmuar ushqimin e qelizave të trupit? Është nëpërmjet urdhërit të Një Zoti Gjithëbujar që ndodhet një ndihmë e tillë e ndërsjellë, e cila provon se asnjë krijesë e gjallë nuk është zot i vetvetes. Kjo gjithashtu është kështu sepse:

Midis vepruesve të gjallë në botë, njeriu është më i nderuari, i pajisur me një vullnet të lirë me një fushë të gjërë aktiviteti. Pavarësisht kësaj, pjesa e tij, madje në aktet e përditshme që ai i kryen nga vullneti i lirë të tilla si të ngrënit, të folurit dhe të menduarit, është aq e vogël sa gati një në njëqind. Në qoftë se më i nderuari i krijesave i pajisur me vullnet të lirë me fushën më të gjërë të aktivitetit ka një pjesë kaq të vogël në pronësi dhe një sundim mbi vetveten, ti mund të krahasosh se deri në çfarë shkalle mund të pretendojnë kafshët e tjera dhe gjërat e pajeta të jenë zot mbi vetvetet.

O Europë! Ajo çfarë të bën ty të biesh në një gabim të tillë, është gjenialiteti yt me një sy që të ka çuar ty të harrosh Zotin tënd – Krijuesin e gjithçkaje. Si rrjedhojë, e mbështetur mbi një iluzion rreth natyrës, ti ua atribuon të gjitha gjërat dhe aktet në univers shkaqeve – materiale– dhe e ndan atë, që realisht i përket Zotit, midis ‘pretenduesve’ të rremë për Hyjni. Kjo e detyron njeriun dhe të gjitha qëniet e gjalla të luftojnë me armiq e hasëm të panumërt për të përmbushur nevojat e tyre të pafundme nëpërmjet një fuqie sa pesha e një atomi, një kapaciteti dëshire sa një qime floku, një vetëdije si një dritë e dobët që zhduket, dhe me një jetë si një shkëndijë e vogël që shuhet shpejt. Çfarëdo që ata kanë (në emrin e fuqisë, dëshirës, vetëdijes dhe jetës), nuk është e mjaftueshme për përmbushjen e madje të vetëm njërës prej nevojave të tyre. Kur atyre u bie një fatkeqësi, ata kërkojnë ndihmë prej shkaqeve të shurdhëta e të verbëra;

وَمَا دُعَاءُ الْكَافِرِينَ إِلَّا فِي ضَلَالٍ

*“Dhe thirrja –lutja– e mohuesve nuk është tjetër, veçse gabim e çudhëzim”.*⁷⁰

Gjenialiteti yt i errët dhe errësues e ka ndryshuar ditën e njerëzimit në natë të ndriçuar vetëm me drita të rreme e mashtruese. Në shikimin e

⁷⁰Kur’an, 13:14

studentëve të atij gjenialitetit tënd me një sy, çdo qenie e gjallë është si ato mjeranet që ne pamë gjatë rrugës tjetër të sulmuar prej errësirës nga të gjitha anët. Ata e shohin botën si një banesë vajtimesh dhe të gjitha zërat në të janë vajtimet mbi vdekjen dhe rënkimet e jetimëve.

Studentët e edukuar plotësisht prej gjenialitetit tënd, secili prej tyre bëhet një 'faraon', një tiran, por një tiran që adhuron madje edhe më të vogëlën e gjërave dhe e shikon çdo shkak të dobishëm sikur zotin e tij. Ai në dukje është kokëfortë –i pabindur– por e ul vetveten në poshtërimin më të skajshëm për hir të kënaqësive dhe madje puth edhe këmbët e djallit për hir të dobisë më të vogël. Ai në dukje është shumë i fuqishëm, por për shkak të qënies së tij pa mbështetje (në botën e tij të brendshme), ai është pafundësisht i dobët.

Të gjitha përpjekjet e studentit tënd janë për përmbushjen e dëshirave të stomakut të tij dhe të pjesëve private ose për dobitë e fisit të tij, por jo në emrin e fisit të tij, por në emrin e interesave vetjake ose për të kënaqur lakminë dhe arrogancën e tij. Ai do vetëm veten e vet dhe mund të sakrifikojë gjithçka për të.

Sa për studentin e singertë të Kuranit, ai është 'një shërbëtor', por ai nuk e ul veten madje as para më të madhes së të krijuarve dhe më të madhes së interesave, madje sikur ajo të ishte parajsja. Ai është 'i butë' dhe i sjellshëm, por ai nuk e ul veten përpara askujt përveç Krijuesit të vet dhe nëpërmjet lejes së Tij. Ai është 'i varfër', por më i pasuri i të gjithëve nëpërmjet asaj çfarë Zoti Gjithëbujar ka depozituar në të. Ai është 'i dobët', por mbështetet në fuqinë e Pronarit të tij, që fuqia e të Cilit është e pafundme. Studenti i singertë i Kuranit, jo më të kërkojë këtë botë kalimtare, nuk do të kërkonte madje as hyrjen në parajsë si synimin e tij, as nuk do të ishte i kënaqur me të. Synimi i tij është të fitojë kënaqësinë e mirë të Zotit të tij.

Shikoje atëherë shkallën e ndryshimit midis objektivave të atyre dy studentëve.

Gjithashtu, studentin e Kuranit i shikon madje edhe gjërat më të stërmëdha si Arshin – Fronin më të lartë të Allahut – dhe diellin veçse si krijesa të pafuqishme në vetvete, të ngarkuara me detyra të nënshtruara. Ai gjen në shpirtin e tij një lidhje shumë të fortë me të gjithë të devotshmit prej banorëve të qiejve e të tokës dhe lutet për ta

prej thellësisë së zemrës së tij, ashtu si një njeri që lutet për familjen e tij.

Shikoje ndryshimin ndërmjet cilësive që kanë ata dy studentët:

Ndërsa njëri ikën madje edhe prej vëllait të tij për tek interesat vetjake, tjetri i shikon të gjithë shërbëtorët e Zotit xh.sh si vëllezër. Kurani i jep dorës së studentëve të tij në vend të këtij tesbije të zakonshme me numrat e të gjitha grimcat e universit për të lavdëruar Zotin xh.sh, dhe në duart e tyre në vend të tesbihut me nëntëdhjetë e nëntë kokrra është vargu i të gjitha grimcave të universit; dhe i këndojnë virdet e tyre me atë tesbih të çuditshëm, dhe e përmendin Zotin e tyre me numrin e të gjithë atij vargu, ose madje edhe me shumë se ai.

Shiko tek studentët evlija të asaj shpallje Hyjnore të tillë si Abdul Kadir Xhilani ose Al Rufai⁷¹, ose Al –Shadhili dhe shiko se si ata i morën në duart e tyre të gjithë zinxhirët e grimcave, atomeve, pikave të shiut, frymëmarrjet e krijesave dhe të tjera si këto si tesbih duke përmendur Allahun me numrin e tyre. Madje, ata e shikuan si të pakët atë që bënë dhe i shtrinë duart e tyre tek ajo që është e pafundme dhe ia referuan njohjes së Njohësit të së padukshmes ‘*Al–Lamul Gujub*’.

Shikoje atë njeri! Megjithëse shpartallohet nga një mikrob dhe bie në pikëllim e dëshpërim edhe nga shqetësimi apo dhimbja më e vogël, shiko tek çfarë rangjesh të larta ai ngrihet dhe tek çfarë shhtrirje zhvillohen aftësitë e tij nga shkëlqimi i udhëzimit të Kuranit. Ai e shikon dynjanë me çfarëdo që ndodhet në të si të pamjaftueshme për të qenë tesbih i vërtetë për virdet e tij, dhe e shpërfill edhe xhennetin – parajsën që të jetë synim për dhikrin –tesbihatet– e tij. Pavarësisht kësaj, ai nuk e sheh veten si më të madh e më të virtytshëm se më e vogëla e krijesave.

Kurani e udhëzon njeriun dhe i thotë:

O njeri! Ajo që ti ke në dorën tënde është një amanet dhe i përket Pronarit (të të gjitha gjërave), i Cili është i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha

⁷¹Ahmed Ibn Ali Ibn Jahja Al Rufai (1120-1184) është njëri prej evlijave Sufi më të shquar të historisë Islame. Ai themeloi tarikatën Sufi të Rifaive. Ai u lind në Vasiit në Irak, ku studioi dhe ndërroi jetë atje. Përkthyesi.

gjërat dhe i Gjithëditur për të gjitha gjërat, që është Mëshirëplotë për ty dhe Gjithëbujar. Ai e blen prej teje pasurinë e Tij që ta ka lënë amanet që ta ruajë për ty dhe që të mos humbasë prej duarve të tua. Në këmbim Ai të jep ty një çmim shumë të lartë. Ashtu si një ushtar, ti ke përgjegjësi dhe je i ngarkuar me disa detyra, prandaj vepro në Emrin e Tij dhe për hir të Tij. Ai të furnizon ty me çfarëdo që ti ke nevojë dhe të mbron ty prej çdo gjëje që ti je i paaftë ta përballosh.

Qëllimi për jetën tënde është që ti të reflektosh manifestimet e Emrave të Tij dhe cilësitë esenciale të Tij. Në qoftë se të bie ndonjë fatkeqësi, thuaj: “Ne sigurisht i përkasim Allahut dhe jemi në shërbim të Tij. Në qoftë se ke ardhur, o fatkeqësi, me lejen dhe kënaqësinë e Tij, ti je e mirëpritur. Ne sigurisht tek Allahu do të kthehemi dhe për shikimin e Tij ne jemi të përmalluar. Ai do të na çlirojë një ditë prej detyrave dhe vështirësive të jetës, kurdo që Ai dëshiron. Në qoftë se, o fatkeqësi, kjo do të ndodhë nga dora jote, s’ka problem, është në rregull. Ndërsa, në qoftë se ti ke ardhur vetëm me dëshirën për të testuar shkallën e vërtetësisë time ndaj Amanetit të Tij, por – ke ardhur – pa lejen dhe kënaqësinë e Tij, unë me sa të mundem nuk do t’ia dorëzoj amanetin e Tij – jetën që Ai më ka dhënë – askujt tjetër veç Atij, i Cili është i Denjë për amanet”.

Ky është realiteti lidhur me dy rrugët që ne i kemi parë. Megjithatë, njerëzit ndryshojnë në udhëzim, dhe pakujdesia ka shkallë të ndryshme. Shkalla e pakujdesisë –gafletit– që ka kapur të civilizuarit i ka bërë ata të pandjeshëm për ato dhimbje të rënda. Por, nëpërmjet shtimit në ndjeshmërinë shkencore dhe paralajmërimit të vdekjes, kjo perde e pakujdesisë përsëri mund të grisët.

Mjerim për ata që çudhëzohen prej tagutëve – të huaj!

O rinia turke! O të rinjtë e tokave Islame! Pasi ju keni vuajtur të gjitha ato fatkeqësi nga duart e Europës, a akoma do të vazhdoni t’i ndiqni ata në shturje e në ide dhe u bashkoheni rradhëve të tyre në mënyrë të pavetëdijshme? Kjo ndjekje e tyre do të ishte në kontradiktë me pretendimin tuaj për patriotizëm, meqenëse do të thotë përbuzje ndaj vlerave kombëtare dhe përqeshje ndaj kombit. Allahu na udhëzofte neve dhe ju në rrugën e drejtë.

Mësoje, o ti që je tronditur nga shumësia e mosbesimtarëve – kafirëve– dhe nga pajtueshmëria e tyre në mohimin e disa të vërtetave të besimit!

Para së gjithash, vlera nuk gjykohet nga sasia. Në qoftë se një njeri nuk mund të mbetet njerëzor, ai kthehet në një kafshë djallëzore. Në qoftë se njeriu përparon në lakmitë e orekset shtazore si mohuesit e feve, ai shtohet në kafshëri. Ti shikon shumësinë e sasive të kafshëve pa kufi dhe pakicën e njeriut ndonëse ai është kalif.

Së dyti, mohimi është një përgënjeshtim. Dhe njëmijë njerëz që mohojnë nuk preferohen mbi dy njerëz që pohojnë.

Në qoftë se ti do të pyesje: Ç’është kafiri – mohuesi, ateisti?

Pëgjigja është kjo: Mohuesit nuk besojnë në asnjë fe dhe ata janë një specie e ndyrë prej kafshëve të Zotit. Allahu i krijoi ato për përmirësimin e jetës materiale në këtë botë dhe në atë të zjarrit (në botën tjetër). Ata mund të shërbejnë për një masë krahasimi në kuptimin e shkallëve të mirësive të Zotit të Gjithëfuqishëm mbi shërbëtorët e Tij besimtarë.

Gjithashtu, pajtueshmëria e tyre mbi mohimin e të vërtetës, dakordësia e tyre nuk ka peshë. Sepse mohimi, edhe në formën e pohimit është përgënjeshtim, mohim, refuzim, injorancë dhe pranim i mosekzistencës. Për shembull, sikur të gjithë njerëzit e Stambollit të mohonin shikimin e hënës së re (në fillimin e Ramazanit), ndërkohë që dy njerëz pohuan se e kishin parë atë. Për shkak të konfirmimit të pohuesve njëri-tjetrit, pohimet e tyre preferohen mbi mohimin e të gjithë njerëzve të tjerë, nuk ka rëndësi se sa shumë mund të jenë ata. Pohimi tregon për vetë realitetin ose për vetë faktin, ndërsa mohimi varet nga ai i cili mohon.

Për shembull, supozo se ndodhet një re e dendur në faqen e qiellit dhe me përjashtim të një pakice prej nesh, ne nuk mund ta shohim diellin kur ngrejmë kokat tona. A do të ishte e pranueshme që ti të thuash, “Ata që nuk mund ta shohin diellin janë më shumë se ata të cilët e kanë parë, dhe si rrjedhojë ne duhet të vendosim sipas shumicës? Natyrisht, jo! Sepse ata që nuk mund ta shohin diellin do të thonë: “Unë nuk mund ta shoh diellin” dhe jo “nuk ndodhet diell në faqen e qiellit”. Në të njëjtën mënyrë, meqenëse ata të cilët mohojnë ose

përgënjeshtrojnë të vërtetat apo esencat e fesë do të japin justifikime të ngjashme, mohimet e tyre do ta mbështesin njëri-tjetrin. Ata janë ndryshe nga ata që bien dakord, pajtohen mbi konfirmimin e realitetit, të cilët si në rastin e atyre që e ndihmojnë dhe e mbështesin njëri-tjetrin, për shembull, në ngritjen e një shkëmbi të madh, gjejnë mbështetje dhe forcë prej njëri-tjetrit, pajtueshmëria e mohuesve është si ardhja bashkë për të kaluar përmes një vrime të ngushtë dhe si rrjedhim nuk ka asnjë dobi, as peshë dhe as vlerë.

Mësoje, o ti që i nxit fort muslimanët të përpiqen për jetën e kësaj bote dhe i fton ata vetëm për progres material! Ruh, kujdes, se disa prej litarëve që i lidh ata me fenë janë të hollë. Prandaj, kujdes që ato të mos këputen dhe që jeta shoqërore të mos dëmtohet shumë. Sepse ndryshe nga një kafir (mohues), një apostat (felëshues), nuk ka të drejtë jete për shkak se bëhet krejtësisht i keq dhe shkakton korrupsion. Përsëri, ndryshe nga ndjekësit e një feje tjetër që jetojnë midis muslimanëve, sipas medhhebit Hanefi, fasiku –ai që bën hapur gjynahe të mëdha dhe pa ndjerë asnjë turp– trajtohet si një tradhëtar dhe dëshmia e tij nuk pranohet në gjyq, meqë ndërgjegjja e tij është fajtoare dhe e prishur. Kështu, mendo gjithnjë e më shumë dhe bëj kujdes! Por mos u mashtro nga shumësia e fasikinëve – gjynahqarëve të mëdhenj, sepse fasiku nuk është i kënaqur me shturjen. Dhe ai nuk e kërkoj pikërisht shturjen, por ra në të. Pothuajse nuk gjendet fasik veçse dëshiron të jetë musliman i devotshëm dhe i përkushtuar dhe t'i shohë eprorët e tij si të devotshëm e të drejtë, veçse në qoftë se bëhet apostat – felëshues, ruajna Zot! A mendon ti se muslimanët nuk e duan dynjanë dhe kanë nevojë të zgjohen dhe se ata e harrojnë pjesën e tyre prej dynjasë? Jo, nuk është kështu. Përkundrazi, lakmia është përforcuar, dhe lakmia për besimtarin është shkak humbjeje e zhgënjimi. Gjithashtu, faktorët që të ftojnë tek dynjaja janë shumë, të tillë si nefsi, nevojat, pasionet, dëshirat, shejtani, shokët e këqinj si ti, ëmbëlsia e përfitimit të menjëhershëm dhe të tjera të ngjashme me këto, ndërsa ato që të ftojnë tek Ahireti – bota tjetër, janë pak.

Ndjenjat patriotike dhe përpjekjet duhet t'i bashkangjiten dhe të mbështesin pakicën. A mendon ti gjithashtu se varfëria jonë vjen prej tendencave tona asketike? Jo! A nuk e sheh se Mexhusët dhe Magët dhe budistët dhe të tjerët të nënshtruar ndaj sulmeve dhe sundimit të europianëve janë më të varfër se ne? A je ti kaq i verbër sa që nuk e sheh se çfarëdo që ndodhet mbi kutin –ushqimin– e domosdoshëm nuk

mbetet në dorën e muslimanëve në të shumtën e rasteve, por u uzurpohet dhe u rrëmbehet atyre me mashtrimin nga kafirët nëpërmjet dredhive të tyre? Në qoftë se ti pret që ndjekja e civilizimit të tyre do të mundësojë ty të realizosh një qeverisje të mirë dhe siguri në vendin tënd, ti ke marrë një rrugë të gabuar. Sepse të qeverisësh njëqind fasikë –me morale të këqija dhe me besim të lëkundur e të dobët– është më e vështirë se qeverisja e mijëra besimtarëve të devotshëm.

Prandaj, besimtarët nuk kanë nevojë të nxiten për tek lakmia për dynjanë. Ajo çfarë ata kanë nevojë është një organizim i mirë i punës dhe i rregullimit të orëve të tyre të punës, dhe për një bashkëpunim të dobishëm dhe siguri të brendshme. Dhe kjo do të ishte e mundur veçse nëpërmjet takvasë – frikës dhe devocionit ndaj Allahut.

Mësoje, o shok! Nga bujaria e Tij e plotë, i Vërteti xh.sh, e ka përfshirë një pjesë të shpërblimit të shërbimit në aktin e vetë shërbimit dhe shpërblimin e aktit në vetë aktin. Për shkak të kësaj, krijesat, duke përfshirë madje edhe ato të pajeta, u binden urdhërave të Zotit në krijimin dhe në operimin e universit me zell e kënaqësi të plotë dhe duke iu bindur atyre urdhërave, ato reflektojnë manifestimet e Emrave *Drita e Dritave*. Një bërthamë e vogël e gruposur në errësirën e dheut, për shembull, kthehet nga dielli me zemrën e saj të pastër, dhe duke e bërë zemrën e saj fronin e diellit, ndriçon duke buzëqeshur tek fytyra jote.

Supozo që grimcat e vockëla dhe pjesët përbërëse të kishin vetëdije, ashtu si fara e përmendur duke u zhvilluar nga të qenurit diçka shumë e thjeshtë deri tek rangu i lulëzimit dhe i ndriçimit më të skajmë. Grimcat dhe pjesët përbërëse gjejnë kënaqësi prej marrjes dhe reflektimit të manifestimeve të Emrave të Zotëruesit të Vetëm të madhështisë, bukurisë dhe plotësisë absolute, dhe si rrjedhojë duke realizuar një zhvillim të madh nëpërmjet bindjes së urdhërave të Krijuesit.

Shiko shqisat dhe organet e tua dhe shërbimet që ato bëjnë për mbijetesën tënde ose për mbijetesën e llojit njerëzor. Shiko se si ato marrin kënaqësi në dhënien e shërbimit aq shumë, saqë ndalimi i shërbimit bëhet një torturë për to.

Pastaj vështro kafshët dhe shiko si ato gjejnë kënaqësi në përmbushjen e detyrave të tyre! A nuk e shikon për shembull, gjelin! Si ai i preferon pulat mbi vetveten dhe i thërret ato për të ngrënë ushqimin

që ai rastisi ta gjejë dhe nuk e ha vetë? Kuptohet nga mënyra e tij se ai bën kështu me zell, kënaqësi e krenari. Gjithashtu, edhe pula duke u kujdesur e duke i drejtuar zogjtë e saj ndërsa janë të vegjël. Ashtu si nënat e të gjitha gjallesave, ajo i lë ato kur të jenë rritur mjaftueshëm për të drejtuar vetveten. Kjo tregon se ajo e bën këtë jo për hir të saj, as për plotësinë e saj, por për hir të Atij që e ka vënë në punë dhe i jep asaj prej mëshirës së Tij kënaqësi në përmbushjen e detyrës së saj.

Përsëri, sodit bimët dhe pemët dhe shiko si ato u binden urdhërave të Krijuesit të tyre në një mënyrë duke shfaqur zell dhe kënaqësi. Zbukurimi i tyre dhe dhënia e aromës shfaqin zellin e tyre, dhe sakrifica e tyre vetveten për mugullimin dhe për frutat e tyre shpallin se kënaqësia e tyre qëndron në bindjen ndaj atyre urdhërave. Është sikur ato kërkojnë më të pastërtin e ushqimit prej Derës së Mëshirës dhe i ushqejnë frutat e tyre me të me lejen e Zotit të tyre. A nuk e sheh se si një pemë fiku i ushqen fiqtë me qumësht të pastër që e merr prej thesarit të Mëshirës ndërsa vetë ushqehet me baltë? Dhe një pemë shege u jep frutave të saj sherbet të pastër që Zoti i saj ia jep, ndërsa vetë ajo pemë pi ujë, dhe kështu me radhë.

Pastaj, sodit farërat nën tokë dhe shiko se ashtu si një i burgosur në një birucë të ngushtë, i cili me zell dëshiron të dalë në kopësht, ato janë të zellshme për t'u rritur e mugulluar në ajër. Ky ligj Hyjnor që dominon gjithandej universit tregon se një gjë joaktive bëhet më e lodhur sesa një tjetër aktive gjithnjë e ripërtërirë. Sepse ndërsa e para ankohet për ngadalsinë e kohës dhe jetës së saj, e dyta është plot falënderime. Rehatia qëndron në të luftuarit me telashet dhe me përballimin e vështirësive, ndërsa shqetësimi qëndron duke ndenjur kot, pa punë.

Përsëri, kur vështron gjërat e pajeta, ti sheh se çfarë është në to e mundshme lëviz për t'u bërë aktuale në një mënyrë që shfaqet sikur ato ndjejnë kënaqësi në atë lëvizje. A nuk e sheh se si një pikë ujë e hap zemrën e saj me entuziazëm nëpërmjet urdhërit të Krijuesit të saj? Pavarësisht dobësisë dhe butësisë së tij, kur ai dëgjon urdhërin: "O ujë! Kthehu me lejen e Zotit tënd!" nëpërmjet zellit të fortë që 'ndjen', uji çan edhe hekurin e fortë.

Nga lëvizja e grimcave më të vogëla për tek rrotullimi i diellit, të gjitha lëvizjet dhe përpjekjet në univers varen tek ligji i Kaderit Hyjnor dhe paracaktohen e kontrollohen nga fuqia Hyjnore. Ato e shfaqin

vetveten nga urdhëri Hyjnor i krijimit, urdhër që përmban njohjen, dëshirën dhe madje edhe fuqinë. Çdo grimcë ose atom dhe çdo përbërës, dhe çdo krijesë e gjallë është si një ushtar i cili ka lidhje me të gjitha sferat e ushtrisë dhe me detyrat përkatëse. Për shembull, një grimcë në njërën prej qelizave të syrit tënd ka lidhje me syrin tënd, me nervat në fytyrën tënde dhe me venat e trupit tënd, dhe funksionon në përputhje me lidhjet e saj. Nëpërmjet gjuhës së pafuqisë së saj esenciale për të mbajtur atë çfarë është e pamundur për ta mbajtur dhe për të kryer detyrat me të cilat është ngarkuar në rregullimin e universit dhe në ruajtjen e ekuilibrit midis ligjeve Hyjnore të natyrës, çdo gjë dëshmon për ekzistencën e domosdoshme të të Gjithëfuqishmit të Parapërdjetshëm. Sepse rregulli dhe balanca janë dy ‘kapituj’ të rëndësishëm e të hollë të Librit të Qartë e të dukshëm të universit. Si do të mundej, për shembull, një grimcë apo një bletë që ta lexonin atë libër, i cili është në Dorën e Atij që e mbështjell qiellin si një letër e bërë tub për shkrim? Gjithashtu, çdo gjë dëshmon për Unitetin e Ekzistuesit të Domosdoshëm, të Vërtetit qoftë Ai i lavdëruar, nëpërmjet lidhjeve të saj, duke qenë një individuale me përbërësit njëra brenda tjetrit ose mbi tjetrin dhe detyrave që ajo përmbush dhe nëpërmjet pozicionit të saj përse ka të bëjë me të gjitha pjesët e atyre përbërësve. Përsëri, Krijuesi i Gjithurtë ka përcaktuar për çdo gjë parimet e dy kapitujve –rregullit dhe balancës– të Librit të Qartë të universit të veçanta për atë gjë dhe në përputhje me nevojat e saj. Kur ajo vepron sipas atyre parimeve, ajo madje vepron, megjithëse e pavetëdijshme, në përputhje të plotë me ligjet e atij libri.

Për shembull, kur një mushkonjë vjen në botë, ajo menjëherë del prej shtëpisë së saj dhe sulmon fytyrën e njeriut, duke e goditur atë me shkopin e saj dhe duke nxjerrë ujin e jetës për vetveten. Kush është ai që ia ka mësuar asaj këtë art të luftimit? Unë pranoj se po të isha në vendin e saj, unë nuk do ta kisha mësuar këtë art veçse pas një periudhe të gjatë instruksioni, stërvitje dhe shumë provave. Ju mund t’i krahasoni me mushkonjën, bletën dhe merimangën, të afta për të marrë inspirimin Hyjnor, edhe të gjitha kafshët dhe bimët e tjera në ‘duart’ e secilës prej tyre, Gjithëbujari Absolut, qoftë i lavdëruar, ka dhënë një libër udhëzues të shkruar me bojën e kënaqësisë e të nevojës.

Qoftë Ai i lavdëruar! Shiko se si Ai i ka përfshirë sekretet në rreshtat e dy kapitujve të Librit të Qartë të universit në ‘manualin’ e futur në kokën e, për shembull, të bletës. Çelësi i saj është kënaqësia e

veçantë për bletën e ngarkuar me disa detyra. Dhe kështu shfaqet prej asaj që ti ke dëgjuar gjer tani, nëpërmjet intuitës së besimit, njëri prej mistereve të:

وَسِعَتْ رَحْمَتُهُ كُلَّ شَيْءٍ

“Dhe mëshira e Tij përfshin gjithçka”⁷²

وَ إِنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ

“Dhe s’ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij, por ju nuk e kuptoni lavdërimin e tyre”⁷³

Shfaqet një sekret prej:

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ

“Sigurisht që urdhëri i Tij, kur Ai do një gjë, është vetëm se Ai t’i thotë asaj “Bëhu!” dhe ajo është bërë (në çast)!

فَسُبْحَانَ الَّذِي بِيَدِهِ مَلَكُوتُ كُلِّ شَيْءٍ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

Kështu pra, i lavdëruar qoftë Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ata ia bashkojnë Atij, në Duart e të Cilit është Zotërimi i çdo gjëje dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni.”⁷⁴

Mësoje, o ti që i thërret muslimanët për tek dynjaja! Ti je i gabuar. A mendon, o i pakujdesshëm, se qëllimi kryesor për jetën e njeriut kufizohet vetëm tek progresi material dhe tek zhvillimi shkencor e teknologjik, tek të fituarit e mjeteve të jetesës dhe tek gjëra të ngjashme lidhur me jetën e kësaj dynjaje? Ndërsa Zoti dhe Sundimtari i krijimit, urdhëri i të Cilit është veçse të thotë: “Bëhu!”, thotë një fjalë të konfirmuar nga ekzistenca, krijimi, realitetet dhe ndjenjat dhe aftësitë e përfshira në natyrën njerëzore:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ ۗ

⁷²Kur’an, 7:156

⁷³Kur’an, 17:44

⁷⁴Kur’an, 36, 82:83

وَكَايْنٍ مِنْ دَابَّةٍ لَا تَحْمِلُ رِزْقَهَا اللَّهُ يَرْزُقُهَا وَإِيَّاكُمْ ...

“Dhe Unë –Allahu– nuk i krijova njerëzit dhe xhindet veçse ata duhet të më adhurojnë vetëm Mua”⁷⁵

“Dhe sa shumë krijesa të gjalla nuk mbartin dot ushqimin e tyre! Allahu është i Cili i ushqen ata dhe ju!”⁷⁶

A mendon ti se Ai që të ka bërë ty dhe vazhdon të të bëjë rishtas gjatë gjithë kohës duke ripërtërirë trupin tënd është në nevojë për atë çfarë bën ti në mbretërinë e Tij, është në nevojë të ndihmës tënde në aktet e Autoritetit të Tij? A nuk e sheh se madje edhe gjëja më e sofistikuar të cilën e bën njeriu, nuk mund të jetë e barabartë në art dhe në krijim me një pemë hurme ose me një bletë, ose me një sy apo me një gjuhë?

Mësoje, o i pakujdesshëm! Do të ishte absolutisht e pakonceptueshme që Ai që të ka krijuar ty nuk e ditka çfarë po ndodh tek ty, ndërsa ti lëviz përmes kushteve shoqërore dhe rrethanave të kësaj bote. Çfarëdo qofshin besimet dhe mendimet e tua, ose madje, edhe në qoftë se do të ishe një ateist apo materialist, ti nuk do të mundeshe veçse të pranoje se ndodhet një akt krijues, një art dhe një veprim në një spermë, ose në një vezë, ose në një kokërr, ose në një bërthamë. Do të ishte e arsyeshme për ty që kushdo ose çfarëdo që vendos e vepron në bërthamë – ai veprim është i vetëdijshëm e i urtë, që shikon lidhjet e bërthamës me botën dhe speciet e saj dhe me atë i cili do të përfitojë prej saj – a është ai i pavetëdijshëm për botën e pemëve me të gjitha kushtet e saj dhe lidhjet me botërat e tjera? Ai është i Vetmi që e çan bërthamën dhe e bën atë të rritet së pari në një filizë dhe pastaj një pemë e zhvilluar e prodhuese, a nuk e sheh e vëzhgon atë ai i cili e mbjell dhe përse e mjell dhe çfarë ai fiton prej saj, dhe lidhjet e saj me botën e kafshëve, ambjentin e saj dhe çfarë po ndodh në atë ambjent? A do të ishte e arsyeshme për ty të imagjinoje që Ai, i Cili i jep formë e trajtë vezës në një mënyrë për të kllonitur dhe për ta pajisur atë me vegëla që i përkasin botës së zogjve, a nuk i sheh Ai kushtet e botës së zogjve dhe të botërave të specieve me të cilat bota e zogjve ka lidhje të afërta? A do të ishte e konceptueshme për ty që Ai,

⁷⁵Kur'an, 51:56

⁷⁶ Kur'an, 29:60

i Cili krijoj prej një pikë fare një copë gjaku të mpiksur që rri varur, dhe atë copë gjaku e bëri copë mishi pastaj mishin e bëri kocka, pastaj i veshi kockat me mish, dhe pastaj e prodhoi atë si një krijim tjetër me jetë, i Cili i dha asaj krijese një formë duke shfaqur një mjeshtëri të tillë artistike, e cila qartë i përket të Gjithëditurit, Gjithëshikuesit të Gjithurtë, njohja, shikimi dhe urtësia e të Cilit janë të pakufishme; dhe e pajisi atë me vegla të cilat njeriu – i krijuar prej një pikë fare – i përdor në lidhjet e tij me shumicën e specieve dhe botërave të tjera, a supozon ti se Ai i Vetëm –Krijuesi– nuk e sheh botën e njerëzimit me të gjitha kushtet e saj dhe çfarëdo që ndodh përreth njerëzimit? Që Ai të mos njohë periudhat përmes të cilave kalon njeriu dhe botërat në të cilat lëviz njeriu me trupin e tij, me ndjenjat, shpirtin, mendjen, imagjinatën dhe me të gjitha aftësitë e tjera me të cilat ai është i pajisur për të goditur botërat dhe për të dalluar të vërtetat?

O i pakujdesshëm! A mendon se je i lirë dhe i përjashtuar prej ndërhyrjes së të Vetmit, i Cili shtrin tek dora jote nëpërmjet shkopit të degëve frutat e një shege të bërë për ty dhe nëpërmjet fibraneve – penjézave– si kërcell bostanë e shalqi të rritur e të përgatitura për ty? Për shkak të pakujdesisë, ti mendon se Autori i bostanit është gafil –i pavëmendshëm– për ngrënien e tij. Për shkak të verbërisë, ti pandeh se Autori i shegës është aq i verbër saqë nuk është në dijeni të asaj që Ai bën për ata që hanë prej saj dhe që mbeten të mahnitur nga mjeshtëria artistike që ajo shfaq duke shpallur: I lavdëruar qoftë Ai, i Cili më ka dhënë formë e trajtë mua, sa bukur më ka formuar Ai mua! Për ata që reflektojnë mbi bukurinë e saj duke deklaruar:

فَتَبَارَكَ اللهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ

“I shenjtëruar pra qoftë Allahu, më i Miri i krijuesve”⁷⁷

الْأَيْعَلْمُ مَنْ خَلَقَهُ هُوَ اللَّطِيفُ الْخَبِيرُ

“A nuk e din Ai i Cili ka krijuar? Dhe Ai është më Dashamirësi, i Mirënjohuri për çdo gjë”⁷⁸

⁷⁷Kur’an, 23:14

⁷⁸Kur’an, 67:14

Ose, a mendon ti, o arrogant se Ai që na i dërgon neve ato fruta për të përmbushur nevojat tona nuk na sheh e nuk na njeh neve? Ose a nuk na vështron ne Ai që ka shpërndarë para nesh dhe anembanë botës sonë kafshë të buta dhe speciet e tjera të kafshëve për dobinë tonë?

Mësoje, o ti që mbështetesh mbi veten tënde, mbi shkaqet dhe mbi dynjanë! Ti i ngjason një xixëllonje e cila mbështetet mbi dritën e saj dhe ditën me diell e ndryshon me natën. Ose përngjasimi yt është si ai i një individi në ushtri, i cili mendon se mbreti i tij përgjithëson me favorët dhe me dhuratat e tij të gjithë njerëzit, deri tek më i thjeshti i ushtarëve, të cilët nuk kanë asnjë rang dhe madje deri tek kafshët; dhe pastaj ulet dhe thotë me vete: “Çfarë vlere kam unë që ai të mund të më shfaqë konsideratë të veçantë midis njerëzve të panumërt për të cilët ai shfaq mirësi? Por, zemra ime ndjen nevojë për një të dashur që do të më mbronte e do të më mbështeste. Kështu, do të ishte më mirë që unë të gjej një mbrojtës e një mbështetës tjetër”. Pastaj, ai nis për të gjetur një mbrojtës tjetër pa marrë parasysh ligjet luftarake dhe u gjykua dhe u gjet rebel, dhe u dënua me burgosje. Ata i thonë atij: A nuk e di, o i mjerë, se thesari i mbretit është i mjaftueshëm për të plotësuar të gjitha nevojat e tua dhe nevojat e të gjithë ushtarëve të tjerë? Ndërsa ajo çfarë është në dorën tënde dhe në duart e atyre të cilët ti u drejtohesh nuk mjafton për të plotësuar madje as edhe më të vogëlën e nevojave të tua, sepse ti je i rrethuar prej armiqve të panumërt dhe prej ambicieve të pafundme. Ligji i mbretit nuk të përjashton ty, përkundrazi ai përfshin gjithkënd, cilido që mund të jetë. Madje sikur vetëm ti të ishe në shërbimin ushtarak, përsëri ti do të kishe të njëjtin trajtim sikur mbreti të ishte veçanërisht i interesuar për ty nëpërmjet ligjit të tij dhe të shikoi ty me sytë e ligjit të tij. Për më tepër, në qoftë se mbreti do të ishte një i shenjtë, i aftë për të qenë prezent në shumë vende në të njëjtën kohë, ai nuk do të ishte i pavetëdijshëm për nevojat e tua, madje as për një çast. Ti e sheh se nevojat e çdo qenieje të gjallë përmbushet veçanërisht për të, gjë e cila shfaq se në favorizimin e përgjithshëm ndodhet një sy me të cilin ti shihesh në mënyrë të veçantë. Kjo është sepse mbreti interesohet për çdo qenie, ndërsa interesohet për nevojat e publikut në përgjithësi. Është si dielli që ndriçon çdo objekt të veçantë dhe shihet në çdo objekt të tejdokshëm, ndërsa i jep dritë tërësisë së botës, ose është si rregulli universal i plotë që sundon në çdo gjë midis konfuzionit të dukshëm që shkaktohet prej gjërave, duke qenë të gjitha të përziera me njëra tjetrën.

Shkurtazi: Krijuesi yt dhe Pronari yt është më i mëshirshëm, më bujar, më i butë dhe më i dhembshur se çdo mik tjetër i afërt, i dashur, shok apo vëlla. Ai është i Gjithëditur për ty dhe për sekretet e tua; dhe Ai është i Gjithëfuqishëm, duke përfshirë më të mëdhajat e kërkesave të tua dhe ato më të fshehtat. Atëherë, braktisi të gjithë përveç Tij dhe mbështetu tek Ai.

Mësoje, o shok! Libri i universit, i cili është “Libri i Fuqisë” është shkruar në përputhje me masat e “Librit të Qartë”, i cili është libri i njohjes. Kjo dëshmohet nga fakti se rregulli universal dhe balanca janë ‘dy kapitujt’ e këtyre dy librave dhe një lidhje midis tyre. Ato janë gjithashtu dy tituj të të dy kapjeve të të Gjithëmëshirshmit; nuk ka gjë të njomë ose të thatë që të mos jetë përfshirë në këto dy kapituj të Librit të Qartë. Meqenëse nuk ndodhet asgjë në ekzistencë e as në krijim e përjashtuar prej këtyre dy kapitujve, gjithçka është përfshirë në atë libër.

Sa për Kuranin, i cili është libri që del prej Atributeve të ligjërimit, është interpretues i dy librave të së dukshmes dhe të së padukshmes, i librave të fuqisë dhe të njohjes. Është indeksi i dy kapitujve të sapo përmendur nga shprehja e thukët e dy kapjeve të referuara.

Është njëri prej parimeve të këtyre tre librave që dalin prej tre Atributeve Hyjnore të njohjes, fuqisë dhe ligjërimit, saqë çdo krijesë e gjallë, madje çdo gjë është si një ushtar i rregullt ose si një shërbëtor i ngarkuar me detyra të veçanta. Ajo punon për hir dhe në emër të mbretit, i cili e ka në pronësi atë, dhe jo për hir të vetes së saj dhe të vet pronësisë së saj. Ajo nuk punon për hir të kënaqësisë së saj, por për hir të kënaqësisë që qëndron në përmbushjen e detyrës së saj. Kushdo që pandeh se është pronar i vetvetes, dhe kushdo që pretendon vetëpronësi zbulohet para zhdukjes dhe copëtimit.

Mësoje, o shok! Qiejt janë bërë pa asnjë plasaritje, që ti mund t’i shohësh. Autori i tyre është aq Madhështor, Dinjitoz, i Lavdëruar dhe i Gjithëpushtetshëm, saqë nuk është aspak e vështirë për Të ta krijojë çdo gjë të veçantë në vendin e saj, dhe absolutisht asgjë nuk mund të ikë prej mbretërisë së Tij. Anëtarët individualë të një specie gjenden të gjitha të përziera me njëri-tjetrin, gjë e cila tregon se Krijuesi i një specie të tillë si peshku e miza është Krijuesi i të gjitha specieve. I Tij është sundimi dhe Atij i përket i gjithë lavdërimi; i Tij është krijimi, i

Tij është urdhëri dhe gjithashtu i Tij është gjykimi; nuk ka zot tjetër përveç Tij.

Mësoje, o shok! Profeti a.s.m dhe profetësia e tij janë më të mirat dhe përmbledhja e plotësisë dhe e të mirës të ndarë nga i gjithë njerëzimi. Rruga dhe feja e tij janë shprehja më e plotë e lumturisë absolute dhe e bukurisë së pastër. Ne shohim në krijimin e tij një plotësi superiore, një të vërtetë folëse, një të mirë të dalluar dhe një bukuri rrezatuese, dhe domosdoshmërisht e drejta dhe e vërteta gjenden në anën e profetit a.s.m, ndërsa çudhëzimi, iluzionet dhe mosekzistenca gjenden në anën e kundërt të tij. Në qoftë se ti dëshiron, shiko prej mijëra e mijëra bukurive dhe virtyeteve të adhurimit, të cilat i solli profeti a.s.m, shiko vetëm këtë: zemrat dhe gjuhët e të gjithë atyre që besojnë në Unitetin e Zotit janë bashkuar mbi shumë raste të tilla si pesë namazet e përditshme, në faljen e Bajramëve, të xhumave, në faljet me xhemat, saqë në raste të tilla çdo person i veçantë i përgjigjet madhësisë së adresimit të të Adresuarit të Parapërdjetshëm, të gjitha zërave të zemrave të të gjithë besimtarëve, duave dhe tesbihateve të tyre me një pajtueshmëri të tillë të gjerë dhe me një solidaritet të gjithanshëm, sikur e gjithë toka të fliste vetë e të falej me të gjitha trevat e saj dhe t'i bindej nëpërmjet të gjitha anëve të saj urdhërit: *“Kryeni faljet me korrektësi”* – urdhër që u lëshua me dinjitet e madhësi prej mbi shtatë qiejt saqë u bë ky njeri i krijuar i dobët – pavarësisht vogëlsisë së tij dhe qënies së tij si një grimcë midis këtyre botërave– u bë një shërbëtor i dashur i Kijuesit të tokës e të qiejve dhe kalif në tokë, një kryetar për kafshët dhe qëllimi përfundimtar i krijimit të universit. A nuk e shikon se po të grumbulloheshin në dëshmi, ashtu si në të padukshmen, të gjithë ata që madhërojnë Zotin, të cilët janë me miliona, të gjithë në të njëjtin moment duke deklaruar *“Allahu Ekber”* në faljen e Bajramit dhe pas namazeve do të ishin të barabartë me tekbinin e globit tokësor, në qoftë se ai do të bënte tekbin. Sikur toka në ditën e festës lëkundet si tërmet dhe madhëron Allahun me vendet dhe malet e saj dhe flet nga thellësia e zemrës së kibles së saj, nëpërmjet gjuhës së Mekës së saj, me *“Allahu Ekber”*. Fjalët që dalin prej shpellave të saj –gjuhëve të besimtarëve të shpërndarë gjithandej saj– ngrihen valë, madje kështu bëjnë edhe në anët e botës së ndërmjetme, Berzah, dhe të qiejve duke u ngritur në valë.

Qoftë i lavdëruar Ai që e krijoi atë – tokën – dhe e bëri si një djep dhe një vend sexhdeje për shërbëtorët e Tij, qoftë Ai i lavdëruar dhe i lartësuar!

Mësoje, o ti që do të doje ta shikoje e të arrije dritën e njohjes së të Vërtetit, qoftë Ai i lavdëruar nëpërmjet dritareve të argumenteve dhe dëshmimeve dhe nëpërmjet pasqyrave të shenjave dhe dëshmimeve të Tij! Mos u përzi me atë që ndodh përreth teje nëpërmjet ngritjes së gishtit tënd të kundërshtimit, as mos iu afro asaj që të ndodh ty me dyshim, dhe i shtrin duart e tua për të kapur dritën që të shfaqet ty, por qëndro i tërhequr prej kushteve të pakujdesshmërisë, ekspozoje veten tënde drejt ardhjes së tyre tek ti dhe kthehu drejt tyre me gjithë zemër.

Është nga eksperiencia ime personale se dëshmitë dhe provat e Zotit xh.sh janë prej tre kategorish:

Disa prej tyre janë si uji, ti mund t'i ndjesh dhe t'i shikosh ato, por nuk mund t'i mbash me duart e tua. Prandaj çliroje veten prej fantazive të tua –prej mendimeve të gabuara– dhe ji i zhytur në to me të gjithë fuqinë tënde. Mos i prek ato me gishtërinjtë e tu të kritikës as në një mënyrë zhbiruese, sepse ato vërshojnë, rrjedhin dhe nuk janë të kënaqura me të qënurit të prekura nga gishtërinjtë.

Kategoria e dytë e tyre është si ajri; ti mund t'i ndjesh ato, por nuk mund t'i shohësh dhe as nuk mund t'i kapësh. Prandaj, ekspozoje fytyrën tënde, gojën dhe shpirtin tënd ndaj atyre flladeve të mëshirës. Mos iu përgjigj atyre me duart e tua të zgjatura për t'i kapur, as për t'i kritikuar dhe as me dyshim, në vend të frymëmarrjes me gojë dhe gjallërimit të shpirtit. Përndryshe, ato do të zhduken. Nuk janë duart ato ku këto dëshmi e prova janë të kënaqura për të banuar.

Kategoria e tretë e tyre është si drita, ti mund t'i shohësh ato, por nuk mund t'i prekësh dhe as t'i marrësh. Kthehu drejt tyre me sytë e intuitës tënde dhe ekspozoje zemrën tënde ndaj tyre. Drita mund të kapet e të gjuhet veçse me dritë, (me dritën e zemrës e të intuitës). Prandaj, mos e shtrij dorën tënde lëndore me lakmi dhe as mos e pesho me mjetet materiale të peshores, sepse ajo e fsheh vetveten, megjithëse nuk shuhet. Ajo nuk do të ishte e kënaqur me burgime, mbyllje materiale apo fizike dhe me kufizime e pronarë të ngurtë.

Mësoje, o shok dhe shikoje shkallën e mëshirës së Kuranit dhe dhembshurinë e tij ndaj njerëzve të thjeshtë, dhe shiko se si ai i respekton dhe merr parasysh thjeshtësinë e të kuptuarit të tyre! Ai i përsërit shenjat e qarta të skalitura në ballet e qiejve e të tokës dhe i bën ata t’i lexojnë ato me shkronja të mëdhaja, të cilat lexohen e shihen me lehtësinë më të plotë, të tilla si krijimi i qiejve dhe i tokës, zbritja e shiut nga qielli, rigjallërimi i tokës (në çdo pranverë) dhe shembuj të tjerë të ngjashëm. Njerëzit e thjeshtë mezi mund t’i dallojnë shkrimet e shkruara me shkronja të vogëla e të holla. Gjithashtu, shikoje pastërtinë dhe elokuencën e shprehjeve të Kuranit, si ai i lexon njeriut atë që Fuqia ka shkruar në fletët e universit. Është sikur Kurani të ishte recitimi i universit, rregulli dhe harmonia e tij dhe shpalljet e Formëdhënësit të tij dhe akteve të Tij.

Në qoftë se dëshiron, dëgjo me një zemër të zgjuar, dëshmuese, sure të tilla si “*Amme*” dhe vërsete të tilla si:

قُلِ اللَّهُمَّ مَالِكِ الْمُلْكِ

*“Thuaj: O Allah! Pronari i gjithë sundimit...”*⁷⁹

Mësoje, se megjithëse duhet të mbahen sekret, unë i shkruaj lutjet e zemrës sime drejtuar Zotit tim për shkak se unë pres e shpresoj prej mëshirës së Tij xh.sh që Ai ta pranojë ligjëratën e librit tim në vendin tim pasi vdekja ta ketë heshtur gjuhën time.

O Mbështetësi im Mëshirëplotë dhe o Zoti im Gjithëbujar! Jeta ime dhe rinia kanë kaluar në abuzimet e zgjedhjes së vullnetit tim të lirë. Ajo çfarë ka mbetur prej fruteve të tyre janë vetëm mëkatet pikëlluese dhe poshtëruese dhe dhimbjet shkatërruese e çudhëzuese dhe vesveset – shqetësimet, mërzitjet– dhe ankthet paralizuese. Me këtë peshë të rëndë, me zemër të sëmurë, dhe me fytyrë të turpëruar, ashtu si paraardhësit e mi, të dashurit, të afërmit dhe moshatarët e mi, unë po afrohem me shpejtësinë më të skajme pa shmangie e pa zgjedhjen time për tek dera e varrit, shtëpia e vetmisë në rrugën për përjetësi pas ndarjes prej kësaj banese të përkohshme e kalimtare, banesë që i nënshtrohet venitjes, rënies, moskeqardhjes dhe mashtrimit për ata, të cilët si unë, ndjekin nefset e tyre urdhëruese për të liga.

⁷⁹Kur’an, 3:26

O Zoti im Mëshirëplotë, o Zoti im Gjithëbujar! E shoh të afërt exhelin tim dhe e shoh se kam veshur qefinin tim, kam hyrë në arkivol, u kam dhënë lamtumirën të dashurve të mi dhe jam drejtuar drejt varrit.

Unë jam duke thirrur tek dera e mëshirës Tënde: Ndhimë! Ndhimë! O i Dhembshur! O Dorëgjërë! Më shpëto nga turpi e mosbindja!

Ah! Unë jam në qefin, po qëndroj në këmbë përbri varrit tim, dhe duke ngritur kokën time drejt derës së mëshirës Tënde, thërras: Ndhimë! Ndhimë! O i Gjithëmëshirshëm! O i Dhembshur! Më çliro prej peshës së rëndë të mosbindjes.

Ah! Unë jam i mbështjellë me qefinin tim, i shtrirë në varrin tim dhe ata që më përcollën më kanë lënë. Unë jam duke pritur faljen Tënde. Duke parë se nuk ka as shpëtim dhe as vendstrehim, veçse tek Ti, unë thërras: Ndhimë! Ndhimë ndaj ngushtësisë së këtij vendi, prej vetmisë së shkaktuar nga mosbindja dhe prej turpërimit të fytyrës sime për shkak të mëkateve!

O i Gjithëmëshirshëm, o i Dhembshur, o Dorëgjërë, o Shpagues, më shpëto mua prej shoqërimit të mëkateve dhe mosbindjes.

O Zoti im! Mëshira jote është streha ime dhe mjeti im për të arritur tek Ti. Unë i paraqes tek Ti ankesën e ankthit dhe të vuajtjes time.

O Krijuesi im Gjithëbujar! O Zoti im Mëshirëplotë! O Prijësi im! O Ruajtësi im! Krijesa Jote, shpikja Jote dhe robi Yt gjynahqar, i paaftë, i pakujdesshëm, injorant, i sëmurë, i poshtëruar, keqbërës, i moshuar, i mjerë dhe i ikur është rikthyer tek dera Jote pas dyzet vitesh duke kërkuar strehë tek mëshira Jote, duke pranuar mëkatet e Tij dhe gabimet, i sprovuar me iluzione e sëmundje dhe duke u përgjëruar tek Ti me përulësinë më të skajme. Në qoftë se Ti e pranon, e fal dhe e mëshiron, kjo është çfarë pritet prej Teje, meqë Ti je më Mëshiruesi i mëshiruesve. Përndryshe, çfarë dere tjetër do të gjendej përveç derës Tënde? Ti je Zoti i Synuar dhe i Vërteti për t'u adhuruar, dhe nuk ka zot tjetër përveç Teje, Ti je Një dhe pa asnjë ortakë.

Fjala e fundit: Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, dhe gjithashtu dëshmoj se Muhammedi është i dërguari i Allahut.

SHTOJCË

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
الْحَمْدُ لِلَّهِ عَلَى نِعْمَتِهِ بِإِنزَالِ الْقُرْآنِ وَعَلَى رَحْمَتِهِ
بِإِزْسَالِ سَيِّدِ الْأَنْبِيَاءِ عَلَيْهِ وَعَلَى آلِهِ الصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi Zotit për mirësinë e Tij ndaj nesh duke shpallur Kuranin dhe për mëshirën e Tij të manifestuar duke na dërguar prijësin e krijimit, Muhammedin a.s.m paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!

Mësoje, o shok! Krijuesi i Gjithurtë Xhel–le Xhelaluhu, qoftë i lartësuar, e ka bërë botën e bimëve dhe të kafshëve –sidomos speciet e të vegjëlve midis tyre– njërën prej arenave më të gjëra të veprimit autoritar të fuqisë së Tij dhe të manifestimeve të Atributeve të Tij në shumësinë më të madhe, dhe njërën prej fushave ku gjenden shumica e ‘pasqyrave’ duke reflektuar Emrat e Tij. Kjo është kështu për shkak të disa qëllimeve dhe urtësive të urta e të larta, disa prej të cilave janë si më poshtë vijon:

Bimët shërbejnë si farëra për tokën, dhe kafshët janë frutat e botës. Një farë ose një bërthamë është një model i zvogëluar i pemës, dhe fruti është indeksi i zvogëluar i saj. Çfarëdo që manifestohet në një pemë, manifestohet gjithashtu në të dyja ato, në farën dhe në frutin. Qëllimi për ekzistencën dhe jetën është të marrë e reflektojë manifestimet e Emrave të Zotëruesit të madhështisë, bukurisë dhe plotësisë absolute. Përkujdesja Hyjnore e manifeston Vetveten nëpërmjet degëzimit ose zhvillimit dhe riprodhimit të bimëve dhe të kafshëve, sidomos me të gjitha pjesët e tyre më të holla dhe anëtarët individualë, dhe kjo është çfarë është më e përshtatshme për urtësinë e përjetshme.

Rrëfëhet se profeti Musa a.s iu ankua Zotit rreth shumësisë së mushkonjave që po e sulmonin dhe pyeti: Cila është urtësia e tyre në krijimin e tyre kaq të shumta? Allahu i shpalli atij në përgjigje:

“Mushkonja pyet: përse e krijove këtë njeri me një vëllim të tillë kaq të madh, ndërsa ai është shumë i pakujdesshëm dhe i pavetëdijshëm ndaj Teje? Në qoftë se do ta kishe bërë kokën e tij prej mushkonjash, Ti do të kishe pasur dhjetëra e mijëra prej atyre që të lavdërojnë Ty me lëvdata e me dhikr duke të të përmendur dhe duke shfaqur manifestimet e Emrave të Tu dhe qëndisjet e Artit Tënd nëpërmjet gjuhëve dhe aftësive të tyre të bashkëlindura”.

Vërtet! Ndërsa Kurani shpirtëror – i padukshëm i shkruar me bojën e yjeve në fletët e sferave të qiejve dhe të tokës lexon për sytë shenjat e madhështisë së krijimit, dhe së bashku me të Kurani i shkruar me bojën e grimcave nënatomike në atomet e syrit tënd, lexon shenjat e njohjes dhe të urtësisë.

Kur ti dëgjon prej të parit, lavdi qoftë për Të, “Sa madhështore janë cilësitë e Tij esenciale”, ti dëgjon prej të dytit, gjithashtu, “Sa e hollë është urtësia e Tij dhe sa i hollë është arti i Tij”. Megjithëse të dy Kuranet janë prej të njëjtës vlerë e rëndësi, meqenëse nuk ka dobi për vëzhguesit dhe shikuesit që t’i shumojnë kopjet e të parit, ndërsa shumimi i kopjeve të të vogëlit është sigurisht i një rëndësie shumë të madhe për ata ëngjëj të panumërt, për xhindët dhe njerëzit, dhe për të tjerët që e studiojnë atë dhe reflektojnë, kur shumohet ai nuk do të mbetet i njëjti libër i vetëm, por do të jetë prej larmive të pafundme të ndryshme dhe i dobive të ndryshme dhe me kuptime të ndryshme, dhe si rrjedhojë, shtohet në bukuri dhe pastërtinë e shprehjes. Për më tepër, kur shumë prej kapitujve të Kuranit më të vogël dhe kopjet e tij ndërfiten në disa prej shkronjave të të madhit, Kurani i vogël ia kalon të madhit me shkallën e vogëlsisë së tij.

Një qëllim tjetër i urtë për krijimin e kafshëve dhe bimëve në numra të mëdhenj është më e plotë e manifestimeve të Hyjnisë është se Zoti e manifeston Vetveten me të gjithë Emrat e Tij të përqëndruara mbi një qenie të vetme. Dhe arti bëhet më i plotë kur gjëja më e madhe ndërfitet në më të vogëlën me të gjitha qëndisjet e saj. Fara dhe fruti në lidhje me pemën, bimët dhe kafshët në lidhje me tokën, njeriu dhe profeti në lidhje me universin, dhe zemra dhe shqisa më e brendshme ose aftësia e njeriut në lidhje me njeriun, këto janë modele –shembuj– esenciale dhe të përmbledhur që marrin e reflektojnë të gjithë Emrat e manifestuar mbi origjinalet, mbi tërësoret dhe të gjithanshmet. Një frut, për shembull, duke qenë si një pjesë e pemës, dhe pema duke

përfaqësuar tërësinë, tregojnë Unitetin, manifestimin e Emrave Hyjnorë mbi të gjitha frutat dhe pemët. Por duke qenë një model i pemës, (duke përmbajtur çfarëdo që ndodhet në pemë) dhe pema duke përfaqësuar shumën e përgjithshme që rritet prej tij dhe që rezulton në të, tregon Njësinë Hyjnore, manifestimin e Emrave Hyjnorë si të përqëndruar mbi frutin.

Për shembull, *وَاللَّهُ الْمَثَلُ لَا عَلَى* “Dhe për Zotin është krahasimi më i lartë”, drita e diellit duke ndriçuar botën në kohë dite është një shembull për manifestimin e Unitetit, ndërsa imazhi i diellit duke u reflektuar në çdo objekt të tejdukshëm, në një pikë uji, në një pellg, në një oqean dhe në planete është një shembull ose analogji për manifestimin e njësisë. Kur ti e sheh diellin në pasqyrën tënde duke marrë ngjyrën dhe cilësitë e pasqyrës dhe pastaj e shikon atë në pasqyra të tjera, ti do të kuptosh e dëshmosh se çfarë do të thotë Njësi apo Unitet. Është i njëjti dhe i vetmi diell që manifestohet në të gjitha pasqyrat. Të cilat shpallin:

*عِبَارَاتُنَا شَتَّى وَحُسْنُكَ وَاحِدٌ * وَكُلُّ إِلَى ذَاكَ الْجَمَالِ يُشِيرُ*

Shprehjet tona janë të ndryshme, por bukuria Jote është Një.

Çfarëdo që është në ekzistencë tregojnë atë bukuri.

Nga kjo kuptohet se Krijuesi i Gjithurtë me urtësinë e Tij të lartësuar dhe me artin e Tij të hollë, kthehet me fuqinë e Tij më të hollë dhe me përkujdesjen e Tij më të përkryer dhe me mëshirën e Tij më të plotë dhe me urtësinë e Tij më të ndjeshme, nga tërësia e krijimit për tek toka, dhe prej aty për tek gjallesat, dhe prej tyre tek njeriu, dhe prej individit të njeriut tek zemra e tij, dhe prej llojit njerëzor tek ajo që është zemra e njerëzimit dhe krijimi dhe bërthama e tij, prej të cilës u krijua universi, dhe gjithashtu fruti i saj i ndritshëm, i cili është qëllimi përfundimtar për krijimin e universit dhe mishërimi i dashurisë së Krijuesit dhe i mëshirës së Tij. Dhe ajo zemër e lartësuar, e shtrenjtë, e pastër dhe e panjollësor është Muhammedi a.s.m, prijësi ynë dhe prijësi i të gjithë krijimit, paqja dhe bekimet qofshin sa numri i frutave të pemës së krijimit.

Mësoje, o ti që pandeh se ka tepërcë e kotësi në ekzistencën e disa krijesave! Plotësia e rregullit dhe e ekuilibrit në krijim e refuzon një

përfytyrim të tillë, sepse rregulli është një skicim, projektim i ndërthurur nga urtësia e të gjitha pjesëve, të veçantave ose individualeve, ose detajeve në krijim. Do të ishte e pamundur për dikë që të vëzhgojë qëllimet e të gjitha detajeve të një pallati, as nuk e neglizhon ai qëllimin kryesor të parashikuar prej ndërtimit të tij. Meqenëse qëllimi kryesor merret në konsideratë kur ai ndërtohet me të gjitha detajet, qëllimet dytësore të parashikuara prej detajeve vëzhgohen kështu. Në qoftë se dëshiron ta verifikosh këtë, dëgjoje me një zemër vigjilente dhe me një dëgjim të mprehtë:

Ndodhen qëllime të holla prapa çdo gjëje, që lidhen me Pronarin, të Gjallin e Përrjetshëm dhe Vetekzistuesin e Përhershëm në proporcion me pronësinë e Tij dhe autoritetin dhe shtrirjen e manifestimit të Emrave mbi atë gjë. Qëllimet e lidhura me vetë gjënë janë gjithashtu në proporcion me jetën dhe ekzistencën e saj.

Çdo gjëje i është paracaktuar një qëllim në jetë, i cili studiohet nga qëniet me mend. Në qoftë se një njeri nuk mund ta dallojë atë këtu, të tjerët mund ta dallojnë, dhe ndodhen shumë mënyra për të përfituar prej çdo gjëje.

وَمَا يَعْلَمُ جُنُودَ رَبِّكَ إِلَّا هُوَ

“Dhe askush nuk i njeh ushtarët e Zotit tënd veçse Ai”⁸⁰

Nuk ka asgjë në ekzistencë, veçse mbi të janë fokusuar shikimet e vëmendshme të qënieve të panumërta. Midis tyre janë melekët që e lavdërojnë dhe e lartësojnë Allahun me të gjitha llojet dhe varietetet e tyre, dhe xhindët duke e vëzhguar krijimin me habi dhe duke reflektuar mbi të me të gjitha klasat dhe grupet e tyre, dhe qëniet shpirtërore duke e lavdëruar Zotin dhe duke deklaruar Unitetin e Tij me të gjitha klasat dhe fiset e tyre; ngurtësia e gjërave nuk formon një pengesë për të shikuar çfarë është në to dhe vështrimi i të cilëve për diçka nuk i pengon nga vëzhgimi i gjërave të tjera. Dhe mbi të gjitha, Autori Krijues i të gjitha gjërave vështron veprat e artit të Tij. Gjithashtu, shumë besimtarë të zgjuar e të ndritur dhe shumë kafshë që lëvizin me shqisat e tyre vështrojnë veprat e artit të Krijuesit.

⁸⁰Kur'an, 74:31

Në qoftë se ti pyet: Cilat nga shenjat e universit e tregojnë ekzistencën e atyre vështruesve ndryshe nga njeriu, të cilët i studiojnë ato me habi e reflektim dhe atëherë nisin ta lavdërojnë Zotin? Cili rresht në atë libër e tregon këtë?

Përgjigja: Rregulli në rreshtin e ekuilibrit në faqen e urtësisë e tregon këtë. Kur ti hyn në një godinë teatri ku po performohet një dramë, ti sheh shumë lloje çudirash që i habitin ata të cilët i shohin, shumë lloje melodish duke i kënaqur ata që i dëgjojnë dhe shumë lloje magjepsje me të cilat mendjet dhe imagjinatat gjejnë kënaqësi. Ndodhen gjithashtu shumë gjëra të tjera, të cilat japin kënaqësi për aftësi të panumërta, për ndjenjat dhe shqisat e njeriut. Pastaj, ti sodit tek salla e spektatorëve dhe do të shohësh veçse pak fëmijë të paralizuar, të shurdhër e të verbër. Ti sigurisht do të dalësh me përfundimin se prapa perdeve të varura përpara mureve ndodhen qenie të ndryshme, inteligjente, me shije e temperamente të ndryshme, të cilët kanë ardhur për një zbatimje të pafajshme dhe janë të kënaqur për të shikuar çdo risi në dramë. Ata të shohin ty dhe dramën nga ku ti nuk mund t'i shohësh.

Në qoftë se e kap kuptimin e këtij krahasimi, shikoj ato krijesa bashkë me botën në të cilën ato janë. Ti do të shohësh ‘qilima’ të hapur, ‘divane’ të vendosur, ‘mantele’ të veshur dhe ‘çarçafë’ të shpalosur. Gjithashtu, ndodhen lule dhe fruta të freskët që u bëjnë ftesë për tek vetvetja me ngjyrat e tyre, shijet dhe me aromat e qënieve të gjalla të ndryshme, dhe u bëjnë thirrje qënieve inteligjente dhe njerëzve të konceptimit me skicimet e tyre, me zbukurimet dhe artin. Përsëri, ndodhen bimë që ngrihen drejt mbi kërcellët e tyre për të përmbushur detyrën e tyre të krijimit, dhe kafshët duke qëndruar mbi këmbët e tyre për të bërë detyrën e tyre të adhurimit. Shumica e atyre krijesave nuk janë të vetëdijshme për bukuritë e pastërta dhe aftësitë e holla të vendosura tek qëniet e tyre. Ato aftësi dhe bukuri nuk janë për ato krijesa të pavetëdijshme dhe memece që i mbajnë ato. Ato janë për të tjerët, të cilët kanë fuqinë e të shikuarit dhe të dëgjuarit. Pavarësisht kësaj madhështie tërheqëse dhe stolie magjepsëse, llojeve të favorizimit, gjërave dhe ngjarjeve që ngjallin kureshtje për njohje dhe ndjenjat e dashurisë për Atë që është prapa tyre, dhe pavarësisht të gjitha iniciativave, qëllimeve dhe vendimeve, vetëzbuqurimeve, buzëqeshjeve, bërjeve me shenjë, përkëdheljeve dhe shumë tërheqjeve të tjera të ngjashme dhe joshjeve që pothuajse nisin të flasin e të tregojnë kuptimet e tyre, midis qënieve të gjalla inteligjente e të

kuptueshme, ne mund të shohim dukshëm në botë vetëm ato dy lloje qëniesh të peshës –njerëz dhe xhinde– pakujdesia e shumicës së të cilëve i ka bërë ata si fëmijë të shurdhër e të verbër me mendje të paralizuar në errësirën e materializmit dhe natyralizmit. Kjo tregon qartë dhe është dukshëm e arsyeshme se përveç njerëzve dhe xhindëve, universi është i mbushur me shpirtëra të cilët reflektojnë mbi ekzistencën dhe e lavdërojnë Allahun xh.sh, ashtu siç deklarohet në Kuran:

تَسْبِيحٌ لَهُ السَّمَوَاتُ السَّبْعُ وَالْأَرْضُ وَمَنْ فِيهِنَّ وَإِنْ مِنْ شَيْءٍ
إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ وَلَكِنْ لَا تَفْقَهُونَ تَسْبِيحَهُمْ ... الخ

“Shtatë qiejt dhe toka dhe kushdo që është në to, e lavdërojnë Atë; dhe nuk ka asgjë që të mos e lëvdojë Atë me lëvdata, por ju nuk e kuptoni lavdërimin e tyre”⁸¹

Mësoje, o shok! Sa më i gjërë të jetë veprimi autoritar i Fuqisë Hyjnore në të pjesshme dhe sa më shumë në numër me të ngjashmet të jenë ato, aq më e madhe është përkujdesja Hyjnore mbi një individ. Mos thuaj: “Unë jam një pikë në një oqean që harrohem për shkak të gjërësisë së oqeanit”. Jo, përkundrazi, ashtu siç dëshmon oqeani, në raport me shtrirjen e mjedisit tënd, ti je nën mbrojtjen e rregullit të qëndrueshëm që mbisundon me të gjithë fuqinë e tij në të gjitha gjërat si ti. Sepse, sa më e vogël, më e fshehur prej syve dhe më e rrethuar që të jetë një gjë, aq më shumë kujdes i jepet asaj dhe më pak e neglizhuar është dhe më shumë e mbrojtur është ndaj ndërhyrjes së të tjerëve dhe ndaj lojërave të rastësisë. Ajo bëhet më e favorizuar si një gjë e krijuar.

A nuk e sheh ti se qendra është më e ruajtur nga sulmet e të tjerëve? Fara është nën mbrojtjen më të madhe kundra dredhive –lojërave– të rastësisë dhe bezdisjes së stuhive, dhe si asaj i jepet një kujdes më i madh?

O njeri! Ti je fara e tokës dhe toka është veza e universit. Për shkak të kësaj, Kurani e përmend shumë herë krijimin e qiejve e të tokës dhe tregon me këtë krijimin e të gjitha gjërave.

⁸¹Kur'an, 17:44

Mësoje, dhe shikoje plotësinë e mirësisë në plotësinë e urtësisë dhe plotësinë e urtësisë në plotësinë e rregullit, dhe plotësinë e rregullit në plotësinë e balancës, ekuilibrit, si për shembull në artin e pesë shqiseve të njeriut. Sepse Krijuesi i ka krijuar pesë shqiset e njeriut në një përbërje të tillë dhe i ka pajisur ato me instrumete të tilla saqë njeriu e ndjen natyrën me to dhe njeh me to veçoritë dhe cilësitë e të gjitha frutave, luleve, tingujve, aromave dhe të tjera të ngjashme me to. Për arsye të tilla, shqisa e të shijuarit ka aq shumë pjesë të holla e të mirorganizuara pajisjeje, saqë ato janë sa numri i shumëllojshmërive të frutave dhe e të gjitha llojeve të ushqimit e të pirjes. Gjithashtu, shqisa e të dëgjuarit ka kapacitetin e marrjes dhe të dallimit midis shumëllojshmërive të panumërta të tingujve. Ti mund t'i krahasosh me këtë shqiset e tjera të jashtme dhe ato të brendshme që janë më shumë në numër dhe më të pasura në pajisje. Kjo natyrë gjithëpërfshirëse e tij e ka bërë njeriun çfarë ai është, duke qenë i aftë për të marrë e reflektuar llojet e pafundme të manifestimeve të Emrave të Kijuesit të tij, Xhel-le Sheënuhu, cilësitë e Tij qofshin të lartësuara, dhe për të shijuar varietete të panumërta të mirësive të Tij.

Shembulli yt, o njeri, është si një çentral telefonik. Ashtu si në një çentral telefonik që ndodhet një kod qëndror për t'i bërë lidhjet brenda një qyteti, edhe ti ke një shqisë qëndrore për të shijuar të gjitha shumëllojshmëritë e Zotit, dhe kode të veçantë i janë bashkëngjitur kokës tënde dhe aftësive të tua për të përjetuar kënaqësinë e qënies tënde për të marrë e reflektuar llojet e panumërta të manifestimeve të Tij. Përdori ato kode siç do të ishte i kënaqur Krijuesi yt duke u sjellur në përputhje me balancën e Sheriatit të Tij

Për shkak të ndryshimeve në shkallët e kapacitetit për t'i përdorur, ato kode do të kenë shkallë të pafundme midis dy personave në përjetimin e kënaqësive të parajsës, ndonëse ata janë në të njëjtin vend. Megjithëse, sihariqi **الْمَرْءُ مَعَ مَنْ أَحَبَّ** "Një njeri do të jetë së bashku me atë që ai e do" i sjell bashkë më të lartin e më të ulëtin në një vend, përjetimi i kënaqësive të parajsës do të jetë i shkallëve pafundësisht të ndryshme në përputhje me si dhe deri në çfarë shtrirje i përdorin njerëzit shqiset, ndjenjat dhe aftësitë e vendosura në natyrat e tyre.

Mësoje, o shok! Konfuzioni i dukshëm dhe gjendja e ngatërruar e gjërave nuk është për shkak se ato janë lodra të rastësisë, përkundrazi, ato janë qëndisjet më të holla të skicimit të përgjithshëm të librit të

universit. Por, ai lloj skicimi nuk mund të dallohet lehtë me një vështrim sipërfaqësor, i pakualifikuar që është drejtuar tek reflektimet e gjërave në pasqyrën e iluzioneve.

A nuk i shikon ti se farërat e përziera të bimëve të ndryshme të shpërndara rastësisht, kuturu, shfaqin një rregull të përkryer kur ato rriten? Pena e Kaderit i vendos ato në atë rregull të mahnitshëm.

Mësoje, o shok! Është një provë vendimtare se Muhammedi a.s.m është vula e profetëve, se ai i shtriu limitet e fesë në të gjitha drejtimit deri në atë pikë që askush nuk mund të perceptojë për një rregull më gjithëpërfshirës e më të plotë. Për shembull, lidhur me Unitetin Hyjnor dhe Qënien Perëndi, ai thotë:

بِيَدِهِ مَقَالِيدُ كُلِّ شَيْءٍ ۚ وَالسَّمَوَاتُ مَطْوِيَّاتٌ بِيَمِينِهِ ۚ
هُوَ الَّذِي يُصَوِّرُكُمْ فِي الْأَرْحَامِ كَيْفَ يَشَاءُ ۚ
هُوَ الْأَوَّلُ وَالْآخِرُ وَالظَّاهِرُ وَالْبَاطِنُ ۗ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ ۚ
وَمَا تَسْأَلُونَ إِلَّا أَنْ يَشَاءَ اللَّهُ ۚ وَنَحْنُ أَقْرَبُ إِلَيْهِ مِنْ حَبْلِ الْوَرِيدِ ۚ

“Në Dorën e të Cilit është mbizotërimi i çdo gjëje”⁸²

“Nuk ka asnjë krijesë të gjallë që Ai të mos e ketë mbërthyer pas balukeve të ballit (ta ketë nën sundimin e Ti të plotë)”⁸³

“Qiejt do të jenë të mbështjellë në Dorën e Tij të Djathtë”⁸⁴

“Ai është i Cili ju formëson në mitra ashtu siç Ai dëshiron”⁸⁵

“Ai është i Pari dhe i Fundit, dhe i Dukshmi dhe i Padukshmi, dhe Ai është i Gjithëditur për të gjitha gjërat, por ju nuk mund të dëshironi, veçse po deshi Allahu”⁸⁶

“Dhe Ne jemi më afër tij sesa vena e qafës”⁸⁷

⁸²Kur'an, 36:83

⁸³Kur'an, 11:56

⁸⁴Kur'an, 39:67

⁸⁵Kur'an, 3:6

⁸⁶Kur'an, 77:30

Gjithashtu, feja Islame solli dekrete që pikat më të largëta në të cilat ndahet lënda, materia, dhe në të cilat limitet e gjërave materiale përfundojnë, në të cilat atomet dhe madje edhe pjesët nënatomike vijnë bashkë me frutet më të mëdhenj të krijimit të tillë si diejt dhe planetet, janë të gjitha të barabarta dhe qëndrojnë sup më sup në bindje ndaj urdhërave të Krijuesit të tyre, i Cili është i lirë prej qënies prej të të njëjtave cilësi si ato dhe i përjashtuar prej të qënurit në nevojë të asaj që ato kanë nevojë. Për sa ka të bëjë me çështjet e Ringjalljes dhe të Unitetit Hyjnor, feja gjithashtu ka arritur tek një pikë, matanë të cilës, në mënyrë të vetëkuptueshme është e pamundur të kalohet. Kështu, në çdo drejtim tjetër, është krejtësisht e pamundur të bësh shtesa të reja për cilindo prej çështjeve të saj, për ta plotësuar e përsosur atë. Prandaj, ajo e ka merituar të jetë e përjetshme, për të vazhduar deri në Ditën e Kijametit.

Mësoje, o shok! I motivuar nga aparencia e prekshme e mjedisit turk, unë vajtova dhe lotët që i derdha janë siç vijon:

Unë jam i përkohshëm, por unë nuk e dua dikë që është i përkohshëm.

Unë jam i pafuqishëm, unë nuk e dëshiroj dikë që është i pafuqishëm.

Unë ia kam nënshtruar shpirtin tim të Gjithëmëshirshmit të Vetëm, unë nuk dua tjetërkënd.

Unë dua vetëm Njërin, i Cili do të mbetet përgjithmonë Miku im.

Unë jam veçse një grimcë e papërfillshme, por unë dëshiroj një Diell të Përjetshëm.

Unë nuk jam asgjë në esencë, por unë mallëngjehem për të gjithë krijimin.

Mos më ftoni tek dynjaja, unë erdha dhe e gjeta atë të keqe e të përkohshme.

Pakujdesia ishte një perde, unë e pashë të mbuluar dritën e të Vërtetit.

Të gjitha gjërat në tërësinë e krijimit i pashë të ishin të përkohshme dhe plot dëm.

⁸⁷Kur'an, 50:16

Ekzistencën në të vërtetë unë e vesha, por medet! Ajo ishte mosekzistencë; unë vuajta shumë.

Sa për jetën, unë e përjetova; e pashë të ishte një torturë brenda torture.

Mendja u bë thjesht ndëshkim; e pashë qëndrueshmërinë të ishte mundim, provë e rëndë.

Jeta ishte si një erë, ajo kaloi në teka e fantazi; e pashë plotësinë të ishte thjesht humbje.

Veprat ishin vetëm për t'u dukur (për të tërhequr vëmendje); i pashë ambiciet të ishin thjesht dhimbje.

Bashkimi ishte në fakt ndarje; e pashë ilaçin të ishte tek sëmundja.

Këto drita u bënë errësirë; i pashë këto miq të ishin jetimë.

Këto zëra ishin lajmërimet e vdekjes; i pashë të gjallët të ishin të vdekur.

Njohja u ndryshua në fantazi; pashë në shkencë me mijëra sëmundje.

Kënaqësitë u bënë thjesht dhimbje; e pashë ekzistencën të përbëhej nga mosekzistenca.

Unë e kam gjetur të dashurin e vërtetë; Ah! Unë vuajta shumë dhimbje nga ndarja.

Unë përfundimisht kam gjetur Zotin; ti kurrë nuk do jesh në gjendje ta gjesh Atë, veçse duke hequr dorë prej gjërave të kësaj bote.

Me këtë dritë unë kam gjetur parajsën në botë; të vdekurit kanë nisur të ringjallen.

Unë kam parë se zërat janë lavdërime për Allahun dhe recitime për Emrat e Tij.

Gjërat janë bërë të njohura.

Kënaqësitë qëndrojnë në vuajtje e dhimbje.

Jeta është bërë një pasqyrë duke reflektuar dritat e së vërtetës.

Qëndrueshmëria, e kam parë, qëndron në vetëasgjësim.

Të gjitha grimcat recitojnë Emrat e Zotit.

Çdo gjë dëshmon për të Vërtetin.

و فِي كُلِّ شَيْءٍ لَهُ آيَةٌ تَدُلُّ عَلَى أَنَّهُ وَاحِدٌ

Në çdo gjë ndodhet një shenjë duke treguar për faktin se Ai është Një.

Mësoje, o ti që pandeh se kënaqësitë dhe lumturia qëndrojnë në pakujdesi dhe në mos'hyrjen brenda limiteve të fesë! Njëherë, unë e testova nefsën tim dhe e pashë veten mbi një urë që shtrihet ndërmjet dy maleve, nën të cilën ishte një luginë shumë e thellë. Ishte errësirë gjithandej. Hodha vështrimin nga e djathta në të shkuarën dhe pashë vetëm shtresa frikësuese errësirash. Vështrova nga e majta në të ardhmen dhe pashë vetëm errësirë tmerruese. Pastaj, sodita poshtë dhe pashë një humnerë të thellë të pafund. Pastaj, drejtova shikimin lart dhe pashë re të errëta, të shurdhëta e memece duke zbritur poshtë veç dëshpërim e pikëllim, brengë e dëm. Pastaj, vështrova para dhe pashë midis errësirës shejtanët e llojit më të lig, akrepa, luanë dhe ujqër me dhëmbët gati për të shqyer. Kur përfundimisht ktheva shikimin prapa, unë nuk pashë as ndihmë dhe as ndihmues.

Ndërsa isha në këtë gjendje të pashpresë, dhe i lodhur nga qënia i testuar në botë, udhëzimi Hyjnor më erdhi në ndihmë, dhe unë pashë hënën e Islamit të shfaqej mbi krijesat dhe dielli i Kuranit ndriçoi të gjitha anët. Unë gjithashtu e pashë urën (e jetës) si një rrugë që kalonte midis mirësive të të Lartësuarit të Vetëm duke përfunduar tek parajsa e mëshirës së të Gjithëmëshirshmit. Në të djathtën time shtriheshin kopshtet e së shkuarës të mbushura plot me lulet e të drejtëve, e ndriçuar me frutet e evlijave, në të cilët lumenjtë e kohës rrjedhin ndërsa ata janë përjetësisht në qëndrueshmëri. Në të majtën time, gjithashtu ndodheshin kopshte, ku lulet e ambicieve dhe të pritshmërive hapeshin prej mëshirës së të Dhembshurit Dorëgjërë. Sipër meje rrinin pezull retë e mëshirës duke lëshuar mbi ne ujin e jetës, në mes të të cilave dielli po buzëqeshte me dritat e udhëzimit dhe të lumturisë së përjetshme. Në fushat që shtriheshin përpara meje, ndodheshin vëllezërit e mi, miqtë dhe kafshët e zbutura, të cilat errësira e çudhëzimit m'i kishte shfaqur si kafshë të egra e të dëmshme.

Për ta kuptuar këtë ëndërr, lexova vërsetin:

اللَّهُ وَلِيُّ الَّذِينَ آمَنُوا يُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ وَالَّذِينَ
 كَفَرُوا أَوْلِيَاؤُهُمُ الطَّاغُوتُ يُخْرِجُونَهُم مِّنَ النُّورِ إِلَى الظُّلُمَاتِ ۗ
 يَا نُورَ النُّورِ بِحَقِّ اسْمِكَ النُّورِ أَخْرَجْنَا مِنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ

“Allahu është Mbrojtësi i atyre që e besojnë Atë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë, por sa për ata që nuk besojnë, ndihmuesit e tyre janë tagutët; këta i nxjerrin nga drita dhe i zhysin në errësirë”⁸⁸

O Drita e dritave! Për hir të Emrit Tënd të dritës “En-Nur” na nxirr neve prej errësirave në dritë... Amin! Amin!

Mësoje, o Said i marrë, i mjerë! Shembulli yt është si ai i një fëmije idiot që rri ulur në bregdet dhe qan papushim për zhdukjen e flluskave që reflektojnë diellin. Meqenëse çdo flluskë zhduket, ai vajton duke menduar se imazhi buzëqeshës i diellit i reflektuar te ajo do të shuhet – vdesë– përjetësisht. Ai qan meqë i sheh flluskat të bëhen të turbullta dhe të pakënaqura me përzierjen me gjëra të ngurta. Ai nuk e ngre kokën e tij derisa të kuptojë se të gjitha imazhet e reflektuara në flluska janë manifestimet e dritave të diellit të ripërtërira mbi sipërfaqen e detit, në faqet e valëve dhe në sytë e pikave. Dielli nuk zhduket me zhdukjen e pasqyrave ku ai reflektohet, dhe si rrjedhojë, zhdukja e imazheve të tij në disa pasqyra nuk është një zhdukje e dhimbshme dhe as një ndarje e trishtueshme. Me fytyrën e tij rrezatuese dhe me bukuritë dhe plotësitë e madhështisë së tij, dielli është i përhershëm gjatë ripërtëritjes së vazhdueshme të manifestimeve të tij në shumësinë e pasqyrave (ku ai reflektohet). Sa për pasqyrat dhe objektet e tjera që marrin manifestimet e diellit, ato i përmbushin detyrat e tyre me gëzim e hare dhe kur i plotësojnë detyrat e tyre, ato fshihen duke buzëqeshur.

Në të njëjtën mënyrë, ti je duke qëndruar në bregun e oqeanit të jetës. Ti qan i pikëlluar për perëndimin e qënieve të plotësisë, të bukurisë dhe të hijeshisë dhe për zhdukjen e frutave të mirësive Hyjnore kur u mbaron afati. Në pakujdesi, ti supozon se bukuritë u përkasin vetë gjërave të bukura dhe frutat pemëve. Stuhitë e rastësisë godasin dhe i rrëmbejnë ato, dhe sipas supozimit tënd, ato zhduken në errësirën e mosekzistencës së përjetshme. A nuk e mendon ti se Ai, i Cili i ka ndriçuar të gjitha gjërat që ti i do me dritën e bukurisë është

⁸⁸Kur'an, 2:257

pikërisht Ai, i Cili i ka ndriçuar të gjitha lulet në kopështin e universit dhe i nxit drejt tyre zemrat e bilbilave ashikë – dashurues?

Sa shumë do të vajtosh, o i mjerë, për zhdukjen e frutave në dorën tënde?! Shiko vazhdimësinë e mirësive të *El-Falikul Habbi Ven-Neva*, “Çarësit të kokrrave dhe bërthamave” duke mbajtur pemën e atyre frutave. Madje, edhe në qoftë se ajo pemë ndalon së dhëni fruta, shiko shtrirjen e sferës së favorizimit të Tij gjithandej botës ku gjenden pemë të panumërta të të njëjtit lloj. Pastaj, në qoftë se ndodhet krizë – mungesë– fruti këtë vit, shiko shtrirjen e favorizimit të Tij të ripërtëritë me ripërtëritjen e stinëve dhe viteve. Pastaj, shiko sferën e favorizimit të Tij duke vazhduar në botën e shëmbëllesës, ose në formën jolëndore dhe në Berzah –në botën e ndërmjetme– me ngjashmëritë e asaj që shikon në këtë botë të dukshme. Pastaj, shiko shtrirjen e sferës më të gjërë e të përjetshme të Tij në Ahiret, ku ti do të gjesh ngjashmëritë e asaj që ti pate bërë miqësi të ngushtë në kopështin e botës. Dhe pastaj... e pastaj... dhe kështu me rradhë.

Mos e shiko mirësinë në mënyrë të pakujdesshme nga akti i të dhënit të mirësive. Përndryshe, ty do të të duhej të kërkoje ngushëllim në qarje. Por shiko prej mirësive tek akti i të dhënit mirësi dhe vazhdimësinë e saj; dhe prej aktit të të dhënit mirësi tek Dhuruesi i mirësive bashkë me gjithëpërfshirjen e vërshimit të mirësive të Tij me bollëk dhe plotësinë e mëshirës së Tij. Buzëqesh me mirënjohje ndaj Tij dhe bëhu i lehtësuar e i gëzuar prej mirësive të Tij.

Kurdoherë që sytë e tu derdhin lot dhe zemra jote qan për ndarjen e gjërave të bukura të përkohshme, shiko shumësinë dhe gjërësinë e sferave njëra brenda tjetrës, që përmbajnë gjithçka që ti do. Kënaqësia e ripërtëritjes së tyre tek gjërat e ngjashme me to do të të bëjë ty të harrosh dhimbjet e ndarjes. Të gjitha ato sfera pafundësisht të ndryshme në përmasa prej asaj më të vogël se unaza jote për tek ajo më e madhe se zona e yjësive, dhe zhdukjet, qëndrueshmëritë, jetëshkurtësitë pafundësisht të ndryshme prej çastit dhe minutit për tek jeta e botës dhe e përjetësisë, janë të gjitha pasqyra për reflektimet ose mjete për manifestimet e hijeve të dritave të bukuri së Zotëruesit të madhështisë, të mirëbërësisë së parapërtjetshme dhe të paspërtjetshme, të Amshuarit, Vetekzistuesit të Përhershëm, të Qëndrueshmit të Përtjetshëm, të Lartësuarit dhe të Shenjtëruarit, i Cili nuk ka as fillim dhe as fund, dhe i Cili është i përjashtuar prej ndryshimeve dhe

ndërrimeve. Kurrë mos mendo se ajo që reflektohet në pasqyrë të jetë pronë e pasqyrës me qëllim që të mos qash për shkak të thyerjes ose vdekjes së pasqyrës. Largoje shikimin tënd prej dynjasë, për sa ka të bëjë me mbajtjen e saj, dhe drejtoje tek pasqyra e zemrës tënde, me qëllim që ti të mund ta shohësh Diellin e bukurisë dhe të njohësh se çfarëdo që ti sheh dhe do në botë është një shenjë e Tij. Midis shenjave të hijeshisë dhe bukurisë së Tij, është se Ai i ka zbukuruar qiejt me llampa dhe tokën me lule. Dhe midis shenjave të bukurisë së Tij është se Ai e ka krijuar njeriun në modelin më të bukur dhe me trupin më të mirë, dhe e ka shkruar librin e universit me shkronjat më të mrekullueshme. Gjithashtu, midis shenjave të madhësisë së Tij është se Ai i ka bërë të ndritshëm e brilantë shpirtërat e profetëve, ka ndriçuar misteret e evlijave, ka stolitur zemrat e arifinëve – njohësve – me dritat e bukurisë së Tij Xhel–le Xhelaluhu, madhështia e Tij qoftë e lartësuar!

Mësoje, o ego mendjemadhe! Ti je në një pafuqi absolute dhe në një varfëri absolute, dhe je e mbyllur brenda kaq shumë limiteve dhe kufizimeve, saqë ti je si një grimcë e vockël, e humbur midis grumbujve të gjërave ose si një mizë e shtypur në peshën e ngjarjeve aq të rënda si malet, ose si një bletë e hedhur këtej apo andej nga stuhitë. Prandaj, ashtu siç e shikon edhe ti vetë, nuk mund të ketë asnjë krahasim midis teje dhe Atij, fuqia dhe pasuria e të Cilit nuk ka kufi dhe manifestimet e Emrave dhe Atributeve të të Cilit nuk kanë kufizime. Tërësia e krijimit është në kapjen e fuqisë së Tij dhe qiejt janë të mbështjellur në Dorën e Tij të djathtë; madje edhe grimca më e vockël nuk mund të lëvizë pa lejen e Tij, dhe nuk ka ortakë me Të as në sovranitetin e Tij absolut dhe as në Hyjni; dhe asnjë nuk mund ta kundërshtojë Atë në sundimin e Tij absolut dhe në Hyjninë e Tij. Nuk ka zot tjetër përveç Atij!

Në qoftë se detyra jote në botë do të ishte për të hyrë në ortakëri me Krijuesin Tënd në Hyjninë e Tij, qoftë Ai i Lartësuar, atëherë do të duheshin lidhje të krahasueshme midis teje dhe Atij. Por, ti e shikon se as nuk mund të ketë ndonjë lidhje të tillë! Si do të mundej një ‘mushkonjë’ t’i thurte ato mantele të pasur e të zbukuruar të prera e të modeluara për ato botëra në përputhje me masën e secilës prej tyre? Detyra e pritur prej teje është të jesh një shërbëtoreshë adhuruese në të cilën qëndron plotësia e potencialeve të tua. Robëria mbështetet e lulëzon nëpërmjet përlësisë dhe njohjes së asgjëje para Zotit xh.sh.. Ajo fillon me këtë njohje dhe përfundon me të qënurit i dashuri i Zotit.

Robëria është e kundërta e Perëndisë dhe e Sovranitetit; dhe krahasimi midis tyre është se nuk ka krahasim. Ti duhesh nga Zoti dhe meriton mëshirën e Tij me shtrirjen e vetëdijes tënde për qënien tënde prej Perëndisë dhe Sovranitetit.

Ashtu si një faqe e zezë –e errët– që shfaq shkronjat e ndritshme të shkruara në të, robëria reflekton dhe shfaq Hyjninë në kontrast. Sa më e zezë të jetë faqja, aq qartë e në mënyrë rrezatuese ajo e shfaq Hyjninë. Sa më të vetëdijshme për qënien e tyre asgjë të jenë qëniet, aq më qartë e më rrezatuese ato reflektojnë manifestimet e ekzistencës së Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm Xhel–le Xhelaluhu, dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij.

Mësoje, o ti që pandeh se ka ekzagjerim në disa prej thënieve të profetit lidhur me virtytet e veprave fetare. Ndodhen rrëfenja, që për shembull, tregojnë se *“Kushdo që bën prej veprave të virtytshme, atij i jepet aq shumë shpërblim sa ai i njerëzimit dhe i xhindëve”*. Disa i kanë interpretuar thënie të tilla me kuptim për t’i inkurajuar njerëzit për t’i bërë ato akte; ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se ato u shfaqën për të shprehur se sa me meritë janë veprat e mira. Sidoqoftë, është e mundur ta fitosh shpërblimin e premtuar në rrëfenja të tilla që kërkojnë interpretim, por kjo varet mbi disa kushte. Është e mjaftueshme të mbështesësh vërtetësinë e tyre, se disa dhe jo të gjithë ata që i kryejnë vepra të tilla, mund të fitojnë shpërblimin e premtuar, jo në të gjitha kohët që i kryejnë ato, por në disa rrethana.

Rrëfenja të tilla u shprehën për të përçuar idenë se ndodhet një shpërblim i mundshëm në vepra të tilla, megjithëse ai shpërblim nuk mund të fitohet nga gjithkush. Ai shpërblim nuk mund të fitohet kurdo që kryhen ato vepra, meqë ai kërkon sinqeritetin më të skajmë dhe qënien e tyre të pranuar nga Zoti xh.sh për ta fituar atë. Gjithashtu, më është zbuluar mua tani se sevabi –shpërblimi– vjen nga mirësia e Zotit dhe prej vërshimit të mirësisë prej Tij. Dhe shërbëtori do të ndjejë nevojë të pafundme për shpërblim në vendbanimin e përjetshëm. Kështu, shikimi i shërbëtorit nuk mund ta kapë e përfshijë atë çfarë i jepet nga Ai për mirësinë vërshuese të të Cilit nevojat e shërbëtorëve janë të pafundme në banesën e përjetësisë që s’ka fund për vazhdimësinë e saj.

Kur ti e shikon mirësinë e Allahut nga këndvështrimi i vetë Allahut, ajo nënkupton pafundësi dhe si rrjedhojë është përtej njohjes së

shërbëtorit. Për shembull, rrëfëhet se “kushdo që rrëfen këtë do t’i jepet aq shumë shpërblim, sevab, sa ai i Musait dhe i Harunit, paqja qoftë mbi ta”. Shpërblimi që jepet për një veprim të tillë nuk shtohet në shikimin tënd të kufizuar në këtë botë të kufizuar. Por, kur përafroshesh lidhur me mirësinë e pafundme të Allahut, shpërblimi i premtuar në rrëfenjë varet nga sinqeriteti ose pastërtia e qëllimit dhe nga qënia e veprimit i pranuar nga Zoti xh.sh.. Gjithashtu, krahasimi në rrëfenjë bëhet për të shprehur sasi, jo cilësi. Një pikë, e cila përfshin imazhin e diellit mund t’i thotë detit: “Fytyra jote nuk është më e gjerë se sa syri im për të marrë dritën e diellit dhe ngjyrat që ti i përmban”.

Shpërblimi i premtuar në hadithet profetike në çështje lidhet me botën e ekzistencës së pakushtëzuar, me botën e absolutësisë. Një grimcë e vockël prej asaj bote mund të përmbajë e përfshijë një botë prej kësaj bote materiale, ashtu si copa më e vogël e xhamit që mund t’i përfshijë qiejt me të gjithë yjet e tyre. Përsëri, ndonjëherë ndodh që dikush mund t’i hapë me lehtësi thesaret e mëshirës me një fjalë të mirë në një gjendje të bekuar, të shenjtë. Njerëzit e shikojnë çdo gjë prej pasqyrave të tyre dhe priren ta gjykojnë absoluten dhe universalen me kriterin e tyre të pjesshëm dhe individual. Megjithatë, njohja është me Njohësin e të padukshmes dhe Ndryshuesin e zemrave Xhel–le Xhelaluhu, qoftë Ai i lavdëruar.

ذَرَّةٌ

مِنْ شُعَاعِ هِدَايَةِ الْقُرْآنِ

Një grimcë

Prej Rrezeve të Kuranit

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

O Ti që të përket mbisundimi dhe lavdërimi! Jepi paqë e bekime prijësit të njerëzimit, të cilit Ti iu adresove si: “يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ” “O profet!”,⁸⁹ ai u përgjigj: “لَبَّيْكَ” “Ja ku jam, në shërbimin Tënd”.

Përgjigjja e tij madje bëri jehonë midis kodrave të melekëve të qiejve më të lartë. Ti e urdhërove atë: “*Sihariqo dhe paralajmëro!*”, ai bëri thirrjen:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ اعْبُدُوا رَبَّكُمْ “*O njerëz! Adhurojeni Zotin tuaj*”.⁹⁰

Thirrja e tij bëri jehonë nëpër periudhat e kohës dhe në të gjitha pjesët e hapësirës, dhe ai vetë u bë “*Një sihariques dhe një paralajmërues*”.⁹¹

⁸⁹Kur'an, 8:64

⁹⁰Kur'an, 2:21

Ai e shikon dhe e dëshmon të vërtetën e asaj që ai sheh, duke u bërë thirrje të gjithë brezave të njerëzimit përmes shekujve dhe trevave. Ai bëri thirrje me zërin më të lartë të Tij dhe u dëgjua nga të gjitha kohët dhe vendet. Sepse bota është mbushur me thirrjen e Kuranit dhe ai ka sjellë nën sundimin e tij gjysmën e tij, të cilën ai e ka tërhequr tek vetja e tij dhe tek Kurani. Ai e tërhoqi atë me zellin e tij të plotë, siç dëshmohej nga jeta dhe sjellja e tij, dhe me besnikërinë e tij më të skajme dhe me besimin në mesazhin e tij, siç dëshmohej nga thjeshtësia e jetës së tij dhe abstenimit të tij për kënaqësitë e botës. Ai gjithashtu e tërhoqi me bindjen e tij të pafundme dhe me paqen e qetësinë e mendjes, siç dëshmohej nga fuqia e parimeve dhe e mësimdhënies së tij, dhe me plotësinë e besimit të tij, siç dëshmohej nga fakti se ai ishte më i avancuari në robërinë ndaj Allahut dhe më i devotshmi dhe më i shmanguri prej mëkateve.

اعْلَمْ يَا أَيُّهَا النَّفْسُ الْجَاهِلَةُ Mësoje, o nefsi injorant! Dyert e hapura drejt Allahut janë sa numri i pjesëve (të librit) të universit dhe i faqeve të tij, dhe sa numri i pjesëve përbërëse të tij njëra mbi ose nën tjetrën. Sa injorancë e madhe do të ishte të hamendësoje se të gjitha ato dyer janë të mbyllura kur njëra prej tyre është e mbyllur për ty. Me këtë hamendësim, ti je si dikush që kur nuk mund të shohë kalorës në ndonjë qytet, del me përfundimin se nuk ka mbret në atë vend; ai injorant i shpërfill të gjitha rregullat dhe udhëzimet e mbretit, ndonëse vendi është plot me ushtarët e mbretit dhe me zyrtarët dhe institucionet e qeverisë.

Mësoje, o shok! Është një provë për faktin se ana e brendshme e ekzistencës është më e lartë, më e shkëlqyer, më e ndjeshme dhe më e fortë në jetë, më e zbuluar, më e hollë dhe më e mirë se ana e jashtme e saj, saqë ajo çfarë e shfaq e jashtëmja në emrin e jetës, vetëdijes dhe plotësisë, është vetëm se një shenjë e jetës, vetëdijes dhe plotësisë së të brendshmes. Do të ishte e pamundur që ana e jashtme të mund të shfaqte jetë dhe vetëdije, kurse ajo e brendshme të ishte e pajetë. Stomaku yt është shumë më i sistemuar se sa shtëpia jote; lëkura jote është thurrur në mënyrë më të mirë e më të shkëlqyer se sa rrobat e tua. Dhe kujtesa jote është skicuar e projektuar më mirë se sa libri yt. Ti mund t'i krahasosh me këto shembuj të pjesshëm botërat materiale dhe

⁹¹Kur'an, 2:119

jomateriale, botërat e dukshme dhe të padukshme dhe këtë botë dhe tjetrën.

Ah, mjerë për nefset! Nefsi urdhërues për të liga duke parë me syrin e epshit dhe të fantazive, e shikon anën e jashtme si të gjallë, të dashur dhe të shtruar mbi të brendshmen e pajetë, të errët e të tmerrshme.

Mësoje, o shok! Fytyra jote ka veçori që të dallon ty prej të gjithë njerëzve të së shkuarës dhe të së ardhmes, megjithëse fytyrat e të gjithë njerëzve janë të njëjta në pjesët dhe strukturat e tyre kryesore. Kjo tregon qartë Njësinë e Autorit Krijues se të gjithë njerëzit dhe shumica e kafshëve kanë të njëjtat pjesë themelore të strukturës, ndërsa ndryshimet e pafundme që i dallojnë individët prej njëri-tjetrit, domosdoshmërisht tregojnë se Autori është pafundësisht i Pavarur dhe i Gjithurtë, dhe ka zgjedhje të lirë absolute. Realiteti bëhet më kuptimplotë kur njerëzit shikohen individualisht, veçmas. Do të ishte pafundësisht e pakonceptueshme që ai ndryshim i urtë, dallues dhe i frutshëm, dhe ai dallim i dobishëm të mos ishin prej zgjedhjes së qëllimshme të Një Dëshiruesi me vullnet absolut, dhe prej njohjes së Një të Gjithëdituri.

Lavdi Atij, i Cili përfshin dhe skalit tipare të pafundme dalluese në faqen e fytyrës tënde. Megjithëse ato nuk mund të kapen nga arsyeja dhe nuk mund të shikohen me një shikim sipërfaqësor, ato dallohen me fuqinë e intuitës dhe mund të perceptohen në detaje nga një shikim i kujdesshëm. Do të ishte e pamundur që ndryshime të tilla të rregulluara me paramendim e me qëllim midis njerëzve dhe ngjashmërive të tyre midis anëtarëve të specieve të tilla si gruri dhe rrusi, dhe gjithashtu midis bletëve, mizave dhe peshqive, të ishin vepra e rastësisë së verbër dhe e koinçidencës. Jo! Jo! Ato janë akti i Gjithëdëgjuesit, Gjithëshikuesit, të Gjithëditurit dhe të Gjithurtit.

Në qoftë se më e gjëra e pjesëve të shumësisë, më e largëta, më holla dhe më e parëndësishmja në dukje në nivelet e shumësisë është e mbyllur para rastësisë dhe e ruajtur kundra ndërhyrjes së saj, dhe nuk është neglizhuar e nuk është lënë në tekat e saj, atëherë ajo është arena për veprimet e qëllimit të të Gjithurtit, dhe zgjedhja e të Gjithëditurit dhe e vullnetit të të Gjithëdëgjuesit dhe e Gjithëshikuesit. Prandaj, o rastësi, nuk ka vend për ty në dominimin dhe në pronësinë e Allahut. Kështu, shkoni bashkë me vëllaun tënd, natyralizmin dhe me babain

tënd, shirkun –të përshkruarin ortakë me Zotin– në ferrin e mosekzistencës dhe të asgjësimit të përjetshëm. Vërseti Kuranor,

وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافُ أَلْسِنَتِكُمْ وَاللُّوَانِكُمْ

“Midis shenjave të Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe ndryshimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaj”,⁹²

tregon nivelet e para dhe të fundit të manifestimit të Urtësisë Hyjnore.

Mësoje, o shok! Njëra prej pëshpëritjeve të shejtanit, është se ai thotë: “Në qoftë se, për shembull, lopa është një krijesë, pronë dhe një skicim i të Gjithëditurit të Gjithëfuqishëm të Parapërdjetshëm, përse të jetë ajo një kafshë kaq e varfër? Në qoftë se është Pena e të Gjithëfuqishmit dhe e Dëshiruesit, me Vullnet Absolut ajo e cila vepron në lëkurën e saj dhe brenda trupit të saj, përse ana e jashtme e lëkurës së saj –pjesa e dukshme e trupit të saj– është kaq e butë, e pafuqishme, injorante, jetime dhe e mjerë?”

Pëgjigjja: O shejtan njerëzor që je bërë mësues prej shejtanësh prej xhindësh!

Së pari: Në qoftë se arti i të Gjithëfuqishmit të Parapërdjetshëm nuk do t’i jepte çdo gjëje atë që është e përshtatshme për të me masën dhe sasinë e nevojshme, veshi i gomarit tënd duhej të ishte më inteligjent dhe më i talentuar se ti dhe mësuesit e tu, dhe do të duhej që në brendësi të gishtit tënd të kishte, për shembull, vetëdije dhe fuqi, madje do të duhej të gjendej në gishtërinjtë e tu vetëdije më e madhe dhe më shumë vullnet i lirë se sa vetëdija dhe vullneti yt i tanishëm. Çdo gjëje i është dhënë një kapacitet bashkë me një potencial për t’u zgjeruar e zhvilluar.

Së dyti: I Gjithëfuqishmi –Kaderi Hyjnor– paracakton për çdo gjë një lloj mase ose kallëpi në përputhje me atë masë. Kjo paracakton kapacitetin e asaj gjëje që ajo e ka marrë prej Burimit Absolut të çdo gjëje. Ajo çfarë emërtohet –lëshohet– nga brenda për në anën e jashtme është në përputhje me fuqinë e vullnetit të lirë dhe të kapacitetit të tij dhe në proporcion me nevojën dhe shkallën e saj, dhe në shtrirjen e

⁹²Kur’an, 30:22

aftësisë dhe në përputhje me masën e përcaktuar nga Emrat Hyjnorë të manifestuar mbi atë gjë. Lopa nuk është një përjashtim prej këtij rregulli; nuk është ana e brendshme e një krijese ajo që përcakton anën e jashtme të saj. Ai që pret të shohë në imazhin e një flluske të gjitha cilësitë e diellit, të tilla që ndriçojnë botën, duke tërhequr planetet rreth vetvetes dhe duke qenë qendra e sistemit diellor, duhet të jetë i çmendur. Imazhi i diellit në një flluskë tregon diellin, por jo cilësitë që ka dielli.

Mësoje, o shok! Ti je një vepër e vetëdijshme arti e bërë me urtësi dhe je dikush që tregon Atributet e Autorit. Ti je një gjallesë duke reflektuar urtësinë, e cila qëndis krijimin, njohjen me fuqinë absolute të zgjedhjes, dhe fuqinë që sheh atë çfarë di të përshtatet. Ti je fruti i një mëshire, e cila dëgjon thirrjet e nevojës tënde. Ti je një mishërim i një arti të Dëshiruesit që do atë çfarë do potenciali yt dhe je akti i mirëbërësisë së të Gjithëditurit që i di kërkesat e tua. Ti gjithashtu je një formë modelimi e Kaderit paracaktues, që është në dijeni të asaj që është e përshtatshme për konstruktin tënd. Si do të ishte e mundur që ti të ishe i përjashtuar prej rregullit të përgjithshëm të krijimit me vullnetin tënd të lirë të pjesshëm dhe me vetëdijen tënde dhe pastaj kthehesh dhe krahason tërësinë me pjesën? Si mund të jesh i pakujdesshëm ndaj Zotit tënd, Pronarit, i Cili ka në pronësi të gjitha gjërat? Dhe si mund të hamendësosh se, pavarësisht kësaj njohjeje që rrethon të gjithë krijimin, se nuk ndodhet Një i Vetëm, i Cili është Kontrollues, Gjithëdëgjues, Gjithëshikues, i Gjithëditur, Përgjigjës i lutjes, Ndihmues, i Cili dëgjon vajtimet, e shikon skamjen tënde dhe i di krimet e tua?

O nefsi im i mjerë! Përse mendon se je i përjashtuar nga sfera e ligjeve Hyjnore dhe u bën padrejtësi të gjitha qenieve të tjera duke mos u dhënë atyre asnjë rëndësi, dhe as nuk ndjehesh i detyruar të përulesh para tyre dhe as nuk e sheh vetveten si përgjegjës për menaxhimin e tyre? Kjo është një peshë që është e pamundur për ty për ta mbajtur. Prandaj, ti duhet ta braktisësh atë lloj shirku të tillë –të përshkruarit ortakë me Zotin– që do të thotë shmangie prej natyrës themelore që Ai i ka dhënë krijimit, dhe hyr në sferën e dominimit të Allahut. Duke vepruar kështu, ti mund të gjesh paqën dhe qetësinë e mendjes dhe të zemrës dhe mund të bëhesh një vëlla i respektuar i të gjitha qenieve. Përndryshe, shembulli yt është si ai që është ngarkuar me drejtimin e njërit prej timonit të anijes të mbushur plot me mallra që i përkasin

mbretit, dhe në vend që t'i vendosë peshat –plaçkat– e tij në anije dhe ta drejtojë timonin me lehtësi, ai e mban peshën e tij mbi shpinë. Në qoftë se do të kishte pak mend, ai duhej të thonte: “Edhe unë gjithashtu udhëtoj në këtë anije, prandaj më duhet t'i vendos peshat e mia pranë mallrave të mbretit, pronarit tim dhe administratorit”. Përveç kësaj, o nefs i mjerë, me qëllim që të jesh i rehatuar dhe të gjesh qetësi, ti gjithashtu duhet t'i vendosësh rregullat Islame dhe parimet në anijen e mendjes së botës Islamike.

Mësoje, o shok! Ai që të ka krijuar ty duhet gjithashtu të ketë krijuar universin me çfarëdo që ndodhet në të, sepse çfarëdo që ndodhet tek ti, ekziston edhe tek ai. Është e domosdoshme që Krijuesi yt duhet të jetë Krijuesi i të gjitha gjërave, sepse Krijuesi i një bostani nuk është tjetër nga Krijuesi i farës së tij, e cila është një shembull i zvogëluar i marrë prej tij dhe e përfshirë në të.

Mësoje, o shok! Ti je një qenie e kufizuar, duke pasë një trup të kufizuar, një jetë të kufizuar dhe një fuqi të kufizuar. Prandaj, ti nuk duhet ta harxhosh këtë jetën tënde të shkurtër e kalimtare mbi gjëra të përkohshme me qëllim që ajo të mos shkojë për kot. Përkundrazi, ti duhet ta harxhosh atë për hir të asaj që është e përjetshme, me qëllim që ajo të mund të fitojë përjetësi. Ti mund të përfitosh prej jetës tënde këtu tek e shumta për njëqind vjet, sikur të ngrënit e njëqind bërthamave të thata hurme. Pa pemën që i prodhon, ato japin, ndonëse më pak se sa vështirësitë që ato shkaktojnë, pak dobi vetëm gjatë jetës së kësaj bote; sepse prej tyre nuk përfitohet pas vdekjes tënde. Në qoftë se ti synon Ahiretin (dhe i gropos ato bërthama në dheun e Ahiretit) duke i ujitur me ujin e shariatit, ti do të mund të fitoje njëqind pemë të shkëlqyera hurme për njëqind hurma të thara të denja vetëm për të qenë dru për zjarrin e Xhehennemit – Hutamenë.

Mësoje, o shok! Është burim iluzionesh, dyshimesh dhe madje çudhëzimi që nefs i supozon veten si të përjashtuar prej sferës së manifestimeve të Kaderit dhe të Atributeve Hyjnore. Pastaj, për shkak të atij përjashtimi të supozuar, nefs i supozon vetveten si të pavarur prej sundimit Hyjnor. Pastaj, çfarëdo që ai has rastësisht në ekzistencë, e cila në fakt është e varur nga Kaderi Hyjnor dhe është e sunduar nga një ose më shumë se një Emër Hyjnor, ai gjithashtu e përjashton atë prej mbretërisë së Zotit dhe prej Autoritetit të fuqisë së Tij. Nëpërmjet, analogjive dhe interpretimeve të detyruara të cilat do ta bënin mësuesin

e shejtanëve, nefsi reflekton disa prej gjendjeve të tij që vijnë prej shirkut të fshehtë, për atë gjë të pafajshme.

Nefsi urdhëruet për të liga i ngjason strucit; ai e mendon atë që është kundra tij si në favorin e tij. Ose nefsi është si sofistët; ai i thotë njërit prej dy kundërshtarëve të cilët hahen me njëri-tjetrin, “argumentet e kundërshtarit tënd të refuzojnë”, pastaj ai kthehet tek tjetri dhe i thotë: “argumentet e atij i shfuqizojnë të tuat”, të dy ju jeni gabim.

Mësoje, o shok! Nefsi e supozon botën tjetër si një shtrirje të kësaj bote dhe kërkon të vazhdojë pakujdesinë dhe moskokëçarjen e tij. Me mendimin e Ahiretit –ndonëse nuk është i bindur për ardhjen e tij– ai kërkon të lehtësohet nga tmerrri i asgjësimit të dynjasë dhe nga dhimbjet e zhdukjes. Duke kërkuar strehë tek pakujdesia ose dyshimet (rreth Ahiretit), ai kërkon të shpëtojë prej telasheve të punës për Ahiret. Dhe i shikon brezat e vdekur sikur të ishin të gjallë, por të fshehur para nesh dhe nuk nxjerr mësim nga vdekja.

Nën iluzionin e ngulitjes –mbjelljes– së pritshmërive të tij të kësaj bote në dheun e Ahiretit domethënë, duke përdorur Ahiretin si një shfajësim për kapjen pas pritshmërive të kësaj bote, ai mendon: “Këto pritshmëritë e mia kanë dy aspekte. Njëri lidhet me dynjanë, e cila nuk ka qëndrueshmëri dhe ikën si pluhur i shpërndarë. Aspekti tjetër lidhet me Ahiretin, i cili ndërtohet mbi të njëjtat themele si dynjaja dhe si shtrirja e saj”. Për shembull, njohja ka dy aspekte, njëri i ndritshëm, tjetri i errët. Nefsi djallëzor të shfaq ty anën e ndritshme dhe ta ofron të errëtën nën maskën e saj. Domethënë, nëpërmjet përpjekjes për të bindur ty se njohja jep fruta në Ahiret, ai të thërret ty ta përdorësh për interesat dhe dobitë e kësaj bote.

Shkurtazi: Nefsi është si një struc ose si një sofist djallëzor.

Mësoje, o shok! Unë jam absolutisht i bindur se në qoftë se Zoti nuk pranohet si Krijuesi i të gjitha gjërave, atëherë Ai nuk do të ishte krijuesi i asgjëje. Sepse, tërësia e krijimit formon një entitet të plotë (si një organizëm), të gjitha pjesët e të cilit janë të ndërlidhura e të lidhura tek njëra-tjetra. Ai nuk pranon ndarje. Çfarëdo që ne pranojmë e njohim në lidhje me diçka, bën të domosdoshme pranimin e saj lidhur me gjithçkanë. Gjithashtu, Krijuesi është ose i njërës, ose i të pafundmes në numër. Sepse, në qoftë se nuk do të ndodhej Një Krijues

i vërtetë (për të njëjtat arsye siç e kërkojnë Qënien e Tij si Krijues i tërësisë së universit), do të duhej të kishte krijues të vërtetë në numër të pafundmë. Do të ishte absolutisht e pakonceptueshme të ndodheshin shumë qënie me të njëjtat attribute të pafundme dhe do të ishte pafundësisht e pamundur që të ndodhej më shumë se Një Qënie e Pafundme. Kjo do të bënte të domosdoshme pranimin e shumë pakonceptueshmërive të çuditshme dhe mosekzistencën e universit në termat absolute, dhe përfundimisht, pranimin e pamundësisë së ekzistencës së Një Krijuesi.

Do të ishte e pamundur që një qënie që jep dritë të ishte vetë pa dritë, një qënie që jep ekzistencë të ishte vetë mosekzistuese dhe një qënie që e bën ekzistencën e diçkaje të domosdoshme të ishte vetë jo e domosdoshme në ekzistencë. Në mënyrë të ngjashme, do të ishte e pakonceptueshme me të njëjtën shkallë për një qënie që jep njohje të ishte vetë pa njohje, një qënie që jep vetëdije të ishte vetë pa vetëdije, një qënie që jep zgjedhje –vullnet të lirë– të ishte vetë pa zgjedhje, dhe një qënie që jep plotësi të ishte vetë e paplotë.

A do të ishte e mundur, që Ai i Cili i jep formë syrit dhe jep fuqinë e shikimit të ishte vetë pa shikim? Është absolutisht e domosdoshme që të gjitha llojet e plotësisë të ndara tek gjërat e krijuara se ato janë prej plotësisë së Krijuesit të tyre. Kur një organizëm mikroskopik që njeh veçse mushkonjat midis zogjve shikon një shqiponjë, meqenëse çfarë ka tek mushkonja nuk gjendet tek shqiponja, ai del me përfundimin se shqiponja nuk është një shpend.

Mësoje, o shok! Atë çfarë nefsi e dëshiron më shumë është qëndrueshmëria dhe përjetësia. Në qoftë se ai nuk e mashtron vetveten me një qëndrueshmëri të rreme, ai nuk do të merrte kënaqësi prej asgjëje në jetë.

O nefsi që kërkon qëndrueshmëri! Vazhdo të përmendësh të Qëndrueshmin e Vetëm të Përjetshëm që të mund të fitosh qëndrueshmëri; dhe të jesh si një pasqyrë duke reflektuar dritën e Tij me qëllim që të mos shuhesh. Gjithashtu, me qëllim që të pastrohesh ji një sedef për margaritarin e Tij. Që të jesh përjetësisht i gjallë, ji një trup për flladin e përmendjes –dhikrit– të Tij. Me qëllim që të mos biesh në humnerën e pafund të mosekzistencës, kapu fort pas filamentit ndriçues, i cili është një rreze prej njërit prej Emrave Hyjnorë. Në qoftë se një frut është i pakujdesshëm ndaj asaj që e mbështet dhe e mban

dhe tërhiqet tek një dritë e jashtme që i buzëqesh në fytyrë, ai frut do të shkëputej prej kërcellit të saj dhe do të binte me kokë.

O nefs! Kapu fort pas Atij, i Cili të mban e të mbështet, sepse nëntëqind e nëntëdhjetë pjesët e qënies tënde janë nën kujdestarinë e Tij, dhe vetëm njëra që mbetet është lënë amanet tek ti. Vendose dhe atë pjesë gjithashtu në anijen që mban pronat e Tij dhe gjej qetësi. Dije se je i paaftë ta krijosh e të mbash veten tënde, dhe në qoftë se duart e tua janë shumë të shkurtëra që të të sjellin ty ndonjë të mirë, atëherë të gjithë njerëzit e tjerë dhe shkaqet më të largëta apo vepruesit janë më të paaftë për të pasur një dorë në krijimin tënd dhe në mbajtjen. Shiko nëse ti do të mund ta bëje gjuhën tënde që është një pemë fjalësh, një pellg i shijeve dhe një çentral komunikimi. Në qoftë se ti nuk mund ta bësh atë dhe kurrë nuk do të jesh në gjendje ta bësh, atëherë mos i përshkruaj ortakë Zotit, sepse

إِنَّ الشِّرْكَ لَظُلْمٌ عَظِيمٌ

“Të përshkruarit ortakë Allahut është gabimi më i rëndë”⁹³

Mësoje, o shok! Bota është një dyqan ose një magazinë Hyjnore, në të cilën ndodhen të gjitha llojet e rrobave, ushqimeve dhe pijeve, disa prej të cilave janë të trasha e të ngurta, disa të holla, disa jetëshkurtëra, disa të vazhdueshme, disa si thelb, disa si lëng, disa të gazta. Disa prej tyre thuren prej asgjëje, krijohen, ndërsa disa të tjera modelohen nëpërmjet manifestimeve të Emrit ose të Emrave përkatës Hyjnorë. Shumica e filozofëve kanë humbur rrugën nëpërmjet shikimit të ekzistencës së gjithçkaje si e vetëdomosdoshme dhe kanë ngatërruar krijimin me modelimin.

Mësoje, o shok! Kur shirku i fshehtë që buron prej egoizmit njerëzor fortësohet e dendësohet, ai kthehet në shirkun e shkaqeve dhe nëse ai vazhdon do të transformohet në kufr – mohim; dhe nëse ai vazhdon, do të ndryshohet në taëtil – në mohimin e Atributeve të Allahut; na ruajtë Allahu nga rënia në një gjendje të tillë.

Mësoje, o shok! Të kërkosh dritë brenda errësirës duke mbetur nën ndikimin e nefsit dhe duke e bërë atë gjendje natyrën e tij, është një dhimbje e rëndë dhe e pa respekt ndaj dritës dhe fëlliqësi ndaj saj. Ti

⁹³Kur'an, 31:13

duhet patjetër të dalësh prej errësirës dhe atëherë shiko drejt dritës, larg prej errësirës dhe jo brenda saj.

Mësoje, o shok! Njeriu është krijuar për të hapur e zbuluar thesaret e Emrave dhe Atributeve Hyjnore, për të qenë një shenjë e ndritshme (duke udhëzuar për tek Zoti), për të marrë e reflektuar manifestimet Hyjnore, për të qenë një hënë dritëdhënëse duke reflektuar fuqinë e parapërrjetshme të të Gjithëfuqishmit, dhe për të qenë një pasqyrë për manifestimet e Bukurisë së Parapërrjetshme. Ai ka fituar një përsosuri e pastërti më të madhe dhe është bërë më i shkëlqyer duke ndërmarrë amanetin prej mbajtjes së të cilit u shmangën edhe qiejt, toka edhe malet. Është njëra prej kërkesave të ndërmarrjes së këtij amaneti që njeriu duhet të jetë një njësi krahasimi për të kuptuar Atributet gjithëpërfshirëse të Allahut xh.sh.. Egoja e tij, e cila bëhet një pikë e errët nëpërmjet pakujdesisë dhe shirkut, duhet të jetë një çelës për të ndezur dritat e atyre Atributeve. Në kundërshtim me ato funksione esenciale të njeriut, përse dhe shumica e njerëzve bëhen perde e barriera? Ndërsa njeriu është i ngarkua me hapjen, atëherë përse dhe si ai duhet të japë ndriçim, përse dhe si ai errëson? Ndërsa duhet të besojë në Njësinë e Zotit, përse dhe si ai bën shirk? Ai duhet ta vëzhgojë Krijuesin nëpërmjet observatorit të krijuar posaçërisht për të shikuar drejt Tij dhe për të pranuar e njohur pronësinë e tij dhe mbretërinë që i përket ekskluzivisht Atij. Por, njeriu e shikon krijimin nëpërmjet observatorit të egos së vet dhe e ndan pronën e Zotit midis krijesave. Prandaj, njeriu është shumë zullumqar, i padrejtë dhe tepër injorant.

Mësoje, o shok! Në qoftë se ti e kënaq Krijuesin tënd nëpërmjet takvasë, abstenimit prej mëkateve dhe bindjes ndaj urdhërave të Tij, dhe nëpërmjet veprave të drejta, kjo gjithashtu mjafton për të kënaqur të krijuarën. Në qoftë se të krijuarat janë të kënaqura me ty për llogari të Zotit të Gjithëfuqishëm, ajo është e dobishme për ty, por në qoftë se ato janë të kënaqura për llogari të vetes së tyre, atëherë ajo nuk ka asnjë dobi. Sepse ato janë të pafuqishëm si ti. Në qoftë se ti zgjedh alternativën e parë, kënaq Zotin tënd; në qoftë se ti zgjedh të dytën, ti ke bërë shirk – i ke vënë shok Zotit më kot. A nuk sheh ti se dikush që shkon në kryeqytet për të gjetur një punë, në qoftë se ai do ta kënaqte mbretin, puna e tij do të gjendej me lehtësi dhe ai do të fitonte dashurinë e subjekteve të tij? Në qoftë se, në të kundërt, ai e pret punën e tij të bëhet nga ana e atyre që janë nën sundimin e mbretit, ai do të hasë vështirësi, madje ai do të duhej t'i kënaqte të gjithë ata dhe të

siguronte dakordësinë e tyre për plotësimin e nevojës së tij. Dhe për më tepër, në qoftë se ai ka qenë në gjendje të siguronte dakordësinë e të gjithë atyre nën sundimin e mbretit, përsëri atij do t'i nevojitej leja e mbretit, e cila varet nga të kënaqurit atë.

Mësoje, o shok! Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm nuk u ngjason qënieve të mundshme –të gjitha qënieve përveç Zotit për të cilat është njëlloj e mundshme nëse ata ekzistojnë ose jo dhe si rrjedhojë ekzistenca e të cilave varet në mënyrë absolute tek Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm– në Esencën e Tij dhe në Cilësi. Gjithashtu, Ai nuk u ngjason atyre as në aktet e Tij. Për shembull, në lidhje me Të, nuk ka ndryshim midis asaj që është afër dhe të largëtës, të paktës dhe të shumtës, individuale dhe species, dhe pjesës dhe të tërës. Gjithashtu, ndryshe nga të mundshmet, Ai nuk ka aspak vështirësi në të gjitha aktet e Tij, as nuk i merr asnjë kohë për t'i bërë ato, as nuk e prekupon Vetën me ndonjë gjë në mënyrë të veçantë. Për këtë arsye, mendja hutohet për të kuptuar natyrën e akteve të të Gjithëfuqishmit dhe shkon aq larg sa të mohojë Atë që i kryen ato.

Mësoje, o shok! Dhëmbët dhe kthetrat e një luani tregojnë për faktin se çfarë pritet prej një luani është të kafshojë e të shqyejë, dhe kënaqësia e një bostani tregon se ai është për ngrënie. Gjithashtu, potenciali i njeriut tregon se detyra e tij esenciale është të adhurojë Zotin xh.sh.. Lartësia e dimensionit të tij shpirtëror për përmallimin e tij për qëndrueshmëri dhe përjetësi tregon se njeriu u krijua së pari në një botë më të hollë e më të përpunuar se sa kjo botë dhe u dërgua këtu për t'u pajisur me pajisjet e domosdoshme dhe që të kthehet përsëri aty nga erdhi. Qënia e tij, fruti i pemës së krijimit, tregon se midis qënieve njerëzore ndodhet dikush i cili është bërthama e humanizmit prej të cilës Autori ka rritur pemën e krijimit. Ajo bërthamë mund të jetë veçse ai për të cilin kanë dakordësi më të virtytshmit dhe më të mëdhenjtë e krijimit, të gjithë njerëzit e plotësuar, madje gjysma e njerëzimit, nëpërmjet misterit të ngjyrosjes së botës me ngjyrimin e tij shpirtëror. Ai është prijësi i të gjithë krijimit a.s.m, mbi të qofshin paqja dhe bekimet.

Pjesa e dytë e grimcës
prej rrezes së udhëzimit të Kuranit

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Mësoje, o shok! Zoti i ka vendosur qiejt dhe tokën në rregull dhe i mbështjell natën dhe ditën rreth kokës së tokës, e cila është si djepi ynë, si një çallmë e vizuar. Si do të ishte e konceptueshme që Ai t’ua dorëzonte drejtimin e disa pjesëve të krijimit duke ua lënë në ngarkim disa qënieve të mundshme të mjera? A do të ishte e mundur të vepronte e të drejtonte tjetër kush përveç Zotit të Arshit nën atë Fron? Jo, kurrë! Sepse ajo fuqi nuk është e shkurtër për të pasur kontroll dhe autoritet mbi të gjitha gjërat dhe nuk lë vend për ndërhyrjen e të tjerëve. Përveç kësaj, nderi dhe dinjiteti i autoritetit të Tij absolut dhe i pavarësisë, dhe vullneti i Tij për t’u njohur e dashur nuk i lejon të tjerët –sido dhe çfarëdo ose kushdo që të jenë ata– që të jenë perde (ndërmjet Tij dhe krijimit të Tij). Ato gjithashtu as nuk i lejojnë të tjerët të jenë mjete emërore për të tërhequr tek vetvetja shikimet e shërbëtorëve të Zotit. Drejtimi i të tërës dhe i pjesës, i specieve dhe i individëve ndodh i gjithi në të njëjtën kohë dhe njëra brenda dhe duke mbështetur tjetrën. Prandaj, është e pamundur që t’i ndash ato, madje as midis dy vepruesve. Sepse i Vetmi, i Cili e ka rregulluar krijimin e mbështet, e zhvillon dhe e drejton njeriun në të njëjtën kohë, ndërsa Ai administron e drejton djepin tonë, tokën. Ai gjithashtu i bën qelizat e trupit tonë dhe krijon grimcat – pjesët më të vogëla të gjërave nëpërmjet asaj fuqie, e cila kontrollon të gjitha pjesët e krijimit. Madje, nëpërmjet vënies së rregullit, Ai kontrollon e menaxhon; nëpërmjet kontrollit e menaxhimit, Ai mbështet, trajnon e zhvillon; dhe nëpërmjet mbështetjes, trajnimit dhe zhvillimit, Ai vendos e krijon. Ashtu siç do të ishte e pamundur për diellin të ndriçonte tërësinë e faqes së një oqeani pa ndriçuar në të njëjtën kohë të gjitha faqet e flluskave, sytë e pikave dhe bebet e pikave të shiut duke rënë mbi të, po ashtu do të ishte e pamundur për dikë tjetër përveç Fuqisë, e Cila i mbështjell natën e ditën përreth tokës, të ndërhyjë tek ndonjëra prej grimcave të qelizave që i përket organit më të vogël të ndonjë banori të tokës. Ai i Cili e ka bërë, modeluar dhe

rregulluar mendjen e një mize dhe syrin e një mikrobi, nuk do t'i lërë veprat e tua të kalojnë pa u regjistruar. Ai i regjistron ato në një libër të qartë dhe do të të bëjë thirrje për të dhënë llogari për to.

Mësoje, o shok! Drejtimi absolut, fuqia gjithëpërfshirëse dhe urtësia gjithëshikuese të vëzhguara në të gjitha krijesat deri tek grimca e vockël, së bashku me gjithçka që ato lidhen edhe me çfarë ndodh rreth atyre, janë një dëshmi e qartë dhe një shenjë e ndritshme për faktin se Krijuesi i të gjitha gjërave është Një i Vetëm pa asnjë lloj ortaku. Nuk ndodhet asnjë ndarje, as copëzim dhe as shpërndarje në Fuqinë e Tij. Në qoftë se ndonjë qenie e mundshme do të ishte krijuesi, do të kishte pasur ndarje, copëzime dhe shpërndarje në drejtimin dhe në ekzekutimin e fuqisë së tij dhe vullnetit. Dhe prandaj është absolutisht e domosdoshme që Krijuesi të jetë Një i Vetëm dhe ekzistenca e Tij e domosdoshme. Nuk ndodhet as limit dhe as ndarje në Fuqinë e Tij, e cila operon në përputhje me masat e Kaderit të Tij dhe 'skalit' mbi rreshtat e Tij.

Mësoje, o shok! Gjallesat e vockëla si një mushkonjë, merimangë e një plesht, janë më inteligjente, më të sofistikuara në strukturë dhe më të holla në art se sa gjallesat –kafshët– e mëdhaja të tilla si elefanti, bualli dhe deveja. Pavarësisht kësaj, jeta e tyre është më e shkurtër, dhe në dukje, ato përfitojnë më pak se të tjerat. Kjo tregon qartë se Ai, Krijuesi, nuk ka aspak vështirësi në krijimin e gjërave dhe se Ai nuk e preokupon Vetën në mënyrë të veçantë me asnjërin prej tyre. Ai vetëm thotë “Bëhu!” dhe ato janë bërë (në çast). Asgjë nuk mund ta detyrojë Atë për të bërë diçka; Ai bën çfarëdo që dëshiron dhe vepron sido që të dojë. Nuk ka zot tjetër përveç Atij.

Mësoje, o shok! Imazhi i diellit në një flluskë, është edhe një pjesë e flluskës, edhe një diell i vockël individual duke mbajtur atributet e diellit. Meqë ai mban atributet e diellit, ai ka identitetin e diellit, por nuk është i të njëjtës natyrë me diellin, ai nuk është as vetë dielli, as diçka tjetër nga dielli. Pjesët e të gjitha krijesave në diellin, domethënë, dhënia e diellit dritë, nxehtësi dhe ngjyra tërësisë së botës, nuk pakëson asgjë në pjesën e flluskës. Nuk bën ndryshim për të nëse të gjitha gjërat ekzistojnë ose jo. Flluska mund të thotë: “Dielli më përket mua dhe në mënyrë ekskluzive është përfshirë tek unë dhe ai ekziston për mua”.

Mësoje, o shok! Ajo çfarë zvogëlohet e largohet prej sferës më të gjërë të Emrit *Edh-Dhahir*, i *Dukshmi*, dhe e sheh vetveten pothuajse

asgjë përpara saj, afrohet dhe e kufizon vetveten tek sfera relative ose reale e Emrit Hyjnor *El Batinu, i Padukshmi*. Në çdo rast, “*Dhe Allahu është Gjithërrethues i tyre nga pas*”,⁹⁴ nëpërmjet Emrave të Tij, njohjes së Tij, vullnetit, fuqisë dhe Atributeve të tjera të Tij.

Me mendjen e tij të kufizuar, të pjesshme, të humbur në atë me çfarë merret, njeriu e shikon madhësinë e të Gjithëfuqishmit dhe administrimin e Tij të planeteve rreth diellit, dhe e gjykon si të pagjashme me krijimin e, për shembull, të një mize. Ai e krahason Ekzistuesin e Vetëm të Domosdoshëm me një krijesë të mjerë të mundshme, një krahasim i nxitur prej shejtanit. Një krahasim i tillë do të thotë përbuzje ndaj krijesave të vogëla, që është një padrejtësi e madhe, sepse nuk ka gjë që të mos e lavdërojë Krijuesin e saj. Asgjë nuk e ul veten për të pranuar si Zotin e saj ndonjë tjetër përveç të Vetmit, për të Cilin kjo botë është veçse një nga bujtinat e Tij, dielli është veçse njëri prej fenerëve të Tij dhe yjet veçse disa prej llampave të tij, sikur të mos ndodhej asnjë krijesë e gjallë në botë përveç tij. Një gjë e madhe nuk ka të drejtë ta shohë vetveten më të madhe se një të vogël dhe të ndjehet krenare, sepse ekzistenca është si e drejta duke mos pasë dallim midis të paktës dhe të shumtës. Ekzistenca e një gjëje të vogël ka të njëjtën vlerë si ajo e të madhes.

Mësoje, o shok! Kur shikohet me vëmendje, prej diellit të diejve për tek frutat e pemëve, çdo gjë është zgjedhur dhe dalluar midis asaj që është e pafundme. Çdo gjë lidhet me atë që është e pafundme; dhe askush përveç se të Vetmit, manifestimet e Atributeve të të Cilit janë të pakufishme, nuk ushtron autoritet mbi atë gjë.

Mësoje, o shok! Furnizimi i gjithanshëm nuk e përjashton furnizimin e asnjë qenieje në mënyrë të veçantë. Sepse mirësitë e Zotit nuk janë si pasuria e vakëfit, si uji i një lumi, prej të cilit gjithkush mund të përfitojë pa marrë parasysh nevojat e veçanta të individëve, me qëllim që individët të mos kenë nevojë të ndiejnë mirënjohje të veçantë ndaj tyre. Nevojat e individëve nuk janë si vazo dhe enë, që ato i kanë për vetveten, për t'i mbushur me mirësitë Hyjnore që ato i marrin si derdhja e pikave të shiut. Përkundrazi, Dhuruesi i Vërtetë i mirësive, qoftë i lartësuar, i Cili e merr çdo individ në konsideratë, bën një enë të veçantë për gjithkënd dhe pastaj e mbush atë me ushqimin e mirësive të

⁹⁴Kur'an, 85:20

Tij. Prandaj, dhënia e falënderimit është detyrë për çdo individ për mirëbërësinë e përgjithshme dhe gjithashtu, ajo është detyrë për çdo individ për mirësitë që i vijnë atij në mënyrë të veçantë.

Mësoje, o shok! Shumica e qënieve njerëzore nuk ia japin hakun e tyre librit të vëzhguar të universit të lavdishëm të Kuranit të recituar e të dëgjuar. Sepse filozofët e tyre i atribuojnë të Domosdoshmit të Vetëm jo më shumë se një pjesë të vogël, një mbulesë të hollë dhe një përbërës të vlerës emërore, dhe pastaj ata ua ndajnë pjesën tjetër shkaqeve, madje ua ndajnë pamundësive dhe thjeshtë nocioneve. Mallkimi i Allahut qoftë mbi ta!

قَاتَلَهُمُ الْمَلَأُئِيُّ فَكُون

"Si janë mbajtur me gënjeshtria larg së vërtetës?"⁹⁵

Ndërsa ai që beson në Unitetin e Tij thotë: "Çfarëdo që është në ekzistencë i përket Atij, ka ardhur prej Tij, tek Ai do të kthehet dhe mbahet me Të". Lidhur me si ata që i bëjnë padrejtësi Kuranit, të diturit midis qënieve njerëzore, të mashtruar nga vijueshmëria e ideve dhe e zbulimeve gjatë kohës, i atribuojnë Zotit të Fronit më të lartë prej atij pallati madhështor –Kuranit– midis themeleve të tij të qëndrueshme, të mirëvendosura, blloqeve të ndërtuara prej ari dhe pemëve të lulëzuara, jo më shumë se vetëm disa pjesë të përpilimit, dhe pastaj e ndajnë pjesën e mbetur prej atyre 'yjeve qiellorë' midis banorëve të tokës.

Mjerë mendja, e cila mashtrohet prej hamendësimit ose imagjinatës se dora e njeriut zgjatet tek qiejt dhe ushtron autoritet në planetet e tij! Shembulli i kësaj është si ai që i jep vetëm ca fluska Atij që e krijoi dhe e mbush oqeanin. Ndërsa, një besimtar dashurues i realitetit thotë: "Çfarëdo që ndodhet në Kuran, prej të parës së themeleve të tij deri tek qëndisjet e fundit të skicimit të tij, deri tek shkronjat e fundit të tekstit të tij, është prej Allahut dhe i përket Atij". Kurani është ndërthurur në stile të cilat marrin në konsideratë mijërat e të adresuarve. Gjithashtu, duke na ardhur neve prej shtatëdhjetë mijë perdeve, Kurani depërton në thellësitat e zemrave dhe të shpirtërave, duke shpërndarë bekimet e tij nëpër të gjitha nivelet e shoqërive njerëzore. Çdo periudhë e kupton dhe e njeh atë; çdo shekull e njeh plotësinë e tij dhe e pranon; çdo epokë miqësohet me të dhe e pranon atë si mësuesin e saj; dhe çdo

⁹⁵Kur'an, 9:30

kohë ka nevojë për të dhe e respekton deri në atë shkallë që e supozon si të ishte shpallur veçanërisht për të. Ai nuk është një libër sipërfaqësor, i cekët. Ai është një oqean i pafund, një diell rrezatues dhe një udhëzim i thellë.

Mësoje, o shok! Shikoje ujin dhe ajrin, sa të butë dhe depërtues janë ato në krijim! Lavdi Atij, i Cili i furnizon dhe i ushqen edhe mikrobin, edhe elefantin! Shikoje Kryekuzhinierin, si Ai e bën ushqimin, i cili kalon edhe përmes grykës së një blete, si dhe mbush gojën e një elefanti, dhe –ai ushqim– nuk është shumë i madh për gojën e një mikrobi, dhe as shumë i vogël, me qëllim që goja e një hundëbriri të mos e përçmojë. Ajo fjalë është aq e shumuar saqë me të mbushet një shpellë mali dhe bën jehonë dhe e kthen prapa tek ti; megjithatë, ajo nuk është shumë e madhe për qelizat e veshit të një mushkonje.

Mësoje, o shok! Në kohën e namazeve të përditshme, ti mund ta imagjinosh botën Islame si një xhami, me Mekën duke qenë një Mihrab –vendi ku qëndron imami i faljes– dhe Kabën duke qenë pika qëndrore e atij Mihrabi. Në këtë xhami, brezat, gjeneratat kryejnë faljen. Xhamia në mënyrë të vazhdueshme mbushet dhe boshatiset prej brezave që vijnë njëri pas tjetrit.

Mësoje, o Said! Lumturi është që ta lësh sot me nder e dinjitet atë çfarë të lë ty nesër duke të të hedhur në poshtërim, mjerim e humbje. Në qoftë se ti e braktis dynjanë, ti do ta shpëtosh veten tënde prej të këqijave të saj dhe do të trashëgosh të mirat e saj. Në qoftë se, në të kundërt, ajo të braktis ty, atëherë ti do të privohesh prej të mirave të saj dhe do të korrësh të këqijat e saj.

Mësoje, o shok! Civilizimi i shthurur modern ka hapur një derë për një shfaqje të madhe të tillë të neveritshme dhe për një hipokrizi të tillë, saqë në emër të famës dhe të reputacionit, ata bëjnë diçka për t'u dukur dhe sillen me hipokrizi jo vetëm ndaj individëve, por ndaj të gjithë kombit. Media i ka bërë ato të njohur për njerëzit dhe meqenëse konceptet moderne të historisë të shkruara kohët e fundit u duartrokasin atyre, ata gjithashtu i nxisin edhe të tjerët të veprojnë kështu. Jetët e individëve sakrifikohen për konsiderata raciste nën maskën e nacionalizmit.

Mësoje, o shok! Duke u bashkuar e duke formuar një unitet të fuqishëm, një komunitet grash mund të fitojë burrëri të fortë, kurse një unitet i dobët burrash bëhet si grua. Frazat kuranore:

وَقَالَتِ الْاَعْرَابُ ۗ وَقَالَ نِسْوَةٌ
*“Gratë thanë”*⁹⁶ dhe *“Arabët (burra) të shkretëtirës thanë”*⁹⁷ (Në frazën e parë, folja në origjinalen e të cilës në arabisht është në formën mashkullore, ndërsa sipas gramatikës arabe duhet të kishte ardhur në formën femërore, meqë kryefjala është ‘gra’; kurse në frazën e dytë, folja në origjinalen e saj në arabisht vjen në formën femërore), tregojnë për këtë fakt. Komuniteti i të dobëteve është i fortë, ndërsa komuniteti i të fortëve është i dobët.

Mësoje, o shok! Duke i refuzuar shejtanët dhe duke i mposhtur, dyert e parajsës hapen.

Mësoje, o shok! Uniteti Hyjnor është më i qarti i provave të profetësisë së Muhammedit a.s.m, sepse është prijësi ynë Muhammedi a.s.m, ai i cili ngriti flamurin e Unitetit Hyjnor –teuhidit– mbi kokat e të gjitha qënieve dhe e vendosi atë në majën e universit. Ai gjithashtu e shpalli Unitetin Hyjnor për të gjitha qëniet e të gjitha shkallët e manifestimit të tij dhe shpjegoi në mënyrë të detajuar e të hollësishme atë çfarë profetët e mëparshëm e patën lënë në një formë të përgjithshme e në vija kryesore.

⁹⁶Kur’an, 12:30

⁹⁷Kur’an, 48:14

***Pjesa e tretë e grimcës
prej rrezes së udhëzimit të Kuranit***

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Mësoje, o shok! Ato stoli, plotësi, skena të bukura dhe sovraniteti i Perëndisë dhe madhështia e Hyjnisë të vëzhguara në univers, kërkojnë një vëzhgues për t'i soditur ato me mahnitje e habi. Pavarësisht injorancës së tij dhe tendencës për padrejtësi, njeriu ka një kapacitet aq të gjithanshëm saqë mund të thuhet për të se ai është modeli i tërësisë së krijimit dhe tek ai është lënë një amanet me të cilin ai mund të perceptojë thesarin e fshehtë dhe e hap atë. Fuqitë e tij dhe aftësitë nuk janë të kufizuara në krijim, me qëllim që ai të ketë një vetëdije universale për të kuptuar madhësinë e mbretërisë së Sovranit të Parapërdjetshëm dhe bukurinë madhështore të Hyjnisë së Tij. Ashtu siç kërkon një bukuri shikimin e një të dashuri (për ta parë atë), po ashtu Hyjnia e Skalitësit të Parapërdjetshëm kërkon ekzistencën e njeriut, i cili do ta vështrojë Atë me vlerësim, admirim, habi e reflektim. Ajo Hyjni gjithashtu bën të domosdoshme qëndrueshmërinë e atij vëzhguesi reflektues të habitur me qëllim që ai të mund ta shoqërojë atë për çfarë habitet e mahnitet përgjatë rrugës për në përjetësi.

Ai i Cili i ka stolitur faqet e luleve, sigurisht i ka krijuar insektet dhe zogjtë në dashuri me to, dhe Ai që ka zbukuruar faqet e të bukurës, Ai gjithashtu ka krijuar të dashur përmallues për të. Ai e ka bërë faqen e botës aq të bukur e tërheqëse dhe i ka ndriçuar sytë e saj me ato llampa buzëqeshëse; dhe Ai e ka qëndisur botën me kaq shumë lloje të bukurive të shkëlqyera, saqë ngjall ndjenjat e dashurisë për Autorin e saj dhe kureshtjen për ta njohur Atë. Një Krijues i Tillë, sigurisht nuk do ta linte atë –botën– pa dashurues të mahnitur, reflektues, ngashënjyes e njohës së çdo bukurie që secila ka. Me natyrën e tij gjithëpërfshirëse e të plotë, njeriu është bërë arsyeja për krijimin e universit dhe rezultati i tij.

Mësoje! Lumturia më e plotë dhe kënaqësia e vërtetë qëndrojnë në braktisjen e gjithçkaje, madje edhe ekzistencën e vet, për hir të Zotit, për lavdinë e Tij, qoftë e lartësuar, për hir të asaj që Ai është Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm dhe për hir të asaj që Ai është i Ploti Absolut, për atë që Ai është Zotëruesi i madhështisë dhe i bukurisë absolute. Atëherë, çfarëdo që kam, madje e gjithë ekzistenca ime dhe çfarëdo që ekziston, u sakrifikofshin për Të, u bëfshin kurban!

Mësoje, o shok! Ashtu si në koincidencat dhe ngjashmëritë midis gjërave që tregojnë Unitetin dhe Njësinë e Autorit, po ashtu, pangjashmëritë dhe dallueshmëritë midis tyre tregojnë se Autori është Zgjedhës i Gjithurtë dhe ka vullnet Absolut për të bërë gjithçka që Ai dëshiron. Për shembull, ngjashmëria e gjymtyrëve dhe e organeve të njerëzve, sidomos simetria midis gjymtyrëve çift, janë prova vendimtare për Njësinë e Krijuesit. Dhe pangjashmëritë esenciale midis njerëzve, secili duke qenë një individ i ndryshëm duke pasur shenja dalluese, është një shenjë e qartë se Krijuesi vepron me zgjedhje, me vullnet absolut e me urtësi.

Mësoje, o shok! Njeriu është më i padrejti midis qënieve. Shiko sa të mëdhaja janë padrejtësitë e tij! Për shkak të dashurisë së tij për vetveten, ai nuk u jep gjërave asnjë vlerë, përveç se në proporcion me sa shumë dobi kanë ato për të. Ai gjithashtu i shikon rezultatet e tyre veçse në lidhje me dobinë e tyre për të. Ai supozon se qëllimi i jetës është vetë jeta. Jo, përkundrazi, në çdo krijesë ndodhen shembuj urtësie lidhur me Krijuesin që janë të vështira për mendjet për t'i kuptuar. Përse të mos jenë këto kafshë jetëshkurtëra dhe këto organizma të gjallë që zhduken shpejt, përse të mos jenë shembuj, modele, themele, bërthama për ngjashmëritë e tyre të mrekullueshme në botën e ndërmjetme, midis kësaj bote dhe tjetrës, midis botës materiale dhe shpirtërore dhe në botën e dimensionit të brendshëm të ekzistencës? Përse të mos jenë ato manifestime ose reflektime në këtë botë të veprimeve autoritative të Fuqisë Hyjnore dhe në botën e së padukshmes?

Mësoje, o shok! Ashtu si syri që e përkufizon vetveten tek ajo çfarë ai sheh ose çfarë ekziston para vetes, po ashtu nefsi urdhëruet për të liga e mohon ekzistencën e asaj që ai nuk e sheh, madje edhe në qoftë se ajo është më e qarta e vetëkuptueshme.

Mësoje, o shok! Njëpërmjet plotësisë së fuqisë së Tij, Zoti ua ka nënshtruar të gjitha grimcat dhe pjesët përbërëse të universit ligjeve të Tij dhe urdhërave të krijimit. Ashtu siç i thotë Ai një mize “Ji kështu” dhe ajo bëhet kështu, po ashtu Ai u thotë me të njëjtën lehtësi të gjitha kafshëve “Jini me veçori e forma të këtilla e të atilla dhe me kaq e q gjatësi jete!” dhe ato me lehtësi janë ashtu siç u urdhëruan të jenë.

Mësoje, o shok! Forca dhe fuqia që i ka marrë ato objekte qiellore në kapjen e saj dhe i ka vënë në rregull ato, ashtu siç i ke vendosur ti gurët e çmuar në kornizën e pasqyrës tënde, nuk është kurrë e paaftë për çfarëdo gjëje, as nuk lejon asgjë që të ndërhyjë në sferën e veprimeve të saja autoritare.

Mësoje, o shok! Nuk ka dyshim se një pikë uji është e të njëjtës natyrë me atë të një oqeani sepse të dy janë ujë dhe me lumin për shkak se të dy u formuan nga retë. Gjithashtu, imazhi i diellit në një pikë uji është pothuajse i të njëjtit identitet me atë të vetë diellit, dhe një peshk i vockël si një gjilpërë është i të njëjtës specie me atë të një peshkaqeni – balene– për shkak se të dy janë peshq. Përsëri, një kokërr gruri nuk është e ndryshme nga një grumbull gruri. Pikërisht, në këtë mënyrë, Emri Hyjnor i manifestuar në qelizën më të vockël vjen bashkë mbi gjënë mbi të cilën Ai manifestohet me Emrin e manifestuar mbi tërësinë e krijimit. Për shembull, Emri *i Gjithëdituri*, *El Alimu* për gjithçka manifestohet me Emrin *El Halik*, *Krijuesi* i kësaj grimce dhe me Emrin *El Musavvir Formëdhënësi* i kësaj blete, dhe bashkë me Emrin *El Munshiu*, *Ndërtuesi* i këtij fruti dhe me Emrin *Esh-Shafi*, *Shëruesi* i kësaj sëmundje. Do të ishte e pakonceptueshme për një Emër me sferën më të gjërë të manifestimit të mos manifestohet në gjënë më të vogël.

Mësoje, o shok! Plogështia, palëvizshmëria, mosveprimi dhe qëndrimi i pandryshuar në të njëjtat kushte do të thotë një lloj vdekje ose mosekzistence për një qenie të mundshme, jeta dhe mbijetesa e së cilës varen nga aktiviteti dhe ndryshueshmëria. Mosekzistenca është një dhimbje në vetvete dhe e keqe. Veprimtaria është një kënaqësi në vetvete dhe ripërtëritja njëpërmjet ndryshimit sjell mirësi të mëdhaja. Megjithëse mund të ketë ca dhimbje e dëshpërime në ndryshim e ripërtëritje, ato dhimbje e dëshpërime janë të mira në shumë drejtime. Duke qenë drita e ekzistencës, jeta pastrohet prej dëshpërimeve dhe përpunohet njëpërmjet dhimbjeve. Jeta matet në përputhje me si ajo i

merr dhe i reflekton manifestimet dhe cilësitë e Dhënësit të jetës, qoftë Ai i lartësuar. Sepse në jetë ndodhen shumë aspekte që lidhen me Dhënësin e jetës, ndërsa ndodhet vetëm njëri për vetë gjallesën.

Një flluskë e stolisur me reflektimin e diellit nuk ka të drejtë të kundërshtojë diellin dhe të kërkojë ndonjë gjë prej tij. Kur njeriu, i cili është si një flluskë në oqeanin e ekzistencës, beson, ai bëhet nëpërmjet besimit si një objekt i shndritshëm si të ishte një yll vezulluez, llampat e të cilit ndriçohen prej Diellit të Parapërdjetshëm.

Mësoje, o shok! Një ndërtues i vetëm e ndërton një pallat të madh dhe e pajis atë me çfarëdo që është e domosdoshme. Pastaj, ai ndërton dhe pajis një pallat tjetër më të vogël duke përdorur gjithçka që ai përdori në të parin. Tani, a do të ishte e mundur që qëllimi kryesor i ndërtuesit nuk është të ndërtojë pallatin e dytë të vogël dhe se qëllimet për ndërtimin e tij nuk lidhen me ndërtuesin? O njeri! Ti je ai pallat i vogël dhe toka është një pallat, dhe po kështu universi.

Mësoje, o shok! Allahu Xhel–le Xhelaluhu, lavdia e Tij qoftë e lartësuar, e bën Vetën të njohur për ne nëpërmjet krijesave të Tij dhe veprave të artit të Tij, dhe e bën Vetën të dashur nëpërmjet mëshirës së Tij, mirësive dhe furnizimeve. Për disa qëllime të tilla si ato që u përmendën, Ai manifeston pothuajse të gjithë Emrat e Tij. Kushdo që i kupton ato ashtu siç duhet –nëpërmjet aftësisë së të kuptuarit që ia jep Allahu– dhe pastaj ua shpjegon atë të tjerëve plotësisht, me lejen e Zotit Xhel–le Sheënuhu, ai do të ishte i meritueshëm për t’iu adresuar me: “Po të mos ishe ti, Unë nuk do t’i kisha krijuar botërat”. Ai është një lidhje e tillë e fortë dhe besnike midis tokës dhe qiejve, saqë toka është lidhur me Fronin më të lartë të Allahut nëpërmjet litarit të thurur në zemrën e tij. Si një qenie njerëzore, ai është më i nderuari i krijimit; si një shembull i njerëzimit, ai është më i plotësuar i qënieve njerëzore; dhe si një individ, ai është shkëlqesia, prijësi i llojit të nderuar me kalifatin e Zotit në tokë. Ai është prijësi i profetëve, imami i të devotshmive, dhe i dashuri i Zotit të botërave, Muhammedi a.s.m, paqja dhe bekimet qofshin mbi të, mbi familjen e tij dhe mbi sahabët – shokët e tij– deri në përjetësi.

Përfundim

Çfarëdo që vuhet për Zotin është e mirë! Sa e ëmbël do të ishte ajo edhe pse në dukje është e hidhur! Sepse ajo të bën ty të shijosh kënaqësinë e lutjes dhe të përgjërimit ndaj Tij.

Ibnu Sam'un thotë: "Çfarëdo ligjërata që nuk lidhet me Të është një bisedë boshe, e kotë".

Mësoje, se unë jam duke udhëtuar drejt Ahiretit. Unë kam aq shumë gjynahe, saqë jo vetëm jeta ime, por gjithashtu shumë jetë të tjerëve nuk do të mjaftonin për të kërkuar falje për to. Prandaj, unë ia delegoj dhe ia lë besim librit tim që t'i lutet Zotit për faljen e gjynaheve të mia vazhdimisht pas meje siç vijon:

Ah, sa keq! Sa mjerisht dhe sa e vajtueshme është që unë i kam kaluar e harxhuar jetën time, shëndetin dhe rininë në gjynahe e mosbindje, dhe për hir të dëshirave dhe tekave të dëmshme e kalimtare! Çfarë kanë mbetur prej moshës time të vjetër dhe shëndetit të sëmurë janë gjynahet dhe dhimbjet. Me këtë peshë të rëndë, fytyrë të errët dhe zemër të sëmurë, unë po i afrohem derës së varrit për një ndarje të përjetshme prej botës së përkohshme. Sa i poshtëruar do të jem kur Zoti im të urdhërojë: "Në Ferr i shtyni të gjithë hipokritët"!

إِلٰهِي عَبْدُكَ الْعَاصِي أَتَاكَ ، مُؤَرًّا بِالدُّنُوبِ فَقَدْ دَعَاكَ ، فَإِنْ
تَرَحَّمْ فَإِنَّتَ لِذَلِكَ أَهْلًا ، وَإِنْ تَطَرَّدْ فَمَنْ يَرَحِمُ سِوَاكَ ۞ يَا رَبِّ
زَكَّنَاهِ زُشْتِ حُودٌ مُنْفَعِلَمٌ ، أَرْ قَوْلٍ بَدُ و فِعْلٍ بَدِ حُودٌ حَجِيْلَمٌ ۞
فَيُضِ بَدَلَمُ زِ عَالِمٍ قُدْسٍ بَرِيْزٍ ، تَا مَحُو شُدَه خِيَالٍ بَاطِلٍ زِدَلَمُ

-----۞۞-----

Ve Hazret-i Mevlâna'nın (K.S.) nidasıyla rahmetin kapısını şöyle çalıyorum:

أَيُّ خُدَا مِنْ أَلَلِّهِ أَلَلِّهِ مِي زَنَمٌ ، بَرْدَرِ تُو شَيْنِيَّا لِلَّهِ مِي زَنَمٌ ۞ أَيُّ
خُدَا بَا سُوي حُودٌ رَاهُ نُمَا ، زَانِكِه مِّنْ كُم رَاهُم رَاهُ مِي زَنَمٌ ۞
إِلٰهِي لَسْنَتْ لِّلْفَرْدَوَسِ أَهْلًا ، وَلَا أَفْوَى عَلَى نَارِ الْجَحِيْمِ ۞ فَهَبْ
لِي تَوْبَةً وَاعْفِرْ ذُنُوبِي ، فَإِنَّكَ عَافِرُ الذَّنْبِ الْعَظِيْمِ ۞

O Zot! Nuk ka shpëtim e strehë përveç derës së mëshirës Tënde.

O Zot! Shërbëtori Yt i pabindur ka ardhur duke pranuar gjynahet e tij, dhe të përgjërohet.

Në qoftë se Ti e fal atë, kjo është ajo që Ti dëshiron të bësh, dhe nëse Ti e dëbon, kush tjetër do të ketë mëshirë për të?

O Zot! Pikëllohem për mëkatet e mia dhe pendohem për to; dhe jam i turpëruar për fjalët dhe veprat e mia të këqija.

Derdh bekime mbi zemrën time prej botës së shenjtërisë, me qëllim që fantazitë të largohen prej zemrës sime.

Të përgjërohem ta hapësh derën e mëshirës me thirrjen e Meulana:

“O Zot! Në mënyrë të përsëritur thërras o Zot! O Zot! Dhe shpreh gjëra për Zotin në rrugën Tënde.

O Zot! Më udhëzo tek rruga që të çon tek Ti; Jam i çudhëzuar, po kërkoj rrugën e drejtë.

O Zot! Unë nuk jam i denjë për Firdeusin – nivelin më të lartë të Xhennetit, as nuk e kam fuqinë të duroj zjarrin e Xhehennemit;

Më mundëso mua të jem i penduar për mëkatet e mia,

Të kërkoj falje për to, dhe më fal. Sepse Ti je Falësi i mëkateve, sado të mëdhaja të jenë ato”.

شَمَةٌ

مِنْ نَسِيمِ هِدَايَةِ الْقُرْآنِ

Një erë

Prej flladit të udhëzimit të Kuranit

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ عَلَى رَحْمَتِهِ عَلَى الْعَالَمِينَ بِرِسَالَةِ سَيِّدِ
الْمُرْسَلِينَ مُحَمَّدٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَ عَلَى آلِهِ وَصَحْبِهِ أَجْمَعِينَ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi i qoftë Allahut, Zotit të të gjitha botëve, për mëshirën e Tij ndaj botërave, nëpërmjet profetësisë së prijësit të mesazhierëve, Muhammedit a.s.m, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, familjen e tij dhe shokët.

Mësoje, o shok! Me të gjitha speciet, pjesët dhe ndarjet në botërat e së padukshmes dhe në botën e dukshme, tërësia e krijimit dëshmon se **لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ** “Nuk ka zot tjetër përveç Atij”, gjë e cila gjithashtu kërkohet dhe shfaqet nga bashkëpunimi dhe solidariteti midis atyre specieve dhe pjesëve.

Shtyllat e krijimit dhe strukturat duke filluar prej sistemit diellor për tek të tjerat, (më të vogëla apo më të mëdhaja) dëshmojnë se “Nuk ka

zot tjetër përveç Atij”, e cila gjithashtu kërkohet e shfaqet nga ngjashmëria dhe bashkëpërgjigjja midis atyre shtyllave dhe strukturave.

Të gjitha organet dhe gjymtyrët e qënieve të gjalla në tokë dëshmojnë se **لَا رَبَّ إِلَّا هُوَ** “Nuk ka Pronar tjetër përveç Tij”, gjë e cila gjithashtu kërkohet e shfaqet nga ato organe e gjymtyrë duke pasur pothuajse të njëjtat përbërje e funksione.

Të gjitha grimcat e të gjitha bimëve dhe kafshëve dëshmojnë se **لَا مَالِكًا إِلَّا هُوَ** “Nuk ka drejtues dhe organizues përveç Atij”, gjë e cila gjithashtu kërkohet dhe shfaqet nga ndihma e ndërhyrjeve midis atyre pjesëve.

Të gjitha nënndarjet e pjesëve të bimëve dhe të kafshëve dëshmojnë se **لَا مُدَبِّرَ إِلَّا هُوَ** “Nuk ka trajnues përveç Atij”. Kjo gjithashtu kërkohet dhe shfaqet nga fakti se korrespondenca, bashkëpërgjigjja midis anëtarëve individualë të specieve –në ato çfarë ato kanë pothuajse të njëjtat organe dhe struktura– shfaq të njëjtën penë dhe tregon se Trajnuesi është Një i Vetëm.

Ndryshimi midis formave dhe tipareve dalluese dëshmon se **لَا مُرَبِّيَ إِلَّا هُوَ** “Skalitësi është absolutisht i Lirë, duke bërë çfarëdo që Ai dëshiron dhe është i Gjithurtë”.

Të gjitha qelizat duke formuar pjesët dhe organet dëshmojnë se **لَا مُتَّصِرَفَ فِي الْحَقِيقَةِ إِلَّا هُوَ** “Nuk ka veprues autoritar përveç Atij”, dhe nuk mund të ketë asnjë veprim veçse nëpërmjet urdhërit të Tij në krijim dhe operim. Sepse, në qoftë se Vepruesi Autoritar nuk do të ishte Një dhe i Vetëm, atëherë do të duhej të ndodheshin veprues të pafundmë në numër, të cilët janë edhe të barabartë me njëri tjetrin në cilësi dhe të kundërt, edhe të pavarur edhe të varur, edhe të pakufizuar edhe të kufizuar, dhe kështu me rradhë.

Të gjitha atomet duke formuar qelizat dëshmojnë se **لَا نَاطِمَ إِلَّا هُوَ** “Nuk ka rregullator përveç Atij”, ashtu siç kërkohet kjo dhe shfaqet prej ngjashmërive dhe bashkëpërgjigjieve midis strukturave që punojnë e funksionojnë prej atomeve.

Dhe me të gjitha grimcat, substanca kryesore e krijimit -eteri-
dëshmon se **لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ** “Nuk ka zot tjetër përveç Atij”, siç kërkohet
gjithashtu dhe shfaqet nga thjeshtësia, qetësia dhe palëvizshmëria që ai
shfaq në përmbajtjen e urdhërave të Krijuesit.

Mësoje, o shok! Askush nuk ka të drejtë të ankohet apo të kundërshtojë Autorin e universit. Sepse të kënaqurit e individit ankues mund të rezultojë në shkeljen ose në të sakrifikuarit e mijëra shembujve të urtësisë duke pasë pjesë në rregullin e përgjithshëm të krijimit, i cili e refuzon kënaqjen e kapriçove të atij individi ankues.

وَلَوْ اتَّبَعُوا الْحَقَّ هُوَ أَعْلَمُ لَأَفْسَدُوا الْأَرْضَ

“Po të kishte qenë e vërteta në përputhje me dëshirat e tyre, padyshim që qiejt dhe toka dhe gjithë ç’është në to do të ishin shkatërruar”⁹⁸

O ankues! Si guxon të ngresh kundërshtime dhe t’i bësh kapriçot e tua standartin për rregullin e universit dhe shijen tënde të prishur si masë për shkallët e mirësive Hyjnore? Si do ta dije ti se ajo çfarë ti e sheh si një fatkeqësi nuk është një bekim? A je ti i autorizuar të ndryshosh drejtimin e kthimit të rrotave të krijimit, me qëllim që të kënaqësh kapriçot e tua të papërfillshme që nuk kanë më shumë peshë se sa krahu i një mushkonje? Ti mund t’ia drejtosh ankesat e tua vetëm Atij, jo rreth Tij, sepse çfarë bie tek pjesa jote prej Tij është vetëm ‘një kokërr’ prej grumbullit të drithit, dhe ai që është i pronizuar nuk mund të jetë pronar. Njihe vendin tënd dhe mos i kalo limitet e tua.

Mësoje, o shok! Ai që është duke operuar në një qelizë të trupit, sigurisht Ai operon në tërësinë e trupit, sepse ai duhet të operojë në një qelizë në përputhje me lidhjen e saj me trupin. Operimi në një qelizë është nën urdhërin e Krijuesit të të gjitha gjërave.

Mësoje, o shok! Si do t’i përshtatej urtësisë dhe Atributit të Ruajtjes së Një të Vetmi, i Cili ruan vezët e insekteve, parazitëve dhe të peshqive dhe farërat e bimëve për qëllime të urta e të mëshirshme, si do t’i përshtatej të neglizhonte për të regjistruar e ruajtur veprat e tua? Ato vepra janë bërthamat e pemëve që do të prodhojnë frutat e tyre në

⁹⁸Kur’an, 23:71

Ahiret, veçanërisht duke marrë parasysh se ti je një mbajtës i amanetit të Tij dhe kalifi i Tij në tokë. Çdo qenie e gjallë ushqen dëshirë të fortë dhe prirje që të ruajë jetën e saj. Kjo dhe tendenca në krijim për të pajtuar të kundërtat për vazhdimësinë e jetës, tregon se ekzistenca e botës do të rezultojë në qëndrueshmëri të përjetshme nëpërmjet Emrave Hyjnorë “*i Gjalli i Përjetshëm, Gjithëruajtësi, i Qëndrueshmi i Përherëshëm*”. Ato gjithashtu aludojnë për një fakt të përcaktuar nga Kaderi Hyjnor se çdo gjë e përkohshme që zhduket ka një aspekt ose pikë.

Mësoje, o shok! Ai i Cili ruan farën e një peme fiku nëpërmjet ndryshimeve që ajo ndërmerr derisa vetë përfundon në fik dhe e mbron atë me përkujdesje të plotë prej kalbjes, dhe përmes stinëve me çfarëdo që ajo duhet të rritet në një pemë fiku, saqë Gjithëruajtësi dhe Mbrojtësi i Vetëm, i Cili i mbron gjithashtu të gjitha bimët dhe kafshët e tjera, nuk do t’i neglizhonte aspak veprat e njeriut, i cili është kalifi i Tij në tokë.

Mësoje, o shok! Ekzistenca materiale e kuptimit –shkronjat dhe fjalët– mund të ndryshojnë dhe të eklipsohen, por kuptimi vazhdon të ekzistojë. Një lëvozhgë mund të copëtohet, por esenca ose thelbi mbetet. Rrobat grisen por trupi mbijeton; dhe trupi rrënohet por shpirti mbetet, mbijeton. Trupi vjetërohet por egoja mbetet e re; shumica dhe e shumta copëtohen e kalben, por Uniteti dhe Njësori mbeten përjetësisht. Pavarësisht vendosjes së tij në ‘trupa’ të ndryshëm, duke ndërmarrë shumë ndryshime dhe duke përjetuar shumë rrethana të ndryshme, “kuptimi” vazhdon e mbetet prej fillimit të jetës së tij deri tek fundi i tij, dhe ruan unitetin, domethënë, mbetet e qëndron. Pa dyshim, kjo tregon se ai do të kalojë sipër “gropës” së vdekjes dhe i çliruar prej çengelëve –grepave– të saj, dhe i zhveshur prej trupit të tij, vazhdon udhëtimin drejt përjetësisë shëndoshë e mirë. Tendënca e fortë e gjërave materiale, esencialisht të prirura drejt zhdukjes, për të mbetur e mbijetuar tregon qartë se gjërat e thjeshta të tilla si kuptimi, drita dhe shpirti, esencialisht të prirur për qëndrueshmëri, do të mbeten përjetësisht.

Mësoje, o shok! Madhështia e Hyjnisë së Zotit dhe dinjiteti i saj dhe pavarësia absolute kërkojnë që të gjitha gjërat, qofshin të mëdhaja apo të vogëla, duhet të jenë nën drejtimin e Tij autoritar. Përmasa jote e vogël fizikisht dhe disa nga gjendjet e parëndësishme në dukje nuk e

bëjnë të domosdoshme qënien tënde të përjashtuar prej Tij. Largësia jote prej Tij nuk do të thotë se Qënia e Tij është larguar prej teje, parëndësia e disa cilësive të tua nuk e bën të domosdoshme parëndësinë e ekzistencës tënde, dhe qënia jote i ndotur në karakter, mendje dhe në mënyrën e të jetuarit nuk bën të domosdoshëm qënien tënde të ndotur për sa ka të bëjë me urtësinë universale në ekzistencën tënde. Pastaj, madhështia e Krijuesit nuk kërkon që gjërat e vogëla duhet të përjashtohen prej drejtimit të Tij autoritar, meqë madhështia reale bën të domosdoshme gjithëpërfshirjen dhe pavarësinë, veçantinë në krijim, sjelljen në ekzistencë.

Mësoje, o shok! Sa më të mëdhaja të bëhen gjërat materiale të ngurta, aq më shumë e humbasin ato ndjeshmërinë e tyre ndaj gjërave të holla e delikate. Ndërsa drita shtrihet e përhapet, ajo shpërndahet më shumë dhe depërton më thellë në gjërat e fshehura e të holla. Dhe sa më e hollë të jetë drita, do të ishte më e zbuluar në brendësinë e gjërave si rrezja Röntgen. Në qoftë se kjo është kështu lidhur me dimensionet e ekzistencës së mundshme, ti mund ta shikosh se si ajo do të ishte për sa ka të bëjë me Dritën e dritave, Njohësin e të gjitha sekreteve dhe të fshehtave dhe Drejtuesin e natës dhe të ditës. Madhështia e Tij bën të domosdoshme të qënurit gjithëpërfshirës, depërtues dhe i gjithanshëm.

Mësoje, dhe shikoje se si Kurani i merr parasysh dhe begenis nivelin e të kuptuarit të njerëzve të thjeshtë, të cilët përbëjnë shumicën absolute. Në një çështje të mundshme për ta përshkruar në mënyra dhe shkallë të ndryshme, ai zgjedh mënyrën më të qartë e të kuptueshme prej tyre. Përndryshe, argumenti do të kishte qenë më i errët e më i ngatërruar se sa rezultati.

Kurani i përmend fenomenet natyrorë për të deduktuar Atributet e Krijuesit, lavdia e Tij qoftë e lartësuar! Ajo çfarë është më e kuptueshme dhe e qartë për njerëzit e thjeshtë është gjithashtu më e përshtatshme për udhëzimin. Për shembull, Kurani thotë:

وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافُ أَلْسِنَتِكُمْ وَالْوَاكِنُمْ

"Dhe nga treguesit e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe dallimi i gjuhëve dhe i ngjyrave tuaja"⁹⁹

⁹⁹Kur'an, 30:22

Prapa ndryshimit të ngjyrave qëndron përcaktimi i Zotit, individualitetet me shenja dalluese dhe me tiparet e secilit, ashtu siç u përmend në trajtesën e mëparshme “Edh–Dherreh”, “Grimca”. Kurani gjithashtu thotë:

انَّ فِي خَلْقِ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافِ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ

“Vërtet që në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe në këmbimin e ndërsjellë të ditës dhe të natës, ka padyshim tregues”¹⁰⁰

Në fletën e natës dhe të ditës zbulohet rrotullimi i tokës në akset e saja dhe rrotullimi rreth diellit. Përsëri, Kurani thotë:

وَجَعَلْنَا الْجِبَالَ أَوْتَادًا “Ne i kemi bërë malet si shtylla mbështetëse”¹⁰¹

Në këtë vërsset, toka shëmbëllet me një anije duke lundruar në oqeanin e hapësirës ose me një tendë të lidhur e të bërë të qëndrueshme si shtylla. Ato shtylla –male– gjithashtu shërbejnë për uljen e zemërimit të tokës për shkak të konvulzionit –tundjes– brenda saj.

تَكَادُ تَمَيِّزُ مِنَ الْغَيْظِ “E cila pothuaj shpërthen me vrull”¹⁰²

Nëpërmjet maleve, toka gjithashtu merr frymë, qetësohet. Po të mos ishin malet, toka do të çahet. Është pikërisht në sajë të maleve të saj që ajo vetëm lëkundet dhe pastaj zë vend, normalizohet. Gjithashtu, shihet qartë se malet janë rezervuarë uji dhe filtrues të ajrit. Gjithashtu, ato shërbejnë për të mbrojtur tokën prej shkeljes dhe uzurpimit të deteve. Prandaj, në një kuptim figurativ malet janë shtylla, domethënë shtyllat e jetës. Ti mund t’i krahasosh vërsset e tjerë të ngjashëm me shembujt që sapo u dhanë. Kurani i merr në konsideratë para së gjithash njerëzit e thjeshtë. Për të njëjtën arsye, sheriati –ligji Islamik– njihet e pranohet shikimin e lindjes dhe perëndimit të hënës (për të përcaktuar fillimin dhe përfundimin e muajit të shenjtë të Ramazanit etj), ndryshe nga llogaritjet astronomike. Përsëri, për këtë arsye, në Kuranin e gjithë është ndodhen përsëritje për të vërtetuar dhe përsëdytje për të konfirmuar.

¹⁰⁰Kur’an, 3:190

¹⁰¹Kur’an, 78:7

¹⁰²Kur’aan, 67:8

Mësoje, o shok! Vërsetet kuranore janë shumë më të gjëra në kuptim se sa imagjinatat në poezi dhe ato janë të lartësuara dhe larg të qënurit një poezi. Ai i Cili flet në vërsete, i përshkruan cilësitë e Veta esenciale dhe aktet, kurse shumica e poezisë flet rreth të tjerëve. Kurani që përshkruan të zakonshëm është i jashtëzakonshëm, kurse poezia që kryesisht flet për të jashtëzakonshëm është e zakonshme.

Mësoje, o shok! Pasqyrat reflektuese dhe faqet e krijimit duke dëshmuar Unitetin e Zotit janë të pafundme në numër dhe të shumëllojshme; dhe ato janë njëra brenda tjetrës, duke buruar nga e njëjta qendër. Shikimi i njëjës prej tyre kërkon shikimin e të tjerave; zbulimi i njëjës prej tyre bën të mundur hyrjen tek të gjithë ato. Nuk është rruga tjetër, domethënë, mosqënia i aftë për të parë njëjën nuk kërkon kurrë qënien e të gjitha atyre të mbuluara ose mosekzistente. Pavarësisht kësaj, nefsi urdhërues për të liga, i instruktuar prej shejtanit, mohon atë që është esencialisht e vërtetë dhe konfirmon atë çfarë është esencialisht e rreme.

Mësoje, o shok! Do të ishte e pamundur që shkruesi i një fjale në një libër mund të ishte tjetër nga shkruesi i një shkronje në të. Do të ishte e pamundur që shkruesi i një rreshti të ishte tjetër nga shkruesi i një faqeje ku ai është, dhe shkruesi i një faqeje të ishte tjetër nga shkruesi i vetë librit. Atëherë, gjithashtu do të ishte e pamundur që Krijuesi i një mize të mund të ishte tjetër nga Krijuesi i të gjitha specieve të kafshëve, dhe Krijuesi i të gjitha specieve të kafshëve të ishte tjetër nga Zoti i të gjitha botëve.

Njëra nga shenjat e Hyjnisë gjithëpërfshirëse absolute është se një fjalë ose madje një libër shkruhet në një shkronjë të madhe. Deti është njëri prej atyre shkronjave të mëdhaja në univers, pemët janë rreshtat e librit të universit dhe toka është si një pikë në tërësinë e universit. Krijuesi e shkruan, e krijon fjalën e peshkut në shkronjën e detit, disa krijesa lëvizëse tokësore në rreshtat e pemëve dhe kafshët në pikën e tokës. Një mizë në ndonjë vend a qoshe të tokës mund të supozohet të jetë e neglizhuar, ndonëse nuk është. Ashtu si tërësia e sures “Ja Sin” që mund të shkruhet brenda shkronjave initiale të saj, Ja dhe Sin, krijesat shkruhen në vezët ose farërat e tyre.

Mësoje, o shok! Ka ngjashmëri midis yjeve dhe diejve. Kjo tregon se Zoti i tyre nuk mund të jetë i llojit të tyre, as nuk mund të jetë Ai

njëri midis tyre. Zoti i njërit midis tyre është domosdoshmërisht Zoti i të gjithë atyre dhe Zoti i të gjitha gjërave.

O njeri! Ah, sikur të ishte i drejtë, i paanshëm, lidhur me atë çfarë ti vuan prej krijesave të tilla si pleshtat dhe mushkonjat! Në një kohë që ato krijesa të holla e të pafajshme durojnë me një nënshtrim të plotë pickimin, kafshimin tënd ndaj të gjitha frutave dhe shumicës së kafshëve, a do të ishte drejtësi të mos duroje shpagimin në shkallën më të vogël që ti vuan nga duart e disa krijesave bezdisëse? Kështu, plaga ka shpëgim.

Mësoje, o shok! Një individ njerëzor është një komunitet i formuar prej organesh dhe gjymtyrësh të përgjegjshme. Sepse secila nga shqisat e jashtme dhe të brendshme ka një formë të veçantë adhurimi, ashtu siç mund të jetë secila edhe rebeluese, edhe mëkatuese nëpërmjet një lloj çudhëzimi. Ashtu si përkulja e kokës –sexhdeja– përpara diçkaje apo ndokujt përveç Zotit që është çudhëzim, po ashtu sexhdeja e imagjinatave të poetëve me habi të tepruar dhe me dashuri adhuruese përpara bukurive të tjera dhe duke lavdëruar të tjerët përveç Zotit –jo për llogari të Allahut– gjithashtu është një lloj tjetër çudhëzimi që e çon imagjinatën të tejkalojë (limitet e vendosura nga Allahu). Krahasoju me imagjinatën shqisat dhe aftësitë e tjera.

Mësoje, o shok! Njëra prej shkaqeve më të shumta të çudhëzimit njerëzor është të supozuarit si e njohur atë me të cilën njeriu ka familiaritet për shkak të qënies së saj e përgjithshme dhe e zakonshme. Ndërsa, në shumicën e rasteve një lloj i tillë familiariteti mund të shkaktojë injorancë të përbërë. Por, për shkak të atij lloj familiariteti, njeriu nuk ka nevojë të reflektojë mbi atë çfarë është e zakonshme dhe e përgjithshme, ndonëse ato që ai i sheh si të përgjithshme janë mrekulli të Fuqisë Hyjnore. Ai vetëm i kushton vëmendje asaj që ai e sheh si të jashtëzakonshme për shkak të rrallësisë. Ai është si ai që, pa shikuar tërësinë e detit me të gjitha kafshët dhe bimët, shikon vetëm valët e shkaktuara nga era dhe shkëlqimin e detit. Pastaj, ai i mendon ato si provat e madhështisë së Pronarit të detit dhe të Autorit të tij, lavdia e Tij qoftë e lartësuar!

Mësoje, o shok! Shumica e njohurive të njerëzve rreth tokës dhe çfarë ata e shohin si të vetëkuptueshme bazohet mbi një familiaritet sipërfaqësor, e cila është një perde e shpërndarë mbi një injorancë të përbërë. Ato nuk kanë asnjë themel real. Për këtë arsye, Kurani tërheq

vëmendjen e njeriut tek e zakonshmja dhe tek ajo me të cilat njerëzit janë mësuar. Me shprehjet e tij shpuese, Kurani e heq mënjanë perden e familiaritetit të sipërfaqshëm dhe i shfaq njeriut se si gjërat që shihen si të zakonshme e të përgjithshme nën perden e familiaritetit janë në fakt të jashtëzakonshme.

Mësoje, o shok! Lidhja ose bashkëbisedimi midis dy gjërave nuk e kërkon qënien e tyre të barabarta ose të ngjashme me njëra-tjetrën. Një pikë shiu dhe një lule fruti kanë një lloj lidhje dhe marrëveshje me diellin. O njeri! Kurrë mos supozo se vogëlsia jote të mbulon prej shikimit dhe favorizimit të Krijuesit të të gjitha gjërave.

Mësoje, o shok! Shtrirja e kohës për disa evlija –shenjtorë– nuk është e pagjashme dhe e mohueshme. Për shembull, imam Sharani¹⁰³ siç përmendet në fund të *Al Teuakit vel xhevahir, Rubinët dhe llojet e tjera të gurëve të çmuar*, e studioi veprën “*El Futuhat El Mekkiyyeh*” *Zbulimet Mekane*, një përmbledhje prej katër volumesh të mëdhenj nga Muhjiddin Ibn el Arebi, dy herë e gjysëm në çdo ditë. Ndodhen shembuj që mund ta bëjnë të qartë e të kuptueshme këtë. A nuk e sheh ti se në një ëndërr e cila zgjat veçse pak sekonda është sikur ti të kesh jetuar një vit ose madje disa vite? Në qoftë se ti do të lexoje Kuran në vend të asaj që të ndodhi ty dhe të asaj që ndodhi për gjatë asaj kohe, do të kishe mbaruar së lexuari hatme Kurani në atë kohë të pakët. Kjo shtrirje e kohës në një eksperiencë të zakonshme është ajo çfarë mund të zbulojnë disa evlija –shenjtorë– gjërat e fshehta për njerëzit e tjerë që i përjetojnë në dimensione të mëdha ndërsa janë të zgjuar. Ata i afrohen sferës së shpirtit që nuk kufizohet e përfshihet nga koha.

Lëvizja është si trupi i kohës ose koha është si ngjyra e lëvizjes. Çfarëdo që ndodh në njërin gjithashtu ndodh në tjetrën. Kështu, përse të mos jetë e mundshme për një evlija, shpirti i të cilit dominon ekzistencën e tij trupore, të lëvizë me shpejtësinë e shpirtit ose të imagjinatës?

¹⁰³Imam Sharani, Abd Al Vahhab Ibn Ahmed Ibn Alip El Hanefi (1493-1564) ishte njëri nga dijetarët sufi. Ai lindi dhe jetoi në Egjipt. Ai ka disa vepra midis të cilave “El mizan el kubra” “Balanca më e madhe” dhe “El Envar el kudsijeh fi maërifet adab el ubudijeh” “Dritat e shenjta në njohjen e mënyrave të adhureshmërisë” janë më të famshmet. Përkthyesi.

Mësoje, o shok! Disa njerëz janë të pamundur të kuptojnë rezultatin e Unitetit Hyjnor; imagjinatat e tyre të prishura nuk mund ta mbajnë atë. Ata përpiqen të refuzojnë provat autentike e vendimtare që vërtetojnë Unitetin Hyjnor. Duke argumentuar se është e pamundur për një provë të tillë që të japë një rezultat të tillë të madh, ata përpiqen të dëmtojnë autenticitetin e vërtetësinë e tyre. Ata nuk e dinë se ajo çfarë e mbështet dhe çon tek ai rezultat është besimi, prova duke qenë vetëm se një dritare përmes të cilës për ta shikuar atë, ose si një furçë duke shkundur e pastruar pluhurat e iluzioneve prej saj. Përveç kësaj, nuk ndodhet një provë për Unitetin Hyjnor, përkundrazi, ndodhen aq shumë sa kokrrizat e rërës në shkretëtirë, sa pikat e shiut dhe sa valët e oqeanëve.

Mësoje, o shok! Ai që i përgatit për ty bostanin dhe mollën për t'i ngrënë, e di më mirë se ti atë çfarë të nevojitet për të ngrënë dhe është në dijeni të asaj me të cilën kënaqet ndërgjegjja jote. A do të ishte e mundur që degët dhe kërcellet e bimëve dhe të pemëve ta dinin këtë? Mjete ose shkaqe të tilla të mirësisë Hyjnore janë veçse kanalet e mëshirës dhe kanalet e mirësive.

Pjesa e dytë e shemme – erës

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi Zotit! Sa e hollë është perdja ndërmjet botës së dukshme dhe dimensioneve të padukshme të ekzistencës, dhe sa e madhe është distanca midis tyre! Sa e shkurtër, megjithatë sa e gjatë është rrua midis kësaj bote dhe botës tjetër! Sa e hollë, megjithatë, sa e trashë është perdja midis njohjes dhe injorancës! Sa e tejdukshme, megjithatë, sa e dendur është hapësira midis besimit dhe mosbesimit! Sa e shkurtër është distanca midis robërisë ndaj Zotit dhe mosbindjes, pavarësisht qënies së tyre aq të largëta sa Parajsa dhe Ferri! Sa e shkurtër është jeta dhe sa të mëdhaja janë shpresat dhe ambiciet!

Ashtu siç ndodhet midis të djeshmes dhe të sotmes një perde e hollë që nuk mund ta pengojë shpirtin për të kaluar e depërtuar në të djeshmen dhe në të shkuarën matanë saj, po ashtu ajo perde për sa ka të bëjë me trupin, kjo distancë është aq e madhe saqë do të kërkonte një vit për ta përshkuar. Gjithashtu, perdet midis dimensioneve të jashtme dhe të brendshme të ekzistencës dhe midis dynjasë dhe Ahiretit janë të holla dhe të tejdukshme për njerëzit e zemrës dhe të shpirtit, ndërsa janë tejet të trasha për njerëzit që u binden nefseve të tyre dhe dëshirave trupore. Gjithashtu, siç ndodhet midis ditës dhe natës tënde një interval i hollë, që është ‘kapaku i syrit’ tënd; kur ti e hap syrin e vetes tënde, nata jote zhduket dhe dita jote ndriçon; në qoftë se ti, nga ana tjetër, harron se çfarë je, ti bie në një natë të përhershme; po ashtu, kushdo që e vështron universin për hir të të Gjithëmëshirshmit, çfarëdo që ai sheh e dëshmon bëhet (një burim) njohje për të; në qoftë se ai vështron me një shikim pakujdesie dhe nga këndvështrimi i shkaqeve materiale ose natyrale, çfarëdo që ai vlerëson si njohje bëhet thjesht dhe vetëm injorancë.

Përsëri, ashtu si midis ndriçimit të “Aya Sofyas” dhe qënies së saj në errësi të dendur natën, ndodhet një kohë aq e shkurtër sa lëvizja e dy gishtave tek çelësi (elektrik); dhe vetëtimat e rrufesë dhe zhdukja e saj ndodhin pothuajse në të njëjtin çast; errësimi i qiellit me re të zeza

dhe pastrimi i tij nëpërmjet largimit të reve të zeza prej fytyrës së diellit nga një erë e mëshirës ndodhin vetëm njëra pas tjetrës në një kohë të shkurtër; po ashtu, ai që vështron dhe sheh me dritën e imanit dhe të besimit në Unitetin Hyjnor, e shikon universin të mbushur me dritë, me miqësi të ngushtë, me dashuri të ndërsjellë dhe me miqësi, dhe të gjitha gjërat dhe qëniet në të janë si vëllezër të dashur e miqësorë. Ndërsa, ai që vështron me mosbesim, i sheh të gjitha gjërat dhe qëniet si kufoma të tmerrshme dhe si të huaj armiqësorë ndaj njëri-tjetrit. Ai gjithashtu e shikon universin në perdet e errësirës njëra mbi tjetrën dhe vetveten e sheh në një det të thellë të mbuluar nga valë mbi valë, mbi të cilat janë retë; kur e shtrin dorën e vet, ai mezi mund ta shohë.

Dhe ashtu si perdja midis dy fytyrave –anëve– të një pasqyre që është më e hollë se një gjethe, por ndodhet aq shumë ndryshim midis tyre sa distanca midis lindjes dhe perëndimit; dhe me një lëvizje të gishtit, pasqyra ose buzëqesh në fytyrën tënde, ose është krejtësisht e zymtë; po ashtu, veprat e njeriut kanë dy aspekte ose dy ‘fytyra’. Veprat e bëra me nijetin –qëllimin– për të kënaqur Zotin të bëjnë ty me një fytyrë te tejdukshme në thellësinë e të cilës reflektohen manifestime të panumërta. Mungesa e një nijeti të tillë ose veprat që nuk kryhen për hir të Zotit shfaqin anën e errët dhe të patejdukshme, e cila nuk mban asgjë në emrin e të vërtetës.

Dhe ashtu si fytyra e errët që nuk ka thellësi dhe nuk mund të përfshijë asgjë, me përjashtim të zënies së një hapësire sa përmasa e vetvetes, ndërsa fytyra e tejdukshme, për shkak të lidhjes së saj me botën jomateriale, të ideve apo të simboleve mundet, në sajë të tejdukshmërisë së saj, të përfshijë gjëra të mëdhaja të panumërta; po ashtu, jeta ka dy fytyra, e para e të cilave lidhet me dynjanë dhe është e errët, e ngushtë dhe e përkohshme, ndërsa tjetra që lidhet me të Vërtetin është e tejdukshme, e gjërë dhe e vazhdueshme. Nefsi i pakujdesshëm, në influencën e sofistiksë djallëzore, vesh fytyrën e errët, por kërkon në të çfarë është e mundshme në fytyrën e tejdukshme si të kërkuarit e përjetësisë.

Mësoje, o shok! Çelësi i krijimit është në duart e njeriut, në egon e tij. Megjithëse dyert e krijimit duken të jenë të hapura, ato në fakt janë të mbyllura. I Vërteti, qoftë Ai i lavdëruar, i ka lënë në besim si amanet njeriut një çelës me të cilin hapen të gjitha dyert e krijimit dhe zbulohet thesari i Krijuesit. Çelësi që t’u besua është egoja, e cila në vetvete

është një enigmë. Kur ti e zgjidh atë enigmë duke njohur natyrën e saj, krijimi hapet për ty. Allahu Fuqiptotë, lavdia e Tij qoftë e lartësuar, i ka dhënë njeriut egon me qëllim që ajo të mund të shërbejë si një njësi krahasimi për të kuptuar Atributet e Hyjnisë. Kur njeriu e njeh ç'është egoja, ai bëhet ta shohë atë si të hollë e të dobët, si një fije e vetëdijshme në litarin e ekzistencës së njeriut, si një vijë e hollë në veshjen e natyrës së njeriut, si një elif¹⁰⁴ në librin e individit. Ajo gjithashtu ka dy fytyra, njëra që është kthyer drejt të mirës, një marrëse pasive e mirësive dhe e bekimeve të Zotit, jo vepruese, ndërsa tjetra është e kthyer drejt të keqes, mosekzistencës dhe qënies së vetvetes një vepruese. Ajo ka një natyrë të rreme, një hyjni e një sovranitet të imagjinuar dhe një ekzistencë aq të dobët, saqë nuk mund të mbajë vetë asgjë. Ajo është për të funksionuar si një termometër ose ndryshe si një instrument me të cilin maten gjërat dhe pronësitë. Ajo është një masë me të cilën njihen Atributet gjithëpërfshirëse dhe absolute të Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm. Njeriu duhet të jetë shumë i vetëdijshëm për këtë dhe duke u bërë një referencë *قَدَافَلَحَمَّنْزَكِّيَهَا* "Vërtet që do të ngadhënjëjë ai i cilin e pastron vetveten"¹⁰⁵ përmbush atë që duhet për amanetin me të cilin është ngarkuar.

Në qoftë se reflekton mbi egon si një njësi krahasimi për të kuptuar Atributet dhe Emrat e Krijuesit, ajo bëhet një sy për të shikuar çfarëdo që ekziston në univers. Informacioni që ti merr nga universi gjen në ego çfarë do ta konfirmojë atë dhe e bën atë njohje reale. Pastaj, pretendimi i saj për hyjni ose sovranitet dhe vetëpronësi vjen në fund, dhe ajo percepton se ekzistenca e saj është vetëm se një ekzistencë e supozuar. Ndërsa, po qe se ti e konsideron egon si të kishte një ekzistencë të pavarur nga vetvetja dhe si rrjedhojë e tradhëton amanetin, atëherë ti do ishe midis atyre të referuar tek:

وَقَدْ خَابَ مَنْ دَسِيَّهَا "Dhe vërtet që dështon ai i cilin e prish vetveten".¹⁰⁶

Sepse ajo është egoja, të cilës iu shmangën qiejt, toka dhe malet prej mbajtjes, meqë me atë aspekt të saj, egoja është burimi i shirkut, i

¹⁰⁴ Elif, ل, shkronja e parë e alfabetit arab

¹⁰⁵ Kur'an, 91:9

¹⁰⁶ Kur'an, 91:10

të gjitha të këqijave dhe i llojeve të çudhëzimit. Në qoftë se egoja e fshih vetveten prej teje, ajo bëhet e trashë, fryhet e zmadhohet derisa të gëlltit, dhe me të gjithë ekzistencën tënde, ti bëhesh një ego. Pastaj, ajo bëhet më e fortë me fanatizmin tribal –fisnor– dhe pastaj, racial, derisa të bëhet një shejtan duke luftuar kundra urdhërit të Krijuesit të vet. Pastaj, ajo i krahason njerëzit e tjerë, gjërat dhe shkaqet materiale me vetveten, duke i atribuar secilës vetëpronësi dhe sovranitet, dhe kështu bie në llojin më të tmerrshëm të shirkut, të përshkruarit ortakë me Zotin. Ndërsa është në këtë gjendje, nëse ti i lëviz sytë e tu anembanë krijimit, çdo gjë është e mbyllur në fytyrën tënde pikërisht kur ajo duket të jetë e hapur për ty, sepse sytë e tu kthehen tek vetja jote dhe ti e shikon çdo gjë të ngjyrosur nga egoja. Ngjyra e egos është shirku ose mohimi i Zotit. Madje sikur të gjitha horizontet të mbusheshin dukshëm me shumicën e shenjave të manifestuara (të ekzitencës dhe Unitetit të Krijuesit), çfarë mbetet në ego do të ishte një pikë e errët duke i mbuluar të gjitha gjërat.

Një çështje e rëndësishme

Egoja ka dy fytyra, njëra e përfaqësuar nga profetësia, tjetra nga filozofia njerëzore.

Fytyra e parë është origjina e robërisë së pastër ndaj Zotit. Në këtë fytyrë, egoja tregon Zotin dhe jo vetveten, dhe ajo ka një ekzistencë të varur të rreme. Megjithëse ajo shfaqet të jetë vetëpronare, në fakt ajo është e pronizuar dhe e drejtuar nga Një tjetër, Zoti. Ajo ka një realitet të supozuar, jo të vendosur. Detyra e saj është të jetë një masë, një njësi krahasimi për të kuptuar Atributet e Krijuesit. Ky është realiteti i egos, ashtu siç u shikua nga profetët, të cilët ia dorëzuan tërësinë e krijimit Zotit xh.sh, ata pohuan e demonstuan se Zoti xh.sh nuk ka absolutisht ortakë as në sovranitetin e Tij, as në Hyjninë e Tij dhe as në Qënien e Tij Perëndi. Në Dorën e Tij janë Çelësat e të gjitha gjërave dhe Ai ka fuqi absolute mi të gjitha gjërat. Nga kjo fytyrë e tejdukshme e gjallë e egos, Mëshirëploti Xhel–le Xhelaluhu ka rritur e zhvilluar pemën e bekuar të robërisë (ndaj Zotit), degët e bekuara të së cilës janë shpërndarë nëpër kopshtin e universit të varura me vilet e frutat e mesazhierëve, profetëve, evlijave dhe dijetarëve të vërtetë që shndërrisin në errësirën si yje.

Sa për filozofinë, ajo e konsideron egon si të kishte një ekzistencë të pavarur e të vetëpronizuar duke shfaqur vetveten. Filozofët kanë supozuar se egoja ka një realitet të vendosur, të qëndrueshëm, dhe se detyra e saj është të plotësohet nëpërmjet vetëdashjes – duke dashur vetveten. Me këtë supozim, shumë lloje shirku kanë buruar dhe në kohën e egos është rritur pema e mallkuar e çudhëzimit. Dega e fuqisë së dëshirave shtazore të kësaj peme, e cila vlerëson fuqinë e padrejtë ose forcën dhe bukurinë fizike të dashuruar për t'u dukur, i ka dhënë njerëzimit idhujt e hyjnizuar (nga admiruesit e tyre), ndërsa vetë përkulen para admiruesve të tyre me një qëndrim adhurimi. Dega e fuqisë së zemërimit ka prodhuar mbi kokat e njerëzimit Faraonë e Nimrudë. Dega e fuqisë së arsyes ka prodhuar ateistë dhe materialistë. Filozofët i atribuojnë Zotit veçse një pjesë të mbretërisë së Tij dhe pjesën e mbetur ia atribuojnë të tjerëve veç të Gjithëfuqishmit.

Megjithëse egoja është esencialisht si ajri ose si avulli, për shkak të shikimit ndjellakeq të filozofëve, ajo bëhet më e dendur duke u bërë e lëngët dhe pastaj, për shkak të familiaritetit të sipërfaqshëm, bëhet si një gjë e ngurtë. Pastaj, për shkak të pakujdesshmërisë, ajo bëhet e ngrirë, dhe pastaj, për shkak të mosbindjes ajo bëhet më e fortë dhe fryhet e zmadhohet derisa e gllabëron pronarin e saj. Ajo bëhet më e gjërë me qëndrimet tribaliste ose raciste, dhe pastaj, për shkak se ua atribuon njerëzve të tjerë ose shkaqeve natyrale vetekzistencën ose pronësinë dhe madje edhe krijueshmërinë, sikur ia atribuon të njëjtat vetvetes, egoja fillon të luftojë kundra Krijuesit të saj. Derisa filozofët janë ndjerë të detyruar të besojnë se shkaqet natyrale kanë efekt real në krijimin dhe në kontrollin e gjërave, dhe i atribuojnë krijueshmëri natyrës dhe rastësisë. Kjo është përse ata e mohojnë Ringjalljen dhe pranojnë se shpirtërat, ose siç është rasti te materialistët, lënda nuk ka fillim. Allahu i sulmoftë ata, sa të mbrapshtë janë! Për shkak të mendjemadhësisë ata janë bërë lodra të djajve, të cilët i kanë hedhur ata në humnerat e çudhëzimit.

Egoja në botën e vogël -njeriun- është si natyra në botën e madhe-universin. Të dyjave u është përshkruar ortakëri me Zotin dhe si rrjedhojë janë hyjnizuar.

فَمَنْ يَكْفُرُ بِالطَّاغُوتِ وَيُؤْمِنُ بِاللَّهِ فَقَدِ اسْتَمْسَكَ
بِالْعُرْوَةِ الْوُثْقَىٰ لَا انفِصَامَ لَهَا وَاللَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

“Kushdo që mohon tagutin (çfarëdo që adhurohet përveç Zotit) dhe beson në Allahun, atëherë ai ka rrokur mbajtësin më të sigurtë që nuk thyhet kurrë, dhe Allahu është Gjithëdëgjuesi, i Gjithëdituri”¹⁰⁷

Mësoje, o shok! Veprat e mira fitojnë gjallëri –jetë– nëpërmjet qëllimit të sinqertë dhe prishen nëpërmjet të vepruarit për t’u dukur, mburrjes dhe hipokrizisë. Ndërsa ndjenjat dhe tendencat (natyrale) ndaj të mirës së ngulitur në ndërgjegje e humbasin pastërtinë e tyre nëpërmjet qëllimeve të ndërgjegjshme. Ashtu siç është nijeti –qëllimi– jeta e veprave, po ashtu, ai është vdekja e gjendjeve të natyrshme. Për shembull, nijeti për të qenë i përlur prish përlulësinë, dhe nijeti për të qenë i madh nxit shpërfillje. Gjithashtu, nijeti për të pasur lehtësim e

¹⁰⁷Kur’an, 2:256

zbavitje shkakton zhdukjen e lehtësimit, dhe nijeti për të qenë i pikëlluar pakëson pikëllimin, dhe kështu me rradhë.

Mësoje, o shok! Ligji i plotësimit –i rritjes dhe zhvillimit– operon në një pemë. Bërthama e pemës nga e cila ajo rritet, është esenca e asaj peme. Ashtu siç njihet, bërthama përfshihet nga fruti –nëse nuk pengohet– ajo rritet nga Përkujdesja e Parapërdjetshme duke u bërë një pemë dhe përsëri vedoset në frutin që rritet në atë pemë. Fruti është pjesa më e çmuar, më e shquar, më e holla, më e kënaqshmja, më e rëndësishmja dhe më e ndritshmja e pemës, duke qenë qëllimi i ekzistencës së saj.

Universi është një pemë. Elementet bazë si dheu, uji, ajri dhe zjarri janë degët e saj, bimët gjethet e saj, kafshët lulet e saj dhe njerëzit frutat e saj.

Më rrezatuesi i atyre frutave, më i shquari, më i madhi, më i bukuri, më fisniku, më gjithëpërfshirësi dhe më i dobishmi i tyre është profeti Muhammed a.s.m, prijësi i profetëve, imami i të devotshmive dhe i dashuri i Zotit të të gjitha botërave. Ai bëri miraxhin dhe syri i tij nuk u lëkund; hëna u çka më dysh për të; dhe zhapiku, gazela, ujku, deveja, mali, shkëmbi, druri, pema, plisi i folën atij. Nga gishtërinjtë e tij uji vërshoi si burim i Keutherit. Ai është më i virtytshmi i njerëzimit, ai që mbajti të gjitha të vërtetat e besimit në personin e tij, me të cilin u arrijnë krijesave të gjitha manifestimet Hyjnore favorizuese, dhe mbi të cilin janë përqëndruar të gjitha misteret e Zotit duke qenë i Gjithëmëshirshëm. Ai është komandanti i ‘kalorësisë’ së profetëve dhe i të vërtetëve, dhe ai është më i miri i të gjitha krijesave.

Ai është mbajtësi i flamurit më të madh nëpërmjet besimit dhe nënshtrimin ndaj Unitetit Hyjnor dhe pronari i litarit më të shquar dhe më të lartë nëpërmjet Islamit. Ai është dëshmitari i mistereve të parapërdjetshme dhe vëzhguesi i dritave dhe interpretuesi i gjuhëve të atyre që e paraprinë. Ai është burimi i njohjes, i butësisë dhe i urtësisë. Ai arriti rangun më të lartë të robërisë ndaj Zotit dhe u dallua me moralin më të lartë të rangjeve më të pastërta. Ai është miku më i madh i Zotit dhe i dashuri më i nderuar i Tij a.s.m, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të sa të vazhdojnë qiejt dhe toka.

عَلَيْهِ أَفْضَلُ الصَّلَوَاتِ وَأَزْكَى التَّحِيَّاتِ

وَأَنَّمَى الْبَرَكَاتِ مَادَامَ الْأَرْضُ وَ السَّمَوَاتِ

Merre dorën time, o prijës i profetëve,

Ti je i dëshiruari dhe i kërkuari, o drita e qartë e bujarisë së Zotit;

Unë nuk kam lider dhe as strehë përveç teje; Prova ime është:

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ مُحَمَّدٌ رَسُولُ اللَّهِ

Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, dhe Muhammedi është i dërguari i Allahut.

O Zot! Do të doja të kisha një mijë gjuhë për të të kërkuar Ty falje deri në Ditën e Kijametit. O Zot! Bëje këtë trajtesën time një zëvendëse për ato gjuhë që kërkojnë falje dhe që bëjnë salevate mbi profetin në vendin tim sa të ekzistojnë penat dhe sa të vazhdojnë të shkruajnë.

O Zot! Gjynahet më kanë bërë të shurdhët dhe shumësia e mosbindjeve të mia më kanë turpëruar. Madhësia e pakujdesisë sime më ka bërë të ulë zërin tim. Unë trokas tek dera e mëshirës Tënde dhe thërras tek dera e faljes Tënde me gjuhën e prijësit tim dhe mbështetjes. Shejh Abd Al Kadir Al Xhilani, iu shenjtëroftë sekreti i tij dhe thërras me thirrjen e tij të pranueshme dhe të njohur tek derëtari:

يَا مَنْ وَسِعَتْ حَمَّتُهُ كَلِّشِي ۚ وَ يَا مَنْ بَدَّ هَمَلِكُو نِكَلِّشِي ۚ وَ يَا مَنْ لَا يَضُرُّ هُشِي ۚ
 ۚ وَ لَا يَنْفَعُهُ شِي ۚ وَ لَا يَغْلِبُهُ شِي ۚ وَ لَا يَعْزُ بِعَنْهُ شِي ۚ وَ لَا يَبُودُ هُشِي ۚ وَ لَا يَسُ
 تَعِينُ شِي ۚ وَ لَا يُشْغَلُ هُشِي ۚ ۚ عَنِّي ۚ وَ لَا يُسَبِّهُ هُشِي ۚ ۚ ۚ وَ لَا يُعْجِزُ هُشِي ۚ ۚ
 ۚ غَفِرَ لِكَلِّشِي ۚ ۚ حَتَّى لَا تَسْأَلُنِي مَنْ شِي ۚ ۚ يَا مَنْ هُوَ آخِذٌ بِنَاصِيَةِ كَلِّشِي ۚ وَ بِيَدِهِ
 مَقَالِيدُ كَلِّشِي ۚ وَ يَا مَنْ هُوَ الْأَوْ لَقَبُ كَلِّشِي ۚ وَ الْأَخِرُ بَعْدَ كَلِّشِي ۚ وَ الظَّاهِرُ فَوْ
 قَ كَلِّشِي ۚ وَ الْبَاطِنُ دُونَ كَلِّشِي ۚ وَ الْفَا هِرُ فَوْ قَ كَلِّشِي ۚ ۚ غَفِرَ لِكَلِّشِي ۚ ۚ إِنَّ كَعْلَى
 كَلِّشِي ۚ ۚ عَدِيدٌ ۚ ۚ وَ يَا عَلِيمًا بِكَلِّشِي ۚ وَ مُحِيطًا بِكَلِّشِي ۚ وَ بَصِيرًا بِكَلِّشِي ۚ وَ يَا
 اَشْهَدًا عَلَيَّ كَلِّشِي ۚ ۚ وَ يَا قَبِيًّا عَلَيَّ كَلِّشِي ۚ ۚ وَ لَطِيفًا بِكَلِّشِي ۚ ۚ وَ خَبِيرًا بِكَلِّشِي ۚ ۚ ۚ
 ۚ غَفِرَ لِكَلِّشِي ۚ ۚ مِنْ الذُّبُوبِ الْخَطِيئَاتِ حَتَّى لَا تَسْأَلُنِي عَنْ شِي ۚ ۚ إِنَّ كَعْلَى كَلِّشِي ۚ ۚ قَدْ
 ۚ ۚ اللَّهُمَّ إِنِّي أَعُوذُ بِكَ مِنْ جَلَالِكَ وَ جَلَالِ عِزِّكَ وَ تَكْوِينِكَ وَ قُدْرَتِكَ وَ سُلْطَانِكَ وَ سُلْطَانِ قُدْرَتِكَ
 وَ تَكْمَلِ الْقَطِيعَةِ الْأَهْوَاءِ الرَّدِيئَةِ يَا جَارَ الْمُسْتَجِيرِ يَا أَجْرَ نِيْمَانَ الشَّهَوَاتِ
 شَيْطَانِيَّةٍ وَ طَهَّرْ نِيْمَانَ الْقَادُورِ يَا بَشْرِيَّةٍ وَ صَفْنِي بِحَبْنِي بِكَ مُحَمَّدٍ صَالِحًا لُحُوعًا

لَيْهَؤْ سَلَامًا لِّلْمُحَبَّةِ الصِّدِّيقِيَّةِ مِنْ صَدَاءِ الْعَفْلَةِ أَوْ هَامِ الْجَهْلِ حَتَّى تَقْنَبَنَا لِأَنَانِي
 هُوَ يَبْقَا الْكُلُّ هُوَ بِاللَّهُوَ مِنَ الْهَعْرِ قَابِنِعْمَةِ اللَّهُ بِحَرْ مَنَّةِ اللَّهُ مَنصُ
 وَرِيْنَسِيْفَاللَّهُمْ خَطُو ظِينِ عِنَايَةِ اللَّهُمْ خَفُو ظِينِ حِمَايَةِ اللَّهُمْ كُنْشَا غَلِيْشَغ
 لَعْنَاللَّهُ ۞ فَيَانُورَ الْأَنْوَارِ وَيَا عَالِمًا لِأَسْرَارِ وَيَا مُدَبِّرَ الْيَلْوِ النَّهَارِ يَا مَلِكِيَا عِ
 زِيْرُ يَا قَهَّارُ يَا رَحِيْمِيَا وَدُوْا دِيَا عَفَّارُ يَا عَلَمًا لِّغُيُوْبِيَا مُقَلِّبًا لِّلْقُلُوْبِ وَالْأَبْصَارِ
 يَا سِتَّارَ الْعُيُوْبِيَا عَفَّارَ الذُّنُوْبِ يَا غَفِيْرَ لِدُنُوْبِيَا وَرَحْمَمُنْضَا قَتْعَالِيْهَا لِأَسْبَابُو
 غُلْفَتْدُوْنَهَا لِأَبُو ابُوْتَعَسَّرَ عَلِيْهِ سَلُوْ كَطْرٍ يِقَاهَا لِأَصْوَابُو أَنْصَرَ مَتَايَا مَهُو
 نَفْسُهُرَاتِعَةٌ فِيمَا دِيْنَا الْعَفْلَةِ وَالْمَعْصِيَّةِ تُوْدِنِي الْاِكْتِسَابِ ۞ فَيَا مَنْ إِذَا
 دُعِيْ أَجَابَ وَ يَا سَرِيْعَ الْحِسَابِ وَ يَا كَرِيْمُ يَا وَهَّابُ إِرْحَمْ مَنْ
 عَظَمَ مَرَضُهُ وَ عَزَّ شِفَائُهُ وَ ضَعُفَتْ حِيلَتُهُ وَ قَوِيْ بَلَاءُهُ وَ أَنْتَ
 مَلْجَأُهُ وَ رَجَائُهُ ۞ إِلَهِيَا لِيْكَ أَرْفَعُ بَيْنُو حُزْنِي وَ شِكَايَتِي ۞ إِلَهِي
 حُجَّتِي حَاجَتِي وَ عُدَّتِي فَاقَّتِي وَ انْقِطَاعُ حِيَلَتِي ۞ إِلَهِي قَطْرَةٌ مِنْ
 بِحَارِ جُودِكَ تُغْنِيْنِي وَ ذَرَّةٌ مِنْ تِيَارِ عَفْوِكَ تُكْفِيْنِي ۞ يَا وَدُوْدُ
 يَا وَدُوْدُ يَا وَدُوْدُ يَاذَا الْعَرْشِ الْمَجِيْدُ يَا مُبْدِيْ يَا مُعِيْدُ يَا فَعَالًا لِمَا
 يُرِيْدُ أَسْأَلُكَ بِوَجْهِكَ الَّذِي مَلَأَ أَرْكَانَكَ شِكْوًا أَسْأَلُكَ بِقُدْرَتِكَ الَّتِي
 قَدَّرْتَ بِهَا عَلَيَّ جَمِيْعَ خَلْقِكَ وَ بِرَحْمَتِكَ الَّتِي وَسَّعَتْ كُلَّ شَيْءٍ
 لِإِلَهٍ إِلَّا أَنْتَ يَا مُغِيْثُ أَغْنِنَا وَ اغْفِرْ جَمِيْعَ ذُنُوْبِي وَ سَقِّطَاتِ
 لِسَانِي فِي جَمِيْعِ عُمْرِي بِرَحْمَتِكَ يَا أَرْحَمَ الرَّاحِمِيْنَ أَمِيْنَ أَمِيْنَ
 ۞ وَ الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِيْنَ ۞

O Ti që mëshira Jote i rrethon të gjitha gjërat!

O Ti që në Dorën Tënde është dominimi i të gjitha gjërave!

O Ti që asgjë nuk të bën Ty as dëm dhe as dobi!

Ty asgjë nuk mund të të mposhtë dhe asgjë nuk mund të fshihet prej Teje;

Asgjë nuk të lodh Ty dhe asgjë nuk të ndihmon;

As bërja e diçkaje nuk të pengon Ty nga bërja e diçkaje tjetër;

Dhe asgjë nuk të shëmbëllen Ty dhe nuk të ngatërron!

Më fal mua për çfarëdo që bëj, (që nuk të kënaq Ty) me qëllim që të mos më marrësh në llogari për çdo gjë (të mëkatshme) që unë kam bërë.

O Ti që e kap çdo gjë prej balukëve –që e ke nën sundim çdo gjë– dhe që në Dorën Tënde janë çelësat e të gjitha gjërave!

O Ti që je i Pari, para të gjitha gjërave;

Je i Fundit, pas të gjitha gjërave;

Je i Dukshmi, mbi të gjitha gjërat;

Dhe i Padukshmi, më i Brendshmi i të gjitha gjërave,

Je Mposhtësi mbi të gjitha gjërat!

Më fal mua për të gjitha gjërat.

Ti je i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat dhe Gjithëpërfshirës për të gjitha gjërat,

Dëshmitar për të gjitha gjërat;

Kontrollues për të gjitha gjërat;

Depërtues tek të gjitha gjërat;

I Mirinformuar për të gjitha gjërat!

Më fal mua për të gjitha mëkatet dhe gabimet, me qëllim që Ti të mos më marrësh në llogari për asgjë. Ti je i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat.

O Zot! Kërkoj mbrojtje nëpërmjet fuqisë së madhësisë Tënde dhe madhësisë së fuqisë Tënde dhe nëpërmjet forcës së sovranitetit Tënd dhe sovranitetit të forcës Tënde që të më ruash prej shikëputjes së lidhjes sime me Ty dhe prej epsheve vrastare.

O i Afërti i atyre që kërkojnë afrimet me Ty! Më ruaj prej dëshirave djallëzore! Më pastro prej papastërtisë njerëzore! Më pastro mua nëpërmjet dashurisë së singertë për profetin Muhammed a.s.m! Më pastro prej ndryshikut të pakujdesshmërisë dhe iluzioneve të injorancës, me qëllim që të mund të çlirohem prej nefsit tim, egos sime, derisa të asgjësohet nefsi im dhe të mbetet gjithçka për Allahun, me Allahun, për tek Ti dhe prej Teje. Dhe që të mund të përmbitem prej favoreve të Allahut në oqeanin e mirësive të Zotit, duke qenë midis atyre që janë fitimtarë nëpërmjet shpatës së Allahut, të favorizuar me përkujdesjen e Allahut, të ruajtur me mbrojtjen e Allahut nga çdo gjë që i pengon prej Allahut.

O Drita e dritave! O Njohësi i sekreteve! O Administrues i natës dhe i ditës! O Sovran! O Mposhtësi! O Mëshirëplotë! O i Dashur! O Falësi! O Njohësi i të padukshmes! O Ndryshuesi i zemrave dhe i syve! O Mbuluesi i defekteve (të sherbëtorëve të Tu)! O Falësi i mëkateve! Më fal mua për mëkatet e mia dhe kjo mëshirë për atë që është në vështirësi të pakapërcyeshme, për të cilin të gjitha dyert

janë të mbyllura, për të cilin është e vështirë të ndjekë rrugën e të drejtëve, dhe ditët e të cilët janë harxhuar në vendet e pakënaqësisë, mosbindjes dhe gjynaheve.

O Ti që përgjigjesh kur të drejtohet lutja!

O Ti që je i shpejtë në kërkim llogarie!

O Gjithëbujar! O Dhurues! Ki mëshirë mbi atë që ka sëmundje të rënda të vështira për t'u kuruar, i cili ka pak mjete të dobëta ndërsa është goditur me fatkeqësi të rënda! Ti je streha e tij dhe shpresa e tij!

O Zot! Unë të ankojem ty rreth vështirësive dhe sprovave të mia!

O Zot! Argumenti im është nevoja ime, dhe çfarëdo që kam në emrin e mjeteve është veçse mungesa ime e mjeteve dhe dobësia ime!

O Zot! Një pikë e vetme prej oqeanit të mirësisë Tënde më bën mua të pasur dhe një pikë e vetme prej vërshimit të faljes Tënde më mjafton mua.

O i Dashur! O i Dashur! O i Dashur! O Zotërues i Fronit më të Lartë! O Filluesi dhe o Rikthyesi! O Ti që bën çfarëdo që do! Të përgjërohem e të lutem për hir të dritës së Fytyrës Tënde e cila mbush të gjitha kolonat e Arshit Tënd dhe për hir të fuqisë Tënde me të cilën Ti je i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha krijesat e Tua, dhe për hir të mëshirës Tënde e cila i rrethon e i përfshin të gjitha gjërat! Nuk ka zot tjetër përveç Teje. O Ndihmues! Të lutem të më ndihmosh dhe të m'i falësh të gjitha mëkatet e mia dhe gafat e gjuhës sime gjatë gjithë jetës sime, për hir të mëshirës Tënde, o më Mëshiruesi i mëshiruesve! Amin! Amin! Amin!

O ti që e lexon këtë kërkim falje! Lexoje atë së pari për veten tënde dhe së dyti në vendin tim në rrugën e Zotit. Sepse unë jam i shtrirë në varrin tim, i pamundur për të bërë asgjë dhe për të thënë asgjë. Unë mund të flas vetëm me gjuhën tënde nëpërmjet këtij librit tim, prandaj fol edhe nga ana ime gjithashtu vetëm për hir të Zotit.

Said Nursi

Pjesa e tretë e shemme – erës

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

(وَمِنَ اللَّهِ التَّوْفِيقُ لِأَقْوَمِ الطَّرِيقِ)

سُبْحَانَكَ يَا مَنْ أَنْطَقَ السَّمَاءَ بِحَمْدِهِ وَتَسْبِيحِهِ بِكَلِمَاتِ النُّجُومِ
وَالسِّيَّارَاتِ ۚ وَيَا مَنْ أَنْطَقَ الْأَرْضَ بِحَمْدِهِ وَتَسْبِيحِهِ بِكَلِمَاتِ
الْأَشْجَارِ وَالنَّبَاتَاتِ ۚ وَأَنْطَقَ النَّبَاتِ وَالشَّجَرِ
بِكَلِمَاتِ الْأَزْهَارِ وَالثَّمَرَاتِ ۚ وَأَنْطَقَ الزَّهْرَ وَالثَّمَرَ بِكَلِمَاتِ الْبُذُورِ
وَالنَّوَاتَاتِ ۚ

وَأَنْطَقَ النَّوَاةَ وَالْبِذَرَ بِلِسَانِ السَّنَابِلِ وَكَلِمَاتِ لَحَبَّاتِ سُبْحَانَكَ يَا
مَنْ تُسَبِّحُ بِحَمْدِكَ الضِّيَاءَ بِأَنْوَارِهِ ، وَالْهَوَاءَ بِأَعْصَارِهِ ، وَالْمَاءَ
بِأَنْهَارِهِ ، وَالْأَرْضَ بِأَحْجَارِهِ ، وَالنَّبَاتَ بِأَزْهَارِهِ ۚ
وَ الشَّجَرَ بِأَثْمَارِهِ وَالْجَوَّ بِأَطْيَارِهِ وَالسَّحَابَ بِأَمْطَارِهِ وَالسَّمَاءَ
بِأَقْمَارِهِ وَالصَّلَاةَ وَالسَّلَامَ عَلَى سَيِّدِنَا
مُحَمَّدٍ نَبِيِّرِ اسْمِ الْأَنْبِيَاءِ وَزَبْرَقَانَ الْأَصْفِيَاءِ وَنَيْرِ الْأَوْلِيَاءِ وَشَمْسِ
النَّقْلَيْنِ وَضِيَاءِ الْخَافِيَيْنِ ۚ

وَ عَلَى آلِهِ نُجُومِ الْهُدَى وَأَصْحَابِهِ مَصَابِيحِ الدُّجَى ۚ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

I kërkoj Zotit të më ndihmojë për të vazhduar në rrugën time. Lavdi qoftë për Të, i Cili i bën qiejt të flasin me lavdërimin ndaj Tij dhe duke bërë tesbihate me fjalët e planetëve dhe yjeve. O Ti që e bën tokën për të bërë lavdërimet e tesbihate për Ty, me fjalët e pemëve dhe të bimëve; që i bën bimët dhe pemët të flasin me fjalët e luleve dhe të frutave; që i bën lulet dhe frutat të flasin me fjalët e farërave dhe bërthamave; që i bën farërat dhe bërthamat të flasin me fjalët e kokrrave dhe të kallinjve.

Lavdi i qoftë Aij, që për lavdërimin e Tij bëjnë tesbihate drita me të gjitha rrezatimet e saj, dhe ajri me erërat e tij, toka me shkëmbinjtë e saj, bimët me lulet e tyre, pemët me frutat e tyre, atmosfera me zogjtë e saj, retë me shiun e tyre, dhe qielli me hënat e tij.

Paqja dhe bekimet qofshin mbi prijësin tonë, Muhammedin a.s.m, i cili është llampae profetëve, hëna e dijetarëve të pastër, ylli i evlijave, dielli i njerëzve dhe i xhindëve dhe drita e lindjes dhe e perëndimit, dhe mbi familjen e tij, yjet e udhëzimit dhe mbi sahabët e tij, llampat ndriçuese në errësi.

Mësoje, o ti që ke shumë vështirësi për të kuptuar misterin e:

وَجَعَلْنَاهَا رُجُومًا لِلشَّيَاطِينِ

"...Dhe Ne i kemi bërë drita të tilla gjuajtëse për të larguar shejtanët"¹⁰⁸

Me qëllim që të arrish qiellin e këtij vërseti, neve na nevojitet një shkallë me shtatë shkelëza.

○ *Shkelëza e parë*: Qiejt kanë banorë që u përshtaten atyre, që quhen melekë – ëngjëj. Meqënëse, pavarësisht masës së vogël të qënies së saj kur krahasohet me qiellin, toka është mbushur plotë me qenie të gjalla, të vetëdijshme, po ashtu edhe qiejt duke pasur yjësi, ato pallate të zbukuruar gjithashtu duhet të jenë plot me qenie të vetëdijshme të veçanta për to.

Universi është i stolisur me të gjitha ato bukuri, dekore, vizatime e qëndisje që kërkojnë ekzistencën e qënieve për të reflektuar mbi to me vlerësim e habi. Sepse bukuria shfaqet veçse për dashuruesin e saj, ashtu si ushqimi që i jepet të uriturit. Njeriu dhe xhindi, për sa ka të bëjë ose me numrin e tyre, ose me mungesën e kapacitetit të mjaftueshëm të tyre, janë larg prej përmbushjes së këtij funksioni të vëzhgimit dhe reflektimit mbi bukuritë e ekzistencës, me të gjithë madhështinë e saj, e cila kërkon ekzistencën e shumë llojeve të melekëve të panumërt dhe të qënieve të tjera shpirtërore.

○ *Shkelëza e dytë*: Ndodhet një lidhje e ngushtë dhe ndodhen marrëveshje midis tokës dhe qiejve. Për shembull, drita, nxehësia dhe

¹⁰⁸Kur'an, 67:5

bekime të ngjashme të tjera vijnë prej qiejve. Kjo tregon e kërkon se ndodhet një rrugë për njerëzimin për t'u ngjitur në qiej; siç realizohet nga profetët, evlijatë dhe qëniet shpirtërore duke qenë të zhveshur prej peshave të tyre trupore.

○ *Shkelëza e tretë*: Rregulli, paqja dhe qetësia e qiejve tregon se banorët e tyre duhet të mos u ngjasojnë banorëve të tokës, ku ngatërresa, tronditja, lëkundja, polemika, grindja dhe provimi dominojnë për shkak të të kundërtave si të mirët dhe të këqinjët duke ekzistuar të përzier me njëri-tjetrin. Kurse banorët e qiejve janë të bindur dhe bëjnë çfarëdo që urdhërohen.

○ *Shkelëza e katërt*: Mbreti i Ditës së Gjyqit dhe Zoti i të gjitha botërave ka Emra me rregulla të ndryshëm që kërkojnë manifestime të ndryshme. Për shembull, Emri i Cili kërkoj dërgimin e melekëve për të luftuar kundra mosbesimtarëve në rradhët e sahabëve të profetit, gjithashtu kërkon luftën midis melekëve dhe shejtanëve, midis të mirëve të qiejve dhe të këqinjve të tokës. A nuk e sheh se si sillet një mbret, ku dinjiteti dhe madhështia e tij kërkojnë shpërblimin ose dënimin përpara dëshmitarëve të atyre që e meritojnë secilën prej tyre, dhe nderimin e disa prej shërbëtorëve ose zyrtarëve? Në vend të bërjes së kësaj nëpërmjet telefonit të tij të veçantë, ai e urdhëron njërin prej ministrave të tij për t'i tubuar njerëzit në një vend të madh për të shfaqur madhësinë e sundimit të Tij, dhe për të organizuar një paradë madhështore.

○ *Shkelëza e pestë*: Sigurisht, që të këqinjët midis qënieve imitojnë të mirët midis tyre duke u përpjekur të ngjiten në qiej. Banorët e qiejve i konfrontojnë ato dhe i zbrapsin për shkak të të këqijave të tyre. Urtësia e sovranitetit të Hyjnisë kërkon që ky dyluftim qiellor duhet të ketë një shenjë në këtë botë të dukshme materiale, me qëllim që njeriu, njëra prej detyrave kryesore të të cilit është të vrotojë e të vëzhgojë, të mund të informohet për këtë. Rruga më e mirë e sjelljes së këtij dyluftimi para shikimit të njeriut është gjuajtja e yjeve ose e meteorëve prej kështjellave të larta të yjësive. Ndryshe nga të gjitha ngjarjet e tjera kozmike duke pasur shumë shembuj urtësie, nuk ka urtësi më të përshtashme për atë ngjarje të gjuajtjes së yjeve se sa qënia e tyre një shenjë e dyluftimit qiellor midis melekëve dhe shejtanëve, një shembull i njohur e i dëshmuar nga të gjithë njerëzit të cilët e njohin realitetin e gjërave.

○ *Shkelëza e gjashtë*: Kurani i gjithurtë i mrekullueshëm kërkon t'i udhëzojë njerëzit tek e vërteta dhe i ndalon nga kundërshtimi e mosbindja me elokuencën e tij të mrekullueshme, me stile te larta e të qarta dhe me analogji ose krahasime. Për shembull:

يَا مَعْشَرَ الْجِنَّ وَالْإِنْسِ إِنِ اسْتَبَطَعْتُمْ أَنْ تَتَفَادُوا مِنْ آقْطَارِ
السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ فَانْفُذُوا لَا تَنْفُذُونَ إِلَّا بِسُلْطَانٍ

“O grupi i xhindëve dhe i njerëzve! Po patët fuqi për të kaluar përmes hapësirës së qiejve dhe të tokës, atëherë i kaloni! Por ju kurrë nuk do të mund t'i kaloni përveç me fuqi nga Allahu!”¹⁰⁹

Vërseti shpall pafuqinë e njerëzimit dhe të xhindëve përpara gjëresisë dhe madhësisë së Hyjnisë së Tij xh.sh.. Është sikur ai vërset të thonte:

“O njeri i pafuqishëm, i dobët dhe i vogël! Si guxon të kundërshtosh me kryengritje ndaj Një Mbreti të Cilit i binden të gjithë diejt, hënat, yjet dhe melekët, të cilët i gjuajnë djajtë me predha aq të mëdhaja sa malet, madje edhe më të mëdhaja? Si guxon ti të rebelohesh në mbretërinë e Një Mbreti midis ushtarëve të të Cilit ndodhen ata që janë të aftë të gjuajnë përballë armiqve yje me përmasën e tokës tënde me aq lehtësi si të hidhje arra ose kokrra lajthie?”

○ *Shkelëza e shtatë*: Ashtu si melekët dhe peshqit, prej më të madhit të tyre tek më i vogëli, yjet kanë shumë lloje. Çfarëdo që shndërit në qiej quhet yll. Ashtu siç ndodhen midis tyre ato që shndrisin si xhevahire dhe duke stolisur qiejt si frutat që stolisin një kopësht dhe peshqit një det, po ashtu ndodhen të tjerë me të cilët qëllohen për vdekje shejtanët si një shenjë e ekzistencës së rojtarëve vigjilentë, të bindur dhe që nuk pranojnë të përzihen me rebelët, ose si një tregues i ligjit të dyluftimit që dominon në sferën më të gjërë të ekzistencës. Allahut i përkasin prova më elokuate dhe urtësia më vendimtare.

Mësoje, o shok! Ndodhen shumë vërsete kuranore që pohojnë në mënyrë të qartë se gjërat janë shkruar para dhe gjatë ekzistencës së tyre fizike, të tilla si:

¹⁰⁹Kur'an, 55:33

وَلَا رَطْبًا وَلَا يَابِسًا إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ

“Nuk ka asgjë të njomë ose të thatë që të mos jetë e shkruar në një libër të Qartë”¹¹⁰

Kjo konfirmohet nga sistemet dhe përbërjet në librin e universit dhe në ‘vërsetet’ e tij, veçanërisht në ato të rregullit universal, harmonisë, balancës, modelimit, zbukurimit dhe dallueshmërisë.

Midis dëshmimeve që tregojnë se të gjitha gjërat janë shkruar para ardhjes së tyre në ekzistencë janë farërat, masat dhe format. Sepse farërat janë senduqe të vegjël, në të cilat përmbajtet e asaj çfarë ka matur, paracaktuar e caktuar Kaderi Hyjnor janë lënë në amanet tek ato. Fuqia Hyjnore ndërton në përputhje me masën e saktë të Kaderit dhe i punëson grimcat në atë ndërtim. Masat janë kallëpe të saktë paraekzistues në Njohjen Hyjnore. Pavarësisht qënies së tyre të verbëra, shurdhe e të pavetëdijshme, grimcat lëvizin për rritjen e gjërave në masa të sakta, duke mos tejkaluar limitet e përcaktuara për to, sikur të kishin një shikim të mprehtë e dëgjim; ato shkojnë e vendosen pikërisht aty ku duhet për rezultate të mëdhaja si frutat. Ti mund të krahasosh me këtë shumë dëshmi të tjera të regjistrimit të gjërave para se ato të vijnë në ekzistencë. Sa për dëshmitë për shkrimin gjatë ekzistencës së gjërave, të gjitha frutat, të cilat janë si një rul – rotullamë– letrash ku ‘veprat’ e pemëve që janë shkruar, sjellin para shikimit të dëshmuesve atë që origjinat e tyre i kanë përjetuar ndërsa ishin të groposura në tokë dhe shfaqen në pranverë. Gjithashtu, kujtesa e njeriut, me masën e një fare sinapi, është si një dokument të cilin Dora e Fuqisë Hyjnore e ka kopjuar prej bllokut –regjistrimit– të veprave të tij me Penën e Kaderit për t’ia dhënë atij në kohën e llogarisë së fundit, me qëllim që ai vetë të mund të shohë se çfarë bëri kur ishte në botë. Dhe gjithashtu që ai të qetësohet se prapa kësaj përkohshmërie e vdekje dhe brenda këtyre ndryshimeve e turbullirave ndodhen shumë pasqyra që i përkasin përjetësisë, në të cilat i Gjithëfuqishmi dhe i Gjithurti vizaton dhe i bën të përhershme identitetet e qënieve kalimtare. Dhe me të vërtetë, ndodhen shumë pllaka që i përkasin përjetësisë, në të cilat Gjithëruajtësi i Gjithëditur shkruan kuptimet e qënieve të përkohshme.

¹¹⁰Kur’an, 6:59

Mësoje, o shok! Ashtu si ora që nuk është e qëndrueshme, me vegëlat e saja duke u tronditur, dridhur e duke lëvizur, po ashtu dynjaja, e cila është si një orë e madhe, është gjithashtu duke u tronditur e lëvizur. Me futjen e kohës në lëvizjen e saj, nata e dita ngjajnë si një akrep që tregon sekondat, dhe viti duke qenë një akrep tjetër tregon minutat dhe shekulli tregon orët. Me futjen e hapësirës, atmosfera ngjan duke pësuar ndryshime shumë të shpejta dhe transformime, ashtu si akrepi i sekondave të orës, dhe toka, sipërfaqja e të cilës shfaq ndryshime të vazhdueshme të bimëve dhe kafshëve nëpërmjet ciklit të vdekjes dhe të jetës, si akrepi i minutave të orës. Brendësia e tokës gjithashtu shfaq, si akrepi i orës, ndryshime e lëkundje të mëdhaja me daljen e kodrave dhe maleve prej brenda saj. Ashtu si akrepi që tregon e numëron ditët, qiejt bëhen skena më e gjerë e ndryshimeve me lëvizjen e trupave të tyre, me shfaqjen e kometave dhe të meteorëve dhe me lindjen e vdekjen e yjeve.

Dynjaja ose jeta e kësaj bote bazohet mbi këto shtatë shtylla, dita dhe nata, viti dhe shekulli, toka, atmosfera dhe qiejt. Pavarësisht përshkrimit nga ana e saj, Emrat Hyjnorë nëpërmjet qënies një skenë ku ato manifestohen dhe ku Pena e Fuqisë dhe e Kaderit punon vazhdimisht, ajo është në një rrjedhje të vazhdueshme si një lum dhe gjithashtu është kalimtare, e përkohshme dhe që zhduket. Megjithatë, ajo shihet si e qëndrueshme dhe e përgjeshme me syrin e pakujdesisë dhe si e stabilizuar me syrin e fiksuar tek ‘natyra’ dhe me shikimin e natyralizmit, duke u bërë një perde për Ahiretin.

Duke e parë dynjanë ose jetën e kësaj bote për llogari të vetes dhe duke u përqëndruar në anën e saj fizike me qëndrimin e mangët, materialist e shkencor, filozofia e shthurur moderne e bën më të trashë atë perde dhe e paraqet atë si shumë më të qëndrueshme e të përhershme. Ndërsa, Kurani me vërsetet e tij e shprish dhe e gërhanon këtë dynja si pambuk. Dhe nëpërmjet shpjegimeve të tij, ai i jep botës tejdukshmëri; dhe nëpërmjet shprehjeve të tij ndriçuese, ai e shkrin atë dynja të ngrirë; dhe me shprehjet e ashpëra të tij, ai e copëton mashtrimin dhe iluzionin se dynjaja është e përhershme; dhe përmes goditjeve gjëmimtare si rrufeja, ai shpërndan e zhduk pakujdesinë e lindur nga koncepti i ‘Natyres’. Realiteti i dynjasë gjithnjë i lëkundur reciton me gjuhën e gjendjes së saj aktuale vërsetin:

وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Dhe kur të lexohet Kurani, dëgjojeni atë me vëmendje dhe heshtni që të mund të fitoni mëshirë, të mëshiroheni”¹¹¹

Mësoje, o shok! Njëri nga faktorët që e dallon njeriun nga kafshët është se njeriu ka lidhje edhe me të shkuarën, edhe me të ardhmen, dhe ai ka një perceptim të tillë gjithëpërfshirës sa të përfshijë e të rrethojë botërat e tij të brendshme e të jashtme. Ai gjithashtu mund të zbulojë shkaqet e jashtme të ngjarjeve dhe njeh çfarë është e domosdoshme për të arritur një rezultat në jetën e tij. Por, detyra e tij më e madhe dhe më e rëndësishme për përmbushjen e të cilës ai është i pajisur me aftësi shumë të rëndësishme është bërja e tesbihateve – që ai të lëvdojë e lavdërojë Allahun xh.sh.. Në të vërtetë, njeriu e lëvdon Autorin e tij me gjuhët e të shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes dhe me gjuhët e botës së tij të brendshme e të jashtme. Ashtu siç ai dëshmon tesbihatet e krijesave të tjera, ai e lëvdon Autorin e gjërave nëpërmjet dallimit të Emrave të manifestuar mbi krijimin e gjërave dhe për qëllimet për jetën e tyre.

Kështu, **سُبْحَانَ اللَّهِ** “*Subhanallah*” përmban kuptimin e habitës dhe të vlerësimit dhe kuptimin e adhurimit dhe dashurisë, Shenjtëria dhe Qënia e të Cilit i përjashtuar larg çdo mangësie e defekti shpallen, dhe madhështia e të Cilit është përtej perceptimit.

Mësoje, o shok! Zoti paracakton e dekreton, i ekzekuton dekretet e Tij dhe fal. Dekreti i Tij i dorëzohet, thyhet para faljes ashtu si shkëmbi i fortë dhe toka që u dorëzohen e copëtohen para rrënjëve të holla si penjëza, dhe ashtu si rezisztencia e hekurit që thyhet përballë ujit të ngrirë. Sepse, ndonjëherë ndodh që ligji i Kaderit pengohet prej promulgimit nga Dekreti i Tij; ligji i Kaderit thyhet para shigjetës së vendimit; ashtu si një ligj universal i cili është kaderi i një specie ose i një grupi që nuk shpallet për një anëtar të veçantë të asaj specie, për shembull një fëmijë i pafuqishëm i vogël, bebe gjendet duke i mbijetuar një katastrofe të madhe e cila ka shkaktuar vdekje të shumta dhe një shkatërrim të madh. Kjo është për të treguar faktin se Zoti xh.sh është absolutisht me zgjedhje të lirë në aktet e Tij, dhe Ai bën çfarëdo që Ai dëshiron. Ajo çfarë Ai jep nuk mund të pengohet dhe dekreti i Tij nuk mund të zbrapset. Lidhja e faljes me ekzekutimin e dekreteve është si lidhja e dekretit me Kaderin. Domethënë, falje –dhënie– do të thotë

¹¹¹Kur’an, 7:204

bërja e të jashtëzakonshmes ose të përjashtuarës prej ligjit të dekretit, dhe dekreti ndonjëherë përjashtohet prej ligjeve të Kaderit. Ai që është i mirinformuar për akte të tilla të Zotit nuk mund t'i shmanget veçse të thotë:

يَا إِلَهِي إِنَّ حَسَنَاتِي مِنْ عَطَائِكَ وَسَيِّئَاتِي مِنْ
قَضَائِكَ لَوْلَا عَطَاؤُكَ لَكُنْتُ مِنَ الْهَالِكِينَ

“O Zot! Veprat e mia të mira janë nga dhënia –falja– Jote dhe unë e di se dekreti, vendimi Yt përfundimisht do të vijë. Dhe po të mos ishte falja Jote, unë sigurisht do të isha prej atyre që do të shkatërrohen”. Për shkak të dhënies pas të këqijave, nefsi urdhërues për të liga meriton të shkatërrohet.

Mësoje, o shok! Arsyeja për shumë vërsete kuranore duke mbaruar me Emrat Hyjnorë është se Kurani i gjithurtë i sjell veprat Hyjnore para shikimit të lexuesit me shprehjet e tij të mrekullueshme dhe pastaj konkludon me Emrat Hyjnorë të cilët janë origjinat e atyre veprave, si në vërsetin:

وَهُوَ الَّذِي بَدَأَ الْخَلْقَ ثُمَّ يُعِيدُهُ وَهُوَ أَهْوَنُ عَلَيْهِ
وَلَهُ الْمَثَلُ الْأَعْلَى السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ

“Është Ai i Cili e fillon krijimin, pastaj do ta përsërisë atë dhe kjo është shumë e lehtë për Të. Atij i takon përsëkrimi më i lartë në qiej e në tokë. Dhe Ai është i Plotëfuqishmi, i Gjithurti”¹¹²

Kurani gjithashtu zbulon thurjet e Artit të Tij para syve të njerëzimit dhe pastaj i mbështjell ato me Emrat Hyjnorë.

Përsëri, ai përmend krijesat dhe shfaq nëpërmjet tyre rregullin, balancën dhe favorizimin dhe pastaj jep Emrat Hyjnorë sikur krijesat e përmendura të ishin ‘fjalët’ e atyre Emrave, të cilët janë kuptimet e përfshira në to ose uji i jetës duke i gjallëruar ato, ose farërat prej të cilave ato rriten, ose përmbledhjet e ngjeshura që përmbajnë informacionin e dhënë në to.

¹¹²Kur’an, 30:27

Përsëri, ai i përmend gjërat e pjesshme materiale të ndryshueshme të disa cilësive dhe pastaj i përmbledh ato me Emrat Hyjnorë me manifestimet universale.

Përsëri, ai shfaq gjërat që rriten me bollëk dhe gjenden në shumë vende dhe pastaj vendos mbi to stampën e unitetit, duke tërhequr vëmendjen drejt pikave të përgjithshme të ndara nga ato.

Përsëri, ai manifeston pasojat e mëdhaja gjithëpërfshirëse ose rezultatet bashkë me shkaqet e jashtme, me qëllim që të shfaqë distancën e madhe midis atyre që shihen si shkaqe dhe rezultatet e tyre, dhe se shkaqet nuk mund të jenë pa origjinë reale të rezultateve, ashtu siç ndodhet një distancë e madhe midis horizontit dhe qiellit, ndonëse ato duken si të bashkëngjitur ose madje kanë prekur njëri-tjetrin. Sepse, madje edhe më të mëdhajat e shkaqeve janë të paaftha për të prodhuar edhe më të vogëlën e pasojave. Kurani mbush gropën e madhe midis shkaqeve dhe pasojave me Emrat Hyjnorë përkatës.

Përsëri, ai përmend veprat e këqija të krijesave dhe i kërcënon ato dhe pastaj i ngushëllon duke përmendur Emrat Hyjnorë që përmbajnë mëshirë. Ai gjithashtu përmend disa qëllime të veçanta dhe pastaj i vërteton ato me Emrat të Cilët përmbajnë ligje universale duke i siguruar ato qëllime.

Mësoje, o shok! Në të vërtetë, ashtu si dashuria, edhe pafuqia gjithashtu është një rrugë që të çon tek Zoti xh.sh, madje është më e drejtëpërdrejtë dhe më e sigurtë se sa rruga e dashurisë. Ata që janë futur në tarikate të cilët kërkojnë të arrijnë tek Allahu nëpërmjet recitimit, dhikrit të heshtur, preferojnë t'i pastrojnë aftësitë e tyre të holla, të tilla si zemra, shpirti dhe aftësitë e tjera, dhe të tjerët të cilët kërkojnë të arrijnë tek Allahu nëpërmjet recitimit të dhikrit me zë të lartë zgjedhin t'i pastrojnë vetet e tyre me shtatë llojet ose nivelet të tillë si nefsi urdhërues për të liga dhe nefset e tjerë. Sa për këtë të pafuqishëm, ai e ka përfutuar prej Kuranit një rrugë të shkurtër, më të drejtëpërdrejtë dhe të rrafshët me katër hapa.

Hapi i parë është ai që tregohet nga vërseti:

فَلَا تُزَكُّوا أَنْفُسَكُمْ *“Prandaj, mos e shfajësoni neftsin tuaj”*¹¹³

Hapi i dytë është ai i treguar nga vërseti:

وَلَا تَكُونُوا كَالَّذِينَ نَسُوا اللَّهَ فَأَنْسَاهُمْ أَنْفُسَهُمْ *“Dhe mos jini si ata që harruan Allahun, dhe Ai atëherë i bëri ata ta harrojnë vetveten”*¹¹⁴

Hapi i tretë është ai që tregohet nga vërseti:

مَا أَصَابَكَ مِنْ حَسَنَةٍ فَمِنَ اللَّهِ وَمَا أَصَابَكَ مِنْ سَيِّئَةٍ فَمِنْ نَفْسِكَ

*“Çfarëdo e mirë që të vjen është prej Allahut, kurse çfarëdo e keqe që të bie, ajo është nga nefsi yt”*¹¹⁵

Hapi i katërt është ai që tregohet nga vërseti:

كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ *“Çdo gjë do të shuhet e shkatërrohet përveç Fytyrës së Tij”*¹¹⁶

Në hapin e parë, njeriu e do vetveten për llogari të vetes duke e kufizuar të gjithë dashurinë për veten e tij. Ai e lavdëron vetveten në një mënyrë e cila i përshtatet veçse të Adhuruarit të Vetëm; ai e mbron vetveten fuqishëm dhe e mban vetveten duke e shfajësuar prej të gjitha të metave, duke mos parë asnjë mangësi në veten e tij. Ashtu si dikush që i ka marrë dëshirat e tij si zotin e tij, ai i përdor aftësitë që i janë lënë si amanet për të bërë tesbihate për Allahun, të Adhuruarin e Vërtetë, i përdor ato aftësi për të lavdëruar veten. Prandaj, pastrimi i tij në këtë hap është mospastrimi i neftsit.

Në hapin e dytë, nefsi kërkon ta harrojë vetveten kur vjen tek shërbimi, tek puna dhe tek detyrimi ndaj të tjerëve, por kur vjen tek marrja e shpërblimit të tij, tek përfitimet, tek kënaqësitë, ai mendon për vetveten. Prandaj, pastrimi dhe edukimi i tij në këtë hap është e kundërta e kësaj gjendje. Domethënë, mos’harresa brenda vetë harresës.

¹¹³Kur’an, 53:32

¹¹⁴Kur’an, 59:19

¹¹⁵Kur’an, 4:79

¹¹⁶Kur’an, 28:88

Në hapin e tretë, njeriu duhet të shohë vetë gabimet, mangësitë, pafuqinë dhe varfërinë në vetveten dhe të kuptojë se të gjitha cilësitë e tij të mira dhe plotësitë janë mirësi që i janë dhuruar nga Krijuesi i Gjithëlavdishëm. Kështu, ai jep falënderime në vend të krenarisë dhe lavdëron Zotin në vend të vetëmburrjes. Pastrimi i tij në këtë hap është të njohësh se plotësimi i nefsit qëndron në pafuqi (para Zotit), dhe pasuria e tij qëndron në varfëri.

*Në hapin e katërt, njeriu duhet të kuptojë se për sa ka të bëjë me veten e tij, ai është esencialisht mosekzistent, i mundshëm, kalimtar dhe i përkohshëm, por vetëm për llogari të qënies një pasqyrë duke reflektuar Emrat e Autorit të tij, ai është dëshmuar dhe i dëshmuar, jep ekzistencë dhe është ekzistues. Kështu, pastrimi dhe dëlirësimi tek ky hap është njohja se mosekzistenca është në ekzistencë dhe ekzistenca është në mosekzistencë, dhe viridi i saj është **لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ** *Lehul Mulku ve Lehul Hamdu, i Tij është sundimi dhe Atij i përket lavdërimi.**

Ata që ndjekin rrugën e unitetit të ekzistencës (vahdet al vuxhud) e shikojnë universin si mosekzistues. Dhe ata që ndjekin unitetin e dëshmisë (vahdat al shuhud) e përkufizojnë të gjithë ekzistencën brenda burgut të harresës absolute. Ndërsa, çfarë unë kam kuptuar prej metodës së Kuranit është se Kurani nuk kërkon as mohim dhe as injorim të ekzistencës aktuale të universit dhe i punëson të gjitha gjërat në detyrën e shfaqjes së Emrave Hyjnorë si pasqyra duke i reflektuar ato. Ai e konsideron të gjithë ekzistencën për hir të të Gjithëfuqishmit xh.sh dhe jo për hir të vetvetes.

Në qënien e njeriut ndodhen sfera të ndryshme ekzistence njëra brenda tjetrës dhe nivele të krijimit njëri brenda tjetrit. Sepse njeriu është edhe një bimë, edhe një kafshë, edhe një qenie njerëzore edhe një besimtar. Domethënë, qënia e tij ka dimensione vegjetale, shtazore dhe humane, dhe në qoftë se ai është një besimtar, një besimtar.

Procesi i pastrimit fillon në nivelin e katërt, nivelin e besimit dhe vazhdon duke zbritur tek niveli vegjetal ku shfaqet rezistenca më e ashpër. Trajtimi vazhdon ditë e natë pa ndërprerë. Gjatë trajtimit, njeriu mund të bëjë gabime nga ngatërrimi i niveleve dhe thotë: “Çfarëdo që është krijuar në tokë është krijuar për mua”. Ai gabon duke menduar se humanizmi është kufizuar tek të qëniti vegjetal ose shtazor; ai gjithashtu gabon duke i konsideruar qëllimet për jetët e gjërave të kufizohen tek

dobitë e tyre për veten e tij dhe duke i parë ato si aq të vlefshme vetëm kur janë të dobishme për veten e tij, dhe si rrjedhojë ai nuk e shkëmben një lule erëmirë për Venusin – Afërditën.

Mësoje, o shok! Adhurimi është rezultati dhe çmimi i mirësive që i janë dhënë njeriut. Ai nuk është mjeti i së ardhmes, i shpërblimit të pritur.

O njeri! Ti tashmë e ke marrë rrogën tënde, sepse Ai të ka krijuar ty në formën më të mirë dhe si një model i të gjithë ekzistencës dhe e ka bërë Vetën e Tij të njohur për ty nëpërmjet dhënies së imanit – besimit.

Përsëri, duke të dhënë një stomak, Ai të ka dhënë substanca të pallogaritshme ushqimi dhe gjithashtu të ka dhuruar ty jetën në sajë të të cilës kjo botë e dukshme materiale është bërë për ty një tryezë e mbushur plot me mirësi. Duke të dhënë ty nefsën njerëzor, Ai i ka bërë botërat e dukshme dhe të padukshme sikur të ishin një tryezë e mbushur rrafsh me mirësi. Për më tepër, duke të dhënë iman, përveç tryezave të përmendura, Ai të ka dhënë ty lloje të tjera tryezash të depozituara në thesaret e Emrave të Tij. Gjithashtu, duke të dhënë ty dashurinë e Tij, Ai ka hapur për ty dhe të ka dhuruar lloje të tjera të mirësive dhe bekimeve të papërshtueshme. Meqenëse ti tashmë i ke marrë mirësitë dhe bekimet të tilla si ato të përmendura, atëherë është obligim për ty që t'i shërbesh Atij. Çfarë Ai të jep pas shërbimeve të tua është shtesë dhe thjesht nga mirëbërësia e Tij.

Mësoje, o shok! Shumimi i pafundmë i anëtarëve të specieve, veçanërisht i atyre prej krijesave të vogëla, pa mangësinë më të vogël në strukturën e tyre dhe me rregullësi të plotë, tregon, madje shfaq qartë, se nuk ka limite për manifestimet e Autorit dhe se Ai është absolutisht i Ndryshëm prej të gjitha atyre, dhe të gjitha gjërat janë të njëjta në lidhje me fuqinë e Tij dhe me ekzistencën e Tij të domosdoshme.

Ky bollëk dhe kjo krijueshmëri janë rezultati i Ekzistencës së Tij të domosdoshme dhe janë dëshmi për Të. Bollëku në speciet i përket madhësisë së Tij, ndërsa krijimi i qëndrueshëm dhe i padefekt i anëtarëve i përket bukurisë së Tij.

Mësoje, o shok! Bërja e diçkaje është aq e lehtë për autorin – njeriun– aq sa shtrirja e njohjes së tij për atë gjë dhe është aq e vështirë

për të aq sa shtrirja e injorancës së tij për të. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur ka të bëjë me gjërat e vogëla me shumë pjesë të holla e delikate. Sa më i informuar të jetë ai për to, aq më të lehta janë ato për të. Lehtësia absolute dhe shpejtësia të vëzhguara në krijimin e gjërave dhe krijimi i tyre në shumësi e bollëk absolut dhe pa defektin më të vogël demonstroi në mënyrë vendimtare se Autori i tyre ka njohje absolute. Vërseti “*Urdhëri Ynë është veçse një (fjalë) sa hap e mbyll sytë*”¹¹⁷ tregon për atë lehtësi.

Mësoje, o shok! Ai që bën një vepër arti të qëndisur me delikatesë dhe e mbulon atë me ‘mantel’ si derma dhe epiderma, lëkura e mbilëkura, të thurura me shumë delikatesë prej të njëjtës substancë të veprës së artit, me prerje të holla dhe duke vendosur instrumente të ndryshëm, të gjithë duke punuar në lidhje të ngushtë me njëri-tjetrin, pa dyshim se ajo vepër arti me anët e brendshme dhe të jashtme të saj, është vepra e një qenieje të vetme dhe që i përket vetëm Atij ekskluzivisht.

E ngjashme me këtë, i Vetmi i Cili krijon specie të panumërta qëniesh prej një shumëllojshmërie të pafundme të qëndisura me shumë delikatesë prej pothuajse të njëjta gjërave të thjeshta dhe i vesh ato me mantele të thurur prej elementeve në përputhje me masën dhe strukturën e secilës, Ai i Vetëm i Cili i përfshin ato krijesa, veçanërisht kafshët që janë miniaturat e botërave, në barqet e atyre botërave të ndërtuara njëra brenda tjetrës për shtëpinë e krijësave që janë frutet ose farërat e tyre, Një i Tillë është veçse i Kërkuari përjetësisht, duke e manifestuar Vetveten me të gjithë Emrat e Tij mbi secilën prej atyre krijësave në mënyrë të veçantë dhe mbi botërat si një tërësi.

Mësoje, o shok! Ashtu si një mbret që ka tituj të ndryshëm për të vendosur autoritetin e tij në departamentet e qeverisë së tij dhe në zyrat e shtetit të tij dhe midis nënshtetasve të tij, dhe për të treguar mbretërimet sikur ai të ishte prezent personalisht dhe duke ushtruar kontroll në të gjitha ato departamente dhe zyra, po kështu –dhe për Zotin është krahasimi më i lartë– i Vetmi Unik me të gjithë Emrat e Tij të bukur e manifeston Vetveten në departamentet e Sovranitetit të Tij me njërin Emër duke qenë dominues në një departament dhe me të tjerët të varur. Ai e vendos autoritetin e Hyjnisë së Tij në çdo nivel të

¹¹⁷Kur’an, 54:50

Sundimit të Tij nëpërmjet manifestimit të njërit prej Emrave të Tij të veçantë për atë nivel. Sikur ai Emër të ishte i veçantë vetëm për atë nivel. Në nivelet e Hyjnisë –Perëndisë– i Gjithëlavdishmi ka sundime esenciale që i korrespondojnë njëri–tjetrit; në sferat e Hyjnisë së Tij, Ai ka Emra duke reflektuar njëri–tjetrin; në pasqyrat e madhështisë së Tij, Ai ka përfaqësime të ndryshme; në operimet e fuqisë së Tij, Ai ka tituj të ndryshëm; në manifestimet e Atributeve të Tij, Ai ka mënyra të lulëzuara të shfaqjes së Vetvetes; në ndarjen e krijesave në specie Ai ka manifestimet e Qënies së Tij Perëndi të specifikuar për çdo krijesë të rrethuar prej manifestimeve mbi speciet si një tërësi. Profeti Muhammed a.s.m, interpretuesi i gjuhës së përjetshme –Kuranit– tregon për këtë realitet në lutjen e tij të quajtur El Xheushan El kebir (Parzmorja e madhe). Kjo lutje ka 99 pjesë si arka xhevahresh, secila prej tyre përmban dymbëdhjetë xhevahire të Unitetit Hyjnor. Kur i Gjithëfuqishmi i Vetëm thirret nga njëri prej tyre, Emri ose Atributi specifikohet për Të ekskluzivisht. Për shembull, kur ne thërrasim “*Ja Da’imu*”, *O i Përjetshëm*, ne duam të themi: “O i Vetëm Një, që përveç Teje nuk ka asgjë të përjetshme në ekzistencë!”

Ashtu siç rrëfehët nga profeti a.s.m, i Gjithëlavdishmi i Vetëm ka aq shumë deri në shtatëdhjetë mijë perde drite. Sepse, një ekzistencë duke depërtuar tek të gjitha nivelet, dispozitat esenciale të të Cilit i korrespondojnë njëra–tjetrës, Emrat e të Cilit reflektojnë njëri–tjetrin, përfaqësimet dhe titujt e të Cilit janë njëri brenda tjetrit, mënyrat e të Cilit për shfaqjen e Vetvetes i ngjasojnë njëra–tjetrës, mënyrat e të Cilit për bërjen e Vetvetes të njohur mbështesin njëra–tjetrën, manifestimet e Hyjnisë së të Cilit vërtetojnë njëri–tjetrin, dhe manifestimet e Emrave të të Cilit të përqëndruar mbi një gjë rrethohen nga manifestimet e tyre mbi një grup gjërash si një tërësi, sigurisht është e domosdoshme dhe e pashmangshme për atë i cili e njeh Atë Ekzistues, Subhanehu, lavdi i qoftë Atij, nëpërmjet njërit, ose prej atyre Emrave ose Atributeve, ose mënyrave të manifestimeve të përmendura se ai nuk mundet veçse ta njohë Atë edhe nga të tjerët gjithashtu.

وَمَا أَمْرُنَا إِلَّا وَاحِدَةٌ كَلَمْحٍ بِالْبَصَرِ

“Vërtet që Ne e krijuam njeriun në modelin më të mirë”¹¹⁸

¹¹⁸Kur’an, 95:4

Mësoje, o shok! Është një veçori e gjithëpërfshirjes së natyrës themelore të njeriut që Krijuesi i Gjithurtë ka përfshirë në atë objekt të vogël metra të panumërta për të matur çfarë është vendosur pafundësisht në mëshirën e Tij dhe e ka pajisur atë me aftësi të panumërta me qëllim që ai të kuptojë çfarë përfshihet në numrin e pafundmë në thesaret e Emrave të tij më të Bukur.

Vështroji dhjetë shqisat e tua dhe shiko se si nëpërmjet tyre ti bëhesh i vetëdijshëm për botërat e gjërave të shikuara, të dëgjuara, të shijuara etj, me të gjitha shumëllojshmëritë e tyre. Gjithashtu, Ai i ka dhënë njeriut attribute tepër të kufizuara ose fuqinë e zgjedhjes, njohjen dhe të dëgjuarit, me qëllim që ai të kuptojë Atributet Gjithëpërfshirëse të Tij dhe Cilësitë e Tij esenciale. Ai gjithashtu i ka thurur egos së tij aq shumë penjëza (duke iu referuar ndjenjave, dëshirave, aftësive dhe shqisave të njeriut), aq sa botërat me të gjitha shumëllojshmëritë e tyre, nëpërmjet të cilave për të njohur natyrën e vet. Përsëri, Ai i ka veshur shtatit të natyrës së tij aq shumë këmisha –mantele– sa numri i perdeve të Hyjnisë –Rububijjeh– me qëllim që ai të mund t’i grisë ato dhe të realizojë progresin mendor e shpirtëror. Përsëri, Ai e ka pajisur atë me një aftësi aq të çuditshme, sa që ajo udhëton pa ndalim në memorie, me përmasën e një fare sinapi, sikur ajo të ishte një botë pafundësisht e gjërë dhe nuk mund të arrihen kufijtë e saj. Për më tepër, ajo botë e gjërë ndonjëherë bëhet aq e ngushtë për atë aftësi, sa që aftësia e rrethon atë, por është vetë bashkë me të gjitha sferat përmes të cilave ajo udhëton dhe librave që ajo i ka studiuar, është e rrethuar prej asaj fare sinapi – kujtese. Lavdi Zotit, i Cili e bën atë gjë kaq të vogël, pavarësisht gjërësisë së saj të pafundme.

Për shkak të kësaj natyre të çuditshme të njeriut, ndodhen ndryshime e diferenca tejet të mëdhaja midis njerëzve. Midis tyre është dikush që është humbur në një grimcë dhe një tjetër në të cilin dynjaja është humbur. Gjithashtu, njeriu hap me njërin prej çelësave që i janë dhënë, një botë të gjërë prej botërave të shumësisë dhe humbet atje duke u çudhëzuar. Ai nuk mund ta arrijë unitetin dhe besimin Hyjnor përveç se me vështirësi të mëdhaja. Njerëzit gjithashtu ndryshojnë shumë në ndjekjen e një rruge në udhëtimin e tyre shpirtëror. Disa përparojnë shumë lehtë dhe arrijnë paqen dhe unitetin, ndërsa të tjerët mposhten nga iluzionet dhe pakujdesia dhe humbasin plotësisht në shumësinë (e gjërave), e harrojnë unitetin.

Ata që e quajnë vetveten si të civilizuar, të cilët e supozojnë shthurjen dhe prapavajtjen të jenë progres, dhe injorancën e përbërë të jetë njohje e sigurtë, dhe fazën më të thellë të gjumit të jetë zgjim i plotë, janë midis atij grupi të dytë të cilët kanë rënë në më të ulëtën e ultësisë.

Mësoje, o shok! Manifestimi i Njësisë Hyjnore (Vahidiya), manifestimi i Emrit mbi një tërësi, tregon se Emri Hyjnor i manifestuar i përfshin e i rrethon të gjitha gjërat. Ndërsa, manifestimi i Unitetit Hyjnor (Ahadijjah), manifestimi i shumë Emrave mbi një gjë të veçantë, shfaq se një krijesë e gjallë i tregon të gjitha Emrat që lidhen me krijimin.

Mësoje, o shok! Grupet, tërësitë dhe speciet janë objektet e manifestimit të madhësisë Hyjnore dhe shumësia absolute në specie është për shkak të atij manifestimi; ndërsa, shumica e ‘pasqyrave’ ku bukuria manifestohet janë pjesët individuale të anëtarëve të atyre grupeve e specieve. Bukuria e individëve, rrezatimi i ‘pasqyrave’, qëndrueshmëria në strukturë e rregull janë për shkak të manifestimit të bukurisë.

Përsëri, Madhështia buron prej manifestimit të Njësisë Hyjnore dhe Bukuria vjen nga manifestimi i Unitetit Hyjnor. Por, gjithashtu mund të ndodhë që Bukuria të burojë nga Madhështia dhe Madhështia të burojë nga Bukuria. Sa e bukur është Madhështia në syrin e bukurisë dhe sa e bukur është Bukuria në syrin e madhësisë!

Mësoje, o shok! Ndërsa krijesat e stolisura shihen me fuqinë e shikimit, paaftësia e fuqisë së intuitës për të parë Krijuesin është ose për shkak të verbërisë së intuitës, ose pamjaftueshmërisë së saj për ta perceptuar e kapur rëndësinë e çështjes, ose për shkak të qënies së saj pa udhëzimin e domosdoshëm. Mohimi i Krijuesit ndryshe do të ishte më qesharak se sa mohimi i fuqisë së të shikuarit.

Mësoje, o shok! Farërat e mbjella në një fushë e bëjnë atë fushë të mbrojtur prej tij i cili e ka mbjellë atë dhe e pengon fushën prej ndërhyrjes së administrimit të të tjerëve. Farërat kështu funksionojnë si një lloj muri i padukshëm i ndërtuar përreth fushës. Në të njëjtën mënyrë, çdo specie midis specieve të bimëve dhe kafshëve është si një fushë e mbjellë dhe e gjendur në shumë pjesë të tokës. Ajo mohon çdokënd tjetër përveç Atij i Cili e ka mbjellë që të veprojë a ndërhyjë

në të. Të gjitha ato së bashku dhe me anëtarët e tyre individual përbëjnë një mur kaq të fortë saqë ato nuk i lejojnë kurrë të tjerët që të veprojnë e të ndërhyjnë tek ato.

Mësoje, o shok! Disa që do të donin të shihnin dhe shfaqnin bukurinë e pashoqe dhe shkëlqimin e kopshteve të tyre si parajsa (sipas parimit se gjërat njihen më mirë nëpërmjet të kundërtave të tyre), vendosin shkëmbinj të paformë, statuja të kërrusura, të shtrembëra dhe gjëra të tjera të ngjashme mbi to mbarë e prapë dhe hapin ca shpella këtu e atje nëpër to. Rregulli dhe harmonia e atyre kopshteve duket të qëndrojnë në qënien e tyre të çrregullt. Por, ai i cili i vështron dhe i dallon ato kopshte me kujdes konkludon se rregulli i këtyre është në dukjen e tyre të çrregullt dhe se kjo është bërë me paramendimin e një Rregulluesi të Gjithurtë, domethënë, çrregullimi i jashtëm i shfaq ato të jenë aq të bukur e të rregullt. E ngjashme me këtë, midis krijesave dhe gjërave të mirërregulluara dhe të mirëbalancuara në kopshtin e tokës, ndodhen shkretëtira, kodra e shkëmbinj të përmasave dhe formave të ndryshme të shpërndara në një mënyrë që dikush me një shikim sipërfaqësor mund të supozojë se dora e rastësisë i ka bërë ato lodra – kukulla. Por, ato janë elementet e shtruara prej Autorit të Gjithurtë, Krijuesit të Gjithëditur në mënyrë të paramenduar me qëllim që të kontribuojnë për rregullin e përgjithshëm dhe për harmoninë e ekzistencës. Shikoji pemët me gjemba dhe bimët e pajisura me gjemba, ferra, duke e mbrojtur vetveten kundra kafshëve barngrënëse. Ti i sheh ato si një rregullsi të mahnitshme dhe me një bukuri të hollë. Njëra prej shenjave e cila shfaq se Autori i Gjithurtë ka një qëllim të veçantë për atë mungesë të jashtme të rregullit, është se ato gjëra që në dukje janë jashtë rregullit të përgjithshëm të specieve të tyre janë secila prej një mase e një forme të ndryshme. Ndryshimi tregon qëllim dhe hedh poshtë rastësinë.

Mësoje, o shok! Në sajë të natyrës gjithëpërfshirëse të njeriut dhe njeriut prej faktorëve që e dallon atë prej kafshëve, është se ai mund t'i kuptojë përshëndetjet e qënieve të gjalla duke ia dhënë Dhuruesit të jetës. Domethënë, ashtu siç e percepton ai fjalën e nefsit të tij të brendshëm, po ashtu ai percepton me veshin e besimit të gjitha fjalët e qënieve të gjalla, madje edhe të atyre të pajeta, duke bërë tesbihate për Zotin. Ashtu si një shurdh që mund të flasë vetëm përbrenda ose t'i flasë vetëm vetes së tij, po ashtu, secila nga ato qënie mund të kapë foljen e brendshme të vetes së vet. Kurse, njeriu është i aftë edhe të

flasë, edhe t'i kapë të gjithë tingujt e prodhuar nga të gjitha krijesat, të gjitha në të njëjtën kohë si shenja të Emrave të Bukur Hyjnorë. Vlera e çdo qenie tjetër kufizohet tek vetvetja, ndërsa një njeri besimtar është aq i vlefshëm sa totali i qënieve. Megjithëse, një individ, ai është si një specie, madje si të gjitha speciet. Allahu e di të vërtetën.

Mësoje, o shok! Megjithëse e vërteta e diçkaje përbëhet ose kufizohet tek aspekti i saj i jashtëm, ndodhet një distancë e madhe midis tyre. Për shembull, besimi i një njeriu të zakonshëm në Unitetin e Zotit është se ai nuk ia atribuon gjërat askujt tjetër përveç të Gjithëfuqishmit. Ky është një mohim i thjeshtë i atribueshmërisë së të gjitha gjërave ndonjë qenieje tjetër përveç Zotit. Kurse, besimi i atyre që e kanë arritur të vërtetën e asaj çfarë do të thotë Unitet Hyjnor është se çfarëdo që shohin e përfshijnë, ata ia atribuojnë të Gjithëlavdishmit të Vetëm. Ata shohin mbi çdo gjë stampën e Tij dhe vërejnë vulën e Tij. Një njohje e tillë u jep paqë mendjes dhe zemrës dhe i pengon ato nga pakujdesia.

Mësoje, o shok! Urtësia në dhënien afat nga ana e Zotit mosbesimtarëve të cilët synojnë vetëm të jetojnë jetën e kësaj bote është se, ndonëse në mënyrë të pavetëdijshme, ata u shërbejnë mirësive dhe bekimeve të ndryshme të dukshme me punën dhe mjeshtëritë e tyre, dhe bëjnë rregullime, ndonëse pa e ditur, për të shfaqur zbukurimet dhe shkëlqimet e veprave të artit Hyjnor, duke ua ofruar ato shikimeve të njerëzve. Mosbesimtarët e bëjnë atë pa vetëdije ashtu si një orë që të tregon ty kohën duke mos e ditur se çfarë po bën.

Mësoje, o shok! A do të ishte e mundur për dikë të suksesshëm të vazhdojë nga e jashtëmja për tek Hakikati, e vërteta, pa kaluar përmes Berzahut, botës së ndërmjetme, të tarikatit. Gjithashtu, unë kam parë një rrugë tjetër që të çon tek njohuritë e synuara pa kaluar përmes studimit të shkencave instrumentale, të tilla si logjika, matematika, metodologjia etj. Është ajo çfarë pritet prej mëshirës Hyjnore gjithëpërfshirëse që Ajo t'iu dhurojë fëmijëve të kohës së tanishme, kohë duke vërsuar shumë shpejt, një rrugë kaq të shkurtër e të sigurtë.

Mësoje, o shok! Ashtu si ekzistenca e një gjëje dhe jeta e saj që është një provë vendimtare për ekzistencën e domosdoshme të Krijuesit të saj dhe për Atributet e Tij, dhe një shenjë e ndritshme se Krijuesi është Një, të Cilit të gjitha gjërat i përkasin dhe se Ai i mban të gjitha shkaqet (materiale ose natyrale) në Dorën e Tij, po ashtu zhdukja dhe

vdekja e saj për t'u zëvendësuar dhe ngjashmëritë e saj është një dëshmi e qartë për Qëndrueshmërinë e Filluesit, Rikthyesit, Trashëguesit për të gjithë dhe Rigjallëruesit, dhe gjithashtu shfaq se Ai nuk ka ortakë, domethënë asgjë tjetër nuk ka pjesë në krijim, dhe se Ai gjithashtu dominon nefset e brendshme të gjërave, duke i penguar ato prej kontrollit të vetvetëve të tyre të brendshme.

Mësoje, o shok! Jeta thotë: Nuk ka zot tjetër përveç Atij dhe i mohon shkaqet që të kenë ndonjë pjesë në të. Ndërsa, vdekja thotë: Nuk ka zot tjetër përveç Atij, duke mos pasë absolutisht asnjë ortakë dhe mohon nefset e brendshme të gjërave duke mos pasë asnjë pjesë në të.

Mësoje, o shok! Kurani dhe ai të cilit iu shpall Kurani na informojnë neve për disa çështje të mëdhaja dhe për disa të vërteta të mëdhaja të vërtetuara. Gjithashtu, ato vendosin themele shumë të mëdhaja. Për shembull, ata provojnë e vërtetojnë Njësinë e të Vetmit:

مَنْ يُطَوِّبُ بِالسَّمَاءِ كَطَبِّ السَّجْلِ لِلْكَتُبِ ۖ وَالسَّمَوَاتِ مَطْوِيَّاتٍ بِيَمِّ يَمِينِهِ ۖ

وَالْأَرْضِ ضَجْمِيْعًا قَبْضَتْهُيَوْمَ الْقِيَامَةِ ۖ وَمَا أَمْرُ السَّاعَةِ إِلَّا كَلَمْحِ الْبَصَرِ

هَمْ، نُسَبِّحُ لَهُ السَّمَوَاتِ السَّبْعِ وَالْأَرْضِ وَمَنْ فِيهِنَّ

هَمْ، خَلَقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ فِي سِتَّةِ أَيَّامٍ

"Ai do t'i mbështjellë qiejt si letër e shkruar (e mbështjellë tub për shkrim)"¹¹⁹

"...Dhe Ditën e Kijametit gjithë toka do të jetë mbështjellë në Dorën e Tij të Djathtë"¹²⁰

Në lidhje me Të:

"...Çështja e Orës (çastit të fundit) është sa një hap e mbyll sytë"¹²¹

¹¹⁹Kur'an, 21:104

¹²⁰Kur'an, 39:67

¹²¹Kur'an, 16:77

“E lavdërojnë dhe e ngrenë në lavdi e madhështi Atë shtatë qiejt dhe toka dhe gjithë ç’është në to...”¹²²

“Ai i Cili i krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë”¹²³

وَيُحْيِي الْأَرْضَ بَعْدَ مَوْتِهَا “Dhe Ai e ringjall tokën pas vdekjes së saj”¹²⁴

Dhe Ai ringjall gjatë asaj ringjallje qindra e mijëra specie bimësh e kafshësh dhe i ‘shkruan’ ato mbi fletën e tokës të gjitha të përziera me njëra-tjetrën, por të dalluara nga njëra-tjetra pa ngatërresën më të vogël. Ringjallja e të gjithë njerëzve në Ditën e Gjykimit nuk është më e vështirë se sa ringjallja vjetore, sepse vetëm numri i mizave të sjella në jetë në një verë të vetme është shumë herë më i madh se tërësia e numrit të njerëzve që jetojnë në tokë që prej shfaqjes së tyre në tokë deri në Ditën e Fundit. Kurani dhe ai të cilit iu shpall Kurani, gjithashtu thonë:

اللَّهُ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ وَكِيلٌ
لَهُ مَقَالِيدُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ
خَلَقَكُمْ وَمَا تَعْمَلُونَ
أَعَدَّ لِلْكَافِرِينَ نَارًا خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا
أَعَدَّ لِلْمُؤْمِنِينَ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا

“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje. Dhe Ai është Rregullues mbi gjithçka”¹²⁵

“Të Tij janë çelësat e qiejve dhe të tokës”¹²⁶

“Ndërsa Allahu ju ka krijuar ju dhe çfarë ju bëni”¹²⁷

¹²²Kur’an, 17:44

¹²³Kur’an, 7:54

¹²⁴Kur’an, 30:19

¹²⁵Kur’an, 39:62

¹²⁶Kur’an, 39:63

“Dhe Ai ka përgatitur për mosbesimtarët dënim të dhimbshëm (Xhehennemin)”¹²⁸

“Dhe kushdo që bën keq sa një thërrmijë qoftë, do ta gjejë atë”¹²⁹

Përsa ka të bëjë me më të qartën dhe më të rëndësishmen e çështjeve, Kurani dhe ai të cilit iu shpall Kurani nuk e shikojnë universin ashtu siç bëjnë shkenca moderne dhe filozofia dhe qëniet e tjera humane. Ata të instruktojnë ty në një art ose të pajisin ty me një talent, shkathtësi, me të cilat ti të njohësh Krijuesin tënd, i Cili i mban të gjitha krijesat në Dorën e Tij dhe i administron ato siç do Ai Vetë; dhe ata të shfaqin ty dimensionin e brendshëm të ekzistencës bashkë me dimensionet dhe pjesët e tjera dhe çfarë shprehin ato për Krijuesin e tyre. Ata të instruktojnë ty në një libër me të gjitha kuptimet dhe domethëniet e tij. Sa për qasjen moderne shkencore dhe filozofinë, ato i përshkruajnë krijesat krejtësisht përtej arritjes së pritshmërisë në sensin absolut të fjalës dhe vetëm aspektet e jashtme të asaj që ata mund të shohin dhe jo dimensionet dhe kuptimet e brendshme, për të cilat ata janë të pavetëdijshëm. Ashtu si mendja e preokupuar në mënyrë të pavullnetshme me mendime të këqija dhe me pëshpëritjet e shejtanit, ata e preokupojnë mendjen tënde me çështje sipërfaqësore të padobishme dhe pa vlerë në esencë dhe, pa njohur asgjë prej kuptimit që ato mbajnë, të instruktojnë ty në format dhe pjesët e tyre të jashtme. Ata të instruktojnë ty në një libër të zbukuruar me xhevahire të stolisur me shpjegimet e formave dhe strukturave të shkronjave të tij dhe pozitave të tyre në lidhje me njëra-tjetrën.

Meqenëse kështu është e vërteta, mos i gjyko të vërtetat e Kuranit dhe atë mbi të cilin u shpall Kurani me standartet e shkencave dhe të filozofisë, as mos i pesho ato me balancat e tyre. Malet të fiksuara thellë në tokë nuk peshohen me peshoren e xhevahireve. Parimet e shkencave tokësore dhe filozofia nuk duhet të aplikohen për vlerësimin dhe konfirmimin e të vërtetave të Kuranit dhe as për atë mbi të cilin u shpall Kurani. Mos u kushto asnjë vëmendje kritikave të disa detajeve të vogëla të atyre të vërtetave të cilat janë çudhëzuar prej iluzioneve dhe fantazive që burojnë nga shkenca dhe filozofia.

¹²⁷Kur'an, 37:96

¹²⁸Kur'an, 33:8

¹²⁹Kur'an, 99:8

Mësoje, o ti që ke vuajtur gjatë prej ndonjë fatkeqësie! Mos i ndaj ‘forcat’ e tua të durimit për të përballur edhe fatkeqësitë e së shkuarës, dhe ato të së ardhmes. Dërgoji ato vetëm kundra fatkeqësive të së tashmes. Sepse ditët e dhimbshme të së shkuarës u janë bashkuar ‘forcave’ të tua me bekimet shpirtërore që mbeten prej tyre dhe shpërblimet që ato kanë fituar për ty për jetën tjetër tënde. As mos i përdor forcat e tua të durimit për të përballur fatkeqësitë që mund të vijnë tek ti në të ardhmen. Sepse e ardhmja nuk ka ardhur akoma dhe çfarë do të sjellë ajo varet nga Vullneti Hyjnor. Dërgoji të gjitha forcat e durimit për të sotmen, madje për këtë orë. Për më tepër, përforcoji forcat e tua të durimit duke buzëqeshur tek fatkeqësitë dhe duke i dashur ato që t’i bësh ato t’u bashkohen forcave të tua dhe duke marrë ndihmë prej mbështetjes tek Pronari yt Gjithëbujar, Mëshirëplotë, i Gjithurtë. Kur ti e bën këtë, durimi yt i dobët do të të mjaftojë për më të madhen e fatkeqësive.

Mësoje, o shok! Hadithet –rrëfenjat– që disa njerëz me kuptim të mangët i hedhin poshtë duke i vlerësuar si të ekzagjëruar, në fakt përmbajnë disa të vërteta të vlefshme. Për shembull, profeti a.s.m transmetohet të ketë thënë:

لَوْ زُنْتِ الدُّنْيَا عِنْدَ اللَّهِ جَنَاحَ بَعُوضَةٍ مَآشِرٍ بِالْكَافِرِ مِنْهَا جُرْ عَتَمَاءِ

“Në qoftë se dynjaja do të kishte aq peshë në shikimin e Zotit aq sa krahu i një mushkonje, një besimtar nuk do të mund të pinte një lugë ujë prej saj”¹³⁰. Hadithi do të thotë se ajo çfarë manifestohet në pasqyrën e jetës tënde kalimtare prej fytyrës së jashtme të dynjasë nuk ka më shumë peshë se krahu i një mushkonje prej botës së përjetshme jolëndore, ashtu si një kokërr gruri që ka potencialin për të fituar përjetësi duke u rritur në bimë, kalli që është më e preferueshme se sa një kashtë që do të mbushte një fushë të madhe lëmë, por e cila ka vetëm potencialin për t’u hedhur e shpërndarë nga era. Gjithkush ka një botë të veçantë për të prej dynjasë. Në qoftë se ai e shikon botën e tij me pajisjen e kuptimit të saj duke treguar Pronarin e saj dhe jo vetveten, dhe me kuptimin si një tokë e punuar për Ahiretin dhe një vend ku manifestohen Emrat e bukur të Allahut, atëherë ajo fiton një vlerë shumë të madhe. Përndryshe, për sa ka të bëjë me aspektin e saj kalimtar, ajo nuk ka vlerë as sa ajo e një kokrre të vetme të

¹³⁰Transmeton Tirmidhi

qëndrueshme. Ju mund t'i krahasoni me këtë hadithet që lidhen me meritat e disa virdeve – recitimeve të veçanta.

Mësoje, o shok! Njëra që demonstroi se jeta bazohet mbi ndihmën e ndërsjellë dhe jo mbi konfliktin siç pranojnë disa të çudhëzuar dhe filozofë të çudhëzuar dhe shkencëtarë, është se toka e dendur dhe shkëmbinjtë e fortë nuk shfaqin rezistencë kundra depërtimit të rrënjëve të holla të bimëve. Shkëmbinjtë krisin e i thyejnë zemrat e tyre të ashpra me prekjën e gishtërinjve të butë si mëndafshi të bijave të bimëve, dhe toka hap kraharorin e saj të ashpër për depërtimin e damarëve të bimëve. Pjesët e trupit të universit kooperojnë me diellin dhe hënën e tij për dobinë e kafshëve; bimët nxitojnë për të ndihmuar kafshët si ushqim; elementet e ushqimit konkurojnë për të qenë ushqim për frutat; frutat stolisen për të tërhequr vëmendjen e atyre që u nevojitet ushqim; grimcat (e dheut, ajrit dhe ujit) bashkëpunojnë për të qenë ushqim për qelizat e trupit dhe kështu me rradhë. E gjitha kjo është një provë vendimtare se parimi i përgjithshëm në jetë është ndihma e ndërsjellë. Konflikti është vetëm një parim i veçantë i jashtëzakonshëm, në mënyrë të dukshme midis disa kafshëve të egra.

Mësoje, o shok! Lehtësia e dukshme absolute në gjërat që vijnë në ekzistencë është njëra prej provave më të qarta të Unitetit të Zotit, sepse çdo gjë, veçanërisht çdo gjallesë, kërkon për ekzistencën e saj atë çfarë është e domosdoshme për ekzistencën e tërësisë. Në qoftë se do të ndodheshin më shumë se një krijues –ruajna Zot nga një mendim i tillë– ekzistenca e një gjëje të vetme do të ishte aq e vështirë sa ekzistenca e tërësisë së universit.

Mësoje, o nefsi i dashuruar pas vetes dhe që mbështetet në ekzistencën tënde fizike! Ti u bërë i kënaqur me një pikë prej një mirazhi të oqeanit të ujit të jetës dhe me një shkrepim të dobët prej diellit të një dite të qartë. Lidhja e ekzistencës tënde fizike me manifestimet e ekzistencës së Krijuesit tënd është si lidhja e ekzistencës së një dielli të vetëm me të gjitha krijesat e shumuara prej grimcave që i formojnë ato krijesa. Ekzistenca jote tregon vetëm veten tënde në atë aspekt, ndërkohë që e tregon ekzistencën e Krijuesit të saj në aspekte të pafundme, ashtu siç e tregon çdo krijesë. Për sa ka të bëjë me ekzistencën tënde, ekzistenca e Tij është aq e qartë sa shtrirja e madhësisë së universit lidhur me ty. Sa për dashurinë për veten tënde, ajo është për shkak se vetja jote është burimi i kënaqësive të tua

sensuale, qendra e ekzistencës tënde dhe miniera e interesave të tua dhe për shkak se ai është më i afërt tek ti se sa çdo gjë tjetër. Por, ti ngatërron një hije të dobët e kalimtare me pikërisht origjinën e ekzistencës. Në qoftë se ti e do veten tënde për një kënaqësi kalimtare, atëherë ti duhet të duash Atë i Cili është në gjendje të të japë ty kënaqësi të përrjetshme dhe krijon gjithçka prej saj, lumturia e të cilave të bën ty të lumtur. Në qoftë se vetja jote është qendra e ekzistencës tënde, atëherë Zoti yt është i Vetmi i Cili ta ka dhënë ty atë ekzistencë dhe e mban atë, bashkë me ata që ekzistenca e të gjitha atyre lidhet me tënden.

Në qoftë se ekzistenca jote është miniera e interesave të tua, atëherë Furnizuesi yt është Ai, në Dorën e të Cilit është e gjithë e mira. Ai është Mirëbërësi i Përrjetshëm dhe me Të janë të gjitha përfitimet dhe dobitë e atyre që janë të dobishme për ty. Në qoftë se vetja jote është më e aftërta për ty (se çdo gjë tjetër), atëherë Krijuesi yt është më afër teje se ajo. Dora e Tij arrin atë çfarë dora e vetes tënde nuk mund ta arrijë dhe atë çfarë është përtej arritjes së vetëdijes tënde. Prandaj, ti duhet t'ia bashkosh të gjithë dashurinë tënde të ndarë midis krijesave dhe duke ia shtuar edhe dashurinë ndaj vetes tënde drejtoja atë të Gjithëfuqishmit, të Dashurit të Vërtetë.

Mësoje, o shok! Ajo çfarë të mbulon ty prej Zotit dhe të mban në pakujdesi është se ti e kufizon shikimin tek gjërat dhe pjesët në mënyrë të ndarë, veçmas, dhe i shikon ato që t'u atribuohen rastësisë dhe shkaqeve. Kurse, ai që e ngen kokën e tij dhe mund të shohë tërësinë dhe universalen me një shikim gjithpërfshirës duhet ta gjejë të pamundur t'ia atribuonte madje edhe gjënë më të vogël më të madhes së shkaqeve. Për shembull, ti mund t'ia përshkruash ushqimin disa shkaqeve, por kur ti sheh djerrinën e tokës dhe varfërinë e saj në dimër, dhe pastaj qënien e saj të stolitur e të mbushur me shumëllojshmëri ushqimesh, të cilat i ka gatuar Fuqia Hyjnore në enët e pemëve dhe kaldatë e fushave dhe kopshteve, ti do të bindeshe se do të ishte e pamundur që Ai i Cili të furnizon ty të mund të ishte dikush tjetër përveç Atij i Cili i furnizon të gjitha qëniet e gjalla duke e ringjallur tokën pas vdekjes së saj.

Për shembull, ti përsëri mund t'ia atribuosh ndriçimin e shtëpisë tënde dhe ndriçimin (e mendjes dhe të shpirtit) tënd disa shkaqeve të dukshme dhe të thuash:

إِنَّمَا أوتيتُهُمْ عَلَىٰ عِلْمٍ

“Kjo më është dhënë mua vetëm për shkak të njohurive që kam unë”¹³¹

Por, kur ti e sheh se drita jote vjen prej dritës së ditës dhe ndriçimi yt varet esencialisht nga Burimi i të gjitha dritave, ti do të fitoje bindjen se askush tjetër përveç Atij i Cili ndryshon ditën dhe natën nëpërmjet lëvizjes së sistemit diellor dhe i Cili i çudhëzon këdo që Ai dëshiron prej shpirtërave mëkatarë të paturpshëm dhe udhëzon cilindo që Ai dëshiron prej shpirtërave të drejtë nëpërmjet dërgimit të Shkrimeve të shenjta për mësim e testim, sigurisht Ai është i Aftë të ndriçojë trupin tënd dhe të ndriçojë mendjen dhe zemrën tënde.

Mësoje, o njeri! Ndodhen gjëra të mëdhaja para teje të cilat detyrojnë çdo qenie të vetëdijshme që t’u kushtojë vëmendje atyre. Njëra prej atyre çështjeve është vdekja, ndarja jote prej gjithçkaje që ti e do dhe prej botës me çfarëdo që gjendet në të. Një tjetër është udhëtimi yt për në përjetësi përmes rrethanave të tmerrshme. Një çështje tjetër është pafuqia jote e skajme duke iu shtuar varfërisë tënde të pafundme në udhëtimin tënd të pakufizuar tek kjo hapësirë e kufizuar e jetës tënde.

Si është që ti të mund të sillesh si i pakujtueshëm, i harruar dhe si i verbër ndaj atyre çështjeve në mënyrën e një struci, i cili e zhyt kokën e tij në rërë me qëllim që të mos e shohë gjahtari? Deri kur do të jesh i zhytur në pikat e zhdukshme kalimtare –në vogëlsira– dhe nuk u kushton vëmendje oqeanëve të frikshëm?

Mësoje, o shok! Lavdi Zotit, i Cili e bën të mundshme për të zgjidhur problemet ontologjike më të mëdhaja nëpërmjet një rregulli të vetëm të linguistikës. Ai është kuptimi i lidhur me shkronjën dhe kuptimi i lidhur me emrin. Kështu, universi është një libër dhe krijesat janë fjalët që ai përmban. Ato fjalë duhet të shikohen jo për llogari të vetvetes së tyre, por për llogari të Shkruesit, Skalitësit. Domethënë, ato janë mesazhet e Zotit duke manifestuar Emrat e bukur Hyjnorë. Shikimi i parë, domethënë t’i shikosh krijesat për llogari të vetvetes së tyre, është shkaku i injorancës së përbërë, i mosmirënjohjes kryeneçe

¹³¹Kur’an, 28:78

dhe i filozofisë me bukuri të rreme, ndërsa tjetri, shikimi i dytë, është origjina e njohjes, e besimit dhe e urtësisë.

Përsëri, lavdi Zotit, i Cili e bën të mundshme të zgjidhësh një çështje të stërmadhe që lidhet me Hyjninë e Zotit –Rububijjeh– nëpërmjet një rregulli të logjikës, kryesisht ndryshimit midis një universaleje duke pasë të pjesshme ose individë, dhe një tërësi e formuar prej pjesëve. Manifestimet e bukurisë dhe të Unitetit të Tij –përqëndrimi i manifestimit të Emrave të Tij– mund të krahasohen me universalen duke pasur të pjesshme ose individë. Manifestimet e Madhësisë dhe të Njësisë –manifestimi i njërit prej Emrave të Tij ose i një grupi tërësie– mund të krahasohet me tërësinë e formuar të pjesëve. Manifestimet e plotësisë dhe madhërisë i rrethojnë e i përfshijnë të dyja. Domethënë, plotësia në shikimin e madhësisë është universalja në shikimin e tërësisë dhe e pjesshmja në shikimin e pjesës.

Mësoje, o shok! Dynjaja është indeksi i Ahiretit. Ajo mban çështjet më të rëndësishme që lidhen me Ahiretin. Për shembull, shiko kënaqësinë që ti merr në të ngrënit dhe në të pirit. Ai i Cili në këtë banesë kalimtare e të përbuzshme, nuk jep kënaqësi të vërtetë ka përfshirë në trupin tënd shqisa, ndjenja, sisteme, organe, pjesë dhe shumëllojshmëri manifestimesh të Emrave të Tij mbi gjërat që i përkasin ekzistencës tënde fizike, i Gjithurti i Vetëm i Cili të ka pajisur ty kështu me shqise të ndryshme, sigurisht që ka përgatitur për mysafirët e Tij gosti të përjetshme në pallate

تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا

“...nën të cilët rrjedhin lumenj – aty do të banojnë përherë”¹³²

Mësoje, o Said i pafuqishëm, i frikësuar! Kur e ke frikë ose e dashuron të krijuarën, frika bëhet një shqetësim i dhimbshëm dhe dashuria bëhet një brengë pikëlluese. Sepse ti ke frikë dikë që nuk ka mëshirë për ty dhe nuk ia vë veshin kërkesave të tua, dhe ti dashuron dikë që nuk të njeh ose të përbuzë ty për shkak të dashurisë tënde, ose nuk të shoqëron ty, dikë që madje të braktis pavarësisht dëshirës tënde. Prandaj, ti duhet të kesh frikë dhe të duash Krijuesin tënd Gjithëbujar

¹³²Kur’an, 5:119

dhe Mëshirëplotë, me qëllim që dashuria jote të mund të bëhet një lumturi e përjetshme dhe pa zhdukje, pa dhimbje dhe pa poshtërim, dhe frika jote të mund të bëhet një përlësi e këndshme duke kërkuar strehë në krahërorin e mëshirës, ashtu si frika e një fëmije prej nënës së tij, e cila e detyron atë ta hedhë në krahët e saja të ngrohtë, dhe kjo bëhet një kënaqësi për të.

Mësoje, o shok! Ti je fruti ose bërthama e pemës së krijimit. Megjithëse, për sa ka të bëjë me ekzistencën tënde fizike, ti je një qenie e vogël, e dobët, e pafuqishme, e poshtëruar, e kufizuar, por Autori i Gjithurtë të ka favorizuar ty me një dispozitë universale. Duke i dhënë jetë trupit tënd, Ai të ka çliruar prej kufijve të një ekzistence të parëndësishme, individuale dhe të ka mundësuar ty për të udhëtuar përmes të gjitha pjesëve të kësaj bote të dukshme me pikërisht shqisat e tua të zhvilluara e hulumtuese me qëllim që secila të mund të fitojë ushqimin e saj të veçantë. Gjithashtu, duke të të bërë ty një qenie humane, Ai të ka pajisur ty me një potencial për të lulëzuar ashtu si një pemë duke u rritur prej një bërthame, përmes të gjitha qosheve të dimensionit fizik të ekzistencës. Për më tepër, Ai të ka dhuruar ty besimin dhe fenë Islame dhe si rrjedhojë të ka pajisur ty me një potencial për të fituar një ekzistencë universale. Për më tepër, duke të të favorizuar ty me njohje e dashuri për Të, Ai të ka bërë ty një dritë gjithëpërfshirëse. Tani zgjidh cilën të duash prej dy alternativave. Në qoftë se ti ia bashkangjit veten tënde dynjasë dhe dëshirave trupore, ti do të bëhesh një individ i dobët e i poshtëruar. Në qoftë se ti i përdor të gjitha instrumentet e jetës tënde, shqisat dhe aftësitë e tua, për llogari të humanizmit më të madh, i cili është Islami, atëherë ti do të fitojë një ekzistencë universale dhe do të bëhesh një llampë ndriçuese qëndrore.

Mësoje, o ti që i do gjërat e kësaj bote me të cilat je i lidhur vetëm aq sa shtrirja që ekzistenca jote fizike e kufizuar të lejon! Meqenëse e shpenzon dashurinë tënde larg vendit të duhur të saj, ti je i dëshpëruar. Por, në qoftë se do të Vetmin e Unitetit dhe i do gjërat e tjera për llogari të Tij, dhe me lejen e Tij, ti do të jesh i shpëtuar prej pikëllimit dhe dhimbjeve të ndarjes (prej gjërave të kësaj bote që ti i do). Ti do të ishe si ai që, në sajë të shërbimit me besnikëri ndaj një mbreti, i cili ka lidhje me gjithkënd në mbretinë e tij, dëgjon me veshët e prijësit të tij dhe sheh me sytë e tij çfarëdo që ndodh gjithandej mbretërisë sikur të ishte i pranishëm në të gjitha vendet dhe përbri gjithkujt në të njëjtën kohë. Duke përdorur të gjitha sistemet e komunikimit që i përdor

mbreti, ai dëgjon të gjithë muzikën e këndshme dhe i shikon të gjitha skenat gjithandej tokave të gjëra të mbretit.

Mësoje, o ti që shfaq kuriozitet të madh për të mësuar rreth hënës dhe planetëve të tjerë! Në qoftë se do të të thuhej se dikush ka ardhur nga hëna që të të tregojë ty rreth saj, ti do të sakrifikoje gjysmën e jetës tënde për ta dëgjuar atë. Ti gjithashtu do ta sakrifikoje atë edhe për hir të njohjes rreth të ardhmes tënde. Atëherë, ka ardhur një njeri i i cili të tregon ty rreth Atij, në botën e sundimit të të Cilit hëna është më e vogël se një flutur nate duke fluturuar rreth një drite; ajo fluturon rreth dritës midis kandilave të panumërt që varen prej tavanit të shtëpisë të cilën Ai e ka përgatitur për mysafirët e Tij. Ai burrë gjithashtu tregon rreth përjetësisë dhe jetës së amshuar së bashku me të vërtetat themelore dhe çështjet e mëdhaja, më e vogëla e të cilave është më e rëndësishme se sa shpërthimi -shkatërrimi- i tokës dhe i hënës. Në qoftë se do të doje ta dëgjosh atë, vëri veshin kapitujve të librit të tilla si:

إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ *“Kur dielli të mbështillet dhe të humbë dritën”*¹³³ dhe إِذَا السَّمَاءُ انْفَطَرَتْ *“Kur qielli të plasë”*¹³⁴ dhe të tjera si këto. Për më tepër. Ai të tregon ty një rrugë të drejtë e të rrafshët që të çon tek Uniteti dhe të ruan ty prej konfuzionit në rrugët e shtrembëruara e të përthyerë të çudhëzimit. Ai shtrin tek dora jote një ‘kapëse të fortë’, një zinxhir ngjitjeje, i cili e ruan cilindo që kapet fort pas tij prej mbytjes në nivelet e errësirës së shumësisë habitëse të gjërave. Ai gjithashtu të ofron ty ujin e jetës, jetën e amshuar, prej burimit të pastër të besimit, me qëllim që ti të mund të shpëtosh prej zjarrit të ndarjes nga gjithçka që ti do në botë. Për më tepër, ai të informon ty për çfarë e kënaq Krijuesin tënd, urdhërit të të Cilit i nënshtrohen dielli, hëna dhe të gjithë yjet e tjerë dhe me lejen e të Cilit toka u vendos dhe u stabilizua, dhe të informon ty për çfarë Ai të urdhëron ty të bësh. Ai gjithashtu interpreton për ty komunikatën dhe bashkëbisedimin me Mbretin e Parapërdjetshëm, fuqia e të Cilit nuk ka limit.

O i dobët dhe i varfër pafundësisht! Duke qenë e tillë e vërteta, a nuk do ta braktisësh nefs tënd me qëllim që të kapësh e kuptosh udhëzimin e Kuranit? A nuk do t’i harrosh dëshirat e tua me qëllim që

¹³³Kur’an, 81:1

¹³⁴Kur’an, 82:1

ti t'i kushtosh vëmendje profetit të të Gjithëmëshirshmit? A nuk do ta prisje mesazhierin e Tij me besim e nënshttrim? A nuk do ta doje me sinqeritet atë që ka ardhur me paqë e shpëtim a.s.m? A nuk do ta ndjeje nevojën e të mësuarit prej tij atë çfarë na kërkon Zoti ynë i Dhembshur, Pronari ynë Dorëgjërë Xhel–le Xhelaluhu, lavdia e Tij qoftë e lartësuar?

Mësoje, o shok! Ne e shohim Autorin e Gjithurtë me plotësinë e urtësisë së Tij dhe dëshmojmë qartë se aktet e Tij janë absolutisht të lira dhe larg tepricës dhe kotësisë. Ai i thur 'tekstilet' e shtrira, të qëndrueshme, të mëdhaja, të shtrenjta dhe të larta prej gjërave shumë të vogëla, jetëshkurtëra dhe të papërfillshme. Përsëri, në sajë të akteve të Tij duke qenë absolutisht të lira dhe larg harxhimit të tepruar dhe paqëllimshmërisë, Ai i ngarkon një gjëje të vogël, secilës prej organeve dhe gjymtyrëve të trupit të njeriut, për shembull dhe veçanërisht atyre në kokën e tij me një larmi të detyrave shumë të rëndësishme. Në qoftë se një organ i ndryshëm me përmasën e një fare sinapi do t'i kërkohet të bënte secilën prej detyrave me të cilat organet në kokën tënde janë ngarkuar, atëherë koka jote duhet të ishte aq e madhe sa mali Sinai. A nuk e sheh gjuhën si ajo, krahas detyrave të tjera të saj shumë të rëndësishme, vepron si një inspektore e mirësive të depozitura në thesarin e të Gjithëmëshirshmit, e të gjitha gjërave të ngrënshme dhe pijeve të përgatitura në kuzhinën e Fuqisë së Tij? Ajo ka detyra sa numri i shijeve të të gjitha llojeve të ushqimit. A nuk tregon ky aktivitet i qëllimshëm për faktin se Autori është duke thurur prej gjërave lëvizëse në rrjedhën e kohës, nga përmbajtjet e ditëve të shkuara, viteve dhe shekujve, 'tekstile' për botën e së padukshmes dhe të Ahiretit nëpërmjet lëvizjes së 'Sovajkës' së ditës me ndërrimin e ditës dhe natës dhe me ndryshimin e stinëve? Ai gjithashtu bën të njëjtën thurje në njeriun, i cili është indeksi i universit. Ai regjistron dhe ruan përjetësisht minutat e jetës së tij në 'tekstilet' e 'fletëve' të kujtesës së tij dhe e përdor vdekjen si një mjet transporti prej kësaj bote të ngushtë të dukshme për tek botërat e padukshme të pastërtisë dhe amshueshmërisë. Ne dëgjojmë prej burimeve të shpalljes se minutat e jetës së njeriut rikthehen tek ai ose të errësuarat me pakujdesshmërinë dhe gjynahet ose të ndriçura me llampat e veprave të mira të varura prej hallkave të atyre minutave.

Mësoje, o shok! Autori Hirëplotë e i Gjithurtë i bën në përmasa tejet të ndryshme anëtarët e çdo specie të kafshëve, veçanërisht duke

përfshirë ato që fluturojnë me dy krahë dhe peshqit, melekët dhe të gjitha krijesat e tjera prej atomeve tek galaktikat. Ai e bën të vogëlën si një model i zvogëluar i të madhes. Disa prej qëllimeve të Tij për bërjen kështu janë se njeriu mund të udhëzohet tek të vërtetat dhe lehtë reflekton mbi krijimin e Tij dhe lexon e kupton mesazhet e fuqisë së Tij, dhe që Ai të shfaqë plotësinë e asaj fuqie dhe t'i ekspozojë dy llojet e artit të Tij, njërin që buron nga bukuria e Tij dhe tjetri që buron nga madhështia e Tij. Gjërat shumë të vogëla dhe të dalluara me vështirësi zakonisht mbeten të panjohura; prandaj, kur ato 'shkruhen' me shkronja të mëdhaja, ato shpëtojnë nga mbetja të panjohura. E ngjashme me këtë, gjërat shumë të mëdhaja për syrin për t'i përfshirë e rrethuar dhe për mendjen për t'i kapur e kuptuar gjithashtu mbeten të panjohura. Kur ato shkruhen në krahasim dhe duke qenë afër 'shkronjave të vogëla', ato mund të shihen e kuptohen lehtë. Pavarësisht këtij fakti, nefsi urdhërues për të liga i mësuar prej shejtanit mendon se masa e vogël është rezultati i dobësisë ose i mangësisë në art dhe si rrjedhojë gjërat e vogëla mund t'u atribuohen shkaqeve të shurdhëta e të vërbëra. Në të njëjtën mënyrë, ai pretendon se gjërat shumë të mëdhaja shfaqin mungesën e ndonjë urtësie dhe qëllimi në to dhe si rrjedhojë i atribuohen rastësisë.

Mësoje, o shok! Në qoftë se do të thuhej se shumësia e pafundme e gjërave dhe bollëku absolut në furnizimin me rëzk i përshtaten kotësisë dhe janë në kontradiktë me urtësinë në ndonjë aspekt, do të të thuhej: në qoftë se ndodhet vetëm një qëllim për ekzistencën e gjërave, veçanërisht për qëniet e gjalla, një shumësi e tillë dhe një bollëk i tillë mund të thuhet të jenë në kontradiktë me urtësinë në krijim e në jetë; por, ndodhen qëllime të panumërta për çdo gjë ekzistuese, e cila gjithashtu ka detyra të ndryshme dhe larmi të mëdhaja frutash. A nuk e sheh ti se gjuha jote ka aq shumë detyra, aq sa numri i qimeve të flokut në kokën tënde? Ndodhen qëllime të pafundme për atë shumësi dhe lidhur me detyrat me të cilat çdo gjë është ngarkuar, nuk ndodhet asnjë kontradiktë me urtësinë. Megjithëse një ushtri është e ngarkuar kryesisht me ruajtjen e kufijve ose me mbrojtjen e vendit (kundra sulmeve të jashtme të mundshme), ne ndjehemi të detyruar të kemi trupa të shumtë, meqë një ushtri ka edhe funksione e detyra të tjera, të tilla si përfaqësimi i autoritetit të një qeverie dhe ruajtja e vendit gjithashtu edhe prej konflikteve të brendshme.

Mësoje, o shok! Një njeri mund të shihet së bashku me veprat e tij të artit, por ndodhen shtatëdhjetë mijë perde ndërmjet Zotit dhe veprave të Tij. Në qoftë se ti do të mund t'i shikoje krijesat e Zotit të gjitha së bashku në një kohë, perdet e errësirës mund të ngrihen – hiqen, dhe atëherë do të mbeteshin vetëm perdet e dritës. Rruga më e drejtëpërdrejtë dhe më e shkurtër për të arritur atë nivel shikimi është brenda teje; ajo mund të gjendet në botën e jashtme veçse me një dashuri të fortë.

Mësoje, o shok! Çdo anëtar i shumicës së specieve riprodhuese të kafshëve dhe bimëve ka një tendencë ose një qëllim për të pushtuar tërësinë e tokës dhe ta kapë atë për ta përdorur si një vend adhurimi duke përmendur e reflektuar Emrat e Krijuesit të saj. Secili prej tyre ka një lloj të veçantë adhurimi ndaj Krijuesit të vet, i Cili është pafundësisht i Denjë për adhurim. Në qoftë se ti dëshiron, vështro një bostan dhe farërat e tij dhe pemët frutdhënëse dhe bërthamat në frutet e tyre, dhe gjithashtu shiko peshqit dhe zogjtë dhe vezët e tyre. Por, meqenëse bota e dukshme është shumë e vogël për të gjitha ato për të realizuar plotësisht 'qëllimin' e tyre, njohja gjithëpërfshirëse e Njohësit të së padukshmes dhe të dukshmes, i Cili njih çfarë ka ndodhur, çfarë po ndodh dhe çfarë do të ndodhë, pritet që të pranojë adhurimin e tyre të synuar.

Mësoje, o shok! Prej qëllimeve për ekzistencën e gjërave, Kurani ndonjëherë përmend ato që lidhen me njeriun. Kjo nuk do të thotë se ato gjëra u krijuan vetëm për qëllimet e përmendura. Ajo është për të tërhequr vëmendjen e njeriut dhe për të drejtuar shikimin e tij tek rregulli dhe harmonia që ato shfaqin, dhe si rrjedhojë, për tek Emrat e Autorit të tyre që ato tregojnë. Sepe njeriu i kushton vëmendje veçse asaj që lidhet me të dhe preferon diçka që lidhet me të, edhe sikur të ishte e vogël sa grimca më e vockël duke e preferuar mbi një 'diell' me të cilin nuk ka lidhje. Për shembull,

وَالْقَمَرَ قَدَرْنَا مَنْزِلَ لِنَعْلَمُوا عَدَدَ السِّنِينَ وَالْحِسَابَ

*"Edhe Hënës Ne i përcaqtuam dhe i matëm asaj vendbanime (faza që t'i përshkqojë)..."*¹³⁵

¹³⁵Kur'an, 36:39

“...që të mund të dini numrin e viteve dhe njehësimin e kohës...”¹³⁶

Kjo është vetëm njëra prej mijëra qëllimeve për ekzistencën e hënës. Ajo nuk do të thotë se hëna u krijua vetëm për këtë qëllim, që u përmend sepse ai është më i qarti për njeriun.

Mësoje, o shok! Njëra nga stampat e paimitueshme dhe nga vulat e veçanta për Të, dhe gjithashtu njëra prej shenjave më të qarta të Unitetit të Fuqisë së pakufishme dhe Njohjes së pafundme të vëzhguara në autoritetin absolut dhe në qëndrueshmërinë absolute dhe lehtësinë në krijimin dhe mbajtjen e tij, është se gjëra të ndryshme të panumërta krijohen nga një gjë e vetme e thjeshtë. Për shembull, toka –dheu– është elementi kryesor për të gjitha llojet e bimëve për të ardhur në ekzistencë dhe për t’u mbajtur, dhe të gjitha organet e një kafshe, duke përfshirë mishin e saj, kockat, gjakun dhe indet, bëhen nga ushqimi i thjeshtë. Përsëri, një gjë e të njëjtës natyre dhe përbërje, trupi i njeriut për shembull, bëhet prej llojeve të panumërta ushqimi.

Lavdi Atij, i Cili ka fuqi absolute për t’i bërë gjërat prej një gjëje të vetme dhe një gjë të vetme prej të gjitha gjërave.

Mësoje, o shok! Në pohimet e Kuranit, *أَمْ نَحْنُ الزَّارِعُونَ* “(A jeni ju që e bëni të rritet) apo jemi Ne Rritës?”¹³⁷ ndodhet një kuptim i thellë. Ashtu siç i ruan ti disa nga farërat dhe i depoziton ato për t’i mbjellë më vonë, po ashtu Trashëguesi për të gjitha gjërat, Gjallëruesi dhe Gjithëruajtësi, i Cili e gjallëron tokën pas vdekjes së saj, i regjistron rezultatet e veprave të të gjitha bimëve dhe i ruan ato për t’i përhapur në shumë zona në përputhje me disa masa. Pastaj, Ai i bën ato të prodhojnë gjethe e lule sikur secila prej tyre të recitonte:

وَإِذَا الصُّحُفُ نُشِرَتْ

“Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të hapen”¹³⁸

Shiko se sa me zell të madh ti kujdesesh për ruajtjen e disa farërave, dhe përpiku të kuptosh se sa në mënyrë perfekte Gjithëruajtësi Absolut ruan në mënyrë të panumërta prej atyre senduqeve të holla të cilat

¹³⁶Kur’an, 10:5

¹³⁷Kur’an, 56:64

¹³⁸Kur’an, 81:10

përmbajnë indekset e prindërve të përcaktuar prej Kaderit, prej ndryshuesve të shumtë dhe prej faktorëve prishës, dhe i dallon ato pa ngatërresën më të vogël. Kjo ruajtje nuk të lë ty në tekat e tua që ti të mund të bësh çfarëdo që dëshiron dhe pastaj të vdesësh për një pushim të përjetshëm.

أَيَحْسَبُ الْإِنْسَانُ أَنْ يُتْرَكَ سُدًى

“A mendon njeriu se do të lihet i harruar (pa u ndëshkuar ose pa u shpërblyer për detyrat e përcaktuara nga Allahu, Zoti i tij)?”¹³⁹

Jo, ti sigurisht që do të thirresh për të dhënë llogari për çfarëdo që ti bën, madje edhe për më të vogëlën e asaj që ti bën.

Mësoje, o shok! Njëra prej detyrave me të cilat është ngarkuar jeta e njeriut është që të gjykojë prej attributeve të veçanta dhe cilësive esenciale që ai dhe bijtë e llojit të tij kanë, ai duhet të perceptojë Cilësitë esenciale dhe Atributet e Krijuesit të tij. Por, me qëllim që të kuptojë aktet e Tij më gjithëpërfshirëse në shkatërrimin dhe rindërtimin e universit dhe ringjalljen e të gjithë të vdekurve bashkë me të gjitha administrimet e Tij në botën tjetër, ti duhet të shikosh aktet e Tij në ringjalljen e tokës në pranverë dhe vdekjen e saj në vjeshtë dhe dimër. Me qëllim që të shohësh përngjasimin e Ringjalljes më të madhe dhe interpretimet e vërseteve të tillë si *إِذَا الشَّمْسُ كُوِّرَتْ* “Kur dielli të mbështillet e të humbë dritën...”¹⁴⁰ reflekto mbi pranverën e vjeshtën.

Mësoje, o shok! Islami është aq gjithëpërfshirës saqë esencat e tij rrethojnë gjithçka, çdo çështje, prej më universaleve të tilla si Emrat më të mëdhenj dhe Atributet e Pronarit të Fronit më të Lartë, qiejt e toka bashkë me melekët e veçantë për to, deri tek më të pjesshmet, më të veçantat të tilla si ndodhitë në zemrën e njeriut. Ato gjithashtu e rrethojnë me parimet e tij më të qëndrueshme atë çfarë është midis qiejve dhe tokës!

¹³⁹Kur’an, 75:36

¹⁴⁰Kur’an, 81:1

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يَغُرَّنَّكُمُ بِاللَّهِ الْغُرُورُ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëpotit.

“...atëherë le të mos ju gënjejë kjo jetë e dynjasë, as të mos ju mashtrojë i pari i mashtruesve (shejtani) për Allahun”¹⁴¹

Mësoje, o ti që i fton muslimanët tek jeta e kësaj bote, e cila është një lodër në gjumë dhe në zbavitje, duke i nxitur ata të lënë sferën e hallallit, e asaj që Zoti e ka bërë të ligjshme prej të mirave të mjaftueshme për ta, për të kënaqur dëshirat e tyre të ligjshme, dhe për të hyrë në sferën e haramit, e asaj që Zoti e ka ndaluar prej gjërave të këqija e të ndyra, të cilat do t’i detyrojnë ata të braktisin disa prej simboleve publike të fesë së tyre ose madje krejtësisht vetë fenë. Në lidhje me to, ti i përngjason një të dehuri i cili nuk mund të dallojë një luan të egër të pangopur prej një kali të butë e të shtruar, as nuk mund të dallojë midis lakut të xhelatit prej litarthit të një fëmije dhe as të çarën e një plage prej një trëndafili të hapur. Ai e supozon luanin të jetë kali, lakun të jetë litarthi dhe plagën e hapur të jetë një trëndafil i kuq. Pavarësisht kësaj, ai e mendon veten të jetë një udhëzues, reformator duke i vënë gjërat drejtë. Ai vjen tek një njeri i cili është në gjendje të tmerrshme, një luan i çuditshëm prapa tij për ta sulmuar, një trekëmbësh për dënim me varje me litar përpara tij, dhe dy plagë të rënda në secilën anë të trupit të tij. Ai ka dy lloje ilaçesh në dorën e tij; në qoftë se ai i përdor ato, plagët e tij do të ndryshohen në dy trëndafila të kuq me lejen e Allahut. Ai gjithashtu ka dy talismane, njëri në gjuhën e tij, tjetri në zemrën e tij. Në qoftë se ai i përdor ato, luani prapa tij do të ndryshohet me lejen e Allahut në një kalë duke e çuar atë tek prania e Pronarit të tij Gjithëbujar, i Cili e fton atë tek vendbanimi i paqes për ta gostitur; dhe laku i xhelatit duke u varur prej pemës së zhdukjes dhe vdekshmërisë do të ndryshohet me mirësinë e Allahut në një mjet transporti për ta transportuar atë nëpër skenat që ndryshojnë vazhdimisht për të shtuar kënaqësinë që merret në ripërtëritjet e

¹⁴¹Kur’an, 31:33

bukurive dhe formave të tyre dhe të favorëve përmes ditëve, stinëve, viteve dhe shekujve.

I dehuri i thotë atij njeriu: “Lëri ato talismane dhe hidhi ato ilaçe! Eja dhe le të luajmë e të dëfretimë!”

Njeriu i përgjigjet: “Ajo çfarë më lejohet të bëj me ruajtjen e atyre talismaneve dhe ilaçeve është e mjaftueshme për kënaqësinë time; nuk ka kënaqësi dhe as lumturi veçse me to. Në qoftë se do të ishte e mundur për ty të vrasësh luanin e vdekjes, i cili do të vdesë vetëm në parajsë dhe ta ngjisësh këtë mjet të ngulur në tokë me vendimin e Sundimtarit të tokës, domethënë të heqësh mjetin e zhdukjes dhe të vdekshmërisë, duke e ndryshuar tokën në diçka tjetër nga toka, dhe në qoftë se gjithashtu do të ishte e mundur për ty ta shërosh këtë plagën time (plagën e pafuqisë) që po sulmon të gjithë qënien time me ndryshimin e jetës sime të përkohshme e kalimtare në një jetë të qëndrueshme e të përhershme, dhe ta shërosh plagën time tjetër që po sulmon të gjithë qënien time me ndryshimin prej qënies sime të varfër e të mjerë në qenie të pasur e të përhershme, atëherë le të bëjmë çfarë ti propozon. Përdryshe, o shejtan i dehur, në qoftë se ti nuk ke aspak fuqi për t’i bërë ato katër gjëra që sapo i përmenda, atëherë ik, shporru! Ti mund të mashtrosh vetëm ata të dehur si vetja jote, të cilët nuk mund të bëjnë dallim midis qeshjes dhe qarjes, qëndrueshmërisë dhe përkohshmërisë, ilaçit dhe sëmundjes, dhe midis shmangies dhe udhëzimit. Sa për mua, **حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ نِعْمَ الْمَوْلَى وَنِعْمَ النَّصِيرُ** dhe *Allahu vetëm më mjafton mua. Sa Ruajtës i Mirë është Ai dhe sa Ndihmues i Mirë është Ai!*”

Mësoje, o shok! Studentët e civilizimit të çudhëzuar e të shthurur dhe nxënësit e filozofisë çudhëzuese e të dëmshme janë të dehur me lakminë e tyre jonormale dhe me pasionet e pazakonshme. Ata përpiqen t’i ftojnë muslimanët që të ndjekin traditat e huaja dhe zakonet dhe të braktisin simbolet e tyre publike që rrezatojnë me dritën e Islamit. Studentët e Kuranit u përgjigjen atyre:

O ju të çudhëzuar të shkujdesur! Në qoftë se ju jeni në gjendje të largoni zhdukjen dhe vdekjen prej dynjasë dhe të hiqni pafuqinë dhe varfërinë prej njeriut, atëherë ju mund të jeni indiferent ndaj fesë dhe simboleve publike të saj. Përndryshe, rrini të heshtur dhe ndalojini britmat që nuk janë më shumë se një zukamë e një mize e krahasuar me

vajtimin, klithmën si rufe të katër gjërve të përmendura lart dhe ligjeve të krijimit dhe jetës duke shpallur me zërin e tyre më të lartë për domosdoshmërinë e fesë dhe ndjekjen e simboleve publike të saj.

وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni”¹⁴²

Në të vërtetë, ndodhet pas meje luani i orës së fundit –exhelit– që më kërcënon gjithmonë mua. Në qoftë se ti do të dëgjoje me dëgjimin e besimit jehonën e Kuranit, atëherë ai luan do të ndryshohej në një kalë, dhe ndarjet (nga ato që ne i duam) në një burak (kafshë e botës së padukshme) që të çon ty tek mëshira e të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit dhe tek prania e Pronarit të Dhembshur Gjithëbujar. Përndryshe, vdekja është një luan i egër grabitqar që do të më shqyejë e më bëjë copash, pavarësisht dëshirës sime, dhe do të më ndajë mua përjetësisht nga të gjithë ata që i dua. Përsëri, para meje ndodhen mjetet e vdekjes dhe të asgjësimit të vendosura në ndër-këmbimin e ditës e të natës, dhe mjetet e zhdukjes dhe të ndarjes duke u shfaqur përmes valëve të stinëve dhe të viteve. Këto vegëla, mjete janë vendosur për të më varur mua me të gjithë të dashurit e mi. Në qoftë se ti i kushton vëmendje me bindje udhëzimit të Kuranit, atëherë këto mjete do të bëhen një kafshë mbi të cilën për të bërë një udhëtim të këndshëm në rrjedhën e kohës, dhe në oqeanin e botës për të vëzhguar veprat e Fuqisë Hyjnore përmes stinëve duke u ndryshuar e duke ndjekur njëra-tjetrën nga rrota e diellit dhe nga rrotullimi i tokës duke mbështjellur rreth kokës së saj çallmën e ditëve dhe të netëve dhe duke veshur mantelet e verës dhe të dimrit njëri mbi tjetrin.

Për më tepër, në anën time të djathtë ndodhet plaga pushtuese e varfërisë së pafundme. Unë jam më i varfër se të gjitha qëniet e tjera të gjalla, domethënë unë kaq aq shumë nevoja materiale dhe shpirtërore aq sa kanë të gjitha qëniet shtazore, ndërsa fuqia ime për t’i përmbushur ato është më e vogël se ajo e një trumcaku. Në qoftë se unë e shëroj atë plagën time me ilaçin e Kuranit, atëherë ajo varfëri absolute e dhimbshme ndryshohet në një zell që jep kënaqësi për tek gostia e mëshirës, dhe në një oreks të këndshëm për frutat e mëshirës së

¹⁴²Kur’an, 7:204

të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotë. Kënaqësia e ndjenjës së varfërisë dhe të pafuqisë së dikujt para Zotit, bëhet shumë më e madhe se ajo e të qënurit në dukje i pasur e i fuqishëm. Përndryshe, unë jam i sigurtë të vuaj dhimbjet e të qënurit i nevojshëm dhe poshtërimin e lypjes dhe të përkuljes para kujtdo që unë pres e shpresoj të plotësojë nevojat e mia.

Në anën time të majtë ndodhet një plagë e thellë e një pafuqie të pafundme, pavarësisht armiqtësive dhe rreziqeve të pambarim. Dhimbja e frikës e shkatërron kënaqësinë e jetës së kësaj bote. Por, në qoftë se unë i kushtoj vëmendje nënshtrimit ndaj thirrjes së Kuranit, atëherë pafuqia ime më çon mua të kem besim në fuqinë absolute të të Vetmit dhe do të gjej një pikë mbështetjeje për të qenë i sigurtë kundra të gjitha armiqtësive dhe rreziqeve në pafuqinë time të pakufishme.

Për më tepër, unë jam në një udhëtim të gjatë që shtrihet përmes varrit dhe ringjalljes për në përjetësi. As bota dhe as mendja nuk më shfaqin mua ndonjë dritë për të ndriçuar errësitat e asaj rruge, as nuk na sjellin neve ndonjë ushqim të nevojshëm për atë udhëtim. Por ama, me dritën që do të fitohet prej diellit të Kuranit të shpjegimit të mrekullueshëm dhe me ushqimin që do të sigurohet prej thesarit të të Gjithëmëshirshmit ne mund ta ndriçojmë rrugën tonë dhe të vazhdojmë me udhëtimin. Tani, në qoftë se ti ke diçka që do të më pengonte mua nga ky udhëtim me kusht që ajo të mos jetë në formën e një rruge mashtruese nëpërmjet çudhëzimit, e cila do të thotë të më flakë mua prej gojës së varrit në gropat e errëta të asgjësisimit të përjetshëm, një situatë kjo më e tmerrshme dhe më e frikshme se sa vetë udhëtimi, në qoftë se ti do ta kishe atë gjë, atëherë deklaroje! Përndryshe, hesht dhe lëre Kuranin të thotë atë çfarë ai thotë:

فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا وَلَا يَغُرَّنَّكُمُ بِاللَّهِ الْغُرُورُ

"...Atëherë, le të mos ju gënjejë ju kjo jetë e dynjasë, as të mos ju mashtrojë i pari i mashtruesve (shejtani) për Allahun..."¹⁴³

Askush nuk të ndjek ty përveç atyre të dehur me verën e politikës ose të pasionit për famë, ose ambicia për t'u lavdëruar, ose preferencat etnike apo fisnore, ose filozofia ateiste apo shthurja moderne. Por, goditjet e dhëna kundra njeriut, shuplakat e tmerrshme që ai i merr në

¹⁴³Kur'an, 31:33

fytyrë, do ta sjellin atë në vete. Ndryshe nga një kafshë, njeriu nuk vuan vetëm për dhimbjet e kohës së tashme, por përveç dhimbjeve të së tashmes, shqetësimet për të ardhmen dhe brengat për të shkuarën gjithashtu e godasin atë në kokë.

Në qoftë se nuk dëshiron të mbetesh më i mjeri i të gjitha kafshëve dhe më idioti dhe më i çudhëzuari i tyre, rri i heshtur dhe vëri veshin besimit për sihariqet e Kuranit.

أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفَ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ ۚ
 الَّذِينَ آمَنُوا وَكَانُوا يَتَّقُونَ ۚ لَهُمُ الْبُشْرَىٰ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ ،
 لَا تَبْدِيلَ لِكَلِمَاتِ اللَّهِ ذَلِكَ هُوَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ۚ

“Padyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut). Ata i pret lajmi i mirë në këtë jetë dhe në tjetrën. S’ka ndryshim në fjalët e Allahut; kjo është fitorja madhështore”¹⁴⁴

¹⁴⁴Kur’an, 10:62 – 4

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 وَالتَّيْنِ وَالزَّيْتُونِ ۚ وَطُورِ سَيْنِينَ ۚ وَهَذَا الْبَلَدِ الْأَمِينِ ۚ
 لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ ۚ ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ سَافِلِينَ
 إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ ۚ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

“Për fikun dhe ullirin, për malin e Sinait, dhe për këtë qytet të sigurtë (Mekën); në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.

Pastaj e çuam atë (kur nuk beson) në gjendjen më të ulët, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira; ata do të kenë shpërblime të pandërprera.

Atëherë, çfarë të shtyn ty (o njeri) që ta mohosh Ditën e Kijametit?

A nuk është Allahu Gjykatësi më i Drejtë?!”¹⁴⁵

Mësoje, o shok! Qëndrueshmëria e mjeshtërisë artistike në çdo gjë dhe plotësia e saj tregon për faktin se Autori i të gjitha gjërave është i pranishëm dhe afër të gjitha gjërave, ndërsa Ai në të njëjtën kohë nuk përfshihet nga hapësira. Për shkak të nevojës së njeriut për të gjitha gjërat, prej më të vogëlës për tek më e madhja, nuk i përshtatet atij të adhurojë asgjë dhe askënd përveç Atij, në Dorën e të Cilit është dominimi i të gjitha gjërave dhe me të Cilin janë thesaret e të gjitha gjërave. Për sa ka të bëjë me ekzistencën, shpikjen dhe bërjen e të mirës, nefs i njeriut ka një qenie shumë të pafuqishme e të mangët, më të pafuqishme se sa një milingonë apo një bletë dhe më të dobët se një merimangë dhe se një mushkonjë. Kurse, për sa ka të bëjë me shkatërrimin dhe keqbërjen, nefs i njeriut është më i madh se qiejt, toka dhe malet. Për shembull, kur ai bën të mirën, ai mund ta bëjë atë brenda arritjes së dorës së tij, ndërsa e keqja që ai bën mund të ketë një ndikim shumë të madh e të largët.

E keqja e mohimit të Krijuesit do të thotë dënim i tërësisë së universit ose i të gjitha krijesave duke zbritur vlerën e të qënurit mesazhe të Zotit dhe pasqyrat e Hyjnisë në qënien gjëra që përbëhen

¹⁴⁵Kur’an, 97:1 – 8

vetëm në gjëra të ndryshueshme që zhduken e ndahen shpejt me të cilat rastësia luan në mënyrë të kotë. Me këtë të keqe, njeriu mund të zvogëlohet prej qënies një pjesë poezie harmonike e mirëkompozuar duke shfaqur manifestimet e Emrave Hyjnorë, dhe një bërthamë e një peme të përhershme e të qëndrueshme, dhe një kalif i Zotit në tokë, superior mbi më të madhen e krijesave në sajë të mbajtjes së amanetit më të madh, zvogëlohet e zbret tek shkalla më e ulët e të qënurit më i ulëti i qënieve kalimtare dhe më i pafuqishmi dhe më i mjeri i tyre. Gjithashtu, për sa ka të bëjë me egon e tij, njeriu ka një vullnet të lirë aq të dobët sa një qime floku, me një kapacitet shumë të pakët, të zbehtë dhe jetëshkurtër, si një shkretimë e largët drite dhe me një ekzistencë të dobët e shumë të kufizuar. Kurse, për sa ka të bëjë pafuqinë dhe varfërinë e tij, ai ka një kapacitet aq të madh sa që ai mund të jetë një pasqyrë e gjërë për manifestimet e të Gjithëfuqishmit pafundësisht dhe të Pasurit përjetësisht.

Përsëri, njeriu për sa ka të bëjë me jetën materiale e shtazore të kësaj bote, pavarësisht qënies së tij si një bërthamë e pajisur me aparate të panumërta për t'u rritur në një pemë duke u shpërndarë lart në të gjitha qoshet e hapësirës, ai zvogëlohet duke zbritur tek qënia duke u përpjekur e luftuar, si një pulë duke gërvishtur tokën për të gjetur ca substanca kryesore, dhe pastaj për t'u tretur në dhé. Por, për sa ka të bëjë me jetën e tij jomateriale, ai është si një pemë e përjetshme me degët e dëshirës duke u shtrirë drejt përjetësisë.

Përsëri, për sa ka të bëjë me punën dhe përpjekjet e tij, njeriu është një kafshë e dobët dhe e pafuqishme, duke pasë një sferë me një rreze veprimi aq të shkurtër sa arritja e dorës së tij. Por, lidhur me lutjen, faljen dhe përgjërimin, ai është një mysafir i nderuar i të Gjithëmëshirshmit, i Cili ka hapur për të thesaret e mëshirës së Tij dhe ia ka nënshtruar atij të gjitha çudirat e artit të Tij dhe ka një sferë të gjërë që shtrihet deri ku shkojnë sytë, madje deri ku arrin imagjinata e tij, madje akoma më e gjërë se ajo.

Përsëri, për sa ka të bëjë me kënaqësitë e jetës së tij shtazore, plotësisë së saj, qetësisë dhe stabilitetit, njeriu është më i ulët se një trumcak, sepse kënaqësitë e tij mbulojnë nga brengat e së shkuarës dhe nga shqetësimet për të ardhmen. Ndërsa, për sa ka të bëjë me aparatet që i janë dhënë atij dhe me shumëllojshmëritë e shqisave dhe të ndjenjave, dhe me kapacitetin zhvillues të potencialeve të tij dhe me

detyrat e tij kryesore në jetë është se ai duhet t'i vëzhgojë të gjitha krijesat në mënyrë reflektuese, medituese e shqyrtuese, dhe të dëshmojë tesbihatet e tyre për Zotin. Ai gjithashtu duhet t'i lutet Zotit për nevojat e tij dhe ta adhurojë Atë me një perceptim e njohje të pafuqisë, varfërisë dhe mangësive të veta – njeriut. Ndërsa për sa ka të bëjë me natyrën e tij aq gjithëpërfshirëse, saqë ai mund të adhurojë Krijuesin e tij në shumë mënyra, ai është shumë herë më superior mbi të gjitha krijesat e tjera.

Një njeri me mend duhet të konkludojë se të gjitha ato aparate i janë dhënë atij për një jetë të përjetshme, dhe jo për këtë jetë kalimtare. Për shembull, në qoftë se vështruar se një njeri i kishte dhënë njërit prej shërbëtorëve të tij dhjetë lira flori që të blinte vetë një veshje prej një materiali të veçantë, ne do të konkludonim se një mijë lira flori nuk iu dhanë shërbëtorit të dytë për të blerë një veshje prej të njëjtit material ashtu siç e bleu i pari. Materiali –stofi– të cilin shërbëtori i dytë duhej ta zgjidhte është njëqind herë më i çmueshëm dhe më i shtrenjtë se tjetri. Në qoftë se, pavarësisht kësaj, për shkak të marrëzisë së tij, ai shërbëtor bleu një veshje prej të njëjtit material stofi ashtu siç e kishte blerë shërbëtori i parë, ai sigurisht që do të dënohej me dënim të ashpër e të gjatë.

Pavarësisht, ose për shkak të mungesës së forcës dhe fuqisë së tij, njeriu është shumë herë më i fortë dhe më i fuqishëm se qëniet e tjera të gjalla; sepse nëpërmjet lutjes së tij dhe kërkesës për ndihmë, atij i nënshtrohet ajo çfarë ai nuk do të mund të arrinte as pjesën më të vogël të saj me fuqinë e tij. Ashtu si një i mitur, që arrin nëpërmjet qarjes së tij atë çfarë ai nuk mund ta arrijë me një fuqi një mijë herë më të madhe se të tijën; ai fiton epërsi mbi të gjitha qëniet e tjera me jetë nëpërmjet krijesave të tjera duke iu nënshtruar atij, dhe jo nëpërmjet fuqisë së tij të pandihmuar, zaptimit, mposhtjes dhe tërheqjes. Prandaj, ai duhet të shpallë pafuqinë e tij, dobësinë, varfërinë dhe skamjen e tij dhe të kërkojë ndihmën e Zotit, të përgjërohet, të lutet dhe bëjë adhurime.

Në sajë të vëzhgimit të bukurive të plotësive të Sovranitetit të Hyjnisë të lajmëtarit të çudirave të manifestimeve të Emrave të tyre të shenjtë, të perceptimit dhe të kuptuarit të përmbajtjeve të thesareve të mëshirës së Tij, të njohjes së xhevahirëve të depozituar në thesaret e Emrave të manifestuar, të sundimit dhe reflektimit rreth mesazheve të

Penës së Fuqisë dhe të përmallimit për të parë hollësitë e krijesave të Tij, njeriu është më i nderuari i krijimit dhe kalifi i tokës.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ ... فَفِرُّوا إِلَى اللَّهِ ...

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për Allahun...”¹⁴⁶

“Andaj, ikni drejt Allahut...”¹⁴⁷

Mësoje, o Said i paaftë, i pafuqishëm dhe i varfër! Për sa ka të bëjë me nefsin tënd, ti ke një mangësi të vazhdueshme, një pafuqi të pakufishme, ke një varfëri të pafundme, nevoja të pakufishme dhe dëshira të panumërta. Ashtu siç jepet uria dhe etja me qëllim që të njohë kënaqësinë e mirësive të të Gjithëmëshirshmit, po ashtu ti je i ngarkuar me paftësi, varfëri, pafuqi dhe nevojë me qëllim që nëpërmjet teleskopit të mangësive të tua, ti duhet të shikosh veprat e larta të plotësisë së të Gjithëlavdishmit, dhe duke përdorur varfërinë tënde si një masë, ti duhet të shikosh shkallët e pasurisë dhe të mëshirës së Tij; dhe nëpërmjet peshës së pafuqisë tënde të shikosh fuqinë dhe madhërinë e Tij; dhe prej shumëllojshmërisë së nevojave të tua të shikosh mirësitë dhe favoret e Tij.

Qëllimi për krijimin tënd është robëria ndaj Zotit, që do të thotë të deklarojsh para derës së mëshirës së Tij mangësitë e tua me *أَسْتَغْفِرُ اللَّهَ* “*Estagfirullah*” dhe *سُبْحَانَ اللَّهِ* “*Subhanallah*”; të deklarojsh varfërinë tënde me *حَسْبُنَا اللَّهُ* “*Hasbunallah*” dhe me *الْحَمْدُ لِلَّهِ* “*Elhamdulillah*” dhe duke iu lutur Atij; dhe pafuqinë tënde me *لَا حَوْلَ وَلَا قُوَّةَ إِلَّا بِاللَّهِ* “*la haule vela kuvvete il –la bil –lah*” dhe me *اللَّهُ أَكْبَرُ* “*Allahu Ekber*” dhe duke i kërkuar ndihmë. Kështu bukuria dhe hijeshia e Hyjnisë shihen në pasqyrën e robërisë – adhurueshmërisë– tënde.

¹⁴⁶Kur’an, 35:15

¹⁴⁷Kur’an, 51:50

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 إِنَّ الْأَبْرَارَ لَفِي نَعِيمٍ وَإِنَّ الْفُجَّارَ لَفِي جَحِيمٍ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

“Vërtet punëdrejtët do të jenë në Xhennet, kurse fajtorët, me siguri do të jenë në zjarrin flakërues”¹⁴⁸

Mësoje, o Said i pakujdesshëm! Gjithkush ka në udhëtimin e jetës së tij dy rrugë për tek varri. Ato dy rrugë janë të barabarta në gjatësi, por njëra prej tyre është e padëmshme; në të ka dobi të mëdhaja siç dëshmohet nga njerëzit e intuitës dhe të dallueshmërisë. Nëntë prej dhjetë atyre të cilët e ndjekin atë rrugë e fitojnë atë dobi. Sa për rrugën tjetër, ndërsa nuk ka asnjë dobi në të, ndodhet një dëm i madh, ashtu siç ka pajtueshmëri mendimi nga njerëzit e intuitës dhe të përjetimit dhe të njohjes fetare. Ajo është nëntëdhjetë e nëntë përqind e dëmshme, ndonëse ai që e ndjek, ndryshe nga ata që ndjekin rrugën tjetër, nuk duhet të mbajë ndonjë armë apo ushqim. Në dukje, ai nuk ka asnjë peshë, asgjë për të mbajtur. Por, ndodhet, mbi shpinën e zemrës së tij një peshë njëqind herë më e rëndë, dhe mbi shpatullat e shpirtit të tij pesha e frikësimeve dhe tmerre. Shëmbëlltyra vijuese do ta bëjë të perceptueshme për ty atë çfarë është e konceptueshme ose abstrakte:

Për shembull, ti dëshiron të shkosh në Stamboll ose dikush të dërgon ty atje. Ndodhen dy rrugë që të çojnë ty atje, njëra në të djathtë, tjetra në të majtë, të dyja duke qenë prej të njëjtës gjatësi, por të ndryshme nga njëra–tjetra, për sa ka të bëjë me dobinë dhe dëmin në to dhe me lehtësinë ose vështirësinë në ndjekjen e tyre. Njerëzit e intuitës, të vëzhgimit dhe të eksperiencës së mjaftueshme kanë pajtueshmëri mendimi se në rrugën nga e djathta ndodhet një dobi shumë e madhe, pa asnjë lloj dëmi, por atyre që e zgjedhin atë për ta ndjekur u kërkohet të mbajnë një armë dhe ushqimet, por ama ata bëhen të lehtësuar prej çdo peshe në zemrat dhe në shpirtërat e tyre, duke mos pasë frikë prej të qënurit të obliguar ndaj të tjerëve (për përbushjen e nevojave të tyre), një peshë kjo aq e rëndë sa malet.

Në kontrast, ashtu siç e dëshmojnë miliona njerëz të eksperiencës dhe të njohjes fetare, nuk ka asnjë dobi në rrugën e majtë, ndonëse në

¹⁴⁸Kur’an, 82:13 – 14

dukje ata që e ndjekin nuk kanë asnjë peshë për të mbajtur, as me armë, as me pajime dhe as me ushqime. Por pesha mbi shpatullat e shpirtit të tyre për shkak të frikës që ata vuajnë dhe mbi shpinën e zemrave të tyre për shkak të frikës së shkaktuar prej qënies të obliguar ndaj të tjerëve për plotësimin e nevojave të tyre është një mijë herë më e rëndë se sa mbajtja e armës dhe e ushqimeve. Ata që ose e kanë plotësuar të gjithë udhëtimin e tyre, ose kanë dëshmuar se me çfarë përballen udhëtarët gjatë dhe pas udhëtimit të tyre, na informojnë ne se ata që ndjekin rrugën nga e djathta udhëtojnë me siguri dhe duke arritur destinacionin e tyre, nëntë prej dhjetë prej tyre janë të mirëpritur me shpërblim të madh. Ndërsa, ata që ndjekin të majtën, rrugën e rrezikshme, vuajnë shumë frikë dhe uri gjatë udhëtimit, dhe për shkak të frikës dhe nevojës, ata duhet të përkulen me poshtërim përpara gjithçkaje ose gjithkujt. Kur arrijnë destinacionin e tyre, ata ose thirren për të dhënë llogari për udhëtimin e tyre, ose vriten, dhe vetëm një, tek e shumta dy prej dhjetë vetave mund të shpëtojnë. Një njeri me mend nuk do të zgjidhte atë çfarë është e dëmshme për hir të mospasjes për të mbajtur asnjë peshë. Si do të ishte e mundur që diçka nëntëdhjetë e nëntë përqind e dëmshme të preferohet mbi atë që është nëntëdhjetë e nëntë përqind me një dobi të madhe?

Sa për udhëtarin, ai je ti. Ndërsa Stambolli është Berzahu –bota e ndërmjetme e varrit– dhe Ahireti. Rruga e djathtë është rruga e Kuranit që kërkon pesë namazet e detyruar për t’u kryer çdo ditë pasi –njeriu– të ketë besuar. Rruga e majtë është rruga e njerëzve të shthurjes dhe të mosbindjes. Njerëzit e intuitës, të përvojës dhe të dallimit janë Evlijatë që përjetojnë atë çfarë beson një njeri i zakonshëm. Sa për armën dhe ushqimet, ato janë obligimet fetare duke përfshirë pesë namazet e detyruar të përditshëm që përfshijnë vërtetimin e Unitetit Hyjnor, i Cili me rradhë, përfshin pasjen e pikave të mbështetjes në Zot dhe kërkimin ndihmë Atij, që do të thotë vendosjen e besimit tek i Gjithëfuqishmi, Gjithëruajtësi dhe i Gjithëdituri dhe tek i Pasuri Absolut, Gjithëbujari dhe Mëshirëploti. Ata që ndjekin rrugën e Kuranit shpëtojnë prej përkuljes në poshtërim para çfarëdo ose kujtdo që ata shpresojnë se mund t’u bëjnë dobi ose dëm. Sepse bindja se لا إله إلا الله “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut”, do të thotë se askush përveç Atij ose përveç se me lejen e Tij nuk është në gjendje të bëjë dëm e dobi.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 إِنَّمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا لَعِبٌ وَ لَهْوٌ ۗ وَإِنَّ الدَّارَ الْآخِرَةَ لَهِيَ الْحَيَوَانُ

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

“Jeta e kësaj bote nuk është tjetër veçse argëtim e lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë, veç sikur ta dinin”¹⁴⁹

Mësoje, o Said udhëtues drejt pleqërisë, drejt varrit, drejt ringjalljes dhe drejt përjetësisë! Pronari yt ta dha ty jetën e kësaj bote që të sigurosh domosdoshmëritë e të dyja jetëve, secila në përputhje me gjatësinë e saj. Por, ti e ke shpenzuar të gjithë atë në këtë jetë kalimtare, e cila është vetëm si një pikë mirazhi e krahasuar me një oqean. Në qoftë se do të ishe me mend, shpenzoje gjysmën ose një të tretën e saj për jetën e përhershme. Dhe megjithatë, sa e çuditshme është që ata idiotë si ti quhen inteligjentë dhe të ditur!

Për shembull, a do të mund të ndodhej dikush më idiot se sa ky shërbëtor? Pronari i tij i jep atij njëzet e katër lira floriri dhe e dërgon atë prej Burduri në Antalya¹⁵⁰ dhe prej aty në Damask, Medine dhe Jemen. Ai e urdhëron atë t'i shpenzojë lirat e floririt për të blerë çfarë është e nevojshme gjatë udhëtimit. Ai e lejon atë të shkojë në Antalya sido që ai dëshiron, qoftë në këmbë apo me mjet, por pas Antalyas ai duhet të vazhdojë rrugën e tij me mjet. Në qoftë se ai blen një biletë, ai mund të udhëtojë me anije ose me tren, ose nga ajri dhe do të arrijë në çdo qytet brenda një dite; në qoftë se nuk ka biletë, ai duhet të udhëtojë vetëm me vështirësi të mëdha. Megjithatë, ai udhëtar idiot i shpenzoi njëzet e tre lirat prej floriri për dy ditë. Atij iu tha: “Të paktën shpenzoje atë që të ka mbetur për të blerë gjërat e domosdoshme të udhëtimit tënd. Në qoftë se ti e bën atë, Pronari yt mund të të mëshirojë”. Por ai u përgjigj: “Unë nuk do ta shpenzoj atë mbi diçka e cila ndoshta nuk sjell asnjë dobi”. Atëherë, atij iu tha: “Sa idiot që je! Arsyeya jote të lejon që ta veçoje gjysmën e pasurisë tënde për ta shpenzuar në një llotari në të cilën marrin pjesë një mijë njerëz dhe si rrjedhojë marrin një rrezik të madh për hir të një shorti ku mundësia e të cilit është një në një mijë. Përsëri, arsyeya jote nuk ta lejon ty ta vësh

¹⁴⁹Kur'an, 29:64

¹⁵⁰Provinca në Turqinë jugore.

menjanë njërën prej njëzet e katër pjesëve të pasurisë tënde për hir të një shorti me mundësinë nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë prej një mijë mundësish, siç dëshmohet prej miliona njerëzve të përvojës dhe me njohuri të dëshmuar. Ndërsa ti pranon lajmet ose informacionin që të jep një njeri i zakonshëm rreth një dobie të mundshme materiale që ti të mund t’i fitosh, përse nuk do të pranoje sihariqet e dhëna prej diejve dhe yjeve të njerëzimit? Për më tepër, dy njerëz duke konfirmuar diçka preferohen mbi mijëra të cilët e mohojnë apo e hedhin poshtë atë. Për shembull, dëshmia e dy burrave që kanë parë lindjen e Hënës së Re të muajit të Ramazanit preferohen mbi mijëra të tjerë të cilët e mohojnë shfaqjen e saj”.

Udhëtari në krahasim je ti. Burduri është bota jote. Antalya është varri. Damasku është bota e ndërmjetme midis kësaj bote dhe tjetrës. Sa për Jemenin, ai nënkupton botërat pas Ringjalljes. Njëzet e katër lirat e florinjta janë njëzet e katër orët e ditë–natës. Ti i shpenzon njëzet e tre orë prej tyre në çështjet e jetës kalimtare, por tregon dembeli kur të vjen puna për të shpenzuar vetëm njërën prej njëzet e katër orëve në kryerjen e pesë vakteve të detyruara, të cilat do të shërbejnë si ushqimi më esencjal gjatë udhëtimit të gjatë.

Ky krahasim shpjegon njërin prej vërseteve:

وَبُرَزَتِ الْجَحِيمِ لِلْغَاوِينَ وَأُزْلِفَتِ الْجَنَّةُ لِلْمُتَّقِينَ

“Atë Ditë Xhenneti do t’u afrohet besimtarëve të devotshëm, ndërsa Xhehennemi do t’u tregohet atyre që kishin humbur.”¹⁵¹

Mësoje, o i pakujdesshëm që e ke braktisur jetën fetare për hir të dobive të kësaj bote! Unë do të të flas ty në një shëmbëlltysë që përmban të vërteta që lidhen edhe me dynjanë, edhe me jetën fetare.

Njëherë ishin dy vëllezër, njëri i diplomuar mirë dhe me sjellje të mira, ndërsa tjetri me sjellje të këqija. Ata u nisën për një udhëtim dhe pas një kohe ata erdhën tek një bigëzim ku rruga ndahej në dy drejtime. Drejtimi nga e djathta kërkonte zbatimin e detyrueshëm të ligjit që sundonte atë rrugë, ndërsa drejtimi nga e majta premonte ndonjë lloj lirie, pa ndonjë detyrim.

¹⁵¹Kur’an, 26:90–91

Vëllai i mirëdisiplinuar ndoqi drejtimin nga ana e djathtë, duke pranuar varësinë nga ligji dhe rregulli. Kurse vëllai me sjellje të këqija mori drejtimin nga e majta, pa ndërmarrë ndonjë detyrim. Ai u drejtua për nga veriu dhe arriti në një shkretëtirë. Papritmas, ai dëgjoi një zë të frikshëm dhe shikoi një luan gati për ta sulmuar. Ndërkohë ai iku dhe rastisi të ndeshte një pus pa ujë, gjashtëdhjetë metra i thellë dhe u hodh në të. Ai ra poshtë tridhjetë metra dhe ndërkohë duart e tij hasën në një pemë që rritej në muret e tij. Pema kishte dy rrënjë. Dy minj, njëri i bardhë dhe tjetri i zi po i brenin ato. Njeriu hodhi shikimin lart dhe pa se luani po e priste në krye të pusit. Ndërkohë, ai hodhi vështrimin poshtë dhe pa një kuçedër të tmerrshme gati tek këmbët e tij, me gojën e saj aq të madhe sa gryka e pusit, me gojë të hapur për ta marrë atë. Kur ai shikoi përreth vetes, pa insekte të dëmshme gjithandej. Pastaj, ai e soditi përsëri pemën. Ajo ishte në fakt një pemë fiku, por ajo kishte prodhuar një shumëllojshmëri të madhe frutash. Aty, duke qenë i varur në pus, ai ishte shumë i frikësuar. Por, ishte i dëshpëruar nga brenda rreth kësaj situatë, dhe shpirti, dhe zemra e tij po rënkonin. Nën influencën e nefsit urdhërues për të liga, ai pretendoi për veten se ai ishte në një kopësht dhe filloi të hante prej frutave. Siç u deklarua në një hadith Kudsî¹⁵²:

أَنَا عِنْدَ ظَنِّ عَبْدِي بِي

“Unë e trajtoj shërbëtorin Tim në mënyrën si ai mendon për Mua”¹⁵³

Ky njeri i mjerë qëndroi në pus në këtë gjendje të tmerrshme. Ai nuk vdiq, por as nuk jetoi mirë. Dhe për shkak të mungesës së tij të të kuptuarit, ai nuk e perceptoi se nuk do të mund të kishte pasë asnjë rastësi në ato çështje.

Duke e lënë atë njeri të mjerë në torturën që ai vuajti, le të ndjekim vëllain fatlum e të matur. Duke qenë njeri me sjellje të mira, i cili gjithmonë mendonte për mirë, shiko se si ai përfitoi dobi prej aty ku vëllai i tij nuk mori asnjë dobi. Ai rastisi të hynte në një kopësht dhe krahas luleve të këndshme dhe tërheqëse, ai hasi edhe gjëra të rrënuara e të shëmtuara në të. Ai e preokupoj vetveten me atë çfarë ishte e mirë

¹⁵²Thënie prej profetit, ku fjalët janë të profetit, por kuptimi i përket Allahut.

¹⁵³Transmetojnë Muslimi, Tirmidhi etj.

dhe e bukur, dhe si rrjedhojë gjeti lehtësi dhe në përgjithësi që i lumtur me gjithçka. Duke pasë vazhduar në këtë rrugë, ai njeri gjithashtu arriti në një shkretëtirë dhe dëgjoji zërin e një luani, i cili gati po e sulmonte. Ai gjithashtu u frikësua, por jo aq shumë sa vëllai i tij, për shkak se ai mendoi se luani duhet të ishte në shërbim të sunduesit të shkretëtirës. Ky njeri i disiplinuar iku e u hodh poshtë në një pus gjashtëdhjetë metër të thellë që ndodhi të ishte atje, dhe me rënien poshtë në gjysmën e pusit u kap pas një peme që kishte dy rrënjë. Ai gjithashtu shikoi dy minj duke brejtur rrënjët e pemës. Duke vështruar poshtë, ai shikoi një kuçedër gati për tek këmbët e tij me një gojë aq të gjërë sa gryka e pusit. Ai gjithashtu u frikësua, por shumë më pak se i vëllai, sepse duke qenë i zgjuar dhe i mirëdisiplinuar, ai nënkuptoi se ato ndodhi të çuditshme organizoheshin nga dikush dhe përbënin një shenjë. Ai mendoi se, ai që duhet t'i ketë organizuar të gjitha ato gjëra po e testonte atë. Frika e tij u kthye në kureshtje rreth njohjes së atij, i cili e kishte bërë vetveten të njohur nga të gjitha ato gjëra. Pastaj, kurioziteti i tij ngjalli tek ai një dashuri për pronarin e shenjave. Duke e parë pemën e fikut që përmbante një shumëllojshmëri frutash, frika e tij u zhduk plotësisht, sepse ai ariti të kuptojë se të gjitha ato gjëra ishin për një qëllim. Në qoftë se nuk do të ishte kështu, atëherë pema e fikut nuk do të mund të mbante frutat e pemëve të tjera. Ato duhej të kishin qenë ushqimet që sundimtari i shkretëtirës i kishte përgatitur për mysafirët e tij. Dashuria e tij për të ngjalli tek njeriu dëshirën për të zbuluar se çfarë shprehnin shenjat e tij dhe çelësin për kuptimin e shenjave të inspiruara tek ai. Ai thirri: “Unë i kam braktisur të gjitha gjërat e tjera për hirin Tënd dhe jam mbështetur tek Ti”. Duke ndjekur atë thirrje, muri i pusit papritmas u nda, dhe një derë u hap nga një kopësht i këndshëm e i mrekullueshëm. Ai pa se kuçedra dhe egërsira u shndërruan në dy shërbëtorë duke e ftuar atë të hynte në të.

Tani, krahasoju pozitat e këtyre dy vëllezërve: Njëri është gati duke rënë në gojën e kuçedrës, ndërsa tjetrit i bëhet ftesa për të hyrë në një kopësht të ndritshëm plot lule e fruta. I pari është tmerrësisht i shqetësuar dhe vuan frikën duke shpërthyer prej thellësisë së zemrës së tij. I dyti studion çfarë ai shikon dhe frika e tij i jep shkas dashurisë, respektit dhe njohjes. I pari është në vetmi, dëshpërim e trishtim, ndërsa i dyti e sheh vetveten në një situatë miqësore dhe është në shpresë e pritshmëri. I pari është shënjestër e sulmeve të armiqve të tmerrshëm, ndërsa i dyti është i mirëpritur dhe i shërbehet si një mysafir. I pari e shton dëshpërimin e tij duke ngrënë në dukje fruta të shijshme, por në

të vërtetë ato janë fruta helmues të cilët paraqiten vetëm si modele, që nuk synohet të konsumohen për hir të tyre, por për t'i bindur klientët për to; ndërsa i dyti e shtyn për më vonë ngrënien e tyre dhe e gëzon pritja.

Tani, ne mund ta interpretojmë shëmbëlltyrën: Njëri nga vëllezërit është shpirti i një besimtari dhe zemra e një të drejti, kurse tjetri është shpirti i një mosbesimtari dhe zemra e një të pabinduri gjynahqar. Prej dy rrugëve, ajo nga e djathta është rruga e Kuranit dhe e besimit, kurse tjetra është rruga e mosbesimit dhe e mosbindjes. Shkretëtira është dynjaja, luani që u shndërrua papritmas është vdekja, dhe gjashtëdhjetë metra thellësi është jetëgjatësia jonë mesatare duke u korresponduar gjashtëdhjetë viteve. Pema në pus është vetë jeta, dy minjtë duke brejtur rrënjët e saj janë dita e nata. Kuçedra në pus është varri i hapur, duke u hapur nga Ahireti. Insektet në muret e pusit janë shqetësimet e telashet që njerëzit përballen në këtë botë. Dhe frutat në pemë janë mirësitë e kësaj bote të paraqitura si modele prej bekimeve të Ahiretit, duke u bërë ftesë klientëve për tek frutat e parajsës. Helmuesit midis atyre frutave janë ato të ndaluarat. Sa për shenjën, ajo është urtësia në krijim dhe çelësi është: Allahu, nuk ka zot tjetër përveç Atij, i Gjalli i Përjetshëm, Vetekzistuesi i Përherëshëm, domethënë, o Zot, Ti je i Adhuruari im, dhe kënaqësia Jote është synimi im në jetë, *La ilahe il-lallah*. Ndryshimi i gojës së kuçedrës në një derë për tek një kopsht nënkupton se varri është dera për tek mëshira e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm në kopështin për njerëzit e Kuranit dhe të besimit. Por, për njerëzit e çudhëzimit dhe të mosbindjes, varri është dera për tek gropat e errëta të vetmisë dhe të tmerrit në botën e ndërmjetme, e cila është si një burg, si barku i kuçedrës. Luani i uritur ndryshoi në një kalë të disiplinuar e të shtruar, kjo do të thotë se për të çudhëzuarit, vdekja është një ndarje e përjetshme prej të dashurve, dhe një dëbim prej parajës së tyre të rreme të dynjasë për në burgun e varrit fillikat. Për të udhëzuarit drejtë, në kontrast, ajo është një mjet bashkimi me miqtë dhe shokët dhe rikthim tek atdheu i tyre; është një dalje prej burgut të dynjasë për tek kopshtet e përjetshme për të marrë shpërblimin për shërbimet e bëra ndërsa ishin në dynja, shpërblim që do t'u jepet prej mirësisë së të Dhembshurit, Dorëgjërit, Shpaguesit dhe të Gjithëlavdishmit, Xhel-le Xhelaluhu ve la ilahe Gajruhu, madhështia e Tij goftë e lartësuar dhe nuk ka zot tjetër përveç Tij.

Mësoje, o Said mburracak, që dëshiron të lavdërohesh madje edhe për atë çfarë nuk e ke bërë! Ti nuk ke të drejtë të mburresh dhe as të krenohesh. Sepse nefsi yt është origjina e të këqijave dhe e mangësive. Në qoftë se ndodhet ndonjë e mirë në veten tënde, ajo e mirë është e pjesshme ashtu si pjesa jote e vullnetit të lirë. Por vullneti yt i lirë shkakton të këqija shumë të mëdhaja. Meqenëse mangësitë e tua u shkaktojnë frutave të destinuara për ty të bien, ti meriton humbje të mëdhaja dhe turp.

Shembulli yt është si ai i një idioti mburracak, i cili ka hyrë në një partneritet tregtar me një grup në një anije. Ndërsa të gjithë të tjerët bëjnë detyrat e tyre, ai neglizhoi të bëjë detyrën e tij, e cila ishte të kthejë timonin, rrotën drejtuese. Si rrjedhojë, anija mbytet dhe ata humbën një mijë lira. Ata i thanë se ai duhet t'ua kompensojë atyre të gjithë humbjen, por ai përgjigjet: “Jo! Përkundrazi, ne duhet ta ndajmë humbjen midis nesh”. Pastaj, ata u nisën në një udhëtim tjetër dhe këtë herë fituan një mijë lira floriri. Ata i thanë atij se ata duhej ta ndanin fitimin sipas kapitalit të secilit. Por, personi u përgjigj: “Jo! Përkundrazi, i gjithë fitimi më takon mua. A nuk ma atribuuar ju më parë të gjithë humbjen mua? Tani i gjithë fitimi më takon mua”. Ata i thonë: “O injorant! Ekzistenca e diçkaje varet nga ekzistenca e të gjitha pjesëve të saj dhe nga prania e të gjitha kushteve të domosdoshme për ekzistencën e saj. Kjo është arsyeja pse frutat e ekzistencës ndahen midis përbërësve të saj. Fitimi është diçka që ka një ekzistencë të ndjeshme pozitive. Ndërsa humbje do të thotë ‘mosekzistencë’ dhe diçka ekzistuese mund të shkojë në mosekzistencë nga shkatërrimi i një pjese të veçantë të saj ose nga mosprania e njëres prej kushteve për mbajtjen, mbështetjen e saj”.

O ti Said me emër por mjeran! O ti që emri yt do të thotë i begatuar, i bekuar, por që në të vërtetë je i mjerë! Ai që i shkakton diçkaje të shkojë në mosekzistencë është përgjegjës për pasojat e saj. Prandaj, ti nuk ke të drejtë të mburresh e të jesh krenar.

Para së gjithash, e keqja është prej teje, kurse e mira është prej Zotit tënd.

Së dyti, e keqja jote është e madhe dhe e përhapur gjërësisht, kurse e mira jote është e vogël dhe e kufizuar.

Së treti, ti e ke marrë rrogën për veprat e tua të mira që më parë se sa ti kryeje t'i ato. Të gjitha veprat e mira për të cilat je në gjendje t'i bësh gjatë gjithë jetës tënde nuk mjaftojnë për të paguar madje as një të biliontën e bekimit të qënies tënde i bërë një musliman. Që je bërë kështu, ti duhet ta kuptosh se Parajsa është thjesht nga mirësia e Tij xh.sh, dhe Ferri është thjesht drejtësi. Sepse edhe akti më i vogël i njeriut mund të shkaktojë një shkatërrim global.

Së katërti, diçka bëhet e mirë në goftë se bëhet për hir të Allahut dhe është vetëm Ai i Cili shkakton diçka të synuar për t'u bërë për hir të Tij të arrihet. Si rrjedhojë, gjithkush është borxhli ndaj Tij për veprat e mira të veta. Ajo është që ti duhet ta falënderosh Atë, pa krenari dhe jo për t'u dukur, gjë të cilat e kthejnë të mirën në të keqe. Duke qenë i pavetëdijshëm për këtë të vërtetë, ti je bërë mburravec në vetvete. Ti ua atribuon të mirën e qënieve njerëzore vetë atyre dhe si rrjedhojë i bën ata të jenë secili si një Faraon. Ti e ndan atë që i përket Zotit midis atyre që janë të pabindur ndaj Tij.

Përsëri, me qëllim që të shmangësh përgjegjësinë, ti ia atribuon të këqijat e tua kaderit, megjithëse ato burojnë prej teje. Ndërsa ti ia përshkruan vetes të mirën, të cilën Krijuesi yt e shkaktoi të dalë prej teje nëpërmjet mirësisë së Tij, dhe kërkon që të vlerësohesh për çfarë nuk ke bërë. Prandaj, dispijloje veten tënde në përputhje me udhëzimin e Kuranit, i cili deklaron:

مَا أَصَابَكَ مِنْ حَسَنَةٍ فَمِنَ اللَّهِ

“Çdo e mirë që të gjen ty, o njeri, është prej Allahut, kurse e keqja që të godet, është prej vetes tënde”¹⁵⁴

Merre atë që të përket ty dhe mos e uzurpo atë që nuk të takon. Për më tepër, dispijloje veten tënde me instruksionet e Kuranit se një e keqe rikthehet me ekuivalencën e saj, kurse një vepër e mirë rikthehet me dhjetëfish. Prandaj, mos shko në ekstreme në armiqësinë tënde ndaj atij që të ka bërë ty një të keqe dhe gjithashtu duke ndjerë armiqësi ndaj të afërmeve të tij dhe ndaj cilësive të mira që ai ka. Gjithashtu, për të njëjtën arsye, përfshi në dashurinë tënde për një njeri të mirë e të drejtë edhe të afërmit e tij dhe mos i vër re të metat e tij.

¹⁵⁴Kur'an, 4:79

Mësoje, o Said i pakujdesshëm! Ti e lë detyrën tënde dhe e preokupon veten tënde me punën e Zotit tënd. Kjo është për shkak të qënies tënde një injorant dhe i padrejtë. Ti e lë detyrën tënde të adhurimit, ndonëse ajo është e lehtë për ty për ta bërë, dhe ngarkon mbi shpinën tënde, mbi kokën dhe mbi zemrën e dobët punën e Hyjnisë, e cila mund të bëhet vetëm prej Atij;

الَّذِي خَلَقَ فَسَوَّىٰ كَفَعَدَّكَ ۗ فَبِأَيِّ صُورَةٍ مَّا شَاءَ رَكَّبَكَ

“I Cili të krijoi ty dhe të dha përmasa të rregullta dhe të harmonizoi, dhe të ka mbujtur në çfarëdo forme që ka dashur”¹⁵⁵

Mendo për punën tënde dhe lëria Atij punën e Tij, me qëllim që ti të rehatohesh dhe të lehtësohesh. Përndryshe, ti do të bëheshe një i pabindur, i mjerë dhe tradhëtar.

Situata jote është si ajo e një individi ushtarak, detyra kryesore e të cilit është bërja e stërvitjes dhe e luftës kur të jetë e nevojshme. Sundimtari i vendit e ndihmon atë me atë detyrë duke e furnizuar me pajimet e nevojshme. Detyra e sundimtarit është që t’i sigurojë ushtarit çfarëdo që i nevojitet, duke përfshirë ushqimin e tij, veshjen, armatimin dhe ilaçet. Por ndoshta ushtari mund të vihet në shërbim edhe në mjetet e kësaj detyre, veçse ama për llogari të shtetit. Kur ata e shohin atë duke gatuar ushqimin dhe e pyesin se çfarë po bën, ai përgjigjet: unë po punoj për shtetin; ai nuk thotë: unë po punoj për të përgatitur ushqimin tim; meqë ai e di se gatimi nuk përfshihet në detyrat e tij. Është detyra e shtetit ta përgatisë ushqimin e tij, madje edhe t’ia vendosë në gojën e tij në qoftë se ai nuk do të ishte në gjendje për shkak të ndonjë arsyeje të tillë si sëmundja. Duke qenë kështu, ai individ ushtarak, i cili bën tregti për të fituar mjetet e jetesës është injorant, i pabindur dhe tradhëtar dhe si rrjedhojë ai meriton ndëshkim. Një ushtar që neglizhon të kryejë stërvitjet e tij dhe dezerton fushën e betejës është një tradhëtar dhe meriton një dënim të rëndë.

O Said i mjerë! Ti je individi ushtarak dhe pesë namazet e detyruara të përditshme janë stërvitja për të cilën je i obliguar që ta bësh. Devocioni yt, duke iu shmangur gjynaheve të mëdhaja dhe duke luftuar kundra nefsit dhe shejtanit është lufta jote. Ky është qëllimi për krijimin tënd dhe Allahu është Ndhimësi, i Cili të bën ty të suksesshëm

¹⁵⁵Kur’an, 82:7–8

në luftën tënde. Sa për sigurimin e ushqimit tënd dhe të domosdoshmërive të tjera të jetës tënde, dhe mbështetjen e jetës tënde dhe jetët e familjes tënde, Krijuesi yt i ka marrë përsipër ato. Megjithatë, Ai mund të të përdorë ty në mjetet e trokitjes tek dera e thesareve të mëshirës së Tij, që t'i kërkosh Atij nëpërmjet edhe fjalës, edhe veprave. Ai të vë ty në shërbim që të ndjekësh rrugët për tek kuzhinat në të cilat piqen mirësitë e Tij, me qëllim që ti t'i kërkosh Atij me gjuhën ose të potencialit, ose të nevojës, ose të veprimit, ose të gjendjes, ose të fjalës për atë çfarë Ai ka caktuar e paracaktuar për ty. Sa injorant je ti që e akuzon Atë lidhur me mjetet e tua të jetesës, ndërkohë që Ai të siguroi me më të mirin e ushqimeve ndërsa ti ishe një fëmijë i vogël pa asnjë fuqi dhe pa aspak zgjedhje. Ai e siguron furnizimin për të gjitha krijesat, askush nuk e ndërmerri furnizimin me rëzk përveç Gjithëdëgjuesit, të Gjithditurit, të Gjithëfuqishmit dhe të Pasurit Absolut, i Cili e bën tokën në verë një kuzhinë për mysafirët e Tij për t'i derdhur bekimet e Tij duke vërshuar prej zarfave të kopshteve dhe i mbush enët e pemëve me më të shijshmin e ushqimeve. Krahas kryerjes së detyrës tënde kryesore, puno për hir të Tij dhe në Emër të tij dhe me lejen e Tij për të bërë detyrat në të cilat Ai të ka punësuar. Vendose besimin tënd tek Ai dhe thuaj:

حَسْبُنَا اللَّهُ وَ نِعْمَ الْوَكِيلُ ۞ نِعْمَ الْمَوْلَى وَ نِعْمَ النَّصِيرُ

“Allahu është i mjaftueshëm për mua dhe sa Ruajtës i mirë është Ai, dhe sa Nihmës i mirë është Ai”.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 ﴿وَإِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ أُجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا دَعَانِ﴾
 ﴿وَكَذَا ﴿أَدْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ﴾ وَكَذَا ﴿قُلْ مَا يَعْبُونَ بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا
 دُعَاؤُكُمْ﴾

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam pranë, u përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua”¹⁵⁶

“...Lutmuni Mua që Unë t’ju përgjigjem!”¹⁵⁷

“Thuaj: Zoti im nuk do t’ju përfillte, po të mos ishte lutja juaj”¹⁵⁸

Mësoje, o ti që pretendon se ti lutesh, por nuk ke përgjigje! Duaja është një lloj ibadeti, adhurimi. Fruti i adhurimit jepet në Ahiret. Ndërsa qëllimet –rezultatet– e kësaj bote që priten prej adhurimit janë kohët e atyre duave të cilat janë ibadete të posaçme. Ashtu siç është perëndimi –i diellit– koha e namazit të akshamit, dhe eklipsi –i diellit– është arsyeja –koha– për faljen e eklipseve, qëllimi për të cilin nuk është të përfundojë eklipsi, përsëri, thatësira është koha –rasti, arsyeja– për faljen e Istiskaë (falja për t’i kërkuar Zotit rënien e shiut), falje e cila nuk u urdhërua me qëllim që të binte shi, përkundrazi, ajo falje është një ibadet i bërë thjesht për kënaqësinë e mirë të Zotit, ndonëse është e domosdoshme të vazhdojë deri sa shiu të vijë. Dhe kur shiu vjen, koha e caktuar për të mbaron; po ashtu, sulmet e keqbërësve kundra muslimanëve dhe qënia e tyre të goditur nga fatkeqësitë janë raste për një lloj tjetër të veçantë lutjesh të cilat duhet të vazhdojnë aq kohë sa ato rrethana sundojnë. Në qoftë se lehtësimi prej tyre bëhet i mundur si një rezultat i lutjes, ajo do të ishte dritë mbi dritë. Në qoftë se ato vazhdojnë, nuk do të ishte e përshtatshme të thuash se lutja nuk është pranuar. Përkundrazi, ne duhet të themi se koha e lutjes nuk ka

¹⁵⁶Kur’an, 2:186

¹⁵⁷ Kur’an, 40:60

¹⁵⁸Kur’an, 22:77

mbaruar akoma. Sa për premtimin e Allahut për t'iu përgjigjur lutjes

أَدْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ *lutmuni Mua se do t'iu përgjigjem*", përgjigjja e lutjes nuk do të thotë pranim i saj dhe dhënie e asaj që u kërkua. Çdo lutje ka përgjigje, por dhënia e asaj për të cilën bëhet lutja varet nga Urtësia Hyjnore.

Për shembull, ti i thërret doktorit duke i thënë "O doktor!", ai përgjigjet "Unë jam në shërbimin tënd". Dhe ti i thua: "Më jep mua këtë ushqim ose atë ilaç". Ndërkohë, ai ose të jep atë çfarë do ti, ose atë çfarë është më e mirë se ajo, ose ai nuk do të ta jepte atë meqë është e dëmshme për shëndetin tënd. Meqenëse ne supozojmë se lutja u bë me qëllim që të arrijmë një qëllim të kësaj dynjaje, ne mendojmë se ajo nuk është pranuar kur nuk kemi qenë në gjendje ta arrijmë atë. Për shembull, ne mendojmë se falja për të rënë shi është e urdhëruar me qëllim që të mund të vijë shiu dhe si rrjedhojë e bëjmë atë për atë qëllim, dhe jo thjesht për hir të Zotit, dhe si rrjedhojë ajo nuk u pranua.

Mësoje, o shok! Revolucionet shkaktojnë një të çarë të thellë për t'u hapur midis dy anëve (në konflikt) dhe me qëllim që të kalosh prej njëres anë tek tjetra, duhet të ketë një urë midis tyre. Por, urat mund të jenë të llojeve dhe të formave të ndryshme, sipas natyrës së revolucioneve dhe të të çarave të hapura. Gjumi është një lloj ure midis kësaj bote dhe botës së simboleve ose formave jomateriale. Bota e ndërmjetme është gjithashtu një urë midis dynjasë dhe Ahiretit. Përsëri, pranvera është një urë midis dimrit dhe verës. Pas Ringjalljes, meqenëse do të ndodhin revolucione të fuqishëm të shumtë, urat e saja do të jenë tejet të çuditshme e të lakuara.

Mësoje, o shok! Në frazat e përmendura shpesh në Kuran, të tilla si:

إِلَيْهِ مَرْجِعُكُمْ ۖ وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ ۖ وَإِلَيْهِ الْمَصِيرُ ۖ وَإِلَيْهَا الْمآبِ ۖ

"...Në fund tek Ai do të ktheheni..."¹⁵⁹ "...Në fund, ju do të ktheheni tek Ai"¹⁶⁰ "...Dhe vetëm tek Ai kthehen të gjithë"¹⁶¹ "Dhe vetëm tek Ai kthehem"¹⁶²

¹⁵⁹Kur'an, 6:60

¹⁶⁰Kur'an, 2:28

¹⁶¹Kur'an, 5:18

¹⁶²Kur'an, 13:36

Përveç kërcënimeve për të pabindurit, ndodhet një sihariq i madh dhe një ngushëllim i madh. Sepse këto vërsete i thonë njerëzimit: “Vdekja, zhdukja, përkohshmëria dhe ndarja prej botës nuk janë dyer që hapen për zhdukje të përjetshme në gropat e errëta të mosekzistencës dhe të asgjësimit. Përkundrazi, ato janë dyer që hapen për shkuarje tek prania e Mbretit të Parapërdjetshëm”. Këto sihariqe – lajme të gëzueshme– e shpëtojnë zemrën prej dhimbjes së tmerrshme të menduarit e ndarjes së përjetshme prej gjithçkaje që është e dashur për të. Shiko gjendjen e lemerishme e të skëtërrshme të cilën e shkakton mosbesimi. Sipas asaj që thotë i Gjithëfuqishmi:

أَنَا عِنْدَ ظَنِّ عَبْدِي بِي “Unë e trajtoj shërbëtorin Tim në mënyrën që ai mendon për Mua”, meqenëse një mosbesimtar e konsideron vdekjen të jetë zhdukje e ndarje e përjetshme, supozimi i tij bëhet një torturë e dhimbshme për të.

Pastaj, shiko se si kënaqësia që buron prej bindjes së takimit me Zotin është më e lartë, madje edhe mbi kënaqësitë e parajsës, dhe pastaj mendo rreth kënaqësive më të mëdhaja që të jepen nëpërmjet rangut të të qenit përjetësisht i kënaqur prej Zotit, pastaj nëpërmjet shikimit të Tij xh.sh, ato janë të tilla saqë gjendja e skëtërrshme trupore e një besimtari njohës e mëkatar që e vuan është si një kënaqësi e parajsës e krahasuar me gjendjen e skëtërrshme shpirtërore të një jobesimtari i cili nuk e njej Krijuesin. Madje, edhe në qoftë se nuk do të kishte prova për jetën e përhershme dhe as mjete për ta siguruar atë, duatë, lutjet e të dashurit të të Dashurit të Parapërdjetshëm, prapa të cilit të gjithë profetët, evlijatë dhe besimtarët e tjerë qëndrojnë në rradhë në këmbë ndaj asaj falje –lutje– më të madhe, do të mjaftonin si një provë e si një mjet. A do të ishte e mundur që të gjendej në këtë bukuri më të madhe, më të jashtëzakonshme dhe më të përkryer kjo shëmti më e madhe dhe defekti më i jashtëzakonshëm, që Ai i Cili dëgjon lutjen më sekrete të më të fshehtës së krijesave të Tij për përmbushjen e nevojave të tyre dhe ua plotëson atyre, të mos dëgjojë e të mos pranojë më të lartin e zërave duke u ngritur nga toka për tek Froni më i Lartë, më të këndshmen e lutjeve dhe më gjithëpërfshirësen e duave për përmbushjen e më të madhes dhe më të ngutshmes së nevojave? Jo, kurrë! Sepse Ai është i Gjithëdituri Gjithëshikues. Pranimi nga ana e të Gjithëfuqishmit atë lutje të të dërguarit të Tij a.s.m është dimension i më i gjërë dhe më gjithëpërfshirës i shefaatit –ndërmjetësimi– të qënies së tij mëshirë për të gjitha botët.

Mësoje, o shok! Njerëzit e pakujdesshëm zakonisht diskutojnë çështjen e kaderit dhe preokupohen me vullnetin e lirë të njeriut dhe me krijimin e veprave të tij. Por, ata në mënyrë të pakujdesshme mohojnë kaderin dhe ia atribuojnë gjërat dhe ngjarjet rastësisë, duke i supozuar vetvetet të jenë veprues të pavarur dhe e ndajnë atë çfarë i përket Zotit dhe veprave të Tij midis bijve të llojit të tyre dhe shkaqeve materiale. Nefsi mohues ose i pakujdesshëm i mohon Zotit krijimin ose administrimin e gjërave dhe të ngjarjeve, madje edhe nëse ato në mënyrë të qartë e konfirmojnë Atë. Ndërsa nefsi besimtar e njohës ia atribuon Zotit të gjitha gjërat dhe ngjarjet me besim e me bindje. Këto dy çështje të teologjisë, kryesisht mohimi ose bindja dhe konfirmimi i Zotit si Krijuesi i Vërtetë dhe Administratori i të gjitha gjërave dhe i ngjarjeve, duke përfshirë të gjitha veprat e njeriut, shënojnë, sipas atyre që kanë njohje të vazhdueshme për Zotin dhe që jetojnë me vetëdije për faktin se Zoti i vëzhgon të gjithë njerëzit gjatë gjithë kohës –shënojnë– pikën përfundimtare të besimit dhe të mbështetjes tek Zoti xh.sh dhe shkallën më të lartë të besimit në Unitetin e Zotit dhe të qënies një musliman i mirë. Ato gjithashtu shërbejnë si një perde ose si një kufi ndërmjet njerëzve të vetëdijes dhe atyre të pakujdesshmërisë.

O njerëz të pakujdesshëm! Sa të larguar jeni ju prej vetëdijes dhe të kërkuarit të saj! Në qoftë se një besimtar përparon në përlulësi dhe në robëri ndaj Zotit dhe ngrihet në rangun e mohimit të vullnetit të lirë njerëzor dhe duke ia atribuar gjithçka Zotit duke përfshirë edhe veprat e njeriut, kjo është e padëmshme, meqë ai është rezultati i të qënurit i humbur ose i dehur me dashurinë Hyjnore dhe me Unitetin Hyjnor. Në këtë rast, çështja e mohimit të vullnetit të lirë të njeriut ose refuzimi dhe konfirmimi i tij nuk lidhen me teologjinë si degë e shkencave fetare; përkundrazi, ato bëhen çështje që i përkasin gjendjes së një besimtari që buron nga dashuria dhe besimi i tij.

Mësoje, o shok! Modestia ndonjëherë kudërshton shpalljen e mirësive të Zotit mbi dikë. Sepse shpallja e mirësive të Zotit ndonjëherë i jep shkas krenarisë dhe arrogancës. Prandaj njeriu duhet të jetë shumë i vëmendshëm dhe të shmangë ekstremet, të shmangë përshtimet qofshin të mangëta ose të tepruara.

Rruga e mesme në shpalljen e dikujt mirësitë e Zotit mbi të është sa vijon:

Çdo mirësi –bekim– ka dy aspekte: njëri i përket atij mbi të cilin Zoti i ka dhuruar mirësi. Ky bekim bëhet si një shenjë për ta dalluar atë në komunitet. Ajo e çon atë të bëhet krenar në vetvete dhe të harrojë të Vetmin i Cili ia ka dhënë atë. Ai shkon aq larg sa të bëhet arrogant në vetvete, duke ia atribuuar aftësive ose meritave të tij, dhe bëhet mendjemadh.

Aspekti tjetër i përket Dhuruesit të mirësive; mirësia –bekimi– shfaq Dorëgjëresinë dhe Mëshirën e Tij dhe dëshmon për Emrat e Tij. Nëpërmjet dhurimit të mirësive mbi krijesat, Ai shpall disa prej ‘vërseteve’ të manifestimeve të Tij. Modestia duhet të tregohet lidhur me aspektin e parë, ndërsa ajo bëhet mosmirënjohje në aspektin e dytë. Me kusht që ato t’i atribuohen tërësisht Allahut dhe Dorëgjëresisë së Tij, pa ndërë asnjë krenari në qënien i nderuar me to, shpallja e njeriut bekimet –mirësitë– e Zotit bëhet një mirënjohje e lavdërueshme.

O Jusuf Kejshi¹⁶³! Kur ti vesh rroba të shkëlqyera, Saidi të thotë ty “Sa i bukur je ti!” ti thuaj: “Bukuria u përket rrobave dhe jo mua”. Kjo është modesti dhe një shpallje e mirësive.

Mësoje, o shok! Kur është koha për marrje rrogash dhe për ndarje shpërblimesh, ndjenjat e rivalitetit dhe të xhelozisë fillojnë të trazohen. Ato janë të plogëta –të paaktivizuara– në kohën e punës dhe të shërbimit. Madje, meqenëse pesha e shërbimit mbi to lehtësohet dhe vështirësia e punës pakësohet, i dobëti vlerëson të fortin dhe dembeli don të zellshmin, punëtorin. Meqenëse dynjaja është vendi i punës për Ahiretin, ose për të përmbushur përgjegjësitë fetare për të marrë shpërblimin në Ahiret, nuk duhet të ketë rivalitet e xhelozia në to. Rivaliteti ose xhelozia në shërbimet fetare do të thotë mungesë sinqeriteti dhe mungesë pastërtie qëllimi, dhe shprehin kuptimin se një njeri xheloz po merr në konsideratë shpërblimet e kësaj bote të tilla si të qënurit i vlerësuar e i lavdëruar nga njerëzit. Një mjeran i tillë nuk e di se si rrjedhë zhvlerëson punët e mira të tij, i bën njerëzit ortakë me Zotin në dhënien shpërblim, dhe jo më të vlerësohet, por ai dënohet prej tyre.

Mësoje, o shok! Krijimi i Zotit një mrekulli ose një ngjarje të jashtëzakonshme nëpërmjet duarve të një shërbëtori të dashur, gjë e cila quhet *keramet*, është e ndryshme nga bërja e një shërbëtori tjetër duke e

¹⁶³Jusuf Kejshi ishte njëri prej nxënësve të Bediuzzamanit. (Përkthyesi)

çuar atë gradualisht në humbje nëpërmjet mosbesimit të tij për të bërë një arritje të jashtëzakonshme, gjë e cila quhet *istidraxh*. Kerameti, ashtu si mrekullia e bërë për një profet, është një akt i Zotit xh.sh, dhe shërbëtori i cili nderohet me të e di se ai keramet buron prej të Gjithëlavdishmit, dhe jo nga vetvetja. Ai është i bindur se i Gjithëfuqishmi e sheh atë dhe e mbron atë dhe i do të mirën. Kjo formon sigurinë e tij dhe mbështetjen e tij tek Ai. Ndonjëherë, ai është i vetëdijshëm për kerametën me të cilin ai është nderuar dhe si ai ndodh, dhe ndonjëherë nuk është i vetëdijshëm. Do të ishte më e sigurtë dhe më e preferueshme për besimin e tij dhe për jetën fetare që ai të jetë i pavetëdijshëm për faktin se Zoti krijon keramete nëpërmjet tij. Për shembull, Zoti mund t'i shkaktojë atij të shprehë në mënyrë të pavetëdijshme atë çfarë i ndodh zemrës së një personi tjetër ose mendjes, ose t'i shfaqë atij skena prej të padukshmes me qëllim që tjetri të mund të udhëzohet për tek Rruga e drejtë. Ai shërbëtor i dashur, në fakt është i pavetëdijshëm për atë çfarë Zoti bën për shërbëtorët e Tij nëpërmjet tij.

Sa për *istidraxhin*, për shembull, disa gjëra prej të padukshmes mund të shfaqen për një të pakujdesshëm, madje edhe për një shërbëtor të çudhëzuar. Ose ai mund të bëjë ca gjëra të çuditshme. Ai ia atribuon të gjitha këto vetvetes dhe fuqisë apo aftësive të tij dhe shton mendjemadhësinë, kotësinë dhe largimin e tij prej Zotit. Ai thotë:

إِنَّمَا أُوتِيْتُهُ عَلَىٰ عِلْمٍ
“Ajo më është dhënë vetëm për llogari të njohjes që kam”¹⁶⁴ dhe ajo është manifestuar ose ka ndodhur për shkak të pastërtisë së vetes sime dhe të ndriçimit të zemrës sime”.

Ata të cilët janë në gjysëm të rrugës në udhëtimet e tyre shpirtërore i ngatërrojnë kerametet dhe *istidraxhet* me njëra-tjetrën. Kurse, ata të cilët kanë arritur rangjet më të larta dhe që kanë realizuar vetëasgjësimin mund të jenë të qartë e të vetëdijshëm për gjërat që i përkasin të padukshmes me shqisat e tyre të jashtme të cilat janë zhvilluar aq sa për të funksionuar sikur të ishin mjete për Zotin për të ekzekutuar dekretet e Tij, [ashtu siç përmendet në një hadith kudsi të transmetuar nga Buhariu:

¹⁶⁴Kur'an, 28:78

“Kur Unë e dua një shërbëtorin Tim, Unë bëhem veshi i tij me të cilin ai dëgjon, syri i tij me të cilin ai shikon, dora e tij me të cilën ai mban dhe këmba e tij me të cilën ai ecën”].

Meqenëse bota e tyre e brendshme është plotësisht e ndritur dhe ndriçon botën e tyre të jashtme, ata mund të bëjnë dallime në mënyrë të qartë midis kerametit dhe istidraxhit.

Mësoje, o shok! **وَأَنْ مِنْ شَيْءٍ إِلَّا يُسَبِّحُ بِحَمْدِهِ** “Nuk ka asgjë që të mos e lëvdojë Atë me lëvdën”¹⁶⁵ Tesbihati dhe adhurimi i çdo krijese kanë aspekte të panumërt. Nuk është e domosdoshme për krijesën të jetë e vetëdijshme për të gjitha ato. Sepse nuk është obligim për një krijesë të jetë gjithmonë e vetëdijshme për tesbihatin e saj. Për shembull, një punëtor me mëditje injorant punon në një anije. Ai duhet të prekë ca kapëse e gozhda në anije pa e ditur se përse dhe për çfarë përdorimesh të rëndësishme i ka kërkuar pronari atij për ta bërë këtë. Ajo çfarë ai di është vetëm rroga që ai merr dhe kënaqësia e fitimit. Ai madje pandeh se puna që ai bën u urdhërua vetëm për kënaqësinë e tij. Përsëri, një kafshë është krejtësisht e pavetëdijshme se përse ajo çiftëzohet dhe për pasojat e çiftëzimit; ajo e bën vetëm për të përmbushur dëshirën e saj seksuale. Por, mosdija e një kafshe për qëllimet e çiftëzimit të saj nuk e pengon riprodhimin dhe ruajtjen e pasardhësve dhe species së saj, gjë e cila është njëri prej qëllimeve të synuara të Pronarit të saj. Për shembull, ndërsa duke përmbushur lakminë e tyre, mizat në mënyrë të pavetëdijshme pastrojnë fytyrën e tokës prej kërmave dhe mikroorganizmave. Ose një orë të tregon ty se sa shumë kohë më shumë nga jeta jote ka kaluar, por ‘njeh’ veçse dhimbjen e dëmtimit të mekanizmit të saj. Ose një bletë bën atë çfarë bën nëpërmjet ëmbëlsisë së inspimit Hyjnor të përfshirë në kënaqësinë e veçantë që ajo merr. Ose si nënat e bimëve dhe kafshëve, madje edhe ato të njerëzve që punojnë për shkak të kënaqësisë së dhembshurisë, të pavetëdijshme për qëllimet e larta të realizuara nëpërmjet tyre të cilat stolisin shtëpinë e universit. Është sikur dhembshuria e tyre të shërbente si një bërthamë ose masë për ato qëllime. Është e mjaftueshme për ato të bëjnë tesbihate dhe ta adhurojnë Zotin, që ato të dinë të bëjnë punën e tyre.

¹⁶⁵Kur’an, 17:44

كُلُّ قَدْ عَلِمَ صَلَاتَهُ وَ تَسْبِيحَهُ...

“A nuk e sheh ti se Allahu është Ai të Cilin e madhërojnë gjithkush që është në qiej e në tokë, edhe zogjtë me krahët e hapur? Për secilin, Ai me të vërtetë di salatin e tij dhe madhërimin e tij. Dhe Allahu është i Gjithëditur për çfarë veprojnë”¹⁶⁶

Nuk është e domosdoshme që ato të dinë se ajo që ato bëjnë është një tesbihat dhe të jenë të vetëdijshme për natyrën e lutjes së veçantë të çdonjërës. Është e mjaftueshme që të mendueshmit midis krijesave e dinë se të gjitha krijesat e adhurojnë dhe e lavdërojnë Allahun. Madje, është e mjaftueshme që i Adhuruari i Vetëm Absolut e di atë. Meqenëse krijesat e tjera përveç njerëzve nuk janë të obliguara ta adhurojnë me vetëdije Zotin, ato nuk duhet të bëjnë ‘nijetin’ e veçantë për tesbihatet e tyre dhe të jenë të vetëdijshme për natyrën e asaj që ato bëjnë. Në të vërtetë, vetë ato krijesa janë fjalë të mishëruara të tesbihatit dhe nëpërmjet jetëve të tyre ato bëjnë një lloj tjetër tesbihati. Ato bëjnë tesbihat në aq shumë mënyra, aq sa ka dashur i Gjithëlavdëruari i Vetëm dhe i Shenjtëruari i Pastër Xhel–le Xhelaluhu ve la ilahe Gajruhu, Madhështia e Tij qoftë e lartësuar dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij.

Mësoje, o shok! Mirësitë dhe bekimet që të janë dërguar ty në shumëllojshmëri të mëdhaja dhe që të zbukurojnë ty nga koka tek këmbët, të arrijnë ty pasi të kalojnë nëpërmjet perdeve të ndryshme në përputhje me masa të caktuara dhe duke qenë filtruar nëpër rrjeta të ndryshme me një rregull të përcaktuar.

Mësoje, o shok! Nodhet një pikë shumë e hollë në nefsi. Unë mendoj se ajo është për të shërbyer për një dritare nëpërmjet të cilës shikohet drejt përjetësisë. Sepse, çfarëdo që ai has ose kontaktohet, ai priret ta përjetësojë atë. Në qoftë se dëshirat e kësaj bote ose tekat do ta përdornin atë, ai bëhet një instrument për të tërhequr blloqet e ndërtimit të Ahiretit për dynjanë dhe përpiqet të ndërtojë një pallat dynjaje me to, dhe ai i ha frutet e Ahiretit në këtë botë kalimtare para se ato të jenë pjekur.

¹⁶⁶Kur’an, 24:41

Mësoje, o shok! Nefsi është një gjë e çuditshme. Në qoftë se pastrohet e zhvillohet, ai bëhet një thesar i instrumenteve të panumërta dhe metra të pafundme për të perceptuar manifestimet e thesareve të Emrave të Bukur Hyjnorë; ndërsa, në qoftë se tundohet dhe mbetet i pazhvilluar, ai bëhet një shpellë gjarpërinjsh e akrepash dhe të llojeve të insekteve të tjera. Çfarë është e preferueshme për sa ka të bëjë me nefsin është qëndrueshmëria dhe jo asgjësimi. Qëndrueshmëria me pastrimin, ta mbash atë të pastruar ashtu siç bënë sahabët e profetit a.s.m është më e përshtatshme me urtësinë se sa vdekja apo asgjësimi i tij, që është rruga e ndjekur prej shumicës së evlijave. Nefsi është në uri të madhe dhe në nevoja të mëdhaja dhe ka shije të çuditshme. Kur trajnohet e pastrohet, cilësitë e tij ndryshojnë, lakmia e tij e qortueshme kthehet në një zell që nuk ngopet, mendjemadhësia e tij e lig bëhet një mjet për të shpëtuar prej të gjitha llojeve të shirkut, dhe dashuria e tij e fortë për veten ndryshohet në dashuri për Zotin, dhe kështu me rradhë. Të këqijat e tij kthehen në virtyte.

Mësoje, o shok! Një njeri besimtar e nxjerr vlerën e tij prej artit, ngjyrimit të dalluar dhe qëndisjeve të manifestimeve të Emrave Hyjnorë në qënien e tij. Kurse një jobesimtar ose i pakujdesshëm është i vlefshëm vetëm në përpjestim me aspektin e tij fizik. Gjithashtu, kur vështrohet për llogari të të Gjithëlavdishmit dhe nga këndvështrimi i qënies së tij vendi ku manifestohen të gjithë Emrat Hyjnorë, ashtu siç jep mësim Kurani, kjo botë bëhet pafundësisht e vlefshme. Ndërsa, në qoftë se shikohet për llogari të vetes dhe nga këndvështrimi i shkaqeve natyrale, ashtu siç jepet mësim nga filozofia e shturur, vlera e saj zvogëlohet në ndryshimin e saj dhe në lëndë materiale të pajetë.

Njohja rreth universit e nxjerrë prej Kuranit është pafundësisht më e lartë se sa njohja që jepet mësim nga shkenca moderne dhe filozofia. Për shembull, Kurani thotë:

وَجَعَلْنَا الشَّمْسُ سِيرًا جَا “Ai e ka bërë diellin një llampë”¹⁶⁷

Vështroje, o njeri shikimin e thellë që të jep Kurani me këtë shprehje për të parë zinxhirët e manifestimeve të Emrave Hyjnorë! Pavarësisht masës së stërmadhe, dielli nënshtrohet ndaj teje duke të të shërbyer ty si një dritë për të ndriçuar shtëpinë tënde dhe si një zjarr për

¹⁶⁷Kur'an, 71:16

të pjekur ose gatuar ushqimin tënd me urdhërin e Tij, i Cili të ushqen ty. Ti ke një Pronar të Tillë të Gjithëfuqishëm e Mëshirëplotë, saqë dielli dhe të tjera të paumërta të ngjashme me të janë lampa në banesën e ndërtuar për mysafirët e Tij midis banesave të Tij të përjetshme.

Tani shiko se çfarë thonë shkenca dhe filozofia: dielli është një masë e madhe zjarri që lëviz vetë. Toka jonë dhe planetet e tjerë u shkëputën prej tij dhe lëvizin në orbitat e tyre të tërhequra nga dielli me një forcë graviteti. Ky informacion nuk të jep ty më shumë se një frikë ose një sens habie.

Mësoje, o shok! Ti nuk ke të drejtë të kërkosh një të drejtë prej të Vërtetit xh.sh, përkundrazi, ajo çfarë ti duhet të bësh është ta falënderosh vazhdimisht Atë. Sepse **لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ** e Tij është e gjithë mbretëria, tërësia e krijimit dhe i Tij është i gjithë lavdërimi.

اللَّهُمَّ يَا رَبَّ مُحَمَّدٍ الْمُخْتَارِ يَا رَبَّ الْجَنَّةِ وَالنَّارِ يَا رَبَّ النَّبِيِّينَ
وَالْأَخْيَارِ يَا رَبَّ الصِّدِّيقِينَ وَالْأَبْرَارِ يَا رَبَّ الصِّغَارِ وَالْكَبَّارِ يَا
رَبَّ الْحُبُوبِ وَالْأَثْمَارِ يَا رَبَّ الْأَنْوَارِ وَالْأَزْهَارِ يَا رَبَّ الْأَنْهَارِ
وَالْأَشْجَارِ يَا رَبَّ الْإِعْلَانِ وَالْإِسْرَارِ يَا رَبَّ اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ ۞
نُشْهَدُكَ وَنُشْهَدُ حَمَلَةَ عَرْشِكَ وَنُشْهَدُ جَمِيعَ مَلَائِكَتِكَ وَنُشْهَدُ جَمِيعَ
مَخْلُوقَاتِكَ بِشَهَادَاتِ جَمِيعِ أَنْبِيَائِكَ وَبِشَهَادَاتِ جَمِيعِ أَوْلِيَائِكَ
وَبِشَهَادَاتِ جَمِيعِ آيَاتِكَ التَّكْوِينِيَّةِ وَالْكَلَامِيَّةِ ، وَبِشَهَادَاتِ جَمِيعِ
مَصْنُوعَاتِكَ وَبِشَهَادَاتِ ذَرَّاتِ الْكَائِنَاتِ وَمُرَكَّبَاتِهَا ، وَبِشَهَادَاتِ
حَبِيبِكَ الْأَكْرَمِ عَلَيْهِ أَفْضَلُ صَلَوَاتِكَ الْمُتَضَمِّنَةِ شَهَادَتَهُ لِجَمِيعِ
تِلْكَ الشَّهَادَاتِ وَبِشَهَادَاتِ قُرْآنِكَ بِنَا كُنَّا نَشْهَدُ :
بِأَنَّكَ أَنْتَ اللَّهُ الْوَاجِبُ الْوُجُودِ الْوَاحِدُ الْأَحَدُ الْفَرْدُ الصَّمَدُ ، الْحَقُّ
الْمُبِينُ الْحَيُّ الْقَيُّومُ الْعَلِيمُ الْحَكِيمُ الْقَدِيرُ الْمُرِيدُ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ
الْمُتَكَلِّمُ لَكَ الْأَسْمَاءُ الْحُسْنَى وَنَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ وَحْدَكَ لَا
شَرِيكَ لَكَ ، لَكَ الْمُلْكُ وَلَكَ الْحَمْدُ وَنَسْتَغْفِرُكَ وَنَتُوبُ إِلَيْكَ ۞
وَ كَذَا نَشْهَدُ بِأَنَّ مُحَمَّدًا عَبْدُكَ وَنَبِيُّكَ وَحَبِيبُكَ وَرَسُولُكَ أَرْسَلْتَهُ
رَحْمَةً لِّلْعَالَمِينَ ۞ فَصَلِّ وَسَلِّمْ عَلَيْهِ أَبَدَ الْأَبَدِينَ آمِينَ

O Allah, o i Gjithëmëshirshëm, o Mëshirëplotë, o Gjithëbujar! Bëje këtë libër një zëvendës për mua të dëshmojë për Ty pas vdekjes sime siç vijon:

O Allah, o Zoti i Muhammedit, të zgjedhurit! O Zoti i Xhennnetit dhe i Xhehennemit! O Zoti i profetëve dhe i të mirëve! O Zoti i të vërtetëve dhe i të drejtëve! O Zoti i të vegjëlve dhe i të mëdhenjve! O Zoti i kokrrave dhe i frutave! O Zoti i dritave dhe i luleve! O Zoti i lumenjve dhe i pemëve! O Zoti i asaj që është e dukshme dhe i asaj që është e fshehtë! O Zoti i natës dhe i ditës! Ne të kemi Ty si një Dëshmitar, ne kemi ata që mbajnë Fronin Tënd më të Lartë si dëshmitarë, ne i kemi të gjithë melekët e Tu si dëshmitarë, ne i kemi të gjitha krijesat e Tua si dëshmitare, të gjithë profetët e Tu, të gjithë evlijatëe Tu, të gjitha shenjat e Tua të krijimit dhe të ligjërimit, dhe të gjitha grimcat e universit dhe pjesët përbërëse të tij janë gjithashtu dëshmitarë, ashtu siç dëshmohet gjithashtu nga i dashuri Yt a.s.m, dëshmia që i përmban të gjitha dëshmitë e tjera, dhe nga Kurani Yt, se ne të gjithë dëshmojmë që Ti je Allahu, Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm, i Vetmi, Një, i Kërkuari përjetësisht, i Vërteti i Qartë, i Gjalli i Përjetshëm, Vetekzistuesi i Përhershëm, i Gjithëdituri i Gjithurtë, i Gjithëfuqishmi Dëshirues, Gjithëdëgjuesi Gjithëshikues, Ligjëruesi. Ty të përkasin Emrat më të bukur. Ne gjithashtu dëshmojmë se nuk ka zot tjetër përveç Teje, je i Vetëm, Një, pa asnjë lloj ortaku. I Yti është i gjithë sundimi dhe i Yti është i gjithë lavdërimi. Të kërkojmë falje dhe pendohemi tek Ti. Gjithashtu, dëshmojmë se Muhammedi është shërbëtori Yt, i dashuri Yt dhe i dërguari Yt të cilin Ti e dërgove si mëshirë për të gjitha botët. Dhuroji paqe e bekime atij, familjes së tij dhe sahabëve të tij gjer në përjetësi. Amin. Amin. Amin.

Pikëla e Katërmbëdhjetë

Kjo përmban “pikërrima” prej oqeanit të mrekullisë më të madhe (domethënë Kur’anit).



Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

● Pikërrima e parë:

Dije se argumentet për profetësinë e Muhammedit a.s.m janë të panumërt. Dijetarët e saktë kanë shkruar volume për t’i shpjeguar ato. Pavarësisht mangësive të mia, unë jam përpjekur me modesti për të shpjeguar rreze prej atij dielli në një trajtesë turqisht të quajtur “*Rreze*”, dhe kam shpjeguar shkurtazi disa aspekte të mrekullisë së Kuranit, të cilat arrijnë numrin dyzet, në një trajtesë tjetër të quajtur “*El-Levamiu*” “*Rrezëllimat*”. Unë shpjegova elokuencën e tij, e cila është njëri prej atyre aspekteve në veprën “*Shenjatat e Mrekullisë*”, një prezantim për interpretimin e Kuranit. Nëse dëshiron, referoju këtyre tre veprave.

● Pikërrima e dytë

Kurani erdhi prej Krijuesit të qiejve dhe trupave qiellorë dhe të kësaj toke dhe krijesave të saj. Ti duhet të kesh kuptuar prej shpjegimeve të mëparshme se Kurani i cili na bën të njohur me Krijuesin tonë, Krijuesin e të gjithë botëve, trajton shumë çështje në shkallë të ndryshme përparësie.

Në qoftë se ti do të pyesje se ç’është Kurani, ne tashmë e kemi shpjeguar atë diku tjetër sa vijon:

Është interpretues parapërrjetësie i librit të madh të universit;

Dhe interpretuesi i paspërrjetësisë i gjuhëve të ndryshme që recitojnë vërsetet e krijimit;

Është komentuesi i librit të botëve të dukshme e të padukshme;

Është zbuluesi i thesareve jolëndorë të Emrave Hyjnorë të fshehura në faqet e tokës e të qiejve;

Është çelësi i të vërtetave të fshehura poshtë këtyre rreshtave të ngjarjeve;

Është gjuha e botës së padukshme në botën e dukshme;

Është thesari i mirësive të Krijuesit Mëshirëplotë dhe i adresimit Hyjnor të parapërdjetësishë i cili vjen nga bota e padukshme matanë perdes së kësaj bote të dukshme;

Është dielli, themeli dhe plani i botës shpirtërore të Islamit;

Është harta e shenjtë e botëve të Ahiretit;

Është komentuesi i shquar, shpjguesi i qartë, prova përcaktuese dhe interpretuesi i saktë i Esencës Hyjnore, i Atributeve, i Emrave dhe i Veprave;

Është edukatori i kësaj bote të humanizmit;

Është uji dhe drita e Islamit, i cili është humanizmi më i madh;

Dhe është urtësia e vërtetë e llojit njerëzor;

Dhe është udhëzuesi dhe drejtuesi i vërtetë që e çon njerëzimin në lumturi;

Dhe ai për njeriun është: një libër urtësie, libër ligji, libër duaje, libër adhurimi, libër urdhri e thirrjeje, libër përmendjeje dhe libër mendimi. Është një libër i vetëm dhe gjithëpërfshirës, i shenjtë dhe burim për të gjithë librat që përmbushin të gjitha nevojat shpirtërore të njerëzimit;

Dhe është një libër qiellor, si një bibliotekë e shenjtë, që jep libra të përshtatshëm për metodat e evlijave, të sinqertëve dhe të dijetarëve, rrugët dhe metodat e të cilëve janë të gjitha të ndryshme, dhe është i përshtatshëm të ndriçojë çdo rrugë e metodë.

● Pikërrima e tretë

Kjo shpjegon rrezëllimën e mrekullisë në përsëritjet ose përsëdytjet e Kuranit. Në këtë rrezëllimë ndodhen gjashtë pika:

Pika e Parë: Mësoje se meqenëse Kurani është një libër thirrjeje, lutjeje dhe përmendjeje, përsëritja e tij është shumë e mirë dhe në përputhje me elokuencën, madje përsëritja është një domosdoshmëri.

Sepse thirrja, lutja dhe përmendja, rivlerësohen dhe përforcohen nëpërmjet përsëritjes. Përsëritja e përmendjes sjell ndriçimin shpirtëror; përsëdytja e lutjes sjell kënaqësi e paqe, dhe thirrja përforcohet nëpërmjet përsëritjes.

Pika e Dytë: Mësoje se Kurani është një adresim Hyjnor dhe ilaç për sëmundjet e të gjitha klasave të njerëzimit. Ai u adresohet të gjithë njerëzve, më inteligjentëve midis tyre dhe atyre më pak inteligjentë, u adresohet më të përkushtuarve në fe dhe më gjynahqarëve, u adresohet më të zellshmive dhe atyre që shfaqin sukses në jetë ose atyre që kanë hequr dorë nga dynjaja, si dhe më të mjeruarve dhe të ulurve dhe atyre të zhytur në punën e tyre. Për këtë arsye, nuk është gjithmonë e mundur për gjithkënd ta lexojë Kuranin nga fillimi gjer në fund, i cili është një ilaç për gjithkënd në të gjitha kohët. Prandaj, me qëllim që ta bëjë atë të lehtë, i Gjithurti Mëshirëplotë i përfshin shumicën e qëllimeve të Kuranit në shumicën e kapitujve të tij, jo vetëm në suret e gjata, por gjithashtu edhe në suret më të shkurtëra. Ai i nxit njerëzit duke deklaruar:

وَلَقَدْ يَسَّرْنَا الْقُرْآنَ لِلذِّكْرِ فَهَلْ مِنْ مُدَكِّرٍ

“Dhe me të vërtetë që e kemi bërë Kuranin të lehtë për ta kuptuar dhe kujtuar; atëherë, a ka ndonjë që të përkujtojë (e të marrë këshillë)?”¹⁶⁸

Pika e Tretë: Ashtu si nevojat trupore që janë të ndryshme, disa prej tyre si ajri janë çdo çast të nevojshme. Të tjerat si uji janë të nevojshme në një rast etje si përgjigje ndaj nxehtësisë; disa si buka janë të nevojshme në çdo ditë; të tjerat nevojiten në çdo muaj ose në çdo vit, ose ato si ilaçet, nevojiten vetëm me raste; po ashtu, nevojat shpirtërore të njeriut janë të ndryshme. Ndërsa disa prej fjalëve dhe vërseteve të Kuranit si ‘Huve’, ‘Ai’ dhe Allahu janë të nevojshme vazhdimisht; midis të tjerave ndodhen ato si ‘Bismil-lah’ që nevojiten në çdo kohë, dhe ato që nevojiten shumë shpesh ‘Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut’.

Kështu, përsëritja e disa vërseteve ose fjalëve është për shkak të përsëritjes dhe intensitetit të nevojës për to. Përsëri, me qëllim që t’u

¹⁶⁸Kur’an, 54:17

kujtojë nevojën për to dhe që t'i nxisë njerëzit të ndiejnë nevojën për disa 'ushqime shpirtërore', disa fjalë e vërsete përsëriten në Kuran.

Pika e Katërt: Dije se Kurani ka themeluar një fe të fortë dhe ka vendosur themelet e saj dhe themelet e botës Islame. Ai gjithashtu ka ndryshuar komunitetet e njerëzimit dhe i ka bashkuar ato në një kulturë e civilizim të përbashkët. Atëherë duhet patjetër që themeluesi ta përsërisë me qëllim që diçka të rënjoset, të përforcohet dhe të vlerësohet e konfirmohet. Dhe kështu, në Kuran ndodhen përgjigje për pyetjet e bëra nga grupe të shumtë të popujve të ndryshëm, të mjediseve dhe temperamenteve të ndryshëm, dhe të niveleve të ndryshme të aftësisë gjuhësore, aftësisë së të kuptuarit e të menduarit.

Pika e Pestë: Dije se Kurani përmend shumë çështje të rëndësishme dhe i thërret zemrat që t'u besojnë atyre, dhe flet rreth të vërtetave të holla dhe i bën thirrje arsyes ose intelektit të ketë njohje të sigurt për to. Është e domosdoshme që ato të përsëriten në stile e kontekste të ndryshëm me qëllim që t'i rënjosë në zemra dhe t'i ngulisë në mendjet e masave.

Pika e Gjashtë: Vërsetet e Kuranit kanë kuptime të brendshme e të jashtme, dimensione të brendshme e të jashtme, dhe ato i shërbejnë një qëllimi përfundimtar për të mirën e njerëzve, si nga ana e brendshme edhe nga ana e jashtme. Për shembull, shumë urdhëresa ligjore dhe norma të etikës synohen të nxirren prej disa vërseteve, dhe rëndësia dhe zbatueshmëria e urdhëresave dhe e normave në kontekste të ndryshëm kërkojnë që vërsetet e Kuranit duhet të përsëriten në mënyra e kontekste të ndryshme. Gjithashtu, në dimensionet e brendshme të kuptimit, përpjekja e mendjes për të kuptuar sfidohet dhe shpërblehet nga vërsetet duke u përsëritur në kontekste të ndryshëm duke mundësuar një ndryshueshmëri të pafundme dhe një thellësi të nuancave të kuptimit.

● Pikërrima e katërt

Kjo është për të shpjeguar virtytin e mospërmendjes së Kuranit në disa çështje lidhur me shkencën dhe duke ia referuar disa çështje të tjera nënkuptimësisë dhe thukëtisë së stilit. Shpjegimi përmban gjashtë pika.

Pika e Parë:Në qoftë se ti do të pyesje se përse Kurani nuk e trajton universin në të njëjtën mënyrë si filozofia moderne dhe shkenca, unë do t'ju thoja se filozofia moderne dhe shkenca i afrohen universit vetëm për veten e tij e për hir të tij. Ndërsa Kurani, i cili u shpall me të vërtetë dhe që udhëzon për tek e vërteta, e trajton universin jo për veten e tij, por lidhur me Krijuesin e tij dhe për hir të kuptimit dhe njohjes së Krijuesit.

Në kundërshtim me filozofinë moderne dhe shkencën, Kurani nuk i përmend në mënyrë të qartë ose i përmend vetëm në mënyrë të ngjeshur dhe me ambiguitet objektet qiellore dhe tokën në formën dhe lëvizjet e tyre. Në qoftë se ti do të pyesje se përse, unë do të të thoja se ambiguiteti apo referimi i paqartë është më tepër domethënës, dhe përmendja e tij ato në mënyrë të thukët është vërtet më e bukur.

Së pari, sepse Kurani e përmend universin nëpërmjet digresionit – shmangies– ose në mënyrë të ndërshtënë në diskutimin për Esencën dhe Atributet e Krijuesit. Një argument duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për gjithkënd duke çuar tek qëllimi. Qëllimi është të mundësojë gjithkënd për të patur njohuri të mjaftueshme për Esencën e Krijuesit, Atributet dhe Emrat e Tij. Nëse do të fliste siç dëshirojnë shkencëtarët, si: “O njerëz! Shikojeni diellin në palëvizshmërinë e tij dhe tokën në lëvizjen e saj dhe shihni si Krijuesi i tyre është Fuqplotë”, argumenti do të kishte qenë më i errët, më i paqartë dhe më i fshehtë se sa qëllimi dhe do të mbetej i pakuptueshëm për shumicën e njerëzve në pothuajse të gjitha epokat, ndonëse shumicës absolute duhet t'i jepet përparësi në udhëzim. Marrja në konsideratë nivelin e njohjes dhe të të kuptuarit të shumicës nuk i përjashton nga përfitimi shkencëtarët, filozofët dhe intelektualët, të cilët përbëjnë vetëm një pakicë në shoqëri. Në kontrast, t'i japësh përparësi pakicës, do ta privonte shumicën (nga përfitimi i udhëzimit të Kuranit).

Së dyti, rregullat e ligjëratës së mirë në tekste për udhëzim kërkojnë që mendjet e atyre për të cilët synohet udhëzimi nuk duhet të ngatërrohen e të bëhen konfuze prej tij. Përkundrazi, shikimet e tyre, ndjenjat dhe niveli duhet të merren në konsideratë dhe atyre duhet t'iu adresohen shkoqur e kuptueshëm dhe duke mos hyrë në detaje, me qëllim që ata të ndjejnë familjaritet me subjektin dhe që të mund ta kuptojnë atë me lehtësi. Udhëzimi i Kuranit synohet për të gjithë njerëzimin në të gjitha epokat dhe forma e tij e shprehjes është e

kuptueshme universalisht sipas shkallës së përpjekjes së individit për të përfituar prej tij.

Së treti, siç u tregua më lart, Kurani përmend universin dhe çfarë ndodh në të, jo në lidhje me të –universin– por lidhur me Krijuesin e tij. Ajo që është e rëndësishme për Kuranin është se universi me çdo gjë dhe me çdo ndodhi në të duhet të tregojë Krijuesin e tij. Sa për shkencën dhe filozofinë moderne, ato e trajtojnë universin vetëm për veten –universin– dhe për hir të tij. Ajo që është e rëndësishme për to është se çfarëdo që është ose ndodh në univers duhet të tregojë vetveten. Ndodhet një ndryshim i madh midis të dyve ashtu si ndërmjet qiellit më të lartë dhe tokës. Gjithashtu, tashmë është përmendur se Kurani është Fjala e Zotit që e zbret veten tek shkalla e të kuptuarit të njerëzve më të zakonshëm. Kurani merr në konsideratë shumicën e njerëzve, kështu që, të çliruar nga mbetja, të kufizuar ndaj imitimit të elitës, ata mund të kenë akses të drejtëpërdrejtë tek njohja e qëndrueshme dhe tek besimi në Zot. Megjithatë, shkenca flet në emër të shkencëtarëve në një mënyrë që të detyrojnë vegjëlinë që t’i imitojnë dhe t’i pranojnë pikëpamjet e tyre. Për shkak të kësaj, kur shkenca hyn në detaje megjithëse është shumë e dyshimtë dhe e diskutueshme se deri në çfarë shkalle e shpreh ajo të vërtetën, Kurani flet në mënyrë të thukët, të paqartë, ose e mban të heshtur, në përputhje me si dhe deri në çfarë shkalle të mund të përfitojnë të gjithë njerëzit.

Së katërti, Kurani synon t’i udhëheqë të gjitha klasat e njerëzimit. Kështu, rregulli i tij për ligjëratën kërkon që shumica e njerëzve duhet të mos çudhëzohen në faktet e pranuar prej tyre si e vërtetë e plotë, të mos çudhëzohen nga mënyrat e argumentit të cilat mund të shoqërohen me sofistikë dhe duke u matur për epërsinë midis qënieve njerëzore. Gjithashtu, do të ishte e kotë, përveç kur është absolutisht e domosdoshme, të ndryshosh pikëpamjet e tyre për fakte të tilla. Madje do të ishte më e mirë të mbahet e fshehtë ose e thukët në çështjet që nuk janë të përdorshme për sa ka të bëjë me detyrat e tyre të domosdoshme ndaj Allahut ose ndaj njëri-tjetrit.

Për shembull, Kurani e përmend diellin jo për llogari të vetes së tij –diellit– as për veçoritë e tij fizike, por për llogari të të Vetmit Krijues i Cili e ka bërë atë një llampë dritëdhënëse.

Gjithashtu, Kurani përmend funksionin e diellit si ‘boshtin’ e sistemit universal dhe qendrën e rregullit të krijimit. Ai i referohet atij

si sovajkë e makinës thurresë nëpërmjet së cilës veprat e Projektuesit të Parapërdjetshëm thuren në faqen e tokës dhe të qiejve me fijet e ditës e të natës dhe me ndryshimin e stinëve. Kurani e bën këtë duke na treguar neve sistemin madhështor dhe rregullin në thurjen dhe sistemin e jashtëzakonshëm dhe Projektuesin e gjërave të thurura me qëllim që të na bëjë të njohur përsosurinë e Krijuesit të tyre të Gjithurtë, Autorin e tyre të Gjithëditur. Nuk është shumë e rëndësishme nga pikëpamja e qëllimeve të Kuranit nëse dielli realisht lëviz apo është i palëvizshëm. Thurja e gjërave nga ana e Hyjnisë është dukshëm madhështore dhe e shkëlqyer; prandaj në qoftë se dielli është realisht i palëvizshëm siç e pohon shkenca, kjo nuk dëmton as qëllimet e Kuranit, as shprehjet e tij për to. Në çdo rast, siç na tregojnë shkencëtarët, palëvizshmëria e diellit është relative vetëm për lëvizjen e tokës dhe të planetëve të tjerë, dhe jo absolute.

Pika e Dytë: Kurani thotë: **وَجَعَلَ الشَّمْسَ سِرَاجًا** “Ai e ka bërë diellin llampë ndriçuese”¹⁶⁹ dhe **وَالشَّمْسُ تَجْرِي لِمُسْتَقَرٍّهَا** “edhe dielli rend në rrugën e tij për një kohë të përcaktuar”¹⁷⁰

Në qoftë se ti do të thoje: asgjë nuk shprehu rreth diellit me llampë, ndonëse ai në shkencë është shumë i madh prej të cilit toka është vetëm një pjesë dhe prandaj ai është shumë larg nga ndjekja e tokës. Përgjigja ime do të ishte:

Duke e quajtur diellin një llampë, Kurani synon të thotë se universi është si një pallat me gjërat në të si pajisjet e tij. Ai gjithashtu përmban edhe pajisje të tjera të domosdoshme si ushqimin, të cilin Gjithëbujari i Vetëm Mëshirëplotë e ka përgatitur për banorët e tij, të cilët në fakt, janë mysafirët e Tij dhe shërbëtorë në të. Dielli është llampa e këtij pallati me urdhërin e Pronarit të pallatit. Përskrimi i diellit si një llampë sugjeron mëshirën e Krijuesit në madhësinë e Hyjnisë së Tij, tregon favorin e Tij në mëshirën e Tij Gjithëpërfshirëse dhe bujarinë e Tij në madhësinë e Sovranitetit të Tij. Nëpërmjet demonstrimit se dielli, i cili është hyjnizuar e adhuruar gjatë historisë, është vetëm se

¹⁶⁹Kur'an, 71:16

¹⁷⁰Kur'an, 36:38

një llampë e nënshtuar ndaj urdhërit të Allahut, ai deklaroi Unitetin Hyjnor.

Shprehja ‘rend’ nënkupton dispozicionin dhe aktet e larta e të qëllimshme të Allahut të Gjithëfuqishëm në ndryshimin e vazhdueshëm të ditës e të natës dhe verës dhe dimrit, njëpasnjëshmërisë së verës e dimrit. Kështu ai sjell ndërmend fuqinë e madhe të Autorit Krijues në qënien e Tij, Zoti i Vetëm i universit.

Kur dielli dhe hëna përmenden së bashku, mendjet vetvetiu shkojnë tek dita dhe nata, vera dhe dimri dhe prej këtu ngjarjet që ndodhin në to. Shprehja ‘*texhri*’, ‘rend’ i nënkupton të gjithë këto kuptime, dhe nuk synohet të përcaktojë nëse dielli në të vërtetë lëviz apo jo.

Soditi fjalët dhe shprehjet e Kuranit dhe shiko se si pavarësisht thjeshtësisë së tyre të jashtme, ato funksionojnë si dyer ose si çelësa për thesaret e kuptimeve të holla. Pastaj, soditi fjalët dhe shprehjet e përdorura nga shkenca dhe shiko se, pavarësisht shkëlqimit të tyre të jashtëm, ato kanë pak dobi për ju qoftë shpirtërisht ose madje mendërisht, apo lidhur me qëllimet kryesore të njeriut në jetë. Ato të shkaktojnë ty të biesh nga qielli i Unitetit të ndritshëm në luginat e errëta të shumësisë. Dëgjoje një pjesë nga ajo që thotë filozofia moderne dhe shkenca lidhur me diellin:

“Është një masë e madhe prej zjarri të fortë, 1300000 herë më i madh se sa toka dhe rrotullohet në boshtet e tij; planetët duke përfshirë tokën tonë, u shpëputën prej tij në distanca të ndryshme, fluturojnë përreth tij të tërhequr drejt tij nëpërmjet gravitetit të përgjithshëm. Në qoftë se pas ndonjë ndodhie të paparashikuar në qiej, të tillë si përplasja me ndonjë kometë që kalon, njëri nga ato planete do ta braktiste orbitën e saj, kjo do të rezultonte në prishjen e sistemit diellor dhe shkatërrimin e botës sonë”.

Mundësia e një ndodhie të tillë i mbush me frikë e tmerr njerëzit të gjithë kohën.

Pyete veten nëse një informacion i tillë do të kishte ndonjë dobi për ty në jetën tënde normale të zakonshme.

Sub’hanallah, qoftë i lavdëruar Allahu! Sa e çuditshme! Si e përmbys çudhëzimi formën e realitetit! Dielli dhe planetët e tij janë

vetëm se krijesat e Autorit të Gjithurtë, të cilat janë ngarkuar me disa detyra dhe të nënshtruara ndaj urdhërit dhe fuqisë së Krijuesit. Pavarësisht vëllimit të tij shumë të madh, dielli është vetëm se një pikë e vetme e ndritshme në faqen e oqeanit të qiejve, mbi të cilin manifestohet një rreze e Emrit Hyjnor En–Nur, Drita. Në qoftë se shkencëtarët dhe filozofët do të kishin përfshirë në çështjet e tyre vetëm një dritë prej Kuranit, dhe të thonin “Zoti i përdor këto objekte të mëdha të pajeta në detyra të rëndësishme për rregullin e universit dhe se ato trupa janë në bindjen më të skajme ndaj Tij”, atëherë njohja e tyre do të kishte patur ndonjë kuptim. Por, meqenëse ata ia atribuojnë krijimin e këtyre trupave qiellorë dhe lëvizjet e tyre dhe detyrat që ato kryejnë vetë objekteve ose natyrës dhe shkaqeve materiale, ata përfshihen në kuptimin e vërsetit Kur’anor:

وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَكَأَنَّمَا خَرَّ مِنَ السَّمَاءِ فَتَخْطَفُهُ
الطَّيْرُ أَوْ تَهْوَى بِهِ الرِّيحُ فِي مَكَانٍ سَحِيْقٍ

*“Dhe kushdo që i emëron shokë e të barabartë Allahut, kjo është sikur ai të kishite rënë nga qielli dhe ta kishin kapur zogjtë ose sikur era ta kishite hedhur në një vend të largët e të humbur”.*¹⁷¹

Me këtë bëj ti analogji dhe për çështjet e tjera.

Pika e Tretë: Mësoje se Kurani ka katër qëllime kryesore: Uniteti Hyjnor, profetësia, ringjallja dhe drejtësia bashkë me adhurimin. Çështjet e tjera të cilat i trajton Kurani janë mjete për realizimin e këtyre qëllimeve. Është një rregull i ligjëratës së mirë se hyrja në detaje në përmendjen e mjeteve dhe ndarja –degëzimi– i çështjeve të varura me shtesa të panevojshme apo me argumente shkakton një shkëputje prej qëllimeve kryesore. Për këtë arsye, Kurani synon të kapërcejë –të lërë në heshtje– disa çështje shkencore të rëndësishme ose i lë të paqarta, ose i shpreh ato në mënyrë të thukët. Shumica e njerëzve nuk parashikohen –nuk priten– t’i kapin pa metafora, pa krahasime e pa shëmbëlltyra të vërtetat e thella Hyjnore. Meqenëse shumica e çështjeve shkencore e filozofike kërkojnë një kohë të gjatë për t’u kuptuar, Kurani u referohet shumicës së çështjeve të tilla me anë të metaforave, përngjasimeve dhe shëmbëlltyrave dhe qëndron i thukët

¹⁷¹Kur’an, 22:31

mbi pikat të cilat do të kuptohen me kalimin e kohës (domethënë me përparimin në hulumtimin shkencor).

Pika e Katërt: Mësoje, o shok! Ashtu si ora që bën tik–tak dhe tronditet vazhdimisht me funksionimin e pandërprerë të veglave në të, po ashtu dynjaja, e cila mund të shihet si një orë gjigante, është aktive dhe vazhdimisht në tronditje. Futja e kohës në këtë aktivitet e bën ndodhjen e ditës e të natës si akrepi i sekondave të orës; i bën vitet si akrepin e minutave të saj, dhe shekujt si akrepin e saj të orës.

Futja e hapësirës në të e bën atmosferën nëpërmjet shpejtësisë së ndryshimeve që ajo ndërmerr, të jetë si akrepi i sekondave. Toka, nëpërmjet ndryshimeve të vëzhguara në të, në bimët e kafshët dhe përsa ka të bëjë me jetën dhe vdekjen, i ngjason akrepit të minutave dhe nëpërmjet tronditjes së saj dhe formimit të maleve të saj i ngjason akrepit të orës. Dhe qiejt, nëpërmjet ndryshimeve që ndodhin në to dhe nëpërmjet lëvizjeve të objekteve të tyre dhe lindjes së yjeve të rinj dhe vdekjes së yjeve të vjetër, janë si akrepi që numëron ditët.

Bota –dynjaja– është ndërtuar mbi këto shtatë elemente bazë –dita, nata, viti, shekulli, toka, atmosfera, dhe qiejt– të cilat, në fakt manifestojnë aktet e Emrave Hyjnorë dhe mbishkrimet e Penës së Fuqisë Hyjnore dhe Kaderit. Megjithëse dynjaja e bazuar mbi këto elemente është në lëvizje, kalimtare, e përkohshme, udhëtuese dhe rrjedhëse si uji, pavëmëndshmëria dhe natyralizmi e ngrijnë atë, duke e bërë një perde sipër Ahiretit – botës tjetër. Duke i nxitur njerëzit të merren shumë me studimet e natyrës e të filozofisë, filozofisë së mangët e të zvetënuar, civilizimi i prishur e shton atë në ‘dendësi’ dhe në ‘patejdukshmëri’.

Sa për Kuranin, ai e bën botën si lesh të gërhanuar nëpërmjet vërseteve të tij dhe e bën atë të tejdukshme nëpërmjet shprehjeve të tij. Kurani gjithashtu e shkrin botën nëpërmjet rrezeve të tij, e copëton përjetësinë e saj të rreme me paralajmërimet e tij të fuqishme ndaj vdekjes dhe ndëshkimit të përjetshëm, dhe lëviz pavëmëndshmërinë e shkaktuar nga natyralizmi me paralajmërimet e tij si rufe. Me karakterin e saj esencial, bota e tronditur në ndryshim reciton vërsetin

وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَكُمْ تُرْحَمُونَ

“Dhe kur të lexohet Kurani, dëgjojeni atë me vëmendje dhe heshtni që të mund të fitoni mëshirë”¹⁷².

Për këto arsye të lartpërmendura, Kurani qëndron i thukët aty ku shkenca dhe filozofia moderne futen në hollësira në përshkrimin e gjërave dhe tiparet e tyre. Në kontrast, aty ku shkenca dhe filozofia moderne janë shprehur shkurt ose janë neglizhente në përshkrimin e funksioneve të gjërave si shërbëtorë të Zotit në bindjen më të skajme ndaj urdhërave të Tij të krijimit dhe jetës duke treguar Emrat dhe aktet e Krijuesit të tyre, Kurani hyn në detaje.

Shkurtazi: Kurani shpjegon kuptimet e librit të universit dhe për çfarë i referohet, ndërsa shkenca përshkruan vetëm strukturën materiale të ‘shkronjave’ të këtij libri së bashku me pozitat e tyre dhe lidhjet reciproke. Shkenca nuk na tregon ne se të gjitha gjërat ose krijesat janë fjalë kuptimplote. Në qoftë se ti do të doje të shihje diferencën ndërmjet qëndrimit të filozofisë e të shkencës dhe urtësisë së Kuranit, ju mund t’i referoheni ‘Fjalës së Dymbëdhjetë’ tek koleksioni i ‘Fjalëve’. Atje ky ndryshim shpjegohet nga këndvështrimi i vërsetit Kuranor:

وَمَنْ يُؤْتَ الْحِكْمَةَ فَقَدْ أُوتِيَ خَيْرًا كَثِيرًا

“Dhe atij të cilit i është dhënë hikmeti –urtësia– vërtet që i është dhuruar mirësi e madhe”¹⁷³.

Pika e Pestë: Ju do ta gjeni këtë pikë të shtjelluar tek ‘Një dritë prej dritave të vërseteve të Kuranit’, që është kapitulli i fundit i këtij libri.

Pika e Gjashtë: Mësoje, o shok! Ashtu siç është pohuar tashmë në pikën e katërt lartë, Kurani thekson aspektet e gjërave që tregojnë aktet e të Gjithëfuqishmit dhe si ato manifestojnë Emrat e Tij xh.sh, qoftë i Lartësuar! Kurani gjithashtu shpjegon se si aktet Hyjnore burojnë prej Emrave Hyjnorë dhe si, duke qenë rrezet e Atributeve Hyjnore, Emrat i rrethojnë e i përfshijnë gjërat.

¹⁷²Kur’an, 7:204

¹⁷³Kur’an, 2:269

Shkurtazi: Kurani i trajton krijesat me aspektet e tyre se tregojnë Krijuesin e tyre. Sa për shkencën, ajo i studion krijesat me aspektet e tyre se tregojnë vetveten dhe shkaqet e tyre. Qëllimi i shkencës fokusohet tek përfitimet e pjesshme shkencore ose teknologjike që japin gjërat. Çfarë injorance do të kishte ai i cili mburret me shkencën dhe filozofinë dhe i merr ato si kriter përmes të cilave të vlerësojnë shprehjet e shenjta të Kuranit.

● Pikërrima e Pestë

Mësoje, o shok! Njëra nga shkretimt e Kuranit, ashtu siç vërtetohet nga shkencat e semantikës dhe stilit retorik, është se ai kombinon e bashkon rrjedhshmërinë e shkëlqyer të stilit, një mbështetje të fortë të ndërsjellë dhe koherencë, harmoni dhe ndihmë midis fjalive dhe elementëve të tij. Ai shfaq një korrespondencë të jashtëzakonshme midis vërseteve të tij dhe kuptimeve të tyre. Ndonëse ai u shpall pjesë-pjesë për njëzet vite me raste të ndryshme, dhe ndonjëherë si përgjigje të pyetjeve dhe rrethanave specifike, ai shfaq një harmoni të tillë të mrekullueshme dhe lidhje logjike saqë është sikur të ishte shpallur vetëm për një rast ose në përgjigje të vetëm një pyetjeje.

Gjithashtu, ai erdhi për të vendosur disa rregulla ose për të shpjeguar disa urdhëresa për raste të ndryshme dhe e përshtati veten për kuptimin e njerëzve të ndryshëm, me stile të ndryshme, me shije e qasje. Por, ai ka një renditje të tillë të mahnitshme dhe një lëvim stili, saqë sikur ai të kishte ardhur për një shkak të veçantë dhe për të kënaqur një shije të vetme dhe për një nivel të të kuptuari. Për më tepër, ai ka një qartësi të tillë shprehjeje, bukuri diksioni dhe pastërti stili, saqë, megjithëse ai merr parasysh çdo nivel kuptimi dhe njohjeje, gjithësecili mendon se Kurani i adresohet pikërisht atij. Përsëri, megjithëse ai erdhi për të udhëhequr të gjithë njerëzit e kapaciteteve të ndryshëm për çdo nivel të veçantë arritje në udhëzim pa asnjë shmangie fare, ai ruan balancën në mënyrë aq të përsosur sikur ai të kishte synuar vetëm një pikë arritjeje në udhëzimin e tij. Kështu, kushdo që ka perceptim të shëndoshë sigurisht që do ta shohë në Kuran një pikëpamje që e merr të gjithë universin me dimensionet e tij të brendshme e të jashtme sikur ai të shikonte një faqe të vetme, dhe do të shihte gjithashtu se Kurani i zbulon të gjithë kuptimet e tij dhe ia jep mësim ato cilitdo që ai dëshiron.

● Pikërrima e gjashtë

Kjo është për të shpjeguar se Kurani nuk mund të krahasohet me asnjë libër apo ligjëratë tjetër.

Mësoje, o shok! Çdo ligjëratë e nxjerr fuqinë e saj, bukurinë dhe lartësinë jo vetëm nga koha, vendi dhe rasti që përcakton rrugën ose mënyrën e të folurit dhe të subjektit – temës, por gjithashtu edhe nga tre gjëra të tjera: nga ai që flet, nga ata për të cilët flitet, dhe nga qëllimi. Ti shiko atë që flet, për kë flet dhe për çfarë e flet dhe në çfarë rrethanash ka folur. Për më tepër, në qoftë se ligjëratat përmban ndonjë urdhëresë apo ndalesë, ai i cili flet duhet të ketë ndonjë autoritet apo fuqi dhe sa më i madh të jetë autoriteti apo fuqia e folësit, aq më e fuqishme dhe e lartë është ligjëratat e tij.

Shikoje autoritetin e fuqisë Hyjnore në urdhrin, për shembull,

كَأَمَّ يُلْحِقَهَا ضُرًّا أَلِيًّا لَعِيقًا

“O tokë! Gëlltite ujin tënd! Dhe o qiell! Përmbaje shiun tënd!”¹⁷⁴

ثُمَّ اسْتَوَىٰ إِلَى السَّمَاءِ وَهِيَ دُخَانٌ فَقَالَ لَهَا
وَاللَّأَرْضِ انْتَبِيَا طَوْعًا أَوْ كَرْهًا قَالَتَا أَتَيْنَا طَائِعِينَ

“Ai i tha atij (qiellit) dhe tokës: ‘Ejani të dy ju me dëshirë a pa dëshirë’. Ata të dy (qielli dhe toka) thanë: Ne vijmë me dëshirë e të nënshtruar”¹⁷⁵.

Shikoje se sa e ndryshme është prej fuqisë njerëzore që nuk ka asnjë autoritet mbi qiellin dhe tokën. Ndryshimi është si ajo nëpërmjet një urdhëri prej një Komandanti Absolut të Cilit i bindet një ushtri e fuqishme e disiplinuar dhe midis urdhrit të një individi, personit ose urdhërit të të cilit askush nuk i kushton as edhe vëmendjen më të vogël.

Shikoje ndryshimin midis:

¹⁷⁴Kur’an, 11:44

¹⁷⁵Kur’an, 41:11

إِنَّمَا أَمْرُهُ إِذَا أَرَادَ شَيْئًا أَنْ يَقُولَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ

“...Kur Ai do një gjë, është vetëm t’i thotë asaj ‘Bëhu’ dhe ajo është bërë (në çast)!”¹⁷⁶ dhe ndërmjet fjalëve njerëzore, shiko tek:

أَفَلَمْ يَنْظُرُوا إِلَى السَّمَاءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَاهَا وَزَيَّنَّاهَا وَمَا لَهَا
 مِنْ فُرُوجٍ ۗ وَالْأَرْضِ مَدَدْنَاهَا وَالْقِينَا فِيهَا رِوَابِي وَأَنْبَتْنَا
 فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجٍ بَهِيجٍ ۗ تَبْصِرَةٌ وَذِكْرَىٰ لِكُلِّ عَبْدٍ مُنِيبٍ ۗ
 وَزَلَّلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً مُبَارَكًا فَأَنْبَتْنَا بِهِ جِبَاتٍ وَحَبَّ الْحَبِيدِ ۗ
 وَالنَّخْلَ بَاسِقَاتٍ لَهَا طَعْمٌ نَضِيدٌ ۗ رِزْقًا لِلْعِبَادِ وَأَحْيَيْنَا بِهِ بَلْدَةً
 مَيْتًا كَذَلِكَ الْخُرُوجُ ۗ

“A nuk e kanë parë qiellin mbi ta, si Ne e kemi zbukuruar, dhe s’ka asnjë të çarë në të! Edhe tokën! Ne e kemi shtrirë atë dhe kemi vendosur në të male që qëndrojnë fort, si dhe kemi sjellë në të çdo lloj bime të mrekullueshme në çift. Një ndriçim e përkujtues për çdo rob që i kthehet Allahut. Dhe Ne zbresim ujë të bekuar nga qielli, pastaj Ne rrisim me të kopshte dhe drithë që rritet e korret. Edhe hurma të larta me vile të renditura palë, rizk (furnizim e mirësi) për robët (e Allahut), dhe Ne i japim jetë me të (shiu) një toke të vdekur. Kësisoj do të jetë ringjallja (e të vdekurve)”¹⁷⁷.

Dëgjoji këto fjalë Hyjnore dhe shihe ndryshimin ndërmjet përshkrimeve të Pronarit të Vërtetë, urdhërat e të Cilit janë absolutisht autoritarë, me ndikim të madh, i Cili përshkruan aktet e Tij në numërimin e mirësive të Tij, dhe cekëtinë e përshkrimeve njerëzore të palidhura me aktet dhe mirësinë Hyjnore. Sa i madh është ndryshimi ndërmjet ‘engjëjve’ të fjalëve të Fjalës së Krijuesit të diellit dhe të

¹⁷⁶Kur’an, 36:82

¹⁷⁷Kur’an, 50:6-11

hënës që përhapin dritat e udhëzimit, dhe midis zhurmës murmuritëse të qenieve njerëzore ‘duke u fryrë nyjeve’ të ambicieve të tyre të kota. Sa të ndryshme janë fjalët e Kuranit, të cilat janë sedefët e perlave të udhëzimit dhe burimi i të vërtetave të besimit dhe i themeleve të Islamit, që kanë dalë prej Fronit më të lartë të të Gjithëmëshirshmit. Ato përmbajnë adresimin e përjetshëm të ngulur e të mbërthyer në Njohjen Hyjnore, Fuqinë dhe dëshirën Hyjnore. Sa të ndryshme janë ato prej fjalëve të zbrazura e prej fantazisë e dëshirave të njeriut. Kurani është si një pemë e cila ka lëshuar degë, është gjethëruar e lulëzuar dhe ka dhënë frutin e botës Islame me vlerat e saj shpirtërore, me parimet, plotësitë dhe me dijetarët e pastër dhe Evlijatë – shenjtoret. Saqë shumë prej bërthamave që ka prodhuar kjo pemë e ndritshme Tuba, si parimet e etikës, janë rritur e bërë pemë frutdhënëse. Është deklaruar rreth saj:

قُلْ لَئِنِ اجْتَمَعَتِ الْإِنْسُ وَالْجِنُّ عَلَىٰ أَنْ يَأْتُوا بِمِثْلِ هَذَا الْقُرْآنِ
لَا يَأْتُونَ بِمِثْلِهِ وَلَوْ كَانَ بَعْضُهُمْ لِبَعْضٍ ظَهِيرًا

“Thuaj: Nëse njerëzimi dhe xhindët do të mblidheshin të gjithë bashkë të nxirrnin ngjasimin e këtij Kurani, ata nuk do ta bënin dot përngjasimin e tij, edhe sikur ta ndihmonin njëri –tjetrin”¹⁷⁸.

Kurani është i veçantë dhe përtej të gjithë krahasimit me bukurinë e rregullit dhe të përpilimit të tij, me origjinalitetin dhe veçorinë e stileve të tij, epërsinë, shkëlqimin dhe qartësinë e shpjegimeve të tij, fuqinë dhe të vërtetën e kuptimeve të tij dhe me pastërtinë dhe rrjedhshmërinë e gjuhës së tij. Kuptimi i tij është aq gjithëpërfshirës saqë parimet e të gjithë juristëve të saktë –muxtehëve– shijet e të gjithë arifinëve, njohësve të realitetit, dhe rrugët e të gjithë udhëtarëve për tek Zoti, e të pastërtive dhe e dijetarëve të plotësuar, që të gjithë e kanë burimin tek Kurani. Ai ka qenë në gjendje të mbetet origjinal dhe i freskët gjatë gjithë shekujve. Madje me kalimin e kohës ai është bërë gjithnjë e më i freskët, dhe ka përmbushur e kënaqur të gjitha nivelet e njohjes dhe të kuptuarit në çdo shekull. Ai i ka heshtur (me argumenta) ata më të shquarit në elokuencë e retorikë. Në të vërtetë, ai e ka bërë të gjithë njerëzimin të paafhtë për të prodhuar madje një vërslet të vetëm si ai.

¹⁷⁸Kur’an, 17:88

Kështu, ndryshimi midis tij dhe fjalëve njerëzore është aq i madh sa ai ndërmjet qiellit më të lartë dhe tokës. Madje fjalët e të gjithë njerëzimit nuk mund të krahasohen me të.

اللَّهُمَّ صَلِّ وَسَلِّمْ عَلَیْهِذَا الذَّاتِ النَّوْرَانِ الَّذِي أَنْزَلَ عَلَیْهِ الْقُرْآنَ الْحَكِيمَ
 مِنَ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ مِنَ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ أَعْنَى سَيِّدِنَا مُحَمَّدٍ أَلْفَ
 أَلْفِ صَلَاةٍ وَ أَلْفِ أَلْفِ سَلَامٍ بِعَدَدِ حَسَنَاتِ أُمَّتِهِ عَلَيَّ مَنْ
 بَشَّرَ بِرِسَالَتِهَا التَّوْرِيَّةَ وَالْإِنْجِيلَ وَالزَّبُورَ ، وَ بَشَّرَ بِنُبُوتِهِ
 الْإِزْهَاصَاتُ وَ هُوَ اتَّفَقَ الْجَبُّوْ أَوْلِيَاءُ الْإِنْسُوْكَوْ هُنَالِ الْبَشْرِ ، وَ انْشَقَّ
 بِإِشَارَتِهِ الْقَمَرُ سَيِّدِنَا وَمَوْلَانَا مُحَمَّدٍ أَلْفَ أَلْفِ صَلَاةٍ وَ أَلْفَ أَلْفِ سَلَامٍ بِعَدَدِ
 أَنْفَاسِ أُمَّتِهِ ۞ عَلِمْنَا بِأَنَّ لَدَى عَوْتِهِ الشَّجَرُ ، وَ نَزَلَ سُرْعَةً بِدُعَائِهِ
 الْمَطْرُ ، وَ أَظَلَّتْهُ الْعَمَامَةُ مِنَ الْحَرِّ ، وَ شَبِعَ مِنْ صَاعٍ مِنْطَعَامِهِ
 مِثَاتٌ مِنَ الْبَشْرِ ، وَ نَبَعَ الْمَاءُ مِنْ بَيْنِ أَصَابِعِهِ ثَلَاثَ مَرَّاتٍ
 كَالْكُوْثْرِ ، وَ سَبَّحَ فِيكَفِيهِ الْحَصَاةُ وَ الْمَدْرُ ، وَ أَنْطَقَ اللَّهُ لَهُ
 الضَّبَّ وَ الطَّبِيَّ وَ الذَّنْبَ وَ الْجُدْعَ وَ الذَّرَاعَ وَ الْجَمَلَ وَ الْجَبَلَ وَ
 الْحَجَرَ وَ الشَّجَرَ صَاحِبُ الْمِعْرَاجِ وَ مَا زَاغَ الْبَصْرُ سَيِّدِنَا وَ
 مَوْلَانَا وَ شَفِيعِنَا مُحَمَّدٍ أَلْفَ أَلْفِ صَلَاةٍ وَ أَلْفَ أَلْفِ سَلَامٍ بِعَدَدِ
 كُلِّ الْحُرُوفِ الْمُتَشَكِّلَةِ فِي الْكَلِمَاتِ الْمُتَمَثِّلَةِ بِأَذْنِ الرَّحْمَنِ فِي
 مَرَايَا تَمْوُجَاتِ الْهَوَاءِ عِنْدَ قِرَاءَةِ كُلِّ كَلِمَةٍ مِنَ الْقُرْآنِ مِنْ كُلِّ
 قَارِءٍ مِنْ أَوَّلِ النُّزُولِ إِلَى آخِرِ الزَّمَانِ وَ اغْفِرْ لَنَا وَ ارْحَمْنَا يَا
 إِلَهَنَا بِكُلِّ صَلَاةٍ مِنْهَا آمِينَ آمِينَ آمِينَ

O Zot! Për hir të Kuranit dhe për hir të atij të cilit iu shpall Kurani, ndriçoji zemrat tona me dritën e Kuranit. Dhe bëje Kuranin shërim për sëmundjen tonë, dhe një shok për ne, si gjatë kësaj jete dhe pas vdekjes. Gjithashtu, bëje atë shok të ngushtë për ne në botë, një shok në varr dhe një ndërmjetësues Ditën e Gjyqit. Bëje atë një dritë në Urën e Siratit, dhe prej zjarrit bëje atë një perde dhe një mbulesë, bëje një shok në Parajsë dhe një udhëzues e lider për të gjithë të mirën, nëpërmjet mirësisë, mëshirës, bujarisë dhe favorit Tënd, o më Bamirësi

i bamirësve dhe o më Mëshiruesi i mëshiruesve! Dhuro bekime e paqe mbi atë, të cilit i zbrite Kuranin dhe që e dërgove si një mëshirë për të gjithë botërat, dhe mbi familjen e tij –Ehlibejtin– dhe sahabët, ashtu siç do të të kënaqë Ty dhe atë dhe siç do të jetë e aprovuar nga Ti, o Zoti i botëve.

O Shpallësi i Kuranit! Për hir të Kuranit bëje këtë libër zëvendësin tim që të thotë këtë dua në vendin tim kur vdekja të më ketë heshtur gjuhën time. Amin, një mijë herë Amin!

Kjo është për të shpjeguar njërin prej xhevahirëve në thesarin e vërsetit:

“Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë”¹⁷⁹

Mësoje, o Said që e ke harruar veten tënde dhe detyrën tënde jetike, dhe që je i pavetëdijsëm për urtësinë në krijimin e njeriut dhe injorant për atë që ka vendosur Autori i Gjithurtë në krijesa të stolisura! Ndërtimi i këtij universi dhe përfshirja në të e botës humane mund të shpjegohet nëpërmjet shëmbëlltyrës vijuese:

Ndodhet një mbret që ka thesare plot me xhevahire të llojeve të ndryshme dhe thesare të fshehur. Ai gjithashtu është tejet i talentuar në bërjen e gjërave origjinale dhe madhështore dhe është i specializuar pothuajse në të gjitha shkencat e profesionet. Ai mbret dëshiron të shfaqë madhëstsinë e mbretërisë së tij dhe shkëlqimin e pasurisë së tij, çudirat e artit të tij dhe mrekullitë e dhuntive të tij. Shkurtazi, ai dëshiron t’i shohë madhëstsinë, plotësinë dhe bukurinë e tij, si me shikimin e tij, po ashtu edhe me shikimin e të tjerëve.

Mbreti ndërton një pallat të madh me shumë kate. Ai e ndan çdo kat në dhoma të ndryshme në përputhje me qëllimet e secilës dhe sipas kërkesave të shkencave përkatëse që ai i njeh. Ai e zbukuron pallatin me xhevahiret në thesaret e tij dhe me stolitë e artit të tij të bukur, dhe vendos një shenjë ose një vulë mbi çdo gjë në të, në një mënyrë për të shfaqur dhuntitë e tij të mrekullueshme, njohjen dhe fuqinë. Ai vendos në dhoma tavolina –tryeza– mbi të cilat ndodhen lloje të panumërta të ushqimeve të shijshme për të ekspozuar dorëgjërësinë e tij. Ai bën shumë gjëra të tjera për të shfaqur plotësitë e tij të fshehura. Pastaj, ai u bën ftesë nënshtrësve të tij për të pasur një kohë të këndshme dhe u jep një gosti të pakrahasueshme. Është sikur çdo kafshë të ishte një produkt i qindra prej dhuntive të holla dhe i arteve. Pastaj, ai cakton një mësues për të bërë të njohur çfarëdo që ndodhet në atë pallat dhe kuptimin e të gjitha stolive dhe dekoreve që ai ka. Mësuesi gjithashtu duhet të përshkruajë se në çfarë mënyrash, mobiljet, xhevahiret dhe stolitë

¹⁷⁹Kur’an, 51:56

tregojnë për plotësitë e pronarit të pallatit, dhe për t'u mësuar njerëzve mënyrën e hyrjes në pallat dhe si të sillen ndaj ndërtuesit të tij. Ai u thotë atyre:

“O njerëz! Pronari dëshiron ta bëjë vetveten të njohur për ju nëpërmjet çfarëdo gjëje që është në pallat, prandaj njiheni atë. Ai gjithashtu dëshiron ta bëjë vetveten të dashur nga ju nëpërmjet këtyre stolive dhe mirësive, prandaj duajeni atë dhe shfaqni dashurinë tuaj duke i vlerësuar ato. Ai e shfaq mëshirën e tij mbi ty, kështu falënderojë atë. Ai e manifeston vetveten për ty, kështu shfaqë edhe ti zellin për të shkuar tek prania e tij”.

Mësuesi gjithashtu thotë shumë gjëra të tjera të ngjashme.

Njerëzit futen në pallat dhe ndahen në dy grupe. Njëri grup shikon tek çfarëdo që është në pallat dhe mendon se gjithçka që shihet dhe ndodh duhet të shprehë diçka shumë të rëndësishme. Ata kthehen nga mësuesi dhe i thonë atij:

“Paqja qoftë mbi ty! Çdo gjë duhet të jetë ashtu siç na thua neve. Prandaj, na e mëso neve atë çfarë të ka mësuar pronari yt”.

Mësuesi u flet atyre dhe ata dëgjojnë. Ata veprojnë në një mënyrë për të kënaqur mbretin. Pastaj, mbreti i fton ata tek një pallat i bukur, i papërshtatshëm dhe në një mënyrë që i përshtatet atij, u dhuron atyre të gjitha llojet e ushqimit dhe të pijeve, të cilat në dukje u ngjasojnë atyre në pallatin tjetër, por të cilat janë pafundësisht të shijshme.

Grupi tjetër nuk i kushton vëmendje asgjëje përveç ushqimit dhe vepron sikur të ishte i verbër ose shurdh ndaj të gjitha bukurive dhe dallimeve të pallatit. Ata hanë sikur të ishin kafshë dhe pastaj flenë. Ata pijnë pije të ndaluara për ta, dhe duke u bërë të dehur, shprehin gjëra të neveritshme dhe u bëjnë shumë dëm të tjerëve. Si rrjedhojë, ushtarët e mbretit i kapin ata dhe i fusin në burg.

Ti e di se mbreti e ka ndërtuar pallatin për qëllimet e përmendura dhe e ka bërë realizimin e atyre qëllimeve të varura nga ekzistenca e mësuesit dhe nga bindja e njerëzve ndaj tij. Kështu, është e përshtatshme të thuhet: “Po të mos ishte ky mësues, mbreti nuk do ta kishte ndërtuar pallatin”; dhe në qoftë se njerëzit nuk i kushtojnë

vëmendje instruksioneve të mësuesit, pallati do të shkatërrohet dhe një tjetër do të ndërtohet në vend të tij për qëllime të tjera.

Në qoftë se e kap kuptimin e shëmbëlltyrës, ti mund ta shohësh formën e të vërtetës. Pallati është kjo botë, tavani i së cilës është stolitur me llampat vezulluese dhe dyshemeja me lulet buzëqeshëse. Mbreti është Monarku i përjetësisë.

“Atë e madhërojnë shtatë qiejt dhe toka, dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë duke e lavdëruar”¹⁸⁰

“Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që krijoi qiejt dhe tokën për gjash të ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin Hyjnor. Ai me errësirën e natës mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përkulen urdhërit të Tij...”¹⁸¹

Banesat janë botërat brenda botës, dhe xhevahiret dhe stolitë janë mrekullitë e fuqisë së Tij. Llojet e ushqimit janë frutat e mrekullueshëm të mëshirës së Tij. Thesaret plot me xhevahire dhe thesaret e fshehur janë Emrat e Shenjtë Hyjnorë dhe manifestimet e tyre. Të gjitha bukuritë, vizatimet dhe dekoret tregojnë ato Emra. Sa për mësuesin, Ai është prijësi ynë Muhammedi a.s.m.. Profetët e tjerë janë të gjithë shokët e tij, kurse të gjithë evlijatë, Zoti qoftë i kënaqur me ta janë studentët e tij. Ndodhen shumë shërbëtorë të bindur në pallat, të cilët janë melekët, paqja qoftë mbi ta. Njerëzit e ftuar për tek pallati janë qëniet njerëzore dhe qëniet e tjera të gjalla. Dy grupet janë njerëzit e besimit dhe të Kuranit, të cilët shpjegojnë kuptimin e të gjitha ‘vërseteve’ të librit të krijimit, ndërsa grupi tjetër janë njerëzit e mosbesimit dhe të mosbindjes, të cilët ndjekin nefsin dhe shejtanin. Ata që i përkasin grupit të dytë janë:

¹⁸⁰Kur’an, 17:44

¹⁸¹Kur’an, 7:54

“(Ata nuk janë tjetër) veçse si bagëti. Madje, ata janë edhe më të larguar nga rruga e drejtë”¹⁸²

Sa për fatlumët dhe të devotshmit, ata i kushtuan vëmendje shërbëtorit i cili e bëri Zotin e tij të njohur me lutjen e tij të tillë si “Xhaushan El Kebir” dhe që komunikoi Kuranin e shenjtë. Ata e dëgjuan Kuranin dhe u bënë vëzhguesit e bukurive të sovranitetit të Hyjnisë së Tij. Ata e lavdëruan dhe e lartësuan Atë, pastaj shpallën mrekullitë e manifestimeve të Emrave të Shenjtë. Ata e lavdëruan dhe e lartësuan Atë, duke njohur me shqisët e tyre përmbajtjet e thesareve të Mëshirës së Tij dhe duke e falënderuar Atë. Ata gjithashtu i njohën xhevahiret në thesaret e Emrave të manifestuar në masa të caktuara në përputhje me kapacitetin e tyre për t’i marrë ato, dhe e shenjtëruan Atë duke e lavdëruar. Ata i studiuuan mesazhet e Penës së Fuqisë duke e vlerësuar dhe duke reflektuar mbi to. Ata morën kënaqësi të madhe shpirtërore në vëzhgimin e bukurive të krijimit dhe u mbushën me dashuri për Krijuesin, dhe u përmalluan për të shkuar për tek prania e Tij. Ata iu përgjigjën dëshirës së Autorit për ta bërë Vetveten të njohur nëpërmjet mrekullive të artit të Tij duke u përpjekur të fitojnë njohje rreth Tij, dhe thanë me habi: “Lavdia qoftë për Ty! Ne nuk jemi në gjendje të të njohim Ty siç kërkohet njohja për Ty, o i Njohuri i Vetëm, nëpërmjet të gjitha krijesave të Tua të mrekullueshme”.

Gjithashtu, ata iu përgjigjën dëshirës së Tij për t’u dashur prej tyre duke e dashur Atë nëpërmjet zburimeve të frutave të mëshirës. Ata iu përgjigjën kthimit të Tij ose prirjes ndaj tyre me kënaqësitë e mirësive të Tij, me lavdërime e falënderime, dhe thanë: “Lavdia qoftë për Ty! Ne jemi të pamundur të të falënderojmë Ty ashtu siç kërkohet nga falënderimi për Ty, o i Falënderuar i Vetëm, nëpërmjet lëvdatave të mirësive të Tua mbi tërësinë e krijimit, dhe nëpërmjet ekspozitave të të gjitha mirësive të Tua dhe shijeve të tyre në tregun e universit, dhe dëshmimeve të melodive të të gjitha frutave të Mëshirës Tënde dhe të favorizimit”.

Ata iu përgjigjën me sexhde në dashuri, habi e përlulësi të skajme ndaj shfaqjes së Tij madhështinë e Tij, plotësinë, bukurinë dhe madhërinë e Tij në çfarëdo që ndodhet në univers, në pasqyrat e krijesave duke ardhur në botë dhe pastaj duke u larguar njëra pas

¹⁸²Kur’an, 25:44

tjetrës. Ata iu përgjigjën shfaqjes së Tij mëshirën e Tij gjithëpërfshirëse dhe pasurisë së Tij të pafundme me njohjen dhe pranimin e varfërisë së tyre duke iu përgjiguar e duke i kërkuar Atij. Ata gjithashtu iu përgjigjën ekspozimit të Tij hollësive të artit të Tij me vlerësim e vëzhgim dhe duke i dëshmuar ato. Ata iu përgjigjën shpalljes së Tij sovranitetin e Hyjnisë së Tij gjithandej universit, me besim në Unitetin e Tij, me bindje dhe adhurim duke e njohur e pranuar pafuqinë e tyre, dobësinë dhe varfërinë.

Shkurtazi, ata i përmbushën detyrat e tyre jetike në këtë banesë dhe ishin më të plotësuarit, më të lartët se të gjitha krijesat, duke zbatuar amanetin më të madh që ata e patën mbajtur si kalifë të besuar në tokë. Pastaj, Zoti i tyre i ftoi tek banesa e paqes për lumturi të përjetshme dhe u dhuroi atyre mirësi e bekime të tilla çfarë sytë kurrë nuk i kanë parë, as veshët nuk i kanë dëgjuar dhe as mendjet kurrë nuk i kanë imagjinuar.

Sa për grupin tjetër të të shtururve dhe keqbërësve, ata nuk besuan në Autorin Krijues dhe me mosbesimin e tyre i përbuzën dhe i përçmuan të gjitha krijesat dhe e zvogëluan vlerën e tyre vetëm tek lënda e tyre materiale. Ata i mohuan të gjitha manifestimet e Emrave dhe kryen një krim pafundësisht të madh dhe merituan një ndëshkim të pafundmë.

Mësoje, o Said i mjerë! A mendon ti se detyra jote në jetë është ruajtja e vetvetes, duke marrë në konsideratë vetëm nevojat e nefsit shtazor dhe duke u shërbyer barkut dhe dëshirave të tua? Ose a supozon ti se qëllimi për të gjitha ato shqisa, ndjenja, sisteme, organe, gjymtyrë dhe aftësitë në mekanizmin e jetës tënde është t'i përdorësh ato për kënaqësinë e kapriçove të nefsit tënd në këtë jetë kalimtare? Jo! Përkundrazi, ato u përfshinë në krijimin tënd me qëllim që ti t'i përdorësh ato për të perceptuar të gjitha shumëllojshmëritë e mirësive të të Gjithëfuqishmit dhe llojet e manifestimeve të Emrave të Tij. Duke i përdorur të gjitha shqiset e tua dhe aftësitë si masa, ti duhet t'i vlerësosh përmbajtjet e thesareve të manifestimeve të Emrave të Tij, madhështia e Tij qoftë e lartësuar. Detyra jote jetike është të shfaqësh midis bijve të llojit tënd mrekullitë e manifestimeve të Emrave të Tij dhe pastaj të shpallësh robërinë tënde edhe me fjalë, edhe me punë tek dera e Hyjnisë së Tij. Dhe pastaj ti duhet ta stolisësh veten tënde me xhevahirët e manifestimeve të Emrave të Tij dhe t'i ekspozosh ato para

shikimit të të Dëshmuarit të Parapërdjetshëm. Gjithashtu, ti duhet të kuptosh përshëndetjet dhe tesbihatet e qënieve të gjalla për Dhuruesin e jetës dhe të dëshmosh për to dhe t'i thërrasësh edhe të tjerët gjithashtu për të njëjtën dëshmi. Përsëri, duke i përdorur atributet e tua, cilësitë dhe aktet si mjete krahasimi, ti duhet gjithashtu të perceptosh Atributet e Krijuesit tënd, Cilësitë esenciale të shenjta të Tij. Gjithashtu, duke shikuar varfërinë tënde dhe pafuqinë, ti duhet të kuptosh shtrirjen e manifestimeve të Fuqisë së Tij dhe të pasurisë.

Natyra e jetës është ajo që duhet të shërbejë si një thesar prej shqisash dhe aftësish, një hartë, një model, një indeks dhe një masë, për të njohur veprat e mrekullueshme të manifestimeve të Emrave të Krijuesit të vdekjes dhe të jetës. Jeta jote mund të përfytyrohet si një fjalë e shkruar, e dëgjuar dhe e perceptuar, e përbërë nga Emrat e Bukur. Realiteti i saj është se ajo është një pasqyrë për reflektimin e Unitetit Hyjnor. Plotësia e saj dhe lumturia qëndrojnë në qënien e saj të vetëdijshme për atë që ajo mishëron dhe të ndjejë dashuri e përmallim për Atë që ajo shërben si pasqyrë.

Sa për qëniet e tjera të gjalla, ato kanë një pjesë prej këtyre qëllimeve, por jo aq shumë sa të tuat. Sepse ti je një pasqyrë gjithëpërfshirëse, ashtu siç rrëfëhet që Allahu të ketë deklaruar:

“As qiejt dhe as toka nuk më nxënë Mua, por zemra e shërbëtorit Tim besimtar më nxë Mua”.

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

O Allah! O i Gjithëmëshirshëm! O Mëshirëplotë! O Unik! O i Gjallë i Përjetshëm! O Vetekzitues i Përhershëm! O Gjykues! O i Drejtë! O i Shenjtë! Për hir të Emrit Tënd më të madh dhe për hir të vërseteve të Kuranit Tënd të gjithurtë, jepi bekime prijësit tonë Muhammedit a.s.m, profetit Tënd më të nderuar, sa numrat e grimcave të trupave tonë dhe sekondave të jetëve tona. Dhe zbrit mbi ne dhe mbi botuesit e këtij libri, dhe mbi të gjithë studentët e Risale–i Nurit paqën, sigurinë dhe qetësinë, ashtu siç i zbritte ato mbi sahabët dhe mbi familjen e profetit Tënd të zgjedhur a.s.m.. Dhe zbrit mbi ne dhe mbi studentët e Risale–i Nurit qetësinë dhe bekimin e sinqertë dhe sigurinë e plotë dhe nijetin e pastër dhe qëndrueshmërinë më të plotë në shërbimin e Kuranit dhe të besimit. Na siguro neve kundër frikësimeve duke larguar risitë antifetare të përfshira në parimet dhe në simbolet publike të Islamit dhe gëzoji zemrat tona me shpalljen e esencave të Islamit gjithandej botës sa më shpejt të jetë e mundur, dhe me përhapjen gjerësisht të Risale–i Nurit midis botës Islame. Na siguro neve! Siguroje fenë tonë dhe siguroji studentët e Risale–i Nurit kundra sulmeve të heretikëve. Na furnizo neve dhe furnizoji studentët e Risale–i Nurit me siguri e shpëtim në fe, në dynja dhe në Ahiret. Na shëro neve prej sëmundjeve tona dhe bëje Kuranin si një shërim për ne e për ata për të gjitha sëmundjet tona dhe të tyre. Dhe na përfshij neve dhe ata midis atyre që gjithmonë të lavdërojnë e të falënderojnë Ty. Amin.

Dhe i Gjithë lavdërimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botëve. Dhe Allahu i dhëntë bekime prijësit tonë Muhammedit dhe të gjithë famijes së tij dhe sahabëve të tij.

Një rreze

Prej Diellit të Kur'anit

Mësoje! Krijuesi i Gjithurtë ka instaluar në trupin tënd të gjitha shqisat, ndjenjat dhe sistemet për të perceptuar shumëllojshmëritë e mirësive të Tij, për të përjetuar larminë e manifestimeve të Emrave të Tij.

Qëllimi për jetën tënde është se ti duhet të shfaqësh veprat e manifestimeve të Emrave dhe për të ekspozuar mrekullitë para shikimeve të krijesave. Humanizmi yt qëndron në qënien i vetëdijshëm për këtë detyrë. Qënia jote një musliman varet nga bindja jote për këtë nder që të është dhënë ty.

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Lëvdata është prej Allahut dhe për Allahun, siç është e meritueshme nga Allahu. Lavdi Allahut sepse lavdërimi është për Allahun.

O Zot! Ne i paraqesim për Ty para të gjitha mirësive dhe veprave të mëshirës, para të gjithë shembujve të favorizimit dhe urtësisë, para të gjithë shembujve të jetës dhe të vdekjes, para të gjitha kafshëve dhe bimëve, para të gjitha frutave, para të gjitha veprave të artit Tënd dhe ngjyrimit, para rregullit universal dhe harmonisë, para të gjithë shembujve të ardhjes tek një ndalesë dhe lëvizjes në të gjitha grimcat e botës dhe në përbërësit e tyre, dëshminë që ne dëshmojmë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut. Ai është Një pa asnjë ortak. I Tij është mbretërimi i të gjithë ekzistencës dhe i Tij është e gjithë lëvdata. Ai jep jetë dhe Ai shkakton vdekjen. E gjithë e mira është në dorën e Tij dhe Ai është i Plotëfuqishëm mbi të gjitha gjërat. Ne gjithashtu dëshmojmë se Muhammedi është shërbëtori i Tij, profeti, i dashuri dhe i dërguari, të cilin Ai e dërgoi si një mëshirë për të gjitha botërat.

O Zot! Jep bekime mbi Muhammedin, oqeanin e dritave të Tua, minierën e mistereve të Tua, diellin e udhëzimit Tënd, burimin e favorizimit Tënd, gjuhën e provës Tënde. Ai është personi që përfaqëson veprën e fuqisë Tënde dhe dashurinë Tënde, është mishërimi i mëshirës Tënde dhe më i dashuri i krijimit për Ty. Jep bekime mbi të gjithë profetët e tjerë dhe mesazhierët, dhe mbi të gjitha familjet dhe shokët e të gjithë atyre, dhe mbi melekët e Tu të bërë afër Teje. Gjithashtu, bekoji shërbëtorët e Tu të drejtë midis banorëve të qiejve dhe të tokës, për hir të mëshirës Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve.

Lavdia qoftë për Ty, o Ti që universi bën tesbihate me lavdërimin Tënd me gjuhën e Muhammedit të tij, mbi të qofshin bekimet e Tua më të mira dhe paqja.

Lavdia qoftë për Ty, që për Ty bën tesbihat dynjaja me veprat e Muhammedit, mbi të qofshin më të bollshmet e bekimeve të Tua.

Lavdia qoftë për Ty, o Ti që para Teje bën sexhde toka para Fronit të Madhështisë Tënde dhe bën tesbihate me lavdërimin Tënd me gjuhën e Muhammedit të saj, mbi të qofshin më të pastërtat e përshëndetjeve të Tua.

Lavdia qoftë për Ty, o Ti që të gjithë besimtarët dhe besimtare të bëjnë tesbihate për Ty me gjuhën e Muhammedit të tyre, mbi të qofshin përherë bekimet e Tua.

Lavdia qoftë për Ty, unë bëj tesbihate me gjuhën e të dashurit Tënd Muhammedit, mbi të qofshin më të plotat e bekimeve të Tua dhe më e bukura dhe më rrezatuesja e paqës Tënde.

Pranoje prej meje për hir të mëshirës Tënde, siç e pranove prej tij...

Mësoje, o shok! Kuptimi tejet gjithëpërfshirës i vërsetit: “Atë e madhërojnë shtatë qiejt, toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë...”¹⁸³ kërkon shpjegim. Unë u përpoqa për ta shqyrtuar atë dhe ca fjalë shpjegimi pikuan brenda zemrës sime prej tij për të shërbyer si një shkelëz për t’u ngjitur drejt tij. Në qoftë se do të doje t’i përthithje ato fjalë shpjegimi duke pikuar prej oqeanit të

¹⁸³Kur’an, 17:44

këtij vërseti ose duke zbritur prej qiejve të tij shumë të lartë, jepi një dëgjim të mprehtë e të vëmëndshëm asaj që vijon:

Lavdia qoftë për Ty! Ne –komunitetet e njerëzimit– nuk jemi në gjendje të njohim Ty siç e kërkon njohja Jote, o i Njohur i Vetëm nëpërmjet mrekullive të të gjitha veprave të Tua, përshkrimeve të të gjitha krijesave të Tua dhe përkufizimeve të të gjithë ekzistencës.

Lavdia qoftë për Ty! Sa i madh është autoriteti Yt dhe sa e qartë është prova Jote!

Lavdia qoftë për Ty! Ne nuk jemi në gjendje të të përmendim Ty siç e kërkon përmendja Jote, o i Përmendur i Vetëm me gjuhët e të gjitha krijesave të Tua, të veprave dhe të frymëmarrjeve të të gjitha fjalëve të librit të universit Tënd.

Lavdia qoftë për Ty! Sa madhështore është përmendja Jote!

Lavdia qoftë për Ty! Ne nuk jemi në gjendje të të falënderojmë Ty siç e kërkon falënderimi Yt, o i Falënderuar. Ti falënderohesh nëpërmjet të gjithë shembujve të mirësive të Tua të shfaqura para shikimeve të të gjithë atyre që kanë shikim dhe nëpërmjet ekspozimit të të gjitha mirësive të Tua në tregun e universit para të gjithë atyre të cilët i dëshmojnë ato. Ti falënderohesh nëpërmjet dëshmimeve gazmore të të gjitha frutave të mëshirës Tënde, e cila u jep formë atyre frutave në kallëpet e rregullit universal dhe të ekuilibrit.

Lavdia qoftë për Ty! Sa e gjërë është mëshira Jote!

Lavdia qoftë për Ty! Ne nuk jemi në gjendje të të adhurojmë Ty ashtu siç e kërkon adhurimi ndaj Teje, o i Adhuruar nga të gjithë melekët dhe nga krijesat e tjera të Tua në mënyra pafundësisht të ndryshme adhurimi dhe tesbihati.

Lavdia qoftë për Ty! Ne nuk jemi në gjendje të bëjmë tesbihat për Ty ashtu siç e kërkon tesbihati Yt, o Ti që shtatë qiejt dhe toka, dhe gjithçka është në to bëjnë tesbihat për Ty.

Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë me lëvdata. Ne besojmë. Ajo është e vërtetë.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që të gjithë llojet e melekëve bëjnë tesbihat për Ty në gjuhë të ndryshme, në mënyra të ndryshme.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që universi bën tesbihat me gojët e botërave të tij, me gjymtyrët e pjesëve kryesore të tij, me qelizat e gjymtyrëve të tij dhe me grimcat e qelizave të tij, nëpërmjet gjuhëve të rregullit të tij të qëllimshëm, ekuilibrit madhështor, funksionit të mirësishtuar dhe konstruktit të mirëpërpjestuar.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që Parajsa bën tesbihat për Ty me gojët e kopshteve të saj nëpërmjet këngëve të hurive të saj dhe lavdërimeve të pallateve të saj, poemave të pemëve të saj dhe himneve të frutave të saj duke i ngjasuar njëri-tjetrit, dhe shëmbëllimet e tyre në këtë botë bëjnë tesbihat për Ty!

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që ndryshon natën dhe ditën dhe nënshtron diellin dhe hënën. Ti je Ai për të Cilin qiejt bëjnë tesbihat për ty me sistemet e tyre, me gojët e diejve të tyre, me fjalët e yjeve të tyre, nëpërmjet gjuhës së rregullit dhe harmonisë së tyre dhe stolisjes së mirëvendosur, dhe nëpërmjet gjuhës së rrezatimit madhështor, bindjes së tyre absolute, qetësisë së tyre dhe lëvizjeve të tyre të urta.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që atmosfera bën tesbihat me gojët e rrufeve të saj, vetëtimës, erërave, reve, yjeve gjuajtës dhe shiut, nëpërmjet fjalëve të rregullit të saj të ekuilibruar me shumë qëllime të lartësuar.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që toka bën tesbihat për Ty, e rënë në sexhde para madhësisë së fuqisë Tënde me Muhammedin e saj dhe Kuranin, nëpërmjet gojëve të deteve të saj, maleve, lumenjve, pemëve dhe tingujve, dhe dridhjeve të zërave – domethënë me tingujt e bimëve të saj dhe lëvizjeve të kafshëve të saj. Ajo bën tesbihat për Ty me fjalët dritëdhënëse dhe me shkronjat e ndritshme – domethënë me profetët e saj dhe me evlijatë e saj – dhe nëpërmjet gjuhës së rregullit të saj, balancës, jetës dhe vdekjes, dhe varfërisë së saj, thatësisë dhe zbukurimit të saj të pasur me lejen Tënde Gjithëbujare dhe me artin Tënd të Gjithurtë.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që bëjnë tesbihat për Ty detet me fjalët e tyre të kafshëve të çuditshme, dhe nëpërmjet këngëve të tyre dhe gjuhës së rregullit të tyre, balancës dhe të shumë qëllimeve që ato u shërbejnë.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që e ke bërë tokën si një djep dhe malet si shtylla. Malet bëjnë tesbihat për Ty me gojët e tyre të burimeve, lumenjve dhe pemëve, dhe nëpërmjet gjuhës së balancës së tyre, rregullit, qëllimeve që u shërbejnë dhe thesareve të tyre.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që e ke bërë çdo gjallesë prej ‘ujit’, dhe që qëniet me jetë bëjnë tesbihat për Ty me gojët e tyre të shqisave, ndjenjave, sistemeve, organeve, strukturave artistike dhe mendjeve dhe zemrave të tyre. Ato bëjnë tesbihat nëpërmjet gjuhës së skicave të tyre të mirëpërpjestuar, dhe se ato kërkojnë nëpërmjet potencialit të tyre dhe nëpërmjet gjuhës së nevojave të tyre, lutjeve dhe qënieve të tyre të furnizuara, dhe ndryshimeve që ato ndërmarrin, dhe jetëve dhe vdekjeve të tyre.

Lavdia qoftë për Ty! O i Vetëm që për Ty insektet fluturues bëjnë tesbihate me himnet e tyre të falënderimit. Zogjtë bëjnë tesbihate bashkë me të vegjëlit e tyre në foletë e tyre me këngët e tyre të mirënjohjes, nëpërmjet gjuhës së vizatimeve të tyre, të stolisjes dhe të lëvizjeve. Ato shpallin favoret e Tua mbi to dhe si rrjedhojë manifestojnë mirënjohjen e tyre në kohën kur ato shijojnë frutat e mirësive të Tua dhe duke u ushqyer me veprat e mëshirës Tënde. Insektet dhe kafshët e egra gjithashtu bëjnë tesbihate për Ty nëpërmjet gjuhës së përpjesëtimit të shkëlqyer dhe të ekuilibrit në strukturat e tyre, dhe në format e tyre, dhe duke u ushqyer me bollëk bujarisht.

Lavdia qoftë për Ty! Sa i bukur dhe i hollë është arti Yt dhe sa depërtues është sundimi dhe Autoriteti Yt!

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që pemët në mënyrë të dukshme bëjnë tesbihate për ty në kohën e lulëzimit të tyre, të gjethërimit dhe të prodhimit të frutave, dhe në kohën e vallëzimit të frutave në degët e tyre, me gojët e gjetheve të tyre jeshile, me lulet buzëqeshëse dhe me frutat e tyre qeshës. Ato bëjnë tesbihate për Ty nëpërmjet gjuhës së formave dhe vizatimeve të tyre të mirëpërpjestuara, shijeve të tyre, ngjyrave të bukura, aromave të mira, qëndisjeve të hijshme dhe stolive të tyre të shkëlqyera e të pasura. Ato gjithashtu të madhërojnë Ty dhe shpallin plotësinë e dhembshurisë Tënde dhe përshkruajnë manifestimet e Atributeve dhe të Emrave të Tu, dhe interpretojnë bërjen e Vetes Tënde të dashur nëpërmjet krijesave të Tua. Ato gjithashtu bëjnë tesbihate me çfarë shfaqet prej gjymtyrëve të frutave të

tyre, që i përkasin rrezatimit të bërjes së Vetes Tënde të dashur prej krijesave të Tua dhe duke ndërmarrë furnizimin e tyre me rëzk.

Lavdia qoftë për Ty! Sa e hollë është prova Jote në mirëbërësinë Tënde dhe sa e stolisur është hijeshia Jote në bërjen e Vetes Tënde të dashur!

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që bimët bëjnë tesbihate për Ty me qartësi të plotë në kohën e lulëzimit të tyre dhe të gjethërimit dhe të prodhimit të kallinjve, me gojë e luleve të tyre, me kallinj të dhe me fjalët e farërave dhe kokrrave të tyre nëpërmjet gjuhës së formave dhe strukturave të tyre të mirëpërpjestuara. Përsëri, ato të madhërojnë Ty, të bëjnë të njohur dhe e shfaqin 'Fytyrën' Tënde, e cila e bën Vetën Tënde të dashur, dhe ato gjithashtu përshkruajnë Atributet e Tua, përmendin Emrat e Tu, interpretojnë bërjen e Vetes Tënde të dashur dhe bërjen e Vetes Tënde të njohur për shërbëtorët e Tu.

Lavdia qoftë për Ty! Sa e hollë dhe e larmishme është dëshmia për Ty dhe sa rrezatuese dhe e pasur është ajo!

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që e zbritë hekurin në të cilin ndodhen një fuqi e madhe dhe një dobi për njerëzimin; për Ty bëjnë tesbihate mineralet me të gjitha shumëllojshmëritë e tyre, me format, veçoritë, dobitë, stolitë dhe zbukurimet, nëpërmjet gjuhës së rregullit të tyre të mirëvendosur dhe balancës së posaçme.

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që elementet bëjnë tesbihat për Ty nëpërmjet ardhjes së tyre së bashku për të bërë pjesët përbërëse me urdhërin e fuqinë Tënde!

Lavdia qoftë për Ty! O Ti që grimcat bëjnë tesbihat për Ty nëpërmjet gjuhës së rregullit dhe të balancës që ato shfaqin. Ato gjithashtu bëjnë tesbihat për Ty, pavarësisht pafuqisë së tyre absolute në vetvete, në atë çfarë ato kryejnë detyra të mëdha me Fuqinë Tënde. Secia prej tyre dëshmon për Ekzistencën Tënde të domosdoshme nëpërmjet gjuhës së pafuqisë së tyre esenciale për t'i kryer detyrat e larta në rregullin e hollë të krijimit. Për shembull, një farë shumë e vockël mban në vetvete një pemë shumë të madhe. Përsëri, çdo grimcë tregon Njësinë Tënde lidhur me detyrat e saj dhe se lëvizjet e saja janë për të kontribuar për rregullin universal. Shkurtazi, një grimcë dëshmon edhe për ekzistencën Tënde të domosdoshme, edhe për Njësinë, dhe

çdo ngjarje tregon se Ti je Një i Vetëm dhe i Kërkuari përjetësisht. Madje, secila dhe çdo gjë tregon e dëshmon se Ti je Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm, Një i Vetëm dhe i Kërkuari përjetësisht, madhështia Jote qoftë e lartësuar dhe nuk ka zot tjetër përveç Teje, Ti je Një i Vetëm pa asnjë lloj ortaku.

Mësoje, o shok! Me të gjitha gjymtyrët, organet dhe shqisat, trupi yt në thelb i përket Autorit të tij, i Cili e rrit atë dhe e drejton, dhe ajo çfarë bie tek pjesa jote në të është veçse detyra jote për ta ruajtur e për ta përdorur në përputhje me urdhëresat e Zotit.

Në qoftë se, në sajë të përdorimit tënd siç duhet atë, ti do të mund të arrijë një rreze të vetëdijes se si është realisht trupi yt, atëherë ai manifeston se Krijuesi i tij ka njohje absolute rreth tij me esencën e tij dhe me të gjitha aspektet e tij, dhe se Emrat dhe Atributet e Tij manifestohen mbi të.

Në qoftë se trupi yt të shërben ty në ndonjë mënyrë në këtë moment, ai i shërben Autorit të tij me të gjitha aspektet në të gjitha kohët. Ai shfaq shumë vepra të mrekullueshme të Krijuesit të tij të Gjithurtë, dhe duke përmbushur detyrat e tij 'natyrale' me një rregull të plotë dhe nëpërmjet një asistence të ndërsjellë të mahnitshme, ai ekspozon hollësitë e Mëshirës së të Gjithëfuqishmit dhe penjëzat e urtësisë së Tij.

Ti ke një pjesë në trupin tënd dhe të drejtën për të vendosur në të, në raport me njohjen tënde për të dhe me pjesën tënde në ruajtjen e tij. Me të gjitha grimcat e tij dhe me pjesët përbërëse, dhe me të gjithë jetën e tij dhe me veçoritë, ai manifeston se i përket Autorit të vet dhe është nën drejtimin e Tij Absolut.

Me të gjitha aspektet e tij, ekzistenca jote ka një lidhje me të Vërtetin Fuqiplotë dhe me krijimin. Për sa ka të bëjë me lidhjen e tij me të Vërtetin, ti je një vepër e hollë arti, një vepër e thjeshtë dhe e pastër e Krijuesit të qiejve dhe të tokës. Sa për pjesën tënde në ekzistencën tënde dhe vlerën dhe plotësimin e saj, është e mjaftueshme për ty që ti e di se je një vepër Arti e Autorit i Cili i ka stolitur qiejt me yje. Është e mjaftueshme për ty të dish se ti je bërë një vëlla i dashur e i nderuar i universit i cili të shërben ty.

Sa për lidhjen tënde me krijimin, ti je i përbërë prej disa elementëve të cilat kanë ardhur së bashku dhe së shpejti do të ndaheni prej shoqërimit me njëri-tjetrin.

Mos i bëj padrejtësi trupit tënd nëpërmjet përvetësimit të tij padrejtësisht dhe këputjes së lidhjes së tij prej të Vërtetit, gjë e cila do ta bënte atë të pavlefshëm. Madje, edhe në qoftë se ai do të vazhdonte me miliona vite, një ekzistencë e pafrutshme nuk mund të jetë e barabartë në vlerë me një moment të një ekzistence të frutshme, e cila merr manifestimet e Një Ekzistence Absolute të Përjetshme. A nuk e sheh ti se Krijuesi yt i mori elementet materiale dhe i gatoi ato me një pjesë më të vlefshme e të përsosur të krijimit, duke të të dhënë ty një ekzistencë të veçantë e të përcaktuar prej oqeanit të ekzistencës? Si erdhën ato së bashku për të të formuar ty? A shikon ti në tregun e qënies dhe të prishjes ndonjë dyqan në të cilin të blihen sytë apo ndonjë depo ku të gjenden trutë dhe gjuhët, apo ndonjë makineri për të prodhuar zemra dhe për të thurur lëkura? Jo, kurrë, Krijuesi yt të ka ndërtuar ty, të ka krijuar në një formë të zgjedhur të mrekullueshme e gjithëpërfshirëse prej diçkaje që nuk i ngjason asgjëje ose prej gjithçkaje, me qëllim që asgjë, madje edhe sikur të ishte më e madhja e gjërave nuk do të mund të shpresonte të ishte Krijuesi i ndonjë gjëje tjetër, madje sikur kjo të ishte më e vogëla. Ndonjë gjë që është e pamundur të krijojë qiejt nuk mund të pretendojë se ajo mund të krijojë, qoftë edhe një mushkonjë.

Mësoje, o shok! Autori i Aftë e përdor lëndën dhe krijon prej saj vepra të mrekullueshme arti. Vlera e vetë lëndës nuk mund të jetë e barabartë madje as me një të qindtën e artit. Një vepër antike arti mund të kërkonte aq shumë miliona dollar, ndërkohë që materiali i saj nuk është i denjë as për pesë centë. Në qoftë se kjo vepër antike arti do të dërgohej në një treg antikash, ajo do të shitej për vlerën e saj të vërtetë për shkak të artit që ajo përmban dhe emrit të artistit brilant i cili e ka modeluar atë. Ndërkohë, kjo vepër arti mund të shitet me çmimin e hekurit në tregun e hedhurinave.

Shumica, madje, të gjitha krijesat janë secila një mishërim arti. Sidomos qëniet e gjalla, dhe në mënyrë të veçantë të vogëlat midis tyre, shfaqin art të përkryer pavarësisht dendësisë së lëndës. Kështu, çfarëdo që është në univers ka dy aspekte. Për shembull, për sa ka të bëjë me aspektin e saj material dhe me jetën e kësaj bote, furnizimi –rëzku– i

saj shërben për ruajtjen e jetës dhe jep një kënaqësi të pjesshme kalimtare. Ndërsa, për sa ka të bëjë me qënien e saj një art duke shfaqur veprat e manifestuara të Autorit, ajo është një thesar i mrekullueshëm, një thesar i pastër, i mahnitshëm. Ajo shërben për të gjitha mirësitë e Autorit për t'u shijuar e njohur dhe që të përjetohen manifestimet e Emrave *Er-Rezzaku El Kerim, Furnizuesi Gjithëbujar*, dhe ajo u shkakton qënieve të vetëdijshme të ndriçohen nga njohja e atyre Emrave. Nëse dëshiron, shiko gjuhën tënde, e cila është vetëm njëra prej mijëra vegëlave që marrin dhe njohin rëzkun – furnizimin. Pavarësisht masës së saj të vogël, ajo përmban aq shumë instrumente aq sa numri i ushqimeve dhe i pijeve. Në qoftë se pronari i një gjuhe zgjohet dhe bëhet i vetëdijshëm për domethënien e saj, ai do të jepte falënderime për secilën prej atyre instrumenteve të holla për të gjitha shumëllojshmëritë e mirësive, të cilat *Er-Rezzaku, Gjithëfurnizuesi* ia jep atij për t'i shijuar prej mëshirës së Tij.

Kjo do të thotë të jesh falënderues për mirësitë, dhe do të ishte më e këndshme se sa vetë mirësitë që njeriu të jetë i vetëdijshëm për ato me të cilat ai furnizohet dhe që merr favorin ose mirësinë e Dhuruesit të mirësive.

Mësoje, o shok! Nuk ndodhet asgjë që të mos jetë bërë apo krijuar prej Zotit Fuqiptotë që të mos jetë e rregullt dhe e balancuar. Çfarëdo që shihet në këtë botë, në këtë banesë të përkohshme është e rregulluar në përputhje me llogaritje të sakta, me balanca të holla dhe me ekuilibër tejet të drejtëpeshur. Kjo balancë e ky rregull nënkuptojnë, madje në mënyrë të qartë tregojnë ardhjen e Ringjalljes dhe madhështinë e llogarisë dhe të peshojës më të lartë, nëpërmjet të cilës veprat e njeriut do të peshohen në Ahiret. Sepse çfarëdo që ne dëshmojmë këtu si farëra apo si themele shërbejnë si tregues, dëshmi dhe shenja për atë çfarë do të lulëzojë në Ahiret, në Botën tjetër.

Çfarëdo që ne vëzhgojmë në botën e ekzistencës është veçse e bërë ose e krijuar. Shenja e qënies së saj e bërë është aq e qartë saqë ajo gati e shpall atë. Asgjë e mundshme nuk mund të jetë autorja e vetvetes, sepse ajo është shumë e dobët dhe e pafuqishme për të qenë autorja e vërtetë e ndonjë gjëje. Sepse bërja ose ndërtimi, le të themi, e një bime apo e një kafshe kërkon instrumente të ndryshëm, vegëla të ndryshme dhe balanca të holla si balancat e përdorura në përgatitjen e ilaçeve. Asgjë e mundshme nuk e ka asnjërin prej këtyre, as nuk e di se si t'i

përdorë ato, dhe si rrjedhojë ajo nuk mund të ketë krijuar asgjë. Çfarëdo që është e nevojshme për ekzistencën dhe mbajtjen e ndonjë gjëje që mund të gjendet afër ose mbi, ose nën, ose para apo prapa saj, është veçse një prej rrezeve ose manifestimeve të fuqisë së Tij, thesaret e të Cilit janë midis Kaf dhe Nun.¹⁸⁴

Midis Emrave Hyjnorë janë disa si: Folësi, Furnizuesi dhe Dhuruesi e të tjerë, që pranojnë mjete për t'i manifestuar vetvetet nëpërmjet perdeve dhe prej prapa mureve. Ndërsa, disa të tjerë të tillë si: Krijuesi, Shpikësi dhe Jetëdhënësi e të tjerë, nuk pranojnë mjete – ndërmjetësi. Megjithatë, arsyeja se përse Emrat që pranojnë mjete janë kështu nuk është se ato kanë nevojë për mjete për shkak të pafuqisë, por ato i pranojnë ato për shkak se dinjiteti dhe madhështia e tyre i kërkojnë ato të manifestohen prapa perdeve dhe mjeteve – ndërmjetësive.

Mësoje, o shok! Unë kam parë në një pemë që rritet në një shkretëtirë dy lloje frutash dhe jam habitur prej saj. Njëri lloj i tyre u ngjasonte kokrrave jeshile, ndërsa tjetri një lloj kokrrave bizeleje ose fasuleje me masën e gishtërinjve ose më e vogël apo më e madhe. Ato lakoheshin, përkuleshin e gërryeshin si shtëpia e përgatitur për mysafirë. Unë e mora njëren prej tyre, dhe sapo e hapa shumë miza dhe insekte fluturues fluturuan në ajër. Ashtu si zogjtë dhe mizat, ato ishin në rreshta. Ishte pak para se të perëndonte dielli dhe ato nisën të vallëzonin në lëvizje në dalli prej përmendjes së Zotit Fuqplotë; mos mendoni se ato po luanin. Përkundrazi, ato po përmendnin Allahun e Gjithëmëshirshëm në ekstazë, i Cili i mban ato në ajër. Bishtajat e kokrrave të gjëra u shërbenin atyre si çerdhe, si mitra e një nëne, e ngrohtë dhe e fortifikuar, në të cilat ato gjetën ushqim të shijshëm.

Kjo në mënyrë të qartë tregon se as ato bishtaja të pavetëdijshme dhe as vetë insektet nuk i kishin bërë bishtajat një shtëpi për formimin ose zanafillën apo rritjen e insekteve, sepse ato dukshëm janë të paaftë për ta bërë atë rregullim tejet të urtë. Kështu që, ajo duhet t'i referohet Dikujt tjetër, i Cili duhet të ketë njohje absolute edhe për kokrrat, edhe për insektet gjithandej botës. Ai gjithashtu duhet të jetë Dikush që të njohë të gjitha nevojat e tyre dhe lidhjet. Një i Tillë mund të jetë veçse

¹⁸⁴Kaf dhe Nun janë shkronjat që formojnë “Kun”, e cila do të thotë “Ji” dhe nënkupton urdhërin e Zotit për ndonjë gjë që Ai dëshiron të jetë ose e krijoj.

“Urdhëri i Tij kur Ai e do një gjë është veçse t'i thotë asaj ‘Bëhu, Ji’ dhe ajo është (bërë) në çast”. (Kur’an, 36:82)

Ai i Vetëm, i Cili ka njohje absolute dhe fuqi mbi të gjitha gjërat, Ai që është i Gjithëditur për gjithçka dhe i Gjithëfuqishëm për gjithçka.

Unë të pyes ty, o ti që ia atribuon drejtimin të tjerëve përveç Zotit në mbretërinë e Zotit, që pranon rolin e rastësisë në ekzistencën e veprave të holla të Zotit. Si mundet ajo pemë e vogël të dëgjojë e të kuptojë, apo ta njohë gjuhën e atyre insekteve që lëshojnë vezët e tyre në degët e saj, duke ua besuar atyre ruajtjen e tyre? Përsëri, ajo pemë siguron për to një shtëpi të ngrohtë me përkujdesin më të skajmë si mitra e një nëne dhe si një djep përkundës në ajër. Pema merr prej thesarit të mëshirës Hyjnore ushqim të shijshëm të mjaftueshëm dhe e depoziton atë në foletë mbi degët e saj pa asgjë në këmbim për krijesat që nuk i përkasin species së saj, për mysafirët e lënë amanet tek ato nga Zoti xh.sh.. Një lloj i tillë i asistencës së ndërsjellë midis krijesave është një shenjë e qartë se çfarëdo që është në univers punon në shërbim dhe nën drejtimin dhe instruksionin e Një Zoti të Vetëm, i Cili është i Kërkuari përjetësisht. Në këtë ne besojmë.

Mësoje, o shok! Kur ti i vështron ato insekte me kujdes, ti i sheh ato të përmendin Krijuesin e tyre në ajër, me gjuhën e mënyrave të tyre, gjendjeve, dekorimeve të mirërregulluara dhe me strukturat e mirëpërpjestuara, edhe në qoftë se ti nuk mund ta kuptosh se si ato e përmendin Krijuesin me gjuhët e tyre të veçanta. Është sikur çdo insekt të ishte një fjalë e shqiptuar. Ashtu si insektet e tjerë, të gjithë kafshët parazitare nën dhë gjithashtu bëjnë tesbihate për Krijuesin e tyre në gjuhët e skicave dhe zbukurimeve të tyre të shkruara prej Penës së Fuqisë, ashtu siç bëjnë ato tesbihate për Të gjithashtu me gjuhët e tyre të veçanta.

Ky realitet do të të japë ty katër dobi.

Së pari, ajo do të të japë ty një ndjenjë besimi që ti e sheh veten tënde në një kështjellë të fortifikuar të formuar nga lindjet e reja dhe fëmijët e sjellur e të stolitur nga përkujdesja e të Gjithëditurit, instruksioni i të Gjiththurtit, nga përkujdesja e Gjithëbujarit dhe nga mëshira e Mëshirëplotit. Ti je gjithmonë nën shikimin e këtij të Gjithëdituri, të Gjiththurti, Gjithëbujari dhe Mëshirëploti.

Së dyti, ti do të bindesh se ti nuk je i lënë në tekat e tua me kokën tënde sipër shpatullave për të bërë çfarëdo që të duash. As nuk je lënë në mëshirën e vetes tënde, e paaftë për të përmbushur edhe më të

vogëlën e nevojave të tua të pafundme, saqë ti të ulesh i qortuar, i zhveshur dhe i frikësuar prej pafuqisë tënde absolute dhe nevojave të pakufishme. Sepse rregulli i plotë dhe balanca e hollë që ti sheh në jetën e atyre krijesave të vogëla dominon gjithashtu në të gjithë sistemin.

O i pakujdesshëm! A nuk të thonë ty ato shkrime të holla, libra të hollë të futura në shkronja të mëdha se edhe ti gjithashtu je i varur në të njëjtin rregull? Atëherë, eja, zgjohu dhe vëzhgoje strikt rregullin ose balancën. Kurse ti luan dhe e zbavit veten si dikush i çmendur në një mënyrë si të prishje balancën.

Së treti, kjo do të të sugjerojë ty bindjen se Atij të Cilit i drejtohesh për përmbushjen e të gjitha nevojave të tua dhe të Cilin ti gjithmonë e ke frikë është pafundësisht afër teje ndonëse ti je pafundësisht larg prej Tij. Ai drejton gjithçka që është në ty dhe në mjedisin tënd nëpërmjet fuqisë së Tij. Në lidhje me atë Fuqi, më e vogëla dhe më e madhja, më e pakta dhe më e shumta, dhe më e afërta dhe më e largëta janë të njëjta. Asgjë fare nuk është e vështirë për Të, dhe Ai nuk ka nevojë të jetë në lidhje direkte me krijesat në aktet e Tij. A të tregon ty ajo se nuk ka arsye për ty për t'u trembur e frikësuar? Sepse kudo që je ti, rregullat e Tij janë dominante atje. Kudo që të kthehesh, ndodhet Fytyra e Tij. Je në shtëpi, apo madje edhe nëse je në brendësi të tokës, Ai gjithmonë të sheh ty edhe sikur të jesh në barkun e 'mosekzistencës'. Duart e mëshirës, dorëgjërsisë dhe urtësisë të marrin ty me lejen dhe urdhërin e Tij nga një gjendje dhe fazë për tek tjetra. Para se të të lërë një dorë, një tjetër zgjatet për të të marrë ty në një vijueshmëri të rregullt. Rastësia në asnjë mënyrë nuk mund të ndërhyjë gjatë udhëtimit tënd. Ty nuk të bëhet padrejtësi nga mosekzistenca, as vdekshmëria nuk të bën ty padrejtësi me asgjësim të përjetshëm. Në çfarëdo vendi që ti të mund të jesh gjatë udhëtimit tënd të ekzistencës ndodhet një shembull mosekzistence. Sigurisht, prapa ose poshtë brenda saj ti sheh njërën prej thesareve të mëshirës plot me atë çfarë mbetet përgjithmonë prej të njëjtit lloj, si ai që zhduket në këtë ekzistencë.

Së katërti, ajo çfarë ti vëzhgon në botën e atyre krijesave të vogëla do të të japin ty dëshmi se çdo gjë krijohet ose bëhet nga Një Autor. Kjo dëshmi përforcohet në mënyrë të përpjesëtuar me vogëlsinë e tyre dhe bëhet më e qartë proporcionalisht me padukshmërinë e tyre. Sepse

është e pamundur për çfarë rrethohet të përjashtohet prej administrimit të Krijuesit të asaj që është rrethuese. Shenja e qënies së krijuar është më e qartë në qëniet e vogëla se sa në qëniet më të mëdhaja.

Mësoje, o shok! Pakujdesshmëria jote për Krijuesin vjen nga katër gjëra:

Së pari është se ti je aq i harruar për veten tënde saqë egoja jote si një qime floku rritet si një 'litar i trashë'. Sepse kur ti harron Zotin për shkak të tekave dhe dëshirave, Ai të shkakton ty të harrosh veten tënde, dhe si rrjedhojë egoja jote bëhet gjithnjë e më e trashë saqë të gllabëron ty plotësisht.

Së dyti, ti i krahason të gjitha krijesat e tjera me veten tënde. Për shembull, kur ti e sheh një kafshë, megjithëse kafsha është e pafajshme, e sigurtë dhe e kënaqur në jetën e saj, ti mendon për të sikur ajo të ishte një njeri i dëshpëruar, i humbur në medimet, dhe në kujtesat e ngatërruara ti i supozon vallet e saja gazmore si rënkim me dëshpërim.

Së treti, meqenëse ti e kufizon veten tënde tek manifestimet e Emrit Hyjnor Edh–Dhahir, i Dukshmi, deri në atë shkallë që çfarëdo që ti e supozon si të përjashtuar prej sferës së Autoritetit të këtij Emri, nuk i përket Atij që thirret prej Tij. Jo, kurrë! Sepse i Vetmi i quajtur me këtë Emër ka shumë Emra të tjerë të bukur. Ashtu siç është Ai mbi gjithçka që është sipër, po ashtu Ai është më i Brendshmi i të brendshmive. Ai është i Pari, i Fundit, i Dukshmi dhe i Padukshmi.

Së katërti, manifestimi Hyjnor i Njesisë, domethënë përqëndrimi i pothuajse të gjithë ose shumë Emrave Hyjnorë mbi një gjë të vetme është më e larta e manifestimeve, krahas qënies gjithashtu më e largëta dhe më e fshehta. Megjithatë, ti dëshiron ta shohësh atë mbi të gjitha gjërat në mënyrë të dukshme. Kur ti sheh një kafshë, duke e krahasuar atë me veten tënde, nën ndikimin e shumë ndjenjave të tua, ti mendon për të si të dëshpëruar për shkak të ndarjes prej të dashurve të saj ose prej shtëpisë dhe të mërzhitur për të ardhmen e saj dhe furnizimin. Ti prekesh prej saj. Por, në qoftë se ti do ta shikoje atë me vërtetësi, ti nuk do ta shikoje kurrë atë ashtu siç e supozove.

Ashtu siç bën ti një gabim për shkak të atij krahasimi, ti bën një gabim tjetër akoma më të madh për shkak të një krahasimi tjetër. Domethënë, ti shikon, le të themi një bletë. Ti pavetëdije e krahason

Autorin e saj, të Vetmin Një, Ekzistuesin e Vetëm të Domosdoshëm të Gjithurtë, i Cili nuk ka nevojë të jetë në prekje të drejtëpërdrejtë të krijesat e Tij dhe nuk ka aspak vështirësi për të krijuar e drejtuar, me qëniet e mundshme, të cilat janë të mjera, materiale dhe të përkufizuara. Ato duhet të jenë afër dhe në kontakt me veprat e tyre dhe vuajnë vështirësi në punën e tyre. Për shkak të këtij krahasimi, ti mendon se ti dhe ajo krijesë –bleta– mbi të cilën Pena e Autorit është duke vepruar tani siç bën gjithmonë, janë afër të Shenjtit, Autorit, të Lartësuarit. Është e vërtetë se Ai, Cilësitë esenciale të të Cilit qofshin të lartësuar, është afër. Ai është më afër teje se sa çdo gjë tjetër dhe më i Afërti për ty, më afër teje se sa vena e qafës. Kurse ti dhe ajo krijesë jeni pafundësisht larg prej Tij. Shikoje një copë qelqi. Ajo shndërit me reflektimin e dritës së diellit në të dhe bëhet e bukur dhe e stolitur me shtatë ngjyrat përthyesë në dritën e diellit. Për shkak të tejdukshmërisë së saj, ‘pastërtisë së zemrës së saj’, një dritare ose një rrugë hapet prej asaj cope qelqi për tek dielli dhe dielli shihet në të. Por, në qoftë se e zgjat dorën tënde për të prekur diellin, edhe sikur ta shtrije shtatëdhjetë, madje shtatëqind herë më gjatë se rrezja e tokës, ti nuk do të ishe në gjendje ta prekje atë. Vetëm ai që ushqen dashuri për diellin në zemrën e tij dhe ka marrëzi në mendjen e tij dëshiron ta arrijë diellin nëpërmjet ndonjëres prej rrezeve të tij. Një i tillë gjithashtu dëshiron ta shohë atë në çfarëdo gjëje që dielli reflektohet, në gjithçka që ai dëgjon ose njuh prej veçorive ose funksioneve të diellit të manifestuara në tërësinë e sistemit të asaj gjëje. Në qoftë se ai nuk mund t’i shohë të gjitha ato veçori e funksione në gjënë, ai vazhdon të mohojë ekzistencën e diellit në të, ose madje ekzistencën e vetë diellit.

Zemra e njeriut është pasqyra e të Vetmit, të Kërkuarit përjetësisht. Por, në kundërshtim me pasqyrat e tjera, ashtu siç shpjegon Imam Rabbani, ajo është e vetëdijshme dhe ka një lidhje të ndjeshme thellë me atë çfarë manifestohet në të. Për shkak të kësaj, zemra ka një kapacitet për të ndjerë shembuj të panumërt lumturie.

Në qoftë se ti pyet se si një aktivitet i jashtëzakonshëm në një krijesë të gjallë mund të pajtohet me heshtjen përreth saj sikur asgjë nuk ndodh dhe me padukshmërinë e asgjëje për ta shfaqur aktivitetin, përgjigja ime është siç vijon:

Në qoftë se aktiviteti u përkiste shkaqeve materiale, ose natyrale, ose vetë krijesës së gjallë, atëherë ajo do të kërkonte që në çdo kafshë

duhej të ekzistonte një veprues i pavarur me një njohje gjithëpërfshirëse. Ajo do të kërkonte në çdo frut një autor të fuqishëm, për fuqinë e të cilit krijimi i tokës me gjithçka që është në të, të mos ishte e vështirë. Pastaj, do të bëhej e mundur të dëgjohej e të vëzhgohej aktiviteti nga jashtë. Por, shikoji qetësinë dhe sigurinë e skajme të vëzhguara në hapësirë, heshtjen dhe qetësinë të vëzhguara gjithandej përveç botës së njeriut, dhe bindjen, paqen dhe qetësinë gjithnjë dominuese në univers. E gjithë ajo është vepra dhe ligji i Atij, i Cili kur dëshiron një gjë,

“Është vetëm se Ai t’i thotë asaj: ‘Bëhu’, dhe ajo është bërë (në çast)!”¹⁸⁵

“Dhe s’ka asgjë që Ne të mos i kemi për të thesaret e pashtershëm dhe Ne nuk e dërgojmë atë veçse në masë të drejtë e të ditur”¹⁸⁶

Në qoftë se do të ishte e lejueshme të bëhej një krahasim për të kuptuar aktivitetin e Zotit, lidhja midis veprave të bëra nga dora jote dhe e veprave të bëra me shpejtësinë e imagjinatës tënde mund të shëmbëllehen me lidhjen midis akteve të tua të imagjinuara dhe akteve të fuqisë së Krijuesit.

Mësoje, o Said i mjerë e arrogant! Prej mijëra nevojave të tua, njëra ose më e pakta se ajo lihet tek ti për ta përmbushur. Pjesa tjetër i dorëzohet plotësisht përkujdesjes së Krijuesit tënd, i Cili të krijoi ty së pari si një shuk brumi dhe pastaj të formoi ty në një lëng nga arti i Tij i mrekullueshëm me qëllim që ti të mund të ishe një pasqyrë për të reflektuar Emrat e Tij. Ai i hapi organet e tua të dëgjimit dhe të shikimit nëpërmjet mëshirës së Tij, me qëllim që ti të mund ta dëgjoje të vërtetën, dhe duke parë të krijuarën, të njohësh Krijuesin. Në zgavrën e gojës tënde Ai vari nëpërmjet favorizimit të Tij një gjuhë, me qëllim që ti të mund ta përmendësh Atë. Ai përfshiu në kokën tënde mendjen për ta njohur Atë dhe vendosi në kraharorin tënd një zemër për ta dashur Atë. Ai të trajtoi ty me dashamirësi në errësirën e vetmisë – errësirën e mitrës– dhe veproi në ty nëpërmjet Hyjnisë së Tij sido që Ai deshi. Ai formoi në trupin tënd nëpërmjet urtësisë së Tij të gjitha ato

¹⁸⁵Kur’an, 36:82

¹⁸⁶Kur’an, 15:21

shqisë të shumë llojeve dhe ato organe të një larmie të madhe, me qëllim që ti të mund të perceptosh të gjitha llojet e mirësive të Tij dhe të njohësh manifestimet e ndryshme të Emrave të Tij.

O i pakujdesshëm mendjemadh! Ndërsa Ai të ka favorizuar ty me të gjitha ato mirësi e bekime të tilla, dhe sa gjatë do vazhdosh ta akuzosh Atë dhe të mbështetesh mbi fuqinë tënde të pjesshme dhe tejet të papërfillshme? Dhe sa gjatë do të vazhdosh t'i lësh çështjet e tua mbi veten tënde dhe t'i bësh padrejtësi vetes tënde duke e ngarkuar nefsin tënd me një peshë që ti je i pamundur ta mbash për shkak të zgjedhjes tënde të keqe? Si është puna që ti nuk mbështetesh tek Ai, i Cili të mban ty prej balukeve –të ka nën sundimin e Tij të plotë– dhe ka marrë përsipër të përmbushë nevojat e tua?

Mbështetu tek Ai dhe hip në anijen e Tij që lundron në rrjedhën e ngjarjeve dhe thuaj: Bismilah, “...*Me Emrin e Allahut do të jetë lëvizja e saj dhe ndalimi i saj*”,¹⁸⁷ me qëllim që ti të mund të pushosh mbi Xhudin e Islamit¹⁸⁸ dhe ta qetësosh veten tënde në bregun e shpëtimit. A nuk e sheh se dielli i jetës gati po perëndon, hëna e trupit po eklipsohet për shkak të pleqërisë dhe koka jote ndrit me zbardhje të flokëve? Nuk ka dobi prej askujt përveç Zotit të Gjithëfuqishëm, përkundrazi, ndodhet një dëm i madh në çfarëdo që është jashtë lejes së Tij.

Pa Të, çdo gjë është e dëmshme dhe armiqësore, ndërsa me Të, ty nuk të nevojitet askush tjetër. Prandaj, ti duhet ta braktisë çfarëdo dhe këdo tjetër përveç Tij.

Pa Të, dhimbjet që qëndrojnë në çdo kënaqësi janë më të rënda se vetë kënaqësitë; madje, kënaqësitë janë thjesht dhimbje pa Të. Prandaj, “*Ikni drejt Zotit*”¹⁸⁹ sepse me Të është gjithçka, çfarëdo e zhdukshme që është me ty, ajo ekziston përjetësisht me Të. Ajo zhduket këtu; ajo nuk vazhdon pa Të, ndërsa ajo vazhdon me Të atje. Përveç kësaj, koha është shumë e kufizuar. A nuk e sheh se ti po vuan dehjet e vdekjes, sepse e gjithë jeta jote kalon në dehje. Prandaj, ngrije kokën tënde që ta

¹⁸⁷Kur'an, 11:41

¹⁸⁸I referohet anijes së profetit Nuh a.s, e cila lundroi nëpër valët si male dhe u vendos, qëndroi në Al Xhudi, i cili ka gjasa të jetë njëra prej kodrave të malit Ararat. (Përkthyesi).

¹⁸⁹Kur'an, 51:50

çlirosh veten tënde nga dynjaja me qëllim që ti të mund të shohësh se ndodhen mirësi të përjetshme, mëshirë e përhershme dhe dashuri e përjetshme me Krijuesin tënd.

Mësoje, o mendues i hutuar e kërkues për të vërtetën! Kur njohja jote mbaron në diçka ose kur ti sheh një shenjë përjetësie në diçka, bëj tesbihat për Zotin tënd që ti i je afruar të Vërtetit. Sepse qënia e panjohur dhe përjetësia janë tituj ose shenja për ushtrimin autoritar të Hyjnisë Absolute, madhështia e Tij qoftë e lartësuar!

Mësoje, o ti me dyshime! Kur dyshimet të sulmojnë, shiko djathtas. Ti do të shohësh sferat e akteve autoritare të Krijueshmërisë së Tij njëra brenda tjetrës prej sferës së sistemit diellor dhe të planetëve për tek sfera e atomeve dhe e grimcave, prej krijimit të qiejve për tek krijimi i frutave, prej ndërtimit të tokës për tek shpikja e krimbave që hanë pemët. E gjitha kjo tregon për faktin se Pena që i skicon ato është Një dhe stampa mbi to është gjithashtu Një. Ti je në mes të universit konik, duke mbajtur amanetin më të lartë dhe duke ndërmarrë kalifatin, përgjegjësinë për të drejtuar dhe për ta përmirësuar tokën sipas ligjeve të Zotit.

Pastaj, shiko majtas. Ti do të shohësh rregullin universal duke gjykuar e sunduar drejtësi në çdo gjë. Ti gjithashtu do të shohësh balancën e përkryer që pengon shmangien në çdo gjë. Realiteti i krijimit do t'i flakë tutje e do t'i fluturojë dyshimet e tua, dhe rregulli universal dhe balanca do t'i largojnë ngatërresat e tua dhe çoroditjen.

Pastaj, shikoje veten tënde me qëllim që ti ta shohësh veten tënde dhe trupin tënd të bëra ose të krijuara nga koka te këmbët, prej më të vogëlës së qelizave tek tërësia e trupit tënd, i cili është në fakt si një qelizë e madhe.

Pastaj, shiko dhe zemrën tënde dhe pastaj lart teje. Ti do të shohësh dritat e Dritës së dritave, i Cili e ka krijuar dritën dhe e ka formuar dritën. Dritat e manifestimeve të Tij depërtojnë në çdo gjë, madhështia e Tij qoftë e lartësuar!

Mësoje, o shok! Përdorimi i formës krahasore ose i sipërores relative në disa nga Emrat Hyjnorë të tillë si Erhamur Rahimin, më i Mëshirshmi i mëshiruesve, dhe Ahsenul Halikine, më i Miri i krijuesve, dhe Allahu Ekber, Allahu është më i Madhi, e të tjerë, nuk e

kundërshton Unitetin Hyjnor. Sepse ajo çfarë synohet prej tyre është të shprehin superioritetin e pakrahasueshëm absolut të të Gjithëfuqishmit mbi çfarëdo ose cilindo tjetër që njerëzit mund t'i imagjinojnë të kenë cilësi Hyjnore. Ky përdorim nuk kundërshton dinjitetin e të Vetmit Mposhtës, sepse qëllimi i tij nuk është të krahasojë Atributet ose aktet e të Gjithëfuqishmit me ato të të krijuarve dhe aktet e tyre. Sepse në lidhje me plotësinë e të Gjithëlavdishmit, çfarëdo që ekziston në të krijuarën në emrin e plotësisë, është veçse një hije e reflektuar. E gjithë plotësia e ndarë nga të krijuarat nuk ka të drejtë të krahasohet me atë të të Gjithëfuqishmit. Qëllimi i këtij përdorimi është për të krahasuar efektin e veçantë të manifestimeve të Emrave Hyjnorë mbi gjërat dhe shtrirjen e gjërave duke u ndikuar prej tyre, dhe efektin e mjeteve të jashtme në të njëjtat gjëra dhe shkallën e gjërave duke u ndikuar. Kjo është kështu:

Një ushtar e sheh rreshterin e tij si më të madhin për t'i shfaqur respekt dhe për t'u falënderuar. Atij i thuhet se mbreti është më i madh dhe më i mëshirshëm se rreshteri. Kjo nuk do të thotë të krahasosh mbretin me rreshterin, gjë e cila do të ishte ironike. Përkundrazi, ajo do të thotë të paralajmërosh ushtarin se mbreti është më i denjë për t'u respektuar e falënderuar, dhe se është veçse me lejen e mbretit dhe me shtrirjen e besnikërisë së rreshterit ndaj mbretit që rreshteri mretion respekt e falënderim.

Ndërsa, lidhur me shprehjet, për shembull, 'Më i Dhembshur se sa çdo i dhembshur', 'Më Bujar se çdo bujar' dhe 'Më me dinjitet se çdo dinjitoz', e të tjera, me këtë ne duam të themi se, e gjithë dhembshuria që një njeri merr prej të gjithë të dhembshurve në univers nuk mund të jetë e barabartë me kujdesin që ai merr prej oqeanit të pafundmë të mëshirës së Zotit.

I Vetmi ka deklaruar të jetë superior, është Real, Një dhe Superior Absolut dhe pakrahasimisht, dhe Ai ka Emrin ose Atributin në çështje si esencial tek Ai. Kurse inferiorët janë vetëm emërorë ose të imagjinuar dhe përfaqësojnë tërësinë e të krijuarve. Ata kanë atributin ose emrin në çështje veçse aksidentale dhe një hije të dobët ose një manifestim të origjinalit të saj të zotëruar nga i Gjithëfuqishmi. Duke u kombinuar së bashku, të gjithë të krijuarit nuk mund të kenë një rrezatim real prej origjinalitetit të tij nga vetja e tyre, ashtu siç deklaroi Zoti xh.sh:

“Me të vërtetë që ata të cilëve ju u drejtoheni në vend të Allahut, nuk mund të krijojnë as edhe një mizë, edhe sikur ata të mblidheshin të gjithë së bashku për t’ia arritur qëllimit”¹⁹⁰

Mësoje, o shok! Emri Allah përmban kuptimin e të gjithë Emrave të tjerë Hyjnorë dhe të të gjithë Atributeve të plotësisë. Ndërsa emrat e përveçëm të të gjitha gjërave të tjera tregojnë veçse personat e qënieve të quajtura nga ato, pa përfshirë atributet e tyre, sepse atributet e qënieve të tjera nuk janë të domosdoshme për to, kështu emrat e tyre të përveçëm nuk tregojnë atributet dhe as cilësitë e tyre. Ndërsa, Emrat dhe Atributet e më të Shenjtit të Vetëm janë të domosdoshme për ta përshkruar Atë dhe Hyjnia në mënyrë të veçantë i kërkon ato. Prandaj, Emri Allah, Emri i ‘përveçëm’ i Hyjnisë, domosdoshmërisht përmban kuptimin e të gjithë Emrave dhe Atributeve të tjera Hyjnore dhe i tregon ato. Po kështu bën edhe përdorimi i ‘ilah’ në kontekstin e mohimit. “La ilahe il–lallah”, Ai i hedh poshtë të gjithë të tjerët të cilëve u atribuohet Hyjni tek La ilahe il–lallah, nuk ka zot tjetër përveç Allahut.

Në qoftë se e ke kuptuar këtë, ti gjithashtu mund të kuptosh se ‘la ilahe il–lallah’ deklaron Unitetin Absolut Hyjnor dhe i përmban të gjitha kërkesat ose konkluzionet e Unitetit aq sa numri i Emrave të bukur Hyjnorë. Kjo frazë përmba mijëra fraza, sepse frazat si kjo shprehin edhe konfirmim, edhe mohim ose refuzim. Meqenëse fjala (Një) Allahu domosdoshmërisht i përmban të gjithë Emrat e tjerë Hyjnorë, edhe la ilahe il –lallah gjithashtu do të thotë, nuk ka krijues, as furnizues, as vetekzistues të përhershëm, as pronar, as shpikës dhe as mposhtës përveç Allahut. Si rrjedhojë, ai që ka përparuar në udhëtimin e tij shpirtëror i synon të gjitha këto fraza ndërsa shpreh la ilahe il–lallah; dhe kjo frazë, nënkupton rangjet dhe gjendjet e tij shpirtërore. Përsëritja e saj ndihmon të shtohet e përmirësohet bindja.

Mësoje, o shok! Në qoftë se ti e di se çfarëdo që ekziston dhe çfarëdo që ndodh tek ti është prej Zotit xh.sh, në qoftë se ke bindje për këtë, atëherë ti duhet ta pranosh e të jesh i kënaqur si me atë që është e pëlqyeshme, po ashtu edhe me atë që është e dëmshme. Në qoftë se ti nuk e pranon me kënaqësi, ti do të kesh rënë në pakujdesi. Kjo është për shkak se Zoti Fuqiplotë dekretoi shkaqet e jashtme të cilat i bëjnë

¹⁹⁰Kur’an, 22:73

sytë të verbër ndaj të vërtetës. Gjërat dhe ngjarjet e papëlqyeshme për njeriun në dynja janë më shumë se ato që janë të pëlqyeshme, dhe universi nuk u ndërtua në përputhje me planet dhe dëshirat e dëshiruesit. Erërat mund të fryjnë kundër dëshirave të detarëve. Prandaj, në qoftë se një dëshirues nuk e vështroi rolin e shkaqeve të jashtme dhe nuk do të shkujdesej ndaj Shkaktuesit të shkaqeve, ai do t'i drejtonte kundërshtimet e tij të pavend e të padrejtë, oponencën, urrejtjen, zemërimin dhe mërinë ndaj Krijuesit të Gjithurtë dhe Pronarit Gjithëbujar. Kur një njeri i pakujdesshëm e hedh shigjetën e tij të kundërshtimit, ai e hedh ose tek kaderi, ose tek Shejtani, por zakonisht ai godet me të kokën dhe veten e tij.

Mësoje, o shok! Kur i jep një shqyrtim të duhur e të vëmendshëm ekzistencës, ti sigurisht do të kuptosh se çdo gjë ose çdo qenie e mundshme është aq larg krijueshmërisë sa pafundësia e Fuqisë së domosdoshme për krijimin e diçkaje.

Mësoje, o shok! Duaja –lutja– është tre llojesh:

Lloji i parë është duaja që e bën njeriu me gojë, me fjalë. Britmat e kafshëve që secila i shfaq me gjuhën e saj të veçantë për nevojat e të cilës ajo është e vetëdijshme janë gjithashtu prej këtij lloji.

Lloji i dytë i duasë është ajo e cila bëhet me gjuhën e nevojës. Duaja e të gjitha bimëve ose pemëve, veçanërisht lutjet që ato bëjnë në pranverë, dhe duatë që bëjnë kafshët për nevojat e tyre për të cilat ato nuk janë të vetëdijshme janë prej këtij llojit të dytë.

Lloji i tretë është duaja e bërë me gjuhën e potencialit. Lutjet e bëra nga të gjitha krijesat që kanë potencialin për t'u rritur, për të ndryshuar dhe për t'u plotësuar janë prej këtij lloji meqë nuk ka asgjë që të mos bëjë tesbihat për Të, as nuk ndodhet ndonjë gjë që të mos i lutet Atij dhe të mos e falënderojë Atë ose me gojë, me fjalë, ose me personin e tij, ose me gjuhën e gjendjes.

Mësoje, o shok! Një bërthamë para se të rritet duke u bërë një pemë, sperma para se të bëhet njeri, veza para se të bëhet një zog fluturues dhe një farë para se të bëhet një bimë sigurisht që është nën drejtimin, urdhërin dhe krontrollin e një njohjeje të plotë e depërtuese. Kjo është me qëllim që ajo të mund të drejtohet ose të dërgohet për tek rruga e drejtë prej rrugëve të panumërta, të lakuara, të verbëra dhe pa

krye. Kjo njohje i përket veçse Njohësit të së padukshmes, i Cili formon në mitra çfarëdo që Ai dëshiron, i Cili njeh të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen. Një bërthamë, sperma, veza ose fara është si një prototip ose një përvijim i kopjuar prej Librit të Qartë, i cili është njëri prej librave të kaderit, ose është si një indeks i nxjerrë prej Regjistrisë të Qartë, njëri prej librave dhe regjistrave të Njohjes së Parapërdjetshme, ose është si një mishërim parimesh të dedukuara prej Nënës së librit, njërit prej librave të kaderit të parapërdjetshëm, sidomos prej kapitullit të balancës dhe rregullit të atij libri, ose është si një përmbledhje apo shkurtore, ose diçka përfaqësuese e përqëndruar dhe e kombinuar, e zbritur prej Hyjnisë së të Gjithëfuqishmit për gjithçka dhe të Gjithëditurit për të gjitha gjërat, madhështia e Tij qoftë e lartësuar.

Mësoje, o shok! Një besimtar e shikon një krijesë si një shkronjë, e cila nuk shpreh pothuajse asgjë nga vetvetja, por shërben si një pjesë plotësuese e fjalës së të cilës ajo i përket. Ndërsa, një mosbesimtar e sheh atë për llogari të vetvetes, duke e kufizuar shikimin e tij për të tek vetë krijesa.

Çdo krijesë ka dy aspekte, njëri ka të bëjë me vetveten dhe me atributet e saj, dhe tjetri duke treguar Krijuesin e saj dhe Emrat e Tij të manifestuar mbi të. Aspekti i dytë është më gjithëpërfshirës dhe më i gjërë, sepse çdo shkronjë në një libër tregon vetveten si një shkronjë, ndërsa ajo shpreh shumë më shumë dhe shërben shumë në librin ku ajo është. Ajo e tregon Autorin e saj dhe e tregon Atë në shumë mënyra. Në të njëjtën mënyrë, çdo krijesë e cila është si një shkronjë prej librit të Kaderit Hyjnor, e tregon vetveten dhe ekzistencën e saj të dukshme me shtrirjen e masës së saj, kurse e tregon Krijuesin e saj të Parapërdjetshëm në shumë drejtime dhe lavdëron Emrat e Tij të manifestuar mbi të.

Është një rregull i vërtetuar dhe i pranuar se asnjë gjykim nuk mund të jepet mbi bazën e një shkronje, as një shkronjë nuk mund të shërbejë për të nxjerrë një konkluzion rreth diçkaje në emrin e pohimit ose të mohimit. Për këtë arsye, mendja nuk hyn në detaje rreth saj. Ndërsa në qoftë se mendja e lidh vetveten qëllimisht me një shkronjë, atëherë ajo shkronjë bëhet si një fjalë.

Për shkak të kësaj, ti i sheh librat filozofik ose shkencor të shkruar rreth universit si shumë të saktë dhe plot kuptim, ndërkohë që ato janë me një domethënie të pakët lidhur me Krijuesin. Në kontrast, teologët i

trajtojnë çështjet filozofike e shkencore jo për llogari të vetvetes, por si duke ofruar argumente për ekzistencën dhe unitetin e Krijuesit. Është e mjaftueshme për ta, që për shembull dielli është një llampë, toka është një djep, nata është një mbulesë, dita një kohë për të punuar për mjetet e jetesës dhe hëna një gjë e ndritshme. Është e mjaftueshme për ta që malet janë si shtylla mbështetëse për stabilitetin e tokës dhe për të freskuar e ndërruar ajrin, për të depozituar ujë dhe minerale, për të mbrojtur tokën dhe për të qetësuar zemërimin e tokës së lëkundur duke i mundësuar asaj të marrë frymë lirshëm. Kurse trajtimi filozofik e trajton diellin si qendra e sistemit të botës, si një zjarr i madh aq i fortë saqë të gjithë planetët duke përfshirë tokën fluturojnë rreth tij si flutura të shpërndara. Dhe kështu, këndvështrimi i teologëve rreth universit ndonjëherë mund të jetë në kundërshtim me realitetin, por meqenëse ata janë përgjithësisht në harmoni me atë çfarë është e dukshme dhe nga pikëpamja e përgjithshme, ata nuk duhet të kundërshtohen. Për këtë arsye, edhe në qoftë se pikëpamjet e tyre për çështje filozofike ose shkencore mund të konsiderohen si të dobëta dhe pa domethënie, këndvështrimet e tyre për esencat e teologjisë janë më të forta se hekuri. Për shkak të kësaj, në dynja të pakujdesshmit dhe të çudhëzuarit mund të duken të kenë epërsi në fillim. Ajo duket kështu meqë ata janë krejtësisht të prirur nga dynjaja me të gjitha aftësitë e potencialet e tyre në një mënyrë që deklarojnë:

“...Nuk ka jetë tjetër përveç kësaj që jemi në këtë botë...”¹⁹¹

Kurse fundi është për të devotshmit dhe për të përkushtuarit, për të cilët dhe për prijësin e tyre Kurani shpall:

“Me të vërtetë Ahireti është më e mirë për ty se sa e para (jeta e dynjasë)”¹⁹²

“Dhe jeta e kësaj bote nuk është asgjë tjetër veçse lojë dhe zbavitje”¹⁹³

“Dhe nuk është gjë tjetër jeta e kësaj bote vetëm se zbavitje e lojë! Vërtetë që banesa e jetës së pastajme, ajo është jeta e vërtetë, veç sikur ta dinin”¹⁹⁴

¹⁹¹Kur'an, 6:29

¹⁹²Kur'an, 93:4

¹⁹³Kur'an, 6:32

Allahu është i mjaftueshëm për ne, sa Kujdestar i Mirë është Ai! Sa i mirë si Mik Mbrojtës dhe sa i Mirë si Ndihmues!

Mësoje, o shok! Falja e Zotit është një akt i një mirësie shtesë, ndërsa ndëshkimi është thjesht drejtësi. Në qoftë se një njeri merr helm, ai meriton të jetë i sëmurë sipas ligjit të vendosur e të qëndrueshëm të Allahut. Në qoftë se ai nuk bëhet i sëmurë, kjo është për shkak të mirësisë shtesë të Allahut ose të një favorizimi të jashtëzakonshëm. Lidhja midis një mëkati dhe ndëshkimi është aq e fortë sa që ajo i çoi muëtezilitët të gabojnë në gjykim rreth saj duke ia atribuar të keqen dikujt tjetër përveç Zotit dhe duke dalë me konkluzionin se çdo e keqe sigurisht që do të ndëshkohet. Ndërsa, madje edhe në qoftë se nuk do të thuhej kurrë se është e domosdoshme që i Gjithëfuqishmi duhet të ndëshkojë çdo të keqe apo mëkat, ndëshkimi i saj i meritueshëm nuk është në kontradiktë me plotësinë e mëshirës Hyjnore. Për shkak të dëmit të së keqes, edhe sikur ajo të ishte e pjesshme ose e pakët, ajo i prek të gjitha fijet që formojnë rregullin universal, i cili është mirësia e madhe absolute për të gjithë. Duke e braktisur atë të mirë absolute të madhe për hir të shmangies së një të keqeje të vogël ose të një dëmi të pjesshëm, do të shkaktonte një të keqe të madhe ose dëm. Kjo është në kundërshtim me urtësinë në drejtësinë e të Drejtit, të Gjithuritit dhe Gjithëbujarit.

O njeri zullumqar injorant! Shmange të keqen sa të jetë e mundur. Përndryshe ti do të meritosh ndëshkim për braktisjen e të mirës dhe të përmbushjes së kushteve të domosdoshme për të arritur rezultatin. E keqja shpreh dhe rezulton në mosekzistencë; mosekzistenca e ndonjë pjese të domosdoshme të ekzistencës së diçkaje shkakton mosekzistencën e saj të plotë, e cila do të thotë gjithashtu anulim i të gjitha pjesëve të tjera, sepse ekzistenca e diçkaje nuk varet nga një pjesë e veçantë, por nga prania e të gjitha kushteve për ekzistencën e saj. Prandaj, falja e Zotit një të keqe është thjesht një akt mirësie që tregon plotësinë e mirësisë së Tij. Për më tepër, Ai ndëshkon një të keqe me një përngjasim të saj –me një të keqe– por e shpërblen të mirën me dhjetëfishin e saj, ndërsa meritat e tyre të vërteta janë ndryshe. Kjo gjithashtu shfaq shtrirjen e padrejtësisë së njerëzimit të cilët gjykojnë anasjelltas.

¹⁹⁴Kur'an, 2964

Mësoje, o shok! Njeriu është i sprovuar me harresë, dhe lloji më i keq i harresës është të harruarit e vetvetes. Harresa e njeriut vetveten në marrëveshje, shërbime, punë dhe reflektim është çudhëzim. Por, vetëharresa në kohën e marrjes së rrogave dhe shpërblimeve është një shenjë plotësie. Njerëzit e çudhëzimit dhe ata të udhëzimit të vërtetë ndryshojnë nga njëri-tjetri në të harruarit dhe të krijuarit. Të çudhëzuarit e harrojnë vetveten në kohën e punës dhe të praktikimit të parimeve të detyrave, ndërkohë që nuk njohin limite për arrogancën e mburrjet e tyre të paepura. Por ata i kujtojnë vetvetet kurdo në kohën e marrjes së frutave, sado të përbuzshëm që janë, shfaqen. Por një njeri i cili e pastron shpirtin e tij e kujton vetveten në kohën e punës dhe fillon lëvizjen ose dhënien shërbim, ose të menduarit, sikur ai ta dinte se ishte përgjegjës për vendosjen e një shembulli të mirë për të tjerët dhe të kishte përgjegjësinë kryesore në përmbushjen e punës ose të detyrës. Por ai e harron veten e tij në fitimin e rezultateve, në marrjen e shpërblimeve dhe në mbledhjen e frutave. Ai bën kështu deri në shkallën që dikush ka përshtypjen se ai nuk ka punuar për veten e vet, veten e përkohshme, por si një shërbëtor për pronarin e tij, me kënaqësinë e sinqeritetit dhe rezultatet e punës së tij i përkasin kryesisht pronarit të tij.

Mësoje, o shok! Solidariteti dhe fryma e kolektivit të besimtarëve në adhurimet e tyre me xhemat dhe në duatë e tyre kanë një kuptim të rëndësishëm e të thellë. Çdo besimtar bëhet si një tullë –gurë– në një ndërtesë të fortë, duke përfituar nga vëllezërit e saj në besim mijëra e mijëra herë më shumë se adhurimi e duatë e tij. Kur besimi i sjell ata së bashku, secili punon për të gjithë dhe bëhet një ndërmjetës dhe një lutës për ta, duke deklaruar pafajësinë e tyre. Të gjithë ata së bashku e lavdërojnë prijësin e tyre a.s.m në një mënyrë të veçantë. Gjithashtu, çdo besimtar merr kënaqësi në lumturinë e të tjerëve si një nënë, ndonëse vetë e uritur, gjen kënaqësi në kënaqësinë e fëmijëve të saj, ose si një vëlla i dhembshur i cili gjen kënaqësi në lumturinë e vëllait të tij. Si rezultat, ai njeri individual i përkohshëm e i mjerë ka kapacitetin e adhurimit ndaj Krijuesit të universit në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe duke fituar lumturi të përvetshme.

Vështroje profetin a.s.m.. Kur ti e sheh atë duke bërë dua me “O më i Mëshirshmi i mëshiruesve”, ti e sheh tërësinë e komunitetit të tij duke iu përgjigjur atij duke thënë: “O Allah! Jepi bekime e paqë shërbëtorit Tënd dhe të dashurit Muhammedit a.s.m, oqeanit të dritave të Tua,

përhapësit të përmendjes dhe falënderimeve të Tua, shpallësit të bukurive të sovranitetit të Hyjnisë Tënde”. Ata deklarojnë pafajësinë e tij para Zotit të tyre, e bëjnë atë të dashur prej Atij i Cili e dërgoi atë si mëshirë për ta dhe konfirmojnë të drejtën dhe autoritetin e tij për të ndërmjetësuar –për shefaat– për ta tek i Gjithëfuqishmi. Përsëri, ata shpallin me gjuhën e pafuqisë dhe varfërisë së tyre absolute, pasurinë absolute të të Gjithëlavdishmit Absolut në pavarësinë e Tij. Ata gjithashtu shpallin bujarinë e Tij absolute në Dinjitetin e Tij madhështor dhe me gjuhën e robërisë së tyre absolute shpallin Hyjninë e Tij absolute. Nëpërmjet një solidariteti të lartë të tillë dhe një ndihme të tillë të ndërsjellë, një besimtar ngrihet prej gjendjes më të ulët të papërfillshmërisë dhe pafuqisë për tek pozita më e lartë e të qënit kalif i Allahut në tokë, duke mbajtur amanetin më të madh dhe duke qenë i nderuar dhe i respektuar për të cilin qiejt dhe toka u nënshtruan.

Mësoje, o shok! Një njeri i cili është larg diçkaje nuk mund ta njohë atë gjë aq shumë dhe aq mirë sa dikush tjetër afër saj, madje edhe sikur të ishte shumë më inteligjent se tjetri. Kur ata nuk kanë dakordësi mbi atë gjë, ai që është afër është më i preferuar. Filozofët europianë dhe shkencëtarët të cilët janë zhytur në çështjet materialiste janë tejet të larguar prej stacionit të lartë të Islamit, besimit dhe Kuranit. Madje, edhe më i madhi i tyre nuk mund të jetë baraz me një musliman të zakonshëm, i cili e kupton Kuranin në mënyrë sipërfaqësore. Ky është vëzhgimi im në përputhje të plotë me realitetin. Mos thuaj: Si është që ata të cilët zbuluan realitetet shkencore të tilla si veçoritë e dritës e të avullit e të tjera, si nuk i kuptojnë ata misteret e të vërtetës dhe dritat e Kuranit? Ata nuk mund t’i kuptojnë ato për shkak se mendjet e tyre janë të kufizuara tek sytë e tyre, dhe sytë nuk mund të shohin çfarë zemra dhe shpirti shikojnë, sidomos në një kohë kur zemrat kanë vdekur për shkak të zhytjes së pakujdesisë në natyralizëm.

“Këta janë ata, zemrat, dëgjimin dhe shikimin e të cilëve i ka mbyllur e vulosur...”¹⁹⁵

Mësoje, o shok! Më e madhja e mosmirënjohjes ndaj mirësive është mosdhënia e falënderimeve për Allahun ndaj mirësive të përgjithshme si dëgjimi dhe shikimi dhe ndaj atyre të vazhdueshme si drita dhe zjarri, dhe atyre të bollshme e gjithëpërfshirëse si ajri dhe uji.

¹⁹⁵Kur’an, 16:108

Një njeri mund ta falënderojë Allahun xh.sh për mirësitë e veçanta për të ose për ato të ripërtërira në një kohë të një nevoje të veçantë. Ndërsa mirësitë që jepen pandërprerë dhe me bollëk janë shumë më të rëndësishme e më të mëdhaja. Qënia e tyre të bollshme e gjithëpërfshirëse tregon rëndësinë e tyre të skajme dhe qënia e tyre të vazhdueshme tregon madhësinë e vlerës së tyre.

Mësoje, o shok! Vërseti: “...*Dhe Ai mban llogari për çdo gjë*”,¹⁹⁶ nënkupton rregull, harmoni, barazi dhe përpjestueshmëri midis numrave të gjërave të afërta ose korresponduese ose përngjasuese me njëra tjetrën, të tilla si gishtërinjtë e dorës, kokrrat në kalli, bërthamat në fruta dhe petëlat në lule. Lavdi qoftë për Atë, i Cili mban llogarinë e të gjitha gjërave dhe njohja e të Cilit i rrethon të gjitha gjërat.

Mësoje, o shok! Pjalmimi dhe lindja bashkë me rritjen e dhembshur janë dy detyra të përgjithshme për të gjitha gjërat deri tek më e vogëla e gjërave. Një shpërblim i menjëhershëm ose një rrogë jepet në këmbim për to, që është kënaqësia që ato të dyja japin. Gjithëpërfshirja e dorëgjërësisë së Mirëbërësit Gjithëbujar bashkë me zellin e fortë të të gjitha gjërave riprodhuese për t’i përmbushur këto dy detyra tregojnë se ato marrin kënaqësi të veçanta për secilën në përmbushjen e asaj detyre. Ajo shkallë shpërblimi e mëshire dhe drejtësie bashkë me deklaratën Hyjnore “*Mëshira Ime i përfshin të gjitha gjërat*”¹⁹⁷ dhe shumë hadithe profetike konfirmojnë shpërblimin dhe hakmarrjen midis kafshëve në Ditën e Gjyqit. Ato tregojnë se shpirtërat e kafshëve ruhen për të marrë shpërblimin e tyre të fundit për bindjen e tyre të plotë ndaj rregullave Hyjnore.¹⁹⁸ Pas vendosjes së të drejtave të përbashkëta, trupat e kafshëve do të bëhen pluhur. Megjithatë, është e mundur që tërësia e një specie do të mishërohet dhe do të përfaqësohet nga ndonjë anëtar i bekuar të tilla si deveja, dashi, qeni, pupëza, milingona e të tjera të përmendura në Kuran.

Mësoje, o Said i mjerë e lakmitar për ruajtjen e ekzistencës tënde materiale në këtë botë kalimtare, pavarësisht faktit se dynjaja është e zbuluar para zhdukjes, dhe vetëm i Qëndrueshmi i Përrjetshëm mund ta

¹⁹⁶Kur’an, 72:28

¹⁹⁷Kur’an, 7:156

¹⁹⁸Ebu Hurejre tregon se i dërguari i Zotit ka thënë: “Të drejtat e përbashkëta do të vendosen në Ditën e Gjyqit deri në shkallën që një dele pa brira të rimarrë të drejtën e saj prej një tjetre me brira”. (Muslimi, nr 2582)

mbajë atë. Ti mund të fitosh qëndrueshmëri veçse duke u kthyer drejt të Gjithëlavdishmit të Vetëm dhe duke e harxhuar jetën tënde në rrugën e Tij.

Duke qenë çështja kështu, përse vazhdon të ngulmosh duke kërkuar qëndrueshmëri në këtë dynja? Përkundrazi, thuaj: Për qëndrueshmërinë, është e mjaftueshme për mua që Zoti, Pronari është i Qëndrueshmi i Përjetshëm; dhe për kënaqësinë e qëndrueshmërisë, është e mjaftueshme që unë e njoh Atë si të Qëndrueshmin e Përjetshëm, të Adhuruarin e Vetëm. Sa për synimin në kërkimin e qëndrueshmërisë, është e mjaftueshme që unë e njoh Atë si Zotin tim të Qëndrueshëm përjetësisht. Për sa ka të bëjë me plotësinë e pritur prej qëndrueshmërisë, besimi im në Qënien e Tij Shpikësi im i Qëndrueshëm përjetësisht, është i mjaftueshëm. Lidhur me ekzistencën, është e mjaftueshme për mua që unë jam vepra e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm. Sa për vlerën e ekzistencës, është e mjaftueshme që unë jam vepra e artit të Krijuesit të qiejve dhe tokës. Në lidhje me qëllimin e ekzistencës, më mjafton që unë e di se unë jam ngjyrimi prej Tij i Cili i ka stolitur qiejt me yje dhe tokën me lule. Për sa ka të bëjë me kënaqësinë e ekzistencës, është e mjaftueshme për mua ta di se unë jam krijesa e Tij dhe Ai është Zoti dhe Shpikësi im. Në lidhje me jetën, mjafton që unë jam një objekt i manifestimeve të Emrave të Krijuesit të vdekjes dhe të jetës. Sa për jetën dhe të drejtat e saj dhe qëllimet e saj, është e mjaftueshme që, në sajë të ekzistencës sime gjithëpërfshirëse, unë shfaq midis vëllezërve të mi perceptues në univers dhe shpall në tregun e botës mrekullitë e veprave të Emrave të Krijuesit të qiejve dhe tokës. Është e mjaftueshme për qëllimin e jetës që unë jam një model dhe një mishërim i veprave të manifestimeve të Emrave të Tij të bukur. Është e mjaftueshme për jetën dhe për plotësinë e saj që me gjuhën e gjendjes sime dhe të mënyrave që unë reflektoj manifestimet e Emrave të Tij me urdhërin e të Cilit qiejt u ngritën lart dhe me lejen e të Cilit toka ka fituar stabilitet. Është e mjaftueshme për kënaqësinë e jetës që unë di se unë jam robi i Tij, krijesa dhe shërbëtori i nevojshëm për Të, dhe Ai është Krijuesi im, Zoti, Shpikësi, Pronari Mëshirëplotë për mua, Bamirës për mua dhe Mbështetësi im. Dhe për sa ka të bëjë me plotësinë, besimi në Zot është i mjaftueshëm për mua kundër çdo gjëje.

Mësoje, o shok! Në Unitetin Hyjnor dhe në atribuimin e gjërave Zotit të Vetëm ndodhet një lehtësi e pafundme, deri në shkallën që ekzistenca do të bëhej pothuajse e domosdoshme. Ndërsa në shirk dhe

në atribuimin e krijesave pseudo–krijuesve të shumtë ndodhet një vështirësi e pafundme, deri në shkallën që ekzistenca do të bëhej e pamundur. Ndërsa ekzistenca fiton vlerën e pafundme duke ia atribuuar atë Zotit të Vetëm; ajo e humbet të gjithë vlerën e saj duke ua atribuuar vetvetet e tyre pseudokrijuesve të shumtë ose natyrës, ose lëndës, ose rastësisë dhe gjërave të ngjashme. A nuk e sheh ti se si një gjë në dorën e një ushtari vlerësohet si e madhe dhe si e çmueshme nëpërmjet qënies së saj duke iu atribuuar mbretit, dhe ligjërimi i ushtarit rreth mbretit tërheq vëmendjen dhe i jepet shumë rëndësi. Gjithashtu, sa e lehtë është të prodhosh të gjitha domosdoshmëritë e jetës prej thesareve të mbretit. Ndërsa, çfarëdo që ka një ushtar ose flet do të humbasë të gjithë vlerën dhe rëndësinë në qoftë se lidhja e tij me mbretin këputet nga mosbindja e tij ndaj mbretit.

Mësoje, o shok! Çfarëdo që vjen nga i Gjithëfuqishmi është e njëjta, nëse sjell dëm apo dobi, të mirë apo të keqe, jetën ose vdekjen nëpërmjet Fuqisë dhe Kaderit të Tij. Sepse vdekja është fillimi i një jete tjetër, dhe e keqja dhe dëmi përfundojnë përkatësisht në të mirën dhe në dobinë.

Mësoje, o shok! Për shkak të natyrës së tij gjithëpërfshirëse dhe të aftësive të shumta, shpirti i njeriut ka kapacitetin edhe për kënaqësi të pakufishme, edhe për dhimbje të pakufizuara. Ai merr kënaqësi në kënaqësitë e fëmijëve të tij, të vëllezërve dhe motrave njerëzore, dhe të krijesave të tjera, dhe vuan për shkak të pikëllimeve të tyre.

Mësoje, o shok! Në qoftë se dikush vëzhgon gjërat me harrimin e vetvetes, realitetet ndryshojnë, ashtu si gjërat që shihen në ujë të kundërta, anasjelltas, mosdija jote të çon ty ta shohësh vetveten si të dijsëm.

Mësoje, o shok! Ajo çfarë kërkon përsëritjen e disa pjesëve të Kuranit gjithashtu kërkon përsëritjen e dhikrit –recitimeve fetare– dhe duave. Sepse Kurani krahas qënies një libër i të vërtetave, libër ligji dhe një libër i njohjes Hyjnore dhe i urtësisë, është gjithashtu një libër recitimi, lutjeje dhe thirrjeje. Dhikri –recitimi– kërkon përsëritje, dua ja kërkon përsëdytje, dhe Daëveti –thirrja– kërkon riafirmim.

Mësoje, o shok! Është njëri prej virtyteve të lartësuara të Kuranit që ai arrin tek Uniteti Hyjnor pas përmendjes së botës së shumësisë, duke bërë kështu një përmbledhje pas shpjegimit. Pas përmendjes së gjërave

të veçanta –të pjesshme– ai konkludon me parimet e Hyjnisë absolute dhe me rregullat e Atributeve gjithëpërfshirëse Hyjnore të plotësisë. Konkluzione të tilla shërbejnë si rezultate të pjesëve kryesore të vërseteve ose si efektet e shkaqeve të trajtuara me to. Duke bërë kështu, Kurani synon ta ndalojë mendjen e dëgjuesit ose të recituesit prej të qënurit e humbur në të pjesshmet e ekzistencës dhe në të harruarit e madhështisë së rangut të Hyjnisë absolute. Ajo gjithashtu shfaq mënyrën e robërisë ‘intelektuale’ ndaj të Vetmit të madhështisë, të bukurisë dhe lartësisë. Përsëri, ajo e shtrin mendjen tënde prej atyre të pjesshmeve për tek ngjashmëritë e tyre dhe të mëson ty se në çdo gjë, madje edhe sikur ajo të ishte më e vogëla, ndodhet një rrugë e drejtë, e qartë për tek njohja e mbretit të parapërdjetshëm e të paspërdjetshëm dhe për tek vëzhgimi i manifestimeve të Emrave të të Vetmit Unik, të të Kërkuarit përjetësisht.

Nëpërmjet këtij stili, Kurani e shfaq ‘diellin’ në një ‘pikë uji’ ose manifestimet e ngjyrave në dritën e diellit mbi një ‘lule’. Ajo e shfaq diellin duke shndërritur me të gjithë madhështinë e tij në mesditë dhe si rrjedhojë e ngre kokën tënde lart për tek dielli me qëllim që ti të mos hutohesh midis shumësisë së gjërave dhe të përbuzësh diellin. Për shembull, në suren Jusuf, pas përmendjes së një ngjarje të veçantë të pjesshme, kryesisht planin e profetin Jusuf për ta mbajtur vëllain e tij me të, ai përmend:

“...E mbi çdo njeri të ditur është Një i Gjithëdijshëm”,¹⁹⁹

Po kështu edhe në suren El Haxh, h,

“Ata nuk e çmojnë Allahun me vlerën e Tij të vërtetë”²⁰⁰

Dhe në suren Ennur,

“Kur fëmijët tuaj të arrijnë moshën e pubertetit” deri tek “Allahu është i Gjithurtë dhe i Gjithëditur”²⁰¹

Dhe në suren El Ankebut,

¹⁹⁹Kur’an, 12:76

²⁰⁰Kur’an, 22:74

²⁰¹Kur’an, 24:59

“Por shtëpia më e dobët është pikërisht rrjeta e merimangës” deri tek *“Veç sikur ta dinin”*²⁰²

Mësoje, o shok! Bekimi dhe ndihma që vijnë nga evlijatë dhe shkëlqimi që ata japin janë një lloj lutje e bërë ose nëpërmjet gjendjes ose aktivisht. Ai që udhëzon dhe që realisht ndihmon është Allahu. Lidhur me këtë, diçka m’u shfaq mua por unë nuk munda ta specifikoj atë dallueshëm. Ajo është kështu: njeriu ka një shqisë të brendshme ose aftësi. Në qoftë se ai, madje edhe sikur të ishte një fasik –gjynahqar i madh– lutet nëpërmjet saj, ai sigurisht do të gjejë përgjigje. Ajo është një aftësi e tillë saqë njeriu betohet për Zotin nëpërmjet saj që diçka të ndodhë, Allahu nuk e kundërshton atë.

Mësoje, o shok! O ti që je i bindur për ndodhjen e ngjarjeve të së shkuarës, por që je dyshues rreth të ardhmes! Kthehu prapa tek disa shekuj dhe supozoje veten tënde si njërin prej paraardhësve të tu. Pastaj, shikoji paraardhësit e tu të cilët tashmë kanë qenë krijesat e së shkuarës dhe pasardhësit e të ardhmes tënde të cilët kanë gjasa të vijnë njëri pas tjetrit. A ndodhet ndonjë ndryshim midis këtyre dy krahëve? Ti nuk do të jesh në gjendje të shohësh dorën e asgjëje –rastësinë apo diçka tjetër– në to. Ashtu si gjeneratat paraardhëse që janë padyshim krijesat e Zotit, po ashtu edhe gjeneratat e së ardhmes do të jenë kështu. Të dy përfshihen në njohjen e Krijuesit dhe vëzhgohen prej Tij. Rikthimi në jetë i paraardhësve të tu nuk do të jetë më e çuditshme se sa krijimi i pasardhësve të tu. Përkundrazi, kjo do të ishte më e lehtë, ashtu siç deklaroi i Gjithëfuqishmi:

*“E për Atë kjo është edhe më e lehtë”*²⁰³

Në qoftë se ti do të krahasoje tërësinë e krijimit dhe ngjarjet me këtë ngjarje të veçantë të pjesshme, ti do të shikoje se të gjitha ngjarjet e së shkuarës janë mrekulli që dëshmojnë se Krijuesi i tyre ka fuqi absolute për të shkaktuar të gjitha ngjarjet e mundshme dhe krijesat. Ai ka gjithashtu njohje absolute për të gjitha detajet më të holla dhe i rrethon e i përfshin ato me shikimin e Tij. Të gjitha ato krijesa dhe objekte qiellore në kopshtin e universit janë mrekulli duke dëshmuar e qartësuar se Krijuesi i tyre është i Gjithëfuqishëm për të gjitha gjërat i Gjithëditur për të gjitha gjërat. E ngjashme me këtë, të gjitha ato bimë

²⁰²Kur’an, 29:41

²⁰³Kur’an, 30:27

të lulëzuara dhe speciet e kafshëve të stolisura që gjenden në kopshtin e tokës janë mrekullitë e artit të Tij dhe dëshmojnë qartë se Autori i tyre është i Gjithëfuqishëm për të gjitha gjërat dhe është i Gjithëditur për të gjitha gjërat. Në lidhje me fuqinë e Tij, krijimi i grimcave dhe i yjeve, dhe bërja e pemëve të prodhojnë fruta dhe ringjallja e të vdekurve janë të njëjta. Rimëkëmbja e bijve të Ademit mbi kockat e tyre të kalbura nuk është asgjë më e vështirë për Të se sa bërja e luleve të pemëve për t’u rihapur e riçelur mbi degët e tyre të holla në çdo vit.

Mësoje, o shok! Ashtu si frutat e pemëve, pikat e ujit, forma e të cilave shfaq rregull të hollë e të përsosur dhe balanca janë midis mirësive të panumërta të Zotit xh.sh.. Ai i Cili i bashkangjiti qëllime të pafundme një pike uji është Ai i Cili mban tërësinë e krijimit në kapjen e Tij dhe thesaret e të Cilit janë midis Kaf dhe Nun. Një pikë uji është mirësia e Tij, i Cili e ka bërë rregullin “Kun”, “Ji” paskajoren (origjinën) e “Kaun”, “Krijimit”. I gjithë lavdërimi dhe mirënjohja janë të Tij, të Gjithëlavdishmit.

Mësoje, o shok! Përmendja e shpeshtë e Ringjalljes së tokës në Kuran, dhe tërheqja e vëmendjes nga Kurani për njerëzimin për tek dheu, u inspirua tek unë se toka është zemra e universit. Më e afërta e rrugëve për tek objektivi kalon përmes ‘dheut’ nëpërmjet derës së përulësisë dhe vetëasgjësimit. Dheu është më i afërti me Krijuesin e qiejve, madje është edhe më i afërt se sa më i larti i vetë qiejve. Sepse nuk ndodhet asgjë tjetër në univers i barabartë me dheun në marrjen e manifestimeve të Hyjnisë dhe të Emrave El Hajj El Kajjum, i Gjalli i Përjetshëm dhe Vetekzistuesi i Përhershëm, duke shfaqur krijueshmërinë Hyjnore dhe ato të qënurit objekt i aktiviteteve të Fuqisë Hyjnore.

Ashtu si Froni i Mëshirës që është mbi ujë, Froni i jetës dhe i Ringjalljes është mbi dhé. Dheu është më gjithëpërfshirësi i pasqyrave duke reflektuar manifestimet e jetës. Sa më e tejdukshme që të jetë pasqyra e një gjëje të dendur, aq më qartë e shfaq ajo atë gjë, dhe sa më e dendur të jetë pasqyra e një gjëje të ndritshme, aq më i plotë është reflektimi i Emrave në të. A nuk e shikon ti se ajri merr vetëm një dritë të zbehtë prej rrezatimit të diellit dhe uji nuk mund t’i reflektojë ngjyrat e diellit, megjithëse ai e shfaq atë për ty me dritën e tij. Sa për dheun, ai shfaq nëpërmjet luleve të tij çfarëdo që ndodhet në dritën e diellit. E krahasuar me Dritën e Diellit të Parapërtjetshëm, ai –dielli– është veçse

një pikë e ndritshme e dendur. Stolisja e dheut dhe shfaqja në pranverë e luleve të tij të panumërta të hijshme të formave dhe ngjyrave pafundësisht të ndryshme dhe e kafshëve të tij të panumërta të bukura dëshmojnë për plotësinë e Hyjnisë – si një dëshmitare për Krijuesin. Nëse dëshiron shikoje atë manushaqe, si vepron Dora e Autorit të Gjithurtë duke e ngjyrosur e duke e zbukuruar atë.

Lavdia qoftë për Atë, i Cili e bën Vetën e Tij të njohur për ne nëpërmjet artit të Tij të hollë, e bën fuqinë e Tij të njohur për krijesat e Tij nëpërmjet mrekullive të Autoritetit të Tij në dhé. Kjo shpjegon kuptimin e hadithit,

“Një shërbëtor është më afër Zotit të tij kur ai bën sexhde para Tij”²⁰⁴

Duke qenë kështu e vërteta, mos u frikëso prej dheut dhe hyrjes në të, as mos e ki frikë varrin dhe shtrirjen në të.

Mësoje, o shok! Mendja ime e shoqëron zemrën time në udhëtimin e saj dhe zemra ia jep zbulimet e saj dorës së mendjes, e cila i shfaq ato ashtu siç bën ajo gjithmonë, në formën e dëshmimeve alegorike. Për shembull, Krijuesi i Gjithurtë është pafundësisht afër krijesave të Tij ashtu siç është Ai pafundësisht larg prej tyre. Gjithashtu, ashtu siç është Ai më i Brendshmi i të brendshmive, po ashtu Ai është më i Jashtmi i të jashtmeve. Përsëri, Ai nuk është as brenda dhe as jashtë diçkaje.

Në qoftë se dëshiron, shikoji veprat e mëshirës së Tij të shpërndara mbi faqen e tokës dhe gjurmët –vulat– ose aktivitetet e fuqisë së Tij në sferat e ekzistencës mbi tokë, me qëllim që ti të mund ta shohësh atë realitet të dukshëm. Shqyrtoji dy grimcat ose dy lulet ose dy frutat ose dy bletët e ekzaktësisht të të njëjtit lloj ose identiteti, njëri në perëndimin më të largët dhe tjetri në lindjen më të largët. Për sa ka të bëjë me kushtet e dukshme fizike, Autori i Cili i krijon këto dy gjëra pikërisht në të njëjtin çast duhet të jetë larg prej tyre. Kurse, nga pikëpamja e lehtësisë dhe e shpejtësisë së krijimit dhe dorëgjërësisë së pafundme të krijesave së bashku me qëndrueshmërinë absolute të tyre, Krijuesi është pafundësisht afër çdonjëres. Kjo nuk është si afërsia e qendrës së rrathëve bashkëqëndrorë për t’i treguar ato të cilat ndryshojnë në afërsi me qendrën. Sepse të gjitha gjërat janë njëlloj afër

²⁰⁴Transmeton Muslimi.

Autorit i Cili e bën çdo gjë pafundësisht të qëndrueshme dhe të bukur. Kjo buron nga cilësitë e sferës së Domosdoshmërisë, Hyjnisë, abstraksionit dhe palëndësisë së dimensionit të brendshëm të ekzistencës, dhe karakterit të pakushtëzuar, absolut i Atributeve Hyjnore dhe i akteve. Kjo është gjithashtu për shkak të karakterit të manifestimeve të Emrave Hyjnorë mbi krijesat një nga një si dhe mbi tërësinë e ekzistencës në të njëjtën kohë, dhe ndryshimi i plotë prej identitetit të Vepruesit Origjinal dhe objektit. Për shembull, dhe për Allahun është krahasimi më i lartë, nëpërmjet imazheve në pasqyrat e objekteve të tejdukshme dhe reflektimeve mbi lulet, dielli është më afër atyre se sa ato me vetveten, ndërsa ato janë tejet larg prej diellit. Është pothuajse e pamundur të kalosh distancën midis imazhit të diellit në pasqyrën tënde dhe origjinalit të tij.

Lavdia qoftë për Atë, i Cili është absolutisht i lirë prej pasjes përngjasues në Esencën e Tij dhe është absolutisht i përjashtuar prej pasjes përngjasues të Atributeve të Tij. Ai është i Pari, i Fundit, i Dukshmi, i Padukshmi. Dhe Ai është i Gjithëditur për të gjitha gjërat!

O Zot! O i Drejtë! O i Gjithhurtë! O i Gjithëditur! Nuk ndodhet një frymë e vetme e re, një pikë e vetme në re, një tingull i vetëm në rrufe, një shkrepimë e vetme në vetëtimë, një lule e vetme në kopësht, një frut i vetëm në pemishte, një bletë e vetme në ajër, një ngjyrë e vetme në bimë, një vepër e vetme arti tek kafshët, një zbulurim i vetëm në ekzistencë, një grimcë e vockël në krijim, një shembull i vetëm rregulli dhe balance në krijim, një gjë e vetme në Fronin më të Lartë Hyjnor, një akt i vetëm në Kursinë më të Lartë Hyjnore, një yll i vetëm në qiejt dhe një gjë e vetme në tokë, që të mos dëshmojë se Ti je Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm, Një, i Vetëm, i Kërkuari përjetësisht. Nuk ndodhet një krijesë e vetme që të mos dëshmojë qartë se Ti je Zoti i Vetëm Një, Njohësi i së padukshmes, Ai i Cili nxjerr kokrrat dhe nënshtron zemrat. Të gjitha krijesat janë nën fuqinë Tënde, me zemrat e tyre në kapjen Tënde, baluket e tyre në Dorën Tënde dhe çelësat me Ty. Nuk ndodhet një grimcë e vockël veçse lëviz me lejen Tënde.

O Zot i atyre të cilët tashmë kanë ikur dhe i atyre që do të vijnë! O Zot i Muhammedit a.s.m dhe i Ibrahimit, Xhebrailit dhe Mikailit a.s! Unë të lutem Ty për hir të Emrit Tënd më të Madh, Dritës së Fytyrës Tënde të nderuar, fesë Tënde të drejtë, Rrugës tënde të drejtë, dhe për shtatë të përsëriturat dy herë (suren El Fatiha), dhe për hir të Kuranit

Madhështor dhe për hir të mijëra e mijëra El Fatihave dhe për hir të mijëra Kul Huvall-llahu Ehad, dhe për hir të Emrave të Tu më të bukur, Emrit Tënd më të Madh, Gurit të Zi të shenjtë dhe Shtëpisë Tënde të nderuar –Qabesë– dhe për hir të Natës së Kadrit dhe Ramazanit të madhërueshëm, dhe për hir të profetëve të Tu të nderuar a.s, dhe për hir të të dashurit Tënd më të nderuar a.s.m, unë të përgjërohem e të lutem Ty për hir të atyre që u përmendën që ta mëshirosh ummetin e Muhammedit a.s.m, hapi kraharorët e tyre për besim e Islam, na mbaj neve të sigurtë kundër heretikëve, mbroje fenë tonë, ndriçoji dëshmitë e Kuranit dhe lartësoje sheriatin e Islamit. Amin, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve.

Allahu ju bekoftë mijëra e mijëra herë dhe Allahu ju dhëntë sukses!

SHTOJCË

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi profetin e Tij.

Mësoje, o shok! Asgjë nuk mund të mbulohet prej Dritës së pastër e gjithëpërfshirëse, dhe asgjë nuk mund të jetë jashtë sferës së Fuqisë së pakufishme, përndryshe ajo që është e pakufijshme do të duhej të ishte e kufijshme, gjë e cila është e pakonceptueshme.

Gjithashtu, urtësia Hyjnore dhuron bekim mbi çdo gjë sipas kapacitetit të çdonjërës, çdo gjë merr prej oqeanit në vëllimin e shtambës së vet. Asgjë e vogël nuk mund ta pengojë të Gjithëfuqishmin e Gjithurtë, i Cili krijon gjithçka me një masë të caktuar prej të preokupuarit me të mëdhajat, as të mëdhajat dhe as speciet nuk mund ta pengojnë Gjithëpërfshirësin, të Jashtmin dhe të Brendshmin dhe të Palëndëtin e Vetëm prej të interesuarit për të vogëlat ose të pjesshmet. Diçka e vogël është e madhe në artin që ajo përmban, dhe një specie e krijesave të vogëla ekziston më me bollëk se të tjerat prej specieve të mëdhaja. Madhështia Absolute nuk pranon kurrë ortakë. Një krijesë pafundësisht e bollshme, me lehtësi absolute dhe me shpejtësi e

qëndrueshmëri absolute shfaq se Një Hirplotë i Vetëm dëshiron të bëhet i njohur dhe shikon se Bukuria dhe Plotësia e Tij Absolute vëzhgohen. Bashkë me këtë krijim, mëshira dhe pasuria absolute të dëshmuara prej çfarëdo gjëje që ekziston dhe që ndodh në univers, dhe ekzistenca e pothuajse e numrave të pafundmë të vëzhguesve reflektivë, të gjitha reflektojnë padyshim ekzistencën e specieve të mikroorganizmave dhe të të vegjëlve, krijesat fluturuese me bollëk të pafundmë.

Mësoje, o shok! Në qoftë se vetja jote është më e dashur për ty se ndonjë gjë tjetër për shkak se ajo është më afër me ty se sa të gjitha gjërat e tjera, atëherë Zoti yt duhet të jetë më i dashur për ty se sa vetja jote, sepse Ai është më afër teje se sa vetja jote. A nuk e sheh ti se gjëra të paçmueshme –shqisa, aftësi etj– janë vendosur tek ty të cilat janë përtej fuqisë tënde dhe imagjinatës, funksionojnë nën udhëzimin e Zotit tënd?

Mësoje, o shok! Nuk ka vend për rastësi në univers. Vështroje një kopësht që të shohësh rregullsi të pafundme në përzierje të pafundme dhe në dallueshmëri të plotë midis përzierjes së plotë të gjërave. Kjo tregon urtësinë e Autorit, njohja e të Cilit është gjithëpërfshirëse.

Mësoje, o shok! Në qoftë se ti nuk ia atribuon të gjitha gjërat Qënies së Vetme, ti do të duhej të pranoje ekzistencën e hyjnive, aq sa numri i manifestimeve të Allahut mbi të gjithë ekzistuesit individualë në univers. Është sikur, pas mbylljes së syve të tu ndaj diellit dhe duke qëndruar i pakujdesshëm ndaj tij, ti i sheh imazhet e diellit duke shndëritur në pikat mbi sipërfaqen e oqeanit. Ti i sheh ato si ekzistuese nga vetvetja të pavarura prej diellit, dhe ti atëherë do të duhej të pranoje ekzistencën e aq shumë diejve, aq sa ato pika. Ndërsa ajo pikë nuk mund të nxë as më të vogëlin e yjeve, jo më të nxënë llampën e botës!

Mësoje, o shok! Në qoftë se ti vëzhgon me sy të vëmendshëm, ti do të shohësh se të gjitha speciet ose llojet e krijesave konkurojnë me entuziazëm për të paraqitur stolitë dhe hollësitë e tyre të bukurisë para shikimit të Vëzhguesit Madhështor, i Cili vazhdimisht i sheh ato. Sepse të gjitha krijesat dukshëm shfaqin një formë që përmban hollësi të pafundme arti të përsosur duke tërhequr shikuesit. Ato konkurojnë për të paraqitur bukuritë dhe stolitë e tyre para shikimit të Dëshmitarit të Parapërdjetshëm, i Cili i ka krijuar të gjitha krijesat me qëllim që në pasqyrat e tyre të shihen manifestimet e dritave të bukurisë së Tij,

hijeshisë, madhësisë dhe plotësisë. Pastaj, Ai i thërret të gjithë dëshmitarët e vetëdijshëm për t'i parë ato me qëllim që ta njohin Atë dhe ta dallojnë Atë Thesar të Fshehtë.

Më i larti i qëllimeve për ekzistencën e një gjëje, më e larta e të drejtave të jetës, është prezantimi i saj vetveten para shikimit të Krijuesit të saj dhe qënies e vështruar prej Tij për shkak se ajo është vepra e Emrave të Tij. Dhe më e madhja e kënaqësive të jetës është se një qënie e gjallë është e vetëdijshme që po vështrohet prej Tij.

Qënia e një gjëje e shikuar prej vëllezërve të saj krijesa është gjithashtu një qëllim tjetër për ekzistencën e saj. Por, e krahasuar me qëllimin e parë, ndryshimi është aq i shumë dhe aq i madh, sa ndryshimi që është midis të fundmes dhe të pafundmes.

Sa për atë që njerëzit e quajnë “e drejta e jetës”, ajo është ruajtja e jetës. Ajo është vetëm njëra prej të drejtave të panumërta të jetës, më e vogël dhe më pak e rëndësishmja, sepse jeta është midis më të lartave, më të shtrenjtave, më të çuditshmeve, më të mahnitshmeve, më të hollave dhe më të nderuarave e mrekullive të Fuqisë së të Gjallit të përjetshëm dhe Vetekzistuesit të Përhershëm, të Vetmit Unik dhe e të Kërkuarit përjetësisht. Madje, ruajtja e jetës është mjeti që kjo mrekulli të njihet dhe që funksionet e saj të përmbushen dhe është e vlefshme vetëm si një mjet. Prandaj, ajo nuk mund të ngrihet tek rangu i një synimi apo qëllimi.

A mendon ti, o i pavëmendshëm, se një shëgë, për shembull, e cila është një vepër e mahnitshme e Artit Hyjnor, është veçse për ngrënien tënde për një minut? Ajo është një fjalë duke treguar kuptimin e saj për Krijuesin e Gjithëlavdishëm, i Cili e formon atë.

Mësoje, se i Vetmi i Cili ka bukurinë më të lartë merr kënaqësi të vërtetë në shikimin e bukurisë së Tij dhe në shfaqjen e saj para krijesave. Ndërsa, është e pamundur të ndjesh kënaqësinë e epërsisë relative me të njëjtën fuqi. I Vetmi me plotësi esenciale dhe me bukuri të përjetshme, të vërtetë e të pastër, duhet për shkak të Vetvetes, për të Cilin është krahasimi më i lartë, dhe i Cili na njoftoi neve me gjuhën e të dërguarit të Tij, paqja dhe bekimet qofshin mbi të, i cili deklaroi: “Ai e ka krijuar krijimin për t’u njohur”. Domethënë, Ai i ka formuar pasqyrat me qëllim që manifestimet e bukurisë së Tij, i Cili është i dashur për shkak të Vetvetes të mund të shihen në to.

Mësoje, o i përkohshëm! Për sa ka të bëjë me qëndrueshmërinë, mjafton që për ty, që pas vdekjes tënde, ti do të vazhdosh të ekzistosh në njohjen e Tij dhe para syve të Tij. Jepja të gjitha gjërat Pronarit të tyre të vërtetë dhe atribuoja ato Atij që të fitosh kënaqësi. Ndryshe, ty do të të duhej të pranoje aq shumë hyjni, aq sa manifestimet e Zotit ose sa grimcat e universit, ose sa grimcat e dheut, ashtu siç është përmendur disa herë në këtë libër. Sepse dheu shërben për gjallesa të panumërta të shumëllojshmërisë së madhe për të ardhur në ekzistencë.

Lavdi qoftë për Atë, i Cili është absolutisht i lirë prej pasjes së përngjasuesve as në Esencën e Tij dhe as në Atributet, dhe Njësinë e të Cilit e dëshmojnë krijesat dhe Hyjninë e të Cilit e dëshmojnë shenjat dhe fuqia, dhe njohja e të Cilit i përfshin e i rrethon të gjitha gjërat, madhështia e Tij qoftë e lartësuar, dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij.

■ Trajtesa e Dymbëdhjetë

Një pikë prej Dritës së njohjes së Zotit

Sqarim

Kur futem në një kopësht, unë zgjedh lulen më të bukur ose frutin më të mirë. Në qoftë se është e vështirë për mua ta këpus, unë marr kënaqësi në shikimin e tij. Në qoftë se unë rastis një të prishur, largohem prej tij, nuk e vë re, në përputhje me rregullin “merre atë që të kënaq dhe lëre atë që nuk të kënaq”. Ky është stili im, dhe unë u kërkoj lexuesve të mi gjithashtu të sillen në të njëjtën mënyrë.

Ata thonë se çfarë unë shkruaj nuk mund të kuptohet qartë. Unë bie dakord me këtë. Unë shkruaj çfarëdo që i ndodh zemrës sime në mënyrën që ajo ndodh. Unë ndjej sikur unë ndonjëherë flas prej majes së një minareje dhe ndonjëherë prej fundit të një pusi.

I dashur lexues! Ndërsa ti e lexon këtë trajtesë, unë të kërkoj ty të marrësh parasysh sa vijon:

Ai i cili flet është zemra ime e mjerë. Ai të cilit i adresohem është nefsi im i pabindur. Ndërsa dëgjuesi është ai njeri i cili është në kërkim të realitetit. Qëllimi ynë dhe synimi ynë është Uniteti Hyjnor. Midis provave të panumërta për Të, ne këtu sjellim vetëm katër.

Said Nursi

Unë besoj në Allahun, në melekët e Tij, në librat e Tij, në profetët e Tij, në Ditën e Fundit dhe në Kaderin, e mira dhe e keqja duke qenë prej Zotit të Gjithëfuqishëm. Ringjallja pas vdekjes është e vërtetë, dhe unë dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe gjithashtu dëshmoj se Muhammedi a.s.m është i dërguari i Tij.

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdërimi qoftë për Allahun, Zotin e të gjitha botëve dhe paqja dhe bekimet qofshin mbi Muhammedin, vulën e profetëve dhe mbi të gjithë familjen e tij dhe sahabët.

“Synimi ynë dhe qëllimi është: Allahu, nuk ka zot tjetër përveç Atij, i Gjalli i Përjetshëm dhe Vetekzistuesi i Përhershëm”²⁰⁵

Midis provave të panumërta për Të, ne sjellim këtu vetëm katër:

Prova e parë është Muhammedi a.s.m.. Ne e shpjegoam këtë provë në trajtesën “Rreze prej njohjes së profetit” dhe gjithashtu në trajtesën e dytë të këtij libri e tilulluar “Pika prej oqeanit të Njohjes së profetit”.

Prova e dytë është ky univers –ky njeri i madh– ky libër i madh i vëzhguar i krijimit.

Prova e tretë është Kurani i shenjtë. Është libri në të cilin nuk ka dyshim dhe i cili është Fjala e shenjtë.

²⁰⁵Kur'an, 2:2555

Prova e katërt është ndërgjegjja njerëzore ose vetëdija, e cila është pikëlidhja e botës së padukshme dhe e botës materiale, të dukshme. Ndërgjegjja e njeriut ose vetëdija influencon intelektin prej të cilës përhapet rrezja e besimit në Unitetin Hyjnor.

Prova e parë: Është e vërteta Muhammedane, mbi të qofshin paqja dhe bekimet. Kjo provë është e pajisur me profetësinë dhe Islamin. Profetësia përmban dëshminë e konsensusit më të madh dhe të dakordësisë më gjithëpërfshirëse të të gjithë profetëve, paqja qoftë mbi ta, dhe Islami mban shpirtin e feve qiellore dhe vërtetimin, dhe konfirmimin e tyre të bazuar në shpallje. Profeti fisnik a.s.m i shpjegon njerëzimit ekzistencën e Zotit dhe Unitetin e Tij me të gjitha fjalët e vërteta të afirmuara nga mrekullitë e tij të dukshme, nga dëshmia e profetëve, paqja qoftë mbi ta, dhe nga konfirmimi i të gjitha feve qiellore. Ai, a.s.m e shfaq atë dritë të Unitetit Hyjnor në emrin e atyre që janë të pastër e të zgjedhur midis njerëzimit, të cilët që të gjithë kanë dakordësi mbi këtë thirrje.

A do të ishte e mundur që gënjeshtra të mund të ketë dorë në atë të vërtetë të qartë, të dukshme e të pastër, e cila gëzon një konfirmim të tillë të fortë dhe dallohet prej syve depërtues në të gjitha të vërtetat? Jo! Ajo do të ishte e pamundur.

Prova e dytë: Është libri i krijimit. Të gjitha shkronjat dhe pikat e këtij libri individualisht dhe kolektivisht, secila shpreh me gjuhën e saj të veçantë, “*Dhe s’ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij*”²⁰⁶ dhe shpall ekzistencën e Krijuesit Madhështor dhe Unitetin e Tij. Çdo grimcë e krijimit dëshmon me dëshmi të vërtetë për domosdoshmërinë e ekzistencës së Krijuesit të Gjithurtë, e lartësuar qoftë madhështia e Tij. Ndërsa, duke qenë ngurruese midis mundësive dhe probabiliteteve ku ato do të shkojnë, nëse ato do të përbëjnë blloqe ndërtimi të një qënieje, në çfarë dhe çfarë lloj qënieje ato do të vendosen, çdo grimcë merr një rrugë të caktuar dhe pajiset me cilësi të caktuar. Ajo drejtohet për tek një qëllim i specifikuar në përputhje me disa ligje të vërtetuara dhe qëllime në shumë rezultate të paramenduara e të habitshme. Ajo e forcon besimin në Zot, e cila ngulitet në aftësinë e brendshme të njeriut nga Allahu, me qëllim që ai të mund ta gjejë Atë, dhe e cila përfaqëson modelet e botërave të së padukshmes në njeriun.

²⁰⁶Kur’an, 17:44

A nuk e shpall grimca me gjuhën e saj të veçantë qëllimin e Autorit të saj të Gjithëlavdishëm dhe urtësinë e Tij të dukshme? Nëpërmjet ekzistencës së saj individuale, cilësive të veçanta dhe natyrës së përcaktuar, çdo grimcë tregon e dëshmon Krijuesin e Gjithurtë. Ajo vepron si një bllok ndërtimi në formimin e pjesëve përbërëse njëra brenda tjetrës, duke marrë një rrugë midis mundësive të panumërta dhe probabiliteteve, ajo si rrjedhë merr një pozitë në një përbërës. Pozita që ajo merr ka lidhje me të gjitha pozitat e tjera dhe grimca përmbush shumë detyra që dalin prej atyre lidhjeve. Meqenëse ndodhet një balancë tepër e saktë dhe një harmoni e përkryer midis pozitive, çdo detyrë që përmbush grimca fiton fruta të urtë të shumtë. Meqenëse e gjitha kjo mbështet dëshminë e grimcës për Krijuesin, me gjuhën e çdo akti të saj dhe të detyrës që ajo përmbush, grimca shpall provat e domosdoshmërisë së ekzistencës së Autorit të saj të Gjithëlavdishëm dhe shfaq qëllimin e Krijuesit të saj të Gjithurtë. Është sikur ajo të recitonte vërsetet fisnike që deklarojnë Unitetin Hyjnor. Shembulli i saj është si ai i një ushtari i cili është ngarkuar me detyra të veçanta dhe ka lidhje me të gjithë divizionet brenda një ushtrie lidhur me ato detyra.

Atëherë, a nuk janë provat e ekzistencës dhe të Unitetit të Zotit të Gjithëfuqishëm më shumë se sa të gjitha grimcat e krijimit? Thënia “Rrugët që të çojnë tek Zoti janë sa numri i frymëmarrjeve të krijesave të Tij”, shpreh një të vërtetë të pastër pa ekzagjërime.

Pyetje: Përse nuk mund ta gjejnë të gjithë njerëzit me mendjet e tyre Krijuesin Madhështor?

Përgjigja: Për shkak të plotësisë së madhësisë së Tij dhe mospasjes së Tij asnjë opozitë.²⁰⁷ *Reflekto mbi rreshtat e universit sepse ato janë mesazhe për ty prej Vendbanimit më të Lartë.* Ky libër i madh i krijimit shfaq rregullsi aq të qartë si dielli në mesditë dhe ekspozon mrekullinë e Fuqisë në çdo fjalë ose shkronjë në të. Ky libër është hartuar në mënyrë aq të mrekullueshme, saqë duke supozuar të pakonceptueshmen, në qoftë se secila prej shkaqeve materiale të ishte si një veprues i lirë, ato të gjithë do ta përkulnin vetveten –do të bënin sexhde– me përlësinë më të madhe përpara kësaj mrekullie, duke

²⁰⁷ Gjithçka në ekzistencë njihet nëpërmjet të kundërtës së saj. Vetëm i Gjithëfuqishmi nuk ka as të barabartë e as të kundërt. (Përkthyesi).

thënë ‘Subhaneke’, Lavdia qoftë për Ty, ne nuk kemi fuqi, sigurisht Ti je i Plotfuqishmi, i Gjithurti.

Ashtu siç mund ta vëzhgosh, ndodhet një rregull aq i hollë e i sofistikuar në këtë libër saqë të vendosësh një pikë të re në vendin e saj të saktë në të do të kërkonte një fuqi absolute të aftë për të shpikur tërësinë e krijimit. Sepse secila nga shkronjat e tij –sidomos ato të gjallesave midis tyre– ka një lidhje të brendshme me të gjitha fjalitë e tij, dhe secila nga shkronjat e tij ka një lidhje shumë të fortë me të gjitha fjalët e tjera. Prandaj, kushdo që i ka krijuar sytë e një mushkonje ka krijuar gjithashtu diellin, dhe kushdo që ka vënë në rregull stomakun e një pleshti, ka rregulluar gjithashtu sistemin diellor. Nëse dëshiron, referoju vërsetit “Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm”,²⁰⁸ dhe shiko se si një dëshmitar i vërtetë shfaqet prej gjuhës së një blete, e cila është vetëm njëra prej mrekullive të Fuqisë ose përfaqëson një fjalë të vogël në këtë libër. Ose, në qoftë se dëshiron, shqyrto një mikroorganizëm, i cili, ndonëse kaq i vogël saqë ai nuk mund të shihet me një sy të zhveshur, është një shembull i zvogëluar i krijimit. Ai i Vetëm, i Cili e ka ‘shkruar’ atë në atë model të mrekullueshëm, gjithashtu Ai ka ‘shkruar’ tërësinë e universit. Nëse ti e studion atë dhe dallon mekanizmat e hollë dhe sistemet e mahnitshëm të instaluar në të, ti do të bindeshe se do të ishte e pamundur t’ia atribuojë ekzistencën dhe jetën e saj shkaqeve natyrale, të thjeshta e të pajeta, që janë të paaftë për të dalluar midis mundësive. Përndryshe, ti do të duhej të pranoje se në çdo grimcë të ekzistencës të gjendej vetëdija e të urtëve dhe njohja dhe gjenialiteti i burrave të shtetit dhe i administratorëve që ato të mund të komunikonin me njëri-tjetrin pa ndonjë mjet ndërmjetësues. Ajo është bestytëni prej të cilës turpërohen edhe vetë bestytënorët. Nuk ka shpjegim për atë mekanizëm të jetës veçse ta shohësh e ta vlerësosh si një mrekulli e Fuqisë Hyjnore. Është shpikja e të Vetmit, i Cili e ka shpikur të gjithë universin dhe ka rregulluar funksionin e tij. Përndryshe, do të ishte e pamundur për dy shkaqet natyrale dhe më të rëndësishme kryesore, ose dy ligjet, kryesisht forca e gravitetit dhe forca e shtytjes, të vinin bashkë në një atom.

Forca e gravitetit, forca e shtytjes, lëvizja dhe fenomene të ngjashëm janë Emrat e Parimeve Hyjnore ose e rrugëve të operimit të

²⁰⁸Kur’an, 31:28

përfaqësuar si ligje. Ato mund të pranohen si ligje me kusht që ato të mos kalojnë nga qënia e tyre një parim në natyrë vepruese, dhe nga qënia e tyre vetëm Emra ose tituj, ose nga pasja e një ekzistence emërore në një ekzistencë ‘reale’ të jashtme.

Pyetje: Pavarësisht këtij fakti të dukshëm, përse disa besojnë në përjetësinë e materies dhe ia atribuojnë formimin e të gjitha specieve në ekzistencë lëvizjeve të rastësishme të grimcave ose gjërave të tjera të ngjashme?

Përgjigja: Duke iu afruar një çështjeje vetëm për t’u bindur racionalisht nuk do të thotë besim në Zot. Ata nuk mund ta perceptojnë prishjen e nocionit si arsytim i tyre se bazohet mbi një shikim sipërfaqësor dhe mbi një imitim. Ndërsa, në qoftë se një njeri do ta hetonte e shqyrtonte çështjen nga afër në kërkim të së vërtetës, ai do të konkludonte se sa e palogjikshme dhe iracionale është një besim i tillë. Në qoftë se akoma, pavarësisht kësaj, ai e arrin një besim të tillë, kjo është për shkak të pakujdesisë së tij ndaj Krijuesit, lavdia i qoftë Atij.

Sa e çuditshme është shmangia! ...Atij që i ngushtohet mendja për përjetësinë e Allahut, qoftë Ai i lavdëruar, dhe për sjelljen në ekzistencë të të gjitha gjërave nga ana e Tij –megjithëse përjetësia dhe krijueshmëria janë midis Attributeve të domosdoshme të Esencës Hyjnore– si ai ua jep atë përjetësi dhe sjellje në ekzistencë grimcave të pafundme dhe gjërave të pafuqishme?

Kujtoje këtë ngjarje të mirënjohur: ata po vështronin qiellin për të parë nëse hëna e re ishte shfaqur për të shënuar fillimin e muajit të shenjtë të Ramazanit. Një burrë i vjetër pretendoi se e kishte parë atë. Ndërsa çfarë ai kishte parë ishte veçse një qime e bardhë prej vetullës së tij e cila u harkua poshtë. Kështu, gjëra si ajo qime e bardhë janë ato të cilat i bëjnë njerëzit të verbër ndaj të vërtetës. Njeriu, për shkak të qënies së tij i nderuar nga natyra, e kërkon të vërtetën vazhdimisht, dhe gjatë kërkimit të së vërtetës, ai ndonjëherë has gënjeshtren dhe e ruan atë në kraharorin e tij, ose ndërsa ai gërmon për të vërtetën, çudhëzimi i bie në kokën e tij, dhe duke e supozuar atë të jetë e vërteta, ai e vesh atë.

Pyetje: Çfarë janë ato gjëra të quajtura natyrë, ligje dhe forca, nëpërmjet të cilave ato mashtrojnë vetveten?

Përgjigjja: Natyra është Sheriati Hyjnor gjithëpërfshirës i vendosur për rregullin dhe harmoninë të vendosura midis akteve, elementeve dhe pjesëve të trupit të krijimit që quhet bota materiale e dukshme. Ky shariat ose ligj i krijimit është ai që gjithashtu quhet ‘Sunnetall–llah’, mënyra, praktika e Allahut, dhe ‘Natyra’ është rezultati i tërësisë së ligjeve emërore që sundojnë në krijim.

Ajo çfarë ata quajnë forca, janë parimet e këtij sheriati; ligjet janë elementet e të njëjtit shariat.

Por, rregullsia e parimeve dhe elementeve të këtij sheriati çon tek qënia e tij i shikuar si “natyrë” me një ekzistencë të jashtme reale. Ata që e shohin natyrën si duke pasë ekzistencë të jashtme reale, e vlerësojnë atë gjithashtu si një vepruese, megjithëse është e pamundur që zemra apo mendja të binden për qënien e saj një veprues i vërtetë; por kjo ide e paarsyeshme i ka shtyrë ata tek hamendësimi i mohimit të Krijuesit të Gjithëlavdishëm dhe kjo për shkak të paaftësisë së tyre për të kuptuar veprat e mrekullueshme të Fuqisë Hyjnore të cilat hutojnë mendjet tona. Kjo “natyrë” injorante dhe e verbër mund të konsiderohet si origjina e gjërave.

Natyra është diçka e botuar, ajo nuk është botuesi; ajo është një skicë, jo skicuesi; një objekt mbi të cilin veprohet dhe jo vepruesi; një rregull ose masë, jo origjina; një sistem dhe jo sistemuesi; ajo është një parim pa asnjë fuqi, një koleksion ligjesh që burojnë nga Atributet Hyjnore të dëshirës dhe të Fuqisë, ligje pa ekzistencë reale të jashtme.

Supozo se një njeri në kulmin e rinisë së tij vjen në këtë botë të mahnitshme prej një bote tjetër dhe hyn në një pallat shumë të madh, të bukur e të stolisur. Ai nuk sheh asnjë njeri në pallatin e të cilit ai mund t’ia atribuojë ndërtimin dhe zbukurimin e tij. Shikimi i tij kapi një libër gjithëpërfshirës që përmbante një plan të pallatit dhe informacion rreth asaj si u ndërtua dhe si u mobilua pallati. Për shkak të injorancës së tij dhe të qenit i obsesuar e i fiksuar me ndërtuesin, ai e imagjinon atë libër të jetë ndërtuesi i pallatit. Në të njëjtën mënyrë, për shkak të pakujdesisë së tij ndaj Krijuesit Madhështor, disa njerëz i mashtrojnë vetvetet duke pranuar botën materiale si krijuesen e vetvetes.

Zoti ka dy lloje sheriati:

Njëri është ai i cili vjen prej Atributit Hyjnor të ligjërimit dhe rregullon ose vë në sistem aktet e shërbëtorëve që burojnë prej vullnetit të tyre të lirë; tjetri është ai i cili vjen prej Atributit Hyjnor të dëshirës dhe fuqisë dhe në fakt përfshin urdhërat Hyjnorë të krijimit dhe është rezultati i mënyrës Hyjnore të të vepruarit.

Sheriati i parë përfshin ligje të konceptueshme e të arsyeshme, ndërsa i dyti përbëhet nga ligjet Emërore, të cilat gabimisht quhen “ligjet e natyrës”. Ato nuk kanë pjesë krijuese ose shpikëse në ekzistencë. Krijimi dhe shpikja janë cilësitë e Fuqisë Hyjnore.

Ashtu siç e kemi përmendur shpesh deri tani ndërsa diskutojmë Unitetin Hyjnor, çdo gjë në ekzistencë është e lidhur me gjërat e tjera; asgjë nuk mund të ekzistojë e as të mbijetojë pa tërësinë e ekzistencës. Ai që e ka krijuar një gjë të vetme, i ka krijuar gjithashtu të gjitha gjërat e tjera, dhe Ai i Vetëm –Krijuesi i të gjitha gjërave– nuk mund të jetë tjetër veçse Një i Vetëm dhe i Kërkuari përjetësisht. Në kontrast, shkaqet materiale të cilave të çudhëzuarit u atribuojnë krijueshmëri, janë të shumta në numër dhe nuk e njohin njëri-tjetrin. Ato gjithashtu janë të verbëra. T’u atribuosh krijueshmëri atyre do të thotë të pranosh se gjëra të panumërta, të verbëra e të pajeta të kenë ardhur bashkarisht nga rastësia dhe ta kenë formuar atë univers të gjerë e të rregullt. Ekzistenca, rregulli dhe harmonia e të cilit në mënyrë të dukshme kërkon njohje absolute, dëshirë, fuqi dhe urtësi.

“Pastaj lëri të luajnë në bisedat e cikërrimat e tyre të kota”²⁰⁹

Përmbledhja: Sistemi i vëzhguar dhe rregullsia në librin e madh të universit dhe mrekullia e dukshme në përbërjen e tij janë dy provat e Unitetit Hyjnor, të cilat shfaqin aq qartë si dielli i shndritshëm se tërësia e universit dhe çfarëdo që është në të janë veçse veprat e fuqisë absolute, e njohjes së pafundme dhe të dëshirës së parapërdjetshme të Krijuesit.

Pyetje: Si mund të vërtetohen sistemi, harmonia dhe rregullsia?

Përgjigjja: Shkencat funksionojnë sikur shqiset e njeriut dhe si “spiunat” që kanë zbuluar rregullin nëpërmjet deduksionit dhe induksionit. Sepse çdo degë e shkencave mbështetet ose studion njërën

²⁰⁹Kur’an, 6:91

prej specieve ose ndarjeve të ekzistencës. Është në këtë sistem, harmoni dhe rregullsi që parimet universale burojnë, shfaqen. Çdo degë e shkencës përfshin parimet dhe rregullat universale që dominojnë në tërësinë e specieve që ajo studion. Universaliteti dhe njëtrajtësia e atyre parimeve tregojnë madhësitë e rregullit, sepse aty ku nuk ka rregull është e pamundur të nxirren rregullat e përgjithshëm. Njeriu mund ta zbulojë atë rregull nëpërmjet spiunave të tij të shkencës dhe ai sheh përsëri nëpërmjet atyre shkencave e ai njeri më i madh –universi– është aq i rregullt si vetja e vet –njeriu më i vogël. Ka urtësi në çdo gjë; asgjë nuk është paqëllim e as e lënë në tekat e veta.

Kjo prova jonë, domethënë libri i krijimit me të gjithë sistemet e tij, me të gjitha botërat e tij të qënieve të gjalla, me të gjitha grimcat e tij shpall Unitetin Hyjnor; të gjithë së bashku ato deklarojnë: La ilahe il–lall–llah, nuk ka zot tjetër përveç Allahut.

Prova e tretë: Ajo është Kurani i Gjithurtë. Kur ti i vë veshin kësaj prove folëse, ti do ta dëgjosh atë të përsërisë: La i lahe il –la Huve, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Kjo prova jonë është si një pemë e madhe, degët dhe degëzimet e së cilës varen poshtë me frutat e shndritshme të panumërt të të vërtetës dhe realitetit. Meqenëse një pemë me shumë fruta të gjallë nuk mund të jetë rritur prej një fare ose bërthame të kalbur, askush nuk mund të dyshojë se ajo bërthamë e kësaj peme që është Uniteti Hyjnor është e fortë dhe e gjallë.

Dega e kësaj peme duke u shtrirë në botërat e dukshme materiale mban frutat e urdhëresave dhe rregullave më të fuqishëm realë, ndërsa tjetra e saj, dega e madhe që shtrihet tek bota e të padukshmes është ngarkuar me fruta të pjekur e realë të lëshuara prej Unitetit Hyjnor dhe besimit në të Padukshmen.

Në qoftë se kjo provë gjithëpërfshirëse studiohet nga ata afër me të gjitha aspektet e saj, sigurisht do të pranohej se ai i cili e komunikoi atë ishte absolutisht i sigurtë për rezultatin e saj, që është Uniteti Hyjnor, dhe nuk ndjeu asnjë ngurim rreth të vërtetës së saj. Ai i bazoi të gjitha pretendimet e tjera të tij mbi këtë rezultat të qëndrueshëm dhe e bëri atë një kriter për të gjykuar çfarëdo që ekziston në univers. Një bazë e tillë e vendosur kaq fuqishëm dhe duke mbajtur një vulë të qartë mrekullie, nuk ka nevojë të bëjë diçka për t'u dukur e pretendime dhe është absolutisht e pavarur për t'u vërtetuar nga të tjerët. Çfarëdo që ai thotë e deklaroi dhe çfarëdo sihariqi që ai jep, janë të gjitha të vërteta.

Të gjashtë anët e kësaj prove të ndritshme janë të tejdukshme e të qarta. Ndodhet vula e mrekullisë së qartë mbi të; nën të janë logjika dhe argumenti; në anën e djathtë është pranimi i mendjes dhe në anën e majtë të saj është dëshmia e ndërgjegjies; para saj është e mira dhe lumturia në të dyja botët, dhe ajo mbështetet mbi shpalljen e pastër. A mund të guxojë dyshimi të hyjë në këtë kështjellë tepër të fortifikuar?

Ndodhen katër rrugë që të çojnë tek “froni” i plotësive, e cila është njohja e Zotit, e lartësuar qoftë madhështia e Tij.

E para është rruga –metoda– e sufizmit, e cila bazohet mbi pastrimin e nefsit dhe të ndriçimit shpirtëror.

E dyta është rruga e teologëve, të cilët për të provuar ekzistencën e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm, mbështeten tek argumenti se çdo gjë vjen në ekzistencë potencialisht, në kohë e hapësirë, ekzistenca ose mosekzistenca e saj janë njëlloj të mundshme, që do të thotë, ndodhet Një i Vetëm i Parapërdjetshëm i Cili preferon ekzistencën e gjithçkaje dhe i sjell ato në ekzistencë nëpërmjet dëshirës së Tij.

Të dyja këto rrugë janë deduktuar –nxjerrë– prej Kuranit. Por, ndjekësit e tyre i kanë ndërlikuar ato gjatë kohës dhe si rrjedhojë u kanë shkaktuar disa dyshimeve të depërtojnë në to.

E treta është rruga e filozofëve e ndotur me dyshime, me ngurrime dhe fantazi.

E katërta dhe më e mira është rruga e Kuranit të shenjtë, i cili e shfaq qartë “fronin” e plotësive me elokuencën e tij të mrekullueshme, me bukurinë e skajme të stilit, me qënien e tij i drejtëpërdrejtë dhe me gjithëpërfshirjen e tij. Ajo është më e drejtëpërdrejtë dhe më e shkurtëra e rrugëve që të çon tek Zoti dhe më gjithëpërfshirësja për qëniet njerëzore.

Ndodhen katër mjete për ta arritur atë “fron”: inspirimi, mësimi ose studimi, pastrimi dhe reflektimi.

Kurani ndjek dy rrugë që të çojnë për tek njohja e Zotit, qoftë Ai i lavdëruar, dhe për të provuar Unitetin e Tij.

E para është argumenti i të favorizuarit dhe i qëllimshmërisë. Të gjitha vërsetet e Kuranit të cilët përmendin përfitimet apo dobitë e

gjërave dhe urtësinë ose qëllimet për ekzistencën e tyre e thurin këtë argument dhe shërbejnë si paqsyre në të cilën ai reflektohet. Ky argument mund të përmblihet me sa vijon:

Të gjitha gjërat në univers janë bërë të qëndrueshme dhe artistikisht, dhe ndodhet një rregullsi e plotë në krijim. Kjo është për disa qëllime e dobi. Rregullsia në krijim dhe qëllimet dhe dobitë e dukshme në ekzistencën e të gjitha gjërave tregojnë se Krijuesi i Gjithurtë ka disa qëllime të urta për krijimin e tyre, dhe në mënyrë vendimtare hedhin poshtë rastësinë dhe koinçidencën. Sepse qëndrueshmëria dhe rregullsia shfaqin qartë ekzistencën e dëshirës dhe të qëllimit. Të gjitha shkencat duke studiuar krijimin, dëshmojnë për atë rregullsi dhe tregojnë dobitë dhe frutat e varura prej degëve të ekzistencës ashtu si vilet dhe zbulojnë shembujt e urtësisë dhe rezultatet e dobishme prapa ndryshimeve të ditëve, muajve dhe stinëve.

Në qoftë se pëlqen, vështro zoologjinë dhe botaniken. Ndodhen qindra e mijëra specie bimësh e kafshësh në botë. Ashtu si njerëzimi që e ka një paraardhës të parë origjinal –Ademin a.s– po ashtu çdo specie e ka një origjinal të llojit të vet. Çdo anëtar i këtyre specieve është si një mekanizëm i mrekullueshëm e i mahnitshëm që huton mendjet. Do të ishte e pamundur dhe e pakonceptueshme që ligjet e imagjinuara me ekzistencë emërore dhe shkaqet natyrale injorante e të verbëra të jenë origjinat e atyre zinxhirëve të panumërt të qënieve. Çdo specie dhe çdo anëtar i species shpall se ato burojnë drejtëpërdrejtë nga Dora e Fuqisë së Urtë Hyjnore.

Kurani i shenjtë na e mëson neve këtë argument në thënien Hyjnore: *“Kthe pra shikimin përsëri, A mund të shohësh ndonjë të çarë?”*²¹⁰ Ai e shpjegon këtë argument në mënyrën më të përsosur e më të bukur. Duke na urdhëruar neve të reflektojmë mbi krijesat dhe duke përmendur dobitë dhe përfitimet e tyre si mirësi Hyjnore, Kurani kërkon të vërtetohet ky argument e të ngulitet në mendje dhe pastaj e thërret arsyen t’i shqyrtojë ato në konkluzionet dhe ndarjet e vërseteve. Ai ndriçon rolin e arsyes dhe lëviz e trazon ndërjegjjen në konkluzione të tilla si: *“A nuk e dinë ata...? a nuk do të reflektojnë ata dhe a nuk do të nxjerrin mësim...?” Prandaj, nxirrni mësim!*

²¹⁰Kur’an, 67:3

Argumenti i dytë i Kuranit: Është argumenti i shpikjes, i cili mund të përmblihet siç vijon:

Allahu i Gjithëfuqishëm i ka dhënë çdo specie dhe çdo anëtar i të çdo specie ekzistencë të veçantë për detyrat që ajo do të përmbushë dhe për plotësitë që ajo do t'i arrijë. Nuk ka ndonjë specie që vjen prej parapërjetësie, sepse çdo gjë, çdo specie ka një filim, dhe nuk ndodhet gjë e specie, ekzistenca e të cilës është absolutisht e domosdoshme. Çdo gjë vjen në ekzistencë me dëshirën dhe preferencën e Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm dhe për atë gjë është njëlloj e mundshme për të ardhur në ekzistencë ose jo. Kjo është një e vërtetë e pamohueshme e cila nuk mund të ndryshohet. Evolucioni gjithashtu është i pamundur, sepse shndërrimet mund të ndodhin vetëm brenda një specie dhe nuk ndodhen specie të ndërmjetme. Në qoftë se njëherë u transformuan speciet në të tjera nga Allahu për ndëshkim, ato nuk mbijetuan. Ajo që ata e quajnë materie është e ndryshueshme dhe e varur nga koha e hapësira, dhe si rrjedhojë ajo ka një fillim. Forcat dhe format janë aksidentale dhe nuk mund të jenë origjina dhe ndryshueshmëria –larmia– e esencave dhe e substancave të specieve. Diçka aksidentale nuk mund të jetë esencë apo substancë. E gjithë kjo të çon tek konkluzioni se substancat e të gjitha specieve me të gjitha atributet e tyre të dallueshme e të larmishme u krijuan nga mosekzistenca. Ngjizja ose riprodhimi është vetëm një kusht i mëvonshëm për vazhdimësi.

Sa e çuditshme është që mendjet e të çudhëzuarve të cilët nuk e pranojnë parapërjetësinë e Krijuesit të Gjithëlavdishëm, megjithëse ajo është njëra prej Attributeve të Tij të domosdoshme, të mund t'i atribuojnë parapërjetësinë materies, e cila në mënyrë të qartë e të dukshme përfshihet në kohë e hapësirë. Pastaj, si e gjetën grimcat e vockëla fuqinë dhe qëndrueshmërinë saqë t'u bëjnë rezistencë urdhërave të Fuqisë Hyjnore dhe të qëndrojnë të përjetshme, ndërkohë që universi me të gjithë madhësinë e tij përkulet me nënshtrim e nderim daj atyre urdhërave? Gjithashtu, si mundet shpikja dhe sjellja në ekzistencë, të cilat janë midis Attributeve të Fuqisë Hyjnore, t'u atribuohen më të pafuqishmeve dhe më të dobtave të gjërave, të cilat janë shkaqet natyrale?

Kurani i shenjtë e vërteton dhe e ngulit këtë argument në vërsitet e tij duke përmendur krijimin dhe shpikjen, dhe konfirmon se askush dhe

asgjë, përveç Allahut të Vetëm, nuk ka fuqi krijuese. Shkaqet funksionojnë vetëm si perde përpara Fuqisë Hyjnore dhe Madhësisë së Saj me qëllim që ta pengojnë mendjen prej nxjerrjes së konkluzioneve të gabuara rreth Qënies së Shenjtë Hyjnore duke e vështruar me një shikim sipërfaqësor Dorën e Fuqisë së Tij të përfshirë në çështjet e ulëta.

Çdo gjë ka dy aspekte;

Njëri është aspekti i saj i jashtëm. Ai është si fytyra e zezë dhe e dendur e një pasqyre. Në këtë aspekt të gjërave, të kundërtat, e vogëla dhe e madhja, e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara, dhe të tjerat, ekzistojnë krah për krah. Roli i shkaqeve lidhur me këtë aspekt është shfaqja e madhësisë dhe e Dinjitetit të Zotit Fuqiplotë.

Tjetri është aspekti shpirtëror i brendshëm. Ai është si fytyra e tejdukshme dhe e shndritshme e pasqyrës. Ky aspekt është i pastër dhe absolutisht i bukur, ashtu siç kërkohet nga Uniteti Hyjnor, shkaqet nuk kanë asnjë rol në të. Meqenëse gjërat si jeta, shpirti, drita dhe ekzistenca janë krijuar drejtëpërdrejtë nga Dora e Fuqisë pa ndërmjetësinë e shkaqeve, ato janë të bukura për sa ka të bëjë edhe me aspektet e tyre të jashtme, edhe me aspektet e tyre të brendshme.

Prova e katërt: Është ndërgjegjia e njeriut e quajtur natyra e vetëdijshme.

E para, cilësitë natyrale ose të bashkëlindura të gjërave nuk gënjejnë. Një bërthamë ka një prirje për t'u rritur sikur të thonte: "Në qoftë se unë mbillem, unë do të rritem e do të jap fruta". Ajo thotë të vërtetën. Një vezë ka një prirje drejt jetës sikur të thonte: "Unë do të bëhem një zog", dhe ajo bëhet kështu me lejen e Zotit. Kur një grusht uji me prirjen e zgjerimit mbi ngrirje thotë: "Unë do të mbuloj një hapësirë më të gjërë", pavarësisht ashpërsisë dhe fortësisë, madje edhe hekuri nuk mund t'i rezistojë atij. Të gjitha ato prirje të tilla si këto janë manifestime të urdhërave të krijimit që vijnë prej Dëshirës Hyjnore.

E dyta, shqiset e njeriut nuk kufizohen tek pesë shqiset e njohura. Ai ka shumë 'dritare' të hapura ndaj botës së padukshme. Ai gjithashtu ka shumë shqise të tjera për natyrën e të cilave ai është i vetëdijshëm ose i pavetëdijshëm. Për shembull, shtytja dhe nxitja janë vetëm dy nga shqiset e tij të tjera të cilat nuk gënjejnë.

E treta, do të ishte e pamundur për diçka të imagjinuar ose thjesht prej një ekzistence emërore të jetë origjina e ekzistencës së dukshme të jashtme. Pika e mbështetjes dhe pika e kërkimit ndihmë, domosdoshmërinë e të cilave njeriu e ndjen në vetvete, janë dy aspekte esenciale të ndërgjegjjes së tij ose të natyrës së vetëdijshme. Njeriu është i nderuar në krijim me një shpirt esencialisht të pastër. Pa këto dy pika ai do të zvogëlohet duke rënë tek më e ulëta e ultësirave. Qënia e njeriut pa to është gjithashtu i papajtueshëm me urtësinë, rregullin dhe me plotësinë në krijim.

E katërta, madje edhe në qoftë se arsyeja neglizhon të funksionojë siç duhet dhe ta shohë të vërtetën siç duhet, ndërgjegjja nuk e harron Krijuesin. Edhe në qoftë se nefsi i njeriut e mohon Atë, ndërgjegjja e sheh Atë, reflekton mbi Të dhe kthehet drejt Tij. Perceptimi intuitiv gjithmonë e nxit, e lëviz, ndërsa inspirimi e ndriçon atë. Dashuria për Zotin gjithnjë e nxit ndërgjegjjen për njohjen rreth Allahut Fuqplotë. Kjo dashuri e cila shtohet nga mallëngjimi për Të, e cila me rradhë buron prej dëshirës së shtuar që vjen prej prirjes së shtuar është e bashkëlindur në ndërgjegjje. Tërheqja ndaj Tij e rrënjosur në ndërgjegjjen e njeriut është për shkak të ekzistencës së të Vetmit i Cili realisht tërheq.

Pas këtyre shënimeve paraprake, vështroje ndërgjegjjen dhe shiko se si ajo është një provë që është lënë amanet në nefsin e çdo njeriu, duke shpallur Unitetin Hyjnor. Gjithashtu, ti do të shohësh se zemra e njeriut ashtu siç përhap jetë në të gjitha pjesët e trupit, burimi i jetës shpirtërore në të, e cila është njohja rreth Allahut, nxit energjitë dhe gjallëron ambiciet e njeriut dhe prirjet e tij të përfshira në të gjitha aftësitë e tij dhe në potencialet e pakufishme. Ajo zbraz mbi to kënaqësinë dhe gëzimin dhe rrit vlerën e tyre. Ajo gjithashtu i zgjeron, i zhvillon dhe i mpreh ato. Kjo është pika e kërkimit ndihmë.

Njohja e Zotit është një pikë mbështetje për njeriun përballë tronditjeve të jetës dhe të ardhjes së fatkeqësive. Sepse njeriu, në qoftë se nuk beson në Krijuesin e Gjithurtë, në çdo akt të të Cilit ndodhet rregullsia dhe urtësia, dhe në vend të kësaj ia atribuon gjërat dhe ngjarjet rastësive të verbëra, duke u mbështetur mbi atë që nuk ka fuqi për t'u rezistuar fatkeqësive, ai do të dridhej me frikë përballë fatkeqësive dhe jetës në një gjendje të skëtërrshme. Njeriu nuk është një qenie për të rënë në një gjendje të tillë të mjeruar, sepse ai është i

nderuar në krijim me një potencial për të arritur të gjitha llojet e plotësive. Kjo do të ishte në kundërshtim me rregullin e përkryer e dominues në univers. Sepse dy pikat e lartëpërmendura, pika e kërkimit ndihmë dhe pika e mbështetjes janë të domosdoshme për shpirtin e njeriut. Krijuesi Gjithëbujar përhap dritën e njohjes së Tij në ndërgjegjjen e çdo njeriu nëpërmjet këtyre dy dritareve. Madje, edhe në qoftë se sytë e arsyes mund të bëhen të verbër, sytë e ndërgjegjjes janë gjithmonë të hapur.

Dëshmia e të gjitha këtyre katër argumenteve gjithëpërfshirës tregojnë për faktin se Krijuesi i Gjithëlavdishëm është Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm, Një, Unik, i Kërkuari përjetësisht, i Gjithëditur, i Gjithëfuqishëm, Gjithëdëshirues, Gjithëdëgjues, Gjithëshikues, Ligjërues, i Gjalli i Përjetshëm, Vetëkzituesi i Përherëshëm; Ai gjithashtu cilësohet me të gjitha Atributet e madhështisë dhe të bukurisë. Sepse çfarëdo që e kanë të gjitha krijesat në emrin e plotësisë, ajo vjen prej hijes së manifestimit të plotësisë së Krijuesit të Gjithëlavdishëm. Sigurisht, bukuria, hijeshia dhe plotësia e të Gjithëlavdishmit janë pafundësisht më të mëdhaja se sa përmbledhja e bukurisë, e hijeshisë dhe e plotësisë së ndarë nga tërësia e krijimit. Gjithashtu, Krijuesi i Gjithëlavdishëm është i lirë prej të gjitha mangësive e defekteve, sepse mangësitë burojnë prej pamjaftueshmërisë së kapaciteteve të bashkëlindura të qënieve natyrale. I Gjithëlavdishmi i Vetëm është absolutisht i lirë prej lëndësisë dhe i përjashtuar prej cilësive të domosdoshme për natyrën e të krijuarve.

“Asgjë nuk i përngjet Atij dhe Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi”²¹¹

Lavdia qoftë për Atë, i Cili mbahet i mbuluar për shkak të intensitetit të manifestimit të Tij! Lavdia qoftë për Atë, i Cili fshihet për shkak të mungesës së të kundërtit të Tij! Lavdia qoftë për Atë, i Cili maskohet nga shkaqet natyrale për shkak të Dinjitetit të Tij!

Pyetje: Cili është mendimi yt rreth shikimit të Unitetit të Qënies?

Përgjigja: Ajo vjen prej zhytjes në Unitetin Hyjnor. Uniteti Hyjnor përjetohet thellë nga ana e brendshme dhe nuk kufizohet për teorinë e mendimin. Thellësia e zhytjes në Unitetin Hyjnor, duke

²¹¹Kur'an, 42:11

ndjekur besimin në Unitetin e Allahut si Zoti dhe Perëndi, rezulton në besimin në unitetin e fuqisë, domethënë të besuarit se nuk ka asnjë tjetër përveç Allahut që të ketë efekte krijuese. Besimi në Unitetin e fuqisë rezulton në besimin në unitetin e mbisundimit dhe dominimit, të cilët me rradhë përfundojnë në shikimin e asaj që dëshmohet si e bashkuar, në Unitetin e të Dëshmuarit dhe përfundimisht në Unitetin e Qënies. Kjo çon tek shikimi i ekzistencës si një ose si e bashkuar dhe pastaj duke e parë atë çfarë ekziston si të bashkuar.

Thëniet e disa dijetarëve sufi të shprehura në dallditë e kënaqësive shpirtërore, të cilat kalojnë përtej asaj që është realisht e synuar, nuk duhet të merren si prova për të vërtetën e kësaj rruge. Në qoftë se dikush që nuk ka qenë në gjendje ta shpëtojë vetveten prej sferës së shkakut dhe pasojës, i cili e organizon jetën e tij duke marë parasysh ligjin e shkakësisë, flet rreth Unitetit të Qënies së përfshirë prej realiteteve të krijuara, ai kalon përtej limiteve të tij për në ekstrem. Ata që realisht e përjetojnë dhe flasin rreth Unitetit të Qënies e kufizojnë vetveten tek Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm në veçim prej të krijuarës dhe e shohin Allahun si Qënien e Vetme ekzistuese.

Shikimi i rezultatit së bashku me ose të përfshirë në dashurinë që të çon tek Ai, domethënë tek shikimi i Autorit të Gjithëlavdishëm si Qënia e Vetme ekzistuese, në harresë të plotë të krijesës, vjen prej zhytjes së shikimit dhe përjetimit të Qënies Hyjnore. Ai është rezultati i shikimit ose i perceptimit të manifestimeve Hyjnore në kanalet e ekzistencës dhe në rrjedhën e shkëlqimeve Hyjnore në dimensionin e brendshëm të gjërave, dhe i manifestimit të Emrave dhe Attributeve Hyjnore në pasqyrat e krijesave.

Këndvështrimi im presonal për Unitetin e Qënies është sa vijon:

Një perceptim i tillë i përket eksperiencës së brendshme dhe të përjetuarit. Por, për shkak të mungesës së fjalëve më të duhura e më me vend për ta shprehur besimin e tyre, ose për shkak të mungesës së eksperiencës së brendshme, ata të cilët e ndjekin këtë rrugë, rrugën e besimit në Unitetin e Qënies, e interpretojnë atë si Hyjni depërtuese dhe jetë përshkuese në krijesa. Kurse, filozofët ose ata të cilët përpiqen të gjejnë vetveten me mendjet e me ndjenjat e tyre, e kanë bërë këtë rrugë të eksperiencës së brendshme një temë diskutimi filozofik ose thjesht intelektual dhe si rrjedhojë një burim nocionesh të rreme.

Përveç sufive dhe filozofëve muslimanë dhe mendimtarëve të cilët flasin rreth Unitetit të Qënies, ndodhen filozofët materialistë e panteistë të cilët besojnë në Unitetin e Qënies. Por, ajo çfarë synojnë sufritë dhe filozofët panteistë me Unitetin e Qënies janë absolutisht kontradiktore me njëra-tjetrën. Ndodhen pesë diferenca –ndryshime– domethënëse midis tyre:

E para, është se dijetarët sufi e kufizojnë shikimin vetëm tek Ekzistuesi i Vetëm i Domosdoshëm dhe janë zhytur në reflektimin për Të me të gjithë fuqinë e tyre deri në shkallën që ata nuk e pranojnë ekzistencën e universit. Sipas tyre, është vetëm Ekzistuesi i Vetëm i Cili mund të shikohet si ekzistues real. Ekzistenca e të gjithë të tjerëve është e rreme. Ndërsa, filozofët materialistë dhe ata me besim të dobët përqëndrohen mbi materien dhe u larguan prej perceptimit Hyjnor. Ata i japin përparësi materies në ekzistencë dhe nuk shohin asgjë tjetër të ekzistojë përveç materies dhe gjërave materiale. Ose, meqenëse ata vazhdojnë të mbyten në çudhëzim, ata e shohin Hyjninë si të përfshirë ose të mishëruar nga materia, ose preferojnë të qëndrojnë indiferent ndaj Hyjnisë për shkak të përkufizimit të shikimit të tyre tek universi.

Diferenca e dytë, është se sufritë të cilët besojnë në Unitetin e Qënies e shohin universin si diçka të dëshmuar ose vetëm të përjetuar. Por, të tjerët e shikojnë universin si realisht ekzistues dhe besojnë në unitetin e asaj që ekziston materialisht.

Diferenca e tretë, rruga e evlijave sufi është një rrugë që i përket eksperiencës së brendshme, ndërsa të tjerët ndjekin thjesht një rrugë racionale të logjikshme.

Diferenca e katërt, evlijatë sufi janë zhytur në të Vërtetin e Gjithëlavdishëm dhe e shohin universin nga këndvështrimi i Hyjnisë. Ndërsa, të tjerët janë zhytur në krijesa dhe reflektojnë mbi to për hir të tyre dhe prej brenda asaj zhytje.

Diferenca e pestë, evlijatë sufi e adhurojnë Allahun dhe e duan Atë thellë, ndërsa të tjerët adhurojnë vetet e tyre dhe ndjekin kapriçot e tyre. Rruga e sufive është aq larg prej asaj të filozofëve materialistë, aq sa toka prej qiellit më të largët, dhe aq e ndryshme prej saj, aq sa ç'është drita e shndritshme prej errësirës së dendur.

Një shënim për ndriçim të mëtejshëm

Nëse do të supozohej, për shembull, që toka të ishte formuar prej copëzave të vogëla të qelqit të ngjyrave të ndryshme, secila prej atyre copave do të merrte dritë prej diellit dhe do ta reflektonte atë në përputhje me masën e saj, me trajtën dhe me ngjyrën. Ndonëse ajo çfarë do të merrte e reflektonte çdo copë qelqi nuk është as dielli dhe as pikërisht drita e tij, në qoftë se çdo copë do të fliste, ajo do të thonte: “Unë jam një diell”.

E ngjashme me këtë, në qoftë se ngjyrat e atyre luleve buzëqeshëse dhe të ndritshme do të flisnin, ndonëse ato janë manifestimet e shtatë ngjyrave në dritën e diellit, secila do të thonte: “Dielli më përngjet mua”, ose “Dielli më përket vetëm mua”.

*Ato iluzione janë gracka për evlijatë, ndërsa në realitet ato janë reflektimet e fytirave të ndritura në kopështin e Allahut.*²¹²

Rruga e atyre të cilët besojnë në Unitetin e të Dëshmuarit ose të të përjetuarit në emrin e ekzistencës është rruga e kthjelltësisë, e zgjimit dhe e dallimit.

*Mendo rreth mirësive dhe bekimeve të Zotit. Mos mendo rreth Esencës së Allahut sepse ti je i paaftë ta bësh atë.*²¹³

Realitetin e njeriut, njeriu nuk është në gjendje ta perceptojë, atëherë si do të mund ta perceptonte ai se si është Mposhtësi i Parapërvjetshëm?

*Ai është Ai i Cili i ka krijuar qiejt dhe i ka ndërtuar ato, atëherë si do të mundej dikush që është një frymë e krijuar ta perceptojë Atë?*²¹⁴

Said Nursi

²¹²Meulana Xhalal Al Din Al Rumi, volumi 1, faqja 3

²¹³Transmetoi Bejhakiu.

²¹⁴Imam Aliu.

■ Trajtesa e Trembëdhjetë

Një dritë prej dritave të yjeve të Kuranit

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

"...Dhe prej Tij ne kërkojmë ndihmë. Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, i Cil na udhëzoi ne për këtë vend. Kurrë nuk do të kishim gjetur drejtim po të mos na kishte udhëhequr Allahu. Vërtet që të dërguarit e Zotit tonë erdhën me të vërtetën..."²¹⁵

Paqja dhe bekimet qofshin mbi argumentin e të Vërtetit për krijimin, mbretin e profetëve, provën e dijetarëve të pastër dhe të dashurin e Zotit të të gjitha botëve, dhe mbi familjen e tij dhe mbi të gjithë sahabët e tij.

Mësoje, o shok! Çfarëdo që të ishte, një fushë apo një mal, luginë apo shkretëtirë, një det apo një copë tokë, ajo mban stampa të ndryshme të Një të Vetmi, të Kërkuarit përjetësisht. Një mal, për shembull, shfaq se ai është një pronë e të Gjithëlavdishmit të Vetëm me të gjitha krijesat që banojnë në të, të tilla si kafshët e shumë specieve dhe pemët e shumë llojeve, të cilat janë gjithashtu pronat e të Gjithëlavdishmit. Përsëri, ai mal shfaq se është gjithashtu një krijesë e të Gjithëfuqishmit, siç dëshmohet prej stampave të ndritshme mbi të, të tilla si llojet e ndryshme të bimëve dhe specieve të zogjve. Ai gjithashtu shfaq se ai është njëra prej mesazheve të Tij, e lartësuar qoftë madhështia e Tij, siç dëshmohet nga vulat e të Gjithëlavdishmit të vendosura në të gjitha qoshtet e tij, të tilla si lulet e stolisura dhe frutat e bukur. Kur ti e di se, për shembull, një dru palme dhe një bletë janë pronë dhe krijesa të të Gjithëlavdishmit, ti do të kuptoje se të gjitha palmat dhe bletët janë gjithashtu prona e Tij.

²¹⁵Kur'an, 7:43

Ajo që shfaq se stampat dhe vulat gjithandej tokës i përkasin Një Monarku të Vetëm dhe Pronarit dhe të Kërkuarit përjetësisht, është se të gjitha llojet e gjërave gjenden pothuajse gjithandej botës në të njëjtin moment. Njëjtësia në ekzistencë, shpikja, forma, blerja dhe koha shfaqin dukshëm se Autori i të gjitha atyre gjërave është Një dhe i Vetëm për të Cilin bërja ose thënia e një gjëje nuk mund ta pengojë nga bërja ose thënia e diçkaje tjetër, as dëgjimi dhe plotësimi i një nevoje nuk mund ta ngatërrojë Atë dhe as ta pengojnë prej bërjes ose thënies së diçkaje tjetër, e lartësuar qoftë madhështia e Tij.

Mësoje, o shok! Në qoftë se dëshiron të më dëgjosh mua rreth mrekullisë së Kuranit ashtu siç ai vërshon tek unë prej oqeanit të Kuranit, dëgjo sa vijon, të cilën në fakt unë ia adresoj vetes time:

O Said i pakujdesshëm për vetveten dhe madje edhe për pakujdesinë tënde! Pakujdesia, mosmirënjohja dhe mosbesimi burojnë nga konceptet ose nocionet e pabaza. Sepse kur ti sheh diçka, sidomos një gjallesë, dhe bie në pakujdesi për shkak se nuk ia atribuon atë të Gjithëlavdishmit, domethënë Zotit të Vetëm, atëherë ti do të duhej të pranoje pamundësitë duke ua atribuuar hyjninë të gjitha grimcave dhe pjesëve përbërëse të dheut, ajrit dhe ujit. Ti do të duhej të pranoje aq shumë perëndi, aq sa manifestimet e Zotit. Sepse ti e di se çdo grimcë e dheut shërben për rritjen e të gjitha llojeve të bimëve, pemëve, luleve dhe frutave. Në qoftë se do të doje të arrije siguri më të madhe, vendos një sasi të mjaftueshme dheu në një vazo. Në qoftë se ti mbjell në të farën e një druri fiku, ti do të kesh një pemë që prodhon fiq; në qoftë se ti mbjell një bërthamë shege apo molle, ti do të kesh një pemë që prodhon shega ose molla, dhe kështu me rradhë. Ti e di se çfarë diferencash të mëdhaja ndodhen midis atyre pemëve frutdhënëse. Në qoftë se mekanizmi i kaderit operues në bërthamën e drurit të fikut është si, le ta themi, një fabrikë sheqeri, makineria e fuqisë që punon në bërthamën e pemës së shegës mund të jetë si një fabrikë tekstilësh;

Pastaj, në vendet e pemëve frutdhënëse, mbill në vazoon tënde bërthamat e të gjitha llojeve të luleve njëra pas tjetrës; atëherë ti do të kesh lule në vend të pemëve frutdhënëse.

Në qoftë se pronari i vazos, pakujdesia jote të çon ty të ndjekësh rrugën e materialistëve, atëherë ty do të të duhej të pranoje ekzistencën në vazoon tënde të aq shumë fabrikave aq sa numri i pemëve frutdhënëse në botë për t'i bërë të gjitha pjesët e pemëve pafundësisht të ndryshme

prej rrënjëve tek frutat, dhe të aq shumë mekanizmave, aq sa numri i luleve. Grimcat e dheut duhej gjithashtu të kishin aq shumë njohje e fuqi sa të rrisin çdo pemë e lule dhe të kishin kapacitet të domosdoshëm për t'i dalluar ato. Në qoftë se ti ua atribuon ekzistencën e pemëve dhe luleve natyrës, këtë herë ty do të të duhej të pranoje që natyra të kishte makina shtypi të panumërta në çdo grimcë të dheut. Farërat ose bërthamat janë gjërat materiale pothuajse të të njëjtës strukturë dhe përmbajtje, dhe duke u përngjasuar njëra-tjetrës në formë e trajtë. Kështu, farërat ose bërthamat duke u rritur secila në një pemë ose lule të ndryshme është si pambuku i pak gramëve prej të cilit thuren dengje mëndafshi, atllasi, dylisi, leshi etj. Vërsete të tilla si, “*Ai ju krijoi ju nga një (shpirt) njeri i vetëm...*” dhe “*Dhe Allahu krijoi çdo gjallesë nga uji*”²¹⁶ tregojnë për faktin se substanca prej të cilës ju u krijuat, kur ajo ishte diçka e thjeshtë dhe jo e përbërë apo pjesë përbërëse si ti, nuk mund të jetë origjina jote. Kurse shpikja e farërave ose e bërthamave, çdonjëra prej të cilave, pavarësisht thjeshtësisë së saj, është si një plan i bërë nga kaderi, dhe pavarësisht masës së saj të vogël, si një origjinë apo bërthamë duke përmbajtur të gjitha parimet e ekzistencës së pemës ose lules për t’u rritur prej saj, shpikja e saj me një përbërje që përfshin të gjitha detajet e pemës ose të lules për t’u rritur prej saj aq larg deri tek majat e degëzave ose petaleve, është dëshira më e qartë që Krijuesi i saj nuk mund të jetë tjetër përveç të Vetmit i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën, dhe në lidhje me fuqinë e të Cilit grimcat e vockëla dhe diejt e mëdhenj janë të barabartë.

Në qoftë se pakujdesia jote buron prej materializmit, atëherë ty do të të duhej të pranoje se në vazon tënde ndodhet një fuqi inteligjente e mahnitshme që është e aftë të bëjë e të formojë të gjitha llojet e pemëve frutdhënëse dhe luleve, dhe një njohje gjithëpërfshirëse që të përfshijë të gjitha tiparet dhe veçoritë deri tek detajet më të holla. Gjithashtu, duhej të ndodhej një dëshirë me njohje e të gjitha parimeve dhe domosdoshmërive të ekzistencës së tyre. Përsëri, vazoja duhet të kishte kapacitetin për të formuar funksionet e Emrave të tjerë Hyjnorë të të Vetmit, i Cili “*Do t’i mbështjellë qiejt si letër e shkruar (tub për shkrim)...*”,²¹⁷ i Cili e mban tokën në Dorën e Tij duke e drejtuar si të dëshirojë.. gjithashtu, zemra e njeriut është midis dy gishtërinjve të Tij dhe e kthen atë si të dëshirojë; dhe për të Cilin diçka e madhe ose

²¹⁶Kur’an, 24:45

²¹⁷Kur’an, 21:104

domethënëse nuk mund ta pengojë prej qënies i preokupuar me atë çfarë është e vogël ose e papërfillshme. Ai e shfaq dritën e Fuqisë së Tij mbi Fronin më të lartë, mbi diellin dhe mbi grimcat me të njëjtën lehtësi, ashtu si dielli që reflektohet si në sipërfaqen e një oqeani dhe në një pasqyrë, dhe në pikat ose flluskat e ujit me të njëjtën lehtësi, të gjitha në të njëjtën kohë dhe me të njëjtën shtrirje të rrezatimit sipas kapacitetit të gjërave për ta marrë atë.

Kjo vëzhgohet veçanërisht në pranverë, kur llojet e panumërta të luleve, bimëve, pemëve dalin papritmas të gjitha në të njëjtën kohë me bollëk të skajmë dhe me lehtësi e qëndrueshmëri absolute. Ti mund ta bësh të njëjtin eksperiment disa herë më shumë, duke e zbrazur vazon tënde dhe duke e rimbushur atë prej vendeve të ndryshme. Është e sigurtë se ti gjithmonë do të arrish të njëjtin rezultat.

Çdo lule, çdo frut, çdo kafshë, çdo mikroorganizëm është si një pikë e formuar prej përbërësve të marrë prej të gjitha pjesëve të ekzistencës me masa të sakta e të holla dhe në përputhje me përllogaritje absolutisht të sakta. Asgjë dhe askush përveç Atij, i Cili mban tërësinë e ekzistencës në kapjen e Tij, duke e administruar atë si të dojë dhe e nxjerr këtë pikë prej ekzistencës me një masë të tillë dhe në përputhje me përllogaritje të tilla, saqë asgjë dhe askush përveç Atij, i Cili e bën çdo lule ose çdo frut, ose çdo kafshë një shembull të zvogëluar, një miniaturë, të tërësisë së ekzistencës kur Ai dëshiron të krijojë prej mosekzistencës, nuk mund ta krijojë atë pikë.

Ashtu siç do të bëhej e domosdoshme të pranoje ekzistencën e aq shumë diejve, aq sa objektet e tejdukshme të tilla si copat e xhamit, pikat e ujit, flluskat e oqeanit e të tjera të ngjashme me këto, kur imazhet e diellit nuk i atribuohen diellit të vetëm në qiell, po ashtu një mosbesimtar mosmirënjohës duhej të pranonte aq shumë perëndi, aq sa të gjitha grimcat e ekzistencës, ashtu siç u përmend tek trajtesa “Flluska” dhe “Pika”, ose aq sa manifestimet e Zotit, siç u diskutua në “Shtojcën” për “Rrezen”.

Në qoftë se ti i ke kuptuar çfarë i thashë unë nefsit tim, ti do të kesh kuptuar vetëm një rreze prej dritave të shpjegimeve të Kuranit të mrekullueshëm nga këndvështrimi i kuptimit të tij, sepse çështja që ne sapo e diskutuam është vetëm një pikë prej pikave të oqeanit të kuptimit të Kuranit.

Mësoje, o shok! Midis artifakteve të njerëzimit mund të ndodhen disa me vlerën e mijëra dollarëve për shkak të artit që ato përmbajnë, ndërsa materiali i tyre kushton veçse pesë dollar. E ngjashme me këtë, besimi është një elikzir duke ndryshuar substancën e përkohshme në një diamant të qëndrueshëm dhe të zbukuruar me gurë të çmuar duke e lidhur atë me Autorin e Qëndrueshëm përjetësisht. Në kontrast, mosbesimi e zvogëlon atë dhe e zbret deri tek shkalla e qymyrit i zbuluar para dekompozimit në tokë.

Njeriu është më i mahnitshmi midis artifakteve të Autorit të Parapërdjetshëm, *“I Cili i ka krijuar qiejt dhe tokën në gjashtë ditë”*²¹⁸ dhe e ka stolitur qiellin me yje dhe tokën me lule. Ai e krijoi njeriun prej balte si deltinë, i zbuluar para shpërbërjes së shpejtë; ai vlen shumë pak për sa ka të bëjë me përbërësit e tij. Por kur shikohet në lidhje me artin që ai përmban, vlera e tij rritet deri në shkallën më të madhe. Sepse ai është një pjesë poezie e kompozuar prej hollësive të manifestimeve të Emrave të bukur Hyjnorë. Ai është si një pasqyrë e shëndritshme për të reflektuar rrezet e Diellit të Parapërdjetshëm e të Paspërdjetshëm.

Besimi është një lidhje e cila e lidh njeriun me Pronarin e tij dhe zbulon artin Hyjnor për njeriun. Ai tërheq shikimin dhe kuptimin për tek fakti se njeriu është një artifakt i Allahut. Nëpërmjet kësaj lidhje, vlera e njeriut rritet deri tek shkalla që parajsa do të bëhet çmimi i saj. Përsëri, nëpërmjet besimit, njeriu ngrihet tek rangu i të qënit kalif i Zotit në tokë dhe duke mbajtur amanetin më të madh. Sa për mosbesimin, ai e pret këtë lidhje dhe i shkakton artit Hyjnor në njeriun të mbulohet. Si rrjedhojë, njeriu zvogëlohet deri tek vetëm substanca e tij materiale dhe e humbet të gjithë vlerën e tij deri tek shkalla që një jobsimtar dëshiron që ai të mos kishte ekzistuar kurrë ose që ai të bëhej pluhur.

Shkurtazi: Njeriu është si një makineri e pajisur me miliona prej instrumenteve të balancës e peshës për të peshuar e përjetuar përmbajtjet e Thesarit të Mëshirës Hyjnore dhe xhevahiret e Thesarit të Fshehur.²¹⁹ Është e tillë sa që vetëm në gjuhë janë vendosur aparate për

²¹⁸Kur’an, 7:54

²¹⁹Aludon për hadithin kudsî: “Unë isha një thesar i fshehur. Unë desha të njihem dhe krijova universin”. (Përkthyesi).

të peshuar e shijuar aq shumë varietete ushqimesh e mirësish, aq sa numri i ushqimeve, me qëllim që gjuha e njeriut të mund të shijojë hollësitë e mirësive të të Vërtetit. Kur kjo makineri përdoret në dritën e bekimit të besimit, ajo do të prodhojë fruta të ruajtur prej Atij të Vetmi i Cili kurrë nuk gabon e nuk harron.

Por, në qoftë se kjo makineri bie në dorën e mosbesimit, atëherë është sikur ajo makineri e çmueshme, e vlefshme dhe e pashoqe, do të kishte rënë në dorën e një njeriu të egër, të paqytetëruar, i cili nuk e njeh atë dhe e përdor thjesht në shërbim të zjarrit, si një vegël e zakonshme deri sa ta djegë.

O Ti që në Dorën Tënde janë dominimi dhe çelësat e të gjitha gjërave, që i kap të gjitha gjërat për balukesh –që i ke nën sundim– dhe që me Ty janë thesaret e të gjitha gjërave! Mos na lër neve të mbështetemi tek neftset tona. Ki mëshirë mbi ne dhe ndriçoji zemrat tona me dritën e besimit dhe të Kuranit.

“...Atëherë, le të mos ju gënjejë kjo jetë e dynjasë, as të mos ju mashtrrojë i pari i mashtruesve (shejtani) për Allahun”²²⁰

Mësoje, o i dehur, i shturur, i shkujdesur dhe i çudhëzuar! Ti je i mbytur në moçalin e dynjasë dhe dëshiron t’i bësh njerëzit të humbasin nëpërmjet paraqitjes së atij moçali si burim lumturie me qëllim që të ngushëllosh veten tënde. Në qoftë se je në gjendje ta ndryshosh natyrën e katër realiteteve vijuese, atëherë bëj çfarëdo që ti dëshiron:

Realiteti i parë është vdekja. Ti nuk mund ta ndryshosh atë dhe as ta largosh prej jetës. Ndërsa ajo është një ndryshim banesash në shikimin e besimtarit, në shikimin tënd është zhdukje e përejetshme .

Realiteti i dytë është pafuqia e brendaqenësishme e njeriut bashkë me nevojat e pakufishme dhe me armiqësitë. Ndërsa në të vërtetë, ky kusht e fton njeriun të mbështetet tek i Gjithëfuqishmi Absolut, ashtu siç i fton për tek Ai pafuqia, ti e bën atë një pafuqi absolute nëpërmjet mosbesimit pa asnjë mbështetje e pikë ndihme.

Realiteti i tretë është varfëria e bashkëlindur e njeriut. Ndërsa ajo është mjete për t’u orientuar drejt thesarit të të Pasurit Absolut dhe një

²²⁰Kur’an, 31:33

ftesë për tek Ai, ti e bën atë një skamje të dhimbshme duke ia shtuar zakonet e turpshme të civilizimit modern.

Realiteti i katërt është zhdukja ose përkohshmëria. Sepse zhdukja e kënaqësive është një dhimbje e përjetshme, prandaj nuk ka mirësi në kënaqësinë që nuk vazhdon. Ndërsa, në të vërtetë, zhdukja është një mjet për të arritur kënaqësi të përjetshme, ti e bën atë një zhdukje të dhimbshme duke lënë prapa veçse mëkate e brenga.

Ai i cili e pret vdekjen vazhdimisht, që është i rrethuar nga pafuqia, që është i sunduar nga varfëria dhe i cili është në një udhëtim të vazhdueshëm, ai mund të mashtrohet me sofistikat e tua vetëm në gjendjen e dehjes, dhe dehja nuk vazhdon për një kohë të gjatë. Ata që ata e quajnë lumturia e jetës konsiston në mjerim, dhe çfarë ata duan të thonë me lumturi mund të jetë e mundshme veçse me vrasjen e vdekjes ose me harrim të plotë të saj; dhe duke larguar pafuqinë ose mburrjen absolute; duke eliminuar varfërinë ose marrëzinë e plotë, dhe nëpërmjet përjetësisë së jetës ose ndalimit të rrotës së ekzistencës.

Allahu më zgjofte mua dhe ju prej gjumit të pakujdesisë, të cilin ju e pranoni si zgjim, ndonëse është pjesa më e thellë e gjumit, dhe na sjellte neve në vete duke na shëruar prej çmendurisë të cilën ti e imagjinon të jetë një ndriçim mendor.

Mësoje, o shok! Shiko se si Autori i Gjithëfuqishëm ka shpërndarë miliona botëra prej llojeve të kafshëve dhe bimëve në sipërfaqen e tokës. Çdo botë është si një det, pikat e të cilit janë ngarkuar me pastrimin. Për shembull, milingonat janë ngarkuar me pastrimin e sipërfaqes së tokës prej kërmave të disa kafshëve.

Gjithashtu, uji, ajri, drita dhe dheu, veçanërisht dëborat, janë si oqeane, çdo pikë prej të cilave është një detyrë e mishëruar. Këto botëra janë njëra brenda tjetrës, ndërsa Autori i Gjithëfuqishëm gjithashtu i bën ato të dallueshme nga njëra tjetra me veçoritë e veçanta të çdonjërit dhe me detyrat. Ai shfaq dallueshmëri të pafundme midis një përzierje të pafundme deri në atë shkallë që, për shembull, Ai e vendos botën e milingonave ose të mizave fluturake midis botërave të krijesave të tjera të gjalla nëpërmjet krijimit dhe bërjes së tyre të vdesin në një mënyrë të veçantë për to. Është sikur faqja e tokës të ishte vetëm shtëpia e tyre. Asnjë konfuzion nuk vëzhgohet në ardhjen e tyre në ekzistencë dhe në vdekjen e tyre. Meqenëse çdo botë e ekzistencave të

gjalla ekziston midis botërave të tjera, çdo anëtar individual i çdo specie gjithashtu rritet midis individëve të tjerë. Mbështetja, mbajtja e një bote në një botë, nuk e pengon Autorin prej mbajtjes së të tjerave, as rritja e një individi nuk e pengon Atë prej rritjes së të tjerëve.

O ti që i ke sytë e verbër për shkak të natyralizmit dhe që e ke zemrën të vulosur! Në qoftë se ti e supozon natyrën një botues dhe një autor, ndërsa në fakt ajo është diçka e shtypur dhe e bërë, atëherë ty do të të duhej të pranoje që në çdo pjesë dheu të gjendeshin makina të përsosura shtypi shumë më shumë në numër se sa tërësia e makinave shtypëse në botë.

Mësoje, o kafshë! Mos u mburr për qënien tënde një kafshë si diçka më e madhe se bimët, sepse arti në bimët nuk është më i ulët në shkallë se ai që ti përmban. A nuk e sheh se ndërsa pjesët e mishta të të gjitha specieve të kafshëve janë pothuajse prej të njëjtës përbërje e cilësi, kurse pjesët e tulta të llojeve të frutave janë të ndryshme nga njëra tjetra? Kjo shfaq se Pena e Fuqisë Hyjnore vepron më thellë e më hollë në to. Gjithashtu, ndërsa kafshët dhe qëniet njerëzore riprodhojnë mesatarisht shtatë, bimët riprodhojnë zakonisht shtatëdhjetë, ose shtatëqind, ose shtatë mijë. Por, për shkak të dobësisë së shqisave të tyre shtazore, peshqit janë një përjashtim për këtë. Riprodhimi i bollshëm shpreh shkallën e rëndësisë që u është bashkangjitur bimëve.

Përsëri, bimët dhe pemët janë mbështetur absolutisht tek Zoti xh.sh, dhe si rrjedhojë ushqimi i tyre u vjen atyre, po ashtu edhe ushqimi i të vegjëlve të tyre. Është sikur rrënjët e çdo bime e peme të lidheshin drejtëpërdrejtë tek thesari i Mëshirës, ndodhet një grykëderdhje nga Mëshira për tek ajo. Mëshira e ndan ushqimin e çdonjërës ndërsa ua jep “prindërve”; ajo u jep bijave të shëgës –frutave– sherbet të pastër dhe bijave të ullirit, për shembull, vaj të bekuar.

O kafshë mburracake nga vetvetja! Arsyeja përse bimët preferohen mbi ty në tre drejtimitet e përmendura, megjithëse ato janë më inferiore se ti, është egoja dhe sëmundja jote dhe se ti ke ca shkallë të vullnetit të lirë, fuqisë së zgjedhjes. Prandaj, nënshtroju Zotit dhe ji i shpëtuar.

“...Njeriu u krijua i dobët”²²¹

²²¹Kur’an, 4:28

O njeri! Mos u mburr ndaj kafshëve! Arsyeja përse ty të është dhënë superioritet mbi kafshët është dobësia jote dhe pafuqia, ashtu si një fëmijë i vogël që urdhëron prindërit e tij dhe vëllezërit e tij më të mëdhenj me forcën e pafuqisë së tij dhe me fuqinë e dobësisë së tij. A mund të shohësh ndonjë kafshë më të pafuqishme se ti në sigurimin e domosdoshmërive të jetës së saj? Një kafshë mund të fitojë për njëzet ditë, ose në njëzet orë, ose në njëzet minuta atë çfarë ti mund ta arrish në njëzet vite nëpërmjet studimit dhe eksperiencës për ruajtjen e jetës tënde. Ti mund të sigurosh me ndihmën e ndërsjellë në një komunitet atë çfarë një kafshë individuale e arrin vetë. Por, lidhur me plotësinë e arritur vetëm nëpërmjet Islamit dhe robërisë ndaj Zotit, një individ human mund të jetë i barabartë me një specie të kafshëve.

Ti dhe unë kemi dy alternativa: ne do të ishim ose më të ulët se sa më e ulëta e kafshëve dhe më të dobët e më të mjeruar se sa ato, ose më të nderuar dhe më të plotësuar se sa të gjitha speciet e tyre. Zgjidh cilëndo që të dëshirosh. Meqenëse është kështu, njihi pafuqinë dhe dobësinë tënde, dhe mësoje se forca dhe fuqia jote qëndrojnë në duanë dhe qarjen para Pronarit tënd.

Për sa ka të bëjë me arritjet e tua me të cilat ti krenohesh, ato janë veprat e inspirimit të Tij, e krijimit të Tij dhe e nderimit të Tij. Ai të ka bërë ty një model për të gjitha speciet ose llojet e krijesave me qëllim që Ai të shfaqë bukurinë e Tij të mrekullueshme dhe krijueshmërinë nëpërmjet teje dhe të të bëjë ty t'i shijosh të gjitha mirësitë e Tij.

Mësoje, o ti që ke dyshime rreth autenticitetit –saktësisë, vërtetësisë– së haditheve profetike rreth Mehdiut, afrimit të Orës së Fundit dhe trazirave të mëdhaja të parashikuara të ndodhin pas profetit a.s.m.. A kërkon ti bindje në të gjitha çështjet duke përfshirë madje edhe çështjet dytësore të cilat nuk lidhen me themelet e besimit. Ndërsa në disa çështje pranimi dhe mosrefuzimi janë të mjaftueshme; ato nuk kërkojnë besim të vërtetuar sa të të nevojitet prova e qartë.

A nuk e din ti se ashtu si pohimet alegorike të thella në Kuran të cilat kërkojnë interpretim, po ashtu hadithet alegorike të paqarta kërkojnë interpretim dhe koment? Kur ti has një rrëfenjë që i atribuohet profetit a.s.m, e cila të duket në kundërshtim me realitetin, merr parasysht shpjegimin e mëposhtëm:

Ajo mund të jetë midis atyre që janë të huazuar prej komenteve të Teuratit –Israilijjat– ose janë rrëfyer prej hebrenjve të konvertuar, rrëfenjat e të cilëve u menduan gabimisht se i përkasin profetit a.s.m, ose ajo do të ishte një shpjegim shtesë prej transmetuesit të një hadithi, shpjegim i cili më vonë u konsiderua se i përkiste vetë hadithit. Ose mund të jetë një deduksion prej hadithit nga transmetuesit, ose një thënie e një transmetuesi të inspiruar që gabimisht iu atribuuua profetit a.s.m, ose përsëri ajo mund të jetë njëra prej thënieve proverbiale që qarkullojnë midis njerëzve të cilat profeti a.s.m i shprehu në ndonjë rast për ndonjë qëllim të caktuar. Kështu, dikush që ndesh ndonjë rrëfenjë të tillë nuk duhet ta kufizojë vetveten tek kuptimi i tij i jashtëm, por ai duhet ta shqyrtojë atë dhe ose ta marrë atë si një thënie të shprehur për udhëzimin e njerëzve për tek e vërteta, ose ta interpretojë atë ashtu si një person në gjumë që interpreton në gjumin e tij atë çfarë sheh një person i zgjuar. Dhe ashtu siç e interpreton ti o i zgjuar atë çfarë pa ai në gjumë, po ashtu interpretoje o ti në gjumë –nëse mundesh– në pakujdesinë e kësaj jete atë që sheh i zgjuari, zemra e të cilit nuk fle dhe rreth të cilit Allahu thotë:

*“Shikimi i tij nuk u lëkund dhe as nuk e kaloi kufirin (e përcaktuar për të)”.*²²²

Gjithashtu, ka urtësi në qënien i panjohur exheli i një individi me qëllim që ai ta presë atë gjithmonë dhe që të përgatitet për Ahiretin e tij. Është e njëjta urtësi që e mban të fshehtë Orën e Fundit, e cila është vdekja e dynjasë me qëllim që ta presin atë bijtë e dynjasë... kjo është arsyeja pse njerëzit në çdo shekull prej epokës së lumturisë deri në të tashmen e kanë pritur atë. Që Ora e Fundit mbahet e fshehtë nuk ka të bëjë me rolin e profetit për të; ajo ka të bëjë me urtësinë e pritjes, e cila kërkon mospërcaktim –të mbahet e fshehtë– me qëllim që të largojë pakujdesinë.

Sa për ndryshimet në rrëfenja rreth Mehdiut, personi që është premtuar të vijë afër fundit të kohës për të zhdukur padrejtësinë dhe për të vendosur drejtësinë Islame gjithandej botes, arsyeja është e njëjta. Rrëfenjat rreth Mehdiut kanë ardhur në formë të paqartë dhe si rrjedhojë njerëzit në çdo shekull e kanë pritur atë. Kjo ka ndihmuar për të përforcuar moralin e tyre dhe për të larguar dëshpërimin e tyre në

²²²Kur'an, 53:17

çdo epokë kur çudhëzimi përhapet e fiton fuqi. Ajo gjithashtu i ka inkurajuar dijetarët muslimanë të cilët luftojnë për të rigjallëruar parimet Islamike dhe për t'i udhëzuar njerëzit për tek e vërteta në një mënyrë të parashikuar e të pritur prej Mehdiut, imamit të shquar të tyre.

Mësoje, o ti që je musliman vetëm në anën e jashtme e në emër! Në imitim të ndaj mosbesimtarëve, pavarësisht shthurjes së tyre, dhe në kundërshtimin të ndaj urdhëresave të Islamit, ti i ngjason një anëtari të një klani –fisi– i cili fillon ta shajë atë fis, ta përçmojë kryetarin e tij dhe të përbuzë zakonet e tij. Ai bën kështu për shkak se ai shikon dikë prej një fisi të ndryshëm e armiqësor, i cili është krenar për virtytet e tij. I mjeri mendon se duke e sharë fisin e tij dhe duke përçmuar zakonet e tij, ai do të bëhej disi i ngjashëm me tjetrin prej fisit armiqësor. Ai nuk e kupton se me një refuzim dhe apostazi të tillë, ai bëhet idiot dhe i poshtëruar dhe humbet krejtësisht të gjithë mbështetjen.

A nuk e shikon ti se një perëndimor i cili refuzon profetin Muhammed a.s.m, përsëri e ngushëllon veten me krishterimin e tij dhe me civilizimin e tij perëndimor që përmban elementet e zakoneve të kombit të tij? Ka gjasa që ai të ruajë në shpirtin e tij disa virtyte të lavdërueshme dhe të bëjë përpjekje të çmueshme për të përmirësuar jetën e tij të kësaj dynjaje. Ky ngushëllim e ruan atë prej shikimit të perdeve të errësirës në shpirtin e tij dhe të vetmisë që ndryshe ai do ta kishte ndjerë.

Sa për ty, o felëshues! Në qoftë se ti mohon profetin Muhammed a.s.m dhe arritjet e tij, ti nuk mund të pranosh asnjë profet tjetër, as Zotin tënd dhe as ndonjë plotësi reale. Vështroje rrënimin e tmerrshëm në shpirtin tënd dhe shikoje dendësinë e errësirës në ndërgjegjen tënde dhe trishtimin dhe brengën në zemrën tënde! Shëmtia e botës tënde të brendshme shpejt do të bëhet e dukshme dhe do të bëhet e qartë se tërheqja sipërfaqësore e apostazisë është më e shëmtuar se sa shëmtia e një mosbesimtari. Ti do të jesh si një mbartës helmi, i dëmshëm edhe për veten tënde, edhe për komunitetin. Apostati –felëshuesi– është i privuar prej të dyja jetëve, jo si kafiri, mohuesi. Sepse kafiri ka të drejtën e jetës nëse ai nuk lufton.

Mësoje, o ti që vuan vështirësi në kuptimin e disa të vërtetave të mëdhaja të Kuranit, të tilla siç pohohen në vërsitet:

“I Cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë...”²²³

“Dhe çështja e Orës (çastit të fundit) është sa një hap e mbyll sytë ose edhe më afër”²²⁴

“Krijimi i ju të gjithëve dhe ringjallja e ju të gjithëve janë si (krijimi dhe ringjallja) e një njeriu të vetëm”²²⁵

“Dhe pastaj do t’i fryhet (Surit) për herë të dytë dhe ja! Kur t’i shohësh, ata të gjithë të ngritur shikojnë (e presin)”²²⁶

“...edhe Ditën kur Ne do t’i mbështjellim qiejt si letër e shkruar (e mbështjellë tub për shkrim)...”²²⁷

...e kështu me rradhë. Libri i krijimit i interpreton qartë e dukshëm këto vërsete kuranore dhe i ofron ato për kuptimin tënd duke të të shfaqur ty shumë realitete fizike të krahasueshme me to, të cilat ti i vëzhgon rregullisht, si për shembull në ndërkëmbimin e ditës e të natës dhe në ndryshimet e stinëve dhe të shekujve.

Në qoftë se ti kërkon bindje, hape thesarin e vërsetit, *“Shihni pra te pasojat e mëshirës së Allahut, se si Ai ringjall tokën pas vdekjes së saj. Sigurisht që Ai do të ngrejë me siguri të vdekurit (Ditën e Ringjalljes)...”²²⁸* me qëllim që ti të mund t’i shohësh qartë shembujt e panumërt të realiteteve të mëdhaja, të cilat ti i gjykon si të pagjasa.

Për shembull, ti shikon në ringjalljen e pranverës ringjalljen e mijëra botërave të bimëve dhe të kafshëve të cilat vdiqën në kijametin e vjeshtës e të dimrit. Ato janë rikthyer përsëri në jetë brenda pak ditëve në rregull të përcaktuar dhe në masa të caktuara të veçanta për secilën. Shumica e atyre botëve gjenden dhe stolisin pothuajse të gjithë rajonet e tokës. Ndodhen shembuj të tjerë të panumërt për këtë.

²²³Kur’an, 10:3

²²⁴Kur’an, 16:77

²²⁵Kuran, 31:28

²²⁶Kur’an, 39:68

²²⁷Kur’an, 21:104

²²⁸Kur’an, 30:50

Midis atyre botëve të panumërta, sodit botën e pemëve, brenda të cilave janë shumë lloje të pemëve mollë dhe çdo anëtar i çdo lloji. Ti do të shohësh tre ndodhi ringjalljeje njëra pas dhe brenda tjetrës. Së pari, pema shpërthen në lule të bukura, pastaj vijon gjethërimi i saj, duke prodhuar gjethe të mirëpërpjestuara e plot entuziazëm. Së fundi, ajo jep fruta të shijshëm e të bukur. Krijuesi i Vetëm i bën këto gjëra në faqen e tokës dhe duke e kthyer fletën e dimrit shkruan –mbush– mijëra fletë secila me masën e fletës së tokës me “fjalë” të mrekullueshme. Ai e prezanton Vetveten si Një i Vetëm i Cili i ka krijuar qiejt e tokën në gjashtë ditë, dhe i Cili i realizon të gjitha gjërat e përmendura në vërsetet lartë.

Mësoje, o shok! Gjithkush ka lidhje dashurie e dhembshurie me të afërmit e tij, pastaj me anëtarët e fisit të tij, pastaj me anëtarët e kombit të tij, pastaj me anëtarët e racës së tij, pastaj me anëtarët e species së tij –njerëzimit– dhe pastaj me të gjitha pjesët dhe grimcat e ekzistencës. Madje, edhe në mënyrë të pavetëdijshme, ai pikëllohet për shkak të fatkeqësive të tyre dhe bëhet i lumtur për shkak të lumturisë së tyre. Në mënyrë të veçantë, ai e ndjen veten bashkë me komunitetin e profetëve, evlijave dhe të të përkushtuarve për shkak të plotësisë së tyre. Një nënë, për shembull, sakrifikon vetveten dhe prish rehatinë e saj për hir të një të afërmi të vetëm ose për hir të një të dashuri. Për shkak të asaj që bota përreth tij i paraqet atij, një individ i zhytur në pakujdesi nuk është në gjendje ta çlirojë vetveten prej dëshpërimit. Përkundrazi, përveç atij dëshpërimit të pashmangshëm, ai shtypet nën peshat e dhimbjeve shpirtërore dhe turbullirës së brendshme. Madje, edhe sikur të vendosej në një parajsë, ai nuk do të ishte më mirë e sa një xixëllonjë e cila jep një shkreptimë të shkurtër e të dobët drite dhe pastaj mbulohet nga errësira prej të gjitha anëve. Madje, kjo dritë kalimtare është një shkak dëmi për atë individ në atë që ajo i shfaq atij skena të trishtueshme përreth tij. Në kontrast, supozo se ai është në gjendje të çlirohet prej pakujdesisë dhe i shikon të gjitha gjërat dhe ndodhitë me dritën e besimit në Pronarin e ekzistencës, çdo veprim i të Cilit është i mirë ose nga vetvetja, ose nga rezultatet e tij. Pastaj, një dritare do të hapet nga zemra e tij për tek dritat e Diellit të Përhershëm duke ndriçuar të gjithë të shkuarën dhe të ardhmen deri në përjetësi. Ai do të jetë në gjendje të dallojë se e gjithë dashuria që ai e ndan midis të gjithë të dashurve të tij është në fakt për Atë të Vetëm i Cili i mjafton dhe i zëvendëson të gjitha gjërat dhe e bën atë t’i harrojë të gjithë të tjerët. Asgjë nuk mund ta zëvendësojë Atë, madje as edhe njërin prej manifestimeve të Tij.

Madje, edhe në qoftë se ky besimtar i bindur për të vërtetën e kësaj do të vendosej në ferr, xhehennem, ai do të gëzonte ndonjë ndjesi të parajsës duke ditur se të gjithë të dashurit e tij ishin të shpëtuar prej zhdukjes së përjetshme dhe prej ndarjes dhe ishin bekuar me lumturi të përhershme.

O Said i pakujdesshëm! Braktise nefsin tënd dhe supozimin e nefsit tënd si pronarin tënd, dhe duke ia dorëzuar të gjithë të dashurit e tu Pronarit të tyre Gjithëbujar e Mëshirëplotë, siguro shpëtimin dhe lumturinë e të gjithë atyre.

Mësoje, o shok! Gjithçka duke përfshirë aktet e njeriut, vjen në ekzistencë nga Allahu. por të këqijat, shëmtitë, defektet dhe ligësitë janë rezultatet e natyrës dhe të kapaciteteve të mangëta të të krijuarve. Krijuesi Dorëgjërë Absolut i përgjigjet me krijim çfarëdo që i krijuari i kërkon Atij me gjuhën e potencialit dhe të gjendjes së natyrshme. E mira dhe bukuria janë absolutisht prej Tij. Sepse është Ai i Cili i sjell ato në ekzistencë dhe i kërkon ato. Sa për shëmtinë dhe defektet, është përsëri Ai i Cili i krijon ato, por pa i kërkuar. I gjithë lavdërimi i takon gjithmonë Atij, sepse kërkimi për bukuri e mirësi është si përgjigje prej Tij dhe Emrave të Tij. I gjithë lavdërimi e tesbihati gjithashtu i përket Atij dhe Ai është absolutisht i lirë dhe larg të gjitha mangësive dhe shëmtisë, sepse janë krijesat që kërkojnë e bëjnë ligësi e shëmti, dhe i Gjithëfuqishmi i sjell ato në ekzistencë. Megjithatë, Ai i bashkangjit shumë pasoja të bukura asaj që duket si e shëmtuar.

“Çfarëdo e mirë që të vjen, ajo është prej Allahu, kurse çfarëdo e keqe që të bie ty, ajo është nga vetja jote”²²⁹

Mësoje, o shok! Të gjitha speciet e krijesave në botë, sidomos speciet e bimëve dhe të kafshëve në tokë janë si penjëza të një qëndisjeje mbi faqen e tokës njëra mbi tjetrën, ose si materiale të veshur nga toka njëri nën ose mbi tjetrin. Disa prej tyre janë më të hollë, disa më të shkurtër, disa të thurura lirshëm, ndërsa disa të tjera grisen në dimër dhe ripërtërihen në pranverë. Por, të gjitha ato janë thurur me një rregull të përkryer dhe me përpjestime të përkryera. Të gjitha speciet e përqafojnë njëra-tjetrën dhe e ndihmojnë njëra-tjetrën me zell të skajshëm. Anëtarët e tyre vijnë bashkarisht dhe ndahen në marrëdhënie të mira.

²²⁹Kur'an, 4:79

Çfarëdo që ekziston në tekstilen e Thurësit të Vetëm është shërbëtor i Një Prijësi të Vetëm. Çdo gjë thuret në mënyrë tipike për vetveten me penjëza të ndryshme karakteristike për vetveten pa asnjë konfuzion e pa defekt. Kjo dëshmon me një siguri të bazuar mbi vëzhgim se ajo është një vepër arti e të Vetmit, fuqia e të Cilit nuk ka limit.

Vëzhgoji stolisjen tipike të qëllimshme dhe furnizimin e të gjitha krijesave të ndryshme nga njëra-tjetra. Kjo dëshmon se Ai i Cili i ka stolisur dhe i ka pajisur pallatet e botës me të gjitha ato specie të ndryshme krijesash me tipare e karakteristika të ndryshme është Ai i Cili ka krijuar çfarëdo që është e domosdoshme për mbajtjen e ruajtjen e atij pallati. Njëri nga qëllimet më të rëndësishme për stolisjen e tij të pasur është bërja e Autorit të tij të njohur dhe se ajo stolisje është njëra prej pasqyrave më të shndritshme e cila reflekton të vërtetën se Autori dëshiron ta bëjë Vetveten të njohur e të dashur.

Nëse dëshiron, shiko midis shembujve të panumërt, atë luledielli të verdhë e cila mbyllet natën e hapet ditën. Autori i saj e bën atë një shtëpi të këndshme për disa organizma të vegjël ose për kafshë të vogëla të cilat bëjnë tesbihat për Krijuesin e tyre. Një grup prej tyre banon në atë luledielli dhe ajo bëhet si një kopësht, ose si një pallat, ose si një fshat për to.

Lavdia qoftë për Atë, i Cili e shfaq në të gjitha gjërat mirësinë e Tij, e bën fuqinë e Tij të njohur nga krijesat e Tij dhe e bën Vetveten të dashur prej shërbëtorëve të Tij nëpërmjet stolisjes së pasur të veprave të Tij të artit, madhështia e Tij qoftë e lartësuar dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij.

“Fjala e Tij është e vërteta dhe i Tij do të jetë mbisundimi...”²³⁰

“Ai as që mund të pyetet se çfarë Ai punon...”²³¹

Mësoje, o shok! Ai nuk pyetet për çfarëdo që Ai bën, dhe nuk ka askush të drejtë dhe asnjë pretekst ta pyesë Atë. Ai vepron me autoritet absolut në mbretërinë e Tij sikur të dojë dhe Ai është i Gjithëdituri, i Gjithurti. Ai njeh atë çfarë ne nuk e njohim. Mosdija jonë rreth urtësisë në një ngjarje ose në ekzistencën e një gjëje nuk do të thotë se nuk ka

²³⁰Kur'an, 6:73

²³¹Kur'an, 22:23

urtësi në të. Sepse urtësia e vëzhguar qartë në shumicën absolute të gjërave dëshmon për ekzistencën e urtësisë në të gjitha gjërat dhe ngjarjet.

Për shembull, ne pikëllohem nga vdekja e një gjallese. Ne mund të mos dallojmë asnjë bukuri dhe as të mirë në jetëshkurtësinë e disa kafshëve të holla. Ne gjithashtu mund të mos perceptojmë asnjë shembull mëshire në zhdukjen e disa krijesave të gjalla në vjeshtë ose në dimër. Por të gjitha ato kundërshtime të tilla apo dhimbje burojnë nga mosdija jonë për realitetin se një qenie e gjallë është si një ushtar ose si një shërbëtor i ngarkuar me shumë detyra në jetë të cilat bëjnë tesbihate dhe lavdërime për Krijuesin e jetës dhe të vdekjes. Qëllimet për jetët e tyre i përkasin Atij, qoftë Ai i lavdëruar. Kështu, shfaqja e tyre në arenën e ekzistencës për një moment të vetëm ose madje nijeti i tyre i brendaqenësishëm për përmbushjen e funksioneve të tyre, si nijetet e farërave dhe të bërthamave për t'u rritur në bimë ose pemë, mund të jetë i mjaftueshëm për të kryer atë çfarë pritet prej jetëve të tyre. Dhe vdekja është vetëm një ndryshim banesash ose një shkarkim prej detyrash, ose një thirrje për tek prania e Krijuesit të tyre, ashtu siç dekreton Vetë Krijuesi, *“Pastaj te Zoti i tyre të gjithë do të mbliidhen”*.²³² Është vetëm njëra prej shenjave të plotësisë së mëshirës së Tij që Ai përgjithësisht të mos ua shtyjë për më vonë krijesave të Tij periudhën e padurueshme të pleqërisë dhe t'u lejojë atyre të qëndrojnë gjatë në mundimet më të ashpëra e të rënda të jetës. Ai i shkarkon dashuruesit e luleve dhe ata që marrin kënaqësi tek perimet prej detyrave të tyre. Autori i atyre krijesave, Pronari i tyre i punëson ato gjatë jetëve të tyre në përputhje me kushtet në të cilat ata mund t'i përmbushin lehtësisht detyrat e tyre. Kur rrudhat, zymtësia e kushteve të tyre të papërballueshme të jetës për shkak të pleqërisë dhe shuarjes së entuziazmit të tyre shfaqen në fytyrat e tyre, mëshira e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm u vjen në ndihmë duke u dhënë atyre shkarkimin. Në vendin e tyre Ai dërgon përngjasuesit e tyre, dhe ata thurin pas tyre shembullin e tyre, me qëllim që edhe ato të bëjnë tesbihat për Pronarin e tyre. Ata ardhës të rinj nisin detyrat e tyre aty ku paraardhësit e tyre i plotësuan të tyret.

O i pakujdesshëm mburracak që e supozon vetveten të jesh pronari i vetvetes tënde dhe i jetës tënde, dhe që imagjimon se lumturia jote

²³²Kur' An, 6:38

qëndron në jetë të vazhdueshme e të lehtë. Ti je gabim dhe mashtron veten tënde. Ti e krahason nefsën tënd vetëharrues me një kafshë të kënaqur me jetën e saj dhe e cila, në fakt përmbush detyrat e saj. Klithmat e gëzimit të shkaktuara nga manifestimet e Mëshirës universale tingëllojnë për ty si qarja. Prandaj, mos u pikëllo rreth tyre për shkak të dhimbjes që buron prej dhembshurisë dhe keqardhjes. Përkundrazi, pikëllohu për nefsën tënd të cilin ti e krahason me to dhe të të vijë keq për të.

Sa për lejimin e disa kafshëve për të sulmuar të tjerat, kjo është për shkak se të dobëtat e sulmuara mund t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre dhe potencialin ose kapacitetin për të mbrojtur vetveten dhe të mësojnë të njohin aftësitë e tyre. Kur ti i krahason kafshët shtëpiake me kafshët e egra të të njëjtit lloj, ti mund ta shohësh këtë urtësi të dukshme.

Mësoje, o shok! Përse evlijatë ndryshojnë në konkluzionet që ata nxjerrin nëpërmjet inspirimit dhe zbulesave shpirtërore ndërsa duke pasë dakordësi në themelet e fesë? Përse evlijatë dhe profetët që erdhën para profetit të fundit a.s.m nuk i shtjelluan shtyllat e besimit përveç Unitetit Hyjnor, kurse Kurani dhe ai mbi të cilin u shpall Kurani a.s.m i shpjeguan të gjitha ato aq qartë saqë nuk kërkojnë sqarime të mëtejshme? Arsyeja është ndërhyrja e disa perdeve midis atyre shtyllave dhe evlijave dhe profetëve të mëparshëm. Një arsye tjetër është se kapacitetet ndryshojnë në marrjen e manifestimeve të Emrave Hyjnorë që ndodhin në ngjyrat e ndritshme dhe në intensitet.

Për shembull, dhe për Allahun është krahasimi më i lartë, dielli ka me lejen e Zotit një manifestim universal mbi të gjitha lulet dhe një manifestim të veçantë mbi çdo specie dhe mbi çdo lule të veçantë. Sipas një teorie të mirënjohur, çdo lule merr ngjyrën e saj prej përthyerjes së dritës së diellit.

Gjithashtu, dielli ka me lejen e Krijuesit të tij një manifestim universal të dritës së tij mbi planetet dhe mbi hënën, e cila reflekton dritën e diellit mbi det e mbi flluskat e pikat e tij, dhe mbi tokë dhe mbi gjërat e tejdukshme mbi të, dhe mbi ajër dhe mbi grimcat.

Përsëri, dielli ka me urdhërin e Krijuesit të tij një reflektim universal të pastër në 'pasqyrat' e atmosferës dhe të sipërfaqes së detit. Ai gjithashtu ka reflektime të veçanta ose imazhe në flluskat mbi

sipërfaqen e detit, mbi pikat e ujit, mbi molekulat e ajrit dhe mbi flokët e dëborës.

Manifestimi i diellit mbi çdo lule, mbi çdo pikë uji, mbi çdo dritare ose pikë vese është në dy mënyra:

Mënyra e parë është e drejtëpërdrejtë, pa ndërmjetëse e pa pengesa;²³³

Mënyra e dytë është indirekte, me ndërhyrjen e perdeve dhe ndërmjetësive. Në këtë mënyrë manifestimet e diellit merren në përputhje me kapacitetin dhe natyrën e pasqyrave.²³⁴

Për sa ka të bëjë me mënyrën e parë, lulja, pika e ujit dhe pika e vesës mund të thonë: “Unë jam një pasqyrë e diellit të botës”, kurse për sa ka të bëjë me të dytën, ato vetëm mund të thonë: “Unë jam një pasqyrë e diellit tim të veçantë ose e diellit të specieve të mia”. Dielli i veçantë i secilit ose dielli i specieve të secilit e shfaq vetveten prapa perdeve ose pengohet nga perdet. Kështu, ajo nuk mund të posedojë veçori të diellit të botës, i cili u shkakton planetëve të rrotullohen rreth tij dhe jep nxehtësi dhe ndriçon tokën dhe lëviz rrotat e jetëve të bimëve dhe gjërave të tjera.

O shok! Le t’i supozojmë vetet tona në vendin e tyre! O nefsi i dendur, ti do të bëhesh lulja e cila merr një ngjyrë si një efekt i prodhuar nga një rreze e dritës së diellit mbi një gjatësi vale të veçantë. Le të jetë ky filozof i mbytur në shkaqet natyrale pika e cila merr prej hënës një hije të dritës së diellit. Vesa e varfër, e zhveshur prej çdo ngjyre mban imazhin e diellit në beben e syve të saj. Lavdia qoftë për Të, i Cili prej mirëbërësisë së Tij na ndriçon, na stolis ne, na ka lëvizur për t’iu afruar Atij e ta shohim Atë!

Ti, lulja, je ngritur në rangun e përfaqësimit të të gjitha luleve. Por një lule është një pasqyrë e dendur, ku drita përthyeret dhe shtatë ngjyrat në të shkrihen. Kështu, ajo e pengon reflektimin e diellit. Për këtë arsye, ti nuk mund të shpëtosh prej ndarjes dhe je e ngatërruar midis cilësive të ngjyrave. Ti nuk mund të jesh e lirë me kusht që ti ta ngresh kokën tënde që është e mbytur në dashurinë e vetes tënde dhe

²³³Kjo rrugë përfaqësohet prej profetësisë.

²³⁴Kjo mënyrë përfaqësohet nga shenjtëria.

tërhiqe shikimin tënd të fiksuar mbi meritat e bukuritë që ia atribuon nefsit tënd, dhe drejtoje atë tek fytyra e diellit në qiejt. Ti gjithashtu duhet ta kthesh fytyrën tënde, e cila sheh poshtë tokës për të tërhequr rëzkun i cili në fakt është i lidhur tek ti, lart nga dielli. Sepse ti je një pasqyrë e tij ashtu siç është ai një pikë e shndritshme prej detit të qiellit, është një pasqyrë për një rreze prej më të ndritshmes së fuqisë së Dritës së Vërtetë, i lavdëruar qoftë Ai. Megjithatë, ti nuk mund ta shohësh atë në identitetin e tij real. Ti vetëm mund ta shohësh atë të ngjyrosur me ngjyrat e attributeve dhe të teleskopit tënd dhe i kufizuar prej kapacitetit tënd të kufizuar.

Ti ke avancuar, o pikë, aq larg, sa hëna me shkallën e shkencës dhe të filozofisë dhe e gjete atë të dendur e të errët, pa dritë e pa jetë. Përpjekja jote ka qenë e gjitha më kot, dhe njohja jote është provuar të jetë e pafutshme. Ti vetëm mund të shpëtosh prej errësirës së dëshpërimit, nga mjerimi i vetmisë dhe nga tmerrri i vetmisë së frikshme me kusht që ti të braktisësh natën e natyralizmit dhe të kthehesh drejt Diellit të së Vërtetës. Beso me siguri se dritat e asaj nate janë veçse reflektime me hije i dritave të diellit të ditës. Por, ti nuk do të jesh në gjendje ta shohësh diellin qartë. Ti mund ta shohësh atë vetëm prapa perdeve të thurura nga njohja dhe filozofia jote, dhe në një ngjyrë të prodhuar nga kapaciteti yt.

Sa për ty, o vesë e dobët dhe e varfër, avanco me avullimin dhe ngritjen në ajër. Pastaj kthehu në zjarr, pastaj transformohu në dritë, pastaj hip mbi një rreze prej rrezeve të manifestimeve të dritës. Në çfarëdo stacioni që ti arrin gjatë udhëtimit tënd lart, një dritare hapet për ty me pamje nga dielli. Ti shikon me siguri se ai i meriton atributet që i ka dhe asnjë perde as pengesë, as kufizueshmëria e kapaciteteve, dhe as vogëlsia e pasqyrave nuk mund të të kufizojnë ty prej të atribuuarit atij të gjitha veprat e sovranitetit esencial. Ti ke kuptuar se ajo që shfaqet në objektet dhe vëzhgohet në pasqyra nuk është vetë dielli, por manifestimet dhe reflektimet e ngjyrosura prej tij të ndonjë lloj.

Tre grupet e përfaqësuara nga lulja, pika e ujit dhe vesa në krahasimin tonë ndryshojnë në meritat e plotësisë që ato kanë përfutur dhe në detajet e rangut të sigurisë që ato kanë arritur. Por, ato të gjitha kanë dakordësi mbi afirmimin, pohimin e të vërtetës.

Mësoje, o njeri! Ti shërben si njësi krahasimi në pesë mënyra.

Ti je një indeks gjithëpërfshirës i veprave të mrekullueshme të manifestimeve të Emrave të bukur Hyjnorë.

Me atributet e tua dhe me hyjninë e supozuar në sferën tënde, ti je një instrument matës për të njohur Atributet gjithëpërfshirëse Hyjnore të Krijuesit.

Ti je një masë për të refuzuar të gjitha llojet dhe shkallët e shirkut në univers. Sepse kur ti je i bindur se i përket Atij ekskluzivisht duke qenë një pronë e Tij, ti beson se Ai nuk ka asnjë ortak në univers. Ndërsa, në qoftë se ti ia jep një të tretën e ekzistencës Atij, një të tretën e dytë shkaqeve natyrale dhe një të tretën e fundit vetes tënde, atëherë kjo ndarje ndodh gjithandej universit. Kur ti ia atribuon egos tënde madje edhe gjënë më të vogël prej pronës së Tij, ty do të të duhej të pranoje se çdo qenie dhe çdo shkak natyral ka gjithashtu një gjë të njëjtës masë dhe si rrjedhojë e ndan pronën e Zotit midis të tjerëve përveç Tij. Gjithashtu, kur egoja jote bëhet e zbuluar për ty, atëherë harta e vërtetë e shkencave ‘natyrore’ dhe e botës së jashtme hapen për ty. Ndërsa, kur ti e harron veten tënde, kjo njohje bëhet e mbyllur për ty ose ndryshohet në injorancë të përbërë dhe në sofistikë të pakuptimë.

Përsëri, çelësat e thesareve të fshehur të Emrave Hyjnorë janë në dorën tënde. Në qoftë se ti mund ta perceptosh pafuqinë tënde të pakufishme, ti do të zbulosh se Krijuesi yt ka fuqi të pakufishme dhe në qoftë se ti shikon varfërinë tënde të pafundme, ti do të shohësh se Furnizuesi yt ka pasuri të pafundme. Dhe kështu, në mënyra të këtilla, manifestimet e Emrave të Tij bëhen shkronja të ndritshme të shkruara në errësirën e ekzistencës tënde. Sa më e dendur të jetë ajo errësirë, aq më të ndritshme janë ato.

Për sa ka të bëjë me këto katër mënyra të përmendura, ti je një qenie e aftë vetëm për marrje, ti nuk ke asgjë të mirë në veten tënde. Ti je një poezi e shkruar me gjuhën “Ji! Dhe ajo është”.

Sa për mënyrën e pestë, ti je një veprues, një shkak veprues, je një lypës me gjuhën e potencialit, nevojës, akteve dhe fjalëve. Ti je origjina e të gjitha të këqijave, defekteve dhe mëkateve, ndërsa Krijuesi yt është burimi i të gjitha të mirave, bukurive, plotësisë dhe dritave.

“Me të vërtetë Allahu ka blerë nga besimtarët jetën e tyre dhe pasurinë e tyre me çmimin se i tyre do të jetë Xheneti”²³⁵

Mësoje, *“O njeri! Çfarë të ka bërë ty të pakujdesshëm ndaj Zotit Gjithëbujar?”²³⁶* i Cili blen prej teje pronën e Tij²³⁷ të lënë amanet tek ti për të përfituar prej saj? Ai jep për të një çmim tejet të madh. Ai e blen atë vetëm ndërsa ti vazhdon ta mbash atë në dorën tënde dhe të përfitosh prej saj. Ai e blen atë vetëm për ta ruajtur prej humbjes dhe që ajo të mund të shtohet në vlerë mijëra herë. Përfitim mbi përfitim, mbi përfitim...

Por ti, o i pakujdesshëm, mos e shit atë dhe të tradhëtosh amanetin e Tij. Ti do ta zvogëloje vlerën e saj prej më të lartës së të lartave për tek më e ulëta e të ulëtave, dhe atëherë ajo do të shkonte më kot. Ti do të privoheshe prej çmimit më të lartë që Ai jep dhe do të duroje vuajtjet, vështirësitë, dhimbjet dhe mundimet për ta mbajtur atë për një kohë shumë të shkurtër dhe ti do të mbaje gjithashtu mëkatet që bën si rrjedhim. Humbje mbi humbje, mbi humbje...

Lidhur me këtë marrëveshje –ujdi– ti i ngjason një njeriu të mjerë që qëndron në këmbë në maje të një mali. Një tërmet ndodh dhe së bashku me të tjerët si ai njeri, ai bie në thellësiat e një lugine dhe humbet çfarëdo që është në dorën e tij. Në atë gjendje, ai është si dikush që gati po bie në një gropë zjarri ose në një banesë të rrënuar, që gati po bie me të në humnerë. Megjithëse ai akoma mban në dorë një amanet që është një makineri e mrekullueshme e cila përmban instrumente të panumërt dhe aparatura të panumërta në gjendje për të prodhuar fruta dhe dobi të pakufishme. Ndërsa ai është në atë gjendje, Pronari i vërtetë i makinerisë, thjesht nga dhembshuria për njeriun, i ofron për ta blerë atë. Ai i thotë atij: “Me qëllim për ta ruajtur atë dhe për ta rikthyer pasi ti të kesh shpëtuar prej kësaj humnere, Unë dëshiroj prej teje ta blej pasurinë time sikur ajo të të përkiste ty. Domethënë ti duhet ta përdorësh atë duke përfshirë të gjithë instrumentet e saj, në kopshtet e Mia pafundësisht të gjëra për të njohur e matur përmbajtjet e thesareve vërshuese të Mia me qëllim që vlera e tyre të mund të shtohet

²³⁵Kur’an, 9:111

²³⁶Kur’an, 82:6

²³⁷Domethënë veten tënde, trupin dhe ekzistencën ose jetën, të cilat në fakt janë prona e Tij. (Përkthyesi).

dhe në këmbim ti mund të marrësh paga –rroga– shumë të larta. Përndryshe, ajo do të bëhej një makineri e ulët e zakonshme e llojit të përdorur nga zgavërat e barkut tënd. Të krahasuara me kopshtet dhe thesaret e Mia, sa të vlefshëm dhe sa të ngushtë janë zgavërat e barkut tënd. Si munden ato zgavëra ta nxënë e ta përfshijnë makinerinë e lënë amanet tek ti, e cila madje nuk mund të përfshihet as nga e gjithë bota? Përveç kësaj, Unë do të të jap një çmim shumë të lartë në këmbim për to. Dhe Unë nuk do ta heq prej dorës tënde sa kohë që ti të vazhdosh të jetosh në këtë mal; përkundrazi, Unë do të marr përsipër ruajtjen dhe menaxhimin e saj me qëllim që ajo të mos të të shkaktojë ty asnjë vështirësi për ta mbajtur. Në qoftë se ti e pranon marrëveshjen – tregtinë– përdore atë në Emrin Tim dhe për llogarinë Time. përdore atë në mënyrën e një ushtari i cili e administron atë që e mban në dorën e tij në emrin e mbretit dhe për llogari të tij, dhe pa asnjë frikë për atë çfarë do të ndodhë dhe pa asnjë dëshpërim për atë çfarë ka ndodhur. Në qoftë se ti nuk e pranon marrëveshjen, ti do të pësosh dëm mbi dëm dhe do të trajtohesh si një tradhëtar i amanetit dhe përgjegjës për humbjen e tij”.

Kurani e përshkruan këtë marrëveshje për njerëzimin dhe i paralajmëron ata: Blije atë dhe fito një çmim tejet të lartë”.

“Vërtet që banesa e jetës së pastajme, ajo është jeta e vërtetë, veç sikur ta dinin”²³⁸

Kurse civilizimi modern dhe filozofia materialiste thonë: “Përvetësoje atë, bëje pronën tënde”.

“...nuk ka më jetë tjetër përveç kësaj që jemi në këtë botë...”²³⁹

Shikoje diferencën midis udhëzimit të ndritshëm Hyjnor dhe gjenialitetit njerëzor çudhëzues!

Mësoje, o shok! I Gjithëlavdishmi i Vetëm është afër, por ti je larg prej Tij. Ashtu siç është Ai afër teje, po ashtu Ai është afër të gjithë anëtarëve të njerëzimit. Ashtu siç është Ai afër të gjithë anëtarëve të njerëzimit, po ashtu Ai është afër të gjitha qënieve të tjera të gjalla dhe

²³⁸Kur'an, 29:64

²³⁹Kur'an, 6:29

të gjitha krijesave prej më të vogëlës së grimcave për tek eteri, qëniet shpirtërore dhe për tek ato përtej imagjinatës tënde.

Në qoftë se ti dëshiron të jesh afër Tij, ty do të të duhej të zhvilloheshe e të zgjeroheshe deri sa të jesh i aftë të përfaqësosh tërësinë e njerzimit dhe pastaj të fitosh një eksperiencë absolutisht universale duke përfaqësuar tërësinë e krijimit. Kjo do të thotë që ti duhet të kalosh përtej shtatëdhjetë mijë perdeve. Në qoftë se Ai është afër teje dhe gjithashtu afër çdo gjëje në të njëjtën kohë, ty do të të duhej të ishe afër çdo gjëje. Pastaj, pas kësaj ti has një hapësirë të pafundme midis mundësisë, sferës së krijimit, dhe Domosdoshmërisë, sferës së Hyjnisë. Si është e mundur ta arrish të Vetmin pafundësisht larg në afërsinë e Tij përtej mijëra botërave? Në qoftë se dëshiron të jesh afër Tij, braktise neftin tënd dhe asgjësoje atë që të heqësh largësitë ndërhyrëse dhe të fitosh qëndrueshmëri me Të, dhe të fitosh afërsi ndaj Tij.

Mësoje, o shok! Allahu është më afër nesh se sa vetet tona, ndërsa ne jemi pafundësisht larg prej Tij. Midis dëshmive të afërsive të Tij është veprimi i Tij autoritar e administrues mbi ne. Por, në qoftë se ne e kërkojmë Atë afër asaj mbi të cilën Ai administron, ne do ta gjejmë Atë afër të gjitha gjërave. Në qoftë se ne jemi në gjendje ta arrijmë Atë nëpërmjet fitimit të universalitetit në një mënyrë që përfaqësojmë tërësinë e krijimit, atëherë ne do ta gjejmë Atë përtej perdeve të Dritës në sferën e Domosdoshmërisë së formuar prej botërave të Emrave, Atributeve dhe Cilësive Esenciale në Dinjitetin e Tij, në madhësinë dhe madhërinë e Tij. Kurse, në qoftë se ne e kërkojmë Atë nëpërmjet afërsisë së Tij duke braktisur neftin tonë dhe duke e asgjësuar atë, atëherë do të jetë e lehtë ta gjesht Atë, në qoftë se Ai dëshiron. Nuk ka as forcë dhe as fuqi, veçse nëpërmjet Tij.

Mësoje, o ti që dëshiron të njohësh diferencën midis urtësisë së Kuranit dhe pikëpamjes së filozofisë! Imagjino se ndodhet një kopje e Kuranit e shkruar me shkronjat e xhevahirëve të çmuar prej ari, argjendi, diamanti, smeraldi, agati e të tjera. Dy njerz e lexuan atë dhe e admiruan, dhe të dy thanë: “Le të shkruajmë për bukuritë e kësaj gjëje të stolisur një libër”, dhe secili shkroi një libër.

Njëri nga ata të dy është i huaj, i cili nuk mund ta kuptojë arabishten, dhe si rrjedhojë është i paaftë të kuptojë kuptimin e Kuranit. Por, meqenëse ai është një bizhuter ekspert dhe si një specialist në

inxhinieri, gjeometri dhe në njohjen e gurëve të çmuar dhe veçorive të tyre, ai shkroi një libër të madh që diskutonte bukuritë e dukshme të shkronjave të tij me xhevahire.

Sa për tjetrin, duke e parë librin, ai kupton se ai është një libër shumë i çmuar dhe i urtë, është Kurani i urtë. Ai e preokupoi vetveten jo me xhevahiret e përdorur për shkrimin e tij, por me çfarë është miliona herë më e lartë, më e bukur, më e stolitur dhe më e çmueshme se shkronjat. Kështu ai shkroi një libër që diskutonte xhevahiret e kuptimit të tij, dritat e mistereve të tij dhe të vërtetave të vërseteve të tij.

O ti që ke mend! Cili nga ato dy libra meriton të pranohet e të thuhet për të se është libri i urtësisë së këtij Kurani? Në qoftë se ti e kuptove këtë analogji, shikoje aspektin e realitetit të tij: Sa për Kuranin, ai është ky univers, dhe dy personat janë filozofët dhe shkencëtarët nga njëra anë, dhe studentët e Kuranit nga ana tjetër.

“Dhe kushdo që mbështetet e vë shpresat tek Allahu, atëherë Ai do t’i mjaftojë atij plotësisht”²⁴⁰

Mësoje, o Said! Lumturia qëndron në besimin e Zotit, prandaj vendose besimin tënd tek Zoti, me qëllim që ti të mund të gjesh paqë dhe qetësi në këtë botë dhe të gjesh një shpërblim të madh në tjetrën.

Shëmbëllimi i dikujt që mbështetet tek Zoti dhe i një tjetri që nuk mbështetet është si shëmbëllimi i dy njerëzve të cilët hipin në një anije duke mbajtur pesha të rënda mbi shpinat e tyre dhe mbi kokë. Njëri prej tyre e ul poshtë peshën e tij dhe ulet mbi të me qetësinë e mendjes. Ndërsa tjetri, nga marrëzia dhe arroganca nuk bëri kështu. Kur atij iu tha ta ulte peshën e tij mbi kuvertën e anijes, ai u përgjigj: “Unë jam mjaftueshëm i fortë për ta mbajtur atë”. Ata i shpjeguan atij: “Kjo anije që të mban ty është më e fortë dhe më në gjendje për ta mbajtur atë. Ndërsa udhëtimi vazhdon, pesha jote do të bëhet më e rëndë për shpinën tënde dhe për kokën. Prandaj, ule atë peshë dhe lehtësohu prej peshës tënde. Në qoftë se pronari i anijes të sheh ty në këtë gjendje, ai ose do të mendonte se ti je i marrë e do të urdhëronte dëbimin tënd, ose duke menduar se ti je një tradhëtar duke shpërfillur anijen e tij dhe duke e tallur atë, ai do të urdhëronte burgosjen tënde. Madje, ti nuk do

²⁴⁰Kur’an, 65:3

të shpëtoje prej përqeshjes dhe talljes së udhëtarëve të tjerë. Kur nuk je në gjendje ta mbash peshën tënde, ti do të duhej ose të pretendoje të jesh i fortë, gjë e cila do të thotë mburrje dhe dëshirë për t'u dukur, ose të shfaqësh arrogancë apo mendjemadhësi, gjë e cila do të thotë dobësi dhe pafuqi”.

Në fund, personi në fjalë e kuptoi gabimin e tij dhe hoqi dorë nga arroganca; pastaj e uli poshtë peshën e tij dhe u ul pranë saj. I lehtësuar ai tha: “Allahu ta shpërbleftë, ti më udhëzove tek ajo mbi të cilën qëndrojnë rehatia ime, shpëtimi dhe nderi”.

Mësoje, o shok! Vërsetet e Kuranit konkludojnë shpesh ose me vetë Emrat e bukur Hyjnorë, ose me frazat që urdhërojnë reflektim dhe shqyrtim, ose që bëjnë thirrje për arsyetim. Vërsetet ndonjëherë përfundojnë me një shprehje të përgjithshme duke përfshirë njërin prej qëllimeve të Kuranit, sikur rrezet prej dritës së urtësisë së lartësuar ose si pikat prej ujit të pastër të udhëzimit Hyjnor. Domethënë, me shprehjet e tij të mrekullueshme, Kurani shpjegon veprat dhe aktet e Autorit dhe pastaj konkludon ose me Emrat Hyjnorë përkatës, ose me pohimin e Ringjalljes, ose me Unitetin Hyjnor, ose me ndonjë shtyllë tjetër të besimit. Për shembull:

“Ai është i Cili krijoi për ju gjithçka në tokë, pastaj u ngrit lart drejt qiellit duke i bërë ata shtatë qiej dhe Ai është i Gjithëdituri për çdo gjë”²⁴¹

“A nuk e kemi bërë Ne tokën si shtrojë dhe malet si shtylla mbështetëse? Dhe Ne ju kemi krijuar në palë, çifte. Dhe Ne jua kemi bërë gjumin për pushim. Dhe Ne jua kemi bërë natën si mbulesë. Dhe Ne jua kemi bërë ditën për gjallëri. Dhe Ne kemi ndërtuar përmbi ju një shtatëshe (qiej) të fortë. Dhe Ne kemi bërë atje një llampë të shndritshme (diellin). Dhe Ne kemi derdhur nga retë ujë të bollshëm. Që Ne të mund të prodhojmë me anë të tij drithëra dhe bimësi. Dhe kopështe të begatë. Me të vërtetë, Dita e Vendimit (ndarjes së banorëve të Xhennetit dhe të Xhehennemit) është kohë e përcaktuar që më parë”²⁴²

²⁴¹Kur'an, 2:29

²⁴²Kur'an, 78:6–17

Kurani shpërndan para syve të njerëzve tekstilet e artit të Tij dhe pastaj konkludon me ato Emra Hyjnorë ose me një referencë për të arsyetuar.

“Thuaju: Kush ju sjell furnizim nga qielli dhe nga toka dhe kush është zotëruesi i të dëgjuarit dhe të shikuarit? Dhe kush e nxjerr të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Dhe kush është rregulluesi dhe sunduesi i të gjitha çështjeve? Do të thonë të gjithë: Allahu. Thuaju: A nuk do të keni atëherë frikë nga ndëshkimi i Allahut? Ky është Allahu, Zoti juaj...”²⁴³

“Padyshim se në krijimin e qiejve dhe të tokës, në këmbimin me rradhë të ditës dhe të natës, në anijet që lundrojnë përmes detit me çfarë është e vlefshme për njerëzimin, në ujin që Allahu derdh nga qielli duke e bërë tokën pas tij të gjallë pas vdekjes së saj, në lëvizjen e të gjitha krijesave të cilat Ai i ka shpërndarë gjithandej, në ndryshimin e drejtimit të erërave dhe të reve që mbahen mes qiellit dhe tokës; të gjitha këto janë me të vërtetë ajete –prova, dëshmi, shenja e tregues– për popullin që ka mend”²⁴⁴

Gjithashtu, Kurani shpjegon aktet e Allahut dhe pastaj konkludon me Emrat ose Atributet e Tij.

“Kështu, Zoti yt do të të zgjedhë ty dhe do të të mësojë shpjegimin e ëndërrave dhe do ta përsosë mëshirën e Tij mbi ty dhe mbi pasardhësit e Jakubit, ashtu siç Ai e përsosi atë te baballarët e tu, te Ibrahim i dhe Is’haku kohë më parë. Padyshim që Zoti yt është i Gjithëditur, i Gjithhurtë”²⁴⁵

“Thuaj: O Allah! Zotëruesi i mbretërimit! Ti ia jep mbretërimin atij që Ti do dhe Ti ia merr mbretërimin atij që Ti do. Ti e mvesh me nder atë që Ti do dhe Ti e poshtëron atë që Ti do. Në Dorën Tëndë është mirësia. Vërtetë, Ti je i Gjithëfuqishëm mbi të gjitha gjërat”²⁴⁶

Përsëri, Kurani i përmend krijesat dhe pastaj përdor rendin, harmoninë, proporcionet dhe frutat e ekzistencës së tyre si pasqyra për

²⁴³Kur’an, 10:31–32

²⁴⁴Kur’an, 2:164

²⁴⁵Kur’an, 12:6

²⁴⁶Kur’an, 3:26

të reflektuar Emrat e manifestuar mbi to, sikur ato krijesa të ishin fjalë dhe Emrat kuptimet e tyre, ose uji i jetës, farërat ose esencat.

“Dhe sigurisht që Ne e krijuam njeriun nga një copë balte. Pas kësaj Ne e bëmë atë nutfah duke e strehuar atë në një banesë të sigurtë (mitra e nënës). Pastaj Ne e bëmë nutfan në një copë gjak të mpiksur, pastaj Ne e bëmë gjakun e mpiksur në një xhungë mishi, pas kësaj Ne bëmë prej asaj xhunge mishi eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj Ne e nxorrëm jashtë si një krijim i ri. I Shenjtëruar pra qoftë Allahu, më i Miri i krijuesve”²⁴⁷

“Padyshim që Zoti juaj është Allahu i Cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë dhe pastaj u ngrit lart mbi Arsh. Ai sjell natën si mbulesë të ditës dhe secila duke synuar tjetrën pandërprerë; dhe Ai krijoi edhe diellin, edhe hënën, edhe yjet të nënshtruar ndaj urdhërit të Tij. Padyshim që i Tij është krijimi dhe komandimi. I shenjtëruar dhe i lartësuar qoftë Allahu, Zoti i të gjithë botëve”²⁴⁸

Përsëri, Kurani përmend disa ngjarje dhe gjëra të ndryshueshme e të veçanta dhe pastaj konkludon me Emrat universalë të ndritshëm, të qëndrueshëm ose me fraza që nxisin reflektim, ose nxjerrje mësimi:

“Dhe Ai ia mësoi Ademit emrat e të gjitha gjërave, pastaj ua paraqiti ato melekëve dhe u tha: “Më thoni Mua emrat e tyre nëse jeni të drejtë”. Melekët thanë: Lavdi të qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç’na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithhurti”²⁴⁹

“...me të vërtetë që edhe te bagëtitë ka mësim për ju. Ne ju japim juve të pini nga ajo që është në barkun e tyre nga bashkimi ndërmjet sekrecioneve të gjendrave dhe të gjakut, qumësht të pastër, i shijshëm e i përshtatshëm për ata që e pijnë. Dhe nga frutat e hurmave dhe nga rrushi ju merrni pije dhe ushqim të mirë. Pa dyshim që këtu ka shenjë të qartë për njerëzit që mendojnë. Dhe Zoti yt frymëzoi bletën duke i thënë: “Ndërtoji shtëpitë e tua në male, në pemë dhe në ndërtime e njerëzve. Pastaj hani nga çdo lloj fruti dhe ndiqni rrugët që Zoti juaj jua bëri të lehtë për ju”. Prej barkut të saj del lëng me ngjyra të

²⁴⁷Kur’an, 23:12–14

²⁴⁸Kur’an, 7:54

²⁴⁹Kur’an, 2:31–32

larmishme në të cilin ka ilaç e shërim për njerëzit. Me të vërtetë që këtu ka tregues të qartë për popullin që mendon”²⁵⁰

Përsëri, Kurani përmend gjëra të mëdhaja ose gjërat e gjendura në shumësi dhe pastaj i vendos mbi to shenjat e Unitetit Hyjnor dhe i përfundon ato me një rregull të përgjithshëm:

*“Kursia–Froni– i Tij shtrihet mbi qiej e tokë dhe Ai nuk ndjen aspak lodhje në ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre. Dhe Ai është më i Larti, më Madhështori”*²⁵¹

*“Allahu është Ai i Cili ka krijuar qiejt dhe tokën dhe që dërgon ujin nga qielli duke nxjerrë prej andej fruta si ushqim për ju; është Ai i Cili i ka bërë anijet të jenë të nënshtruara ndaj jush që të mund të lundrojnë nëpër det me lejen dhe vullnetin e Tij; po kështu Ai i ka bërë edhe lumenjtë të jenë të nënshtruar e në shërbimin tuaj; dhe Ai i ka bërë diellin dhe hënën të dy të ndjekin vazhdimisht drejtimin e tyre, po kështu ka bërë edhe natën edhe ditën të nënshtruar për ju. Dhe Ai ju dha gjithçka që ju kërkuat dhe po të numëroni mirësitë e Allahut, ju kurrë nuk do të ishi në gjendje t’i numëroni ato. Me të vërtetë që njeriu është shumë i padrejtë dhe tepër mosmirënjohës”*²⁵²

Përsëri, ai përmend shkaqet e jashtme për gjërat që vijnë në ekzistencë dhe pastaj tërheq vëmendjen për tek Vepruesi Real i Cili i krijon ato dhe frutat e tyre, kështu duke treguar se është e pamundur për shkaqet e pajeta që t’i njohin ato fruta dhe ato rezultate të qëllimshme. Madje, edhe në qoftë se shkaqet duken të jenë afër pasojave, ndodhet një distancë shumë e madhe midis tyre, dhe është aty që Emrat Hyjnorë shfaqen në madhësinë e tyre. Nuk është e mundur për më të mëdhajat e shkaqeve të sjellin nga vetvetja e tyre as më të vogëlat e pasojave. Në të njëjtën mënyrë, horizonti duket të ketë prekur malet, ndonëse midis tij dhe atyre ndodhet një distancë e madhe, distanca në të cilën yjet qëndrojnë.

“Atëherë, le të shohë njeriu tek ushqimi i tij. Ne derdhim ujë me bollëk dhe Ne e çajmë tokën në plasa. Dhe Ne e bëmë drithin (grurin) të rritet në të. Dhe rrushtë dhe tërfilin (bimët e gjelbërta si ushqim për

²⁵⁰Kur’an, 16:66–69

²⁵¹Kur’an, 2:255

²⁵²Kur’an, 14:32–34

bagëtitë). Dhe ullinjtë dhe hurmat, dhe kopështet me pemë të dendura. Dhe frutat dhe abba (barishte e kullotë), (për të qenë) furnizim dhe përfitim për ju dhe për bagëtitë tuaja”²⁵³

Fjala “furnizim nga Zoti” dhe përmendja e bimëve dhe e pemëve, secila prej tyre është një vepër e përsosur arti me shumë dobi, shfaqin se shkaqet e jashtme nuk kanë asnjë efekt krijues në ardhjen e tyre në ekzistencë.

“A nuk e shihni se Allahu i drejton retë me qetësi, pastaj i mbledh ato bashkë, pastaj i kthen ato në stivë shtresa–shtresa dhe ju shihni shiun të dalë nga brendësia e tyre? Ai dërgon nga qielli edhe male me breshër dhe godet me të atë që do Ai ose e largon atë prej kujt të dojë Ai. Drita e shpejtë e shkrepjes së tyre (reve) sa s’ të merr sytë. Allahu bën që nata dhe dita të ndjekin njëra–tjetrën. Vërtetë që në të ka mësim për ata që janë të pajisur me mprehtësi. Dhe Allahu krijoi çdo lloj gjallese nga uji. Prej tyre ka disa që zvarriten me barkun e tyre, disa ecin me dy këmbë dhe disa ecin mbi katër. Allahu krijon çfarëdo Ai. Vërtetë që Allahu është i Gjithëfuqishëm për të gjitha gjërat”²⁵⁴

Përsëri, Kurani përmend veprat e jashtëzakonshme të Allahut me qëllim që t’i përgatisë mendjet që të pranojnë aktet e mahnitshme në Ahiret ose Ai i përmend aktet e Tij të së ardhmes në një mënyrë që tregon ngjashmëritë e tyre të cilat ne i dëshmojmë këtu në këtë botë.

“A nuk e sheh njeriu se Ne e kemi krijuar atë nga nutfah? Prapëseprapë, kur shih! Ai (paraqitet) kundërshtar i hapur. Dhe na shëmbëllen Ne të tjerë dhe harron krijimin e vet. (Një i tillë) thotë: “Kush do t’iu japë jetë këtyre kockave kur të jenë kalbur e të jenë bërë pluhur?”

Thuaj: “Ai do t’iu japë jetë atyre, i Cili i krijoi ato për herë të parë! Dhe Ai është për çdo krijesë i Gjithëditur!”

(Ai) i Cili nxjerr për ju zjarrin nga pema e gjelbër, kur ja! Ju prej saj ndizni (zjarret tuaj). A nuk është Ai i Cili krijoi qiejt dhe tokën, i

²⁵³Kur’an, 80:24–32

²⁵⁴Kur’an, 24:43–45

Plotëfuqishëm t'i krijojë përsëri ata? Po, nuk ka pikë dyshimi dhe Ai është Gjithëkrijuesi, i Gjithëdituri”²⁵⁵

“Kur dielli të mbështillet dhe të humbë dritën dhe të përmbysset”²⁵⁶

“Kur qielli të plasë”²⁵⁷

“Kur qielli të çahet”²⁵⁸

Kur shohim në ringjalljen e pranverës analogji të shumta për Ringjalljen. Për shembul, ti e shikon përngjasimin, madje përngjasimet e *“Dhe kur fletët e shkruara të veprave të çdo njeriu do të hapen”²⁵⁹* në mbirjen dhe rritjen e farërave dhe bërthamave, regjistrat e ‘nënave’ të tyre dhe historitë e jetëve të tyre.

Përsëri, Kurani përmend qëllimet e veçanta ose ngjarjet, pastaj i konfirmon dhe i mbështet ato me Emrat sikur ato të ishin rregulla universale.

“Vërtetë që tashmë Allahu e dëgjoi fjalën e saj e cila fjaloset me ty në lidhje me bashkëshortin e saj dhe ia çon ankimet e saj Allahut. Dhe Allahu i dëgjon argumentet mes ju të dyve. Vërtetë që Allahu është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues”²⁶⁰

“Lavdia dhe madhështia qoftë për Atë i Cili e mori robin e Tij për udhëtim natën nga Mesxhidi Haram, nga xhamia e shenjtë, për në Mesxhidi Aksa, xhamia e largët në Kuds, rrethinat e së cilës Ne i bekuam me qëllim që t'i tregojmë atij ajetet Tona. Me të vërtetë që Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi”²⁶¹

“Gjithë lavdërimet dhe falënderimet janë për Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të tokës, i Cili i bëri melekët lajmëtarë me fletë, dy, tri a

²⁵⁵Kur'an, 36:77-81

²⁵⁶Kur'an, 81:1

²⁵⁷Kur'an, 82:1

²⁵⁸Kur'an, 84:1

²⁵⁹Kur'an, 81:10

²⁶⁰Kur'an, 58:1

²⁶¹Kur'an, 17:1

*katër. Ai shton në krijim çfarëdo që Ai do. Vërtetë që Ai është i Gjithëfuqishëm për të gjitha gjërat*²⁶²

Përsëri, Kurani përmend aktet e njerëzve mosmirënjohës me dënim të kërcënuar për ato akte. Pastaj, ai i ngushëllon ato me Emrat që tregojnë mëshirë.

*“Thuaju: “Po të kishte pasur zota e perëndi të tjerë bashkë me Të, siç thonë ata, atëherë ata sigurisht që do të kishin kërkuar të gjenin një rrugë drejt Zotit të Arshit. Lavdi, madhështia dhe lavdia qofshin për Të! Larg nga të gjitha trillimet dhe shpifjet që i ngjisin e thonë për Të. E lavdërojnë dhe e ngrenë në madhështi Atë shtatë qiejt dhe toka dhe gjithë ç’është në ta, dhe s’ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij, por ju nuk e kuptoni lavdërimin e tyre. Me të vërtetë që Ai është gjithnjë tepër i Durueshëm dhe Falës i Madh”*²⁶³

Një çështje e rëndësishme

Kurani thotë:

*“Thuaj: Sikur deti të ishte bojë për (të shkruar) fjalët e Zotit tim, madje edhe sikur të sillnin një të dytë si ai në ndihmë të tij”*²⁶⁴

Në qoftë se ti pyet se në çfarë mënyrash Kurani është superior në vlerë ndaj të gjithë llojeve të tjerë të ligjëratës, të shprehur ose të shkruar, përgjigja do të ishte:

Kurani është Fjala e Allahut, me Cilësinë e Tij, Zoti i të gjitha botëve, duke pasë titullin Perëndia e të gjitha botëve dhe me Emrin Zoti i qiejve dhe i tokës, dhe nga aspekti i Hyjnisë Absolute, dhe prej aspektit të sovranitetit universal. Ai është kështu si pjesë e Mëshirës

²⁶²Kur’an, 35:1

²⁶³Kur’an, 17:42-44

²⁶⁴Kur’an, 18:109

Gjithëpërfshirëse dhe nëpërmjet madhështisë dhe lartësisë së Hyjnisë, dhe është një libër që buron prej fushës gjithëpërfshirëse të Emrit më të madh dhe duke iu adresuar rrethit të përfshirë prej Fronit më të madh.

Sa për fjalët e tjera të Zotit, ato janë fjalët për llogari të manifestimeve të veçanta të Hyjnisë me Emra dhe tituj të veçantë dhe si pjesë e sovranitetit të veçantë dhe të mëshirës. Ato janë si shumica e inspirimeve Hyjnore. Për këtë arsye, një evlija mund të thotë: “Zemra ime më informon mua prej Zotit tim”; ai nuk mund të thotë: “Zemra ime më informon mua prej Zotit të botëve”.

Një profet merr rezatim e ndriçim prej manifestimit të Zotit të botëve me Emrin eTij më të madh në pasqyrën e Fronit më të lartë, që është ‘Nëna’ e të gjitha froneve. Të krahasuar me këtë, sa të pjesshme janë ndriçimi dhe rrezatimi që ti, o evlija, o shenjtor merr prej manifestimit të Zotit tënd në pasqyrën e zemrës tënde në përputhje me kapacitetin e zemrës tënde? Me qëllim që ta kuptosh diferencën, ti mund të shohësh ndryshimin midis dritës së diellit të reflektuar në pasqyrën tënde të vogël e të dobët dhe midis dritës që dielli ia jep të gjithë sistemit diellor. Diferenca gjithashtu është si diferenca midis adresimit të një mbreti ndaj njërit prej nënshtetasve të tij lidhur me një çështje të veçantë, mbi një linjë të veçantë komunikimi me atë nënshtetas dhe midis dekretit të një mbreti që ka lëshuar për të gjithë nënshtetasit e tij. Ai e ka lëshuar dekretin nëpërmjet të dërguarit të tij për llogari të qënies së tij autoriteti më i lartë mbi të gjithë mbretërinë dhe me madhësinë e plotë të atij autoriteti.

Ky realitet domethënës gjithashtu shpjegon se përse shumica e shpalljeve Hyjnore erdhën nëpërmjet më të mëdhenjve të engjëjve, ndërsa inspirimet vijnë pa ndërmjetësimet e engjëllit; dhe përse madje edhe më i madhi i evlijave nuk mund të arrijë rangun e asnjërit prej profetëve. Ai gjithashtu shpjegon arsyen për epërsinë e Kuranit bashkë me dinjitetin e tij të pakrahasueshëm, shenjtërinë, lartësinë dhe bukurinë e thukëtisë së tij të mrekullueshme. Përsëri, Ai shpjegon, përveç shumë mistereve të tjerë, pse ishte e domosdoshme për vulën e profetëve a.s.m për Miraxhin, ngjitjen në qiej aq larg, deri tek më e largëta Pema Lotë. Ai shpjegon se përse ai u ngjit deri tek afërsia e dy harqeve për t’i bërë lutje Atij i Cili është më i afërt për të se vena e qafës së tij, dhe pastaj u rikthye në dynja aq shpejt, aq sa pulitja e kapakëve të syrit.

Ashtu si njohja e dëshira, të folurit e Allahut për Vetveten është njëra prej Atributeve të Tij të parapërdjetshme. Ekzistenca e saj është e njohur dhe natyra e saj është e panjohur. Dhe fjalët e Tij janë të pafundme.

“Lavdi të qoftë Ty! Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç’na ke mësuar Ti. Vërtetë që vetëm Ti je i Gjithëdituri, i Gjithurti”²⁶⁵

O studiues! Kjo çështje e madhe është prej plotësuesve të pikës së katërt të pikëlës së katërmëdhjetë.

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Prej Tij ne kërkojmë ndihmë. Me Emrin e Allahut, Bismil–lah!

Mësoje, o shok! Çdo gjë thotë Bismil–lah, ose me gjuhën e fjalës, ose të gjendjes, ose të potencialit. Sepse ti shikon se pavarësisht pafuqisë së saj esenciale, çdo gjë prej grimcave më të vogëla për tek diejt më të mëdhenj, kryen detyra të mahnitshme; një të biliontën e asaj detyre, ajo nuk është në gjendje ta kryejë me fuqinë e vet. Kjo në mënyrë të qartë tregon se ajo i bën ato me fuqinë e të Fortit të Plotëfuqishëm; ajo i ndërmer ato detyra me Emrin e të Gjithëfuqishmit të Gjithurtë.

Gjithashtu, pavarësisht injorancës së saj të plotë, ajo i bën ato detyra me aq urtësi dhe me rregull dhe në një mënyrë të dobishme për të gjithë dhe aq në mënyrë të frutshme, saqë do të ishte e pamundur për të, të bënte një të biliontën e saj vetë. Kjo është shenja më e qartë se ajo i merr ato detyra të qëllimshme me Emrin e Një Madhështori të Gjithurtë. Çdo objekt vepron e funksionon për dobinë e krijesave të gjalla dhe me Emrin e të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotë dhe për llogari të të Gjithëditurit Gjithëbujar.

Nëse dëshiron, soditi farërat dhe bërthamat dhe shiko se si secila mban një pemë ose një bimë. Shiko pemët dhe frutat e tyre, mikroorganizmat dhe kafshët e tjera dhe detyrat që ato kryejnë. Dikush

²⁶⁵Kur’an, 2:32

që sheh një ushtar që t'i grumbullojë bashkë të gjithë njerëzit e një qyteti në ndonjë vend dhe pastaj i dërgon ato në vende të ndryshme për të bërë disa detyra, njeriu do të dilte me konkluzionin se ai ushtar i jep urdhërat nëpërmjet fuqisë së qeverisë ose të sovranitetit dhe vepron në emrin e tij dhe i vë në shërbim njerëzit në emrin e atij sovraniteti. Gjithashtu, dikush me pak mend do ta kuptonte qartë se të gjitha ato krijesa injorante të pafuqishme i kryejnë të gjitha detyrat e tyre të mëdhaja në mënyrë aq të urtë, të rregullt e të frutshme në Emrin e të Gjithëfuqishmit të Gjithëditur, dhe për llogari të të Plotëpushtetshmit të Gjithurtë, dhe duke dhënë frutat e detyrave të tyre në Emrin e të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotë. Çfarëdo detyre që kryen një krijesë dhe si rrjedhojë, prodhon fruta, është e tillë saqë mëshira Hyjnore universale jep kënaqësi të veçantë në këmbim për të. Ajo është si kënaqësia që merr një nënë në dhembshurinë e saj për fëmijët e saj, ose kënaqësia që ka një bletë duke iu bindur inspirimit Hyjnor në të për të bërë atë çfarë ajo bën, ose si kënaqësia që merr një mashkull në fekondim. Është si kënaqësia që çdo organizëm i gjallë merr në të ngrënit e në të pirit dhe në të pushuarit, ose si kënaqësia që merr një krijesë në vënien në efekt të potencialit të saj, si mbirja dhe rritja e bimëve, dhe kështu me rradhë.

Krijuesi i Gjithurtë dhe Pronari Gjithëbujar i ka bërë kënaqësi të tilla si rroga –paga– për shërbimet që bëjnë krijesat dhe si orekse që nxisin aktet e tyre.

Tani, o njeri që mban amanetin më të madh! Si nuk i bindesh një ligji që i rrethon të gjitha gjërat prej Fronit më të lartë për tek krijesa më e vogël në tokë? Dhe si mund të guxosh të ngresh krye kundër një parimi të vendosur nga i Vetmi i Cili ka nënshtuar diellin dhe hënën dhe që i ka vënë në shërbimin e Tij yjet dhe grimcat?

Mësoje, o shok! Ndryshimi midis rrugës së besimit në Unitetin Hyjnor dhe midis ateizmit dhe herezisë është si ndryshimi midis parajsës dhe ferrit, dhe midis asaj çfarë është absolutisht e domosdoshme dhe asaj që është ose duhet të jetë e pakonceptueshme. Nëse dëshiron, merre parasysh krahasimin e mëposhtëm:

Besimi në Unitetin Hyjnor ia atribuon të gjitha gjërat Një Qënieje të Vetme dhe si rrjedhojë e zvogëlon vështirësinë dhe harxhimin për ekzistencën e tyre deri në atë shkallë që në lidhje me fuqinë e Atij të

Vetmi, diejt dhe grimcat më të vockëla dhe e pakta dhe e shumta e panumërueshme janë të njëjta.

Gjithashtu, besimi në Unitetin Hyjnor zbulon shumë qëllime për ekzistencën e gjërave që i përkasin Autorit të tyre. Njëri prej këtyre qëllimeve është se një gjë manifeston Emrat e Krijuesit sikur të ishin fjalë gjithëpërfshirëse duke mbajtur kuptimet e Emrave dhe duke i treguar ato.

Në kontrast, njerëzit e pakujdesshëm dhe të çudhëzuar ia atribuojnë ekzistencën e një gjëje gjërave të tjera të shumta, elementeve të pajetë e të pafuqishëm dhe forcave të shurdhëta dhe të verbëra të ligjeve. Ata e bëjnë ekzistencën e gjërave aq të vështirë për një gjë që të vinte në ekzistencë, aq sa të gjitha gjërat. Përsëri, ata i konsiderojnë gjërat vetëm për sa ka të bëjë me dobitë e tyre për njerëzimin, të tilla si qenia e tyre ushqim për të mbajtur jetët njerëzore, i cili është vetëm njëri prej shumë qëllimeve për ekzistencën e tyre.

Shëmbëllimi i një besimtari dhe i një ateisti është si shembulli i dy njerëzve të cilët panë bërthamën e një hurme dhe nisën ta përshkruajnë atë.

Njëri prej tyre tha: Ajo është një indeks prej indekseve të tjerë të panumërt të quajtur bërthama ose farëra. Ajo bën të njohur kuptimin dhe esencën e pemës së destinuar të rritet prej saj dhe përshkruan historinë e jetës së pemës e cila e ka prodhuar atë. Ajo është një hartë duke shfaqur natyrën e potencialeve të pemës së saj dhe funksionet si një lloj makinerie që thur një pemë hurme.

Tjetri tha: Jo! Me të gjitha pjesët dhe gjetet e saj, pema e hurmës është grumbulluar tek kjo bërthamë, për ta shpikur atë dhe për ta pajisur me shumë instrumente. Por, pa dobi. I vetmi qëllim për ekzistencën e kësaj peme është të prodhojë këtë bërthamë, dhe përsëri kjo bërthamë do të hahet nga një kafshë ose do të kalbet në tokë.

Të gjitha gjërat ndodhin me një lehtësi të skajme pavarësisht bollëkut të tyre, dhe pavarësisht qënies së tyre të përziera me njëra-tjetrën, çdo gjë mund të dallohet lehtë dhe një rregull gjithëpërfshirës dominon në univers. A është e mundur për dikë me pak mend e vetëdije t'ia atribuojë, madje edhe sikur një gjë të vetme, një shege për shembull, shkaqeve të pajeta? Shumica e gjërave në ekzistencë

bashkëpunojnë për atë gjë të vetme për të ardhur në ekzistencë, e cila është një shembull i të gjitha gjërave. A do të ishte e mundur që një gjë e tillë –një shegë– të jetë krijuar vetëm për ngrënie?

Urtësia universale e ka ngarkuar kokën e njeriut me të gjitha shqisat që ajo përmban me detyra të shumta. Në qoftë se për secilën prej këtyre detyrave do të caktohej një instrument i ndryshëm me përmasën e një fare sinapi, atëherë koka e njeriut duhej të ishte aq e madhe sa mali Sinai.

Shikoje gjuhën tënde dhe detyrat që ajo kryen! Të shijuarit, të peshuarit e të gjitha përmbajtjeve të thesareve të mëshirës Hyjnore është vetëm njëra prej atyre detyrave.

A do të ishte e mundur që kjo urtësi universale të kishte caktuar për atë shegë, e cila është një vepër e mrekullueshme arti, një qëllim të vetëm, kryesisht që ti ta haje atë në një moment pakujdesie? Ashtu siç është e pakonceptueshme që diçka me masën e kokës tënde të prodhonte një frut me përmasën e një mali, po ashtu është njësoj e pakonceptueshme që diçka me përmasën e një mali të jepte një frut të vetëm si koka jote. Supozimi i një lloji të tillë pakonceptueshmërie do të thotë të mos shohësh asnjë ndryshim midis urtësisë dhe kotësisë dhe absurditetit, do të thotë ta shohësh urtësinë e pafundme të njëjtë me kotësinë e pafundme dhe me absurditetin. Kurse, ashtu si të gjitha llojet e tjera të frutave, ajo shegë përmban një poezi të gjatë për Emrat e bukur Hyjnorë duke shpjeguar kuptimet e tyre.

I lavdëruar qoftë Ai prej artit të të Cilit habiten mendjet!

Kjo sa vijon është një lule e pemës së vërsetit:

“E lavdërojnë dhe e ngrenë në lavdi e madhështi Atë shtatë qiejt dhe toka, dhe gjithë ç’është në ta, dhe s’ka gjë që të mos e lëvdojë lartësinë e Tij...”²⁶⁶

²⁶⁶Kur’an, 17:44

Kuptimi i këtij vërseti m'u shfaq mua në një kohë kur pemët lulëzuan në pranverë. Unë hyra në dalldi dhe reflektova mbi kuptimin e tyre. Rreshtat vijues m'u shfaqën:

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Lavdi i qoftë Allahut, të Cilin të gjitha gjërat e lavdërojnë me fjalë të veçanta për secilën, të dukshme e të perceptueshme!

Për shembull, dritat, lumenjtë dhe retë e shiut janë fjalët e burimit të dritës, të ujit dhe të ajrit përkatësisht.

Lavdia qoftë për Atë, të Cilin e lavdërojnë:

Burimi i dritës me drita,

Uji dhe ajri me lumenjtë dhe retë,

Toka dhe bimët me shkëmbinj e lule,

Atmosfera dhe pemët me zogj e fruta,

Retë dhe qielli me shi e hëna.

Shkreptima e dritës është nëpërmjet ndriçimit të Tij dhe duke e bërë Atë të njohur.

Ajri prodhon valë nëpërmjet administrimit të Tij dhe duke e ngarkuar atë (me detyra).

Uji shpërthen dhe vërshon me nënshtrimin e Tij dhe duke e depozituar atë,

Që është një lavdërim i qartë për të Vetmin i Cili i përcakton të gjitha gjërat dhe cakton për çdo gjë një natyrë të veçantë.

Zbukurimi i gurëve është nëpërmjet skalitjes dhe modelimit të Tij.

Buzëqeshja e luleve është nëpërmjet stolisjes dhe zbukurimit të Tij.

Bukuria e frutave është nëpërmjet mirëbërësisë dhe bujarisë së Tij,

Gjë e cila është një lavdërim i qartë, i hijshëm për të Vetmin i Cili krijon çdo gjë me një natyrë të veçantë.

Cicërima e zogjve duke i bërë ato të flasin është nëpërmjet mirësisë së Tij;

Të kënduarit e shiut duke e bërë atë të bie është prej mirëbërësisë së Tij;

Lëvizja e hënave është nëpërmjet përcaktimit të Tij, planit dhe rrotullimit të Tij,

Gjë e cila është një lavdërim elokuent për Përcaktuesin e Vetëm; është një shenjë e ndritshme për Mposhtësin e Vetëm.

Lavdia qoftë për Atë të Cilin e lavdërojnë:

Qiejt me yjësitë dhe me objektet dritëdhënëse;

Sistemet planetarë me diejt, yjet dhe hënat;

Atmosfera me rrufetë, vetëtimën dhe shiun;

Toka me kafshët, bimët dhe pemët;

Pemët e lavdërojnë Atë me gjethet e lulet, pastaj me frutat e mirëpërpjestuar.

Kur lulet ndalojnë së lavdëruari, frutat fillojnë të flasin me një lavdërim elokuent që përhap drita.

Bërthama këndon himn në heshtje nga zemra me plotë mistere;

Një libër i shkruar në të, regjistri i historisë së pemës së saj.

Ajo shpreh lavdërimin e Çarësit të kokrrave, lavdërimin e Krijuesit.

Të gjitha bimët e lavdërojnë, adhurojnë dhe lëvdojnë dhe janë në sexhde para Përcaktuesit.

Buzëqeshjet e bimëve nëpërmjet luleve të tyre janë lavdërim i dukshëm për dikë që është në gjendje të dallojë.

Mugullimet dhe kallinj të janë gjuhët e tyre, farërat dhe kokërrat janë fjalët e poezisë që ato recitojnë.

Përppjestimet dhe rregullsia janë një gjuhë tjetër dhe skica e tyre është prej skicimit të Dritëdhënësit.

Secila është një vepër arti e stolisur prej Rrezatuesit.

Me qënien e tyre ushqim, me ngjyrat e tyre dhe erërat, ato përshkruajnë e lavdërojnë Krijuesin.

Ato përshkruajnë Atributet e Tij, bëjnë të njohur Emrat e Tij dhe interpretojnë Vullnetin e Tij për ta bërë Vetveten të njohur e të dashur.

Kokërrat në kallinj dhe lulet si sytë janë “pikat” e manifestimeve të Krijuesit.

Me qëllim që Ai të mund të duhet prej shërbëtorëve të Tij dhe të njihet prej krijësave të Tij,

Një pemë në lulëzim është një shprehje lavdërimi në varg me shumë “sy” që kanë hapur;

Ajo ka stolisur pjesët e saj jeshile për ditën e saj festive, me qëllim që Zoti i saj të mund t’i vërshojë veprat e Tij të shquara.

Ajo ekspozon xhevahiret që i janë bashkangjitur asaj për ata që kanë sy për të parë dhe shpall për njerëzimin urtësinë në krijim, me thesarin e depozituar në të nga dorëgjërsia e Zotit të frutave.

Lavdia qoftë për Atë i Cili bën mirë çfarëdo që Ai bën!

Sa e stolisur është prona e Tij! Sa të qarta janë shpjegimet e Tij, i Cili është Krijuesi Formëdhënës, Krijuesi Fuqiplotë, Krijuesi Dritëdhënës!

Vështroje mëshirën e Tij në stinën e pranverës që të shohësh artin e Tij!

Stina e pranverës është një ditë festive për shërbëtorët e Tij.

Dita kur krijimi i Tij –pemët dhe bimët– stolisin vetveten e tyre.

Çdo bimë shfaq tek shkalla e rangut të saj sovranitetin e Mbretit të saj dhe dhuratat e Pronarit të saj.

Ajo është e gatshme të marrë e të përmbushë dhuratat e Tij, të thejë shumë shërbim në Emrin e Tij.

Ajo lulëzon e jep fruta me lejen e Tij, duke i ngjasuar një tryeze të pastër për mysafirët e Tij.

Drita, ajri, dheu dhe uji janë përçuesit e urdhërave të Tij dhe mbajtësit e Fronit të Tij, duke njoftuar artin e Tij dhe duke përçarur urtësinë e Tij.

Njohja dhe urtësia, drita është froni i tyre;

Mirësia dhe mëshira, uji është froni i tyre;

Ruajtja dhe rigjallërimi, dheu është froni i tyre;

Urdhëri dhe dëshira, ajri është froni i tyre!

Mësoje, o shok! Të gjithë ato elemente janë objekte në të cilat manifestohen Emrat e Tij. Ato janë ndërmjetësues, jo burime dhe as origjina; ato janë pasive mbi të cilat veprohet dhe jo vepruesit. Ato janë përçuesit nëpërmjet Fuqisë së Tij dhe përçojnë me lejen e Tij, me Emrat e Tij. Ato bëjnë atë çfarë bëjnë me fuqinë e Tij.

Në qoftë se ajo çfarë bie tek pjesa e gjërave nuk konsiston vetëm në këtë, domethënë në të qëniet objekte ku manifestohen Emrat e Tij, duke qenë vetëm ndërmjetësuese pasive, atëherë do të kishte qenë e domosdoshme për dheun, ajrin, dritën dhe ujin të kishin në secilën prej grimcave të tyre ose atomeve apo molekulave një njohje të pafundme, një fuqi dhe aftësi krijuese.

Për shembull, ajri kalon përmes atmosferës dhe viziton grimcat dhe të gjitha bimët e destinuara për t'u rritur.

Kalimi i tij shkakton të shfaqen mrekulli të pallogaritshme, mrekullitë e artit të Tij, i Cili i ka krijuar qiejt.

Në qoftë se do të ishte e mundur për një grimcë të thjeshtë, të pajetë dhe injorante për t'i ndërtuar ato pemë, t'iu bashkangjisë pemëve ato fruta dhe t'i formonte ato lule, shkurtazi, t'i shpikte ato gjëra;

Dhe në qoftë se do të ishte në gjendje ta mbante këtë tokë, këtë botë, atëherë ti do të kishe të drejtë të kishe dyshime rreth Njesisë së Tij, i Cili nuk ka ortakë.

Ose ndryshe, është përtej çdo ndryshimi se askush tjetër përveç Atij i Cili e mban të gjithë krijimin në kapjen e fuqisë së Tij, në kapjen e urtësisë së Tij, të mund të pretendojë ndonjë pronësi e dominim të gjërave.

Sepse çdo kokërr ose pikë apo grimcë vepron në shërbim të bimësisë, frutave dhe luleve. Në qoftë se ato nuk do të ishin vënë në punë e shërbim nga Zoti i qiejve, atëherë çdo grimcë, kokërr dhe pikë do të duhej të kishin aq art të madh e fuqi dhe të ishin aq me urtësi të mjaftueshme, aq sa t'i shpiknin dhe t'i drejtonin të gjitha ato krijesa.

Lavdia qoftë për Atë të Cilin pemët e lavdërojnë me gjethet e tyre, me lulet dhe frutat!

Shpërthimi –çelja– e luleve midis shumësisë së gjetheve për të hapur rrugën e rritjes së frutave;

Dhe rritja e frutave në prehërin e luleve, të cilat janë bijat e pemëve, duke vallëzuar në duart e degëve jeshile, të lëvizura nga erërat dhe flladet gjallërues;

E gjitha kjo është një ligjërim elokuent duke e lavdëruar Atë, i Cili i ka ndërtuar ato, i Cili është Një i Vetëm, Mposhtës.

Gojët e tyre, shkronjat dhe fjalët janë gjethet, lulet dhe frutat; lulet buzëqeshin me mirënjohje ndaj të Plotëfuqishmit për stolisjen e tyre;

Frutat gëzohen për atë çfarë Mëshira u jep atyre duke kënduar melodi të këndshme. Të mirërregulluar e të mirëpërpjestuar, në ngjyra të ndritshme, artistikisht të vizatuar e të qëndisur, me formë të mahnitshme, mjaft të zbukuruara dhe mrekullisht të ngjyrosura, të shijshme në të ngrënë, arti i mrekullueshëm që ato shfaqin, qënia e tyre në shumëllojshmëri të mëdhaja dhe me lëkura të larmishme, e gjitha kjo është një lavdërim për Krijuesin dhe përshkruajnë të Plotëfuqishmin. Ato përshkruajnë Atributet e Tij dhe i bëjnë Emrat e Tij të njohur, duke interpretuar se Ai dëshiron të njihet e të duhet prej shërbëtorëve të Tij dhe të shfaqë dhembshurinë e Tij për krijesat e Tij në varfëri.

Lavdia qoftë për Atë! Sa e qartë është prova e Tij! Sa e madhe është fuqia e Tij! Sa e dukshme është mëshira e Tij! Gjithëndertuesi, Gjithëformuesi, Gjithëkompozuesi, Gjithërregulluesi, Gjithëpërhapësi, Gjithësihariquesi!

Lavdia qoftë për Atë! Sa e hijshme është madhështia e Tij! Sa e madhërishme është bukuria e Tij! Sa i madh është sovraniteti i Tij!

Shikoje tokën mbi të cilën ti jeton dhe thuaj: “*Allahu Ekber*”. Shikoje universin dhe thuaj: “*Allahu Ekber*”. Ai është Krijuesi, Gjithëvepruesi, Gjithëhapësi, i Gjithëdituri, Gjithëdhënësi, Gjithëshpërndarësi! Ai është i Plotëpushtetshmi i Gjithurtë dhe Ai është Gjithëbujari Mëshirëplotë.

Në qoftë se do të doje ta dije kuptimin e “*Allahu Ekber*”, “*Zoti është më i Madhi*”, sodite universin. Ai përbëhet nga hijet e Dritave të Tij, nga rezultatet e akteve të Tij, rreshtat e penës së vendimit dhe të kaderit të Tij, qëndisjeve të Emrave të Tij dhe pasqyrave të Atributeve të Tij.

Mësoje, dhe thuaj *Allahu Ekber*! Vështroji botërat! Ato të gjitha mbahen në kapjen e njohjes së Tij, në kapjen e fuqisë së Tij, në kapjen e drejtësisë së Tij, në kapjen e urtësisë së Tij të mirërregulluar, të drejtëpeshuar e të harmonizuar. Rregulli i vëzhguar në univers është nëpërmjet rregullimit të Tij. Drejtëpeshimi është prej bërjes së Tij të drejtëpeshuar, të balancuar, që të dyja këto, rregulli dhe balanca, janë dy kapje të të Gjithëmëshirshmit dhe dy titujt e dy kapitujve prej Regjistrit të Qartë. Ky libër bashkë me atë Regjistër janë titujt e dukshëm të njohjes dhe fuqisë së të Plotëfuqishmit të Gjithëditur, të të Gjithëdrejtit të Gjithurtë. Nuk ndodhet asgjë jashtë rregullit të këtij sistemi dhe masës së këtij ekuilibri, drejtëpeshimi. Kjo tregon për dikë të drejtë e të ndjeshëm, për atë që ka sy në kokën e tij për të parë, se asgjë në hapësirë e në kohë nuk përjashtohet prej kapjes së administrimit të të Gjithëmëshirshmit.

Sodit dhe thuaj *Allahu Ekber*! Ai është i Gjithëdrejti, Gjithësunduesi. Ai është i Gjithurti dhe i Pavaruri, i Vetmi. Është Ai i Cili ushtron drejtësi dhe vepron me urtësi. Sepse Ai është i Cili e ndërtoi universin duke e drejtëpeshuar me rregullin e vullnetit dhe me urtësinë drejtuese. Parimet e urtësisë së Tij janë një sistem hallkash midis ekzistencash. Ai i dalloj të gjitha gjërat dhe qëniet si individë me

parimin e Vendimit të Tij dhe me ligjin e Kaderit dhe paracaktimit të Tij. Ligjet e kaderit përcaktojnë vijat dalluese të formave të qënieve. Ai e organizoi të gjithë universin me rregull nëpërmjet parimit të mënyrës së Tij të të veprimit dhe ligjeve të praktikës së Tij. Parimet e mënyrës së të vepruarit të Tij ligjet e praktikës së Tij, i vendosin krijesat në rregull. Sepse Ai bën çfarëdo që dëshiron dhe dekreton çfarëdo që Ai dëshiron në qiej dhe në tokë me mirësinë e mëshirës dhe me dorëgjërësinë e përkujdesjes. Ai e stolis universin me ligjet e mëshirës dhe me parimet e përkujdesjes, në të cilat të gjitha bukuritë e vëzhguara në krijesa kanë burimin e tyre. Ai e ndriçoi universin me manifestimet e Emrave dhe Atributeve të Tij, të cilët formojnë llampat e krijesave në qiej dhe në tokë.

Kuptoje këtë dhe thuaj *Allahu Ekber!* Ai është Krijuesi i Gjithëditur, është Autori i Gjithurtë. Ajo botë e madhe dhe kjo botë e vogël –njeriu– janë veprat e fuqisë së Tij dhe shpikjet e kaderit të Tij. Ai e krijoi të parën dhe e bëri atë një vend adhurimi; Ai shpiku të dytën dhe e bëri atë një adhurues. Ai e ndërtoi të parën e cila është prona e Tij dhe e ndërtoi të dytën, i cili është shërbëtori i Tij. Arti i Tij në të parën u shfaq si një libër, dhe ngjyrimi i Tij në të dytën u paraqit si ligjërimit. Fuqia e Tij e manifestuar në të parën shfaq dinjitetin dhe pushtetin e Tij, dhe mëshira e Tij në të dytën rregullon mirësitë e Tij mbi të. Stampa e Tij në të parën është e dukshme në tërësitë dhe pjesët, dhe vula e Tij në të dytën është mbi një trup si një i tërë dhe mbi gjymtyrët.

Shiko dhe thuaj *Allahu Ekber!* Ai është i Plotëfuqishmi i Vazhdueshëm. Ai është Krijuesi i Gjithëditur. Ai është i Mirinformuari i Hollë Gjithëbujar. Ai është Hirëploti Madhështor, është Skalitësi i Universit.

Në qoftë se ti njezh rreth universit, ai përbëhet nga pjesë, çdonjëra prej tyre është një shembull i tërësisë. Ai përbëhet nga botëra, të cilat si tërësi ose si pjesë duke përfaqësuar të tërat janë rreshtat dhe skalitjet e vendimit të Tij dhe vizatimet e kaderit të Tij, qoftë për sa ka të bëjë me organizimin e grimcave ose me përcaktimin e qëllimeve, ose me paracaktimin e formave.

Pastaj, vjen caktimi i limiteve në përputhje me dimensionet dhe veprat e fuqisë për të individualizuar format me vizoren dhe kompasin e kaderit në përputhje me qëllimet e caktuara për secilën. Duke parë dobitë lidhur me çdonjëren, kjo dëshmon për faktin se të gjithë rreshtat

e veçantë dallues të çdonjërës janë vizatuar prej Penës së të Gjithëditurit dhe rregullimit të të Gjithhurtit.

Pas individualizimit vjen përkujdesja për të stolisur format me dorën e saj të ndritshme. Format stolisën në mënyrën më të mirë të perceptueshme, e cila shfaq me siguri për dikë që ka sy për të parë se stolia dhe bukuria janë veprat e mirësisë së Tij, shenjat e dorëgjërësisë së Tij.

Pas stolisjes vjen bujaria e Tij për të stolisur për të bërë të bukur në një mënyrë për të treguar se Gjithëbujari dëshiron të duhet prej krijesave të Tij. Ai shfaq dëshirën e Tij për t'u njohur nga njerëzit dhe xhindët. Të gjithë bukuritë e dëshmuara dhe të gjithë shembujt e mirësisë burojnë prej dëshirës së Tij për t'u dashur e njohur. Krijuesi shfaq vullnetin e Tij për t'u dashur nga bërja e të gjitha veprave të Tij të bukura. I Plotëfuqishmi shfaq dëshirën e Tij për t'u njohur nga stolisja e veprave të Tij.

Pas dëshirës për t'u dashur, vjen mëshira e Tij për të dërguar mirësi dhe për të ruajtur krijimin e Tij. Ai shpërndan tryezat e Tij për kënaqësinë e qenieve të gjalla. Mëshira e Krijuesit është e dukshme në veprat e Tij. Dhembshuria e Furnizuesit –Rëzkdhënësit– e shfaq Vetveten nga frutat.

Përmbledhja

Kjo botë përbëhet në mënyrë të dukshme prej vijave dhe skalitjeve të Kaderit të Tij, qëndisjeve të Penës së Tij, stolisjeve të bujarisë së Tij dhe luleve të mirësisë së Tij.

Kur vështrohet me shikimin e besimit dhe të vërtetës, ajo përbëhet nga frutat e mëshirës së Tij, nga shkrepetimat e bukurisë së Tij dhe nga pasyrat e plotësisë së Tij. Çfarë vëzhgohet në emrin e bukurisë, çfarë shfaqen në emrin e plotësisë, ato janë të gjitha pasqyra lëvizëse dhe të ndryshueshme, hijet e dritës së Tij dhe shenjat e plotësisë së Tij. Ato tregojnë plotësinë e veprave të Tij.

Një vepër e plotë dëshmon ashtu siç do të pranohej nga një njeri me mend, për një akt të plotë. Një akt i plotë tregon, për ata që kuptojnë, një titull të plotë. Një titull i plotë në mënyrë të qartë tregon një atribut të plotë. Një atribut i plotë domosdoshmërisht shfaq një cilësi esenciale të plotë ose një potencial. Një cilësi esenciale e plotë ose një potencial tregon, me siguri për plotësinë e të Vetmit, i Cili është i Vërteti i Qartë, i Lartësuar në grada, Krijuesi i universit. Kjo shfaq për atë që ka sy për të parë se bukuria e dukshme mbi gjëra nuk u përket atyre. Zhdukja e pasqyrave dhe asgjësimi i krijësive, ndërkohë që Emrat Hyjnorë dhe Atributet vazhdojnë ta shfaqin Vetveten dhe të sjellin krijesa të reja në ekzistencë, është njëra prej provave më të qarta dhe më të shquara të bukurisë absolute dhe të dhuratave gjithnjë të ripërtërira të Ekzistuesit të Vetëm të Domosdoshëm, të të Qëndrueshmit përjetësisht dhe të të Dashurit.

Njihe dhe thuaj Allahu Ekber! Ai është Krijuesi Madhështor. Është Vepruesi i Gjithëfuqishëm. Objektet e kësaj bote, stolitë tokësore, trupat qiellorë, yjet si perla në kopështin e universit janë mrekullitë e fuqisë së Tij, dëshmitarët e urtësisë së Tij dhe provat e të Vetmit Një dhe të Plotëfuqishmit, të Kërkuarit përjetësisht.

Lavdia qoftë për Atë, i Cili e ka bërë kopështin e tokës ekspozitën e Artit të Tij! Bimët në lulëzim, pemët frutdhënëse, kafshët e stolisura, zogjtë e këndshëm e të bukur janë mrekullitë e artit të Tij, dëshmitarët e njohjes së Tij dhe dëshmitë e mirësisë së Tij. Buzëqeshja e luleve të cilat janë stolitë e frutave në këto kopështe shfaq dëshirën e Mëshiruesit për t'u dashur, dhe dëshirën e Mirëbërësit për t'u njohur prej xhindëve dhe njerëzve dhe prej shpirtërave dhe kafshëve, dhe gjithashtu dhembshurinë e të Dhembshurit të Vetëm ndaj tyre. Lulet dhe frutat, kokërrat dhe farërat janë mrekullitë e Urtësisë, dhuratat e Mëshirës, dëshmitë e Unitetit. Ato gjithashtu janë dhuratat e ofruara në këtë botë për të dhënë silariqe, lajme të gëzueshme, se ngjashmëritë e tyre do të jepen në tjetrën. Përsëri, ato janë dëshmitarë të vërtetë se Autori i tyre ka njohje të plotë për të gjitha gjërat dhe se Ai i përfaqon të gjitha gjërat me mëshirë e njohje dhe me mirëbërësi dhe organizim e rregullsi. Dielli ose një grimcë e vockël, një yll ose një lule, dheu ose një vezë, asgjë nuk është e vështirë për Të, për të krijuar e mbajtur, për të ruajtur dhe për të dhënë formë dhe për të bërë dhe për të pajisur.

Kuptoje këtë dhe thuaj Allahu Ekber! Ai është Sovrani i Parapërdjetshëm. Ai është Sundimtari i përjetësisë. Ai është Mbreti i Përhershëm. Sodite faqen e qiellit! Ti do të shohësh një heshtje në qetësi, një lëvizje me urtësi, një rrezatim me madhështi, një buzëqeshje me stoli, me rregull në krijim. Vezullimi i yjeve të tij shpall për inteligjentët një sovranitet të pambarim. Këto objekte të ndritshëm, ato planete rrotullues janë dëshmi të shndritshme dhe dëshmitarë dritëdhënës duke shpallur fuqinë dhe dinjitetin e Madhështisë Hyjnore, duke shfaqur madhërinë e Sovranitetit të Zotit, duke zbuluar madhësinë dhe gjerësinë e Fuqisë së Tij, dhe duke treguar urtësinë e Tij gjithëpërshirëse.

Beso dhe thuaj Allahu Ekber! E Tij është madhëria në qiej dhe në tokë dhe Ai është i Gjithëpushtetshmi i Gjithurtë.

Lavdia qoftë për Atë, për ezistencën e domosdoshme të të Cilit dhe për Unitetin ndodhen dy dëshmitarë në çdo gjë!

Lavdia qoftë për Atë, për Njësinë e të Cilit dhe për Qënien i Kërkuari përjetësisht ndodhen dy shenja në çdo gjë!

Lavdia qoftë për Atë, stampa e të Cilit është vënë në ballin e krijesave si një dëshmitar i vërtetë dhe si një dëshmi folëse!

Vështroji veprat e Tij! Ti do të shohësh aq ndritshëm si mëngjesi një bollëk absolut dhe një rregull absolut. Në krijimin dhe në administrimin e të gjitha gjërave, ti do të shohësh një rregullsi dhe balancë absolute pavarësisht lehtësisë absolute; një art absolutisht të bukur pavarësisht shpejtësisë absolute; një qëndrueshmëri absolute pavarësisht bollëkut absolut; një lirësi absolute pavarësisht një vlere absolute; një përzierje absolute pavarësisht dallueshmërisë absolute; një pajtueshmëri absolute pavarësisht largësisë absolute; një plotësi absolute pavarësisht shumësisë absolute. Kjo në mënyrë të hapur e vendimtare shfaq për atë që ka mend dhe e detyron hipokritin e marrë të pranojë se i Vërteti është Një, duke pasë fuqi absolute dhe Ai është Njohësi Absolut.

Mendo rreth kësaj dhe thuaj: Nuk ka krijues veçse Ai! Nuk ndodhet asnjë tjetër përveç Atij i Cili e krijon çdo gjë me një natyrë të veçantë për të.

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

“A nuk e sheh se Allahut i bie me fytyrë në tokë në sexhde kushdo që është në qiej dhe kushdo që është në tokë, edhe dielli, edhe hëna, edhe yjet, edhe malet, edhe pemët, edhe të gjitha gjallesat dhe shumë nga njerëzit? Por ka shumë njerëz mbi të cilët është i merituar e i përligjur ndëshkimi dhe këdo që turpëron Allahu, askush nuk mund ta nderojë atë. Sigurisht që Allahu bën çdo gjë që Ai do”²⁶⁷

Mësoje, o shok! Kurani i shenjtë deklaroi hapur: Të gjitha gjërat nga Froni më i lartë për tek toka, nga yjet te insektet, prej engjëjve tek peshqit dhe prej planetëve tek grimcat e materies adhurojnë Zotin, bien në sexhde para Tij dhe e lëvdajnë dhe e lartësojnë Atë në mënyra të ndryshme të veçanta për secilën. Ne do të tregojmë vetëm ca prej këtyre rrugëve.

Për shembull, dhe për Allahun është krahasimi më i lartë, kur një mbret i madh dëshiron t'i ketë një qytet të madh dhe një pallat madhështor të ndërtuar, ai punëson katër llojë punonjësish:

I pari: Janë skllëverit e tij. Ata nuk kanë as rroga, as shpërblime. Ata marrin kënaqësi në çfarëdo që ata bëjnë me urdhërin e tij, gjithnjë flasin me vlerësim për të dhe janë të kënaqur me nderin e të qenurit i lidhur me të dhe duke punuar për llogari të tij.

I dyti: Janë njerëz të zakonshëm, të cilët mbreti i punëson në këmbim për një pagë të vogël të veçantë për ta. Ata nuk e dinë se çfarë qëllimesh të mëdhaja synohen për punën e tyre. Madje, disa prej tyre mendojnë se nuk ka qëllim për qënien e tyre të punësuar përveç pagës së vogël që u jepet atyre.

I treti: Janë kafshët që i përkasin vetë mbretit. Ato nuk mund të kenë paga përveç ushqimit dhe kënaqësisë që ato marrin në punën dhe në detyrat e përshtatshme për potencialin e tyre. Ndodhet një kënaqësi në vënien e potencialit në efekt.

²⁶⁷Kur'an, 22:18

I katërti: Janë punëtorët të cilët e dinë çfarë bëjnë dhe punëtorët e tjerë dhe përse ata punojnë. Ata gjithashtu i dinë qëllimet e mbretit. Punëtorët e kësaj klase kanë gjithashtu detyrat e inspektimit mbi punëtorët e tjerë. Ata marrin paga në përputhje me rangjet e tyre.

Në të njëjtën mënyrë, Pronari i qiejve dhe i tokës dhe Ndërtuesi i tyre i punëson dhe u shkakton melekëve, kafshëve, objekteve të pajeta, bimëve dhe qenieve njerëzore të bëjnë adhurim. Por, Ai nuk bën kështu nga nevoja sepse Ai është Krijuesi i tyre dhe krijuesi i asaj çfarë ata bëjnë. Por ajo kërkohet prej dinjitetit të Tij, madhësisë dhe cilësive esenciale të Hyjnisë së Tij dhe kështu me rradhë.

Melekët nuk fitojnë gradim –ngritje– nga përpjekja. Secili prej tyre ka një rang të përcaktuar e të fiksuar, por mer kënaqësi të veçantë prej vetë punës dhe një rrezatim në përpjestim me gradën e tij në aktin e adhurimit që ai bën. Shpërblimi për shërbimet e tyre përfshihet në vetë shërbimet. Ashtu si njeriu që ushqehet me ajër, ujë, dritë dhe ushqim, dhe merr kënaqësi prej tyre, po ashtu melekët ushqehen me dritat e dhikrit, përmendjes, lavdërimit, tesbihatit, njohjes dhe me dashurinë ndaj Allahut, dhe marrin kënaqësi prej tyre. Sepse, meqenëse ato janë krijuar prej drite, drita dhe gjërat e afërta me dritë të tilla si parfumet, aromat janë të mjaftueshme si ushqim për ta. Ata ndjejnë lumturi të madhe në detyrat që ata kryejnë me urdhërin e të Vetmit që ata adhurojnë, në aktet që ato bëjnë për hir të Tij, në shërbimin që ata japin në Emrin e Tij, në mbikëqyrjen që ata ushtrojnë nëpërmjet shikimit të Tij. Ata gjejnë lumturi të madhe në nderin që ata fitojnë nëpërmjet lidhjes me Të, në ‘rifreskimin’ që ata gjejnë në studimin e dimensioneve materiale dhe jomateriale të mbretërisë së Tij, dhe në kënaqësinë që ato kanë në vëzhgimin e manifestimeve të Mirësisë dhe të Madhësisë.

Sa për kafshët, meqenëse ato kanë një nefsi oreksmadh dhe aftësinë e një vullneti të pjesshëm, puna e tyre nuk është thjesht për hir të Zotit. Si rrjedhojë, Pronari i tyre Gjithëbujar u jep atyre pagë për punën e tyre. Për shembull, Krijuesi i Gjithurtë e vë në shërbim bilbilin që shquhet për dashurinë për trëndafilin, për të shpallur lidhjen e fortë ndërmjet specieve dhe bimëve. Bilbili është një orator i Zotit midis kafshëve, të cilët janë mysafirë të të Gjithëmëshirshmit, dhe është i ngarkuar për të brohoritur dhuratat e Furnizuesit të tyre dhe për të shpallur gëzimin e tyre lidhur me këtë. Ai gjithashtu ka detyrën për të

njoftuar mirëseardhjen e dhënë për bimët në këmbim për ndihmën që bimët u japin kafshëve, dhe për të deklaruar mbi bimët e bukura nevojën e madhe të kafshëve për bimët, ai ofron një mirënjohje shumë të bukur ndaj madhërisë së Pronarit të të gjithë sundimit, Zotëruesit të madhështisë, bukurisë dhe dorëgjërësisë, me përmallimin më të këndshëm dhe në një formë më të hollë. Bilbili vepron për t'i arritur këto qëllimi për hir të të Gjithëlavdishmit. Ai flet me gjuhën e tij të veçantë; ne i kuptojmë këto kuptime prej tij, edhe pse ai vetë nuk i di kuptimet e melodive të tij. Mosdija e bilbilit për ato qëllime me të gjitha detajet e tyre nuk do të thotë se ai nuk është vënë në shërbim për to. Është ashtu si një orë që të tregon ty kohën, ndonëse vetë nuk është e vetëdijshme për atë çfarë ajo bën. Sa për pagën e bilbilit, ajo është kënaqësia që ai merr në shikimin e luleve buzëqeshëse, dhe gëzimi që ai merr me bashkëbisedimin me to. Këngët e tij prekëse nuk janë ankesa që burojnë prej pikëllimeve shtazore; përkundrazi, ato janë falënderime për dhuratat e të Gjithëmëshirshmit të Vetëm.

Ti mund të krahasosh me bilbilin bletën, merimangën, milingonën dhe me 'bilbilat' midis insekteve dhe kështu me rradhë. Për secilin prej tyre, një kënaqësi e veçantë si pagë është përfshirë në detyrat e tyre. Ashtu si dikush i punësuar në një anije mbretërore, ato u shërbejnë disa detyrave të rëndësishme dhe artit të Krijuesit. Ato zbatojnë urdhërat e Zotit në krijim dhe në funksionimin e universit me bindje të plotë dhe si rrjedhojë shfaqin qëllimet për krijimin e tyre në Emrin e Tij në mënyrën më të mirë dhe i harxhojnë jetët e tyre në përmbushjen e detyrave të tyre në fuqinë e Tij në mënyrën më të mrekullueshme. Në këtë mënyrë, ata paraqesin dhuratat e adhurimit të tyre dhe virtytet e nënshtimit të tyre ndaj Krijuesit të tyre. Adhurimi i tyre dhe nënshtimi do të thotë manifestimi i tyre aktual i qëllimeve të kërkuara të jetëve të tyre nga Dhënësi i jetës.

Sa për bimët dhe objektet e pajeta, meqenëse ato nuk kanë vullnet të lirë, atyre nuk u jepet ndonjë pagë. Ato bëjnë me fuqinë e Zotit dhe në Emrin e Tij dhe thjesht për hir të Zotit çfarëdo që ato bëjnë dhe çfarë u kërkohet atyre prej Dëshirës Hyjnore. Por, ashtu siç mund të konkludohet prej vëzhgimit të tyre, bimët kanë ca lloj kënaqësie në përmbushjen e detyrave të tyre, por ndryshe nga qëniet e gjalla që kanë zgjedhje të lirë, ato nuk vuajnë dhimbje. Rezultatet e veprave të bimëve dhe të objekteve të pajeta janë më të plota se ato të kafshëve për shkak se asnjë zgjedhje e lirë nuk ka pjesë në to. Midis krijesave shtazore të

cilat kanë një lloj zgjedhje, puna e atyre si bletët dhe të tjerat të ngjashme me to që janë pajisur me një lloj inspirimi është më e fortë se ajo e të tjerave të cilat mbështeten mbi vullnetin e tyre.

Për sa ka të bëjë me qëniet njerëzore, ato u ngjasojnë melekëve në universalitetin e adhurimit të tyre, në shtrirjen e mbikëqyrjes së tyre, gjithëpërfshirjes së njohjes së tyre dhe qënies së tyre lajmëtarë të Perëndisë Hyjnore. Në të vërtetë, njeriu është më gjithëpërfshirës në natyrë se sa melekët. Meqenëse ai ka një nefsi oreksmadh të prirur ndaj të keqes, ai ka një kapacitet për gati përparim të pakufishëm ose për rënie. Për sa ka të bëjë me kërkimin e kënaqësisë për vetveten në punën e tij dhe një pjesë për vetveten, ai u ngjason kafshëve dhe ka dy lloje pagash, njëra shtazore, e parëndësishme dhe e menjëhershme, tjetra ëngjëllore, universale dhe e shtyrë për më vonë.

Meqenëse ne i kemi diskutuar në shumë pjesë të Risale-i Nurit kuptimin, përmbajtjet dhe rezultatet e adhurimit të njeriut dhe detyrën dhe adhurimin dhe tesbihatin e bimëve dhe të objekteve të pajeta, ne nuk do të bëjmë shpjegim të mëtejshëm këtu.

Një shtojcë për diskutimin mbi bilbilin

Mos mendo se të kënduarit dhe të njoftuarit e tesbihateve për Zotin i atyre me aftësinë e dëgjimit është e veçantë vetëm për bilbilin. Përkundrazi, çdo specie ka një ‘bilbil’ të vet duke përfaqësuar ndjenjat më të holla të asaj specie me tesbihatin më të hollë në vargun më të hollë. ‘Bilbilat’ e parazitëve dhe të insekteve në mënyrë të veçantë, janë edhe të shumtë, edhe të ndryshëm. Ato e këndojnë tesbihatin e tyre në poezi të hollë për anëtarët e tjerë të specieve të tyre dhe i japin kënaqësi cilitdo që i dëgjon.

Disa prej atyre bilbilave janë kafshë nate, somnambul. Sikur secili të ishte kryetari i një rrethi duke recituar në heshtje Emrat e Zotit. Miqtë recitues të poezisë prej të gjitha kafshëve të vogëla i këndojnë tesbihatet e tyre për Zotin në qetësinë e heshtur të natës. Kënga është si

një gjuhë e përbashkët për të gjithë, të cilën gjithkush me fuqinë e dëgjimit dhe me ndjenjat mund ta kuptojë.

Një grup tjetër i atyre kafshëve është ditor, kafshë dite. Gjatë ditës në pranverë e verë, sikur secili të ishte kryetari i një rrethi duke recituar me zë të lartë Emrat e Zotit, ato shpallin tesbihatet në varg të hollë ndaj qënieve të gjalla prej ‘predikatoreve’ të pemëve dhe i çojnë në ekstazë ata që i dëgjojnë.

Profeti Muhammed a.s.m është më i virtytshmi i të gjitha qënieve dhe më i shquari, më i nderuari, më i ndrituri, më i thelli, më i madhi dhe më fisniku i bilbilave. Zëri i tij është më i larti dhe më lirik, atributet e tij janë më të ndritshmet, recitimi i Emrave të Zotit nga ana e tij janë më të plotat dhe më gjithëpërfshirëset, dhe falënderimet e tij janë më universalet. Profeti Muhammed a.s.m është bilbili i njerëzimit, duke kënduar në kopështin e universit. Ai nëpërmjet këngëve dhe melodive të tij më të këndshme është bërë bilbili i të gjitha krijesave në qiejt dhe në tokën mbi të, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij, profetët e tjerë, qofshin më të mirat e bekimeve dhe të paqës.

Mësoje, o shok! Fakti se një kafshë lindet në botë me një shkathtësi dhe me njohjen praktike që asaj do t’i nevojitet gjatë jetës së saj shfaq se ajo dërgohet në botë vetëm për të punuar, dhe jo për t’u plotësuar nëpërmjet të mësuarit. Ndërsa njeriu, lindet në injorancë të plotë dhe me pafuqi që i nevojitet të mësojë gjatë gjithë jetës së tij për të plotësuar domosdoshmëritë e jetës së tij. Kjo tregon se ai dërgohet në dynja për t’u plotësuar nëpërmjet të mësuarit dhe adhurimit, dhe jo për të punuar vetëm për jetën e tij. Ajo çfarë i kërkohet të bëjë për jetën e tij është të organizojë aktet e bimëve dhe të kafshëve, të cilat Allahu ia ka nënshtruar atij dhe të përfitojë prej ligjeve të mëshirës. Detyra e tij reale është të adhurojë, të lutet, të përgjërohet dhe të kërkojë prej të Vetmit, i Cili ia ka nënshtruar atij krijimin për shkak të dobësisë dhe pafuqisë së tij të pakufishme dhe varfërisë dhe nevojave të pakufishme. Ai duhet të fitojë njohje rreth Tij i Cili e ka bërë atë më të nderuarin e krijimit dhe e ka pajisur me atë që do t’i duhet për adhurim. Ai duhet të gjejë lumturi duke studiuar krijimin dhe urtësinë në të në një mënyrë që do ta çonte tek njohja e Krijuesit të kozmosit me Emrat e Tij, Atributet, madhësinë, bukurinë dhe plotësinë. Çdo studim i cili nuk e bën atë të fitojë këtë njohje do të ishte i padobishëm esencialisht dhe do të shkaktonte shmangie.

O Zot! Na bëj ne shërbëtorët e Tu duke të të adhurar me sinqeritet kurdo dhe në cilindo rang që të jemi dhe duke t'u lutur Ty si Zotin tonë dhe duke qenë të preokupuar me fitimin e njohjes rreth Teje! Amin!

Mësoje, o shok! Meqenëse Krijuesi i Gjithurtë është absolutisht i Lirë prej çdo pafuqie dhe është plotësisht Dorëgjërë, Ai e krijon një grimcë ashtu siç krijon diellin; Ai i jep një grimce të njëjtin lloj ekzistence ashtu siç i jep diellit. Gjithashtu, ashtu siç Krijon Ai më të vogëlën e formave të bimëve, po ashtu Ai krijon edhe më të madhen e pemëve. Ashtu siç krijon melekun inspektues dhe duke menaxhuar lëvizjen e diellit, po ashtu Ai krijon melekun inspektues dhe duke menaxhuar një pikë të vetme shiu. Ashtu siç krijon Ai më të madhen e kafshëve, po ashtu Ai krijon më të vogëlën midis tyre. Nga më e vogëla e krijesave për tek më e madhja, të gjitha e adhurojnë Atë dhe i binden Atij. Sidoqoftë, e vogël apo e madhe dhe ekzistuese me bollëk apo me pakicë, të kufizuara në numër, të gjitha krijesat kanë detyra të përshtatshme për secilën dhe lidhet me qëllimin për ekzistencën e çdonjërës. Ato janë caktuar nga i Vetmi.

“Sigurisht që urdhëri i Tij kur Ai e do një gjë është vetëm se Ai t’i thotë asaj “Bëhu!” dhe ajo është bërë (në çast)! Kështu pra, i lavdëruar qoftë Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ata ia bashkojnë Atij në Duart e të Cilit është mbizotërimi i çdo gjëje dhe tek Ai ju të gjithë do të ktheheni!”²⁶⁸

Mësoje, o musliman! Sheriati Islam të jep ty mundësinë që t’i bësh të gjitha aktet dhe veprat e tua të përditshme një thesar për jetën tënde të pastajme dhe një elikzir të madh. Veprat e tua më të zakonshme mund të bëhen një akt adhurimi dhe pakujdesia jote mund të ndryshohet në një prokopi të paqshme. Për shembull, merr parasysh dhe përmend urdhëresën përkatëse të shariatit kur ti bën pazar ose biznes dhe shprehi fjalët e dekretuara prej tij kur të përfundosh blerjen ose shitjen. Përveç ndjenjës së një lloji gëzimi për shkak të bërjes së një akti adhurimi, ti gjithashtu do të merrje shpërblim shpirtëror në këmbim për të. Myzhde është për atë i cili i ndryshon aktet e tij në akte adhurimi, dhe si rrjedhojë i ndriçon ato nëpërmjet zbatimit edhe të urdhëresave dytësore të shariatit. I lumtur është ai të cilit Allahu i mundëson të ndjekë profetin a.s.m në të gjitha aktet dhe veprat e tij dhe

²⁶⁸Kur’an, 36:82–83

si rrjedhojë e bën jetën e tij të përkohshme të fitojë fruta të panumërta që zgjasin e vazhdojnë përgjithmonë. Sa fatkeq është ai të cilin Allahu e ka poshtëruar për shkak se ai ndjek dëshirat shtazore e kapriçot dhe i cili i ka marrë nefsin dhe tekat e tij si zot dhe kështu jeta e tij kalon e gjitha më kot.

O Zot! Na jep sukses në kënaqësinë Tënde dhe të punojmë me librin Tënd dhe me sunnetin e profetit Tënd a.s.m! Amin!

Mësoje, o shok! Midis qënieve njerëzore disa janë barinj të cilët mbikëqyrin jetët dhe funksionet e disa specieve të kafshëve. Midis tyre ka fermerë që preokupohen me rritjen e disa bimëve. Gjithashtu, midis melekëve disa inspektojnë kafshët e shpërndara mbi faqen e tokës dhe si rrjedhojë mund të quhen “barinj”. Por, inspektimi i tyre është i ndryshëm nga ai i qënieve njerëzore dhe ata e bëjnë atë thjesht në Emrin e Zotit, për hir të Tij dhe me urdhërin e fuqinë e Tij. Ato vëzhgojnë manifestimet e Hyjnisë mbi speciet e kafshëve dhe studiojnë aktet e fuqisë dhe të mëshirës mbi to. Ato inspirojnë urdhërat Hyjnore tek ato për të drejtuar jetët e tyre.

Disa nga melekët inspektojnë shpërndarjen e bimëve në fushat e tokës me lejen e Allahut, me fuqinë, urdhërin dhe në Emrin e Tij. Inspektimi i tyre konsiston në përfaqësimin dhe shpalljen e tesbihateve të bimëve për Krijuesin e tyre dhe bindjen e tyre ndaj Tij, përveç organizimit dhe mbrojtjes së përdorimit të tyre aparatet –gjymtyrët– që u janë dhuruar atyre. Melekët nuk kanë autoritet të vërtetë mbi speciet e kafshëve dhe të bimëve me një efekt krijues, sepse mbi çdo gjë është një stampë e veçantë që tregon se Ai është Krijuesi i të gjitha gjërave, i Cili e ka krijuar dhe e drejton atë; inspektimi i melekëve është adhurimi i tyre ndaj Allahut. Meleku Mikail a.s i cili është midis atyre që mbajnë Fronin e providencës Hyjnore, atyre që i përcjellin mirësitë Hyjnore tek krijesat me vullnetin e Tij, fuqinë, lejen dhe në Emrin e Tij, e bën detyrën e tij të adhurimit duke inspektuar bimët në faqen e tokës. Ndodhen shumë melekë të tjerë, çdonjëri prej të cilëve inspekton një specie të veçantë me urdhërin e Tij. Gjithashtu, ndodhen melekë që inspektojnë speciet e kafshëve.

Në qoftë se dëshiron ta kuptosh këtë realitet, vështroje tokën se si Krijuesi i Gjithurtë e ka bërë Atë një fushë të madhe dhe një kullotë të gjërë për bimët dhe kafshët. Pastaj, shikoj llojet e bimëve të shpërndara mahnitshëm mbi një rregull të çuditshëm duke shpërndarë

rreth e qark farërat e tyre sipas urtësisë së Krijuesit të tyre të Gjithëfuqishëm e të Gjithëditur. Gjithashtu, shikoji kafshët e shpërndara në një mënyrë të mrekullueshme e të mahnitshme. Ato i mbajnë jetët e tyre në tokë e në det në një mënyrë të rregullt nëpërmjet përkujdesjes së Krijuesit të tyre të Gjithurtë e Gjithëbujar, madhështia e Tij goftë e lartësuar dhe nuk ka zot tjetër përveç Atij.

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

O Allah! O i Gjithëmëshirshëm! O Mëshirëplotë! O i Pavarur! O i Gjalli i Përjetshëm! O i Gjithurtë! O i Drejtë! O i Shenjtë! Për hir të Emrit Tënd më të Madh, vendosi studentët e Risale-i Nurit, të cilët e botojnë këtë “El Methnevi En-Nurijeh” në Xhennetin El Firdeus, dhe jepu atyre lumturi të përjetshme atje. Bëji ata gjithmonë të suksesshëm në shërbim të besimit dhe të Kuranit. Shkruaju, o Zot, në regjistrat e tyre të veprave shumë shpërblime shpirtërore për secilën nga shkronjat e këtij libri. Amin. Amin. Amin. Për hir të mëshirës Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve!

Said Nursi